

RAPORTI I VLERËSIMIT

**të përputhshmërisë së Kosovës me standardet ndërkombëtare
në parandalimin e pastrimit të parave
dhe luftimin e financimit të terrorizmit**

PËRMBAJTJA

SHKURTESAT	4
PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE	6
Gjetjet kryesore	6
Rreziqet dhe gjendja e përgjithshme	8
Niveli i përgjithshëm i efektivitetit dhe përputhshmërisë teknike	8
Veprimet me përparësi	15
Vlerësimi për efektivitetin dhe përputhshmërinë teknike	16
RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDËRSJELLË	17
Parathënie	17
KAPITULLI 1. RREZIQET DHE RRETHANAT E PP/FT-së	18
Rreziqet e PP/FT-së dhe studimi i çështjeve me rrezik më të lartë.....	18
Rëndësia	21
Elementët strukturorë	21
Prapavija dhe faktorët rrethorë	22
KAPITULLI 2. POLITIKAT DHE BASHKËRENDIMI VENDOR PËR PPP/LFT-në	29
Gjetjet kryesore dhe veprimet e rekomanduara	29
Rezultati i Menjëhershëm 1 (Rreziku, politikat dhe bashkërendimi)	31
KAPITULLI 3. SISTEMI JURIDIK DHE ÇËSHTJET OPERATIVE	41
Gjetjet kryesore dhe veprimet e rekomanduara	41
Rezultati i Menjëhershëm 6 (Inteligjenca financiare për PP/FT-në)	44
Rezultati i Menjëhershëm 7 (Hetimi dhe ndjekja penale)	58
Rezultati i Menjëhershëm 8 (Konfiskimi)	68
KAPITULLI 4. FINANCIMI I TERRORIZMIT DHE FINANCIMI I PËRHAPJES	77
Gjetjet kryesore dhe veprimet e rekomanduara	77
Rezultati i Menjëhershëm 9 (Hetimi dhe ndjekja penale e FT-së)	80
Rezultati i Menjëhershëm 10 (Masat parandaluese për FT-në dhe sanksionet financiare)	89
Rezultati i Menjëhershëm 11 (Sanksionet financiare për FP-në)	93
KAPITULLI 5. MASAT PARANDALUESE	96
Gjetjet kryesore dhe veprimet e rekomanduara	96
Rezultati i menjëhershëm 4 (Masat parandaluese)	98
KAPITULLI 6. MBIKËQYRJA	105
Gjetjet kryesore dhe veprimet e rekomanduara	105
Rezultati i menjëhershëm 3 (Mbikëqyrja).....	107
KAPITULLI 7. PERSONAT DHE MARRËVESHJET JURIDIKE	114
Gjetjet kryesore dhe veprimet e rekomanduara	114
Rezultati i Menjëhershëm 5 (Personat dhe marrëveshjet juridike)	115
KAPITULLI 8. BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR	122
Gjetjet kryesore dhe veprimet e rekomanduara	122

Rezultati i Menjëhershëm 2 (Bashkëpunimi ndërkombëtar)	123
SHTOJCA E PËRPUTSHMËRISË TEKNIKE	133
Rekomandimi 1 – Vlerësimi i rrezikut dhe zbatimi i qasjes së bazuar në rrezik.....	133
Rekomandimi 2 – Bashkëpunimi dhe bashkërendimi kombëtar	135
Rekomandimi 3 – Vepra e pastrimit të parave	137
Rekomandimi 4 – Konfiskimi dhe masat e përkohshme.....	139
Rekomandimi 5 – Vepra e financimit të terrorizmit.....	141
Rekomandimi 6 – Sanksionet financiare të shënjestruara lidhur me terrorizmin dhe financimin e terrorizmit.....	144
Rekomandimi 7 – Sanksionet financiare të shënjestruara lidhur me përhapjen	145
Rekomandimi 8 – Organizatat Jofitimprurëse (OJF)	146
Rekomandimi 9 – Ligjet e fshehtësisë për institucionet financiare	150
Rekomandimi 10 – Kujdesi i duhur ndaj klientit	151
Rekomandimi 11 – Ruajtja e të dhënave.....	160
Rekomandimi 12 – Personat e ekspozuar politikisht	162
Rekomandimi 13 – Korrespondenca bankare	163
Rekomandimi 14 – Shërbimet e transferimit të parave apo valutës	164
Rekomandimi 15 – Teknologjitë e reja.....	165
Rekomandimi 16 – Transfertat elektronike	166
Rekomandimi 17 – Mbështetja te palët e treta.....	170
Rekomandimi 18 – Kontrollat e brendshme dhe degët e filialet e huaja.....	171
Rekomandimi 19 – Vendet me rrezikshmëri më të lartë	174
Rekomandimi 20 – Raportimi i transaksioneve të dyshimta	175
Rekomandimi 21 – Zbulimi dhe konfidencialiteti	175
Rekomandimi 22 – BPCJF-të: Kujdesi i duhur ndaj klientit	176
Rekomandimi 23 – BPCJF-të: Masat e tjera.....	180
Rekomandimi 24 – Transparenca dhe pronësia përfituese e personave juridikë.....	182
Rekomandimi 25 – Transparenca dhe pronësia përfituese e marrëveshjeve juridike	186
Rekomandimi 26 – Rregullimi dhe mbikëqyrja e institucioneve financiare.....	187
Rekomandimi 27 – Kompetencat e mbikëqyrësve	192
Rekomandimi 28 – Rregullimi dhe mbikëqyrja e BPCJF-ve.....	193
Rekomandimi 29 – Njësia e Inteligjencës Financiare (NjIF)	196
Rekomandimi 30 – Përgjegjësitë e autoriteteve të zbatimit të ligjit dhe të hetimit.....	199
Rekomandimi 31 – Kompetencat e autoriteteve të zbatimit të ligjit dhe të hetimit	200
Rekomandimi 32 – Korrierët e parave të gatshme.....	201
Rekomandimi 33 – Statistikat.....	204
Rekomandimi 34 – Udhëzimet dhe informatat kthyese	205
Rekomandimi 35 – Sanksionet	206
Rekomandimi 36 – Instrumentet ndërkombëtare	209
Rekomandimi 37 – Ndihma e ndërsjellë juridike.....	209
Rekomandimi 38 – Ndihma e ndërsjellë juridike: ngrirja dhe konfiskimi	211
Rekomandimi 39 – Ekstradimi	212
Rekomandimi 40 – Format e tjera të bashkëpunimit ndërkombëtar.....	213
SHTOJCA II: Gjetjet kyçe të përputhshmërisë së Kosovës me Direktivën e 4^{ët} të BE-së për PPP-në.....	228

SHKURTESAT

AAPSK	Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe Konfiskuar
AIF	Raport i informatave shtesë (shkurtimi nga gjuha angleze)
AKI	Agjencia e Kosovës për Inteligjencë
AME	Autoriteti i Mbikëqyrjes Evropiane
ARBK	Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës
ASHM	Armë të Shkatërrimit në Masë
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
AZL	Autoritet/Agjenci e Zbatimit të Ligjit
BE	Bashkimi Evropian
BPCJF	Biznes apo Profesion i Caktuar Jofinanciar
BPV	Bruto Produkti Vendor
BQE	Banka Qendrore Evropiane
BQK	Banka Qendrore e Kosovës
DBE	Direktiva e Bashkimit Evropian
DBJN	Departamenti për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar
DRNOJQ	Departamenti për Regjistrim dhe Ndërlidhje me OJQ-të
DHKEK	Drejtoria për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit (në PK)
DK	Dogana e Kosovës
EULEX	Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë
EUROPOL	Agjencia e Bashkimit Evropian për Bashkëpunim në Zbatimin e Ligjit
FATF	Task Forca për Veprim Financiar
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
FP	Financimi i Përhapjes
FT	Financimi i Terrorizmit
goAML	Sistemi elektronik i NjIF-it për menaxhimin e të dhënave
GPQ	Grupi Punues Qeveritar
IAIS	Shoqata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Sigurimeve
IF	Institucion Financiar
IFJB	Institucion Financiar Jobankar
ILECU	Njësia për Bashkëpunim Ndërkombëtar në Zbatim të Ligjit
IMF	Institucion Mikrofinanciar
INB	Instrumenti i negociueshëm i bartësit
INTERPOL	Policia Ndërkombëtare
IOSCO	Organizata Ndërkombëtare e Komisioneve të Letrave me Vlerë
KDK	Kujdesi i Duhur ndaj Klientit
KDSh	Kujdesi i Duhur i Shtuar
KE	Komisioni Evropian
KiE	Këshilli i Evropës
KKLKE	Koordinatori Kombëtar për Luftimin e Krimit Ekonomik
KP	Kodi Penal
KPP	Kodi i Procedurës Penale
LFT	Luftimi i Financimit të Terrorizmit
LHT	Luftëtar i Huaj Terrorist
Ligji për PPP/LFT-në	Ligji për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit
LKK	Lufta kundër Korrupsionit
MAP	Ministria e Administratës Publike
MD	Ministria e Drejtësisë
MF	Ministria e Financave
MM	Marrëveshje e Mirëkuptimit
MONEYVAL	Komiteti i Ekspertëve për Vlerësimin e Luftës kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit, Këshilli i Evropës
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MPJ	Ministria e Punëve të Jashtme
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
NNJ	Ndihma e Ndërsjellë Juridike
NjIF	Njësia e Inteligjencës Financiare

NjPIARK	Njësia e Përbashkët për Inteligjencë, Analizë të Rrezikut dhe Kërcënimeve
OJF	Organizatë jofitimprurëse
OJQ	Organizatë joqeveritare
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
OSHTK	Ofrues i Shërbimit(eve) për Truste dhe Kompani
PEP	Person i Ekspozuar Politikisht
PK	Policia e Kosovës
PP	Pastrimi i Parave
PPJ	Përgjegjësia e Personave Juridikë për Vepra Penale (Ligji për)
PPP/LFT	Parandalimi i Pastrimit të Parave/Luftimi i Financimit të Terrorizmit
PSO	Procedurë Standarde e Operimit
PSRK	Prokuroria Speciale e Kosovës
PT	Përputhshmëria Teknike
QKMK	Qendra Kombëtare për Menaxhim Kufitar
R.	Rekomandim
RKSKB	Rezolutë e Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara
RM	Rezultat i Menjëhershëm
RTD	Raport i Transaksionit të Dyshimtë
RTG	Raport i Transaksionit në Para të Gatshme
RTP	Raport i Transaksionit të Pazakonshëm
SFSh	Sanksonet Financiare të Shënjestruara
SOCTA	Vlerësimi i kërcënimit nga krimet e rënda dhe krimi i organizuar
ShTPV	Shërbim i Transferimit të Parave apo Valutës
TI	Teknologjia e informacionit
TMGÇ	Tregtarët e Metaleve dhe Gurëve të Çmuar
UA	Udhëzim Administrativ
UNMIK	Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë
VKR	Vlerësimi Kombëtar i Rrezikut

PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

1. Ky raport përmbledh masat për PPP/LFT-në që ekzistojnë në Kosovë deri në datën e vizitës në terren, nga 18 deri në 28 qershor 2018. Raporti analizon nivelin e përputhshmërisë me 40 Rekomandimet e FATF-së dhe nivelin e efektivitetit të sistemit të PPP/LFT-së së Kosovës, si dhe sjell rekomandime se si të fuqizohet ky sistem.

Gjetjet kryesore

1. Edhe pse janë miratuar një sërë mekanizmesh për të vlerësuar rrezikun e PP/FT-së në nivel vendor, sektorial dhe operativ, autoritetet ende nuk kanë ndonjë të kuptuar tërësisht të integruar të rreziqeve të PP/FT-së që rrjedhin nga përpjekjet e bëra deri tani. Në fakt, është konstatuar se raporti i VKR-së nuk është mjaftueshëm i shtjelluar në vërtetimin sasior dhe cilësor të gjetjeve të veta dhe nuk demonstroi karakteristikat e vlerësimit gjithëpërfshirës në bazë të ndonjë metodologjie solide. Për më tepër, gjetjet e tij nuk i janë komunikuar si duhet sektorit privat. Sa i përket FT-së, edhe pse ky komponent i VKR-së është tejet i limituar, niveli i përgjithshëm i të kuptuarit që kanë autoritetet për kërcënimet nga FT-ja është gjetur se është zhvilluar thelbësisht që nga viti 2013. Autoritetet kanë kornizë të integruar mirë të menaxhimit të rrezikut, që parasheh lidhje direkte ndërmjet ushtrimit të VKR-së dhe hartimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit për PPP/LFT-në. Edhe pse ekziston mekanizmi për të bashkërenduar politikat vendore të PPP/LFT-së, konstatohet se mungojnë sinergjitë e afërta me strategjitë vendore për tema të ndërlidhura, si lufta kundër terrorizmit, krimin të organizuar, menaxhimi i kufijve, si dhe trafikimi i narkotikëve dhe qenieve njerëzore. Bashkërendimi dhe bashkëpunimi me kornizën institucionale të Kosovës lidhur me luftën kundër FP-së po ashtu duhet të zhvillohet.
2. NjIF-i ka demonstruar aftësinë e vet për të shpërndarë përgjithësisht inteligjencë financiare të nivelit të lartë tek autoritetet kompetente që e shfrytëzojnë gjerësisht këtë informacion bashkë me të dhëna të tjera në dispozicion dhe të qasshme për të zhvilluar hetimet paraprake për PP-në, vepra kryesore të ndërlidhura dhe FT-në. Disa çështje ende ekzistojnë lidhur me cilësinë dhe afatshmërinë e informacionit të përdorur për të gjeneruar inteligjencë financiare. Përdorimi (gjatë fazës paraprake) i kompetencave të AZL-ve për të kërkuar në mënyrë aktive informacion financiar dhe për të ndërmarrë hetime financiare jashtë kornizës së bashkëpunimit me NjIF-in dhe në bazë të inteligjencës tashmë të pranuar nga NjIF-i nuk është demonstruar, pavarësisht burimeve të tjera të ndryshme në dispozicion përmes zbatimit të kompetencave policore. Autoritetet e kanë demonstruar pjesërisht dobinë e informacionit për zhvillim të hetimeve formale për vepra penale të ndërlidhura në pajtim me rreziqet e shumta të konstatuara nga VKR-ja. Nuk është demonstruar nëse informacioni do të përdorej mjaftueshëm për hetime të PP-së ose ndjekje penale të mëtejshme.
3. Autoritetet për zbatimin e ligjit në Kosovë i kanë dhënë prioritet hetimit të pastrimit të parave duke institucionalizuar dhe duke i kushtuar burime të konsiderueshme hetimeve financiare brenda kontekstit të hetimeve financiare paralele dhe në vijim të raporteve nga NjIF-i. Edhe pse kriminaliteti kryesor i ndërlidhur i ndjekur në rastet e PP-së nga agjencitë për zbatimin e ligjit duket se në përgjithësi është në përputhje me profilin e rrezikut dhe kërcënimin në Kosovë, vëllimi i rasteve që ndiqen penalisht dhe që gjykohen është në mënyrë shpërfillëse më i ulët në krahasim me përmasën e rrezikut që rrjedh nga kriminaliteti kryesor i ndërlidhur dhe që rezulton në PP në Kosovë. Në ato pak raste të dënimeve për PP-në, sanksionet duket se janë zbatuar proporcionalisht; sidoqoftë, numri i tyre është shumë i ulët për të pasur efekt ndryshues të kriminalitetit në Kosovë.
4. Përkundër përpjekjeve dhe prioritetëve të vendosura nga autoritetet e Kosovës për konfiskimin, sistemi ende përballet me sfida të mëdha. Për më tepër, sekuestrimit dhe konfiskimit nuk pasqyrojnë tërësisht profilin e rrezikut të Kosovës, duke marrë parasysh nivelin dhe fushëveprimin e rreziqeve ndërkufitare. Korniza legjislativë për konfiskim është e ndërlikuar dhe jofunksionale në disa segmente, gjë që kërkon

reformë gjithëpërfshirëse (tashmë të iniciuar nga autoritetet e Kosovës).

5. Autoritetet kanë shfaqur të kuptuar të duhur të rreziqeve nga terrorizmi që prekin Kosovën dhe rajonin, megjithatë vetëdijesimi dhe përqendrimi i tyre në financimin e terrorizmit është i pabarabartë dhe ende nuk ka rezultuar në zhvillimin dhe zbatimin e një mekanizmi strategjik për zbutjen e rrezikut të FT-së. Korniza ligjore për ndjekjen penale të aspekteve të ndryshme të veprës penale të FT-së ka mangësi dhe duhet të qartësohet dhe fuqizohet.
6. Pavarësisht kapacitetit të demonstruar të autoriteteve hetuese të Kosovës për të hetuar aspektet financiare të rasteve të lidhura me terrorizmin, nuk është zhvilluar asnjë ndjekje penale në lidhje me veprat penale të FT-së në një sërë rastesh të terrorizmit dhe duket se nuk ka përqendrim të mjaftueshëm në ndjekjen penale të veprave të shkëputura të FT-së. Masat alternative që zbatohen, kur nuk është e mundur të sigurohen dënimet, nuk duket se sigurojnë ndonjë rezultat të qëndrueshëm.
7. Autoritetet e Kosovës nuk kanë zbatuar ndonjë sistem gjithëpërfshirës të sanksioneve financiare të shënjestruara dhe mungon korniza ligjore për sanksione të shënjestruara. Autoritetet kosovare kanë bërë përpjekje të vlerësojnë rreziqet që ndërlidhen me OJF-të edhe pse këto përpjekje as nuk u bënë me kohë, as nuk rezultuan në identifikimin adekuat të nënsektorit specifik të OJF-ve që bartin rrezikun më të madh apo në masat lehtësuese të tyre, përfshirë mbikëqyrjen dhe ngritjen e vetëdijes. Sistemi i Kosovës nuk ka gjeneruar rezultate të prekshme në drejtim të privimit të pasurisë që lidhet me terrorizmin ose FT-në.
8. Kuptimi i rreziqeve të PP/FT-së ndryshon ndjeshëm në mesin e përfaqësuesve të sektorit privat. Bankat dhe, deri në një shkallë proporcionale me ekspozimin e tyre ndaj rrezikut, institucionet e tjera financiare (përveç zyrave të këmbimit valutor) shfaqin një nivel të caktuar të të kuptuarit të rreziqeve të PP-së, karakteristikë për Kosovën. Cilësia e ushtrimit të vlerësimit të rrezikut ndryshon në varësi të kapaciteteve të institucionit financiar, gjë që tregon nevojë të qartë për më shumë udhëzime në përgatitjen dhe zhvillimin e vlerësimeve të rrezikut.
9. Performanca e raportimit të transaksioneve të dyshimta ka shumë dallim ndërmjet subjekteve të Ligjit për PPP/LFT-në në përgjithësi dhe ndërmjet bankave në veçanti. Zbatimi i kontroleve të brendshme dhe procedurave nga bankat dhe institucionet e tjera financiare (me përjashtim të zyrave të këmbimit valutor) duket se ka sjellë rezultate të mira, ndërsa e njëjta gjë nuk mund të supozohet lidhur me zyrat e këmbimit valutor dhe BPCJF-të për shkak të mungesës së njohurive për PPP/LFT-në nga njëra anë dhe fushëveprimit dhe intensitetit të pamjaftueshëm të mbikëqyrjes nga ana tjetër.
10. Ndarja praktike e përgjegjësisë mbikëqyrëse ndërmjet NjIF-it dhe BQK-së është çështje që duket se shkakton paqartësi të konsiderueshme dhe rrjedhimisht, joefikasitet të regjimit mbikëqyrës, veçanërisht lidhur me kontrollin e pajtueshmërisë me kërkesat e raportimit të RTD-ve nga bankat dhe institucionet e tjera financiare. Masat e hyrjes në treg në sektorin financiar duhet të përmirësohen dhe duhet të bëhen përpjekje të qarta në drejtim të zbatimit të masave efektive për të futur në sistemin e rregulluar personat e përfshirë në aktivitetet e shkëmbimit të parave dhe huadhënies pa ndonjë regjistrim dhe licencë.
11. Në mesin e mbikëqyrësve, NjIF-i dhe BQK-ja shpalosin pikëpamje mjaft të avancuara dhe të kuptuar të rreziqeve të PP/FT-së, por praktikat e profilizimit të rrezikut duhet të rezultojnë në prodhim të rregullt dhe rishikim të dokumenteve të shkruara. Mangësitë në praktikat e profilizimit të rrezikut duket se kanë ndikim negativ në të gjitha fazat e mëvonshme (p.sh. te planifikimi, ekzekutimi dhe ndjekja) të ciklit mbikëqyrës. Nuk duket se sanksionet proporcionale dhe zbindëse që i parasheh Ligji për PPP/LFT-në të jenë shqiptuar ndaj subjekteve raportuese pas kryerjes së raporteve të inspektimit nga mbikëqyrësit.
12. Edhe pse të gjithë personat juridikë janë të detyruar të regjistrohen dhe informatat bazë janë në dispozicion të publikut përmes Regjistrimit të Bizneseve (ARBK), nuk duket të ketë ndonjë proces për verifikimin e informacionit që i është dhënë Regjistrimit të Bizneseve apo për të kontrolluar nëse ka nevojë për përditësim. Bankat duket se janë përgjithësisht të vetëdijshme për nevojën e tyre që të identifikojnë pronarin përfitues të një subjekti ose marrëveshjeje juridike, megjithatë është shumë e dyshimtë nëse institucionet e tjera financiare dhe BPCJF-të janë të vetëdijshme për këtë detyrim.

Përdorimi i mundshëm i mashtruesve dhe përdorimi i paligjshëm i të emëruarve nuk janë hulumtuar në mënyrë të mjaftueshme dhe është hasur shumë pak vlerësim i rreziqeve të paraqitura nga këto dukuri.

13. Autoritetet e Kosovës kanë krijuar një sistem gjithëpërfshirës dhe bëjnë përpjekje të konsiderueshme për të ofruar një gamë të gjerë të NNJ-së, megjithatë disa mangësi dhe procedura të mbetura teknike në bashkëpunimin për NNJ-në ndërkombëtare ndikojnë në afatet kohore të ndihmës. Autoritetet e Kosovës nuk kanë shfaqur ndonjë shfrytëzim aktiv të NNJ-së për qëllime të hetimit apo ndjekjes penale të PP-së dhe FT-së në Kosovë.
14. Sa i përket formave të tjera të bashkëpunimit ndërkombëtar, NjIF-i në mënyrë aktive shkëmben informata për PP-në, veprat e ndërlidhura penale dhe FT-në. Aktiviteti i rëndësishëm i AZL-ve për shkëmbimin ndërkombëtar të informacionit nuk plotësohet nga përqendrimi i duhur në rastet e PP-së dhe FT-së dhe bashkëpunimi mbikëqyrës në këtë drejtim duket të jetë i kufizuar. Çështjet lindin në lidhje me mungesën e pasjes në dispozicion (me kohë) të një pjese të informacionit të duhur.

Rreziqet dhe gjendja e përgjithshme

2. Kosova është juridiksion që ballafaqohet me një sërë rreziqesh të brendshme dhe ndërkufitare të PP-së dhe FT-së, që përkeqësohen më tej nga faktorët strukturorë dhe rrethorë në Kosovë. Një pjesë e madhe e ekonomisë joformale (pothuajse 32%) e përkeqëson rrezikun e shmangies nga tatimi, ndërsa përdorimi i përhapur i parave të gatshme kufizon më tej efektivitetin e çdo mekanizmi të kontrollit financiar, përfshirë PPP/LFT-në. Shqetësimet e përgjithshme lidhur me qeverisjen çojnë në një shkallë të lartë të korrupsionit, që klasifikohet si një nga kërcënimet kryesore në kontekstin e PP-së, si në drejtim të gjenerimit të të ardhurave kriminale, ashtu edhe të dëmtimit të themeleve strukturore të regjimit të PPP/LFT-së.

3. Kosova ndodhet në rrugën ballkanike të një sërë linjash të trafikimit të narkotikëve, armëve të zjarrit, kontrabandimit të metaleve dhe gurëve të çmuar dhe mallrave të tjera, si dhe për trafikimin e migrantëve/qenieve njerëzore. Grupet e krimit të organizuar në Kosovë janë të integruar mirë në rrjetet rajonale dhe ndërkombëtare të krimit të organizuar. Prania e diasporës së madhe kosovare jashtë vendit përkeqëson më tej kërcënimin e PP-së në kontekst ndërkufitar, me vëllime të konsiderueshme të remitancave hyrëse dhe dalëse dhe rrjedhës së parave të gatshme.

4. Kosova është përballur me një kërcënim të madh nga terrorizmi dhe financimi i terrorizmit, me një numër të madh të luftëtarëve të huaj terroristë që largohen drejt zonave të konfliktit; si dhe financimet e dyshimta hyrëse përmes sektorit jofitimprurës. Edhe pse autoritetet kanë ndërmarrë veprime për të frenuar kërcënimin terrorist, komponenti i financimit të tij mbetet kryesisht i patrajtuar.

Niveli i përgjithshëm i efektivitetit dhe përputhshmërisë teknike

5. Që nga vlerësimi i mëparshëm nga Projekti PECK janë ndërmarrë masa për të përmirësuar përputhshmërinë teknike dhe efektivitetin e kornizës së PPP/LFT-së. Në veçanti, është miratuar Ligji i ri për PPP/LFT-në për të trajtuar mangësitë e identifikuar nga PECK; Njësia e Inteligjencës Financiare të Kosovës (NjIF) dhe Banka Qendrore e Kosovës (BQK) kanë miratuar një sërë rregulloresh për çështjet e kontrollit të brendshëm, kujdesin e duhur ndaj klientit (KDK) dhe pronësinë përfituese, personat e ekspozuar politikisht (PEP) dhe çështje të tjera. Është duke u zhvilluar reforma e rëndësishme e Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale, që ka për qëllim, ndër të tjera, të avancojë procedurat dhe mekanizmat e konfiskimit.

6. Zhvillimet kryesore institucionale përfshijnë funksionalizimin e institucionit të Koordinatorit Kombëtar për Luftimin e Krimit Ekonomik (KKLEK), i cili është përgjegjës për rritjen e efektivitetit të sistemit të sekuestrimit dhe konfiskimit në Kosovë; një tjetër zhvillim është krijimi i Qendrës Kombëtare për Menaxhim Kufitar (QKMK) e cila, ndër të tjera, është përgjegjëse për monitorimin e lëvizjeve ndërbankare të parasë.

7. Në të njëjtën kohë, nuk janë adresuar një sërë mangësish të konsiderueshme, sidomos mungesa e kornizës legislative dhe institucionale për zbatimin e sanksioneve financiare të shënjestruara, transparencës së personave juridikë dhe masave të kontrollit në lidhje me organizatat jofitimprurëse (OJF-të).

Vlerësimi i rreziqeve, bashkërendimi dhe vendosja e politikave (Kapitulli 2 - RM.1; R.1, R.2, R.33)

8. Autoritetet e Kosovës kanë zhvilluar një sërë mekanizmesh për të vlerësuar rreziqet nga pikëpamja si gjithëpërfshirëse, ashtu edhe sektoriale; janë krijuar mekanizma në baza periodike dhe në vazhdimësi. Pavarësisht vargut të mekanizmave të krijuar, autoritetet ende nuk kanë një të kuptuar të integruar tërësisht të rreziqeve të PP/FT-së që rrjedhin nga këto ushtrime. Janë ndërmarrë një VKR e veçantë dhe vlerësimi i kërcënimit nga krimet e rënda dhe krimi i organizuar (SOCTA), edhe pse nuk janë bashkërenduar plotësisht, gjë që duhet të jetë thelbësore gjatë përditësimit të radhës të të dy dokumenteve në vitin 2018. Në nivel sektorial, disa nga vlerësimet e bëra kohëve të fundit, i kanë mundësuar autoriteteve të zhvillojnë të kuptuarit e tyre për zonat me rrezik më të lartë të patundshmërive, OJF-ve, sektorit të ndërtimit dhe të lojërave të fatit, edhe pse këto duhet të thellohen dhe të zgjerohen për të siguruar që të gjitha kërcënimet themelore, tipologjitë dhe dobësitë e produktit financiar të mbulohen si duhet për këta sektorë, të kuptohen nga autoritetet dhe të komunikohen si duhet për sektorin privat.

9. Raporti i VKR-së i vitit 2013 nuk është mjaftueshëm i përpunuar dhe nuk shpërfaq karakteristikat e një vlerësimi gjithëpërfshirës bazuar në metodologji të shëndoshë. Përvijimi ndërmjet blloqeve kryesore të VKR-së (kërcënimi, dobësia, gjasat dhe pasojat) nuk janë përcaktuar saktësisht. VKR-ja nuk ka përfshirë gjerësi dhe thellësi të mjaftueshme në lidhje me tendencat dhe tipologjitë mbizotëruese të PP/FT-së në Kosovë. Përderisa NjIF-i ka zhvilluar tipologji me cilësi të lartë, këto nuk kanë rezultuar në të kuptuar të rreziqeve nga ana e autoriteteve të Kosovës gjatë procesit të VKR-së, ose më gjerësisht, brenda komunitetit ndërinstitucional. Për më tepër, shpeshësia e përditësimit të VKR-së nuk është në përputhje me situatën e rrezikut në zhvillim të PP/FT-së. Duke pasur parasysh se niveli i përgjithshëm i të kuptuarit nga institucione financiare të ndryshme dhe BPCJF lidhur me rrezikun e PP/FT-së ndryshon në mënyrë të konsiderueshme, është konstatuar se masat parandaluese në Kosovë nuk janë të përshtatura në mënyrë specifike me rreziqet mbizotëruese të identifikuara në këtë juridiksion.

10. Edhe pse komponenti i FT-së në VKR është jashtëzakonisht i kufizuar, të kuptuarit në përgjithësi që kanë autoritetet për kërcënimet e FT-së ka evoluar ndjeshëm që nga viti 2013. Në veçanti, është rritur qartë vetëdijësimi për rreziqet kryesore të FT-së që ndërlidhen me luftëtarët e huaj terroristë dhe organizatat jofitimprurëse nga të gjitha autoritetet e përfshira në PPP/LFT-në. Autoritetet konsiderojnë se këto rreziqe do të lehtësohen në masë të madhe nga zbatimi i ligjeve, ndërhyrjet rregullatore dhe të politikave, edhe pse për këtë çështje ende nuk është bërë asnjë matje e rrezikut të mbetur.

11. Autoritetet kanë një kornizë të integruar mirë të menaxhimit të rrezikut, që parasheh korrelacion të drejtpërdrejtë ndërmjet ushtrimit të VKR-së dhe hartimit të Strategjisë për PPP/LFT-në dhe Planit të Veprimit. Për më tepër, autoritetet kanë sjellë dëshmi për veprime specifike të ndërmarrura në lidhje me rialokimin e burimeve në disa agjenci qeveritare për të shënjestruar rreziqet e identifikuara nga VKR-ja. Në të njëjtën kohë, ekziston ndjesia se Strategjia dhe Plani i Veprimit janë të bazuara në gjetje shumë të përgjithshme të VKR-së, ndërsa veprimet e nevojshme nuk janë të përcaktuara në mënyrë koherente dhe/ose niveli i ambicies së politikave në shumë aspekte të Planit të Veprimit nuk është tërësisht i përshtatshëm për një dokument të PPP/LFT-së. Përderisa ekziston një mekanizëm që bashkërendon politikat kombëtare të PPP/LFT-së, strategjive kombëtare shpeshherë u mungojnë sinergji të ngushta për tema të ndërlidhura, si lufta kundër terrorizmit, krimin të organizuar, menaxhimit të kufirit, trafikimit të narkotikëve dhe të qenieve njerëzore.

12. Kosova është përpjekur të rrisë bashkëpunimin dhe bashkërendimin në nivel operativ ndërmjet të gjithë autoriteteve kompetente. Mekanizmat kompetentë të krijuar për këtë qëllim (marrëveshjet e mirëkuptimit (MM) dhe procedurat standarde të operimit (PSO) ndërinstitucionale) duket se janë pjesërisht funksionale, por nuk monitorohen tërësisht për efektivitetin e tyre, edhe pse ka pasur disa rezultate praktike. Në praktikë, autoritetet për zbatimin e ligjit kryejnë bashkëpunim efektiv përmes zyrtarëve ndërlidhës, njësite të përbashkëta, grupeve punuese dhe operacioneve. NjIF-i shërben si qendër përqendrimi e rëndësishme në bashkëpunimin ndërinstitucional. Sidoqoftë ka hapësirë për përmirësim sa i përket: bashkëpunimit ndërmjet NjIF-it dhe mbikëqyrësve sektorialë; qasjes në kohë reale në

databaza ndërmjet autoriteteve; mekanizme të informacionit kthyes për hetimet dhe ndjekjet penale të PP-së.

13. Është e nevojshme të zhvillohen bashkërendimi dhe bashkëpunimi brenda kornizës institucionale të Kosovës sa i përket luftës kundër FP-së. Rezultatet e punës së bërë nga agjenci të ndryshme shtetërore lidhur me luftën kundër përhapjes duhet që të komunikohen dhe të pasqyrohen në politikat që zhvillohen brenda juridiksionit.

Inteligjenca financiare, pastrimi i parave dhe konfiskimi (Kapitulli 3 – RM 6-8; R.3, R.4, R.29-32)

14. Autoritetet kompetente të Kosovës përdorin gjerësisht inteligjencë financiare të një cilësie përgjithësisht të lartë, bashkë me të dhëna të tjera në dispozicion dhe ku ka qasje, në mënyrë që të zhvillojnë hetime paraprake të PP-së, veprave të ndërlidhura penale dhe FT-së. Në përgjithësi, kjo do t'i kontribuonte në mënyrë aktive zhvillimit të sistemit. Tek efektiviteti ndikon deri diku qasja jodirekte në disa nga këto burime dhe mangësitë në informacionin që ruhet.

15. Është demonstruar dobia e këtij informacioni edhe për zhvillimin e hetimeve formale për vepra të ndërlidhura penale në pajtim me disa rreziqe të konstatuara në VKR dhe vepra penale që përgjithësisht raportohen në Kosovë. Mirëpo nuk u arrit të konfirmohet që ky informacion do të përdorej mjaftueshëm për hetime të PP-së. Shkalla e gjerë e informacionit (RTD, RTG, RTP, AIF) nga subjektet raportuese ka cilësi të mjaftueshme për t'i kontribuar shpërndarjes së dobishme nga NjIF-i. Megjithatë, disa çështje me përdorim të kufizuar të RTG-ve për të iniciuar raste dhe për të interpretuar dyshimet kanë efekt të dëmshëm te sistemi.

16. Autoritetet e zbatimit të ligjit në Kosovë i kanë dhënë prioritet ligjit për pastrimin e parave duke institucionalizuar dhe duke i kushtuar burime të konsiderueshme për hetimet financiare edhe brenda kontekstit të hetimeve financiare paralele, edhe si vijimësi e raportimeve nga NjIF-i. Në të njëjtën kohë, përpjekjet intensive të agjencive për zbatimin e ligjit në këtë fushë mbyten nga pengesat në burime në nivel të prokurorisë. Kjo ndodh pjesërisht për shkak të kufizimeve në burime te Prokuroria Speciale, që është e vogël dhe ka kompetenca të vetme për ndjekjen penale të PP-së. Kosova ka pasur shembuj të dënimeve të palëve të treta dhe një dënim më vete për PP-në, edhe pse ky i fundit është përjashtim i kohëve të fundit, me shpresë që tregon një tendencë të re të krijuar nga prokuroria. Në vitet e mëparshme prokuroria kishte imponuar standard të lartë të dëshmisë për veprat kryesore të ndërlidhura, që në mënyrë efektive arritën të kufizojnë agjencitë për zbatimin e ligjit të ndiqnin veprat e PP-së.

17. Edhe pse kriminaliteti i ndërlidhur që ndiqet penalisht në veprat e PP-së nga agjencitë për zbatimin e ligjit duket të jetë kryesisht në përputhje me profilin e rrezikut dhe të kërcënimit në Kosovë, vëllimi i lëndëve që arrijnë të ndiqen penalisht dhe të gjykoen është shumë i ulët në krahasim me masën e kërcënimit që rrjedh nga kriminaliteti i ndërlidhur dhe që rezulton në PP në Kosovë. Në disa pak raste ku ka pasur dënime për PP-në, duket se sanksionet janë zbatuar në mënyrë proporcionale, mirëpo numri i tyre është tepër i ulët për të pasur ndonjë efekt frenues të kriminalitetit në Kosovë. Për rrjedhojë, Kosova ka arritur shkallë të papërfillshme të karakteristikave të një sistemi efektiv për hetimin, ndjekjen penale dhe dënimin e PP-së.

18. Pavarësisht prioritetit që i kanë dhënë autoritetet e Kosovës çështjes së konfiskimit dhe përpjekjeve të konsiderueshme të KKLEK, korniza dhe rezultatet e sistemit të konfiskimit në Kosovë përballen me sfida të mëdha. Ende ka mungesë të përpjekjeve sistematike në sistemin prokurorial dhe gjyqësor në përgjithësi, përfshirë të gjithë prokurorët dhe gjyqtarët që merren me krime që gjenerojnë përfitim për të identifikuar dhe trajtuar si duhet konfiskimin. Faktorët që i kontribuojnë kësaj përfshijnë mungesë të njohurive dhe të kapaciteteve, si dhe interpretime të ngushta gjyqësore. Për më tepër, sekuestrimet dhe konfiskimet nuk pasqyrojnë tërësisht profilin e rrezikut në Kosovë sa i përket veprave të ndërlidhura dominuese dhe duke marrë parasysh nivelin dhe fushëveprimin e rreziqeve ndërkufitare.

Financimi i terrorizmit dhe financimi i përhapjes (Kapitulli 4 – RM 9-11; R.5-8)

19. Është e qartë se Kosova nuk ka demonstruar qartë se autoritetet përqendrohen njëjtë të çështje të FT-së si dukuri me specifikat e veta të krimit financiar, pavarësisht hapave që janë ndërmarrë për të demonstruar rreziqet e ndërlidhura me terrorizmin. Disa mangësi që kanë mbetur në kriminalizimin e terrorizmit dhe përkatësisht financimit të terrorizmit në Kosovë përmes KP, Ligjit për PPP/LFT-në dhe Ligjit për Ndalimin e Pjesëmarrjes në Konfliktet të Armatosura Jashtë Territorit Shtetëror ndikojnë në zbatimin e masave të LFT-së. Autoritetet e Kosovës kanë bërë përpjekje të mëdha dhe kanë demonstruar arritje të rëndësishme në

parandalimin dhe ndjekjen penale të aktiviteteve terroriste si më vete, ashtu dhe në bashkëpunim me vendet e rajonit dhe partnerë të tjerë ndërkombëtarë. Megjithatë, pavarësisht hetimeve që përfshijnë përpjekje ndërinstitucionale dhe ndërkombëtare, ka pasur ndjekje penale/dënime të kufizuara për FT-në.

20. Kjo e fundit vjen për shkak të një sërë faktorësh objektivë të demonstruar, përfshirë natyrën e aktiviteteve terroriste të identifikuar dhe të profilit financiar të personave të përfshirë dhe të mekanizmave vetëfinansues. Megjithatë, përqendrimi shtesë dhe përpjekjet e autoriteteve të Kosovës lidhur me FT-në është i nevojshëm për të ndjekur penalisht veprat e FT-së si masë për të zbutur rreziqet e shumta lidhur me: seriozitetin e problemit të LHT-ve, mbështetjen dhe rekrutimin që ka të bëjë me këtë dukuri, numrin e OJF-ve të pezulluara që i kanë kontribuar radikalizimit, mangësitë në mbikëqyrje dhe indikatorët që kanë të bëjnë me OJF-të dhe potencialit për financim nga jashtë. Masat alternative të përdorura atëherë kur nuk është e mundur të sigurohet dënim duken se kanë qenë kryesisht të kufizuara.

21. Kosova nuk ka zbatuar në mënyrë sistematike sanksionet e shënjestruara sipas RKSKB-ve 1267 dhe 1373. Autoritetet kanë bërë disa përpjekje, kryesisht NjIF-i, DK-ja dhe Policia Kufitare për të zbatuar disa masa parandaluese dhe të shënjestruara sa i përket RKSKB-ve të përmendura, mirëpo ato konsiderohen me ndikim anësor në mungesë të mekanizmave të tjerë ligjorë.

22. OJF-të në Kosovë mbikëqyren nga DRNOJQ-ja në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike, NjIF-i për shkak të qenies së tyre si subjekt raportues sipas Ligjit për PPP/LFT-në dhe Administrata Tatimore. Duket se një sërë mangësish legislative dhe mungesa e efektivitetit administrativ ndikojnë në zbatimin e masave parandaluese ndaj OJF-ve, më e rëndësishmja ndër të cilat është mungesa e kompetencave administrative për pezullimin e caktuar të aktiviteteve të OJF-ve kur nuk është e mundur të sigurohet dënimi penal. Përpjekjet e rëndësishme të AZL-ve dhe NjIF-it nuk duket se pasqyrohen konsiderueshëm në mbikëqyrjen e zgjeruar formale dhe në ndryshimin e praktikave administrative. Gjithashtu, vihet re se numri i pezullimeve të përkohshme të OJF-ve nuk ka dhënë ndonjë shtysë të fortë drejt miratimit të një qasjeje gjithëpërfshirëse të synuar për sektorin, edhe pse autoritetet e Kosovës kanë filluar përpjekje të pjesshme për të siguruar zhvillimin e mëtejshëm të masave lehtësuese sipas rrezikut. Autoritetet e Kosovës kanë demonstruar efektivitet në privimin e terroristëve nga instrumentet e tyre (zakonisht shuma të vogla ose pronë me vlerë relativisht të kufizuar), por pa ndonjë sukses të konsiderueshëm në përqendrimin në pasuritë e mundshme të OJQ-ve ose financuesve të terrorizmit.

23. Edhe pse mekanizmi i zbatimit të sanksioneve të FP-së është i ngjashëm me atë për sanksionet e FT-së, nuk ka pasur zbatim të kornizës për sanksionet financiare të shënjestruara në pajtim me RKSKB-të 1718, 1737 dhe rezolutat e tyre pasardhëse. Përveç dështimit për të zbatuar këto rezoluta sipas ligjit të Kosovës, është konstatuar se deri më sot nuk ka pasur ngrirje të aseteve apo fondeve të lidhura me FP-në.

Masat parandaluese (Kapitulli 5 – RM 4; R. 9-23)

24. Të kuptuarit e rreziqeve të PP/FT-së ndryshon dukshëm ndërmjet përfaqësuesve të sektorit privat. Mangësia e përbashkët në mënyrën se si subjektet raportuese e kuptojnë dhe e interpretojnë rrezikun është se ata janë shumë të vetëdijshëm për faktorët rrethorë të rrezikut dhe segmentet më të larta të tij, por kanë pikëpamje shumë më pak të shprehura sa i përket metodave dhe modeleve përmes të cilave autorët mund të keqpërdorin sistemet financiare dhe jofinanciare në Kosovë për të pastruar paratë ose për të financuar terrorizmin.

25. Bankat dhe, deri diku në përpjesëtim me ekspozimin e tyre ndaj rrezikut, institucionet e tjera financiare (me përjashtim të zyrave të këmbimit valutor) shfaqin një nivel të caktuar të të kuptuarit të rreziqeve të PP-së, që janë karakteristike për Kosovën. Ata i shpjegojnë rrjedhshëm kornizat e tyre të zbutjes së rrezikut dhe raportojnë se kanë zbatuar kërkesat e Ligjit për PPP/LFT-në për të vlerësuar periodikisht dhe për të dokumentuar rreziqet e tyre. Cilësia e analizës së vlerësimit të rrezikut ndryshon në varësi të kapaciteteve të institucionit financiar, që tregon nevojë specifike për më shumë udhëzime në përgatitjen dhe kryerjen e vlerësimeve të rrezikut.

26. Sa i përket elementëve të regjimit parandalues, kuptimi i pronësisë përfituese kufizohet vetëm në zotërimin e drejtpërdrejtë të 25% apo më shumë aksioneve në një kompani sikurse përcaktohet me Ligjin për PPP/LFT-në. Në mesin e BPCJF-ve, vetëm noterët dhe, në një masë të kufizuar, avokatët (ku firmat ligjore japin mbështetje juridike për transaksionet e mëdha

ekonomike) raportojnë për zbatimin e masave bazë të KDK-së si identifikimi i klientëve dhe verifikimi i identitetit të tyre.

27. Performanca e raportimit të transaksioneve të dyshimta është shumë e pabarabartë në mesin e subjekteve të Ligjit për PPP/LFT-në në përgjithësi dhe midis bankave në veçanti, ku disa prej të cilëve ndjehen të kënaqur me zbatimin e kërkesave për raportim duke paraqitur RTD-të. Të gjithë përfaqësuesit e sektorit privat theksojnë rëndësinë e marrjes së informatave më të përgjithshme dhe specifike nga NjIF-i lidhur me pajtueshmërinë me kërkesat e PPP/LFT-së në përgjithësi dhe me performancën e raportimit të RTD-ve në veçanti.

28. Zbatimi i kontrolleve të brendshme dhe procedurave nga bankat dhe institucionet e tjera financiare (përveç zyrave të këmbimit valutor) duket se prodhojnë rezultate të shëndosha, siç është konstatuar edhe nga gjetjet e mbikëqyrjes. E njëjta gjë nuk mund të supozohet në lidhje me zyrat e këmbimit valutor dhe BPCJF-të për shkak të mungesës së njohurive për PPP/LFT-në nga njëra anë dhe fushëveprimit dhe intensitetit të pamjaftueshëm të mbikëqyrjes nga ana tjetër.

Mbikëqyrja (Kapitulli 6 – RM.3; R.26-28, R. 34-35)

29. NjIF-it, BQK-së dhe mbikëqyrësve të tjerë sektorialë u caktohen përgjegjësi për mbikëqyrjen e pajtueshmërisë me PPP/LFT-në të institucioneve financiare dhe BPCJF-ve. Ndarja praktike e përgjegjësisë mbikëqyrëse ndërmjet NjIF-it dhe BQK-së është një çështje që me sa duket shkakton paqartësi të konsiderueshme dhe, për rrjedhojë, joefikasitet të regjimit mbikëqyrës, sidomos në lidhje me kontrollin e pajtueshmërisë me kërkesat e raportimit të RTD-ve nga bankat dhe institucionet e tjera financiare.

30. Ekzistojnë një sërë masash të hyrjes në treg në sektorin financiar që duhet të përmirësohen duke futur, ndër të tjera, dispozita për të parandaluar bashkëpunëtorët e kriminelëve të hyjnë në tregun financiar si zotërues (ose pronarë përfitues me) pjesëmarrje të konsiderueshme ose kontrolluese. Autoritetet duhet të bëjnë përpjekje të fuqishme në drejtim të zbatimit të masave efektive për të sjellë në sistemin e rregulluar personat pa regjistrim dhe licencim të përfshirë në shkëmbimin e parasë dhe aktivitetin e huadhënies.

31. Ndërmjet mbikëqyrësve, NjIF-i dhe BQK-ja demonstrojnë pikëpamje dhe të kuptuar mjaft të avancuar të rreziqeve të PP/FT-së. Megjithatë, duket se dispozitat për profilizimin e rrezikut zbatohen për të orientuar në mënyrë paraprake përpjekjet e mbikëqyrësve pa prodhim apo rishikim të rregullt të dokumenteve me shkrim që artikulojnë qartë gjetjet dhe konkluzionet rreth profilit të rrezikut të subjekteve individuale të mbikëqyrura.

32. NjIF-i dhe BQK-ja kanë kompetenca të duhura dhe pavarësi operative për të zbatuar funksionin e tyre mbikëqyrës. Megjithatë, përshtatshmëria e burimeve të NjIF-it në raport me përgjegjësinë e saj për mbikëqyrjen e të gjitha BPCJF-ve nuk është e qartë dhe do të ishte një objektiv vështirë i arritshëm nëse nuk arrihen marrëveshje për ta shpërndarë atë përgjegjësi në mënyrë të barabartë ndërmjet NjIF-it dhe mbikëqyrësve sektorialë. Mangësitë në praktikën e profilizimit të rrezikut të NjIF-it dhe BQK-së duket se kanë një ndikim negativ në të gjitha fazat e mëvonshme (p.sh planifikimi, ekzekutimi dhe ndjekja) të ciklit mbikëqyrës.

33. Inspektimet e bëra nga NjIF-i dhe BQK-ja mbulojnë fusha të ndryshme dhe konstatojnë parregullsi të ndryshme në institucionet financiare dhe BPCJF-të. Nuk duket se shqiptohen sanksione proporcionale dhe parandaluese sipas Ligjit për PPP/LFT-në për subjektet raportuese pas përgatitjes së raporteve të inspektimit nga NjIF-i ose BQK-ja. Në prapavijë të zbatimit joefektiv të sanksioneve proporcionale si masë parandaluese kundër mospajtimit me kërkesat e zbatueshme për PPP/LFT-në, përfaqësuesit e sektorit privat i referohen natyrës joproportionale të gjobave të përcaktuara me Ligjin për PPP/LFT-në për ato që janë përcaktuar si shkelje shumë të rënda, të rënda dhe të lehta të legjislacionit.

34. Në lidhje me sektorin financiar, si NjIF-i ashtu edhe BQK-ja kanë mekanizma, kanale dhe praktika të duhura të komunikimit për të promovuar të kuptuarit e qartë të detyrimeve të PPP/LFT-së dhe rreziqet e PP/FT-së së bankave dhe, në një masë më të vogël, të institucioneve të tjera financiare. Në praktikë, ofrimi i udhëzimeve dhe trajnimit duket të jetë një fushë ku mbikëqyrësit në përgjithësi dhe NjIF-i në veçanti kanë nevojë të investojnë në mënyrë të konsiderueshme më shumë burime. Ekziston një shqetësim i përgjithshëm në lidhje me informacionin kthyes të përgjithshëm dhe specifik që u ofrohet subjekteve raportuese për raportimin e RTD-ve.

Transparenca e personave dhe marrëveshjeve juridike (Kapitulli 7 – RM 5; R. 24-25)

35. Të gjithë personat juridikë kanë detyrim që të regjistrohen dhe informacioni bazë vihet në dispozicion të publikut përmes Regjistrimit të Bizneseve (ARBK). Megjithatë nuk ka një regjistër të pronësisë përfituese, bankat dhe institucionet financiare duket se janë përgjithësisht të vetëdijshme për nevojën e tyre për të identifikuar pronarin përfitues të një subjekti ose marrëveshjeve juridike, mirëpo të kuptuarit e asaj që përbën pronësi përfituese ndryshon (në shumicën e rasteve ajo është e kufizuar të posedimi direkt i 25% ose më shumë aksioneve në një kompani siç përcaktohet me Ligjin për PPP/LFT-në).

36. Nuk duket të ketë ndonjë proces për verifikimin e informacionit që i është dhënë Regjistrimit të Bizneseve ose për të kontrolluar nëse kërkon përditësim. Përderisa ekziston një kërkesë ligjore për ndryshimin e informacionit bazë në lidhje me të gjithë personat juridikë që duhet të raportohet në Regjistrimin e Bizneseve brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga ndryshimet e bëra, mosrespektimi nuk i nënshtrohet ndonjë sanksioni. Megjithatë, niveli i pajtueshmërisë, saktësisë dhe aktualitetit të pjesës më të madhe të informacionit në regjistër nuk është shqyrtuar asnjëherë.

37. Autoritetet nuk e kanë vlerësuar rrezikun e PP/FT-së së ndërlidhur me llojet e subjekteve juridike të krijuara në Kosovë. Për më tepër, keqpërdorimi i mundshëm i personave juridikë, përdorimi i rremë i personave, përdorimi i paligjshëm i të emëruarve nuk janë hetuar mjaftueshëm dhe është hasur në vlerësim shumë të vogël të rreziqeve të paraqitura nga këto dukuri. Mekanizmat për të siguruar që informacioni për pronësinë përfituese është i saktë dhe i përditësuar janë minimalë, ku autoritetet e zbatimit të ligjit dhe NjIF-i përdorin informacionin ekzistues të marrë nga bankat sipas kërkesave të KDK-së.

38. Gjatë punës së saj mbikëqyrëse, BQK-ja vlerëson nivelin e verifikimit të informacionit mbi pronësinë përfituese nga subjektet raportuese gjatë zhvillimit të inspektimeve në terren. BQK-ja kontrollon nëse ai është i përshtatshëm, i saktë dhe aktual. Efektiviteti i kornizës së sanksioneve të BQK-së është i diskutueshëm dhe kështu është edhe efekti zbindës i sanksioneve. Edhe pse ka pasur zbrazëti të herëpashershme që janë identifikuar në lidhje me pronësinë përfituese, asnjë ndëshkim nuk është shqiptuar ndonjëherë.

39. Korniza ligjore në Kosovë nuk i njeh trustet, ndërsa funksionimi i marrëveshjeve juridike të arritura sipas ligjit të huaj nuk është i ndaluar. Si autoritetet, ashtu edhe shumica dërrmuese e subjekteve raportuese nuk duket të kenë njohuritë e duhura për rreziqet e PP/FT-së që lidhen me marrëveshjet juridike pasi nuk kanë njohuri të mjaftueshme për strukturat e tyre apo natyrën e aktiviteteve të tyre.

Bashkëpunimi ndërkombëtar (Kapitulli 8 – RM.2; R. 36-40)

40. NNJ-ja në Kosovë bëhet në pajtim me marrëveshjet dypalëshe ose me parimin e reciprocitetit i cili në fakt mundëson një gamë të gjerë të ndihmës. Kërkesat hyrëse dhe dalëse për NNJ-në trajtohen në Kosovë përmes mekanizmit të centralizuar ndërinstitucional me shumë faza që bashkërendohet nga Ministria e Drejtësisë. Edhe pse MD ka bërë përpjekje të konsiderueshme për të bashkërenduar në mënyrë efektive kërkesat për NNJ-në dhe ekstradimin, kompleksiteti i mekanizmit në fazat e mëvonshme të tij është në disa raste i dëmshëm për afatshmërinë dhe efikasitetin e bashkëpunimit, veçanërisht në lidhje me kërkesat për ekstradim.

41. Sigurimi i ndihmës juridike ndërkombëtare në afat në çështjet penale nuk është demonstruar deri në vitin 2017. Disa ndryshime të ndërmarra në vitin 2017 duket se i kanë kontribuar afatshmërisë; bashkëpunimi i drejtpërdrejtë ndërmjet autoriteteve ka pasur gjithashtu efekt pozitiv. Vizita në terren konfirmoi se refuzimi i bashkëpunimit ka ndodhur në rrethana shumë të kufizuara dhe, në asnjë mënyrë, nuk mund të interpretohet se ka ndikuar negativisht në sigurimin e bashkëpunimit.

42. Autoritetet e Kosovës nuk kanë demonstruar se kanë kërkuar në mënyrë aktive bashkëpunim në lidhje me çështjet e FT-së, pavarësisht nga përdorimi i gjerë i NNJ-së në rastet e ndërlidhura me terrorizmin. Për më tepër, kanali i NNJ-së nuk duket të jetë përdorur mjaftueshëm në rastet e PP-së të ndërmarra nga autoritetet e Kosovës dhe vlerësuesit janë të shqetësuar nga zvogëlimi i mbështetjes në këtë bashkëpunim. Janë dhënë disa shembuj në lidhje me bashkëpunimin aktual që po kryhet për identifikimin e pasurive, por përsëri në rrethana shumë të kufizuara në lidhje me sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurisë.

43. Bashkëpunimi i zbatuar nga NjIF-i është aktiv dhe i bazuar si në kërkesa, ashtu edhe në informacionin spontan. Bashkëpunimi bëhet në përputhje me procedurat standarde të operimit (PSO), të cilat përcaktojnë mekanizmat e duhur për format e ndryshme të shkëmbimit të informacionit. Afatet e sakta jepen në udhëzimet e brendshme. Sikurse dëshmohet nga të dhënat e ofruara për vlerësuesit, praktika e NjIF-it korrespondon me kërkesat e brendshme dhe praktikat më të mira ndërkombëtare. Rastet e paraqitura dhe diskutimet i lejojnë ekipit të vlerësimit të arrijë në përfundimin se informacioni i marrë është përdorur gjerësisht. Kompetencat për bashkëpunimin policor dhe shkëmbimin e informacionit janë përdorur gjerësisht, por nuk është e qartë, për shkak të mungesës së statistikave specifike, se deri në ç'masë ato janë në të vërtetë të ndërlidhura me rastet e PP-së dhe FT-së. Bashkëpunimi i autoriteteve doganore në Kosovë gjithashtu duket të jetë shumë aktiv edhe pse rrallë lidhet me PP-në në mënyrë specifike. Nuk është demonstruar nëse BQK-ja do të angazhohej në mënyrë aktive në bashkëpunimin ndërkombëtar veçanërisht për qëllime të PP-së dhe FT-së.

Veprimet me përparësi

- i. Autoritetet e Kosovës duhet të kryejnë një VKR gjithëpërfshirëse për PP-në dhe FT-në të bazuar në metodologji që siguron shqyrtim të hollësishëm të kërcënimeve dhe dobësive kryesore për të gjithë sektorët financiarë/BPCJF dhe produktet e tipologjitë e ndërlidhura me to.
- ii. Autoritetet duhet ta forcojnë përqendrimin e tyre strategjik te FT-ja dhe të marrin parasysh integrimin e rrezeve specifike në strategji të tjera përkatëse ose përmes miratimit të instrumenteve specifike për të siguruar veprime të duhura kundër FT-së dhe për të ndërmarrë masa që sigurojnë mjaftueshmërinë e bazës ligjore për ndjekjen penale të FT-së.
- iii. Duhet të zbatohet me urgjencë një sistem i sanksioneve financiare të shënjestruara dhe masave që të arrihet privimi i plotë i aseteve.
- iv. Bashkërendimi në nivel të politikëbërjes duhet të zhvillohet më tej ndërmjet Ministrisë së Financave, Ministrisë së Drejtësisë dhe aktorëve të tjerë, në mënyrë që të sigurohen inpute të konsiderueshme për PPP/LFT-në në strategjitë që kanë të bëjnë me PPP/LFT-në, si dhe në procese të vlerësimit të rrezikut që zhvillohen jashtë juridiksionit të MF (p.sh. SOCTA).
- v. Autoritetet e Kosovës, përfshirë PSRK dhe KKLEK duhet të ndërmarrin masa sistematike për të promovuar hetimin dhe ndjekjen penale autonome të PP-së (pa pasur nevojë për ndjekje penale të veprës kryesore të ndërlidhur) në bazë të praktikës gjyqësore të kohëve të fundit.
- vi. Autoritetet e Kosovës duhet të vazhdojnë dhe finalizojnë reformat e iniciuara që synojnë decentralizimin e rasteve të PP-së te prokurorë jo të PSRK-së, duke i lënë gjithsesi PSRK-së mbikëqyrjen dhe ndjekjen penale për lëndët e profilit të lartë dhe me vëllim të madh.
- vii. Autoritetet duhet të vlerësojnë nënsektorët e OJF-ve në rrezik, përfshirë dhe aktivitete të parregulluara dhe të pamonitoruara, në mënyrë që të zbatohet qasje e shënjestruar dhe të merren masa të mëtjshme për regjistrimin, monitorimin ose kontrollin.
- viii. Të sigurohet se NjIF-i dhe mbikëqyrës të tjerë të negociojnë dhe arrijnë në marrëveshje që parashihen edhe me Ligjin për PPP/LFT-në për të mundësuar një mekanizëm funksional për ndarje të përgjegjësisë mbikëqyrëse dhe për të gjetur zgjidhje praktike për çështjen e kontrollit të duhur të pajtueshmërisë së institucioneve financiare me kërkesat për raportim të RTD-ve.
- ix. Të futen elementet që mungojnë në rregullat e hyrjes në treg dhe të bëhen përpjekje vendimtare drejt zbatimit të masave efektive që të përfshijnë shkëmbimin e palicencuar të valutës dhe aktiviteteve të huadhënies në sistemin e rregulluar.
- x. Të sigurohet caktimi i sanksioneve proporcionale dhe zbindëse në Ligjin për PPP/LFT-në për mospajtueshmërinë e evidentuar nga subjektet raportuese.
- xi. Të promovohet të kuptuarit e pronësisë përfituese përtej zotërimit të 25% apo më shumë aksioneve në kompani; të përcaktohen dhe zbatohen masa më efektive për verifikimin e burimit të fondeve.
- xii. Të ndërmerret rishikimi i llojeve të ndryshme të personave juridikë me synim vlerësimin e tyre të rrezikut, dobësive dhe tërheqjes për t'u përdorur për qëllime të PP/FT-së.
- xiii. Të përafrohen dispozitat në KPP lidhur me sekuestrimin dhe konfiskimin në mënyrë që të shmangen përplasjet dhe pështjellimi gjatë zbatimit të tyre.
- xiv. Të ndërmerren masa për të fuqizuar aftësinë e Kosovës për të parandaluar financimin e përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë duke futur legjislacion që parasheh masa për zbatimin e sanksioneve financiare të shënjestruara të ndërlidhura me RKSKB-të përkatëse. Autoritetet kosovare duhet të miratojnë legjislacion të ri sa më parë që të jetë e mundur për të rregulluar SFSH-të lidhur me FP-në dhe të caktojnë autoritetet kompetente për këtë.
- xv. Autoritetet e Kosovës duhet të sigurojnë qasje efikase dhe në kohë tek i gjithë informacioni i nevojshëm dhe të rrisin më tej përdorimin e automatizuar të këtij informacioni për të gjeneruar inteligjencë financiare të dobishme dhe për të zhvilluar raste të mundshme të PP-së, veprave të ndërlidhura penale dhe FT-së.
- xvi. Autoritetet duhet të konsiderojnë alokimin e mëtjshëm të burimeve, përfshirë rritjen e burimeve njerëzore në dispozicion dhe mekanizma për t'i dhënë përparësi mbledhjes dhe përdorimit të informacionit për qëllime të nxitjes dhe mbështetjes së hetimeve të PP-së.
- xvii. Të sigurohet se autoritetet që bëjnë kontroll ndërkufitar të parave të gatshme të marrin parasysh sistematikisht dyshimet e PP/FT-së.

Vlerësimi për efektivitetin dhe përputhshmërinë teknike

Vlerësimi për efektivitetin

RM.1 – Rreziqet, politikat dhe bashkërendimi	RM.2 – Bashkëpunimi ndërkombëtar	RM.3 – Mbikëqyrja	RM.4 – Masat parandaluese	RM.5 – Personat juridikë dhe marrëveshjet juridike	RM.6 – Inteligjenca financiare
Moderuar	Moderuar	Moderuar	Moderuar	Ulët	Moderuar
RM.7 – Hetimi dhe ndjekja penale e PP-së	RM.8 – Konfiskimi	RM.9 – Hetimi dhe ndjekja penale e FT-së	RM.10 – Masat parandaluese dhe sanksionet financiare kundër FT-së	RM.11 – Sanksionet financiare kundër FP-së	
Moderuar	Ulët	Ulët	Ulët	Ulët	

Vlerësimi për përputhshmërinë teknike (P – në përputhje, KP – kryesisht në përputhje, PP – pjesërisht në përputhje, MP – në mospërputhje, N/A – nuk aplikohet)

R.1 – Vlerësimi i rrezikut dhe zbatimi i qasjes së bazuar në rrezik	R.2 – Bashkëpunimi dhe bashkërendimi kombëtar	R.3 – Vepra e pastrimit të parave	R.4 – Konfiskimi dhe masat e përkohshme	R.5 – Vepra e financimit të terrorizmit	R.6 – Sanksionet financiare të shënjestruara lidhur me terrorizmin dhe financimin e terrorizmit
PP	KP	KP	PP	PP	MP
R.7 – Sanksionet financiare të shënjestruara lidhur me përhapjen	R.8 – Organizatat jofitimprurëse	R.9 – Ligjet e fshehtësisë për institucionet financiare	R.10 – Kujdesi i duhur ndaj klientit	R.11 – Ruajtja e të dhënave	R.12 – Personat e ekspozuar politikisht
MP	PP	KP	PP	KP	PP
R.13 – Korrespondenca bankare	R.14 – Shërbimet e transferimit të parave apo valutës	R.15 – Teknologjitë e reja	R.16 – Transfertat elektronike	R.17 – Mbështetja të palët e treta	R.18 – Kontrollat e brendshme dhe degët e filialet e huaja
KP	P	P	PP	MP	PP
R.19 – Vendet me rrezikshmëri më të lartë	R.20 – Raportimi i transaksioneve të dyshimta	R.21 – Zbulimi dhe konfidencialiteti	R.22 – BPCJF-të: Kujdesi i duhur ndaj klientit	R.23 – BPCJF-të: Masat e tjera	R.24 – Transparenca dhe pronësia përfituese e personave juridikë
PP	KP	KP	PP	PP	PP
R.25 – Transparenca dhe pronësia përfituese e marrëveshjeve juridike	R.26 – Rregullimi dhe mbikëqyrja e institucioneve financiare	R.27 – Kompetencat e mbikëqyrësve	R.28 – Rregullimi dhe mbikëqyrja e BPCJF-ve	R.29 – Njësitë e inteligjencës financiare	R.30 – Përgjegjësitë e autoriteteve të zbatimit të ligjit dhe të hetimit
KP	PP	PP	PP	KP	KP
R.31 – Kompetencat e autoriteteve të zbatimit të ligjit dhe të hetimit	R.32 – Korrierët e parave të gatshme	R.33 – Statistikat	R.34 – Udhëzimet dhe informatat kthyesë	R.35 – Sanksionet	R.36 – Instrumentet ndërkombëtare
KP	KP	PP	P	PP	N/A
R.37 – Ndihma e ndërsjellë juridike	R.38 – Ndihma e ndërsjellë juridike: ngrirja dhe konfiskimi	R.39 – Ekstradimi	R.40 – Format e tjera të bashkëpunimit ndërkombëtar		
KP	PP	PP	KP		

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDËRSJELLË

Parathënie

1. Ky raport përmbledh masat ekzistuese të PPP/LFT-së në datën e vizitës në terren. Raporti analizon nivelin e përputhshmërisë me 40 Rekomandimet e FATF-së dhe nivelin e efektivitetit të sistemit të PPP/LFT-së, si dhe rekomandon se si ky sistem mund të fuqizohet.
2. Ky vlerësim është mbështetur në Rekomandimet e FATF-së të vitit 2012 dhe është përgatitur duke shfrytëzuar Metodologjinë e vitit 2013. Vlerësimi është bazuar në informacionin e dhënë nga autoritetet e Kosovës dhe në informacionin e siguruar nga ekipi i vlerësimit gjatë vizitës në terren në vend nga data 18 deri më 28 qershor 2018.
3. Vlerësimi është zhvilluar nga ekipi i vlerësimit i përbërë nga:
 - Z. Evgeni Evgeniev –ekspert i zbatimit të ligjit;
 - Z. Manfred Galdes –ekspert ligjor; dhe
 - Z. Arakel Meliksetyan –ekspert financiar.
4. Rishikues (ekspertë shkencorë):
 - Z. Nicolas Choules-Burbidge – rishikues financiar;
 - Z. Lajos Korona – rishikues ligjor dhe i zbatimit të ligjit.
5. Ekspertë nga autoritete homologe:
 - Z. Giuseppe Lombardo – Kryesues i mbledhjes plenare;
 - Znj. Lenka Mlynarik Habrnalova;
 - Znj. Jana Ružarovská;
 - Z. Gabor Simonka;
 - Z. Klaudio Stroligo.
6. Sekretariati i KiE-së
 - Z. Igor Nebyvaev – Udhëheqës i Njesisë, Divizioni për Bashkëpunimin kundër Krimit Ekonomik;
 - Z. Edmond Dunga – Këshilltar i Projektit PECK II;
 - Z. Jamie Brown – Koordinator Projekti, Divizioni për Bashkëpunimin kundër Krimit Ekonomik dhe;
 - Znj. Joana Kashi – Koordinatore Projekti, Divizioni për Bashkëpunimin kundër Krimit Ekonomik.
7. Më herët, Kosova ka kaluar nëpër vlerësimin e PECK I të zhvilluar në vitin 2013 dhe në vlerësimin vijues në vitin 2014, që janë zhvilluar në përputhje me Metodologjinë e FATF-së të vitit 2004. Vlerësimet janë publikuar dhe mund të gjenden në www.coe.int.

KAPITULLI 1. RREZIQET DHE RRETHANAT E PP/FT-SË

8. Kosova gjendet në Evropën juglindore, në qendër të Gadishullit të Ballkanit dhe ka sipërfaqe prej 10.908 km². Popullsia e përafërt që banon në Kosovë është 1.815.606,13 prej të cilëve përafërsisht 92% janë shqiptarë dhe 8% nga minoritetet serbe dhe të tjera. Gjuhët zyrtare në Kosovë janë shqipja dhe serbishtja. Në nivel komunal, gjuhët turke, boshnjake dhe rome kanë statusin e gjuhëve zyrtare.

9. Më 10 qershor 1999 Këshilli i Sigurimit të OKB-së miratoi Rezolutën (RKSOKB) 1244. Kjo rezolutë, edhe pse konfirmonte kufijtë ndërkombëtarë të Serbisë, e largonte Kosovën nga juridiksioni i Serbisë duke e zëvendësuar atë me një zgjidhje të përkohshme me administratë të mbikëqyrtur nga ndërkombëtarët, që kishte si synim të mbështeste zhvillimin e institucioneve funksionale autonome në Kosovë. Në bazë të Rezolutës 1244, u krijua Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK). Këtij misioni iu dhanë kompetenca administrative, legjislative dhe gjyqësore në Kosovë.

10. Kosova shpalli pavarësinë nga Serbia më 17 shkurt 2008. Në prill të vitit 2008, autoritetet e Prishtinës miratuan Kushtetutën, që hyri në fuqi në qershor 2008. Kosova nuk është anëtare e Kombeve të Bashkuara.

11. Kosova ka sistem juridik të mbështetur në të drejtën civile, ku Kushtetuta është akti më i lartë dhe ku të gjitha ligjet dhe aktet e tjera juridike duhet të jenë në përputhje me Kushtetutën.

Rreziqet e PP/FT-së dhe studimi i çështjeve me rrezik më të lartë

Vështrim i përgjithshëm i rreziqeve të PP/FT-së

Kërcënimet e PP-së

12. Në përputhje me VKR-në (2013) veprat e ndërlidhura penale që kanë të bëjnë me PP/FT-në përfshijnë korrupsionin, shmangien nga tatimi, mashtrimin, vjedhjen dhe përvetësimin. Për më tepër, kërcënime të tjera të rëndësishme duket se kanë të bëjnë me krimin e organizuar vendor dhe lidhjet e tij ndërkufitare me grupe të huaja të krimit të organizuar, si dhe me spektrin e veprave të kryera nga këto grupe (kontrabandimi, trafikimi i narkotikëve, qenieve njerëzore dhe armëve etj.). Të dhënat krimnologjike për veprat e ndërlidhura penale janë të kufizuara dhe ka ende shumë shqetësime lidhur me besueshmërinë dhe besimin në të dhënat dhe shifrat në dispozicion. VKR-ja thekson praninë e madhe të ekonomisë joformale si kërcënim kyç rrethor për pastrimin e parave në Kosovë.

13. Kontrabandimi i migrantëve është raportuar si proces domethënës në krimin që gjeneron përfitim, në shumë raste i lehtësuar nga grupe të krimit të organizuar, përafërsisht në vlerën e 44 milionë euro në vitin 2015 (edhe pse ky numër thuhet të jetë zvogëluar dukshëm në vitet në vijim).¹ Sa i përket trafikimit të qenieve njerëzore, Kosova është vend burimor dhe destinacion për burra, gra dhe fëmijë që janë pjesë e trafikimit për seks dhe punë të detyrueshme.²

14. Kosova është pikë tranziti për drogat e paligjshme që vijnë nga Afganistani e kalojnë përmes Turqisë dhe Kosovës për t'u kontrabanduar në Evropën Perëndimore. Policia e Kosovës raporton se vlera e konfiskimeve të drogës për periudhën 2014-2016 ishte 12.5 milionë euro, ndonëse vlerësimet e tjera e vendosin vlerën vjetore të tregut të drogës në 50 milionë euro.³ Kontrabandimi i mallrave konsiderohet të jetë një nga veprat më të zakonshme të pastrimit të parave, pasi përdorimi i gjerë i parave të gatshme luan rol në lëvizjen e pasurive kriminale përtej kufijve.⁴ Policia e Kosovës raporton se ata rregullisht kapin armë të paligjshme në kufi

¹ Business and Strategies Europe, Vlerësim për Përhapjen e Ekonomisë Joformale në Kosovë (9 nëntor 2017), f. 39. Shih edhe Frontex, Analiza Vjetore e Rrezikut në Ballkanin Perëndimor (2017), f. 31.

² Departamenti i Shtetit i SHBA, Raporti i Trafikimit të Personave 2017, f. 239.

³ Policia e Kosovës, Raporti Vjetor 2016, f. 20.

⁴ Vlerësimi i Rrezikut Kombëtar nga Pastrimi i Parave në Kosovë (2013).

dhe raportojnë një numër veprash të ndërlidhura me transportin e armëve dhe posedimin e paligjshëm të tyre.⁵

15. Korrupsioni njihet edhe nga autoritetet vendore, edhe nga organizatat ndërkombëtare si një ndër pengesat më të mëdha të Kosovës për qeverisje të mirë dhe tërheqje të investimeve. Kosova ka miratuar legjislacionin për të luftuar korrupsionin, mirëpo ka pasur progres shumë të kufizuar në përpjekjet për të hetuar, ndjekur penalisht, burgosur dhe konfiskuar pasuritë e individëve të korrumpuar. Raportohet se korrupsioni si vepër penale për PP-në është më i përhapur në çështje të prokurimit publik dhe kryesisht në mesin e personave të ekspozuar politikisht (PEP) vendorë, si dhe të PEP-ve të huaj nëse kemi parasysh praninë e pazakontë ndërkombëtare në Kosovë.

16. Trendët e pastrimit të parave në Kosovë shpesh janë të ndërlidhur me përdorimin e gjerë të parave të gatshme dhe shpesh investohen në biznese të ligjshme, si ato të patundshmërive, ndërtimeve, industrive nxjerrëse dhe tregtisë së karburanteve. Të ardhurat e krijuara nga krimi jashtë vendit që hyjnë në Kosovë, si përmes kanaleve të ligjshme (si remitancat), ashtu edhe me mjetet joformale, paraqesin kërcënim, sidomos në lidhje me krimin e organizuar që lidhet me komunitetin e diasporës. Çështjet që kanë të bëjnë me keqpërdorimin e personave dhe marrëveshjeve juridike përmes ndërmjetësuesve mashtrues, krijimit të kompanive guaskë, fshehjen e pronësisë përfituese, etj., përbëjnë gjithashtu kërcënime gjithnjë në rritje ndaj integritetit të sistemit financiar në Kosovë.

Kërcënimet e FT-së

17. Rreziqet e ndërlidhura me terrorizmin dhe FT-në në Kosovë janë vërejtur nga një sërë studimesh. Pasojat e konflikteve në Siri dhe në Irak mbi radikalizmin, ekstremizmin e dhunshëm dhe furnizimin e luftëtarëve të huaj terroristë janë shqetësime të konsiderueshme.

18. Në bazë të VKR-së së vitit 2013, fondet e përdorura për qëllime të financimit të terrorizmit pjesërisht kanë dalë nga të ardhurat e krimin, edhe pse një pjesë e financimit të terrorizmit vjen përmes mbledhjes së fondeve dhe donacioneve të ligjshme. Një nga rreziqet specifike të theksuara në VKR-në e Kosovës është dhurimi i fondeve legjitime të përdorura për FT-në përmes OJQ-ve, të cilat gjithashtu mund të përfshijnë burime financimi jashtë Kosovës. Disa burime vënë në pah se OJQ-të mund të përfshihen në një të tretën e rasteve të FT-së. Roli i OJQ-ve në promovimin e radikalizimit dhe rekrutimit është vërejtur nga raportimet në media dhe financimi i huaj nga aktorë të caktuar shtetërorë apo organizata private konsiderohet se përbën rrezik të konsiderueshëm të FT-së.

19. Financimi i terrorizmit që ndodh brenda dhe nëpër Kosovë është raportuar se ka lidhje me celula apo individë që veprojnë në vende të huaja, përfshirë edhe Evropën Perëndimore, disa prej të cilëve vijnë nga diaspora e gjerë e Kosovës. Në disa raste të njohura të terrorizmit, besohet se financimi ka ardhur nga organizata terroriste që gjenden në Lindjen e Mesme.

Vlerësimi i rrezikut në Kosovë

20. Kosova ka zhvilluar dhe publikuar VKR-në e parë dhe të vetme në vitin 2013. VKR-ja u zhvillua në bazë të një metodologjie të zhvilluar bashkë me një projekt të asistencës ndërkombëtare dhe u bashkërenduan nga NjIF-i në bazë të një Udhëzimi Administrativ të MF-së, që rregullon procesin e VKR-së dhe përfshirjen e autoriteteve të tjera. Qeveria e Kosovës themeloi një grup punues. VKR-ja u shpërnda tek autoritetet publike, ndërsa një përmbledhje u botua në uebfaqen e NjIF-it.

21. Janë zhvilluar tre vlerësime sektoriale të rrezikut të bazuara në një metodologji të ngjashme të cilat kanë mbuluar sektorin jofitimprurës, patundshmërinë / ndërtimet dhe lojërat e fatit. Për më tepër, në vitin 2016, autoritetet e Kosovës përfunduan një vlerësim të kërcënimit nga krimet e rënda dhe krimi i organizuar (SOCTA), që ofron informata të rëndësishme për kërcënimet kriminale me të cilat ballafaqohet Kosova, përfshirë komponentin e pastrimit të parave dhe terrorizmin. Procesi për përditësimin e SOCTA-s është në vijim e sipër dhe duhet të finalizohet deri në fund të vitit 2018. Autoritetet e Kosovës planifikojnë të përfundojnë VKR-në e dytë deri në fund të vitit 2018.

22. Analizë e hollësishme e të kuptuarit në Kosovë të PP/FT-së dhe masave të marra, përfshirë ato që rrjedhin nga VKR-ja dhe nga vlerësime të tjera paraqitet në RM 1.

⁵ Policia e Kosovës, Raporti Vjetor 2017, f. 20; FRONTEX, Analiza Vjetore e Rrezikut për Ballkanin Perëndimor (2017), f. 6.

Studimi i çështjeve me rrezik më të lartë

23. Ekipi i vlerësimit identifikoi fushat që kërkonin përqendrim më të lartë përmes analizës së informacionit të ofruar nga autoritetet e Kosovës, përfshirë VKR-në dhe duke u konsultuar me burime të ndryshme. Këto ishin si në vijim:

24. **Përdorimi i parave të gatshme:** Pavarësisht përpjekjeve të autoriteteve për të kufizuar transaksionet në para të gatshme, përdorimi i përhapur i tyre lehtëson shmangien nga tatimi dhe përkeqëson ekonominë joformale dhe të zezë. Vlerësuesit u përqendruan në (1) suksesin e masave të ndërmarra deri më tani për të reduktuar ekonominë gri, shmangien nga tatimi dhe PP-në e ndërlidhur; (2) nëse NjIF-i është duke përdorur në mënyrë efektive raportet e transaksioneve në para të gatshme për të identifikuar PP-në dhe vepra të ndërlidhura dhe nëse rastet e tilla janë duke u hetuar dhe ndjekur penalisht në mënyrë efektive; (3) efektivitetin e kontrolleve në kufi për të zbuluar deklaratimet e rreme/mosdeklarimet dhe për të identifikuar dyshimet për PP/FT-në; (4) masat e zbatuara nga sektori financiar, posaçërisht bankat dhe ShTPV-të, për të identifikuar burimin e fondeve në lidhje me transaksionet në para të gatshme; dhe (5) nëse ka ndonjë arsyetim ekonomik në themel të rrjedhës së konsiderueshme të parave të gatshme dhe cilat janë burimet dhe destinacioni. Ekipi i vlerësimit i kushtoi vëmendje të veçantë përdorimit të mekanizmave të NNJ-së dhe formave të tjera të bashkëpunimit të brendshëm (ndërinstitucional) dhe ndërkombëtar.

25. **Krimi i organizuar (dhe veprat penale të ndërlidhura):** Duke pasur parasysh migrimin rajonal, trafikimin e drogës etj., rrugët dhe lidhjet ndërkufitare të grupeve të krimit të organizuar⁶, mungesën e një përqendrimi të veçantë të VKR-së së Kosovës te krimi i organizuar dhe përdorimin e përhapur të parave të gatshme dhe rolin e tyre në lëvizjen e pasurive kriminale, një nga fushat e përqendrimit ishte të kuptuarit nga autoritetet e Kosovës të këtyre çështjeve dhe masave të ndërmarra për t'i trajtuar ato.

26. **Korrupsioni:** Lufta kundër korrupsionit ka qenë ndër prioritetet e Qeverisë së Kosovës, por mbetet një nga sfidat kryesore me të cilat ballafaqohet vendi, ku korrupsioni nuk zbulohet dhe as nuk parandalohet mjaftueshëm, nepotizmi dhe qëndrimi tolerant ndaj korrupsionit është norma dhe ka mungesë transparence dhe llogaridhënieje. Vlerësuesit e shqyrtuan kornizën ligjore në fuqi për të zbuluar pastrimin e parave që rrjedh nga veprat e korrupsionit dhe mori parasysh vlerësimin paralel të PECK II që po zhvillohet për masat kundër korrupsionit në Kosovë për të gjykuar mbi ndikimin e korrupsionit si faktor rrethanor që ndikon në funksionimin e përgjithshëm të sistemit të PPP/LFT-së.

27. **Të kuptuarit e rrezikut nga FT-ja:** Vlerësimi pati për qëllim të konfirmojë nëse hetimet financiare përkatëse për aspekte të FT-së janë zhvilluar si pjesë e të gjitha hetimeve për terrorizëm, përfshirë raste që kanë të bëjnë me luftëtarët e huaj terroristë, radikalizimin ose për qëllime të rekrutimit; gjithashtu është marrë parasysh edhe përdorimi i kundërmasave alternative (p.sh. dëbimi, mbyllja e personave juridikë etj.) si dhe rastet për aplikimin e masave të përkohshme të NjIF-it.

28. **Organizatave joqeveritare (OJQ):** Ekipi i vlerësimit ka marrë në shqyrtim aktivitetet e organizatave jofitimprurëse si një pikë përqendrimi kryesor në vlerësimin e sistemit të LFT-së në Kosovë, në dritën e çështjeve të mbetura teknike bashkë me mundësinë për shpërdorim të sektorit për qëllime të FT-së. Iu kushtua përqendrim edhe masave lehtësuese të ndërmarra nga autoritetet në lidhje me nëngrupet specifike të OJQ-ve të dyshuara për përfshirje në FT, karakteristikave të lëvizjes së fondeve, profilit rajonal dhe përqendrimit në aktivitete që paraqesin rreziqet më të mëdha.⁷

29. **Ndërtimi:** Sipas VKR-së, ndërtimi është identifikuar si një nga sektorët më të cenueshëm ndaj pastrimit të parave (në rrezikun e identifikuar 17) dhe ishte një nga fushat e përqendrimit të vlerësimit. Brenda sektorit të ndërtimit në Kosovë, raportet sugjerojnë se një shkallë e konsiderueshme e veprimtarive ndërtimore anashkalojnë aktorët e sektorit financiar dhe në të vërtetë financohen nga mjete alternative për shkak të tendencës për të përdorur shkëmbimin e aseteve dhe pasurive. Kështu, shumë burime potencialisht të paligjshme mund të jenë të pranishme. Veç kësaj, karakteristikat strukturore të sistemit tatimor të Kosovës

⁶ Shih për shembull 'Tregtimi i paligjshëm i drogës përmes Evropës Juglindore', UNODC, mars 2014; Frontex Analiza Vjetore e Rrezikut për Ballkanin Perëndimor 2017; lidhjet e krimit të organizuar rajonal janë vënë në dukje edhe në raportet e vlerësimit të ndërsjellë të MONEYVAL për Slloveninë dhe Serbinë.

⁷ Frontex, Analiza Vjetore e Rrezikut për Ballkanin Perëndimor (2017), f. 47.

paraqesin disa dobësi të shfrytëzueshme për flukse të paligjshme të parave dhe të pastrimit të parave.⁸

30. **Patundshmëria:** Pasuritë e patundshme konsiderohen po ashtu sektor shumë i ndjeshëm ndaj pastrimit të parave (në rrezikun e identifikuar 17) dhe ishte një nga fushat e përqendrimit. Njësoj si me sektorin e ndërtimit, po zhvillohet një shkallë e konsiderueshme e aktivitetit joformal në lidhje me patundshmërinë, me një sasi të konsiderueshme të parregullsive financiare dhe të kontabilitetit që shihen në dallimin ndërmjet kontabilitetit të biznesit dhe informacionit kontabël vendor mbi fitimet e patundshmërive.⁹

31. **Monitorimi i remitancave:** Tërheqja, depozitimi dhe dërgesa e parave të gatshme (përmes ShTPV-ve ose transportit fizik) zakonisht përdoren në skemat e PP-së. Banka Qendrore raporton se remitancat kryesisht përdoren për konsum personal dhe jo për qëllime investimi. Megjithatë, Kosova nuk zbaton asnjë lloj kontrolli kapital apo kufizimi të flukseve ndërkombëtare të kapitalit. Kështu, qasja në valutë për remitancat e investimeve është plotësisht e liberalizuar. Remitancat joformale të parave (dhe praktikat e lidhura me to, si rrjetet *hawala*) gjithashtu u shqyrjuan gjatë vlerësimit.

32. Gjatë vizitës në terren, **sektori i metaleve dhe gurëve të çmuar** u paraqit si rrezik i lartë për PP-në dhe FT-në, duke pasur parasysh mungesën e kontrollit për hyrjet në treg dhe të mbikëqyrjes, numrin dhe llojet e rasteve të trajtuara nga autoritetet, si dhe shkallën e kontrabandimit të metaleve dhe gurëve të çmuar në Kosovë, përfshirë edhe ato që përfaqësojnë një rrezik të mundshëm për FT-në.

Rëndësia

33. Në vitin 2017, Kosova kishte BPV të vlerësuar prej rreth 6.4 miliardë euro, që pasqyrore BPV për frymë (PPP) prej 3.086 euro, duke e vënë popullsinë në Kosovë në kategorinë e të varfërve të dytë në Evropë, pas Moldavisë. Euro është monedha zyrtare e Kosovës, edhe pse vendi nuk është anëtar i Eurozonës. Një raport i vitit 2016 sugjeronte se vlera e përgjithshme e ekonomisë joformale arrinte në 1.845 miliardë euro, që përfaqësonte rreth 31.7% të vlerës së BPV në Kosovë. Të hyrat janë në nivelin 27% të BPV (shumë më e ulët se mesatarja e BE-së prej 45%).

34. Kosova është ende ekonomi e bazuar në importe, e detyruar të importojë mallra dhe lëndë të para që nuk ofrohen nga tregu vendor. Mallrat kryesore që importohen përfshijnë mallrat e prodhuara, makineritë dhe pajisjet, ushqimet e procesuara, pijet dhe duhanin dhe lëndët djegëse.

35. Kërkesa e fuqishme e brendshme financohet nga transfertat dhe hyrjet e kapitalit që vijnë në masë të madhe nga diaspora e Kosovës. Remitancat janë një burim i rëndësishëm i të ardhurave për të paktën 43% të popullsisë së Kosovës, dhe përfaqësojnë mbi 14% të BPV-së (ose mbi 700 milionë euro) në vitin 2016. Shumica e remitancave vijnë nga diaspora e Kosovës në vendet evropiane, sidomos në Gjermani dhe Zvicër.

36. Kosova ka 10 banka tregtare dhe 15 shoqëri të sigurimeve të licencuara; nuk ekziston tregu i letrave me vlerë. Sektori bankar i Kosovës mbetet i kapitalizuar mirë dhe fitimprurës. Kushtet e vështira ekonomike, zbatimi i dobët i kontratave dhe qëndrimi ngurrues ndaj rrezikut kanë kufizuar aktivitetet e kreditimit të bankave, edhe pse në dy vitet e fundit ka pasur përmirësim të dukshëm. Shumat e mjeteve të vlerësuara të tri bankave më të mëdha janë afërsisht USD 2.3 miliardë. Përkundër trendeve pozitive, kreditimi relativisht i vogël është i drejtuar kryesisht ndaj aktiviteteve afatgjata të investimit. Normat e larta të interesit (mesatarisht rreth 7.7%) dhe kërkesat e kolateralit janë pengesa për huamarrësit.

Elementët strukturorë

37. Disa nga elementët strukturorë kryesorë që janë të domosdoshëm për një regjim efektiv të PPP/LFT-së në përgjithësi janë të pranishëm në Kosovë. Ekziston një angazhim i nivelit të lartë nga ana e hartuesve të politikave për të adresuar çështjet e PPP/LFT-së, që janë me prioritet në nivel strategjik bashkë me çështje që merren me ekonominë joformale. Kjo është e

⁸ Business and Strategies Europe, Vlerësim për Përhapjen e Ekonomisë Joformale në Kosovë (9 nëntor 2017), f. 53-54.

⁹ Business and Strategies Europe, Vlerësim për Përhapjen e Ekonomisë Joformale në Kosovë (9 nëntor 2017), f. 58.

dukshme në veçanti përmes Grupit Punues Qeveritar i themeluar për të trajtuar çështjet e PPP/LFT-së dhe ekonominë joformale. Ky grup kryesohet nga Ministri i Financave dhe përfshin zyrtarë në nivel të ministrave/zëvendësministrave dhe drejtuesve të agjencive (shih përshkrimin më poshtë).

38. Në të njëjtën kohë, një sërë elementësh strukturorë ende nuk janë krijuar plotësisht në Kosovë. Edhe pse situata është përmirësuar në vitet e fundit, ende ka mungesë të konsiderueshme të stabilitetit politik; institucionet, përfshirë sistemin gjyqësor, ende nuk kanë një shkallë përgjegjësie, integriteti dhe transparence.

39. Kosova po kalon nëpër një periudhë të zvogëlimit të misionit për sundimin e ligjit EULEX, gjë që do të sjellë sfidat e veta afatshkurtra dhe afatmesme sa i përket nevojës për të ndërtuar më tej kapacitetet e institucioneve të Kosovës.

Prapavija dhe faktorët rrethorë

40. Korrupsioni është një faktor kyç rrethor me një ndikim të gjerë në të gjithë elementët e sistemit të PPP/LFT-së. Kjo gjë është paraqitur në raportin e VKR-së të vitit 2013, në Raportin e Vlerësimit të Projektit PECK I të vitit 2014 dhe është reflektuar më tej në Indeksin e Perceptimit të Korrupsionit ku Kosova renditet e 85-ta nga 180 juridiksionet e vlerësuara, me një rezultat prej 39 nga 100. Për më tepër, sipas Treguesve Botërorë të Qeverisjes, kontrolli i korrupsionit në Kosovë mbetet i ulët në një prej 40%, duke mos treguar asnjë përmirësim të dukshëm përgjatë viteve.

41. Vlerësimi i Projektit PECK II për pajtueshmërinë me standardet ndërkombëtare në fushën e luftës kundër korrupsionit identifikoi disa zbrazëti që kanë të bëjnë me kornizën për parandalimin e korrupsionit në nivel të funksioneve të larta ekzekutive dhe të organeve të zbatimit të ligjit. Më parë, dy vlerësime të rrezikut në fushat e gjyqësorit dhe prokurorisë identifikuan një sërë faktorësh rreziku në këta sektorë. Këto gjetje konfirmojnë se fushat që janë kryesore për të siguruar një regjim efektiv të PPP/LFT-së, janë gjithashtu shumë të ndjeshme ndaj rreziqeve të korrupsionit, që duhet të adresohen si çështje me prioritet.

Strategjia për PPP/LFT-në

42. Qeveria e Kosovës ka miratuar Strategjinë dhe Planin e Veprimit pesëvjeçar për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Joformale, Pastrimit të Parave, Financimit të Terrorizmit dhe Krimeve Financiare (2014-2018). Plani i Veprimit në shtojcë të Strategjisë paraqet aktivitetet konkrete për arritjen e objektivave specifike dhe qëllimeve të zbatimit në Strategji, identifikon se cili institucion publik ka përgjegjësinë primare për zbatim dhe raportim, si dhe jep afatin kohor dhe kostot e vlerësuara për zbatim. Që të dy dokumentet janë hartuar në bazë të VKR-së dhe shërbejnë si element qendror i përpjekjeve të Qeverisë për të zbutur rreziqet. Gjithashtu, është integruar edhe një proces monitorimi për të rishikuar dhe vlerësuar zbatimin e Strategjisë dhe të Planit të Veprimit. Ekzistojnë dhe një numër strategjish mbështetëse për të luftuar terrorizmin dhe krimin e organizuar që plotësojnë strategjinë për PPP/LFT-në për qëllime të këtij vlerësimi (shih analizën e mëtejshme të kornizës strategjike nën RM 1 dhe Rekomandimin 2).

Korniza ligjore dhe institucionale

43. Korniza për PPP/LFT-në në Kosovë udhëhiqet nga Ligji për PPP/LFT-në, i miratuar në vitin 2016. Një version paraprak i Ligjit për PPP/LFT-në (që zëvendëson Rregulloren fillestare të UNMIK-ut nr. 2004/2) është miratuar në vitin 2010 dhe më pas është ndryshuar në vitin 2013. Që nga vlerësimi i fundit, janë nxjerrë disa akte nënligjore, rregullore dhe udhëzime administrative në përputhje me legjisllacionin e rishikuar të PPP/LFT-së, kryesisht nga Ministria e Financave dhe NjIF-i në veçanti, por pa u kufizuar vetëm në:

- Udhëzimi Administrativ i NjIF-it nr. 05/2014 për standardet minimale, procedurat e shkruara dhe kontrollet për parandalimin dhe zbulimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit nga profesionistët në fjalë;
- Urdhëresa Administrative e NjIF-it nr. 02/2015 për parandalimin dhe zbulimin e pastrimit të parave;
- Urdhëresa Administrative e NjIF-it nr. 03/2015 për parandalimin dhe zbulimin e financimit të terrorizmit;
- Udhëzimi Administrativ i NjIF-it nr. 02/2017 për trajnimet për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit.

44. Ligji për PPP/LFT-në (neni 56) paraqet veprat penale të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, që përmenden edhe në Kodin Penal (neni 308). Një sërë dispozitash të ndërlidhura me PPP/LFT-në janë ende duke u zhvilluar, kryesisht në lidhje me sanksionet financiare të shënjestruara për financim të terrorizmit.

45. Agjencitë dhe organet ndërinstitucionale kryesore të përfshira në strukturën institucionale të PPP/LFT-së së Kosovës janë në vijim:

46. **Njësia e Inteligjencës Financiare (NjIF)** është themeluar në vitin 2010. NjIF-i është njësi administrative e inteligjencës financiare dhe ka një rol udhëheqës në lidhje me masat e PPP/LFT-së. Në pikëpamje administrative, ajo është në varësi të Ministrisë së Financave. **Bordi Mbikëqyrës** i NjIF-it kryesohet nga Ministri i Financave dhe përfshin Ministrin e Punëve të Brendshme, Kryeprokurorin e Kosovës, Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Kosovës, Drejtorin e Administratës Tatimore të Kosovës, Drejtorin e Përgjithshëm të Doganës dhe Guvernatorin e BQK-së. Bordi bën bashkërendimin e politikave në nivel shtetëror për PPP/LFT-në në bashkëpunim me institucionet e tjera dhe palët e interesuara përkatëse dhe mbledhet së paku dy herë në vit. Ai miraton buxhetin dhe strukturën e NjIF-it, emëron Drejtorin e NjIF-it dhe shqyrton raportet vjetore të NjIF-it.

47. **Ministria e Financave (MF)** formulon dhe zbaton politikën e Qeverisë lidhur me çështjet financiare, tatimore dhe doganore. Ajo ka përgjegjësinë e përgjithshme për legjislacionin në fushën e PPP/LFT-së. MF-ja gjithashtu bën licencimin dhe mbikëqyrjen e veprimtarive të kompanive të auditimit privat, auditorëve dhe kontabilistëve si dhe operatorëve të lojërave të fatit përmes divizionit të veçantë pranë Administratës Tatimore të Kosovës.

48. **Administrata Tatimore e Kosovës (ATK)** është organi qendror përgjegjës për mbledhjen e të ardhurave tatimore në Kosovë dhe hetimin e shmangies nga tatimi. ATK-ja është gjithashtu autoriteti rregullator i lojërave të fatit. Ajo mbikëqyr dhe menaxhon procesin e regjistrimit, por gjithashtu menaxhon procesin e licencimit të operatorëve të lojërave të fatit në përputhje me ligjin.

49. **Komisioni për kontrollin e tregtisë së mallrave strategjike** përcakton regjimin rregullator dhe mekanizmat e kontrollit për mallrat me përdorim të dyfishtë (sipas Ligjit nr. 04/L-198 për Tregtinë e Mallrave Strategjike, ku përfshihen armë të shkatërrimit në masë sipas nenit 3, paragrafi 1.6). Komisioni përbëhet nga pesë anëtarë, që përfaqësojnë Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, Ministrinë e Punëve të Jashtme, Ministrinë e Forcës së Sigurisë, Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Doganën e Kosovës.

50. **Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI)** është përgjegjëse për themelimin dhe mbikëqyrjen e Regjistrimit të Organizatave të Biznesit dhe Emrave Tregtarë. Që nga viti 2011, ky funksion sigurohet nga **Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës (ARBK)**.

51. **Ministria e Punëve të Jashtme (MPJ)** është përgjegjëse për bashkërendimin e zbatimit të sanksioneve financiare që shënjestrojnë terrorizmin dhe sanksionet e lidhura me FP-në (në përputhje me Ligjin nr. 03/L-183 për Zbatimin e Sanksioneve Ndërkombëtare).

52. **Ministria e Punëve të Brendshme (MPB)** ka për mision të ndërtojë, ruajë dhe rrisë sigurinë për të gjithë qytetarët. Një nga prioritetet e saj strategjike është parandalimi dhe zvogëlimi i krimit. Ajo mbikëqyr funksionimin e Policisë së Kosovës.

53. **Policia e Kosovës (PK)** është përgjegjëse, ndër të tjera, për sigurimin e rendit dhe sigurisë publike, luftimin e krimit të organizuar dhe garantimin e integritetit të kufijve. Ajo ka themeluar Divizionin kundër Krimit të Organizuar (DKO), që përfshin Sektorin e Hetimeve të Integruara Financiare që është përgjegjës për të zhvilluar hetime mbi kriminalitetin; si dhe Drejtorinë për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit (DHKEK), që përfshin Sektorin për Hetime Financiare dhe Njësinë e PP-së, që merret posaçërisht me krimin financiar dhe pastrimin e parave.

54. **Dogana e Kosovës (DK)** siguron lejimin dhe kontrollin e tregtisë së ligjshme dhe të udhëtarëve, mbledh të ardhurat doganore dhe punon për të parandaluar rreziqet tatimore dhe për të hetuar veprat penale të kontrabandës dhe trafikimit, si dhe pastrimin e parave të ndërlidhur.

55. **Banka Qendrore e Kosovës (BQK)** promovon dhe mban stabilitetin e sistemit financiar, sistemit të pagesave, si dhe stabilitetin e çmimeve. Banka Qendrore është gjithashtu autoriteti mbikëqyrës për të gjitha institucionet financiare në Kosovë, duke përfshirë institucionet e kreditit bankare dhe jobankare, dërguesit e parave, shkëmbimet e valutave dhe shoqëritë e sigurimeve.

56. **Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK)** është institucion tërësisht i pavarur në ushtrimin e funksioneve të tij me qëllim të sigurimit të një sistemi prokurorial profesional dhe të paanshëm. Këshilli përbëhet nga 13 anëtarë, 10 prej të cilëve janë prokurorë dhe 3 që nuk janë prokurorë, të cilët vendosin për politikat e të gjithë sistemit të prokurorisë.

57. **Zyra e Prokurorit të Shtetit (PSH)** është institucion i pavarur me autoritet dhe përgjegjësi për ndjekjen penale të personave të akuzuar për kryerjen e veprave penale ose akteve të tjera të përcaktuara me ligj. Prokuroria e Shtetit është sistem i unifikuar i autorizuar për të: filluar procedura penale, siguruar hetimin dhe ndjekjen penale të veprave penale në kohën e duhur kundër personave të dyshuar ose të akuzuar për kryerjen e veprave penale; përfaqësuar aktakuzat para gjykatës; ushtruar mjetet juridike të rregullta dhe të jashtëzakonshme kundër vendimeve gjyqësore; mbrojtur të drejtat ligjore të viktimave, dëshmitarëve, të dyshuarve, të akuzuarve dhe personave të dënuar; bashkëpunuar me policinë, gjykatat dhe institucionet e tjera; ndërmarrë të gjitha veprimet e tjera të përcaktuara me ligj.

58. **Prokuroria Speciale (PSRK)** në kuadër të Zyrës së Prokurorit të Shtetit është themeluar me ligj të veçantë. PSRK-ja ka kompetencë ekskluzive të hetojë dhe të ndjekë penalisht, ndër të tjera, pastrimin e parave, veprat e terrorizmit, krimin e organizuar, si dhe kompetenca plotësuese për vepra si trafikimi, falsifikimi i parave, korrupsioni e mashtrimi dhe veprat e tjera të rënda.

59. **Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK)** siguron pavarësinë dhe paanshmërinë e sistemit gjyqësor. Ai është përgjegjës për rekrutimin dhe propozimin e kandidatëve për emërim në sistemin gjyqësor. KGJK-ja është gjithashtu përgjegjës për transferimin e gjyqtarëve dhe procedurat disiplinore.

60. **Agjencia Kosovare e Inteligjencës (AKI)** është themeluar si shërbim i sigurisë dhe i inteligjencës në Kosovë. AKI-ja ka status juridik dhe kompetencë për të vepruar në të gjithë territorin e Kosovës. AKI-ja mbledh informacion për kërcënimet ndaj sigurisë në Kosovë: terrorizmin, krimin e organizuar, trafikimin, etj. AKI nuk ka kompetenca ekzekutive.

61. **Koordinatori Kombëtar për Luftimin e Krimit Ekonomik (KKLKE)** promovon, bashkërendon, monitoron, vlerëson dhe raporton për aktivitetet e institucioneve të zbatimit të ligjit që kanë të bëjnë me parandalimin, zbulimin, hetimin, ndjekjen dhe gjykimin e krimit që gjeneron përfitime materiale.

Sektori financiar

62. Sektori financiar në Kosovë përbëhet nga 10 banka tregtare të licencuara që funksionojnë në Kosovë, 2 fonde pensionale të licencuara, 15 shoqëri sigurimi të licencuara (përfshirë 3 shoqëri që ofrojnë sigurim të jetës), 11 IMF, 18 ndërmjetësues për sigurime, 56 IFJB nga të cilat 8 IFJB bëjnë transfertat parash dhe aktivitete pagese, 4 janë të përfshira në aktivitete kreditore, 3 bëjnë aktivitete lizingu, një merret me faktoringun ndërsa 42 janë zyra këmbimore (dy IFJB që merren me aktivitete kreditore janë të përfshira edhe në aktivitete të tjera).

63. Shuma e përgjithshme e aseteve të sektorit financiar (duke përjashtuar BQK-në) në Kosovë ka arritur 5.91 miliardë euro në vitin 2017 dhe është rritur me 9.7% në krahasim me vitin 2016. Asetet e sektorit bankar janë 3.87 miliardë euro, me shkallë të rritjes vjetore prej 6.4%, që përbën rreth 65.5% të aseteve të përgjithshme të sektorit financiar. Fondet pensionale nën menaxhim të trustit kanë arritur në 1.653 miliardë euro me shkallë të rritjes 16% dhe përbëjnë 27.9% të totalit të aseteve financiare. Asetet e menaxhuara nga IMF-të janë në vlerën e 192.4 milionë euro, me rritje prej 28.6% dhe përfaqësojnë 2.5% të sektorit financiar, pas shoqërive të sigurimit me asete në 177.1 milionë euro (155.7 milionë euro për jo-jetë dhe 21.6 milionë euro për jetë) që përfaqësojnë 3% të aseteve të sektorit financiar.

64. Vitet e fundit, sistemi bankar është karakterizuar nga ndryshime në zgjerimin e infrastrukturës, ku numri i degëve dhe agjencive (nën-degëve) të bankave komerciale është ulur nga 265 në vitin 2015 në 238 në dhjetor 2017. Tetë banka janë pronë e kapitalit të huaj (Austri, Gjermani, Francë, Turqi, Slloveni, Serbi), ndërsa dy prej tyre janë në pronësi vendore.

65. Bankat në pronësi të huaj dominojnë në sistemin bankar të Kosovës pasi menaxhojnë 88.1% të totalit të aseteve në sistemin bankar në dhjetor 2017. Pjesa e mbetur e aseteve (11.9% në dhjetor 2017) menaxhohet nga pronësia vendore. Sistemi i bankave në Kosovë vazhdon të karakterizohet nga niveli i lartë i përqendrimit të tregut, ku 61.1% e totalit të aseteve bankare menaxhohet nga tri bankat më të mëdha, ndërkohë që përqendrimi i aseteve në bankat në pronësi të huaj është në nivelin 88.1%.

66. Thellësia dhe sofistikimi i shërbimeve financiare të ofruara nga IMF-të janë të dobët, me përqendrim kryesor që ato të jenë produkte bazë të kredive. Institucionet mikrofinanciare janë të përfshira kryesisht në operacionet e mikrokredisë në zonat rurale, ku ka një nivel të konsiderueshëm të ekonomisë joformale, duke rritur kështu rreziqet e PP/FT-së.

67. Operatorët e ShTPV-ve dhe bankat kryejnë një volum të madh të dërgimit të remitancave në para nga dhe drejt komuniteteve të gjera të diasporës që gjenden jashtë Kosovës. Për vitin 2017, remitancat hyrëse kanë arritur gjithsej në 759.2 milionë euro, ndërsa remitancat e dërguara jashtë kanë arritur gjithsej në 51.1 milionë euro.

68. BQK-ja është përgjegjëse për mbikëqyrjen e të gjitha subjekteve të sektorit financiar. Për momentin ende nuk ka bursë në Kosovë dhe asnjë ndërmjetësues të licencuar për letrat me vlerë.

BPCJF-të

69. Kategoritë e BPCJF-ve që përkufizohen si subjekte raportuese në Ligjin për PPP/LFT-në përfshijnë kazinotë, përfshirë kazinotë me bazë internetin, si dhe objektet e licencuara të lojërave të fatit; agjentët e patundshmërive dhe ndërmjetësuesit e patundshmërive; avokatët dhe noterët kur ata përgatiten për ose angazhohen në transaksione për klientët e tyre lidhur me disa aktivitete të caktuara; kontabilistët, auditorët dhe këshilltarët tatimorë; ofruesit e shërbimeve për truste dhe kompani të cilët nuk mbulojnë tjetërkund nga Ligji për PPP/LFT-në dhe që ofrojnë disa shërbime të caktuara për palë të treta në baza komerciale; si dhe shitësit e metaleve të çmuara dhe tregtarët e gurëve të çmuar. Gjithashtu, autoritetet e Kosovës kanë përcaktuar si subjekte raportuese edhe subjektet në vijim: personat fizikë dhe juridikë që tregtojnë mallra me vlerë të lartë në 10.000 euro apo më shumë dhe organizatat jofitimprurëse.

70. Të gjitha llojet e BPCJF-ve operojnë në Kosovë, me përjashtim të ofruesve të shërbimeve për truste dhe kompani (OSHTK), që nuk njihen në sistemin juridik të Kosovës. Sipas NjIF-it, në Kosovë janë të regjistruar gjithsej rreth 1.885 BPCJF:

Tabela 1: Numri i subjekteve sipas autoritetit në secilin sektor të BPCJF-ve

SEKTORI JOFINANCIAR Emërtimi i subjektit	Nr. i subjekteve të licencuara / rregulluara / regjistruara
Lojërat e fatit	41
Agjentë të patundshmërive	46
Avokatë	840
Noterë	74
Kontabilistë dhe auditorë	473
Tregtarë të metaleve dhe gurëve të çmuar	411
Tjetër: OJQ të regjistruara	9.555

71. Në Kosovë nuk ka kazino të regjistruara, mirëpo ka 41 lojëra të fatit, ku përfshihen makinat e fatit (aktiviteti kryesor), bingot, tombola, njësitë sportive të basteve dhe një lotari publike. Sektori mbikëqyret nga ATK-ja dhe NjIF-i (për qëllime të PPP/LFT-së).

72. Sektori i pasurive të patundshme konsiderohet si me rrezikshmëri të lartë, sepse agjencitë e patundshmërive nuk marrin licencë për të vepruar (ata konsiderohen të jenë lehtësues të transaksioneve të ardhshme ndërmjet blerësit dhe shitësit) dhe për shkak të përdorimit të gjerë të parave të gatshme në këtë sektor. Patundshmëritë duhet të noterizohen dhe më pas të regjistrohen në Zyrat Kadastrale Komunale përkatëse (ZKK). Çdo transaksion për shitjen / blerjen e pasurisë në vlerën prej 10.000 euro apo më shumë duhet të kryhet përmes transfertës bankare, përndryshe nuk regjistrohet në kadastër, prandaj bankat kanë një rol të mundshëm parandalues në monitorimin e transaksioneve të patundshmërive.

73. Avokatët në Kosovë organizohen përmes Odës së Avokatëve të Kosovës (OAK). Veprimtaria e Odës dhe organizimi i saj rregullohet nga Ligji për OAK nr. 04/L-193, Statuti i OAK dhe Kodi i Etikës për Avokatët. MD-ja është përgjegjëse për t'u siguruar se profesioni juridik ushtrohet në përputhje me ligjin.

74. Noterët në Kosovë organizohen përmes Odës së Noterëve të Kosovës (ONK), që është organ i krijuar rishtazi. Ministri i Drejtësisë përcakton numrin e përgjithshëm të noterëve dhe mbulimin relativ për secilën komunë. Noterët janë të përfshirë në të gjitha transaksionet që

lidhen me shitjen e pasurive të luajshme dhe të paluajshme, përfshirë patundshmëritë, dhe si të tillë kanë rol shtesë në regjimin parandalues për transaksionet e patundshmërive.

75. Sektori i kontabilitetit përfshin firma të mëdha ndërkombëtare, biznese të vogla lokale, si dhe profesionistë të pavarur. Aktivitetet e kryera nga ky sektor, sikurse u konfirmuan gjatë vizitës në terren, përfshijnë kontabilitetin, konsulencën për tatimet dhe auditimin. Firmat më të mëdha gjithashtu shoqërojnë transaksionet kapitale.

76. Tregtarët e metaleve dhe gurëve të çmuar janë individë ose subjekte juridike. Veprimtaria e tyre rregullohet në mënyrë specifike nga ligje të tjera bashkë me Ligjin nr. 04/L-154 për Punimet nga Metalet e Çmuara. Sipas këtij ligji, produktet e metaleve të çmuara i nënshtrohen ekzaminimit dhe shënimit të detyrueshëm para se të vendosen në treg. Ato duhet të certifikohen me vulë nga Inspektorati i Metrologjisë, aktualisht Agjencia e Metrologjisë dhe monitorohen nga Inspektorati i Tregut në kuadër të MTI-së. Ekzaminimi bëhet në laboratorin e produkteve të metaleve të çmuara. Pavarësisht kërkesave rregullative, ekziston rreziku i konsiderueshëm nga produkte të pashënuara të vendosura dhe të shitura nga TMGÇ-të në Kosovë, potencialisht me prejardhje prej të ardhurave nga krimi. Janë zhvilluar një sërë operacionesh policore që kanë rezultuar në konfiskim të sasive të konsiderueshme të produkteve të tilla.

Masat parandaluese

77. Ligji për PPP/LFT-në përmban kërkesat kryesore për masat parandaluese që duhet të ndërmerren nga subjektet raportuese, përfshirë kërkesat për KDK-në, raportimin, vlerësimin e rrezikut, ruajtjen e të dhënave dhe kontrollin e brendshme. NjIF-i dhe BQK-ja kanë miratuar një sërë aktesh nënligjore për detajimin e kërkesave parandaluese (p.sh. në fushën e identifikimit të pronësisë përfituese).

78. Versioni i vitit 2016 i Ligjit për PPP/LFT-në ka trajtuar disa mangësi lidhur me masat parandaluese të theksuara në vlerësimin e ndërsjellë të vitit 2014. Megjithatë, një numër mangësish kanë mbetur ende, ashtu si theksohet në Shtojcën e Përputhshmërisë Teknike.

Personat dhe marrëveshjet juridike

79. Në bazë të legjislacionit të zbatueshëm, në Kosovë mund të krijohen këto lloje të personave juridikë:

80. Biznes Individual (BI): është subjekt që mund të krijohet dhe të zotërohet vetëm nga një person fizik dhe nuk ka status të veçantë juridik. Pronari i një subjekti të tillë ka përgjegjësi të pakufizuar personale për borxhet dhe detyrimet e biznesit individual. Edhe pse nuk është person juridik, ai mund të lidhë kontratë, të posedojë pronë dhe të ushtrojë padi ose të jetë i paditur në emër të vet ose në emër të pronarit të vet.

81. Ortakëri e Përgjithshme (OP): është ortakëri e krijuar nga dy apo më shumë persona fizikë ose juridikë, të cilët ndërmarrin veprimtari afariste në pajtim me marrëveshjen e ortakërisë së përgjithshme. Pronarët e këtyre subjekteve janë përgjegjës bashkërisht dhe individualisht për borxhet dhe detyrimet e OP. Kjo përgjegjësi është e pakufizuar. OP nuk është person juridik, por mund të krijohet nga persona juridikë që bëhen partnerë të përgjithshëm të OP. OP menaxhohet nga ortak(ët) e saj të përgjithshëm. Edhe pse OP nuk është person juridik, ajo mund të lidhë kontratë, të posedojë pronë dhe të ushtrojë padi ose të jetë e paditur në emër të vet ose në emër të pronarit të vet.

82. Shoqëri komandite (SHKM): është shoqëri e krijuar nga të paktën një ortak i përgjithshëm dhe të paktën një ortak i kufizuar. Edhe pse shoqëria komandite nuk është person juridik, ajo mund të lidhë kontratë, të posedojë pronë dhe të ushtrojë padi ose të jetë e paditur në emër të vet ose në emër të pronarit të vet.

83. Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar (SHPK): është person juridik i krijuar dhe në pronësi të një ose më shumë personave fizikë ose juridikë, duke përjashtuar OJQ-të. SHPK është ligjërisht e ndarë dhe e dallueshme nga pronarët e saj. Përgjegjësia personale e pronarëve është e kufizuar në kapitalin që kanë investuar në SHPK.

84. Shoqëri aksionare (SHA): është person juridik në pronësi të aksionarëve të saj, por është ligjërisht e ndarë dhe e dallueshme nga aksionarët e vet. Kështu, aksionarët kanë përgjegjësi të kufizuar personale për borxhet dhe detyrimet e SHA.

85. Ligji për Shoqëritë Tregtare parasheh procesin e krijimit të personit juridik dhe dorëzimin e informacionit bazë të pronësisë në Regjistrin e Kosovës për Shoqëritë Tregtare dhe Emrat Tregtarë. Regjistri i Bizneseve është regjistrer qendror që mban të dhënat e të gjitha

shoqërive të regjistruara. Regjistri i Bizneseve është përgjegjës për: regjistrimin e shoqërive të reja; regjistrimin e emrave tregtarë; regjistrimin e degëve të shoqërive të huaja; marrjen e një kopjeje të pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve të biznesit të SHPK-ve dhe SHA-ve (një kopje e pasqyrave financiare dërgohet edhe në MF).

86. Aktualisht, Regjistri i Bizneseve përmban gjithsej 161.155 shoqëri. Nga këto, 128.976 janë regjistruar si BI, 3.503 si OP, 87 si SHKM, 27.061 si SHPK, 513 si SHA, 809 si shoqëri të huaja tregtare, 133 si kooperativa bujqësore, 30 si ndërmarrje sociale, 10 si ndërmarrje publike, me 33 shoqëri nën juridiksionin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

87. Ligji i Kosovës nuk i njeht trustet si lloj i veçantë i marrëveshjeve juridike dhe Kosova nuk është palë në Konventën e Hagës për Ligjin e Zbatueshëm për Truste dhe për Njohjen e tyre.

Masat mbikëqyrëse

88. Korniza mbikëqyrëse e PPP/LFT-së kryesisht konsolidohet nën BQK-në dhe NjIF-in. Për institucionet financiare, BQK-ja është autoriteti kryesor licencues dhe mbikëqyrës edhe për qëllime të PPP/LFT-së si dhe për qëllime jo të PPP/LFT-së. Në të njëjtën kohë, NjIF-i është përcaktuar si mbikëqyrës për PPP/LFT-në për IF-të:

Tabela 2: Institucionet financiare

Institucionet financiare	Licencimi ose regjistrimi	Mbikëqyrësi për PPP/LFT-në
Banka	BQK	BQK dhe NjIF
Zyra të këmbimit të valutës	BQK	BQK dhe NjIF
ShTPV	BQK	BQK dhe NjIF
Shoqëri të sigurimeve	BQK	BQK dhe NjIF
IMF	BQK	BQK dhe NjIF
IFJB	BQK	BQK dhe NjIF
Fonde pensionale private	BQK	BQK dhe NjIF

89. BPCJF-të mbulohen nga masat e mëposhtme:

Tabela 3: BPCJF-të

BPCJF	Licencimi, regjistrimi, caktimi, rregullimi	Mbikëqyrësi për PPP / LFT-në
Noterë	Oda e Noterëve / Ministria e Drejtësisë	NjIF
Avokatë	Oda e Avokatëve / Ministria e Drejtësisë	NjIF
Auditorë të pavarur dhe kompani të auditimit	Këshilli Kosovar për Raportim Financiar / Ministria e Financave	NjIF
Kontabilistë të pavarur dhe kompani të kontabilitetit	Këshilli Kosovar për Raportim Financiar / Ministria e Financave	NjIF
Persona dhe kazino që organizojnë lojëra me çmime përfshirë persona që organizojnë lojëra të tilla përmes internetit	Divizioni i Lojërave të Fatit / Administrata Tatimore e Kosovës	NjIF
Agjentë/agjenci të patundshmërive	ARBK & ATK	NjIF
Ofrues të shërbimeve për truste dhe kompani	N/A	N/A
Tregtarë të metaleve të çmuara; tregtarë të gurëve të çmuar	Departamenti i Metrologjisë / MTI	NjIF
Tregtarë të mallrave që paguhen në para të gatshme në vlerë prej 10.000 euro apo më shumë	-	NjIF
OJQ	DRNOJQ / MAP	NjIF
Parti politike	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	

Bashkëpunimi ndërkombëtar

90. Për shkak të statusit të vet, Kosova përballet me një sërë pengesash ndaj bashkëpunimit ndërkombëtar, veçanërisht përmes mekanizmave multilateralë, ku autoritetet e Kosovës nuk janë të përfaqësuar, si për shembull Interpoli. Kohët e fundit, NjIF e Kosovës

është bërë anëtare e Grupit Egmont, gjë që ka lehtësuar shkëmbimin e informacionit me NjIF-e të huaja; Dogana e Kosovës është bërë pjesë e Organizatës Botërore të Doganave, gjë që duhet ta lehtësojë shkëmbimin e mëtejshëm të informacionit. Marrëveshjet bilaterale për NNJ përdoren në mënyrë aktive, aty ku ato janë arritur, ndërsa në raste të tjera NNJ-ja dhe forma të tjera të shkëmbimit ndërkombëtar të informacionit bëhen përmes UNMIK-ut ose EULEX-it.

KAPITULLI 2. POLITIKAT DHE BASHKËRENDIMI VENDOR PËR PPP/LFT-NË

Gjetjet kryesore dhe veprimet e rekomanduara

Gjetjet kryesore

- Autoritetet e Kosovës kanë zhvilluar një sërë mjetesh dhe mekanizmash për të vlerësuar rreziqet nga pikëpamja gjithëpërfshirëse dhe sektoriale; janë krijuar mekanizma periodikisht dhe në vazhdimësi. Mirëpo, duke pasur parasysh gamën e mekanizmave ekzistues, autoritetet ende nuk kanë një kuptim plotësisht të integruar të rreziqeve të PP/FT-së që rrjedhin nga këto ushtrime.
- Janë kryer veçmas VKR-ja dhe vlerësimi i kërcënimit nga krimet e rënda dhe krimi i organizuar (SOCTA), edhe pse nuk janë bashkërenduar plotësisht, gjë që duhet të jetë thelbësore për përditësimin e ardhshëm të dy dokumenteve në vitin 2018.
- Në nivel sektorial, disa vlerësime të ndërmarra kohët e fundit u kanë mundësuar autoriteteve kosovare të zhvillojnë të kuptuarit e tyre për zonat me rrezik më të lartë të patundshmërive, OJF-ve, ndërtimit dhe lojërave të fatit. Megjithatë, këto duhet të thellohen dhe zgjerohen për të siguruar që të gjitha kërcënimet e ndërlidhura, tipologjitë dhe dobësitë e produktit financiar të jenë të mbuluar siç duhet për këta sektorë, të kuptohen nga autoritetet dhe t'i komunikohen si duhet sektorit privat.
- Raporti i vitit 2013 i VKR-së nuk është i përpunuar mjaftueshëm sa i përket vërtetimit cilësor dhe sasior të gjetjeve të tij dhe nuk shfaq karakteristikat e një vlerësimi gjithëpërfshirës të bazuar në një metodologji të fuqishme. Përshkrimi midis blloqeve themelore të VKR-së (kërcënimi, cenueshmëria, gjasat dhe pasojat) nuk është përcaktuar në mënyrë të përpiktë. VKR-ja nuk ka përfshirë shtrirje dhe thellësi të mjaftueshme lidhur me tendencat dhe tipologjitë mbizotëruese të PP/FT-së në Kosovë. Përderisa NjIF-i ka zhvilluar tipologji me cilësi të lartë, këto nuk kanë bërë që autoritetet e Kosovës të krijojnë të kuptuar të rreziqeve gjatë procesit të VKR-së, ose më gjerësisht në komunitetin ndërinstucional.
- Shpeshësia e përditësimit të VKR-së nuk është në përpjesëtim me situatën në zhvillim të rrezikut të PP/FT-së.
- Mekanizma të tjerë të nivelit operativ për monitorimin e kërcënimeve, përfshirë njësinë e specializuar që është pjesë e Qendrës së Menaxhimit të Integruar të Kufirit, kanë një të kuptuar më të mirë të rreziqeve / kërcënimeve të ndërlidhura me kufirin, përfshirë ato që lidhen me kontrabandën e parave, mirëpo mungon vetëdijesimi i autoriteteve të tjera për këto çështje.
- Edhe pse komponenti i FT-së në VKR është jashtëzakonisht i kufizuar, në përgjithësi të kuptuarit që kanë autoritetet për kërcënimet nga FT-ja ka evoluar ndjeshëm që nga viti 2013. Në veçanti, është arritur vetëdijesim i qartë për rreziqet kryesore nga FT-ja që ndërlidhen me luftëtarët e huaj terroristë dhe organizatat jofitimprurëse nga të gjithë autoritetet e PPP/LFT-së të përfshira. Autoritetet konsiderojnë se këto rreziqe do të zbuten kryesisht nga zbatimi i ligjit, ndërhyrjet rregullative dhe të politikave, mirëpo ende nuk është bërë ndonjë matje e rrezikut të mbetur në këtë çështje.
- Autoritetet kanë një kornizë të integruar mirë të menaxhimit të rrezikut, që parasheh një ndërlidhje direkte ndërmjet ushtrimit të VKR-së dhe hartimit të Strategjisë për PPP/LFT-në dhe Planit të Veprimit. Për më tepër, autoritetet kanë ofruar dëshmi për veprime specifike të ndërmarra në lidhje me rialokimin e burimeve tek agjencitë qeveritare për të shënjestruar rreziqet e identifikuar nga VKR-ja. Në të njëjtën kohë, ndihet se Strategjia dhe Plani i Veprimit janë bazuar në gjetje shumë të gjera të VKR-së, ndërsa veprimet e nevojshme nuk janë përcaktuar në mënyrë koherente dhe/ose niveli i ambicieve të politikave në shumë aspekte të Planit të Veprimit nuk është tërësisht i përshtatshëm për një dokument të PPP/LFT-së.
- Integrimi i masave për të luftuar ekonominë joformale me dokumentet strategjike të PPP/LFT-së ka njëfarë vlere; sidoqoftë ai duhet të trajtohet me një shkallë të kujdesit,

duke pasur parasysh mjetet e ndryshme që përdoren shpesh për të ndjekur PPP/LFT-në në nivel operativ.

- Ekipi i vlerësimit konstatoi se niveli i përgjithshëm i të kuptuarit që lloje të ndryshme të institucioneve financiare dhe BPCJF-të kanë për rrezikun e PP/FT-së ndryshon në mënyrë të konsiderueshme. Ky është tregues se masat parandaluese në Kosovë nuk janë të përshtatura në mënyrë specifike me rreziqet mbizotëruese të identifikuara në juridiksion.
- Edhe pse ka mekanizma për të bashkërenduar politikat kombëtare të PPP/LFT-së, shpesh mungojnë sinergji të përafërta me strategjitë kombëtare, si lufta kundër terrorizmit, krimin të organizuar, menaxhimin të kufirit, trafikimit të drogës dhe të qenieve njerëzore.
- Kosova është përpjekur të rrisë bashkëpunimin në nivel operativ dhe bashkërendimin ndërmjet të gjitha autoriteteve kompetente. Mekanizmat praktikë të krijuara për këtë qëllim (MM dhe PSO ndërinstytucionale) duket se janë pjesërisht funksionale dhe jo tërësisht të monitoruara për efektivitetin e tyre, edhe janë arritur disa rezultate praktike. Në praktikë, autoritetet e zbatimit të ligjit praktikojnë bashkëpunim efektiv përmes zyrtarëve ndërlidhës, njësisive dhe operacioneve të përbashkëta.
- NjIF-i shërben si pikë qendrore kryesore për bashkëpunimin ndërinstytucional. Sidoqoftë, ka ende hapësirë për përmirësim sa i përket: bashkëpunimit ndërmjet NjIF-it dhe mbikëqyrësve sektorialë; qasjes më të lehtë në kohë reale në databazat ndërmjet autoriteteve; mekanizmave lidhur me informatat kthyesë për hetimet dhe ndjekjet penale të PP-së.
- Koordinatorin Kombëtar për Luftimin e Krimin Ekonomik (KKLKE) është institucion i rëndësishëm që lehtëson bashkërendimin ndërmjet autoriteteve të drejtësisë penale, sidomos për çështje të sekuestrimit dhe konfiskimit dhe ka arritur rezultate të konsiderueshme në këtë fushë. Në të njëjtën kohë, ka në përgjithësi hapësirë për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe prokurorisë, sidomos sa i përket ndjekjes së rasteve dhe bashkërendimit të informacionit statistikor për PP/FT-në.
- Bashkërendimi dhe bashkëpunimi brenda kornizës institucionale të Kosovës në lidhje me luftimin e PF-së duhet të zhvillohet. Rezultatet e punës së bërë nga agjencitë e ndryshme në lidhje me luftën kundër përhapjes duhet të komunikohen dhe të reflektohen në hartimin e politikave brenda juridiksionit.

Veprimet e rekomanduara

Autoritetet e Kosovës duhet të fuqizojnë vlerësimin e rrezikut, menaxhimin e rrezikut dhe kornizën strategjike, sidomos me anë të masave në vijim:

- Zhvillimi i një VKR-je gjithëpërfshirëse për PP-në që bazohet mbi metodologji të përqendruar te shqyrtimi i hollësishëm i kërcënimeve dhe dobësive mbizotëruese. Shqyrtimi i kërcënimeve duhet të ndërlihet ngushtë me procesin e SOCTA-s dhe me mekanizmat e tjerë të nivelit operativ në Kosovë (MIK, NjPIARK, etj.). Autoritetet duhet të vlerësojnë me kujdes të lartë të gjithë sektorët financiarë dhe produktet financiare nga pikëpamja e rrezikut të PP/FT-së dhe tipologjive të ndërlidhura me këta sektorë dhe produkte në Kosovë, dhe njësoj të veprohet për të gjithë sektorët e BPCJF-ve (duke përfshirë një përqendrim të veçantë te TMGÇ-të); VKR-ja duhet të përcaktojë rrezikun e mbetur të PP-së dhe FT-së në Kosovë dhe të marrë parasysh korrupsionin si faktor rrethor që ndikon në efektivitetin e PPP-së.
- Nga ana tjetër, procesi i SOCTA-s në komponentin e vet lidhur me PP-në duhet të përafrohet me gjetjet e VKR-së së ardhshme dhe me vlerësimet e tjera për PP-në.
- Duhet siguruar vlerësim gjithëpërfshirës i rreziqeve të FT-së, qoftë në kuadër të VKR-së së PP-së, qoftë si një ushtrim më vete, si dhe një analizë e thellë e tipologjive të financimit të terrorizmit që lidhen me LHT-të dhe radikalizimin në Kosovë; kërcënimet dhe tipologjitë e keqpërdorimit të OJF-ve në Kosovë dhe dobësitë specifike sektoriale dhe të produkteve që lidhen me këto fenomene, përfshirë sektorin e TMGÇ-ve.
- Autoritetet duhet të miratojnë një format të kornizës së menaxhimit të rrezikut që vazhdon të adresojë faktorët rrethorë (të cilët janë të natyrës më statike), por që të

jetë mjaftueshëm operative dhe e adaptueshme ndaj rreziqeve në zhvillim të PP/FT-së.

- Strategjia dhe Plani i Veprimit për PPP/LFT-në duhet të ripërcaktohen për t'u përqendruar tek impakti; duhet të futen në përdorim mjete që matin rrezikun e mbetur të PP/FT-së.
- Bashkërendimi i nivelit të politikave duhet të zhvillohet më tej ndërmjet Ministrisë së Financave, Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Drejtësisë dhe aktorëve të tjerë, me qëllim që të sigurohet kontribut i rëndësishëm për PPP/LFT-në në strategjitë e ndërlidhura me PPP/LFT-në, si dhe proceset për vlerësimin e rrezikut dhe kërcënimit që funksionojnë jashtë juridiksionit të MF (p.sh. SOCTA).
- Dokumentet strategjike dhe planet e veprimit për PPP/LFT-në duhet të paraqesin qartësi për masat në nivel operativ që duhen zhvilluar (nga agjencitë për zbatimin e ligjit, mbikëqyrësit dhe NjIF-i) për të zbutur rreziqet e identifikuara dhe gjithashtu për t'u siguruar se këto masa operative përfshihen në strukturat dhe praktikat ekzistuese të bashkërendimit.
- Të bëhet shqyrtimi dhe aktualizimi i Marrëveshjeve të Mirëkuptimit ekzistuese (MM për Shkëmbimin e Informacionit, Vlerësimin e Rrezikut dhe Bashkërendimin në mes Institucioneve dhe Agjencive të Zbatimit të Ligjit) për të thjeshtuar mekanizmat dhe procedurat e brendshme në mbështetje të platformave të bashkëpunimit mes shumë agjencive.
- Të përforcohet bashkëpunimi ndërinstitucional duke futur në përdorim mekanizma të kontrollit vertikal dhe horizontal që të sigurojnë zbatimin e plotë të MM-ve dhe PSO-ve në fuqi në mënyrë që të përmirësohet shkëmbimi i informacionit dhe ndërveprimi operativ ndërmjet AZL-ve dhe agjencive të tjera në Kosovë.
- Të krijohet një mekanizëm monitorimi dhe raportimi për të verifikuar që përparimi i bashkëpunimit ndërinstitucional është identifikuar qartë dhe është regjistruar. Ky mekanizëm duhet të trajtojë në mënyrë të veçantë kërkesat e bëra dhe përgjigjet e dhëna; statusin e raportimit; raportet, analizat dhe këshillat e ofruara në të dyja mënyrat dhe statusin e informatave kthyes.
- Të zhvillohet dhe zbatohet një sistem i rritjes së vetëdijesimit për subjektet e ngarkuara për identifikim të rreziqeve të PP-së dhe FT-së; si dhe udhëzuesit dhe kërkesat për subjektet raportuese që ky informacion të përfshihet në vlerësimin e tyre të rrezikut.
- Të kërkohet nga autoritetet përgjegjëse të mbikëqyrin institucionet e rregulluara dhe BPCJF-të për të përfutur një qasje të bazuar në rrezik për mbikëqyrjen dhe për t'u siguruar se të gjithë operatorët brenda sektorëve që u nënshtrohen ligjeve për PPP/LFT-në të kenë një nivel të dukshëm të të kuptuarit të ekspozimit të tyre ndaj rrezikut.
- Të mbahet parasysh përdorimi i institucionit të KKLKE për bashkërendimin e masave për të ndjekur raste të PP-së në sistemin e drejtësisë.
- Autoritetet duhet të zhvillojnë mekanizma bashkërendues për t'iu kundërvënë përhapjes së financimit.

91. Rezultati i Menjëhershëm përkatës i marrë në shqyrtim dhe i vlerësuar në këtë kapitull është RM. 1. Rekomandimet përkatëse për vlerësimin e efektivitetit në këtë seksion janë R. 1-2.

Rezultati i Menjëhershëm 1 (Rreziku, politikat dhe bashkërendimi)

Të kuptuarit që ka Kosova për rreziqet e PP/FT-së

92. Kuptimi i rrezikut brenda Kosovës ndryshon shumë. Edhe pse janë zhvilluar një sërë ushtrimesh në nivel kombëtar për të vlerësuar nivelin e rrezikut dhe kërcënimit, disa prej tyre tani janë të vjetëruara dhe janë zëvendësuar nga ngjarje. Ushtrimet e ndryshme të vlerësimit të rrezikut që janë kryer nuk janë ndërlidhur, edhe pse sektori privat ka qenë i përfshirë në zhvillimin e Vlerësimit Kombëtar të Rrezikut (VKR) në vitin 2013, shumica dërrmuese e subjekteve raportuese nuk janë në dijeni të rezultateve të këtyre studimeve.

93. Të kuptuarit e rreziqeve nga institucionet e Kosovës vjen nga informacionet e mbledhura në aktivitetet operative të vetë autoriteteve dhe, në një farë mase, ushtrimet për vlerësimin e rrezikut dhe kërcënimit janë zhvilluar që nga viti 2013. Në vitin 2016, u finalizua vlerësimi i kërcënimit nga krimet e rënda dhe krimi i organizuar (SOCTA) dhe mbulon periudhën 2014-2015 (përditësimi i SOCTA-s është duke u bërë dhe pritet të finalizohet deri në fund të vitit 2018). Për më tepër, ndërmjet tremujorit të tretë të vitit 2017 dhe tremujorit të parë të vitit 2018 u zhvilluan tre vlerësime të veçanta të rrezikut sektoriale që shqyrtojnë rreziqet e PP/FT-së në sektorin e OJQ-ve, industrinë e ndërtimit dhe biznesin e lojërave të fatit. Në kohën e vizitës në terren, ishin ndërmarrë vetëm hapa paraprakë për të zhvilluar një VKR të dytë, edhe pse kanë kaluar pesë vjet që nga publikimi i raportit të parë dhe në juridiksion kanë ndodhur një sërë zhvillimesh, bashkë me ndryshimet në trendet e PP/FT-së që ende nuk janë marrë parasysh. Kjo ka pasur efekt të dëmshëm në formulimin e politikave dhe masave operative të ndërlidhura me rrezikun.

94. VKR-ja e zhvilluar në vitin 2013 ishte përpjekje e parë për një ushtrim të tillë dhe autoritetet kosovare duhet të përgëzohen që kanë ndërmarrë një nismë të tillë. Shqyrtimi i raportit të VKR-së vuri në pah se ushtrimi i realizuar nuk ishte mjaftueshëm gjithëpërfshirës. Ky fakt u pranua nga autoritetet dhe u ndërmorën hapa për të siguruar se VKR-ja duhej të përfundonte deri në fund të dhjetorit 2018 dhe të bëhet në bazë të metodologjisë që ka fushëveprim më gjithëpërfshirës. Procesi i VKR-së u udhëhoq nga NjIF-i, me përfshirjen e shumë autoriteteve të tjera të sektorit publik në një grup punues *ad hoc* ku ishte përfaqësuar edhe sektori privat.

95. Duke analizuar VKR-në mund të arrihet në konkluzionin se raporti nuk shtjellon mjaftueshëm vërtetimin cilësor dhe sasior të gjetjeve të tij dhe kështu nuk paraqet karakteristikat e një vlerësimi gjithëpërfshirës bazuar në një metodologji të fuqishme. Raporti nuk përmban ndonjë pjesë të analizës së plotë, që do të lejonte për të gjykuar mbi logjikën dhe vërtetimin e konkluzioneve të paraqitura në dokument. Dokumentet teknike të paraqitura para ekipit të vlerësimit, që mbështesin gjetjet e Raportit, duket se tregojnë se mjeti kryesor i përdorur për të arritur te këto gjetje është një studim i zhvilluar nga autoritetet kompetente, megjithatë duket se llojet e tjera të analizës apo informacionit themelor (analiza statistikore, rastet dhe tipologjitë, gjetjet nga mbikëqyrja, të dhënat nga kërkesat e bashkëpunimit ndërkombëtar, burimet akademike dhe ndërkombëtare) janë të nevojshme për një VKR të besueshëm.

96. Skicimi i blloqeve themelore të VKR-së – kërcënimi, dobësia, gjasat dhe pasojat – nuk është i përcaktuar qartë. Këta identifikues përdoren në mënyrë të ndërlidhur me një fushëveprim të gjerë të fenomeneve, duke e bërë kështu të gjithë ushtrimin të duket i pastrukturuar. Për shembull, lista e kërcënimeve të PP-së përfshin formulime të tilla si "Biznesi ndërtimor, biznesi i patundshmërive dhe stacionet e karburantit janë sektorët më të cenueshëm nga pastrimi i parave" ose "shtrirja e ekonomisë joformale në Kosovë mbetet në nivel të lartë apo në rritje". Edhe pse konkluzione të tilla janë me të vërtetë të dobishme në një vlerësim të rrezikut, ato nuk janë drejtpërdrejt të lidhura me kërcënimin, pasi ai përshkruan sektorët ekonomikë ku zhvillohet veprimtaria e PP-së dhe dobësitë e BPCJF-ve (për sektorin e patundshmërive); ky i fundit është kryesisht një faktor rrethanor.

Kërcënimet

97. Sa i përket kërcënimeve, VKR-ja identifikon veprat kryesore në vijim: korrupsioni, veprat penale tatimore, krimet lidhur me procesin e prokurimit dhe privatizimit, kontrabanda dhe krime të tjera financiare dhe krimet e drogës. Ajo që bie më shumë në sy është mungesa e referimit ndaj kërcënimeve të paraqitura nga krimi i organizuar, që qartazi është burim kryesor për shqetësim në Kosovë, si dhe trafikimi i qenieve njerëzore. Për më tepër, nuk ka përshkrim të hollësishëm të mjedisit kërcënues përtej listës së thjeshtë të veprave të mësipërme dhe nuk ka ndonjë dallim ndërmjet veprave penale në vend dhe jashtë. Kjo e fundit është veçanërisht e rëndësishme në kuadër të pozitës gjeografike të Kosovës, duke marrë parasysh lidhjet me grupet e organizuara ndërkombëtare, trafikimin ndërkufitar të drogës, kontrabandën dhe aktivitetet e trafikimit të qenieve njerëzore.

98. SOCTA shkon disa hapa përtej VKR-së për identifikimin e kërcënimeve specifike kriminale ndaj të cilave është i ekspozuar juridiksioni. SOCTA shqyrton një sërë veprash dhe tendencash specifike për Kosovën dhe rajonin përreth. Në të njëjtën kohë, SOCTA zbaton një qasje përshkruese për secilin krim dhe nuk tenton të paraqesë përshkrim gjithëpërfshirës të strukturës së kriminalitetit të organizuar në Kosovë, sikurse bëhet normalisht në raportet e SOCTA (p.sh. numri dhe madhësia e grupeve të organizuara, specializimi, përbërja etnike, shpërndarja rajonale, lidhjet ndërkombëtare, etj.). Përderisa autoritetet kompetente (Divizioni

kundër Krimin të Organizuar i PK-së) duket se kanë elementë të të kuptuarit, autoritetet duhet ta zhvillojnë më tutje këtë në një analizë gjithëpërfshirëse dhe të hollësishme dhe ta përdorin atë për të synuar masat operative, përfshirë për qëllime të PPP-së.

99. Në nën-kapitullin për pastrimin e parave, SOCTA pranon elementin ndërkombëtar të pastrimit të parave, ku PP-ja në Kosovë ndodh nga veprimtaria kriminale e huaj dhe anasjelltas (PP-ja ndodh jashtë vendit nga veprimtaria kriminale që ndodh në Kosovë). Ky është një element i rëndësishëm, i cili duhet të zhvillohet më tutje në një përshkrim dhe tipologji të hollësishme të këtyre lidhjeve ndërkombëtare. Në të njëjtën kohë, SOCTA vazhdon të theksojë se "deri tani nuk është identifikuar asnjë grup i organizuar kriminal i përfshirë në rastet e korrupsionit apo pastrimit të parave". Ky konkluzion bie në kundërshtim me rastet e shumta që i janë prezantuar ekipit të vlerësimit, ku kriminaliteti i organizuar dhe PP-ja ishin të lidhura shumë qartë. Kjo lidhje mbështetet edhe më tej nga intervistat me përfaqësuesit e DKO-së të PK-së, që paraqitën një tablo mjaft të qartë të pastrimit të parave nga krimi i organizuar në sektorët e lojërave të fatit dhe të ndërtimit (që pasqyron gjetjet e dy vlerësimeve sektoriale përkatëse të kryera nga NjIF-i). Analiza e kërkesave për PPP-në gjithashtu tregon se kriminaliteti i organizuar shpesh lidhet me PP-në. Për rrjedhojë, rezultatet e PP-së së SOCTA-s janë pjesërisht të pasakta dhe nuk përputhen as me situatën në terren, as me vlerësimet sektoriale të NjIF-it.

Dobësitë

100. Sa i përket dobësive, VKR-ja paraqet një listë të gjatë të çështjeve rrethore dhe sistematike që lidhen me ekonominë joformale, kornizën legjislative, gjyqësorin, zbatimin e ligjit dhe autoritetet për PPP/LFT-në. Ndërkohë që të gjithë faktorët janë me rëndësi të konsiderueshme lidhur me rreziqet që rrjedhin nga PP/FT-ja, ata shpesh janë të vetëkuptueshëm ose të nivelit shumë të lartë (p.sh. "Korniza ligjore vendore për pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit nuk është plotësisht në përputhje me standardet ndërkombëtare"; "Mandatet e përsëritura dhe modelet joefikase për bashkëpunim, bashkërendim dhe shkëmbim të informacionit dobësojnë performancën strategjike dhe operative të autoriteteve përkatëse", "Rregulloret e brendshme joefikase dhe mekanizmat e kontrollit dhe zbatimi i tyre i dobët në sektorët publikë dhe privatë dobësojnë parandalimin dhe zbulimin e pastrimit të parave, financimin e terrorizmit, krimin ekonomik, krimin financiar dhe ekonominë joformale"). Shumica e dobësive të identifikuara në VKR janë përgjithësisht të lidhura me nevojën e përmirësimit të nivelit të lartë të sistemit të PPP/LFT-së në aspekte të ndryshme, mirëpo i mungon matja e fuqisë së masave parandaluese dhe mbikëqyrjes për të kufizuar nivelin e rrezikut të PP/FT-së në mbarë juridiksionin.

101. Në praktikë, VKR-së i mungon niveli më "veprues" i analizës së dobësive që ndërlihen me dobësitë sektoriale dhe të produkteve. VKR-ja nuk përfshin ndonjë analizë të sektorëve financiarë dhe të BPCJF-ve nga pikëpamja e dobësive ekzistuese në kontrollet e tyre për PPP/LFT-në (p.sh. KDK i dobët, mungesa e kapacitetit për të identifikuar pronarin përfitues); dhe dobësitë e përfshira, pavarësisht nga kontrollet efektive për PPP/LFT-në (p.sh. vëllimi i transfertave ndërkombëtare në/nga Kosova mund të paraqesin dobësi të brendshme). Për më tepër, vlerësimi i dobësive nuk mbulon produktet financiare të ofruara nga IF-të, ndërkohë që është komponent i rëndësishëm. Vlerësimi / të kuptuarit e dobësive nuk mbështetet në mënyrë specifike të vlerësimit për PPP/LFT-në të kryera në Kosovë.

Rreziqet dhe klasifikimi i tyre (pasojat dhe gjasat)

102. Ekipi i vlerësimit ka konstatuar se VKR-ja nuk ka pasur shtrirje apo thellësi të mjaftueshme në lidhje me identifikimin e tendencave dhe tipologjive mbizotëruese të PP/FT-së në Kosovë, të cilat në fund të fundit përbëjnë listën e skenarëve të rreziqeve të vlerësuara kundrejt gjasat dhe pasojave.

103. Lista e rreziqeve të zhvilluara nga autoritetet e Kosovës përmban vetëm dy formulime, të cilat përputhen me përshkrimin e rrezikut të pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit (domethënë, përshkrim se si PP-ja ose FT-ja mund të ndodhin), përkatësisht:

- Fondet legjitime të përdorura për financimin e terrorizmit kryesisht rrjedhin nga fondet e mblledhura dhe të dhuruara përmes organizatave joqeveritare;
- Bashkëpunimi ndërkombëtar joefikas mundëson pastrimin e të ardhurave të jashtme nga krimi në Kosovë.

104. Të dy skenarët identifikojnë kërcënimin bazë, që shfrytëzon një dobësi në sistem, duke rezultuar kështu në PP ose FT. Pasojat dhe gjasat e këtyre rreziqeve janë renditur respektivisht si të larta/të mundshme dhe të moderuara/të mundshme, të cilat bien në spektrin e mesëm.

Thënë kështu, do të nevojitej një shtjellim i mëtejshëm i këtyre rreziqeve në mënyrë që të bëhen më vepruese nga pikëpamja operative.

105. Të tjera formulime në listën e "rreziqeve" nuk janë në fakt skenarë të PP-së ose FT-së dhe prirjen të adresojnë çështje më të larta të politikave ose rrethanore (p.sh. "Shkalla e lartë e papunësisë rrit ekonominë joformale në Kosovë", ose "Funkcionet e mbikëqyrjes joefikase të përputhshmërisë po shtojnë ekonominë joformale dhe krimet financiare "). Në përgjithësi, këto dobësi në VKR tregojnë mungesë të kapacitetit për të kuptuar se nga vijnë paratë që mund të pastrohen përmes sistemit financiar kosovar, cilat entitete apo subjekte mund të përdoren për PP-në dhe si e bëjnë procesin e vendosjes, shtresimit ose të integritit të PP-së në ose nga Kosova.

106. Një bazë e mirë për zhvillimin e skenarëve të rrezikut do të ishte puna e tipologjive nga NjIF-i, që deri më tani ka rezultuar në publikimin e dy raporteve për tipologjitë, ku njëri prej tyre i kushtohet posaçërisht korrupsionit dhe PEP-ëve. Megjithatë, këto nuk kanë krijuar të kuptuar të rreziqeve nga autoritetet e Kosovës në procesin e VKR-së, ose më gjerësisht në komunitetin ndërinstytucional apo sektorin privat.

107. Raportet e tipologjive të NjIF-it ofrojnë përshkrim të skenarëve dhe tipologjive, që kanë ndodhur ose mund të ndodhin. Megjithatë, ashtu siç mund të pritet, këto raporte nuk adresojnë çështjet e gjasave për këto skenarë të PP/FT-së që ndodhin ose pasojat e tyre. Megjithatë, për punën e vlerësimit të rrezikut në të ardhmen, autoritetet kosovare duhet të përdorin në mënyrë aktive dhe të zhvillojnë tipologji (dhe të identifikojnë të reja) si bazë për përcaktimin e rreziqeve dhe komponentëve të rrezikut (kërcënimet, dobësitë) në një VKR të ardhshme.

108. SOCTA përmban një sërë përshkruesish të pjesshëm të rrezikut nga PP-ja, në veçanti duke iu referuar llogarive offshore dhe aktiviteteve fiktive të biznesit në vendet offshore si mjet për PP-në. Kjo është një deklaratë e rëndësishme, e cila duket se ka ngjallur reagim të pakët nga autoritetet e zbatimit të ligjit kur ato u pyetën nëse përdorshin zonat offshore dhe kompanitë guaskë për PP-në. Përveç ATK-së, përfaqësuesit e agjencive për zbatimin e ligjit duket se nuk janë të vetëdijshëm ose të kenë trajtuar raste të tilla. NjIF-i ka raportuar se i ka shqyrtuar materialet në dispozicion në internet si rezultat i skandaleve jashtë vendit (p.sh. "Panama Papers"), mirëpo nuk kanë gjetur asnjë lidhje me persona ose subjekte në Kosovë. Autoritetet e Kosovës duhet të marrin masa në VKR-në e radhës për të zhvilluar në mënyrë specifike të kuptuarin e rreziqeve që rrjedhin nga operacionet e mundshme offshore ose përmes kompanive guaskë dhe të zhvillojnë masa për t'i luftuar këto dukuri.

109. Sa u përket personave juridikë, mangësia e përgjithshme është dështimi i autoriteteve për të kuptuar se cilat lloje të subjekteve vendore ose të huaja përdoren për të pastruar të ardhurat nga krimi, ose së paku cilat kategori të subjekteve janë posaçërisht në rrezik për t'u përdorur për këtë qëllim. Diskutimet gjatë vizitës në terren treguan se ka shumë pak njohuri për këtë çështje në përgjithësi.

110. VKR-ja nuk e trajton në mënyrë gjithëpërfshirëse rrezikun ndërkufitar në mënyrë që ndikimi i tij të mund të vlerësohet ose të kuptohet, apo të lidhet dhe të konsiderohet në rrethanat e kërcënimeve që shfaqen në fusha të tjera, si krimi i organizuar, trafikimi i qenieve njerëzore dhe trafikimi i drogës. Duket se nuk ka ndonjë vlerësim të qartë të përdorimit të transfertave bankare në rrethana ndërkufitare. Kosova mbetet ekonomi e bazuar në para të gatshme, me një diasporë të madhe në Evropë që transferon sasi të mëdha parash në vendin e tyre. Disa mekanizma operativë, përfshirë edhe një njësi e specializuar në kuadër të Qendrës së Menaxhimit të Integruar të Kufirit kanë të kuptuar të mirë të rreziqeve / kërcënimeve të ndërlidhura me kufirin. Megjithatë, këto kryesisht kanë të bëjnë me kontrabandën e parave të gatshme e madje edhe në raste të tilla, mungon qartësisht vetëdijesimi i autoriteteve të tjera për këto çështje.

111. Lidhur me referimin te ajo që është në thelb faza e integritit të PP-së, SOCTA liston llojet e mëposhtme të mallrave ku investohen të ardhurat nga krimi: patundshmëri; ndërtim; hotele; automjete; hapje e aktiviteteve të ndryshme të biznesit ose vazhdim i bizneseve ekzistuese, shpenzime për jetesë. Dy nga këto rrugë (investimi në patundshmëri dhe ndërtimi) janë trajtuar në vlerësimet sektoriale të rrezikut që përgjithësisht kanë mangësi të njëjta metodologjike, sikurse është theksuar më lart, por gjithsesi përmbajnë më shumë specifika sa i përket sektorëve dhe disa prej keqpërdorimeve të mundshme. Në të vërtetë, ato u kanë mundësuar autoriteteve të Kosovës të zhvillojnë më tej të kuptuarit që kanë për zonat me rrezikshmëri të lartë. Megjithatë, mbetet e paqartë se mbi çfarë baze janë përzgjedhur sektorët. Duke marrë parasysh konkluzionet e SOCTA-s, mund të supozohet se përdorimi i Kosovës për qëllime të financimit të terrorizmit mund të kishte merituar edhe një vlerësim kushtuar këtij rreziku, për shkak të seriozitetit të çështjes.

Të kuptuarit e rrezikut nga financimi i terrorizmit

112. Rreziku i FT-së brenda juridiksionit është vlerësuar në mënyrë shumë sipërfaqësore në VKR. Ashtu siç është paraqitur në pjesë të tjera të këtij raporti (shih RM 9), fusha e FT-së është posaçërisht e rëndësishme për Kosovën, pasi ka pasur një numër proporcionalisht të lartë të rasteve ku janë identifikuar luftëtarë të huaj terroristë të cilët më pas janë ndjekur penalisht. Edhe pse është e qartë që autoritetet janë të vetëdijshme për nivelin më të lartë të rrezikut të FT-së brenda juridiksionit, do të pritej që kjo çështje të trajtohej në hollësi dhe se njësitë të ngarkuara do t'u jepeshin udhëzime të bazuara në një plan të hollësishëm dhe të plotë për vlerësimin e rrezikut. Në të vërtetë, të kuptuarit e përgjithshëm që kanë autoritetet për kërcënimet e FT-së ka ndryshuar që nga viti 2013. Në fakt, niveli i vetëdijesimit që kanë arritur autoritetet e PPP/LFT-së për rreziqet kyçe të FT-së që ndërlidhen me luftëtarët e huaj terroristë dhe organizatat jofitimprurëse konsiderohet të jetë në nivel të mirë. Autoritetet konsiderojnë se këto rreziqe do të zbuten në masë të madhe nga zbatimi i ligjit, ndërhyrjet rregullative dhe politikave, mirëpo ende nuk është bërë ndonjë matje e rrezikut të mbetur në këtë çështje dhe, për këtë arsye, vlerësimi aktual i rrezikut në këtë fushë ende bazohet në njohuritë personale të individëve që punojnë në këto autoritete.

113. Në përgjithësi, është thelbësore që publikimet e ardhshme të SOCTA-s dhe VKR-së, si dhe çdo vlerësim tjetër për rrezikun sektorial të harmonizohen reciprokisht, në mënyrë që të zhvillohet një vështrim koherent dhe i hollësishëm i rreziqeve të PP/FT-së në Kosovë. SOCTA duhet të përdoret si bazë për të vlerësuar mjedisin kërcënues për VKR-në; nga ana tjetër, gjetjet e VKR-së duhet të japin informacion për kapitullin e SOCTA-s që ka të bëjë me PP-në. Këto duhet të mbështeten gjerësisht në tipologjitë, rastet dhe statistikat e zhvilluara nga NjIF-i dhe agjencitë për zbatimin e ligjit dhe duhet të marrin parasysh raportet e vlerësimit të PPP/LFT-së si dhe gjetjet e mbikëqyrësve, në mënyrë që të përcaktojnë dobësitë.

114. Përprjekjet për të bërë vlerësimin e mëtejshëm të rrezikut duhet të përqendrohen më tepër në rreziqet e PP/FT-së ndërkuftare, sidomos tek ato që dalin nga transfertat bankare dhe lëvizjet ndërkuftare të parave të gatshme, duke pasur parasysh komunitetin e madh të diasporës jashtë Kosovës, kërcënimet e PP-së që rrjedhin nga disa vepra penale si trafikimi i armëve, trafikimi i drogës, ndikimi i krimit të organizuar në PP/FT-në, rreziku i paraqitur nga personat juridikë në kuadër të FT-së dhe dobësia e sektorit të BPCJF-ve ndaj PP/FT-së.

115. Edhe pse raporti i VKR-së përcakton që VKR-ja duhet të vlerësohet në baza vjetore (faqja 8 e VKR-së), nuk ka ndonjë dëshmi se ky rishikim periodik po zbatohet. Prandaj, duket se autoritetet e Kosovës kishin qëllimin të matin rrezikun e mbetur, bazuar në masat zbutëse që janë ndërmarrë, edhe pse kjo nuk ishte bërë në praktikë. Sidoqoftë, duke pasur parasysh përqendrimin e politikave të nivelit të lartë të VKR-së, ky rishikim do të kishte marrë formën e një dokumenti politikash dhe jo të paraqitej si mjet për matjen e rrezikut të mbetur.

Politikat dhe aktivitetet vendore për të adresuar rreziqet e identifikuar të PP/FT-së

116. Autoritetet e Kosovës kanë hartuar kornizën strategjike për PPP/LFT-në në korrelacion direkt me Vlerësimin Kombëtar të Rrezikut dhe gjetjet e tij, me qëllim që të krijojnë një sistem gjithëpërfshirës për menaxhimin e rrezikut të PP/FT-së për të gjithë Kosovën. Pra, VKR-ja ka shërbyer si një nga dokumentet themelore për zhvillimin e Strategjisë Kombëtare për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Joformale, Pastrimit të Parave, Financimit të Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2014-2018, si dhe Planit të Veprimit për të njëjtën periudhë.

117. Mirëpo, ashtu siç përshkruhet më lart, VKR-ja kryesisht adreson çështje të nivelit të lartë institucional, rregullativ dhe të kapaciteteve dhe jo rreziqe specifike të PP/FT-së. Prandaj, Strategjia dhe Plani i Veprimit në mënyrë të pashmangshme pasqyrojnë këto gjetje të VKR-së dhe nuk janë përqendruar ende në rreziqe specifike të PP/FT-së. Ndoshta, duke pasur parasysh se sistemi i PPP/LFT-së në Kosovë po kalon nëpër atë që në thelb është proces i maturimit institucional dhe legjislativ, kjo qasje ishte e justifikueshme në fazën fillestare. Mirëpo, në fund të fundit, sistemi i menaxhimit të rrezikut duhet të përqendrohet në rreziqe specifike të PP/FT-së të identifikuar nga autoritetet dhe t'i shërbejë zbutjes së këtyre rreziqeve.

118. Autoritetet e Kosovës kanë informuar se zbatimi i Strategjisë është integruar në vendimmarrje në aspektin e buxhetit dhe planeve të performancës së ministrive dhe institucioneve publike përgjegjëse. Qeveria shqyrton çdo 6 muaj progresin e arritur kundrejt treguesve të performancës së Strategjisë për të parë nëse nevojiten rregullime në masat për zbutjen e rreziqeve. Për më tepër, në fund të vitit Qeveria gjithashtu bën rishikime për të përcaktuar nëse vlerësimi i rrezikut dhe fushëveprimi i menaxhimit janë ende të duhurit. Këtyre rishikimeve u kontribuojnë një sërë agjencish.

119. Një prioritet i rëndësishëm për Strategjinë Kombëtare është ulja e nivelit të ekonomisë joformale, që është një nga faktorët kryesorë rrethanorë që lehtëson pastrimin e parave në Kosovë. Objektivi i Strategjisë në këtë drejtim është rritja e vetëdijesimit për ekonominë joformale dhe promovimi i transparencës, llogaridhënies dhe qeverisjes së mirë. Objektiva të tjerë kyçë të Strategjisë janë promovimi i inteligjencës, hetimit, ndjekjes penale, gjykatave dhe procedurave të ekzekutimit; rritja e kapaciteteve institucionale; bashkëpunimi proaktiv ndërkombëtar; përmirësimi i legjislacionit. Plani i Veprimit i shtjellon më tej këto objektiva me anë të një liste veprimesh që u janë caktuar autoriteteve përgjegjëse, afateve të zbatimit dhe treguesve të performancës. Duhet thënë se Strategjia dhe Plani i Veprimit janë kryesisht të orientuara nga veprimi dhe jo ndikimi. Nuk ka ndonjë mekanizëm të përfshirë për të gjykuar nëse këto aktivitete të ndërmarra kanë ndikuar apo jo në zvogëlimin e ekonomisë joformale apo në trajtimin e pastrimit të parave/financimit të terrorizmit bazuar në të dhëna objektive.

120. Duke pasur parasysh se fushëveprimi tematik i Planit të Veprimit përfshin çështjet e ekonomisë joformale, shumë nga veprimet janë të nivelit shumë të lartë, si "Zgjerimi i bazës tatimore të Kosovës për të mbrojtur interesin fiskal të shtetit, për të siguruar të drejtat e punonjësve dhe për të siguruar konkurrencë të drejtë në fushën e biznesit ". Plani i Veprimit përfshin edhe masa që kanë për qëllim rritjen e standardeve të qeverisjes korporative në sektorin privat. Ndërsa është e kuptueshme që masat e tilla të gjera janë të rëndësishme në aspektin rrethanor, autoritetet duhet të përkujdesen që të sigurojnë se fushëveprimi i çështjeve të PPP/LFT-së të adresuara nga Strategjia apo Plani i Veprimit nuk pëson si rezultat. Kjo do të jetë sidomos me rëndësi kur autoritetet e Kosovës të avancojnë më tej në të kuptuarit që kanë për rreziqet e PP/FT-së dhe për masat që duhen marrë. Në këtë fazë, ambiciet e politikave të Strategjisë / Planit të Veprimit lidhur me ekonominë joformale mund të mos jenë në përputhje me detyrën më të përqendruar për trajtimin e rreziqeve specifike të PP/FT-së. Autoritetet duhet të jenë të vetëdijshme për këtë dhe të miratojnë një format të kornizës për zbatimin e rrezikut që vazhdon të adresojë faktorët rrethanorë (të cilët janë më statikë për nga natyra), por që janë mjaftueshëm operativë dhe të adaptueshëm ndaj rreziqeve në zhvillim të PP/FT-së.

121. Në të njëjtën kohë, sa i përket PPP/LFT-së, disa nga masat e përcaktuara nuk janë dhe aq të qarta. Për shembull, një nga masat parasheh "Zbatimin e aktiviteteve të mbikëqyrjes së përputhshmërisë për të vlerësuar përputhshmërinë e subjekteve që raportojnë për PPP/LFT-në në pajtim me Ligjin për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit" dhe sektorët e përcaktuar janë kujdesi shëndetësor, sistemi juridik/gjyqësori, partitë, qeveria dhe kontrolli kufitar/dogana, biznesi i ndërtimit, biznesi i patundshmërive dhe pikat e karburantit. Ndërkohë që përqendrimi sektorial në Planin e Veprimit është diçka për t'u mirëpritur, modalitetet e këtij zbatimi nuk janë bërë të qarta dhe është e diskutueshme nëse mbikëqyrja e PPP/LFT-së mund të adresojë në mënyrë të arsyeshme të gjitha këto fusha (ndoshta me përjashtim të patundshmërive), duke pasur parasysh numrin e kufizuar dhe natyrën e mjeteve në dispozicion të tij.

122. Në sferën e inteligjencës, hetimit dhe ndjekjes penale, Plani i Veprimit parashikon krijimin e një sërë procedurash standarde të operimit (PSO), si PSO-ja për shënjestrimin e krimeve të rënda. Këto dokumente janë miratuar nga autoritetet e Kosovës dhe duket se kanë rezultate pozitive sa i përket përdorimit në praktikë. Përqendrimi te krimet e rënda është sidomos me rëndësi në rrethanat e rreziqeve me të cilat ballafaqohet Kosova dhe duhet të lavdërohet. Sidoqoftë, Plani i Veprimit nuk jep orientim të mëtijshëm tematik për llojet dhe modalitetet e veprimtarive të rënda kriminale, të cilat duhet të adresohen përmes këtyre PSO-ve.

123. Autoritetet e Kosovës nxjerrin raporte vjetore për zbatimin e Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit. Këto dokumente janë një mjet i rëndësishëm për të ruajtur natyrën funksionale të kornizës strategjike dhe për të siguruar angazhimin e vazhdueshëm të autoriteteve të Kosovës. Në të njëjtën kohë, këto dokumente shërbejnë kryesisht si përditësime të informacionit lidhur me veprimet e ndërmarra nga autoritetet dhe nuk përmbushin ndonjë funksion për të analizuar ndikimin ose për të matur ndonjë rrezik të mbetur të PP/FT-së.

124. Vlerësimet sektoriale të zhvilluara nga autoritetet lidhur me ndërtimin, patundshmërinë, lojërat e fatit dhe OJF-të janë të gjitha të kohëve të fundit. Në këto vlerësime të rrezikut janë përshkruar një sërë veprimesh, megjithatë duket se është shumë herët që të shqyrtohen masa të politikave të ndërmarra nga autoritetet e Kosovës si rezultat i këtyre vlerësimeve.

125. Ka pasur edhe vendime të politikave të marra nga autoritetet që janë të bazuar në rrezik, si për shembull ndalimi i transaksioneve për patundshmëri në vlerën e 10.000 euro apo më shumë dhe që kryhen në para të gatshme. Është e qartë se këto janë dëshmi për një

ndryshim të mendësisë që ka ndodhur gjatë viteve, megjithatë, këto vendime janë para VKR-së dhe qartazi nuk janë zbatuar si pasojë e ndonjë vlerësimi formal të rrezikut.

126. Ekzistojnë një sërë strategjish të tjera të cilat kanë lidhje me strategjinë për PPP/LFT-në, sidomos në fushat e parandalimit të krimit, të luftës kundër korrupsionit, luftës kundër terrorizmit, luftës kundër krimit të organizuar, menaxhimit të integruar të kufirit etj. Edhe pas leximit të këtyre dokumenteve, ekipi i vlerësimit nuk mundi të identifikojë pikat specifike ku janë krijuar sinergji praktike me Strategjinë për PPP/LFT-në, ose masat e PPP/LFT-së në përgjithësi. Edhe pse vetë Strategjia për PPP/LFT-në i përmend këto dokumente dhe nevojën për bashkërendim, duket se progresi në këtë fushë ende nuk është bërë në praktikë.

127. Sferat e lartpërmendura nuk i mbulojnë të gjitha fushat kryesore të rrezikut që ekipi i vlerësimit i ka vërejtur si problem për Kosovën dhe që kërkojnë politika të mundshme dhe masa të tjera për zbutjen e rreziqeve. Në veçanti, kjo ka të bëjë me pastrimin e të ardhurave nga korrupsioni, rreziqet e PP-së në sektorin e transfertave bankare ndërkufitare, kontrabandën me para të gatshme, përdorimin e zonave offshore dhe kompanive guaskë, kërcënime të veçanta që rrjedhin nga krimi i organizuar, trafikimin e qenieve njerëzore dhe migrantëve, si dhe kërcënime të ndërlidhura me FT-në që rrjedhin nga luftëtarët e huaj terroristë (në vijim: LHT).

Përfundimet, masat e shtuara dhe të thjeshtuara

128. Nuk ka pasur ndonjë shenjë që rezultatet e vlerësimit formal të rrezikut të jenë përdorur për të mbështetur zbatimin e përfundimeve, masave të shtuara për skenarë me rrezik më të lartë dhe masave të kufizuara të thjeshtuara për skenarë me rrezik më të ulët ndërmjet institucioneve raportuese.

129. Është bërë një përfundim për raportimin e RTG-ve/pragut, sipas Udhëzimit Administrativ nr. 1/2017 të NjIF-it (për pagesat e detyrimeve komunale, pagesat e tatimeve), megjithatë nuk ka dëshmi që ky përfundim të jetë bërë si rezultat i ndonjë vlerësimi të rrezikut. Në fakt nuk pati në dispozicion asnjë dëshmi të vlerësimit formal të rrezikut që të arsyetonte veprimin e ndërmarrë nga autoritetet për të reduktuar nivelin e kontrollit të klientëve në këto rrethana.

130. Nuk ka asnjë mekanizëm legjislativ ose rregullativ, as ndonjë veprim të ndërmarrë që kërkon nga subjektet raportuese të marrin parasysh rreziqet e larta të PP/FT-së të identifikuar nga autoritetet e Kosovës. Institucionet financiare janë të lira të përcaktojnë vetë rreziqet e larta të PP/FT-së, në përputhje me dispozitat e nenit 18 të Ligjit për PPP/LFT-në. Masat e thjeshtuara për zbatimin e Rekomandimeve të FATF-së nuk parashihen nga legjislativi i Kosovës, me përfundim të kujdesit të duhur të thjeshtuar ndaj klientit. Ky mund të zbatohet nga subjektet raportuese në pajtim me nenin 23 të Ligjit për PPP/LFT-në, në situata kur subjekti e ka identifikuar rrezikun si të ulët dhe ky rrezik i ulët është konfirmuar nga NjIF-i dhe mbikëqyrësit sektorialë. Autoritetet e Kosovës nuk kanë ofruar dëshmi se kjo ka ndodhur në të vërtetë në praktikë.

Objektivat dhe aktivitetet e autoriteteve kompetente

131. Mekanizmat përcjellës të përshkruar më lart në përfundim sigurojnë se autoritetet kompetente zbatojnë aktivitetet, gjetjet dhe prioritetet e përcaktuara nga VKR-ja si dhe nga Strategjia dhe Plani i Veprimit për PPP/LFT-në.

132. Autoritetet e Kosovës deklaruan se rreziqet e identifikuar në VKR dhe në Strategjinë dhe Planin e Veprimit rezultojnë në veprime specifike të ndërmarrura në lidhje me rishpërndarjen e burimeve nëpër agjencitë qeveritare për të shënjestruar rrezikun e identifikuar të PP/FT-së. Ekipi i vlerësimit konfirmoi se kështu është me të vërtetë, sidomos në lidhje me NjIF-in, ku është zhvilluar Plani i Performancës dhe Burimeve për periudhën 2015-2017 dhe është hartuar një Plan i ri i Performancës 2018-2020 në vitin 2018. Këto plane janë të bazuara dhe marrin parasysh zonat e rrezikut të identifikuar në VKR dhe vlerësimet sektoriale, gjë që është për t'u vlerësuar. Për shembull, Plani i NjIF-it kërkon që RTD-të e ndërlidhura me sektorin e ndërtimit të priorizohen, pasi janë identifikuar si prioritet në VKR. Në bazë të rekomandimeve të VKR-së, NjIF-it do t'i ndahen burime shtesë.

133. Nuk është e qartë se deri në ç'masë ekziston praktikë e njëjtë lidhur me autoritetet e tjera. Në disa raste, ekipi i vlerësimit ka qenë dëshmitar i të kundërtës, ku disa autoritete operative kanë zbuluar rreziqe, që nuk ishin identifikuar në nivelin më të lartë, ose nuk ishin të njohura në komunitetin më të gjerë ndërinstitucional.

134. Sikurse është përmendur më lart, rekomandimet që rrjedhin nga VKR-ja dhe janë ripërshkruar në Planin e Veprimit kanë ndikim të veçantë të prioritetet operative të autoriteteve kompetente, në veçanti AZL-ve dhe Prokurorisë. Shembulli më i mirë është PSO-ja për

Përzgjedhjen e Shënjestrave të Krimeve të Rënda dhe Ekipet Hetimore Ndërinstitucionale, që përcakton një sërë kriteresh për priorizimin e rasteve në një mjedis ndërinstitucional. PSO-ja përqendrohet në veçanti në caktimin e prioriteteve për veprat e ndërlidhura madhore në Kosovë, përfshirë korrupsionin, krimin e organizuar, trafikimin e qenieve njerëzore, pastrimin e parave, financimin e terrorizmit, krimin kibernetik, trafikimin e drogës dhe kontrabandën. Megjithatë, nuk është e qartë se në ç'masë dhe në cilat modalitete përdoret kjo PSO dhe deri në ç'masë autoritetet e ndryshme i përdorin procedurat e përcaktuara aty.

135. Qendra për Menaxhim të Integruar të Kufirit (QMIK) është një shembull i shkëlqyeshëm i një organi ndërinstitucional i cili ka të integruar mekanizmin e brendshëm të vlerësimit të rrezikut që përshtat më tutje aktivitetet e QMIK në përgjigje të rreziqeve dhe kërcënimeve të identifikuar. Bazuar në modelin e policimit të udhëhequr nga inteligjenca, QMIK ka identifikuar rreziqet, ka përcaktuar profilet e rrezikut dhe ka zhvilluar veprime specifike lidhur me transportin ndërkufitar të parave të gatshme dhe metaleve dhe gurëve të çmuar.

136. Autoritete të tjera të zbatimit të ligjit duket se janë mjaftueshëm në dijeni të fushave me rrezikshmëri të lartë të PP-së dhe FT-së, kur këto bien brenda sferës së tyre të specializimit. Në përgjithësi, siç është demonstruar nën RM 6, fushëveprimi i hetimeve dhe ndjekjeve penale në përgjithësi pasqyron profilin e rrezikut të Kosovës lidhur me llojet e veprave penale dhe llojet e pastrimit të parave që po ndodhin. Megjithatë, vëllimi i ndjekjeve penale dhe dënimeve në përgjithësi nuk është në përpjesëtim me profilin e rrezikut të Kosovës.

137. Dëshmia për një qasje të bazuar në rrezik ndaj mbikëqyrjes nga autoritetet kompetente ishte shumë e kufizuar. NjIF-i ka sugjeruar që përzgjedhja e dy firmave audituese të cilat i nënshtrohen ekzaminimit për përputhshmëri në terren është kryer mbi bazën e ndjeshmërisë ndaj rrezikut, por kjo nuk duhet të shihet si dëshmi e mbikëqyrjes së bazuar në rrezik. BQK-ja pretendon se po zhvillon mbikëqyrjen mbi bazën e ndjeshmërisë ndaj rrezikut të PP/FT-së, megjithatë përcaktimi i rrezikut mbetet plotësisht në diskrecion të tyre.

138. Gjatë vlerësimit në terren, u konstatua gjithashtu se BQK-ja e përqendron, siç do të pritej, pjesën më të madhe të përpjekjeve të saj mbikëqyrëse te bankat. Megjithatë, nuk ka informata nëse institucionet financiare jobankare dhe shoqëritë e sigurimeve të kenë bërë ndonjë vlerësim të rrezikut në sektor. Gjithashtu, nuk i është dhënë rëndësi e mjaftueshme nivelit më të lartë të rrezikut që rrjedh nga përdorimi i operatorëve me rrezikshmëri të lartë si shkëmbimi zyrtar dhe jozyrtar i valutës.

139. Në aktivitetet e tyre, autoritetet mbikëqyrëse duket të kenë dështuar që në mënyrë eksplicite të lidhin pajtueshmërinë e PPP/LFT-së nga subjektet e licencuara me kërcënimet (domethënë veprat më kryesore të ndërlidhura) në Kosovë dhe potencialin e sektorëve specifikë që përdoren për pastrim.

140. Gjithashtu, është përcaktuar se nuk është ndërmarrë asnjë veprim specifik lidhur me mbikëqyrjen nga BQK-ja, NjIF-i dhe nga mbikëqyrësit e BPCJF-ve në bazë të VKR-së dhe SOCTA-s, gjë që dëshmon mungesën e sinergjive në nivelin e krijimit të politikave.

Bashkërendimi dhe bashkëpunimi vendor

141. Bashkërendimi i nivelit të politikave në fushën e PPP/LFT-së drejtohet në mënyrë efektive dhe në nivel të lartë, kryesisht nën udhëheqjen e Ministrit të Financave. Organi kryesor bashkërendues është Grupi Punues Qeveritar (GPQ) i kryesuar nga Ministri i Financave ku bëjnë pjesë Ministrinë e Drejtësisë, Punëve të Brendshme, Tregtisë dhe Industrisë, Punës dhe Mirëqenies Sociale, dhe krerët e Policisë, Doganës, Administratës Tatimore, Prokurorisë, Bankës Qendrore, Gjykatës Supreme, Agjencisë kundër Korrupsionit, Njësisë për Inteligjencë Financiare; si dhe përfshin përfaqësues nga shoqëria civile dhe sektori privat. GPQ është mekanizëm që funksionon mirë dhe përdoret për të shtyrë përpara politikat e PPP/LFT-së në nivel të lartë dhe që është në gjendje të angazhojë aktivisht një spektër të gjerë të autoriteteve.

142. Në të njëjtën kohë, Kosova ka një sërë strukturash bashkërenduese të nivelit të lartë për PPP/LFT-në, si Koordinatori Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Kufirit (Zëvendësministri i Brendshëm), Koordinatori Kombëtar për Luftën kundër Terrorizmit (Ministri i Brendshëm), Bordi Këshillues i Koordinatorit Kombëtar për Luftimin e Krimin Ekonomik (KKLKE), që kryesohet nga Ministri i Drejtësisë. Është vërejtur gjatë vizitës në terren se, ndërsa të gjitha këto struktura marrin pjesë në dhe i kontribuojnë GPQ-së, duhet të bëhen më shumë përpjekje për të siguruar që prioritetet e PPP-së ose LFT-së të integrohen në punën e tyre; dhe që të ndërmerret një qasje e harmonizuar lidhur me politikat e shtjelluara nga këto struktura bashkërenduese.

143. Në nivel operativ, autoritetet e Kosovës kanë miratuar një Marrëveshje Mirëkuptimi (MM) gjithëpërfshirëse për Shkëmbimin e Informacionit, Vlerësimin të Rrezikut dhe Bashkërendimin ndërmjet Institucioneve dhe Agjencive për Zbatimin e Ligjit, që gjithashtu parasheh disa grupe bashkërendimi për qëllime të luftimit dhe parandalimit të krimeve ekonomike dhe financiare, përfshirë Grupin e Nivelit Strategjik, Grupin e Nivelit Taktik dhe Grupin e Nivelit Analitik (Menaxhimi i Cilësisë). Megjithatë, nuk ishte e qartë se deri në ç'masë ky mekanizëm ka qenë funksional. Marrëveshja e Mirëkuptimit parasheh përcaktimin e pikave të kontaktit ndërmjet agjencive, si dhe një mekanizëm për të rritur ndërveprimin ndërmjet databazave të autoriteteve të zbatimit të ligjit përmes studimeve të përbashkëta të fizibilitetit. Deri më tani janë kryer disa studime të tilla (p.sh. midis NjIF-it dhe doganës), megjithatë ishte e qartë se integrimi i databazave në mesin e të gjitha agjencive përkatëse mbetet punë në vazhdim e sipër (shih analizën e hollësishme në RM 6). Ndërkohë, vlerësuesit kishin përshtypjen se mekanizmi i krijuar në kuadër të kësaj Marrëveshjeje nuk monitorohet plotësisht dhe duket se është pjesërisht funksional.

144. NjIF-i ka marrëveshje bashkërendimi shumë efektive dhe operative me të gjitha agjencitë kryesore qeveritare të përfshira në PPP/LFT-në. Shkëmbimi i informacionit në disa raste bëhet direkt përmes sistemit goAML të NjIF-it, ku AZL-të kanë qasje të drejtpërdrejtë.

145. Koordinatorin Kombëtar për Luftimin e Krimit Ekonomik është mekanizëm efektiv që funksionon për të rritur bashkëpunimin e të gjitha institucioneve përkatëse, veçanërisht në lidhje me promovimin e rritjes së efektivitetit të prokurorisë në fushën e sekuestrimit dhe konfiskimit.

146. Mekanizmat dypalëshe si themelimi i njësisë së përbashkët hetimore ndërmjet Policisë dhe Doganës së Kosovës mund të konsiderohet një praktikë e mirë. Edhe Dogana është pjesë e një sërë databazash të përbashkëta me agjencitë e zbatimit të ligjit dhe prokurorisë. Në të njëjtën kohë, qasja automatike të të gjitha databazat është proces në progres e sipër.

147. Bashkëpunimi në fushën e mbikëqyrjes është një veprimtari në zhvillim, ku NjIF-i dhe BQK-ja ndërmarrin masa aktive për të ndarë informatat e duhura për inspektimet dhe kontrollet. Sidoqoftë, ka çështje në lidhje me ndarjen e informacionit të lidhur me RTD-të (shih RM 3 për më shumë hollësi). Për më tepër, ndërsa Ligji për PPP/LFT-në parashikon që të nënshkruhet një marrëveshje midis NjIF-it dhe BQK-së, kjo nuk ka ndodhur në praktikë dhe duket se pengon efektivitetin.

148. Sa i përket bashkërendimit në fushën e luftimit të përhapjes, Kosova ka themeluar Komisionin për Kontrollin e Tregtisë së Mallrave Strategjike, i përbërë nga pesë anëtarë dhe zëvendësanëtarë, që përfaqësojnë: Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, Ministrinë e Punëve të Jashtme, Ministrinë e Forcës së Sigurisë, Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Doganën e Kosovës. Megjithatë, ky Komision nuk merret me çështjet e FP-së në vetvete. Plani i Veprimit për PPP/LFT-në (2014-2018) gjithashtu tregon se bashkërendimi i sanksioneve të ndërlidhura me FP-në është ndërmarrë nga Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave dhe Koordinatorin Kombëtar për Luftimin e Krimit Ekonomik. Sidoqoftë, nuk është ofruar për vlerësuesit asnjë dokument tjetër mbështetës në lidhje me këtë bashkërendim.

Vetëdijesimi i sektorit privat për rreziqet

149. Sektori privat është përfshirë në procesin e VKR-së. VKR-ja e plotë u publikua në uebfaqen e NjIF-it, por ka shumë pak dëshmi për të treguar se subjektet përgjegjëse janë inkurajuar të qasen në VKR dhe të ndërmarrin ndonjë veprim si rezultat i konkluzioneve të tij. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për SOCTA-n dhe vlerësimet specifike sektoriale të rrezikut të kryera kohët e fundit.

150. Gjatë pjesës së vlerësimit në terren nuk është përftuar ndonjë dëshmi se konkluzionet e raportit të VKR-së apo të SOCTA-s kishin ndryshuar të menduarit e institucioneve financiare dhe BPCJF-ve se çfarë përbën rrezik të PP/FT-së, dhe as përfundimet e përfshira në vlerësimin e rrezikut të klientit në nivel të subjektit përgjegjës. Shumica dërmuese e subjekteve të sektorit financiar dhe BPCJF-ve të intervistuar as nuk ishte në dijeni të ekzistencës së këtyre dokumenteve apo të detyrimit të tyre për të përfshirë në vlerësimin e tyre të rrezikut përfundimet e këtyre dokumenteve. Edhe ato subjekte që me sa duket kishin një nivel shumë të mirë të pajtueshmërisë kishin mungesë tërësore të dijenisë për ekzistencën e këtyre raporteve. Disa bashkëbisedues që iu referuan atyre dokumenteve sugjeruan se gjetjet e VKR-së janë të pasakta dhe të vjetëruara. Për më tepër, edhe pse autoritetet përgjegjëse për mbikëqyrjen e sektorit financiar dhe të BPCJF-ve ishin të vetëdijshme për zonat me rrezik më të lartë, mendimi i tyre nuk ishte i bazuar në ndonjë studim shkencor apo dëshmi empirike.

151. Nga perspektiva e rrezikut dhe roleve të tyre në lidhje me transaksionet e pasurive të paluajtshme, mund të ndërmerret sensibilizim konkret lidhur me implikimet nga VKR-ja që mund të jetë i dobishëm për noterët, agjentët e patundshmërive dhe avokatët. Po ashtu, mund të bëhet sensibilizimi i siguriesve, kompanive të lizingut, unioneve të kreditit, firmave të investimeve, OJQ-ve, dërguesve të parave dhe kazinove lidhur me fushat e rrezikut dhe cenueshmërinë nga PP/FT-ja.

152. Meqenëse industria e ndërtimit dhe shitja e patundshmërive njihet se paraqesin rrezikun më të lartë për PP-në në Kosovë (gjë që është konfirmuar nga shumica e personave të intervistuar gjatë pjesës së vlerësimit në terren), fakti që njohja e kërkesave të PPP/LFT-së nga noterët, avokatët dhe agjentët e patundshmërive që ofrojnë shërbime në këtë fushë është veçanërisht e ulët, për të mos thënë joekzistente, është posaçërisht shqetësues. Ky fakt përkeqësohet nga një nivel shumë thelbësor dhe për fat të keq joefektiv i mbikëqyrjes dhe mungesës së sanksioneve administrative që u imponohen operatorëve dhe profesionistëve që ofrojnë shërbime në këtë sektor edhe kur janë identifikuar shkelje të ligjit.

153. Pavarësisht dyshimeve rreth ushtrimit të VKR-së dhe rëndësisë së tij, përfaqësuesit e bankave me të cilët u takua ekipi i vlerësimit treguan një qasje proaktive ndaj vlerësimit dhe shqyrtimit të rrezikut dhe kishin një të kuptuar të mirë të tij nga një perspektivë sektoriale dhe nga pikëpamja vendore. Megjithatë, vetëdijesimi për rreziqe në sektorë të tjerë mbetet i ulët. Rezultati i Menjëhershëm 3 jep informacion të mëtejshëm.

Konkluzione të përgjithshme për Rezultatin e Menjëhershëm 1

154. Autoritetet e Kosovës kanë ndërmarrë përpjekje të konsiderueshme për të zhvilluar të kuptuarit e tyre për rreziqet e PP-së. Edhe pse vërtet janë zhvilluar një sërë vlerësimesh të nivelit të lartë dhe ushtrimesh për vlerësimin e rreziqeve, këto nuk janë mjaftueshëm të zgjeruara dhe të thella kur kemi parasysh tendencat dhe tipologjitë më të përhapura në Kosovë dhe nuk ofrojnë përgjigje specifike për zbutjen e rreziqeve. Për më tepër, themelet metodologjike për këto ushtrime duhet të rishikohen dhe duhet të arrihet integrimi dhe ndërveprimi midis tyre. Ato duhet të përfshijnë module për matjen e ndikimit të masave për zbutjen e rreziqeve, si dhe shqyrtimin e rrezikut të mbetur.

155. Pavarësisht mangësive të dukshme në VKR, rreziqet aktuale që rrjedhin nga veprat e ndërlidhura penale vendore dhe kërcënimet terroriste duket se në të vërtetë janë kuptuar mirë nga autoritetet, sidomos nga individët e përfshirë në zbatimin e ligjit, mbledhjen e inteligjencës, BQK-në dhe NjIF-in. Megjithatë, mungesa e analizave të hollësishme dhe mosndarja e analizave të tilla me subjektet përgjegjëse, bashkë me mosekzistimin e provave që këto analiza të jenë përdorur për qëllime mbikëqyrëse shkakton dyshime serioze nëse është arritur niveli i të kuptuarit dhe njohurive që kërkohet nga standardet ndërkombëtare.

156. Mekanizmat e bashkëpunimit ndërinstucional të nivelit operativ funksionojnë mirë, edhe pse ato mund të përfitojnë nga sistematizimi, kontrolli dhe monitorimi i mëtejshëm, me qëllim të përmirësimit të mëtejshëm të efektivitetit dhe ndërveprimit ndërmjet autoriteteve. Bashkëpunimi në fushën e FP-së nuk është vendosur dhe duhet të krijohet.

157. Kosova ka arritur nivel të moderuar të efektivitetit me Rezultatin e Menjëhershëm 1.

KAPITULLI 3. SISTEMI JURIDIK DHE ÇËSHTJET OPERATIVE

Gjetjet kryesore dhe veprimet e rekomanduara

Gjetjet kryesore

RM 6

- Autoritetet e Kosovës përdorin rregullisht një spektër të konsiderueshëm të informatave nga burime të ndryshme për qëllime të inteligjencës financiare. Disa çështje shqetësuese kanë të bëjnë me mirëmbajtjen dhe përditësimin e informacionit të përdorur për të gjeneruar inteligjencë financiare, qasjen indirekte në databazat nga autoritetet kompetente dhe koherencën e inteligjencës së gjeneruar për profilin e rrezikut të Kosovës. Përdorimi (gjatë fazës paraprake) i kompetencave të AZL-ve për të kërkuar informacion aktiv financiar dhe për të ndërmarrë hetime financiare jashtë kuadrit të bashkëpunimit me NjIF-in dhe bazuar në inteligjencën e siguruar tashmë në NjIF nuk u demonstrua pavarësisht burimeve të tjera në dispozicion përmes zbatimit të kompetencave të policisë.
- NjIF-i demonstroi aftësinë e vet për të shpërndarë informacione financiare përgjithësisht me cilësi të lartë tek autoritetet kompetente që e përdorin këtë informacion gjerësisht bashkë me të dhëna të tjera të disponueshme dhe të arritshme për të zhvilluar hetime paraprake për PP-në, veprat kryesore të ndërlidhura dhe FT-në. Autoritetet pjesërisht paraqitën dobinë e informacionit për kryerjen e hetimeve formale për krime të ndërlidhura në përputhje me disa nga rreziqet e konstatuara në VKR. Nuk u demonstrua nëse informacioni do të përdorej mjaftueshëm për hetimet e PP-së ose ndjekjet penale të mëvonshme.
- Pavarësisht rritjes së ndjeshme të numrit të RTD-ve dhe informatave të tjera të përfuara nga subjektet raportuese dhe cilësisë në dukje të duhur të raporteve, nuk është demonstruar tërësisht nëse RTD-të e marra përkojnë me profilin e rrezikut të Kosovës. Nevojiten përpjekje shtesë nga NjIF-i për udhëzime dhe trajnime që promovojnë raportimin e bazuar në rreziqet më të rëndësishme.
- Autoritetet kanë arritur nivel të mirë bashkëpunimi bazuar në një sërë nismash dhe mekanizmash formale. Disa mangësi të vogla në bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit zbuten nga mekanizmat e zgjeruar për hetime të përbashkëta dhe shënjestrim të rreziqeve kryesore në Kosovë.

RM 7

- Kosova ka elementet e nevojshme të një sistemi juridik dhe kornize institucionale që është përcaktuar të hetojë dhe ndjekë penalisht pastrimin e parave.
- Autoritetet e zbatimit të ligjit në Kosovë kanë priorizuar hetimin e pastrimit të parave duke institucionalizuar dhe duke i kushtuar burime të konsiderueshme hetimeve financiare, si në kuadër të hetimeve financiare paralele, ashtu edhe si vazhdimësi e shpërndarjes nga NjIF-i. Në të njëjtën kohë, vendimi për të referuar apo jo një rast për hetim paralel financiar është në diskrecion të tyre.
- Për sa i përket burimeve, kufizimet ekzistuese të burimeve të PSRK-së lejojnë që ajo të marrë në shqyrtim vetëm një numër të kufizuar të rasteve të PP-së. Kompetenca ekskluzive e PSRK-së për veprën e PP-së pengon kështu përdorimin e saj më të gjerë për vepra penale të ndërlidhura që sjellin përfitim.
- Disa tregues bëjnë fjalë për ekzistencën e një standardi të lartë të provave të caktuara nga PSRK-ja mbi agjencitë për zbatimin e ligjit për të siguruar se ndjekja penale e veprës penale të ndërlidhur është e mundur kur ndiqet penalisht aktakuza për pastrim parash. Edhe pse trendi mund të jetë duke ndryshuar, kjo ka çuar në përpjekje zhgënjyese dhe lodhje të burimeve në njësitë e zbatimit të ligjit që trajtojnë rastet e

dyshimta për PP-në, ku vepra e ndërlidhur penale nuk dihet përfundimisht (p.sh., bazuar në shpërndarjet nga NjIF-i).

- Ndërkohë që kriminaliteti kryesor i ndjekur në rastet e PP-së nga agjencitë e zbatimit të ligjit duket të jetë gjerësisht në përputhje me profilin e rrezikut dhe kërcënimit të Kosovës, vëllimi i rasteve që në fund ndiqen penalisht dhe gjykohen është paksa i ulët në krahasim me shkallën e kërcënimit që rrjedh nga ky kriminalitet dhe që rezultojnë me PP në Kosovë. Në pak raste të dënimeve për PP-në, sanksionet duket se janë zbatuar në mënyrë proporcionale, megjithatë numri i tyre është tepër i ulët për të pasur ndonjë efekt parandalues për kriminalitetin në Kosovë.

RM 8

- Kosova ka vendosur prioritet të qartë në rritjen e efektivitetit të masave të përkohshme dhe konfiskimit, edhe pse progresi në këtë fushë mbetet shumë i ngadalshëm.
- Koordinatori Kombëtar për Luftimin e Krimit Ekonomik luan një rol shumë konstruktiv dhe proaktiv në përpjekjet për të përmirësuar sistemin dhe praktikën e sekuestrimit dhe konfiskimit në Kosovë.
- Rastet e konfiskimeve përfundimtare janë të pakta dhe kryesisht rezultojnë nga një numër i madh i rasteve të profilit të lartë, që tregojnë se përpjekjet që bëhen nga agjencitë për zbatimin e ligjit për të gjurmuar, ngrirë dhe konfiskuar pasurinë nuk po materializohen më tutje në zinxhirin e drejtësisë penale.
- Sistemet për mbajtjen e statistikave nga autoritetet e ndryshme janë shumë të papërfundimta dhe nuk paraqesin ndonjë kategorizim të mjaftueshëm të të dhënave për të lejuar gjykimin e duhur mbi profilin dhe përmbajtjen e konfiskimeve.
- Dispozitat ligjore për ngrirjen dhe konfiskimin sipas Kodit të Procedurës Penale (KPP) janë komplekse me një sërë përsëritjesh, që çojnë në pështjellim gjatë zbatimit.
- Sistemi i deklarimit të parave të gatshme dhe INB-ve nuk rezultojnë në rezultate përfundimtare lidhur me sekuestrimet dhe konfiskimet, sidomos në lidhje me rastet e mundshme të dyshimeve për PP-në dhe FT-në.

Veprimet e rekomanduara

RM 6

- Autoritetet e Kosovës duhet të sigurojnë ndryshimin e regjistrave përkatës që përdoren dhe saktësinë e informacionit, përfshirë edhe konsolidimin e regjistrave të patundshmërive. Gjithashtu, autoritetet duhet të shqyrtojnë qasjen indirekte të NjIF-it në databazën e patundshmërive dhe të ATK-së në kuadër të analizës së inteligjencës financiare për të siguruar me afat disponueshmërinë e informacionit në përpjesëtim me rreziqet dhe prioritetet e autoriteteve kompetente.
- Autoritetet e Kosovës duhet të ndërmarrin veprime për të automatizuar më tej proceset analitike në NjIF për të reduktuar punën manuale që ka mbetur.
- NjIF-i, AZL-të dhe Prokuroria duhet të diskutojnë arsyet për përdorim të pasuksesshëm të inteligjencës financiare për qëllimet e hetimeve dhe ndjekjeve penale të PP-së rast pas rasti. Kjo duhet sidomos të bëhet në rastet kur mungojnë indikatorë të qartë për veprën specifike penale të ndërlidhur dhe kur vazhdon të ketë vështirësi në formulimin e aktakuzës, me qëllim që të sigurohet se rastet e PP-së kanë prioritet.
- Komentet e dhëna nga AZL-të lidhur me shpërndarjet nga NjIF-i duhet të jenë të detajuara dhe të jepen rregullisht në mënyrë që të sigurohet përmbushja e plotë e nevojave të tyre operative nga NjIF-i.
- NjIF-i dhe autoritetet kompetente duhet të marrin në konsideratë masa të mëtejshme për të inkurajuar përdorimin e informacionit për transaksionet në para të gatshme dhe instrumentet monetare që lëvizin përtej kufirit për të zhvilluar raste të PP-së të

mundshme dhe veprave penale të ndërlidhura dhe FT-së.

- Duhet mbajtur statistika të tjera për të mundësuar vlerësimin e plotë të dobisë së informacionit të NjIF-it nga subjektet raportuese dhe për shpërndarjet që janë bërë.
- Autoritetet duhet të përcaktojnë afate kohore për dhënien e përgjigjeve për kërkesat e NjIF-it dhe për të siguruar zbatimin e këtyre afateve.
- Autoritetet duhet të vlerësojnë përshtatshmërinë e raportimit dhe përdorimin e raporteve për transaksione të pazakonshme që dorëzohen nga subjektet raportuese; duhen dhënë udhëzime dhe tipologji të mëtejshme për të siguruar që informatat e nevojshme janë në dispozicion të autoriteteve kompetente në përputhje me kërkesat për raportimin e aktiviteteve të dyshimta.
- Autoritetet duhet të marrin parasysh shpërndarjen e mëtejshme të burimeve, përfshirë rritjen e burimeve njerëzore dhe të mekanizmave në dispozicion për të prioritetizuar mbledhjen dhe përdorimin e informacionit me qëllim nxitjen dhe mbështetjen e hetimeve të PP-së.

RM 7

- Autoritetet e Kosovës duhet të vazhdojnë dhe të finalizojnë reformat që kanë iniciuar me synim decentralizimin e rasteve të PP-së te prokurorët që nuk janë të PSRK-së por duke mbajtur rastet e profilit të lartë dhe me vëllim të lartë për t'u mbikëqyrur dhe ndjekur penalisht nga PSRK-ja.
- Autoritetet e Kosovës, përfshirë PSRK dhe KKLKE, duhet të ndërmarrin masa sistematike për të promovuar hetimin dhe ndjekjen penale në mënyrë autonome të PP-së (pa pasur nevojë për ndjekjen penale të veprave penale të ndërlidhura) në bazë të praktikës gjyqësore të kohëve të fundit.
- Pas zbatimit të sistemit të decentralizimit, autoritetet e Kosovës duhet të marrin parasysh të sigurojnë se Koordinatori Kombëtar për Luftimin e Krimit Ekonomik monitoron dhe zgjeron aktivitetet e prokurorisë për ndjekjen e veprave penale të pastrimit të parave.
- Autoritetet e Kosovës duhet të zhvillojnë më tej sistemin e tyre të trajnimit për ndjekjen penale dhe gjykimin e pastrimit të parave dhe për të ndërtuar kapacitetet e grupit të ekspertëve financiarë që ofrojnë ekspertizë si pjesë e procesit gjyqësor në rastet e PP-së.

RM 8

- Nevojitet mbështetje e mëtejshme për KKLKE në përpjekjet e tij për të rritur efektivitetin e masave të përkohshme dhe konfiskimeve të aplikuara në rastet e krimit që sjell përfitim.
- Autoritetet e Kosovës duhet të unifikojnë dhe integrojnë sistemet dhe mekanizmat e ndryshme për mbledhjen dhe mbajtjen e statistikave për sekuestrime dhe konfiskime dhe të sigurojnë hollësi të mjaftueshme në të dhënat e ruajtura.
- Duhet të qartësohen dispozitat në KPP lidhur me sekuestrimin dhe konfiskimin me qëllim që të shmangen përsëritjet dhe pështjellimi në zbatim.
- Të sigurohet që autoritetet që zbatojnë masa kontrolluese ndërkufitare të parave të gatshme të marrin parasysh sistematikisht dyshimet për PP/FT-në.

158. Rezultatet e Menjëhershme përkatëse që janë shqyrtuar dhe vlerësuar në këtë kapitull janë RM 6-8. Rekomandimet përkatëse për vlerësimin e efektivitetit në këtë seksion janë R. 3, R. 4 & R. 29-32.

Rezultati i Menjëhershëm 6 (Inteligjenca financiare për PP/FT-në)

Përdorimi i inteligjencës financiare dhe i informatave të tjera

159. Autoritetet kompetente të Kosovës kanë qasje në dhe përdorin një sasi të konsiderueshme informacioni nga burime të ndryshme, si publike ashtu edhe private, dhe shkëmbimi i informacionit mundësohet nga një sërë marrëveshjesh ndërmjet institucioneve. Në të njëjtën kohë, ekzistojnë disa shqetësime lidhur me mangësitë në disa nga databazat që përdoren dhe me efektivitetin e qasjes në informacionin e nevojshëm në raste të caktuara.

160. NjIF-i bën analiza të bazuara në një gamë të gjerë burimesh përfshirë RTD-të, RTP-të, RTG-të dhe deklaratat e instrumenteve monetare në kufi, si dhe informacionin shtesë që mund të mblidhet nga çdo subjekt raportues. NjIF-i është e autorizuar të mbledhë informata shtesë nga të gjitha subjektet raportuese (pavarësisht nga subjekti që ka paraqitur raportin) sa herë që një rast hapet për analizë dhe kjo mund të bëhet duke u bazuar në një numër të madh shkaktarësh, sikurse shtjellohet më poshtë.

161. NjIF-i ka qasje në një sërë databazash të institucioneve publike, edhe pse vërehen kufizime të caktuara ose të ndërlidhura me procesin e qasjes në informacion apo me përshatshmërinë e vetë informacionit sikurse shtjellohet më poshtë.

162. NjIF-i ka qasje të drejtpërdrejtë në databazat e Agjencisë së Regjistrimit Civil (Statusi Civil, Databaza e Regjistrimit të Automjeteve, Trungu Familjar), Doganës (Eksporti / Importi i Mallrave dhe Shërbimeve, Deklarimi i mjeteve monetare në pikat kufitare, mjetet monetare), Regjistrin të Shoqërive Tregtare dhe Emrave Tregtarë të Kosovës (në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë) dhe DRNOJQ-së në MPA.

163. NjIF-i ka qasje të drejtpërdrejtë në Regjistrin e Shoqërive Tregtare dhe Emrave Tregtarë të Kosovës. Ky do të ishte edhe burimi kryesor i informacionit mbi pronësinë përfituese. Siç është theksuar në Rekomandimin 24, sidoqoftë ekzistojnë një sërë çështjesh që kanë të bëjnë me disponueshmërinë e informatave të përshtatshme për pronësinë përfituese në regjistër për secilën kategori të subjektit. Kjo do të kërkonte edhe përdorimin e mekanizmave të KDK-së dhe marrjen e informacionit nëpërmjet subjekteve raportuese (kryesisht bankave). Një sërë mangësish të tjera të Regjistrin të Shoqërive Tregtare kanë efekt të dëmshëm mbi aftësinë e autoriteteve kompetente të Kosovës për të marrë dhe përdorur informacion mbi personat juridikë: informacioni është shpesh i vjetërsuar, ka mungesë të informacionit për aksionarët në raste të caktuara etj.

164. Sa i përket qasjes së AZL-ve në informatat mbi personat juridikë dhe pronësinë përfituese, nuk është e qartë se cilat mekanizma të drejtpërdrejta janë në dispozicion dhe a përdoren ashtu siç përmendet në Rekomandimin 24. Disponueshmëria dhe përdorimi i kanalit të NjIF-it është vërejtur, edhe pse nuk konsiderohet të jetë tërësisht në gjendje të zëvendësojë mangësitë në qasjen e vetë AZL-ve dhe do të kishte ndikim në burimet e NjIF-it. Në aspekt më pozitiv, analiza e rasteve të diskutuara me AZL-të dhe NjIF-in nuk do të konfirmonte përdorimin në shkallë të gjerë të shoqërive të huaja apo strukturave juridike komplekse që do ta bënin identifikimin edhe më të vështirë.

165. Pavarësisht qasjes së drejtpërdrejtë të përmendur në databazën e DRNOJQ-së, efektiviteti i përdorimit të këtij informacioni ndikohet nga numri i mangësive që lidhen me regjistrimin dhe mbikëqyrjen e OJQ-ve dhe, në mënyrë specifike, me pasaktësitë e databazës dhe mungesën e informacionit të përditësuar në disa raste, mungesën e identifikimit të duhur etj. Po ashtu, nuk është e qartë nëse në databazë ka informacione për të dhënat e plota që lejojnë identifikimin e duhur të të gjithë personave që ushtrojnë funksione menaxhimi ose kontrolli. Këto mangësi do të ishin të dëmshme për përpjekjet e LFT-së të të gjitha autoriteteve kompetente, veçanërisht AZL-ve dhe AKI-së. Është vërejtur vënia në përdorim e një databaze të re në vitin 2017. Kjo ka zgjidhur një sërë çështjesh, mirëpo problemet strukturore të regjistrimit dhe të mbikëqyrjes mbeten ashtu siç janë vërejtur në kuadër të RM 10.

166. Për më tepër, NjIF-i përdor dokumentet publike në dispozicion, përfshirë ato të Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve, Agjencisë kundër Korrupsionit (deklarimi i pasurive), ATK-së (kërkimi për tatimpaguesit), Interpol-it (databaza e të dhënave të personave të kërkuar), Agjencisë Kosovare të Privatizimit. Këto të dhëna publike megjithatë do të ishin të kufizuara (mungesa e të dhënave identifikuese në dispozicion të publikut, mungesa e hollësive të plota dhe pasqyrave financiare etj.) dhe në praktikë, në shumë raste, do të kërkonte qasje të tërthortë me anë të kërkesave.

167. Sa i përket shkëmbimeve të tërthorta nga NjIF-i, vihet re se mbi 90% e informacionit shkëmbëhet përmes sistemit elektronik (goAML) që është një kanal i sigurt komunikimi. Në të njëjtën kohë, duke vlerësuar efektivitetin e përgjithshëm të qasjes së tërthortë në informacionin e autoriteteve të tjera nga NjIF-i, vërehet se NjIF-i nuk mund të përcaktojë afate kohore të rrepta për marrjen e këtij informacioni dhe gjithashtu nuk ka afate të përcaktuara në Ligjin për PPP/LFT-në, gjë që ka potencial të dëmtojë analizën e NjIF-it. Kjo konfirmohet nga analiza e dëshmuar e një rasti të NjIF-it, që ka zgjatur më shumë se 6 muaj nga pranimi i RTD-së deri në shpërndarjen e tij, pavarësisht mbledhjes relativisht të kufizuar të të dhënave shtesë. Është paraqitur informacion se regjistrat e llogarive bankare, kredive dhe pagesave ndërkombëtare tashmë janë krijuar, mirëpo NjIF-it nuk i është dhënë qasje të drejtpërdrejtë.

168. NjIF-i e merr informacionin për patundshmëritë nga zyrat kadastrale komunale ose dokumentet kadastrale nga Agjencia Kadastrale. Po ashtu, informacioni sigurohet edhe sipas kërkesës, nga ndërmarrjet që ofrojnë shërbime publike në vend. Sikurse është shtjelluar gjatë takimeve në terren, informacioni merret pas një kërkesë me shkrim (përmes lidhjes së sigurtë elektronike). Në shumë raste, sidomos në lidhje me tokën, është e nevojshme që kërkesa për të dhënat kadastrale qendrore të pasohet me një kërkesë për hollësi të plota pranë zyrës përkatëse komunale. Afati kohor mesatar për marrjen e informacionit nga autoriteti qendror është rreth një javë. Nevojitet kohë shtesë më pas për komunat. Kjo nënkupton kërkesa të veçanta dhe afate të pritjes për secilën komunë dhe duhet gjithashtu të merret parasysh bashkë me mungesën e ndonjë kërkesë ligjore për autoritetet përkatëse publike për t'u përgjigjur me afat. Ky proces, edhe pse i kufizuar me tokën, konsiderohet të jetë i vështirë dhe potencialisht rezulton me vonesa në marrjen e hollësive të plota mbi pronën e zotëruar. Duke marrë parasysh përdorimin e të afërmeve dhe bashkëpunëtorëve për blerjen e pronës, ndikimi në afatshmërinë dhe aftësinë për të gjurmuar asetet duket të jetë edhe më i madh. Disa nga personat që u takuan në terren kanë vënë në dukje mangësitë në informacionin në dispozicion (historia e plotë e të dhënave). Plani i Performancës dhe Burimeve të NjIF-it i vitit 2018 pranon që regjistri kadastral nuk është i përditësuar dhe nuk mund të përdoret si burimi i vetëm i besueshëm i pronësisë së patundshmërive. Duke marrë parasysh rëndësinë e rreziqeve të patundshmërive, mungesa e një mekanizmi të centralizuar dhe me qasje të drejtpërdrejtë ku ruhet informacion për patundshmëritë paraqet shqetësim për vlerësuesit.

169. Aftësia e AZL-ve për të marrë dhe përdorur informacion të tillë për patundshmëritë duke përdorur kompetencat e tyre nuk u demonstrua. Për më tepër, janë vërejtur vështirësi të konsiderueshme lidhur me marrjen e informacionit për patundshmëri në vendet fqinje, veçanërisht kur bëhej fjalë për kontrollin e tërthortë. Blerja e këtyre patundshmërive është përmendur si një nga tipologjitë më të rëndësishme për të ardhurat nga pastrimi i parave, përfshirë edhe korrupsionin. Po ashtu, as noterët nuk janë konsideruar burim i besueshëm informacioni për patundshmëritë, pavarësisht rritjes së rolit të tyre në transaksionet e patundshmërive.

170. Duke marrë parasysh rreziqet vendore të identifikuar nga autoritetet e Kosovës lidhur me sektorin e patundshmërive, mangësitë e lartpërmendura në qasjen në informata kanë shumë ndikim në përdorimin e informacionit të duhur për zhvillimin e provave dhe gjurmimin e të ardhurave.

171. NjIF-i qaset në informata të plota tatimore përmes kërkesës pranë ATK-së. Për shembull, në vitin 2017, janë paraqitur 111 kërkesa të tilla që përbëjnë pjesën dërrmuese të kërkesave për marrjen e informacionit nga institucionet publike (nga gjithsej 165 kërkesa për autoritetet publike për vitin 2017). Kjo do të korrespondonte me rëndësinë e rreziqeve të ndërlidhura me taksat që janë identifikuar në VKR. Nuk duket që qasja e tërthortë në informata të ketë ndikuar negativisht në afatshmërinë e tyre, ndërsa ATK-ja i jep NjIF-it informata kthyesë të plota për të gjitha rastet e shpërndara, duke udhëzuar kështu më tej përpjekjet e NjIF-it. Këto shifra janë në përpjesëtim me numrin e dërgesave nga NjIF-i në ATK. Kështu, NjIF-i duket se kërkon dhe merr informata të përshtatshme nga ATK-ja dhe i shfrytëzon ato plotësisht. Sidoqoftë, qasja e tërthortë në informata të tilla, duke pasur parasysh numrin e madh të kërkesave, duket të jetë e dëmshme për përpjekjen e përgjithshme të përqendruar te një nga rreziqet kryesore të identifikuar në Kosovë.

172. Nuk është ofruar asnjë informacion i mëtejshëm lidhur me qasjen e agjencive për zbatimin e ligjit në informata të taksave. Megjithatë, nuk është demonstruar se informacioni i mbledhur dhe i shkëmbyer të ketë rezultuar në ndjekjen penale të PP-së të ndërlidhur me tatimet.

173. Për marrjen e të dhënave financiare, AZL-të do të mbështeteshin kryesisht te kompetencat e NjIF-it. Përveç ekspertizës së NjIF-it dhe komunikimit me subjektet raportuese,

do të nevojitej edhe përdorimi i kompetencave të NjIF-it duke marrë parasysh kufizimet e AZL-ve, gjë që mundëson qasje në të dhënat financiare vetëm si pjesë e masave të fshehta të parapara me Kodin e Procedurës Penale brenda fazës (formale) të hetimit paraprak. Nenet 86-92 të Kodit të Procedurës Penale do të ishin të zbatueshme në fazën e hetimit paraprak dhe do të siguronin kërkesa të detajuara në këtë drejtim. Kështu që shumica e kërkesave drejtuar NjIF-it për hetime paraprake do të bëheshin nga PK-ja, AKI-ja, DK-ja, prokuroritë dhe ILECU. Shumica e kërkesave nga AKI-ja do të përqendroheshin në kontrollimin e flukseve financiare që potencialisht mund të ishin të ndërlidhura me terrorizmin dhe, me sa duket për periudhën 2014-2017 kjo po ndodh në nivel relativisht të lartë. Duke krahasuar numrin e rasteve të hapura për mbledhjen e informacionit në bazë të këtyre kërkesave me numrin e rasteve të iniciuara nga RTD-të duket se ka një volum të konsiderueshëm rastesh në NjIF që mund të ketë efekt të dëmshëm të burimet. Për shembull, situata në vitin 2017 tregon për 130 kërkesa për NjIF-in nga institucione të tjera prej të cilave rreth dy të tretat (80) vijnë nga PK-ja, DK-ja dhe ILECU. Situata për 2014-2016 duket të jetë e krahasueshme. Kërkesat e thjeshta janë kryesisht përgjegjësi e zyrtarëve ndërlidhës të DK-së dhe PK-së me NjIF-in, duke lehtësuar kështu ndikimin e mundshëm negativ në burimet e NjIF-it. Vlerësuesit u pajisën me informata se rreth 90% e këtyre kërkesave janë trajtuar nga zyrtari ndërlidhës i PK-së për NjIF-in, duke zvogëluar kështu barrën e burimeve të NjIF-it. Sidoqoftë, kur numri i kërkesave krahasohet me numrin e rasteve të hapura si rezultat i kësaj, shumica e kërkesave duket se kanë rezultuar në hapjen e rasteve¹⁰, sipas procedurave operative të NjIF-it. Duke gjykuar në bazë të PSO-së së NjIF-it kuptohet se këto raste (bazuar në kërkesa) janë trajtuar si mbledhje e informacionit shtesë për rastet e mëparshme dhe kryesisht pjesa më e madhe e punës është marrë përsipër nga analistët përkatës të NjIF-it brenda rastit përkatës.

174. Kështu, kanali i NjIF-it do t'u mundësonte AZL-ve që të ndërmarrin në mënyrë efektive hetimet përkatëse para fazës formale hetimore dhe të konstatojnë lidhje të mundshme me veprat e ndërlidhura me PP-në dhe FT-në. Duke krahasuar numrin e rasteve të hapura nga NjIF-i në bazë të kërkesës me numrin e kërkesave të dërguara në NjIF, konfirmohet se shumica e kërkesave (për të mos thënë të gjitha) ndërlidhen me informacionet e mëparshme nga NjIF-i, duke ngritur kështu dyshime në lidhje me aftësinë e duhur të AZL-ve për të marrë informacion financiar për zhvillimin e rasteve të hetimeve financiare të gjeneruara sipas treguesve të AZL-ve në fazat fillestare dhe ku NjIF-i ende nuk ka pranuar asnjë RTD.

Tabela 4: Kërkesat për NjIF-in

Institucionet kërkuese	2013	2014	2015	2016	2017
Policia e Kosovës	57	91	52	45	53
AKI – kryesisht lidhur me FT-në dhe terrorizmin	14	23	19	28	31
EULEX	8	11	7	5	2
Prokuroria Speciale e Kosovës	1	6	3	1	2
Prokurori i Shtetit	5	6	3	0	
Administrata Tatimore e Kosovës	20	7	2	0	8
Dogana e Kosovës	61	25	15	22	21
ILECU	15	6	6	6	6
Tjetër	2	2	3	6	7
Gjithsej	183	177	110	113	130

175. Në të njëjtën kohë, numri i rasteve kur informatat shtesë (AIF, shih më poshtë) që kanë të bëjnë me RTD të mëparshme, kërkohen nga NjIF-i dhe ofrohen nga subjektet raportuese është jashtëzakonisht i lartë në krahasim me numrin e rasteve dhe potencialisht do ta kufizonin aftësinë e NjIF-it të përqendrohet në rastet e reja të PP-së bazuar në gamën e gjerë të informacionit në dispozicion, prandaj duhen vënë në përdorim burime për përpunimin e këtij informacioni shtesë (RTD-të, kërkimi për të dhëna në burime të tjera). Ekipi i vlerësimit

¹⁰ Në bazë të PSO-së të vitit 2014.

konsideron se numri i madh i këtyre informatave shtesë bazohet në nevojat e AZL-ve dhe duket se përkon me praktikën e përcaktuar të AZL-ve për të kërkuar rregullisht informata shtesë nga NjIF-i pas pranimit të shpërndarjes përkatëse. Arsyet për këto kërkesa shtesë nuk duket të jenë të lidhura me mungesën e cilësisë së raporteve të shpërndara të NjIF-it (bazuar në intervistat dhe rastet specifike të shqyrtuara, shih më poshtë). Atëherë, një shpjegim i mundshëm ka të bëjë me atë që shtjellohet në kuadër të RM 7 në lidhje me nivelin e kërkuar të provës për kriminalitetin dhe përpjekjet e AZL-ve për të zhvilluar sa më shumë hulumtime të plota në aspektet financiare të rastit dhe veçanërisht në mungesën e treguesit për vepër të ndërlidhur penale. Kështu, shqetësim mbetet dobia e inteligjencës financiare të mbledhur si nxitës i hetimeve të pavarura për PP-në, kur është e vështirë të konstatohet kriminaliteti specifik i ndërlidhur dhe është e nevojshme të mbështetet në prova rrethore.

176. NjIF-i dhe AZL-të janë pjesë e grupit për zbulimin dhe shënjestrimin e krimeve të rënda që udhëhiqet nga PSRK-ja dhe që vepron në pajtim me Procedurat Standarde të Operimit për Përzgjedhjen e Shënjestrave të Krimin të Rëndë dhe Ekipet Hetimore Ndërinstitucionale. Si rezultat, NjIF-i dhe Prokuroria Speciale kanë theksuar më shumë bashkëpunimin për çështje operative në proces e sipër dhe veprime të tjera me interes të përbashkët. Grupi e ka filluar aktivitetin e vet në vitin 2015 dhe ka trajtuar 28 raste ku ka qenë e përfshirë edhe NjIF-i. Ndër prioritetet kyçe të grupit të përbashkët është lufta kundër korrupsionit dhe janë paraqitur disa raste, ndër to edhe një rast ku ishte i përfshirë një gjyqtar, rastet e sekretarëve të ministrive në Kosovë dhe një anëtar i parlamentit.

Shembull – Rasti i gjyqtarit nga Klina (për elementë të tjera nga ky rast shih RM 7)

Një ish-gjyqtar u hetua në bazë të informatave të konsiderueshme nga NjIF-i. Aktakuza kundër ish-gjyqtarit i cili e ushtronte detyrën e tij pranë Gjykatës Themelore në Klinë, një qytezë e vogël në Kosovë, u ngrit me 5 korrik 2011. Me të njëjtën aktakuzë, prokurori kishte përfshirë edhe dy persona të tjerë. Ata akuzoheshin për veprat penale në vijim: krim i organizuar sipas nenit 274, paragrafët 1, 2 dhe 3 të ish-KP (në fuqi deri më 2013 kur hyri në fuqi KP i ri), pastrim të parave sipas nenit 10.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2004/02, keqpërdorim i detyrës apo autoritetit zyrtar sipas nenit 339, paragrafët 1 dhe 3 të ish-KP, shmangie nga tatimi sipas nenit 249, paragrafët 1 dhe 2 të ish-KP dhe dy vepra penale të tjera.

Në vitin 2017, GJTH në Prishtinë mori vendimin që dënonte ish-gjyqtarin për veprën penale të nxjerrjes së vendimeve gjyqësore të paligjshme sipas nenit 432 të KP, pastrim të parave sipas nenit 56.1 të Ligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Terrorizmit dhe keqpërdorim të detyrës zyrtare sipas nenit 422 të KP.

Hetimi zbuloi pasuri të mëdha që i pandehuri, ish-gjyqtar, kishte blerë në periudhën 2002-2008 për të fshehur origjinën e të ardhurave nga shpërdorimi i detyrës dhe vepra të tjera penale, gjithsej rreth 1.200.000 euro. Këtu hynin pasuri të blera në Kosovë (2 apartamente dhe një shtëpi, lokale), patundshmëri e identifikuar në Mal të Zi, automjet dhe fonde të siguruar nga shitja e dy lokaleve.

177. Autoritetet kompetente të Kosovës përdorin gjerësisht informacion financiar dhe të dhëna të tjera të disponueshme dhe të qasshme për të zhvilluar hetime paraprake për PP-në, veprat e ndërlidhura dhe FT-në. Pavarësisht nga dobia ose jo e këtij informacioni për zhvillimin e hetimeve formale për krimeve të ndërlidhura në pajtim me disa nga rreziqet e konfirmuara në VKR dhe veprat penale të raportuara përgjithësisht në Kosovë, nuk mund të konfirmohet nëse informacioni do të përdorej në mënyrë të mjaftueshme për hetimin e PP-së dhe, më pas, për ndjekje penale të PP-së.

178. Nga viti 2014 deri në 2017, Policia e Kosovës (DHKEK) i ka paraqitur NjIF-it gjithsej 86 kërkesa për informata. Kjo shifër përfshin vetëm kërkesat e DHKEK (Drejtoria për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit). Në përgjithësi, të gjithë sektorët e Policisë së Kosovës (përfshirë Drejtorinë kundër Terrorizmit) kanë paraqitur pranë NjIF-it gjithsej 241 kërkesa për shkëmbim të informacionit dhe ndihmë për hetim.

179. Sektori i Hetimeve të Integruara Financiare (SHIF) i Policisë së Kosovës i ka paraqitur NjIF-it kërkesa për raste të ndryshme të krimin të organizuar, si më poshtë. Numri i kërkesave duket të jetë afërsisht i krahasueshëm me numrin e veprave penale të raportuara të krimin të organizuar në periudhën përkatëse.

Tabela 5: Kërkesat për NjIF-in nga Sektori i Hetimeve të Integruara Financiare (SHIF) i Policisë së Kosovës lidhur me krimin e organizuar

	2013	2014	2015	2016	2017
Kërkesat	16	8	3	6	10
Kërkesat për mbledhje të informacionit përmes kërkesës ndërkombëtare	4	1	3	3	3
Gjithsej	20 - kërkesa të dorëzuara 21 - përgjigje të pranuar	9 - kërkesa të dorëzuara 13 - përgjigje të pranuar	6 - kërkesa të dorëzuara 6 - përgjigje të pranuar	9 - kërkesa të dorëzuara 9 - përgjigje të pranuar	13 - kërkesa të dorëzuara 13 - përgjigje të pranuar

180. ATK-ja, përveç mekanizmit të lartpërmendur të përputhjes, ka shprehur kënaqësi edhe me shkëmbimin e informacionit (që ndihmohet nga një zyrtar ndërlidhës i ATK-së për NjIF-in) dhe rastet kur ATK-ja ka përdorur informacionin e ofruar, që më pas ka rezultuar në zbulimin e detyrimeve tatimore të padeklaruar ose të papaguara. Përveç kësaj, sikurse u tha më lart, ATK-ja i ofron NjIF-it informacion që kontribuon në analizën e rasteve dhe shpërndarjen e mëtejshme tek ATK-ja për hetim (shih më poshtë). Autoritetet kanë pretenduar përdorim të konsiderueshëm të inteligjencës financiare për ato qëllime dhe informuan për kontributin e informacionit të NjIF-it për hetimet lidhur me tatimet. Një numër i konsiderueshëm i raporteve të NjIF-it shkojnë për ATK-në.

Tabela 6: Raportet e NjIF-it për ATK-në

	2013	2014	2015	2016	2017	Gjithsej 2013-2017	% e të gjithëve
Administrata Tatimore e Kosovës	21	21	23	26	39	130	28.57%

181. Megjithatë, statistikat e ofruara nuk paraqesin dobinë e informacionit që NjIF-i i ka siguruar ATK-së (28.57% e të gjithë raporteve të shpërndara nga NjIF-i për periudhën 2013-2017) si shkak i vetëm i rasteve të ndërlidhura me tatimet. Raportet e NjIF-it u përdorën si shkak për vetëm 2 nga hetimet për krime tatimore në periudhën 2015-2017. Ashtu si është përmendur më lart, nuk ka pasur raste të PP-së të ndërlidhura me tatimet që të jenë ndjekur nga ATK-ja.

182. Korniza e bashkëpunimit ndërmjet NjIF-it dhe AKK-së nuk ka paraqitur asnjë rezultat specifik të bazuar në inteligjencën financiare. NjIF-i ka dërguar raportime të kufizuara në AKK. Në vitin 2017, NjIF-i ka dërguar në AKK tri raporte, pa asnjë informacion në dispozicion lidhur me rezultatet e kontroleve të pasurive të mundshme të padeklaruar. Nga ana tjetër, Agjencia kundër Korrupsionit ka paraqitur një sërë kërkesash pranë NjIF-it kryesisht lidhur me mospajtueshmërinë me detyrimet për deklarim të personave dhe duke pasur parasysh pamundësinë për të mbledhur informacionin e nevojshëm financiar. Kërkesat e AKK-së për NjIF-in ishin rreth 6-8 në vit, duke përfshirë 3 kërkesa në 2015, 6 në 2016 dhe më shumë në vitet në vijim.

183. Pavarësisht disa rasteve të hetimeve të PP-së të diskutuara gjatë vizitës në terren, numri i referimeve nga policia në Prokurori bazuar në raportet e NjIF-it tregon se një numër i parëndësishëm i produkteve të inteligjencës financiare janë shpërndarë për të nxitur hetime për PP-në. Statistikat e PK (DHKEK-SIF) treguan se për periudhën 2015 - 2017 ka pasur gjithsej 8 raste të kallëzimeve penale në PSRK për PP-në, nga të cilat 4 janë iniciuar në bazë të raporteve nga NjIF-i (edhe pse NjIF-i duket se po kontribuon për të gjithë rastet e hetimeve financiare). Pavarësisht faktit se gjysma e raporteve për PP-në janë nxitur nga raportet e NjIF-it, numri duket i pallogaritshëm në krahasim me numrin e përgjithshëm të raporteve (322 për të njëjtën periudhë) dhe numrin e hetimeve për vepra të ndryshme, përfshirë krimin e organizuar, trafikimin e armëve, etj. Shumica e rasteve të dënimeve për PP-në që i janë paraqitur ekipit të vlerësimit ishin raste më të vjetra ku janë shpallur aktgjykimet përfundimtare në tri vitet e

fundit, gjë që nuk lejoi vlerësimin e duhur të përdorimit efektiv të inteligjencës financiare dhe informatave të tjera për zhvillimin e provave dhe gjurmimin e të ardhurave të ndërlidhura me PP-në. Në kuptim më pozitiv, AZL-të kanë vërejtur se disa nga raportet e shpërndara kanë nxitur hetime për vepra të tjera penale të ndërlidhura (p.sh. shmangia nga tatimi, mashtrimi, etj.) edhe pse nuk ka statistika të detajuara në dispozicion.

Shembull: Rast rajonal i pastrimit të parave

NjIF-i inicioi një rast në bazë të një RTD-je. Personi B.S. i cili u paraqit me dokumente nga shteti X ka hapur llogarinë e biznesit "P" dhe ka filluar realizimin e depozitave në para të gatshme në llogarinë e hapur në njërën nga bankat në Kosovë. Pasi janë bërë depozitat në para të gatshme, personi në fjalë filloi realizimin e transfertave ndërkombëtare dalje, të përshkruara si pagesa për fatura për një kompani në vendin Q. Nëpërmjet bashkëpunimit ndërkombëtar, vendet si vendi X dhe Q u kontaktuan për të marrë më shumë informacion rreth personit B.S. dhe kompanisë që po pranon transferta nga Kosova. U ngrit dyshim për përdorimin e dokumenteve të falsifikuara.

Gjatë hetimit u konstatua se personi me inicialet B.S. mund të ishte një tjetër i huaj nën hetime për përfshirje në kontrabandimin e cigareve dhe duhanit. Ai gjithashtu ishte përfshirë në kontrabandë të drogës. Për vërtetimin e këtyre fakteve shërbeu shkëmbimi ndërkombëtar i informacionit.

NjIF-i bashkëpunoi ngushtë me Prokurorinë Speciale dhe mbajti takime të përbashkëta me hetuesit e policisë. Të dhënat financiare të grumbulluara nga NjIF-i përfshinin informacion të gjerë, përfshirë të gjitha hollësitë e llogarive bankare në të gjitha bankat vendore dhe ato në vendet e huaja, u kontrolluan të gjitha deklaratat e mjeteve monetare në pikat e kalimit kufitar, informatat nga ShTPV-të, gjurmimi i pasurisë, përfshirë pasurinë jashtë vendit, kamerat e vëzhgimit dhe pikat e kalimit kufitar dhe u bë krahasimi me të dhënat e transaksionit. Gjithashtu, u mbajtën takime me hetues nga juridiksionet e huaja përkatëse.

184. Statistikat e paraqitura për shtyrjen e transaksioneve të filluara nga NjIF-i tregojnë se vetëm një numër shumë i kufizuar i hetimeve formale është hapur në ndonjë prej këtyre rasteve dhe nuk është e qartë se sa prej kontrolleve paraprake në të vërtetë kanë qenë në lidhje me PP-në. Nuk është e qartë se cila pjesë e fondeve të përfshira në urdhrat e ngrirjes së NjIF-it (gjithsej më shumë se 2 milionë euro për 2016-2017) janë siguruar aktualisht. Në frymë më pozitive, duket sqaruar se shtyrja e urdhrave ka të bëjë me transaksione të veçanta dhe jo raste (domethënë, shtyrje që ka të bëjë me një numër relativisht të kufizuar të rasteve), duke e bërë kështu shpërpjesëtimin ndërmjet hetimeve formale dhe aktakuzave dhe rasteve ku shtyrjet janë përdorur më pak të dukshëm. Sidoqoftë, nuk u vunë në dispozicion statistika të sakta për ta sqaruar tërësisht këtë shpërpjesëtim.

Tabela 7:

Viti	Numri i urdhrave për shtyrje të lëshuar nga NjIF-i	Numri i rasteve kur urdhri i NjIF-it është pasuar nga hetim paraprak dhe nga lëshimi i urdhrat për sekuestrim	Numri i rasteve kur urdhri i NjIF-it është pasuar nga hetim paraprak dhe është lëshuar urdhër për ngrirje	Numri i rasteve kur është iniciuar ndjekje penale / aktakuzë
2014	20	1	20	1
2015	6	1	1	1
2016	85	1	85	1
2017	3	1	3	1

185. Në vitet 2013-2017, NjIF-i ka shpërndarë rreth 40 raste në bazë të dyshimit për FT. Gjatë vizitës në terren u diskutuan një sërë rastesh të lidhura me raportimet për FT. U zhvilluan kontrolle gjithëpërfshirëse në lidhje me këto raste dhe u shqyrtua prejardhja dhe destinacioni i fondeve. NjIF-i gjithashtu mund të konsiderohet si një kontribues i rëndësishëm i informacionit për të përcaktuar lëvizjet e fondeve për hetimet e ndërlidhura me terrorizmin. Një nga shembujt ishte rasti i përkrahjes për Sirinë (ju lutemi referojuni RM 9), ku NjIF-i inicioi kryesisht kontrollet për aspektet financiare. Në këtë rast, bashkëpunimi përfshinte NjIF-in dhe DK-në. Pavarësisht

nga mungesa e konfirmimit të FT-së si rezultat i shumicës së rasteve të zhvilluara më parë dhe të mungesës së dënimeve për FT apo FT të ndërlidhur me PP, përfshirja e konsiderueshme e NjIF-it në të paktën dy raste të dyshuara për FT aktualisht nën hetim formal është diskutuar gjatë vizitës në terren. Një nga rastet kishte të bënte me transaksionet nga zonat përreth zonave të konfliktit në Lindjen e Mesme dhe tjetri përfshinte FT-në e dyshuar që po ndodhte nga një vend i BE-së dhe lidhej me një sërë transaksionesh përmes disa vendeve dhe duke përdorur kanale të ndryshme dërgesash, në një rast relativisht kompleks.

RTD-të e pranuar dhe të kërkuara nga autoritetet kompetente

186. NjIF-i ka të drejtë dhe merr informata për dyshime të lidhura me PP-në, vepra të ndërlidhura penale si dhe FT-në nga subjektet raportuese dhe autoritetet publike. Kjo do të përfshinte RTD-të nga subjektet raportuese sipas Ligjit për PPP/LFT-në (përfshirë OJF-të), si dhe raporte shtesë të bazuara në RTD (RTP) dhe RTG të mëparshme. Përveç këtyre kategorive të informacionit, NjIF-i është në gjendje të marrë informacion që ka të bëjë me funksionet e saj prej një spektri të gjerë të autoriteteve publike, përfshirë gjykatat ose autoritetet përgjegjëse për zbatimin e ligjit, organizatat ndërqeveritare dhe ndërkombëtare dhe organet publike ose qeveritare. Informacioni për dyshimet për PP-në, veprat kryesore dhe FT-në mund t'i ofrohet NjIF-it edhe vullnetarisht. Në praktikë, përveç RTD-ve nga subjektet raportuese në sektorin privat, NjIF-i pranon raporte me dyshime vetëm nga DK-ja dhe mbikëqyrësit (këtu nënkuptohet BQK-ja). Nuk është pranuar asnjë informacion mbi dyshime nga DRNOJQ-ja, pavarësisht nga rreziqet e konsiderueshme që ndërlidhen me sektorin. Sa i përket dyshimit për FT-në, pothuajse të gjitha raportet për periudhën 2013-2017 janë pranuar nga subjektet raportuese me përjashtim të një raporti nga DK-ja në vitin 2013 dhe një raporti nga mbikëqyrësi sektorial në vitin 2016. Për më tepër, një rast u pranua nga autoritetet publike dhe rezultoi në sekuestrimin e patundshmërisë në një dënim të ndërlidhur me terrorizmin.

187. Numri i përgjithshëm i RTD-ve të pranuar në vitet 2011-2017 ishte 2.417. Për periudhën 2013-2017 ka pasur 103 RTD në lidhje me FT-në. Numri i RTD-ve të pranuar është rritur ndjeshëm, ku është vërejtur një rritje prej 83% në vitin 2017 në krahasim me vitin 2015. Bankat janë kontribuesi kryesor në këtë rritje, ndërsa kontributi i të gjitha subjekteve të tjera raportuese është i parëndësishëm. Nuk ka asnjë raportim nga BPCJF-të që të përbëjë ndonjë shqetësim të konsiderueshëm, duke pasur parasysh rreziqet e konsiderueshme që ndërlidhen me sektorin e patundshmërive, lojërave të fatit etj. Vlerësuesit gjithashtu kanë dyshime sa i përket efektivitetit të sistemit të krijuar për OJF-të, duke pasur parasysh se nuk është marrë asnjë raport prej tyre.

188. Përgjithësisht, NjIF-i e vlerëson cilësinë e raporteve si të mira dhe në rritje në vitet e fundit pas një sërë trajnimesh dhe udhëzimesh të ofruara. Autoritetet gjithashtu e konsiderojnë sistemin aktual të masave mbrojtëse ndaj zbulimit të informacionit për RTD-të (të rregulluar dhe të interpretuar në mënyrë të rreptë për të parandaluar zbulimin edhe para mbikëqyrësit dhe drejtuesit të institucioneve financiare) si faktor që kontribuon në efektivitetin e regjimit të raportimit, sidomos në rastin e dyshimeve lidhur me korrupsionin dhe, sipas NjIF-it, të raportimeve në rritje të informacionit mbi PEP-ët. Tipologjitë që mbulojnë këto çështje janë bërë publike. Në të njëjtën kohë, lindin dyshime të caktuara sa i përket aftësisë së autoriteteve për të ruajtur cilësinë e raportimit, duke marrë parasysh çështjet që rrjedhin nga praktikat mbikëqyrëse ashtu si shtjellohen në RM 3 dhe RM 4. Vlerësuesit besojnë gjithashtu se sistemi mund të përfitojë nga udhëzime dhe tipologji të tjera të mëtejshme që u sigurohen subjekteve dhe institucioneve raportuese. Në 5 vitet e fundit, NjIF-i ka nxjerrë dy raporte të tipologjive, një prej të cilëve përqendrohet te PEP-ët, por vihet re se, për shembull, raportet vjetore të NjIF-it nuk kanë përfshirë rregullisht tipologji dhe nuk ka nisma të tjera të njohura në këtë fushë. Për OJF-të nuk është ndërmarrë asnjë sensibilizim shtesë lidhur me tipologjitë dhe raportimin.

189. Përveç burimeve të lartpërmendura të informatave nga subjektet raportuese, NjIF-i merr edhe informacione shtesë të mbledhura më pas nga subjektet raportuese pas RTD-së të raportuar më parë. Kjo informatë shtesë (e përcaktuar si AIF në raportet e NjIF-it) raportohet sipas nenit 26, paragrafi 2 i Ligjit për PPP/LFT-në, edhe pse efektiviteti i përdorimit të këtij informacioni nuk mund të konfirmohet për shkak të mungesës së informacionit të mëtejshëm nga autoritetet. Nuk ka kritere të qarta për zbatimin e këtij detyrimi nga subjektet raportuese, përfshirë marrjen e vendimit për të vazhduar raportimin, shkallën e raportimit etj. Nga ana tjetër, vërehet se subjektet raportuese në një numër të vogël rastesh kanë vazhduar raportimin me nismën e vet. Nga ana tjetër, shumë prej këtyre raporteve duket se janë paraqitur me kërkesë nga NjIF-i duke gjykuar nga informacioni i dhënë nga autoritetet. Nuk është siguruar asnjë statistikë sa i përket numrit të saktë të paketave të tilla shtesë të informacionit pas RTD-së fillestare.

190. Dispozita e përmendur e ligjit parasheh pranimin e këtij informacioni edhe në bazë të kërkesës nga NjIF-i (në kuadër të punës së vet për rastin) dhe kjo përbën pjesën më të madhe të AIF-ve të marra. Bazuar në këto udhëzime, përshtypja e vlerësuesve është se informacioni shtesë do të përmbante hollësi mbi transaksionet e zhvilluara në llogaritë e ndara. Statistikat e NjIF-it bëjnë fjalë për 6.016 pjesë të informacionit shtesë (transaksione) në vitin 2014, 3.975 në vitin 2015 dhe 6.325 në vitin 2016. Nuk është e qartë nëse këto shifra përfaqësojnë transaksione apo raporte të ndara. Duke marrë parasysh përdorimin e kanaleve të komunikimit elektronik dhe pranimin e strukturuar të informacionit mbi transaksionet, si dhe diskutimet në terren, këto raporte mund të konsiderohen se janë në gjendje t'u ndihmojnë në mënyrë të konsiderueshme autoriteteve kompetente gjatë kryerjes së detyrave të tyre. Kjo duhet të shqyrtohet edhe nga pikëpamja e kapacitetit analitik në dispozicion të NjIF-it (që përfshin të paktën tre ekspertë të certifikuar financiarë forenzikë) për të përpunuar informacionin. Megjithatë, numri i madh i raporteve duket të jetë në kundërshtim me burimet njerëzore në dispozicion. Të gjitha kërkesat nga NjIF-e të tjera, policia etj., janë trajtuar nëpërmjet AIF-ve për të siguruar informacionin e duhur.

191. Në lidhje me pranimin dhe përdorimin e RTP-ve, vërehet se ky sistem i raportimit nuk mund të konsiderohet në vetvete mjet efektiv dhe i dobishëm, pasi nuk ka bazë të veçantë ligjore për pranimin e këtij informacioni dhe përdorimin e mëvonshëm dhe nuk duket të shërbejë si një burim informacioni i besueshëm. Gjenerimi i këtyre raporteve nga NjIF-i kuptohet nga vlerësuesit si çështje që ka të bëjë nga njëra anë me mungesën e udhëzimeve të duhura për subjektet raportuese. Numri i këtyre raporteve varion nga disa në vitet 2014 dhe 2015, në 23 në vitin 2016, por megjithatë përfshijnë shuma të konsiderueshme të parave, sikurse shihet në tabelën e mëposhtme. Çështja duhet të sqarohet nga autoritetet dhe të sigurohet se nuk ka keqpërdorime.

Tabela 8: Fondet e përfshira në RTP-të e pranuar nga NjIF-i

Viti	2014	2015	2016	2017
RTP	1.001.320 euro	601.600 euro	16.176.800 euro	14.408.443 euro

192. Ende nuk është e qartë se cila është vlera e shtuar e këtij sistemi duke marrë parasysh se nuk ka informacion për përdorimin e këtyre raporteve në analizë e rezultate dhe mungesën e detyrimit të njëjtë dhe të qartë, të kuptueshëm dhe të zbatueshëm për të gjitha subjektet raportuese për të ofruar informata të tilla në të gjitha rastet, pasi as ligji i ri, as ai i vjetër për PPP/LFT-në nuk përfshijnë një detyrim të tillë. Kërkesa për raportim për këto raporte, edhe pse përcaktohet qartë në Ligjin për PPP/LFT-në (si atë aktual, ashtu edhe atë të mëparshëm), i nënshtrohet një interpretimi më të gjerë nga NjIF-i (sikurse është demonstruar p.sh. në Raportet Vjetore të NjIF-it për vitet 2014-2016). Ligji e përcakton qartë raportimin vetëm kur kërkohet nga NjIF-i ndërkohë që paraqitja e këtyre raporteve nuk është e detyrueshme. Së dyti, edhe pse duket se janë të përfshira shuma të konsiderueshme, nuk është e qartë, për shkak të vështirësive të mësipërme të interpretimit, nëse të gjitha informatat e mundshme për transaksione të pazakonshme janë dorëzuar në të vërtetë dhe i kontribuojnë përpjekjeve të NjIF-it. Së treti, nuk është e qartë se cilat procedura do të ndiqen nga NjIF-i, pasi kjo gjë nuk shpjegohet në PSO-në për analizën dhe procesin e inteligjencës të vitit 2015 dhe madje as nuk përmendet si burim informacioni.

193. Autoritetet nuk demonstruan se aktivitetet e ndërlidhura të raportuara si pjesë e RTD-ve përputhen plotësisht me profilin e rrezikut të vendit (sidomos në lidhje me patundshmëritë, lojërat e fatit, korrupsionin, krimin e organizuar dhe lëvizjen e parave të gatshme). Është posaçërisht shqetësuese që shumë pak raporte janë siguruar nga DK-ja dhe shumica e tyre kanë të bëjnë me instrumente monetare të padeklaruara në kufi. Nuk duket se është raportuar asnjë dyshim në lidhje me lëvizjet e konsiderueshme të parave të gatshme në rast të respektimit të detyrimeve të deklarimit, si dhe në lidhje me pastrimin e parave nga tregtia. Ky është një shqetësim i madh, edhe duke pasur parasysh kontrabandimin e përhapur të mallrave dhe armëve dhe praninë e një eksperti të dërguar nga DK-ja që punon si analist në NjIF (shih më poshtë). Në një këndvështrim më pozitiv, DK-ja duket se përfiton në mënyrë aktive nga RTD-të dhe informata të tjera financiare në dispozicion të NjIF-it pavarësisht nga njëfarë mungese të sqarimit në PSO të njësisë hetimore të DK-së lidhur me procedurat për përdorimin e mundshëm të inteligjencës financiare. Në bazë të PSO-së të Doganës kuptohet se zyrtari ndërlidhës do të kryente shumicën e detyrave që kanë të bëjnë me ofrimin e informacionit për Doganën dhe të siguronte se aspektet financiare mbulohej si duhet. Pavarësisht shkëmbimit të konsiderueshëm të informatave me ATK-në, nuk ka pasur raporte që NjIF-i i ka paraqitur në ATK lidhur me dyshime për PP-në.

194. Sa i përket RTG-ve, autoritetet shpjeguan përdorimin e tyre të gjerë si mjet për analizim të rasteve nga NjIF-i dhe për raportet pasuese. Në të njëjtën kohë, këto RTG përdoren edhe në kuadër të kornizës për gjurmimin e të dhënave në përputhje me një metodologji gjithëpërfshirëse (PSO) që merr parasysh rreziqet dhe prioritetet specifike. Mirëpo, nuk ka në dispozicion hollësi të tjera që të konstatohen rezultatet e përdorimit të RTG-ve si pjesë e analizës. Në periudhën midis 2012 dhe 2016, numri i transaksioneve në para të gatshme të raportuara u rrit mbi 60%. Numri i transaksioneve të pranuar u rrit nga 778.286 në vitin 2016 në 837.903 në vitin 2017. Shifrat e përmendura përfshijnë edhe informacionin e pranuar nga DK-ja.

Tabela 9: Numri i RTG-ve (përfshirë edhe instrumentet monetare në kufi) përgjatë viteve

Vitet	2012	2013	2014	2015	2016	2017
RTG të pranuar	480.479	606.778	553.651	617.430	778.286	837.903

Tabela 10: RTG të pranuar, përfshirë instrumentet monetare të deklaruar në kufi

Subjektet dhe institucionet raportuese	2014		2015		2016	
	Raporte	Transaksione	Raporte	Transaksione	Raporte	Transaksione
Banka	1.700	548.139	2.028	614.162	2.087	774.463
Institucione mikrofinanciare	12	37	12	25	22	184
Sektori i sigurimeve	3	11	0	0	0	0
Këmbim valutor	297	2.959	292	1.875	297	2.384
Agjenci për transferim të parave	25	500	23	104	18	99
Gjithsej RTG të bankave dhe institucioneve financiare	2.037	551.646	2.355	616.166	2.424	777.130
Dogana e Kosovës	12	2.005	12	1.264	12	1.156
Gjithsej	2.049	553.651	2.367	617.430	2.436	778.217

Nevojat operative të mbështetura nga analiza dhe raportet e NjIF-it

195. Funkzioni analitik i NjIF-it zhvillohet në bazë të një sërë procedurash të hollësishme dhe kryesisht të procedurave standarde të operimit gjithëpërfshirëse nga analistë me përvojë dhe të kualifikuar, duke përdorur mjete të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit shumë të sofistikuar për futjen, ruajtjen, nxjerrjen e informacionit, përpunimin dhe shpërndarjen. Mirëpo nuk përdoren plotësisht të gjitha potencialet e sistemit të TI-së për automatizim, megjithatë, dhe pavarësisht kënaqshmërisë së përgjithshme me cilësinë e rezultateve të NjIF-it, disa nga bashkëbiseduesit kanë ngritur shqetësime sa i përket afateve kohore të raporteve të shpërndara.

196. NjIF-i fillon dhe zhvillon analiza operative që kryesisht bazohen në informacionin e RTD-ve që vjen nga subjektet raportuese (përfshirë autoritetet publike). Analiza është në përputhje me jo më pak se shtatë (7) procedura standarde të operimit (PSO) të miratuara nga Drejtori i NjIF-it ose së bashku me PK-në dhe ATK-në. Këto PSO përfshijnë pjesën më të madhe të proceseve në NjIF deri në hollësi, përfshirë hapjen dhe zhvillimin e rasteve, priorizimin dhe përzgjedhjen, mbledhjen e informatave shtesë nga burime të ndryshme, mbledhjen e inteligjencës dhe pasurimin e rasteve, kushtet dhe garancitë për proceset e inteligjencës, shkëmbimin ndërkombëtar të informacionit, përputhjen anonime të databazave me ATK-në dhe PK-në (shih më lart), dhe shënjestrimin e krimit të rëndë. PSO-të ofrojnë një bazë të shëndoshë

për zbatimin e funksioneve të NjIF-it. Ato gjithashtu konsiderohen si instrumenti i duhur për të shmangur keqpërdorimin e kompetencave të NjIF-it dhe për të siguruar përqendrimin efektiv të burimeve në kryerjen e funksioneve kryesore të NjIF-it. Janë vërejtur disa mangësi të vogla, p.sh. mungesa e kriterëve për shpërndarjen e raporteve, ose faktorët e rrezikut dhe kriteret e renditjes apo përshkrimi i disa prej proceseve në terma shumë të përgjithshëm. Ekspertët e NjIF-it dukej se ishin të vetëdijshëm për kërkesat dhe përpiqeshin të tejkalonin çdo problem apo vështirësi që krijohet nga ose që lidhet me rritjen e flukseve hyrëse të informacionit, duke bërë ndryshime në PSO (p.sh. përmes Planit të Performancës dhe Burimeve të vitit 2018 që përcakton veprimet për dy vitet në vijim).

Tabela 11: Burimet për rastet e hapura nga NjIF-i

Rastet e hapura për analizë	2015	2016	2017
Rastet e hapura në bazë të RTD-ve	125	180	147
Rastet e hapura në bazë të informacionit anonim	14	18	6
Rastet e hapura nga informacioni spontan nga NjIF-e të tjerë	1	1	5
Rastet e bazuara në kërkesa për informacion	106	113	140
Projekte të përbashkëta për analiza/hetime me institucione të tjera të zbatimit të ligjit	1	6	12
Gjithsej raste të hapura	247	318	310

197. NjIF-i përqendrohet gjithnjë e më shumë në projekte të përbashkëta të analizës dhe hetimit me AZL-të dhe me autoritete të tjera. Një rritje e konsiderueshme e numrit të rasteve të tilla të gjeneruara nga puna e përbashkët është parë në vitin 2017. Këto projekte u mundësojnë autoriteteve kompetente që të punojnë së bashku mbi subjektet e dyshuara për kriminalitet specifik të ndërlidhur me rrezik të konsiderueshëm ose me rëndësi të veçantë publike. Këtu përfshihet edhe përqendrimi në rritje të listat e personave që gjenerohen bashkë me AKK-në sa i përket origjinës së paqartë të pasurisë së PEP-ëve. Në bazë të këtyre projekteve, NjIF-i ka hapur rastet e lartpërmendura për analiza të mëtejshme sa herë që ka pasur në dispozicion informacion shtesë.

198. Procedurat Standarde të Operimit të NjIF-it përmbajnë edhe analizën e informacioneve të RTG-ve si pjesë e përpunimit të rasteve të hapura. Sistemi i TI-së i NjIF-it ofron një sërë mjetesh për analizimin dhe gjetjen e informacionit që mund të jetë i dobishëm për pasurimin e rasteve dhe u demonstrua se produktet e inteligjencës përmbajnë edhe analizën e të dhënave të RTG-ve.

199. Në të njëjtën kohë, që nga viti 2014 NjIF-i ka filluar zbatimin e një sistemi kryesisht të nxjerrjes së të dhënave nga të dhënat e RTG-ve bazuar në kriteret e paracaktuara dhe kërkesa shtesë në pajtim me rreziqet kryesore dhe prioritetet e punës së NjIF-it. Objektivat përcaktohen çdo vit, por edhe përzgjedhja e caqeve për analizë të mëtejshme bëhet në bazë të prioritetëve specifike, rasteve të përbashkëta të zhvilluara etj. Bazuar në këtë nxjerrje të caqeve, nxiten propozime për rastin, të cilat edhe pse nuk janë transformuar ende në raste konkrete, konsiderohen se janë me mjaft përfitim në varësi të monitorimit të ardhshëm për nivelin e rrezikut. Vlerësuesit e konsiderojnë këtë si një mjet të mundshëm për zhvillimin e mëtejshëm të rasteve për raportim, sidomos duke pasur parasysh rreziqet e ndërlidhura me ekonominë joformale, përdorimin e parave të gatshme dhe lëvizjen e tyre përtej kufirit. Megjithatë, efektiviteti i tij kufizohet nga përdorimi i pamjaftueshëm që kryesisht ka të bëjë me mungesën e burimeve për t'i trajtuar këto raste, përveç analizës së bazuar në RTD-të dhe në rastet e hapura me kërkesë të autoriteteve të tjera. Kështu, hapja aktuale e rasteve në bazë të RTG-ve duket se ka të bëjë me kufijtë për vitin përkatës dhe nivelin e rrezikut të ndërlidhur me propozimin konkret të rastit. NjIF-i ka paraqitur 28 propozime për raste në vitin 2015 dhe një në vitin 2016. Vlerësuesit nuk janë informuar për rastet aktuale të nxitura apo për raportet e shpërndara në bazë të këtyre propozimeve.

200. Funkcioni i pranimit, përzgjedhjes dhe analizës së NjIF-it përfiton mjaft nga marrja e informacionit elektronik nga subjektet raportuese (më shumë se 95%) duke përdorur modele të standardizuara dhe duke lejuar që informacionet e strukturuar të regjistrohen me shpejtësi në databaza. NjIF-i ka zhvilluar dhe zbatuar një sistem të plotë dhe efektiv të prioritizimit dhe ai është pjesë e PSO-së së njësishme. Sistemi bazohet në kriteret e detajuara dhe mekanizma të

vlerësimet. Sidoqoftë, procesi i përzgjedhjes dhe prioritizimit të raporteve përmes propozimeve të rasteve të kërkuara (CAP) për nivelin drejtues të NjIF-it përfshin ende punë manuale. Kjo kryesisht ka të bëjë me kontrollet manuale në shumicën e databazave në mënyrë që të përcaktohet lidhja me raportet e mëparshme ose informacione të tjera të rëndësishme. Kjo do të ndikonte negativisht në burimet analitike të NjIF-it.

Tabela 12: Kërkesat për informacion (ORD) nga NjIF-i (për subjektet raportuese dhe autoritetet publike)

Viti	Numri i kërkesave
2014	1.992
2015	1.616
2016	1.628
2017	1.032

201. Në vitin 2017, NjIF-i ka dërguar rreth 77% të të gjithë kërkesave për informacion te bankat dhe rreth 7% te subjektet e tjera raportuese. Për të njëjtën periudhë, rreth 16% e të gjitha kërkesave u janë paraqitur autoriteteve publike. Shumica e këtyre të fundit iu paraqitën ATK-së (111 kërkesa) dhe Kadastrës (25).

202. Përveç burimeve të ndryshme të informacionit në dispozicion të NjIF-it dhe që janë shfrytëzuar, të dhënat në analizën e NjIF-it për informacionin nga AZL-të kryesisht arrihen përmes përdorimit të mekanizmave të përputhshmërisë me databazën. Këto mekanizma garantojnë zhvillimin si duhet të rasteve të mundshme të PP-së, veprës së ndërlidhur penale dhe FT-së dhe mund të konsiderohen si mënyrë shumë efikase për të shmangur dyfishimin e përpjekjeve dhe për të siguruar informatat kthyes me kohë dhe prioritizimin e rasteve, si dhe raportimin e duhur. Në të njëjtën kohë, vihet re se hollësi të mëtejshme mbi informacionin në dispozicion duhet të merren nëpërmjet një kërkesë të veçantë të drejtuar për AZL-në e cila ka efekt negativ në afatin kohor të ndihmesës së AZL-së, megjithëse zbutet nga përdorimi i zyrtarit ndërlidhës të PK-së në NjIF. Nga ana tjetër, lindin disa shqetësime lidhur me ofrimin e informatave kthyes në kohë nga PK-ja në lidhje me shpërndarjen e NjIF-it dhe informatat e kufizuara që zakonisht ofrohen (ndryshe nga p.sh. informatat kthyes nga ATK-ja). Informatat kthyes nga PK-ja zakonisht bëhen periodikisht në një mënyrë të përmbledhur për një sërë raportimesh të pranuar dhe është i kufizuar sa i përket arritjeve të raportimit pranë prokurorisë ose jo. Sa i përket kërkesave për informacion nga PK-ja te NjIF-i, ekipi i vlerësimit u informua lidhur me hollësitë e rastit përkatës, vetëm në rastet kur nevojitet kërkesë ndërkombëtare për informacion (me qëllim të përmbushjes së parimeve të shkëmbimit të informacionit).

203. Zyrtarët ndërlidhës të PK-së dhe DK-së i kontribuojnë efektivitetit të përpjekjeve dhe punës së NjIF-it për bashkëpunim. Të dy zyrtarët ndërlidhës gjithashtu kryejnë detyra të analizës së inteligjencës, në kushtet e masave mbrojtëse të zbatueshme për analistët e tjerë të NjIF-it.

204. Afati kohor mesatar për analizën dhe raportimin e rasteve ndryshon në varësi të natyrës së tyre, por përfshin edhe procesin fillestar të analizës së RTD-së dhe propozimin vijues për rastin dhe kohën për grumbullimin/pasurimin dhe analizimin shtesë të informacionit. PSO përcaktojnë 15 ditë nga pranimi i një RTD-je për propozimin e rastit nga ana e analistit dhe nuk ka pasur ndonjë informacion që të shfaqë mospërputhje me këtë afat kohor. Autoritetet vunë në dukje se rreth 92% e raporteve të dyshimta të pranuar në vitin 2015 janë përpunuar gjatë vitit në shqyrtim, ndërsa pjesa e mbetur mbetet për t'u analizuar në vitin vijues. Për vitet në vijim nuk është dhënë asnjë informacion i ngjashëm kur vihet re një rritje e konsiderueshme në numrin e RTD-ve (që do të përpunohen duke përdorur të njëjtat burime). Për më tepër, një rast i rastësishëm me prioritet normal dhe në dukje me ndërlikim mesatar (që përfshin kërkesa për dy NjIF-e dhe një numër të kufizuar të autoriteteve publike, p.sh. tatimet) që i është prezantuar vlerësuesve nxori në pah rreth 8 muaj nga pranimi deri në shpërndarje. Nuk u ofrua asnjë informacion i mëtejshëm për rrethanat e veçanta të rastit. Autoritetet nuk treguan se sa RTD ishin shpërndarë në vitet përkatëse. Disa nga bashkëbiseduesit që u takuan në terren komentuan mungesën e afateve kohore të disa prej raporteve që ju janë dhënë. Megjithëse kjo nuk është vlerësuar si çështje e sistemit, ka shqetësim lidhur me afatin kohor të kryerjes së punës analitike të NjIF-it. Arsytet kryesore duket të jenë të lidhura me burime të kufizuara, një nivel të caktuar të punës manuale sidomos në fazat fillestare të analizës dhe qasjen e tërthortë në disa lloje të informatave siç u përmend më lart.

205. NjIF-i e ka zhvilluar funksionin e vet analitik për periudhën 2014-2017 me 5-6 analistë në departamentin e operacioneve dhe analizave dhe është ristrukturuar në fillim të vitit 2018 për të rritur stafin e kësaj njësie deri në 7, duke përjashtuar udhëheqësin e njësisë. Stafi i përgjithshëm i NjIF-it, përfshirë dy zyrtarët ndërlidhës të sipërpërmendur me kohë të plotë të PK-së dhe DK-së, arrin në 23. Vlerësuesit nuk kanë asnjë dyshim në lidhje me aftësitë dhe përvojën e analistëve. Për shembull, të paktën tre prej tyre janë edhe ekspertë të certifikuar forenzikë financiarë. Ngarkesa mesatare e punës së departamentit të analizës për periudhën 2015-2017 ka lëvizur ndërmjet 22 në vitin 2015 në 30 raste në 2017. Kjo duket si një ngarkesë e arsyeshme e punës, por kufizimet e burimeve janë të dukshme kur merren parasysh ngarkesat shtesë të punës në aspektin e kërkesave të bashkëpunimit me institucionet e tjera dhe proceset e përzgjedhjes (të RTD-ve që variojnë nga 398 në 728), rritja e informacionit të pranuar dhe procedurat e shënjestrimit dhe analizat strategjike. Për më tepër, vlerësuesit kanë përshtypjen se procedura e shënjestrimit dhe priorizimit të RTD-ve dhe RTG-ve mund të rregullohen në praktikë në atë formë që të ruajnë ngarkesën mesatare të punës sa i përket rasteve që mund të jenë të dëmshme për efektivitetin duke lënë mënjanë rastet të cilat gjithashtu mund të kenë vlerë të konsiderueshme potenciale për përpjekjet e përgjithshme të autoriteteve kompetente. Përveç këtyre, autoritetet e Kosovës duhet të ndërmarrin masa shtesë për të siguruar hapësira të duhura për NjIF-in, jo vetëm për ekspertët e përfshirë në detyrat e veta, por edhe për ruajtjen e përshtatshme të informacionit e kopjeve rezervë dhe arkivimin e dokumentacionit.

206. Sa i përket analizës strategjike, përpjekjet e NjIF-it u përqendruan në zhvillimin e VKR-së dhe analizën e disa sektorëve me rrezikshmëri të lartë, që rezultoi në masa specifike të planifikuara dhe që aktualisht po zbatohen. Megjithatë, vihet re se një sërë zonash me rrezikshmëri të lartë duket se janë ende të pambuluara.

207. Analiza strategjike bëhet nga i njëjti departament që është përgjegjës për analizën operative dhe si i tillë varet në masë të madhe nga kufizimet e njëjta të burimeve. Analiza strategjike është bërë në bazë të PSO-së për Analizën dhe Procesin e Inteligjencës, si dhe një sërë metodologjish specifike të hartuara për analizën e rrezikut.

208. Në katër vitet e fundit, NjIF-i ka bashkërenduar me nismën e mundësitë e veta dhe është përfshirë gjerësisht në bashkëpunim me autoritetet e tjera përkatëse dhe sektorin privat në kryerjen e analizave gjithëpërfshirëse të rrezikut të sektorëve të ndërtimit dhe të patundshmërive, sektorit të lojërave të fatit dhe organizatave jofitimprurëse. Pavarësisht nga përfitimet e këtyre produkteve dhe planeve vijuese të veprimit, vihet re se një sërë zonash të rrezikuara të identifikuara në VKR dhe disa strategji kombëtare në vijim për luftimin e llojeve të ndryshme të aktiviteteve kriminale dhe dukurive negative nuk janë adresuar, kryesisht për shkak të mungesës së burimeve.

209. Megjithatë, NjIF-i duhet të lavdërohet që ka bërë përpjekjet e nevojshme për të kuptuar mirë rreziqet dhe çështjet më urgjente që ndikojnë në efektivitetin e luftës kundër PP-së, veprave penale të ndërlidhura dhe FT-së.

210. Rezultatet e këtyre përpjekjeve mund të demonstrohen jo vetëm nga numri i rasteve të shpërndara tek autoritetet kompetente, por edhe nga masat legjislative të zbatuara (p.sh. ndryshimet në ligjin për lirinë e asociimit, ligjin për organizatat fetare etj.).

Shpërndarja e informacionit

211. NjIF-i shpërndan informacion për një spektër të gjerë të autoriteteve kompetente bazuar kryesisht në RTD-të që ka pranuar, si dhe duke u bazuar në disa nisma të përbashkëta me autoritetet e zbatimit të ligjit dhe AKI-në. Shpërndarja e informacionit ka të bëjë me PP-në, veprat e ndërlidhura penale dhe FT-në në pajtim me autorizimin e qartë në legjislacionin për PPP/LFT-në.

212. Kriteret për shpërndarjen e informacionit parashihen në nenin 15, paragrafi 2 të Ligjit për PPP/LFT-në, i cili kërkon që NjIF-i të dorëzojë informata përkatëse për hetimet brenda kompetencave të autoriteteve. Megjithatë, PSO-të e NjIF-it nuk përmbajnë asnjë kriter tjetër dhe vendimet për shpërndarjen e informacionit merren në baza *ad hoc*. Shpjegimi i autoriteteve është që vendimi për autoritetin kompetent për të pranuar raportimin dhe për të përcaktuar prioritetet e raportimit do të bazohej në vlerësimet e rrezikut bazuar në kritere objektive dhe kërcënimet kryesore të përcaktuara për periudhën përkatëse nga NjIF-i. Prokuroria do të merrte rastet e vlerësuara me rrezikshmëri më të lartë, ndërsa të gjitha rastet e tjera do të kërkonin vërtetim të mëtejshëm nga AZL-të para se të shkonin në prokurori.

Tabela 13: Shpërndarja e informacionit nga NjIF-i

Raportet e shpërndara nga NjIF-i që u janë referuar institucioneve të tjera përkatëse (vetëm rastet e hapura sipas RTD-ve)	2013	2014	2015	2016	2017	Gjithsej 2013-2017	%
Policia e Kosovës	44	27	42	54	60	226	49.56
Prokuroria Speciale e Kosovës / Prokurori i Shtetit	0	1	9	7	4	21	4.59
Administrata Tatimore e Kosovës	21	21	23	26	40	131	28.6
Dogana e Kosovës	4	2	6	1	2	15	3.28
Agjencia e Inteligjencës së Kosovës	0	0	4	0	1	5	1.09
Agjencia kundër Korrupsionit	0	0	1	0	3	44	0.87
EULEX	2	2	1	13	2	20	4.37
NjIF-e ndërkombëtare / informacion spontan	3	6	8	11	5	33	7.21
Të tjerë	0	0	0	0	2	2	0.44
Gjithsej raporte të inteligjencës të shpërndara	74	59	94	112	119	458	100

213. Një sërë nga këto raste të shpërndara ishin rezultat i proceseve të shënjestrimit të krimet dhe nismave të ndryshme të përbashkëta me autoritetet e zbatimit të ligjit siç u shtjellua më lart. Këtu përfshihen personat/transaksionet e shënjestruara dhe të analizuara në lidhje me krimin e organizuar, burimet e financimit të organizatave jofitimprurëse, analiza e fondeve të zonave të caktuara gjeografike, pasuria e lidhur me korrupsionin dhe transaksionet. Këto do të mbulonin disa prej rreziqeve të konsiderueshme të identifikuar në VKR, por jo të gjitha. Për më tepër, në tri vitet e fundit, sistemi nuk duket se i ka kontribuar fuqishëm rreziqeve kryesore që janë identifikuar për Kosovën. Për vitin 2017 nuk ka pasur shënjestra. Për vitet 2016 dhe 2015, rastet me rëndësi kanë pasur të bëjnë me remitencë të parave që janë zhvilluar bashkërisht me NjIF-in e Shqipërisë, mirëpo shënjestrimet e tjera nuk duket të kenë qenë të ndërlidhura me rreziqet më të rëndësishme.

214. Janë ofruar shembuj të mbështetjes së duhur të hetimeve të NjIF-it nga PK-ja në raste individuale të PP-së ose pastrimit të parave nga palë të treta. Këto përfshinin 2 raste të lidhura me vendet e BE-së dhe përfshirjen e një aktori ekonomik në PP të realizuar me fonde që vinin nga mashtrime me pjesëmarrjen e një PEP-i. Edhe NjIF-i në raportet e veta, edhe PK-ja në hetimet e mëtejshme të bazuara në raporte të tilla duket se përqendrohen edhe në këto lloje të PP-së. Megjithatë, në një numër të madh rastesh, AZL-të janë ankuar për mungesë të informatave të mjaftueshme për veprën e ndërlidhur penale në disa nga raportet e pranuar nga NjIF-i, gjë që do ta bënte jashtëzakonisht të vështirë çdo hetim të mëtejshëm. Pavarësisht kësaj, gjatë vizitës në terren në përgjithësi nuk pati këndvështrime që të tregonin mungesën e cilësisë së rasteve të shpërndara. AZL-të konfirmuan se zakonisht RTD-të përmbajnë pista të mjaftueshme për t'u ndjekur nga AZL-të për të dëshmuar më tej PP-në dhe/ose veprën e ndërlidhur penale. Përshtypja e vlerësuesve, bazuar në rastet e ofruara dhe të shtjelluara, është po ashtu se raportet përmbajnë informacion të mjaftueshëm dhe analiza cilësore.

215. Rastet e FT-së trajtohen me prioritet më të lartë nga NjIF-i dhe në përgjithësi marrin vlerësimin më të lartë të rrezikut, duke rezultuar kështu në raportim të shpejtë, pavarësisht nga procedurat e kryera përgjithësisht në lidhje me RTD-të për PP-në. Një sërë veprimesh të sipërpërmendura nga NjIF-i lidheshin me rreziqet e FT-së dhe kanë rezultuar në një sërë rastesh të shpërndara. Për më tepër, vihet re se në një sërë rastesh është bërë ngrirja (shtyrja) e transaksioneve/fondeve edhe pse dyshimi nuk ishte konfirmuar.

216. Ashtu siç u diskutua më lart, është e qartë se raportimet rrallëherë u kanë kontribuar dënimeve të PP-së gjatë tri viteve të fundit. Pavarësisht ndikimit të raportimeve në lidhje me krimet e ndërlidhura me tatimet dhe krimet e tjera të hetuara nga autoritetet kompetente, vlerësuesit nuk janë në gjendje të japin ndonjë përfundim mbi rezultatet e raportimeve duke

marrë parasysh mungesën e statistikave të qarta për përdorimin e tyre të mëvonshëm në hetime formale dhe ndihmesën për dënime në lidhje me veprën e ndërlidhur penale.

Bashkëpunimi dhe shkëmbimi i informacionit/inteligjencës financiare

217. NjIF-i dhe autoritetet e tjera kompetente bashkëpunojnë gjerësisht në kuadër të një sërë grupesh të përbashkëta në nivel strategjik dhe në pajtim me një sërë PSO-ve dhe MM-ve që kanë rezultuar në disa nisma në nivel operativ të përqendruara në rreziqet kryesore të identifikuar në nivel vendor.

218. NjIF-i bën përpjekje të konsiderueshme për t'u siguruar që autoritetet kompetente pajisen me informata përkatëse. Shembulli i aktiviteteve më poshtë mund të konsiderohet si praktikë e mirë në këtë drejtim.

Praktikë e mirë: Përputhja e automatizuar NjIF – PK dhe databaza të ATK-së

Autoritetet e Kosovës kanë zbatuar një sistem të dobishëm për përputhjen anonime të informacionit nga databazat në bazë të procedurave standarde të operimit të vitit 2014. Qëllimi i kësaj procedure standarde të operimit (në vijim: PSO) është të përcaktojë dhe të standardizojë trajtimin e kërkesave për informacion që i dërgohen Policisë së Kosovës nga NjIF-i me qëllim që të kontrollojë nëse disa subjekte të caktuara që janë të regjistruara në databazën goAML-it të NjIF-it janë gjithashtu të regjistruara në Sistemin Informativ të Policisë së Kosovës (në vijim: SIPK). Qëllimi është identifikimi i personave të regjistruar në SIPK, të dyshuar për krime që mund të përbëjnë vepër të ndërlidhur penale të pastrimit të parave ose pasuri të destinuar për financim të terrorizmit. PSO-ja gjithashtu siguron zbatimin e dispozitave të konfidencialitetit dhe të mbrojtjes së të dhënave.

Një sistem i ngjashëm u krijua në vitin 2014 sipas një PSO-je edhe me ATK-në dhe këtu përputhja është vënë në zbatim.

Këto duket të jenë një mjet i dobishëm, por nevojitet më shumë informacion për të vlerësuar efektivitetin e mekanizmit përputhës dhe rezultatet e tij.

219. NjIF-i po ashtu ofron ndihmë të përshtatshme për AZL-të përmes përdorimit të kompetencave të veta për shkëmbimin ndërkombëtar të informacionit. Procedurat e ndjekura nga NjIF-i sigurojnë garanci të mjaftueshme si në lidhje me vërtetimin e kërkesave që merr nga AZL-të për ndihmë, ashtu edhe në lidhje me përdorimin e duhur të informacionit që u shpërndahet AZL-ve me anë të përgjigjes.

220. Nga ana tjetër, pavarësisht nga niveli përgjithësisht i mirë i bashkëpunimit, vërehen disa mangësi në lidhje me informatat e ofruara nga autoritetet e tjera kompetente me qëllim të zhvillimit të rasteve të PP-së së mundshëm, përfshirë (siç u shtjellua më sipër) mungesën e informatave kthyesë të rregullta dhe të hollësishme në disa raste, ofrimin e tërthortë të informacionit, nivelin e ulët të raportimit të rasteve që mund të tregojnë PP të mundshëm në NjIF në disa raste (p.sh. nga DK-ja dhe ATK-ja).

221. Përveç nismave të përbashkëta për subjekte specifike të përkrahura më sipër, NjIF-i përfshihet edhe në procesin e shënjestrimit të bërë në bazë të procedurave të përcaktuara në PSO-në për Procesin e Analizës dhe Inteligjencës dhe PSO-në për Përzgjedhjen e Shënjestrave të Krimeve të Rënda dhe Ekipet Hetimore Ndërinstitucionale. Procesi zhvillohet në nivel të NjIF-it çdo muaj dhe përfshin takime kryesive me prokurorinë dhe PK-në. Në nivel vendor, të gjitha autoritetet kompetente janë të pranishme dhe i kontribuojnë këtij procesi.

Tabela 14: Shënjestrimi dhe mbështetja nga NjIF-i

	2014	2015	2016	2017
Numri i takimeve të rregullta të përqendruara me Policinë e Kosovës dhe Prokurorinë Speciale siç përcaktohet në Procedurat Standarde të Operimit të NjIF-it për Inteligjencë dhe Analizë Strategjike e Operative	10	12	12	12

Numri i hetimeve të PP-së të mbështetura nga ekspertiza e NjIF-it për analiza	2	3	3	3
---	---	---	---	---

222. Të gjithë autoritetet kompetente përdorin kanale për shkëmbimin e informacionit që janë të sigurta dhe efikase, përfshirë dhe përdorimin e lidhjeve të dedikuara përmes sistemit të TI-së së NjIF-it.

Përfundimet e përgjithshme për Rezultatin e Menjëhershëm 6

223. Autoritetet e Kosovës përdorin një gamë të gjerë burimesh të informacionit, edhe pse qasja e tërthortë në disa prej këtyre burimeve dhe mangësitë në informacionin e mbajtur kanë ndikim në efektivitetin e institucioneve kompetente dhe nuk janë në përputhje me profilin e rrezikut në disa raste.

224. Autoritetet kompetente të Kosovës përdorin gjerësisht informacion financiar të cilësisë përgjithësisht të lartë së bashku me të dhëna të tjera të disponueshme dhe të arritshme për të kryer hetime paraprake për PP-në, veprat e ndërlidhura penale dhe FT-në. Kjo në përgjithësi do të përfshinte inteligjencë të nivelit të lartë të gjeneruar nga NjIF-i që duket se i kontribuon në mënyrë aktive zhvillimit të sistemit.

225. Pavarësisht dobisë së këtij informacioni për zhvillimin edhe të hetimeve formale për vepra të ndërlidhura penale në pajtim me disa prej rreziqeve të përcaktuara në VKR dhe vepra penale të raportuara përgjithësisht në Kosovë e cila u demonstrua, megjithatë nuk mund të konfirmohet nëse informacioni do të përdorej sa duhet për hetimet e PP-së.

226. Pavarësisht nga disa mangësi të vogla, NjIF-i dhe autoritetet e tjera kompetente bashkëpunojnë për një spektër të gjerë nismash në kuadër të një sërë grupesh të përbashkëta në nivel strategjik dhe në pajtim me një sërë PSO dhe MM që kanë rezultuar në disa projekte në nivel operativ që përqendrohen në rreziqet kryesore të identifikuar në nivel kombëtar.

227. Kosova ka arritur nivel të moderuar të efektivitetit me Rezultatin e Menjëhershëm 6.

Rezultati i Menjëhershëm 7 (Hetimi dhe ndjekja penale)

Identifikimi dhe hetimi i PP-së

228. Kosova ka elementet e nevojshme të një sistemi juridik dhe kornize institucionale, që është krijuar për të hetuar dhe ndjekur penalisht pastrimin e parave. Në kohën e vizitës në terren, Kosova po përgatiste një reformë gjithëpërfshirëse të sistemit të saj të drejtësisë penale, përfshirë Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale, që do të ketë ndikim në hetimin dhe ndjekjen penale të PP-së¹¹. Këto masa ende nuk ishin vënë në zbatim në kohën e vizitës në terren dhe kështu nuk do të merren parasysh për qëllimet e këtij vlerësimi. Mirëpo këto ndryshime do të demonstrojnë se autoritetet e Kosovës i kuptojnë mangësitë ekzistuese në sistemin aktual për ndjekjen penale të veprave të PP-së.

229. Vepra penale e pastrimit të parave hetohet nga një sërë autoritetesh, ku shumica e hetimeve kryhen nga Policia e Kosovës (PK). PK-ja ka dy struktura të ndara të specializuara në hetimin e PP-së: Drejtoria për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit (DHKEK) dhe Drejtoria për Hetimin e Krimin të Organizuar (DHKO).

230. DHKEK-ja dhe më konkretisht, Sektori për Hetime Financiare (SHF) ka përgjegjësinë për pranimin e materialeve nga NjIF-i dhe, kur është e nevojshme, nisjen e hetimeve për PP-në në bazë të këtyre materialeve. DHKEK-ja ka 120 hetues, ndërsa SHF-ja punon me 14 vetë. Ekziston edhe specializim i mëtejshëm për PP-në brenda sektorit, që përmban një njësi të specializuar të pastrimit të parave, e përbërë nga 4 hetues. Hetuesit e SHF-së trajtojnë raste me prioritet të lartë dhe mund të transferojnë raste të një rëndësie më të vogël për kolegët e tyre në DHKEK, të cilët gjenden nëpër rajone. Kur një vepër e ndërlidhur penale identifikohet në rastin e një hetimi për PP-në, ky informacion u dërgohet drejtorive të specializuara për të hetuar më tej veprën e ndërlidhur penale (p.sh. Drejtoria për Hetimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore (DHTQNJ), Drejtoria për Hetimin e Trafikimit me Narkotikë (DHTN) etj.). DHKEK-ja ka lidhje të

¹¹ Kodet e reja parashohin, ndër të tjera, zgjerimin e kompetencave për ndjekjen penale të PP-së edhe te prokurorë jo të PSRK-së.

drejtpërdrejtë TI përmes Platformës goAML dhe pranon materialet e NjIF-it drejtpërdrejt përmes kësaj lidhjeje.

231. DHKO-ja ka në përbërje një Sektor për Hetime të Integruara Financiare (SHIF) me 10 zyrtarë, që është përgjegjës për të nisur hetime financiare paralele për vepra të ndërlidhura penale, si krimi i organizuar, trafikimi me qenie njerëzore, drogë dhe armë, krimi kibernetik etj. Ndryshe nga hetimet për PP-në nga DHKEK-SHF-ja, hetimet e DHKO-SHF-së nisin gjithnjë nga hetimi për vepra të ndërlidhura penale ose nga brenda vetë DHKO-së, DHTQNJ-së, DHTN-së ose ndonjë drejtorie tjetër të PK-së.

232. PK-ja ka procedura standarde të operimit për sektorë të veçantë përfshirë SHIF. Edhe pse PSO-të nuk u referohen specifikisht hetimeve financiare paralele si koncept, në praktikë këto PSO duket se e mbulojnë thelbin e këtyre hetimeve. Autoritetet gjithashtu kanë theksuar se SHIF është ngritur për të ndërmarrë në mënyrë specifike hetime financiare paralele. Intervistat e gjera të mbajtura në terren me SHIF-në konfirmojnë se kjo praktikë është krijuar vërtetë dhe zhvillohet sa herë që ekziston një sasi e konsiderueshme e fondeve në lidhje me ndonjë vepër të ndërlidhur penale, që sipas autoriteteve është përafërsisht 80% e rasteve që gjenerojnë të ardhura të konsiderueshme. Megjithatë, nuk ka të dhëna specifike që mund të shprehen në terma sasiorë sa i përket shpeshësisë së hetimeve financiare paralele kundrejt hetimeve të veprave të ndërlidhura penale në përgjithësi, ose se cili mund të jetë pragu specifik për të nisur një hetim paralel financiar.

233. Dogana e Kosovës (DK) dhe Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) gjithashtu mund të hetojnë pastrimin e parave. Të dy agjencitë janë përfshirë në hetimet lidhur me PP-në së bashku me Policinë e Kosovës. Njësitë e specializuara për PP-në në këto dy agjenci ende nuk janë themeluar.

234. Vepra penale e pastrimit të parave është nën kompetencën e vetme të Prokurorisë Speciale (PSRK), që do të thotë se PSRK-ja mbikëqyr të gjitha hetimet e PP-së të ndërmarrura nga autoritetet e zbatimit të ligjit. Kur autorizon një hetim për PP-në, PSRK-ja lëshon një të ashtuquajtur letër besimi tek autoriteti i zbatimit të ligjit që ndërmerr veprimet e nevojshme hetimore. Në praktikë, prokurorët e PSRK-së duket se ndjekin nga afër hetimet për PP-në dhe janë të vetëdijshëm për hollësitë e një çështjeje, madje edhe kur aktakuza ende duhet të ngrihet. PSRK-ja mund të delegojë mbikëqyrjen dhe ndjekjen penale të rasteve të PP-së te prokurorët e tjerë jashtë PSRK-së, megjithatë kjo nuk është bërë kurrë në praktikë. Edhe nëse ka pasur delegime, aktakuza sërish duket se ngrihet nga PSRK-ja.

235. Autoritetet e zbatimit të ligjit kanë raportuar disa mangësi të efektivitetit në punën e tyre për të ndjekur pastrimin e parave që janë shkaktuar nga standardet e larta për prova që kërkon PSRK-ja për veprën penale të ndërlidhur. Ajo që çon te kjo praktikë është paaftësia për të nisur një hetim individual për PP, pa hetim paralel për vepër penale të ndërlidhur. Ky kushtëzim duket të ketë qenë posaçërisht i dëmshëm për punën e DHKEK-SHF-së dhe Njësisë së Pastrimit të Parave, që është përgjegjëse për hetimin e PP-së në bazë të raportimit të NjIF-it. Si në shumë raste, këto raportime tregojnë aktivitet financiar të dyshimtë dhe rrallëherë ka mundësi për të përcaktuar qartë bazën e një veprë të ndërlidhur penale. Edhe kur mund të nënkuptohet vepra e ndërlidhur penale, në shumë raste është praktikisht e pamundur të përcaktohet nëse fondet specifike janë në fakt, përfitime nga veprimtaria kriminale. Kështu, DHKEK-SHF-ja është në fakt e detyruar të ndërmarrë "hetim paralel" për të çuar përpara hetimin e pastrimit të parave, që është e anasjellta e asaj që kërkohet nga standardet. Deri më sot, kjo rrethanë ka zbehur në mënyrë të konsiderueshme rezultatet nga burimet e rëndësishme të investuara në aktivitetet e DHKEK-SHF-së për të ndjekur penalisht në mënyrë proaktive pastrimin e parave.

236. Statistikat e siguruara nga autoritetet janë pjesërisht të plota dhe nuk paraqesin pamjen e plotë sa i përket funksionimit të zinxhirit të zbatimit të ligjit dhe drejtësisë penale. Tabela në vijim tregon numrin e hetimeve të zhvilluara nga organet përkatëse të zbatimit të ligjit:

Tabela 15:

AZL	2014	2015	2016	2017
DHKEK-SHF	2 / 5 ¹² : nuk ka të dhëna	7 / 24 / 3: nuk ka të dhëna	2 / 2 / 0: nuk ka të dhëna	1 / 2 / 1: nuk ka të dhëna
DKO-SHIF	32 / 5	19 / 5	17 / 4	15 / 1
Dogana	N/A	3 / 18 / 26: nuk	1 / / 10 (rast i	1 / / 10 (rast i

¹² Numri i rasteve të hetuara / numri i personave fizikë / numri i personave juridikë / numri i aktakuzave

		ka të dhëna	hapur)	hapur)
--	--	-------------	--------	--------

237. Siç është përmendur në analizën për RM 6, gjatë vizitës në terren DHKEK-SHF-ja ka raportuar paraqitjen e gjithsej 8 kallëzimeve penale në PSRK për PP-në gjatë periudhës 2015-2017, me vetëm 4 prej tyre bazuar në raportimet e NjIF-it (numri i përgjithshëm i raportimeve të NjIF-it të PK-ja ishte 322 në të njëjtën periudhë).

238. Deri më tani nuk janë siguruar statistika të cilat t'i mundësojnë ekipit të vlerësimit të përcjellë numrin e aktakuzave të kategorizuara sipas AZL-së kompetente që ka zhvilluar hetimin bazë. Sa i përket ndjekjes penale të PP-së, statistikat e mëposhtme janë siguruar nga Këshilli Prokurorial i Kosovës, i cili ka mekanizëm statistikor për të përcjellë veprat penale:

Tabela 16:

Viti	Bartur (nga periudha paraprake)		Pranuar (gjatë vitit)		Gjithsej raste të hapura		Të zgjidhura (gjatë vitit)		Të pazgjidhura (në fund të vitit)	
	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona
2015	30	83	9	27	39	110	7	15	32	95
2016	31	76	4	7	35	83	6	17	29	66
2017	29	76	8	23	37	99	7	16	29	82

239. Nëse marrim vitin 2016 si vit shembull, duhet theksuar se vetëm 4 raste të reja për PP-në i janë sjellë PRSK-së, ndërkohë që dy prej tyre me shumë gjasë e kanë prejardhjen nga DHKEK-SHF dhe pjesa tjetër nga DKO-SHIF dhe Dogana e Kosovës. Mund të supozohet edhe se shumica e 29 rasteve të bartura nga periudhat paraprake kanë qenë rezultat i hetimeve të DKO-SHIF-së. Ato 6 raste të zgjidhura nga PSRK-ja në vitin 2016 rezultuan në 3 aktakuza, ndërsa 3 rastet e tjera u hodhën poshtë. Trendi për vitin 2017 është praktikisht i njëjtë.

240. Në Raportin Vjetor 2017 të Koordinatorit Kombëtar për Luftimin e Krimit Ekonomik (KKLKE) janë dhënë statistika shtesë ku thuhet se në vitin 2017 PSRK-ja ka trajtuar gjithsej 37 raste të PP-së, nga të cilat 29 janë zgjidhur deri në fund të 2017. Pa statistikat e DKO-SHIF-së nuk mund të bëhen përlogaritje të besueshme sa i përket përqindjes së rasteve të PP-së të hedhura poshtë nga PSRK-ja, mirëpo bazuar në të dhënat e KPK-së dhe KKLKE-it mund të thuhet se shumica e lëndëve që barten nga viti në vit tejkalon dukshëm (pesë ose gjashtëfish) shumën e rasteve që zgjidhen në baza vjetore.

241. Edhe pse në disa raste lëndët e grumbulluara mund të jenë për shkak të vonesës në procesin hetimor, përfshirë afatet kohore të zgjatura për bashkëpunimin ndërkombëtar dhe NNJ-në, ky nuk mund të jetë shpjegimi kryesor. Arsyeja tjetër për lëndët e grumbulluara (dhe ngurrimi i përgjithshëm i PSRK-së që të merret me rastet e PP-së) mund të jetë i rrënjësor në funksionin institucional të PSRK-së që përqendrohet në krimin e profilin e lartë dhe në ngarkesën e punës me raste të tilla. Duhet të kuptohet se PSRK-ja u krijua për t'u përqendruar në vepra penale me kërcënim të lartë si terrorizmi, gjenocidi, krimet kundër njerëzimit dhe krimet e luftës, krimi i organizuar, etj., ku i është dhënë kompetencë e vetme. Me vetëm 12 prokurorë të punësuar në PSRK, vëllimi i punës ka qenë shumë i lartë –me rreth 60 lëndë për prokuror në një moment të caktuar. PSRK-ja gjithashtu ka 4 ekspertë për të ndihmuar në radhë të parë me analizën financiare, edhe pse me sa duket disa nga këto pozicione kanë qenë të lira për periudha të ndryshme dhe në çdo rast të tillë, masat e marra nuk janë të mjaftueshme për të mbështetur ndonjë numër më të madh të ndjekjeve penale për PP-në dhe konfiskimet e ndërlydhura, që duhet të jenë objekt i autoriteteve të Kosovës.

242. Kështu, ngarkesa me lëndë dhe potencialisht kompleksiteti financiar mund të jenë pengesë dhe/ose faktor shkurajues për të çuar përpara rastet e pastrimit të parave. Së paku, kjo do të ndikonte në sasinë e rasteve të pastrimit të parave të trajtuara. E thënë kjo, nuk duket se PSRK-ja të ketë vendosur ndonjë prag të bazuar në vlerë ose në kërcënim për rastet e PP-së që është e gatshme të procedojë, përveç standardit të fuqisë së provës. Në të njëjtën kohë, Procedurat Standarde të Operimit për Përzgjedhjen e Shënjestrave të Krimeve të Rënda dhe Ekipet Hetimore Ndërinstitucionale përcaktojnë një sërë kriteresh, përfshirë aspektet që lidhen me të ardhurat nga krimi. Grupi Punues që zbaton këto PSO duket se aktualisht po funksionon, mirëpo nuk ka qenë kështu gjithmonë. Grupi Punues merret me raste, shpesh me të dhëna dhe me praninë e NjIF-it në takimet e Grupit Punues. Statistikat specifike për rastet e shqyrtuara nga ky Grup Punues nuk i janë vënë në dispozicion ekipit të vlerësimit.

243. Në këtë kontekst, duhet të theksohet se transferimi i vazhdueshëm i rasteve nga prokurorët e EULEX po krijon presion shtesë të vëllimit të lëndëve të PSRK-ja, që në këtë situatë nuk mund të lehtësohet nga 5 pozitat e lira të hapura, gjë që do të sillte numrin e prokurorëve të PSRK-së në 17. Mënyra logjike për të trajtuar lëndët e prapambetura është rishikimi i ekskluzivitetit të PSRK-së për ndjekjen penale të PP-së, që aktualisht po propozohet nga projekte në legjislacion. Si alternativë e dytë në rast se propozimet legjislative nuk realizohen, është të rekomandohet krijimi i procedurës dhe praktikës sistematike për delegimin e rasteve të PP-së të prokurorët e tjerë jashtë PSRK-së, në bazë të një pragu të caktuar të vlerës ose kërcënimit, duke ruajtur kompetencën e PSRK-së mbi rastet më të rëndësishme të profilit të lartë. Duket se po bëhen përpjekje nga PSRK-ja dhe KKLKE për të përgatitur trajnime për prokurorë jo të PSRK-së që t'i përgatisin për trajtimin e rasteve të PP-së në të ardhmen.

244. Sa i përket dënimeve, Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka siguruar këto statistika:

Tabela 17:

Viti	Bartur nga periudhat paraprake	Raste të reja të pranuar	Gjithsej raste të hapura	Gjithsej persona të akuzuar	Dënime me burgim	Persona të dënuar me burgim	Raste të hedhura poshtë (shfajësim)
2014	1	4	5	10	2	4	
2015	3	2	5	9	0	0	
2016	5	3	8	28	2	3	
2017	6	2	8	28	0	0	

245. Kështu, gjatë periudhës 4-vjeçare në vitet 2015-2017 u dhanë gjithsej 4 dënime, që arrinin në një mesatare prej një dënimi në vit. Duke krahasuar përpjesëtimin e aktakuzave të PSRK-së për PP-në dhe numrin e dënimeve, pabarazitë ndërmjet rasteve të hapura dhe dënimeve (duke pasur parasysh numrat e përgjithshëm të ulët) nuk duken shumë të habitshme, duke marrë parasysh numrin në rritje të rasteve të bartura nga viti në vit. Këto statistika tregojnë se PSRK-ja po ndjek penalisht minimumin e rasteve të PP-së.

246. Në përgjithësi, pengesa e rrjedhës së lëndëve që krijohet në PSRK rezulton në humbje të konsiderueshme të burimeve nga NjIF-i dhe DHKEK-SHF-ja sa i përket arritjeve. Në thelb, kjo nënkupton për NjIF-in se vlera e shtuar unike që rrjedh nga raportimi spontan rezulton në përfitime afër 0% për zinxhirin e drejtësisë penale më poshtë. Më pas, pasi DHKEK-SHF-ja nuk është në gjendje të ndjekë PP individual bazuar në materialet e NjIF-it, funksioni thelbësor i zbatimit të ligjit i paraparë nga korniza për PPP-në për të mbrojtur sistemin financiar nga pastrimi i parave është pothuajse tërësisht i dëmtuar.

247. Në këto rrethana kufizuese, një tjetër vështirësi është që AZL-të nuk marrin asnjë informatë kthyesë nga PSRK-ja sa i përket ecurisë së rasteve të tyre në gjykata. Ky informacion mund t'u sigurojë AZL-ve orientim sa i përket strategjive hetimore dhe pragjeve të provave që konsiderohen të përshtatshme nga gjykatat. Nga informacionet e ofruara del se ka qenë e vështirë për ekipin e vlerësimit të gjykojë rreth mesatares së kohëzgjatjes së hetimeve, ndjekjeve penale dhe procedurave gjyqësore. Mirëpo duhet të vihet re se nga disa shembuj të cituar më poshtë kohëzgjatja e plotë e procesit të drejtësisë penale, duke filluar nga hetimi në procesin gjyqësor mund të zgjasë disa vite (shih, për shembull, rastin Sitnica, që u iniciua në vitin 2013 dhe procedurat gjyqësore janë ende në vazhdim e sipër).

Koherenca e hetimeve dhe ndjekjeve penale të PP-së me kërcënimet e profilit e rrezikut dhe politikat vendore për PPP-në

248. Sikurse është vërejtur në analizën e RM 1, sistemi i masave ekzistuese për të vlerësuar kërcënimet dhe rreziqet kriminale në Kosovë përbëhet nga një sërë mjeteve, përfshirë VKR-në, SOCTA-n dhe njësitë e analizës së rrezikut që funksionojnë në mënyrë të përhershme pranë Qendrës për Menaxhim të Integruar të Kufirit (QMIK) dhe Doganës së Kosovës. Për qëllime të RM 7, këto mjete të marra së bashku zakonisht identifikojnë shtrirjen e kërcënimeve endemike dhe karakteristike për Kosovën, përkatësisht: korrupsionin, veprat tatimore, krimet lidhur me prokurimin dhe procesin e privatizimit, kontrabandën, trafikimin me qenie njerëzore, krimin e organizuar, krimet e drogës, krimin kibernetik, mashtrimin dhe krime të tjera financiare. Megjithatë, mungesa e integritetit ndërmjet mjeteve të lartpërmendura të vlerësimit dhe metodologjive të ndryshme që janë përdorur, çon në një kuptim të fragmentuar nga autoritetet e Kosovës lidhur me kriminalitetin bazë dhe vëllimin e strukturën e të ardhurave nga krimi.

249. Në këtë kontekst, përgjigja e agjencive të zbatimit të ligjit dhe prokurorisë ndaj PP-së mund të konsiderohet vetëm si e pjesshme në aspekt të kalibrimit të gjetjeve nga vlerësimi i rrezikut dhe i kërcënimeve që është bërë në Kosovë. Për organet e zbatimit të ligjit, procesi i SOCTA-s në veçanti duket se merr përparësi më të madhe se sa VKR-ja, ndoshta nga që udhëhiqet nga Ministria e Punëve të Brendshme, që është organi mbikëqyrës i Policisë së Kosovës. Mirëpo SOCTA nuk përqendrohet në PP-në. Mekanizmat e vlerësimit të rrezikut në MIK dhe DK janë dukshëm më të bazuara në operacione dhe pasqyrojnë realitetin në terren, mirëpo as ata nuk kanë përqendrim te PP-ja.

250. Funkcionet e Koordinatorit Kombëtar për Luftimin e Krimit Ekonomik janë mjaftueshëm të gjera dhe përfshijnë përgjegjësi sa i përket bashkërendimit për PPP-në. Në të njëjtën kohë, ekipit të vlerësimit i është dukur se Koordinatori kryesisht përqendrohet në çështje që kanë të bëjnë me sekuestrimin dhe konfiskimin. Mungesa e përqendrimit specifik te PP-ja është pjesërisht e logjikshme në rrethanat aktuale institucionale dhe procedurale, duke pasur parasysh se NjIF-i ka marrë rol udhëheqës në çështje të PPP-së dhe se PSRK-ja ka përgjegjësinë e vetme për hetimin dhe ndjekjen penale të rasteve të PP-së (shih RM 7). Sidoqoftë, nëse kjo rrethanë ndryshon dhe hetimi e ndjekja penale u delegohen prokurorëve jo të PSRK-së, roli bashkërendues i KKLKE në fushën e PPP-së duhet të rritet, sidomos sa i përket shënjestrimin të agjencive për zbatimin e ligjit dhe veprimeve prokuroriale në fushat me rrezikshmëri të lartë.

251. Autoritetet e Kosovës sigurojnë statistikën e mëposhtme vetëm për një shembull të kriminalitetit të lidhur me vepra të ndërlidhura penale. Për të plotësuar mangësitë, shifrat janë nxjerrë nga burime të kombinuara (përgjigjet e pyetësorëve të vlerësimit të ndërsjellë, Policia e Kosovës, Këshilli Prokurorial i Kosovës, SOCTA), të cilat në disa raste ofrojnë statistika kontradiktore. Edhe pse mund të supozohet se mospërputhjet statistikore janë për shkak të metodave të ndryshme të mbledhjes së statistikave, statistikën e paraqitura më poshtë nuk mund të konsiderohen si plotësisht të sakta dhe paraqiten vetëm për qëllime treguese:

Tabela 18:

Numri i veprave penale të raportuara / dënimeve (persona)	2014	2015	2016	2017
Pjesëmarrje në një grup kriminal të organizuar dhe shantazh	165 / nuk ka të dhëna	156 / 2	83 / nuk ka të dhëna	94 / nuk ka të dhëna
Terrorizëm, përfshirë financim të terrorizmit	105 / 15	74 / 16	103 / 17	81 / 7
Trafikim me qenie njerëzore dhe kontrabandim me migrantë	118 / nuk ka të dhëna	86 / nuk ka të dhëna	40 / 3	50 / nuk ka të dhëna
Shfrytëzim seksual, përfshirë shfrytëzimin seksual të fëmijëve	93 / 24	67 / 5	76 / 14	74 / 16
Trafikim i paligjshëm me lëndë narkotike dhe substanca psikotrope	Nuk ka të dhëna			
Trafikim i paligjshëm me armë	793 / 177	654 / 145	991 / 192	1.256 / 219
Trafikim i paligjshëm me mallra të vjedhura dhe të tjera	44 / 13	19 / 3	25 / 1	6 / nuk ka të dhëna
Korrupsion dhe ryshfet	153 / 67	166 / 80	180 / 140	134 / 88
Mashtrim	1.011 / 67	860 / 80	849 / 140	668 / 88
Falsifikim i parave	21 / nuk ka të dhëna	17 / nuk ka të dhëna	20 / nuk ka të dhëna	18 / nuk ka të dhëna
Falsifikim dhe pirateri e produkteve	25 / 0	27 / 1	7 / 0	23 / 1
Krim mjedisor	Nuk ka të dhëna			
Vrasje dhe lëndim i rëndë trupor	35 / nuk ka të dhëna	25 / nuk ka të dhëna	Nuk ka të dhëna	
Rrëmbim, pengim i paligjshëm dhe marrje peng	82 / nuk ka të dhëna	103 / nuk ka të dhëna	63 / 66	74 / nuk ka të dhëna
Grabitje ose vjedhje	404 / nuk ka të dhëna	281 / nuk ka të dhëna	Nuk ka të dhëna	
Kontrabandim (përfshirë lidhur me doganën, detyrimet e akcizës dhe ato tatimore)	181 / nuk ka të dhëna	Nuk ka të dhëna		

Numri i veprave penale të raportuara / dënimeve (persona)	2014	2015	2016	2017
Krime tatimore (që kanë të bëjnë me tatimet direkte dhe indirekte)	69 / nuk ka të dhëna	93 / nuk ka të dhëna	70 / 14	60 / nuk ka të dhëna
Shtrengim me anë të kanosjes ose dhunës	52 / nuk ka të dhëna	61 / nuk ka të dhëna	Nuk ka të dhëna	
Falsifikim	Nuk ka të dhëna			
Pirateri	Nuk ka të dhëna			
Krim kibernetik	24 / nuk ka të dhëna	21 / nuk ka të dhëna	Nuk ka të dhëna	
Manipulim me informatat e brendshme dhe manipulim i tregut	Nuk ka të dhëna			
Tjetër: I paspecifikuar	84 / nuk ka të dhëna	65 / nuk ka të dhëna	80 / nuk ka të dhëna	55 / nuk ka të dhëna

252. Autoritetet e Kosovës nuk mbajnë (nuk kanë siguruar) statistika të kategorizuara të PP-së sipas hetimeve apo ndjekjeve penale të kriminalitetit bazë në themel të tyre, prandaj, nuk mund të bëhet krahasim i kryqëzuar për të përcaktuar nëse PP-ja ndiqet penalisht sa duhet dhe proporcionalisht për të gjitha veprat e ndërlidhura penale. Në të njëjtën kohë, kur flitet për statistikat e përgjithshme për dënimet, shpërpjesëtimi ndërmjet veprave të ndërlidhura penale dhe pastrimit të parave bëhet shumë i dukshëm. Kjo është veçanërisht e habitshme në lidhje me veprat e tilla si korrupsioni dhe mashtrimet, ku mund të hamendësohet se të ardhurat janë krijuar dhe pastruar më rregullisht, por rezultatet gjyqësore në lidhje me PP-në janë të papërfillshme. Bazuar në intervistat në terren, rezulton se një nga arsytet për këtë mospërputhje sasiore të dukshme duket të jetë tendenca në përgjithësi e PSRK-së që rregullisht të largojë PP-në nga aktakuzat, me një tendencë të ngjashme të gjykatave për ta hequr PP-në gjatë fazës së gjykimit.

253. Burimi i vetëm i besueshëm, ku lidhja midis veprës penale dhe veprimtarisë së PP-së mund të kuptohet në mënyrë të besueshme janë rastet e pakta që i janë paraqitur ekipit të vlerësimit ose në fazën e aktakuzës, ose në atë të dënimit.

Rasti "NATA"

254. Vepra penale kryesore: lehtësim i prostitucionit. Lloji i rastit: vetëpastrim. Ky rast u iniciua me kërkesë të Drejtorisë për Trafikim me Qenie Njerëzore të PK-së që iu parashtrua DKO-SHIF të PK-së për të zhvilluar hetime financiare (mars 2012). SHIF ndërmori veprime hetimore dhe kërkoi/pranoi informata nga NjIF-i dhe arriti në përfundimin se rasti përmbante elemente të pastrimit të parave. Fillimisht, hetimi financiar u zhvillua në lidhje me 10 persona, prej të cilëve 8 ishin shtetas të huaj. Analizimi i transaksioneve financiare, kryesisht të atyre që ishin transfertat dhe depozita, u zgjerua për të përfshirë edhe dy persona të tjerë (përfshirë personin X). Personi X u identifikua duke përcjellë transfertën në llogarinë e tij të shumës prej 11.000 euro nga llogaria e të dyshuarit kryesor. Transferta u bë me përshkrimin "Hua", me këtë rast iu paraqit kërkesë NjIF-it ku tregohej se personi X merrte në llogaritë e tij bankare diku rreth 2.000.000 euro. U bë raportimi te prokurori, i cili mori vendim për të filluar hetimin. Hetimet përfshinë 8 shtetas të huaj, 7 nga të cilët ishin nga Ukraina dhe një nga Holanda, 5 shtetas ukrainas u shpallën fajtorë për prostitucion dhe me urdhër të gjykatës u deportuan në Ukrainë dhe 2 prej tyre u shpallën fajtorë për prostitucion dhe pastrim parash.

255. Në këtë rast, hetimi fillestar u iniciua për veprat penale të krimit të organizuar, trafikimit me persona, lehtësimit të prostitucionit, pastrimit të parave. Në aktgjykimin e formës së prerë, tre persona të akuzuar me shtetësi të Kosovës u shpallën fajtorë për veprat penale të lehtësimit të prostitucionit dhe pastrimit të parave (ata u dënuan përkatësisht me 4 vite dhe 50.000 euro gjobë, 2 vjet dhe 20.000 euro gjobë dhe 2 vjet dhe 20.000 euro gjobë).

256. Dënimi për pastrim parash u mor duke provuar se të dyshuarit kishin përfituar në mënyrë të paligjshme nga të ardhurat e investimit në patundshmëri dhe duke depozituar para në llogaritë bankare dhe duke i transferuar ato nga një llogari në tjetrën me qëllim fshehjen e prejardhjes së mjeteve. U konfiskuan lloje të ndryshme të pasurisë: patundshmëri dhe tokë,

automjete, fonde në llogaritë bankare dhe para të gatshme. Rasti është ndjekur penalisht me përfshirjen e një prokurori nga EULEX¹³.

Rasti i transfertave me Kinën

257. Vepra penale kryesore: shmangie nga tatimi. Lloji i rastit: pastrim parash nga pala e tretë. Në vitin 2012, Personi X si pronar i një biznesi u përfshi në shmangie nga tatimi (tatimi për qarkullim përmes shitjeve të padeklaruar, TVSH-ja dhe tatimi për të ardhura personale). Për të fshehur burimin e fondeve dhe për të shmangur raportimin e detyrimit tatimor, Personi X përdori llogarinë bankare të Personit Y për të depozituar fonde dhe më pas i transferoi ato në Republikën e Kinës (gjithsej u kryen 5 transferta). Për shërbimet e tij, Personi Y mori 50 euro për transfertë.

258. Të pandehurit e pranuan fajësinë dhe u dënuan për PP (dënimi u bë në vitin 2015):

- Personi X: 1 vit (me kusht) dhe gjobë prej 7.500 euro (vetëpastrim);
- Personi Y: 6 muaj (me kusht) dhe gjobë prej 500 euro (PP me palë të tretë).

Rasti "Sitnica"

259. Vepra penale kryesore: trafikim droge. Lloji i rastit: vetëpastrim. Drejtoria për Hetimin e Trafikimit me Narkotikë paraqiti kërkesë pranë SHIF për të filluar hetim financiar. Personi i dyshuar kryesor X ishte grup kriminal i organizuar me bazë në një vend të Evropës Perëndimore dhe i përfshirë në trafikimin e drogës. Personi X u ndoq penalisht për trafikimin e drogës në atë vend dhe u largua për në Kosovë, duke ndryshuar mbiemrin e tij që të arratisej. Personi X bleu një sërë pronash që u transferuan te palët e treta. Gjatë hetimit, personi X u përpoq të justifikonte pronën e tij përballë autoriteteve duke pretenduar se këto ishin të ardhura nga një biznes, megjithatë, ekspertiza e kryer nga ATK-ja për biznesin tregoi se kjo nuk ishte e vërtetë. Në këtë rast, u bë shkëmbim i informacionit me Gjermaninë. Fillimisht u sekuestruan sendet e mëposhtme: një shtëpi, dy apartamente, tokë, etj. Rasti është ende në procedurë gjyqësore.

Rasti "Perëndimi-West"

260. Vepra penale kryesore: trafikim droge. Lloji i rastit: pastrim parash nga pala e tretë. Rasti është iniciuar nga Drejtoria për Hetimin e Trafikimit me Narkotikë. Të dyshuarit ishin shtetas të huaj nga një shtet në rajonin e Ballkanit, të cilët u arrestuan teksa transportonin heroinë. SHIF nisi hetimin financiar, duke bërë të mundur identifikimin se pasuritë në posedim të të dyshuarve ishin përftuar nga shitja e lëndëve narkotike. U zhvillua bashkëpunim ndërkombëtar me vendin e origjinës, që konfirmoi se ai i përkiste një grupi të krimit të organizuar. Nipi i personit X ishte i përfshirë në pastrimin e parave, pasi kishte blerë një banesë gjatë periudhës së paraburgimit të personit X. Nipi i personit X do të ishte akuzuar se kishte mundësuar PP-në nga pala e tretë, mirëpo ai vdiq para ngritjes së aktakuzës. Në këtë rast, është bërë konfiskimi i banesës dhe i një automjeti (vendimi PKR.P. nr. 4/15).

Rasti "Gjyqtari i Klinës"

261. Përshkrimi i hollësishëm i rastit "Gjyqtari i Klinës" jepet në kuadër të RM 6. Rasti ka rezultuar me një dënim në vitin 2017, përfshirë burgimin me 4 vite e 6 muaj, gjobë prej 5.000 euro, konfiskimin e 6 pasurive të paluajtshme në Kosovë dhe Malin e Zi, një automjeti dhe parave të gatshme. Veprat penale kryesore në këtë rast ishin nxjerrja e paligjshme e vendimeve gjyqësore dhe keqpërdorimi i detyrës zyrtare (vepra të ndërlidhura me korrupsion). Akuzat për PP-në ishin për vetëpastrim, që kishte ndodhur ndërmjet viteve 2002 dhe 2008 dhe aktakuza u ngrit nga PSRK-ja në vitin 2011. Mirëpo Gjykata Supreme e ka dërguar rastin në rigjykim në gjykatën themelore, bazuar në mospërputhje procedurale të identifikuar gjatë trajtimit fillestar të rastit.

Rasti "Vëllezërit Kqira – Paradiso"

262. Një rast i njohur, që ilustron vështirësitë me të cilat përballen autoritetet e Kosovës në ndjekjen e krimit të organizuar dhe të ardhurave nga krimi, është rasti "Vëllezërit Kqira" në Prizren. Në këtë rast është ngritur aktakuza fillestare për PP, mirëpo me pas, akuzat u hodhën poshtë. Grupi i organizuar kriminal ishte përfshirë në aktivitete të paligjshme të lojërave të fatit,

¹³ Për qëllime të këtij vlerësimi, rastet që përfshijnë EULEX-in në fazat e ndjekjes penale dhe aktakuzës janë marrë për të ilustruar rrezikun dhe profilin e kërcënimit të rasteve në Kosovë, sidoqoftë ky vlerësim nuk e përfshin në fushëveprimin e vet rishikimin e efektivitetit të EULEX-it.

fajde (duke detyruar debitorët të paguajnë interesa të mëdha) dhe trafikim droge. Prokuroria angazhoi një ekspert për të vlerësuar vlerën e pasurisë së paligjshme të të pandehurve, me ç'rast u konfiskuan 300.000 euro para të gatshme ndërsa hotelet u sekuestruan. Mirëpo gjykata nuk u pajtua me gjetjet e prokurorisë, duke përmendur mospërputhje ndërmjet kohës së kryerjes së veprave penale dhe periudhës kur ishte blerë prona. Rasti (përfshirë akuzën për PP) është aktualisht në shqyrtim në Gjykatën e Apelit.

Rasti i "rajonal i pastrimit të parave"

263. Rasti i "rajonal i pastrimit të parave" përshkruhet në RM 6. Ai përfaqëson profilin e rrezikut në Kosovë, që përdoret si juridiksion për sjelljen dhe grumbullimin e të ardhurave nga krime të kryera jashtë, që rrjedhin nga krimi i organizuar, kontrabandimi dhe trafikimi i drogës.

Rasti "Mashtrimi në prokurim në MPB" (rast i EULEX-it)

264. Personi N.V. dhe bashkëpunëtorët e tij përvetësuan 1.4 milionë euro përmes mashtimit me një kontratë të prokurimit publik me Ministrinë e Punëve të Brendshme. Më pas, paratë u pastruan përmes transferimit të kompani të themeluara nga N.V. Ky rast u ndoq penalisht nga një prokuror i EULEX-it dhe u gjykua nga një gjyqtar i EULEX-it, edhe pse dëshmon rreziqet e identifikuar në VKR sa i përket keqpërdorimit dhe mashtimit me prokurim.

Rasti i tregtisë me Kinën (dënim më vete për PP – vendimi i gjykatës PKR nr. 33/14 i datës 28.03.2018)

265. Dy të pandehurit A dhe B pastruan paratë e përfituara nga shmangia e tatimit dhe keqpërdoren lejet. Të pandehurit krijuan dy kompani për tregti mallrash me Kinën. Autoritetet identifikuan skemë për pastrim të parave me bazë tregtinë në bazë të mospërputhjes së rrjedhës së parave të gatshme në dalje kundrejt produkteve të importuara. I pandehuri A u dënua për PP me 3 vjet burgim dhe gjobë 15.000 euro, ndërsa vepra e ndërlidhur penale (shmangia tatimore) kundër tij u hodh poshtë. I pandehuri B u dënua për PP me 2.5 vjet burgim dhe gjobë 10.000 euro. Ndaj të pandehurit B nuk pati akuza të ndërlidhura. Rasti u iniciua në vitin 2009 në bazë të një raportimi nga NjIF-i të PK-ja.

Shembuj të hetimeve në vazhdim e sipër

266. Autoritetet e Kosovës kanë informuar më tej për një sërë hetimesh që po zhvillohen për momentin:

- *Lidhur me korrupsionin*: hetim lidhur me një politikan të profilit të lartë për shmangie nga tatimi dhe pastrim parash i ndërlidhur (me përfshirjen e ATK-së, NjIF-it, PSRK-së dhe PK-së);
- *Kontrabandim i parave të gatshme*: Dogana e Kosovës po heton aktualisht një rast të dyshimtë për pastrimin e parave, ku arsyeja fillestare e dyshimit ishte deklarimi në kufi i parave të gatshme nga një shtetas i huaj, që deklaroi se paratë e gatshme destinoheshin për një biznes në Kosovë. Biznesi u kontrollua dhe operacionet e tij u konsideruan të dyshimta, pasi përfshinin transaksione bankare në llogaritë personale. Ky rast po ndiqet nga Prokuroria Speciale. Në këtë rast, NjIF-i ka ofruar informacion nga vendi i origjinës së parave që besohet të jenë objekt i pastrimit.
- *PP me bazë tregtinë*: në një rast të Doganës së Kosovës sipas treguesve të saj vërehet se ekziston dyshimi i bazuar për pastrimin e parave, pasi një njësi importuese ka importuar mallra dhe në një kohë të shkurtër i ka rieksportuar në të njëjtin vend në Evropën Perëndimore, duke deklaruar kosto dhjetëfish më të lartë të mallrave të njëjta. Dogana e Kosovës, bazuar në dispozitat e një marrëveshjeje ndërkombëtare për ndihmën e ndërsjellë administrative, njoftoi vendin e origjinës së mallrave, por përgjigja nga vendi ishte negative sa i përket dyshimeve për pastrim parash.

267. Në përgjithësi, shembujt e rasteve të hetimeve, ndjekjeve penale dhe dënimeve të përshkruara më lart pasqyrojnë rrezikun dhe profilin e kërcënimit të Kosovës, sidomos kategoritë e rëndësishme të veprave të ndërlidhura penale të identifikuar në VKR dhe SOCTA, përfshirë shmangien nga tatimi, korrupsionin, kontrabandimin, trafikimin me qenie njerëzore dhe trafikimin e drogës. Sa u përket sektorëve, ka tregues të qartë se sektorët e ndërtimit/patundshmërisë dhe lojërave të fatit janë shumë të ndërlidhur me veprimtarinë e pastrimit të parave dhe kjo është reflektuar në ndjekjet penale dhe dënimet për PP-në. Konfiskimet e patundshmërive, përfshirë dhe hoteleve, e konfirmojnë këtë.

268. Përmasa ndërkombëtare e rreziqeve nga pastrimi i parave me të cilin ballafaqohet Kosova po ashtu është pasqyruar në disa raste, ku Kosova është përdorur si juridiksion për vendosjen dhe grumbullimin e të ardhurave nga jashtë, edhe përmes skemave të tregtisë. Ashtu sikurse tregojnë rastet Sitnica dhe Perëndimi-West, Kosova është përdorur gjithashtu si një juridiksion për integrimin e të ardhurave nga veprimtari kriminale nga shtetasit kosovarë dhe të huaj që u përkasin grupeve kriminale të organizuara ndërkombëtare.

269. Pasi është thënë kjo, rastet e paraqitura në gjykatë të gjykuara më tej janë shumë pak për të konsideruar se reagimi i drejtësisë penale ndaj ndonjë prej këtyre kërcënimeve është i mjaftueshëm. Përfundimi i vetëm në këtë fushë mund të jenë krimet tatimore, të cilat tregojnë korrelacione shkak-efekt ndërmjet proceseve të vlerësimit të rrezikut e kërcënimeve dhe politikave nga njëra anë dhe masave rezultuese të drejtësisë penale nga ana tjetër. Për më tepër, disa prej këtyre rasteve janë të nivelit shumë të ulët (p.sh. rasti i transfertave me Kinën) për t'u konsideruar pjesë e një ushtrimit të priorizimit bazuar në kërcënim apo vlerësim të rrezikut. Duke pasur parasysh natyrën e kufizuar të ushtrimit të VKR-së (p.sh. mungesa e tipologjive udhëzuese të PP-së), si dhe mungesën e korrelacionit me SOCTA-n, mund të arrihet në përfundimin se autoritetet e zbatimit të ligjit orientohen në prioritetet e tyre hetimore nga përvoja e vet dhe të kuptuarit që kanë për situatën në fjalë dhe jo nga ndonjë mekanizëm specifik për përcaktimin e prioriteteve të hetimeve të PP-së apo të çdo tipologjie të PP-së që është në themel të tyre.

270. Sikurse shtjellohet në RM 6, e vetmja zonë e rrezikut ku janë marrë masa efektive për zbutjen e rreziqeve (kryesisht përmes mjeteve të drejtësisë jopenale) është shmangia nga tatimi. Duhet të theksohet gjithashtu se, sipas vëzhgimeve të njëjsteve të zbatimit të ligjit të specializuara për PP-në (sidomos DHKEK-SHIF), shmangia nga tatimi përbën pjesën më të madhe të rasteve që kanë në themel veprimtari të dyshimtë ekonomike dhe pastrim të parave, që kalojnë nëpër radarët e tyre. Në këtë kuptim, duhet të zhvillohen mekanizma më prioritarë të funksionimit që të sigurohet përqendrimi i duhur i AZL-ve.

271. Çështja e kohëzgjatjes së rasteve është një faktor i madh negativ. Ndoshta shembulli më ilustrues është rasti i gjyqtarit të Klinës, ku ka kaluar 7 vjet që nga dorëzimi i aktakuzës fillestare. Në raste të tjera të përshkruara në këtë seksion, kohëzgjatja e trajtimit të rastit është më e shkurtër, por megjithatë mund të zgjasë deri në 3 ose më shumë vite.

272. Autoritetet e Kosovës e informuan ekipin e vlerësimit se në raste si Paradiso, ku përfshihet kriminaliteti i dhunshëm i organizuar (që gjithashtu mbizotëron në sektorin e shitjes së karburantit), prokurorët dhe gjyqtarët përballesh me kërcënime fizike dhe frikësim. Kjo sigurisht është alarmuese dhe duhet të parashihen masa shtesë të sigurisë për të mbrojtur gjyqtarët dhe prokurorët që trajtojnë raste të tilla me rrezikshmëri të lartë.

Llojet e rasteve të PP-së që janë ndjekur

273. Sikurse është përshkruar në shembujt me raste më sipër, autoritetet e Kosovës ndjekin raste të PP-së që janë edhe vetëpastrim, edhe pastrim parash nga pala e tretë. Ka të paktën dy raste në të cilat është ndjekur vetëpastrimi ku vepra e ndërlidhur penale është kryer jashtë vendit (rasti Sitnica dhe rasti Perëndimi).

274. Autoritetet e Kosovës kanë ndjekur, së paku në një rast, aktakuzë për PP, ku vepra e ndërlidhur penale nuk dihej (rasti PPS. 66/2011 i datës 1.10.2013) në bazë të aktivitetit të dyshimtë të një personi fizik që tentoi të depozitonte fonde në një llogari bankare. Me sa duket, që nga ajo kohë nuk është ndjekur ndonjë akuzë e vetme për pastrim parash, me përjashtim të dukshëm të rastit të Tregtisë me Kinën të kohëve të fundit. Qëndrimi i PSRK-së nuk është tërësisht i qartë, pasi intervistat në terren me agjenci për zbatimin e ligjit dhe me prokurorë dëshmuar një ngurrim të përgjithshëm për të ndjekur PP të vetme. Në të njëjtën kohë, duket se ka pasur raste që demonstrojnë të kundërtën, edhe në aktakuzën e vitit 2013, edhe në rastin e Tregtisë me Kinën.

275. Dykuptimshmëria në Ligjin për PPP/LFT-në duket se së paku i kontribuon kësaj pjesërisht. Neni 56 (paragrafi 3.1) i Ligjit për PPP/LFT-në thotë se "personi mund të dënohet për vepër penale të pastrimit të parave madje edhe nëse nuk ka qenë asnjëherë i dënuar për vepër të ndërlidhur penale prej së cilës është nxjerrë pasuria e fituar me anë të veprës penale" të pastrimit të parave. Ndërsa në shikim të parë ky nen mund të shërbejë si provë për të kriminalizuar ndjekjen penale individuale të pastrimit të parave, ai gjithashtu mund të interpretohet edhe si provë për të kriminalizuar pastrimin e parave nga pala e tretë (domethënë dënim për personin që ka bërë PP-në, ndërsa një tjetër dënim jepet për personin që ka kryer veprën e ndërlidhur penale). Edhe pse qëllimi i ligjvënësve mbetet i paqartë në lidhje me këtë formulim, nuk ekziston kushtëzim i njëjtë i rreptë i paraparë me nenin 56, që do të kërkonte

dënim për vepër të ndërlidhur penale si parakusht i domosdoshëm për dënim për PP-në. Për më tepër, bazuar në dispozitat korresponduese të paragrafëve 1 dhe 2 të nenit 56 ("përfaqësimet e bëra si pjesë e njëhetimi zbulues"), prova e vetme që kërkohet për veprën penale të PP-së është besimi i kryesit se prona përbën të ardhura nga krimi, në bazë të provave të drejtpërdrejta apo të tërthorta të mbledhura përmes mjeteve të posaçme hetimore.

276. Rasti i Tregtisë me Kinën demonstroi qartë (sikurse konfirmohet nga Gjykata Supreme gjatë intervistave në terren) se nuk kërkohet ndonjë dënim paraprak ose paralel për PP-në. Mirëpo është fakt se PSRK-ja ende nuk ka nisur ndjekje penale të PP individual, që nga aktakuza e vitit 2013. Rasti i Tregtisë me Kinën nuk ishte shembull i aktakuzës më vete për PP, por i një vendimi gjyqësor për të hedhur poshtë akuzat për vepër të ndërlidhur penale. Prandaj, mbetet pyetja nëse PSRK-ja, si çështje e praktikës së përgjithshme, kërkon standard të lartë të provave sa i përket veprave të ndërlidhura penale në mënyrë që të ngrejë aktakuza për PP-në.

277. Përgjegjësia penale e personave juridikë është përcaktuar në përputhje me nenin 40 të Kodit Penal të Kosovës, mirëpo nuk janë siguruar statistika sa i përket asaj nëse personat juridikë janë ndjekur penalisht për veprën e PP-së. Mirëpo disa nga statistikat tregojnë se personat juridikë mund t'i jenë nënshtruar hetimeve (shih statistikat për zbatimin e ligjit më lart), sidoqoftë nuk është e qartë nëse kjo ka qenë vetëm për qëllime të procedurave hetimore apo penale.

Efektiviteti, proporcionaliteti dhe zbindja nga sanksionet

278. Sipas nenit 56 të Ligjit për PPP/LFT-në, pastrimi i parave dënohet deri në 10 vjet burgim ose me gjobë deri në 3 herë më të madhe se shuma e fondeve të pastruara. Sanksionet e tilla janë potencialisht proporcionale dhe zbindëse. Sa i përket efektivitetit të zbatueshmërisë së tyre, vlerësuesit patën vështirësi në bërjen e vlerësimit të duhur, duke pasur parasysh të dhënat e paplota që u siguruan. Megjithatë, nga analiza e rasteve të parashtruara dhe nga aktgjykimet mund të nxirren statistikat në vijim në lidhje me sanksionet për PP-në:

Tabela 19:

Nr. i rastit/referimit	Data	Statusi i gjykimit	Dënimi me burg	Gjoba (euro)
"Nata" / PAKR. nr. 351/2016	2016	Përfundimtar	Personi 1: 4 vite	50.000
			Personi 2: 2 vite	20.000
			Personi 3: 2 vite	20.000
"Transfertat me Kinën" / PKR nr. 175/15	2015	Përfundimtar	Personi 1: 1 vit (me kusht)	7.500
			Personi 2: 0.5 vit (me kusht)	500
"Perëndimi-West" / PKR.P nr. 4/15	2016	Përfundimtar	Person 1: 2 vite	15.000
"Gjyqtari i Klinës" / PKR nr. 642/15		Dërguar nga Gjykata Supreme për rigjykim	Personi 1: 4.5 vite	5.000
"Tregtia me Kinën" PKR nr. 33/14	2018	Gjykata Themelore	Personi 1: 3 vite Personi 2: 2.5 vite	Person 1: 15.000 euro Person 2: 10.000 euro

279. Duhet theksuar se numri i ulët i dënimeve që nga fillimi dëmton efektin zbindës të sanksioneve të parashikuara me nenin 56 të Ligjit për PPP/LFT-në. Në dy raste të paraqitura për ekipin e vlerësimit, sanksionet dënuese ishin në shkallën e mesme (4-4.5 vjet), që duket proporcionale. Një rast kur gjykata mori dënim me kusht, arsyetimi duket i justifikueshëm për shkak të një sërë rrethanash lehtësuese (ishte shkelja e parë ligjore për të dy të pandehurit, i pandehuri i dytë ishte në gjendje të keqe ekonomike).

280. Edhe pse në shumicën e rasteve ka pasur konfiskime, shkalla e gjobave të shqiptuara haptazi anon nga e ulëta. Në një rast (rasti i gjyqtarit të Klinës) u zbatua sanksioni i ndalimit të ushtrimit të detyrave (meqë ky rast është dërguar për rigjykim dhe mund të shërbejë vetëm për qëllime ilustruese në këtë analizë).

281. Në përgjithësi, nga disa raste të gjykuara nga autoritetet e Kosovës, mund të thuhet se autoritetet janë të afta të përdorin lloje të ndryshme të sanksioneve dhe potencialisht në mënyrë proporcionale, megjithatë meqë mungojnë të dhënat e duhura, nuk mund të dilet në përfundime që konfirmojnë nivel pozitiv të efektivitetit në këtë fushë.

Masa të tjera të drejtësisë penale

282. Në fakt, nuk ka mekanizma shtesë në dispozicion të autoriteteve të Kosovës për të ndjekur PP-në jashtë procedurave të rregullta të drejtësisë penale të përshkruara më lart. Ligji nr. 04/L-140 për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë së Fituar me Vepër Penale mund të ketë sjellë disa mjete shtesë për ndjekjen e të ardhurave nga veprat penale, mirëpo ky ligj nuk zbatohet në praktikë për shkak të disa mospërputhjeve terminologjike që e kanë bërë të papërdorshëm në rrethanat juridike të Kosovës.

Përfundimet e përgjithshme për RM 7

283. Autoritetet e zbatimit të ligjit në Kosovë kanë priorizuar hetimin e pastrimit të parave duke e institucionalizuar dhe duke i kushtuar burime të konsiderueshme hetimeve financiare, si në kuadër të hetimeve financiare paralele, ashtu edhe si vazhdimësi e raportimeve të NjIF-it. Në të njëjtën kohë, përpjekjet e gjera të agjencive të zbatimit të ligjit në këtë fushë janë penguar nga pengesat e burimeve në nivelin e prokurorisë.

284. Ndonëse kriminaliteti bazë i ndërlidhur që ndiqet në rastet e PP-së nga agjencitë e zbatimit të ligjit duket të jetë gjerësisht në përputhje me profilin e rrezikut dhe kërcënimit të Kosovës, vëllimi i rasteve që në fund të fundit ndiqen penalisht dhe gjykohen është disi i ulët krahasuar me shkallën e kërcënimit që rrjedh nga kriminaliteti bazë i ndërlidhur dhe PP-ja që rezultojnë në Kosovë. Në ato pak raste të dënimeve për PP-në, sanksionet duket se janë zbatuar në mënyrë proporcionale, megjithatë numri i tyre është tepër i ulët për të pasur ndonjë efekt parandalues të kriminalitetit në Kosovë. Si rezultat, Kosova arrin vetëm në një masë të papërfillshme karakteristikat e një sistemi efektiv për hetimin, ndjekjen penale dhe dënimin për PP-në.

285. Kosova ka arritur nivel të moderuar të efektivitetit me Rezultatin e Menjëhershëm 7.

Rezultati i Menjëhershëm 8 (Konfiskimi)

Konfiskimi i dobisë pasurore, mjeteve dhe pasurive me vlerë të barsvlershme si objektivi i politikave

286. Kosova ka priorizuar konfiskimin e të ardhurave dhe dobive kriminale si objektivi i madh i politikave. Edhe pse ai nuk përmendet në mënyrë të qartë në Strategjinë për PPP/LFT-në, aktivitetet për të përmirësuar regjimin e konfiskimit përfshihen në Planin e Veprimit për PPP/LFT-në, përfshirë edhe sigurimin e konfiskimit të bazuar në vlerë (pasuri në vlerë korresponduese); dhe VKR-ja ka identifikuar ekzekutimin joefikas të vendimeve të konfiskimit si një nga çështjet kryesore.

287. Priorizimi i përgjithshëm i sistemit të sekuestrimit dhe konfiskimit në Kosovë ka qenë në mënyrë efektive objektivi kryesor i institucionit të Koordinatorit Kombëtar për Luftimin e Krimin Ekonomik (KKLKE), që është krijuar posaçërisht për këtë qëllim nga një Marrëveshje Mirëkuptimi e përbashkët ndërmjet Këshillit Prokurorial të Kosovës, Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Ministrive të Drejtësisë, Financave, të Punëve të Brendshme, NjIF-it, Agjencisë kundër Korrupsionit dhe Bankës Qendrore që nënshkruesit e MM-së të bashkëpunojnë aktivisht me KKLKE, sikurse ka konstatuar vizita në terren. Në fakt, Koordinatorin Kombëtar ka autoritet të konsiderueshëm në komunitetin e agjencive për zbatimin e ligjit dhe në mesin e prokurorëve sa i përket kryerjes së detyrave të tij për bashkërendim. Koordinatorin i kushton përpjekje të konsiderueshme ngritjes së vetëdijes në mesin e agjencive të zbatimit të ligjit dhe prokurorëve për çështje të sekuestrimit dhe konfiskimit që e bën përmes trajnimeve dhe seminareve, si dhe me diskutime për raste specifike. Në fakt, duket se këto përpjekje kanë rezultuar në një vetëdije shumë më të lartë për nevojën e ndjekjes së sekuestrimeve dhe konfiskimeve dhe për të zhvilluar hetime financiare paralele për të gjurmuar pasuritë.

288. Koordinatorin Kombëtar publikon raporte tremujore dhe vjetore për gjendjen dhe rezultatet e përpjekjeve për sekuestrim dhe konfiskim nga autoritetet e Kosovës, që synojnë të vlerësojnë gjendjen në këtë fushë. Analiza e paraqitur në këto raporte është mjaft e plotë dhe e ndershme në aspekt të gjykimit të efektivitetit të sistemit të konfiskimit. Në veçanti, raportet e KKLKE pranojnë se përparimi në sigurimin e konfiskimeve "është shumë i ngadalshëm dhe ende jo në nivelin e kërkuar". Duke bërë analiza retrospektive të statistikave për konfiskime ndër vite deri në vitin 2017, KKLKE vë në dukje se "deri më tani kemi vetëm pak vendime përfundimtare që përfshijnë konfiskimin në shkallë të gjerë të pasurive të fituara nëpërmjet veprimtarisë

kriminale". KKLKE gjithashtu ka identifikuar një sërë mangësish sa i përket metodave të raportimit lidhur me sekuestrimet, në veçanti me dështimin e prokurorëve për të raportuar për të gjitha sendet e sekuestruara (p.sh. automjetet), që me sa duket shpesh nuk përfshihen në statistikat përfundimtare të sekuestrimit. KKLKE ka identifikuar edhe probleme të tjera në fazën e gjyqimit, ku gjyqtarët kanë urdhëruar kthimin e përfitimeve/dobive (p.sh. automjetet) të përdorura në kryerjen e një krimi të pandehurit, edhe në rastet kur vendimi i ka shpallur ata fajtorë. Këshillit Gjyqësor të Kosovës i është bërë rekomandim për ta shqyrtuar këtë çështje dhe për të zhvilluar masa që e korrigjojnë këtë praktikë.

289. Në përgjithësi, mund të thuhet se KKLKE është institucion shumë i dobishëm dhe proaktiv në drejtim të monitorimit dhe lehtësimit të efektivitetit të masave të përkohshme dhe konfiskimit në Kosovë. Pa dyshim ka qenë vendim politik pozitiv për ta themeluar këtë organ dhe puna e tij duhet të mbështetet më tej.

290. Kosova ka miratuar legjislacionin të specializuar (Ligji nr. 04/L-140 për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë së Fituar me Vepër Penale), që do të kishte lejuar zgjerimin e kompetencave të konfiskimit, përfshirë ndryshimin e barrës së provës bazuar në mënyrën e jetesës kriminale. Mirëpo ligji i miratuar përmbante mospërputhje me legjislacionin e procedurës penale të Kosovës, prandaj nuk ka pasur aplikim të dukshëm praktik. Ndërkohë që propozimet e reja për të rregulluar këtë problem janë aktualisht në hartim e sipër, Kosova prej vitesh nuk është në gjendje të miratojë legjislacionin e duhur në këtë fushë. Kjo pjesërisht paraqet joefektivitetin e politikës së konfiskimit në nivelin e lartë legjislativ, që pa dyshim është shqetësues duke pasur parasysh profilin e rrezikut të Kosovës.

291. Sikurse u përmend në RM 7, autoritetet e Kosovës rregullisht ndërmarrin hetime financiare paralele për veprat penale që sjellin përfitim dhe gjurmojnë pasuri, edhe pse nuk ka procedura standarde për këtë. Kjo bëhet kryesisht nga Sektori i Hetimeve të Integruara Financiare sa herë merr referime nga drejtori të tjera të PK-së për të ndërmarrë hetime financiare. Sistemi i referimit është disi shqetësues, duke pasur parasysh se mbetet në diskrecionin e departamentit nëse do të angazhohet SHIF ose jo. Në të njëjtën kohë, SHIF ka raportuar se hetimi financiar paralel dhe gjurmimi i pasurive shpesh kanë qenë efektive dhe të dobishme edhe për hetimin e veprave fillestare të ndërlidhura, ku janë identifikuar të dyshuar të tjerë përmes përcjelljes së flukseve financiare. Autoritetet e Kosovës raportuan gjithashtu krijimin e njësisë për rikuperimin e asetëve në kuadër të PK-së, edhe pse nuk është e qartë se deri në ç'masë kjo është funksionale, sidomos duke pasur parasysh faktin se Zyra për Rikuperimin e Asetëve konsiderohet të ketë ekzistuar që nga vlerësimi i fundit i bërë nga PECK në vitin 2014, por ende nuk është paraqitur asnjë rezultat i dukshëm.

292. Krijimi i Agjencisë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar (AAPSK) mund të konsiderohet po ashtu se tregon përqendrimin e autoriteteve të Kosovës në çështje të sekuestrimit dhe konfiskimit. Në të njëjtën kohë, vëllimet e sekuestrimeve dhe konfiskimeve të cilat administrohen nga Agjencia janë ende relativisht të ulëta në përpjesëtim me profilin e përgjithshëm të rrezikut të Kosovës.

Konfiskimi i të ardhurave nga vepra të kryera jashtë dhe në vend dhe i dobive që gjenden jashtë

293. Sistemi i masave të përkohshme në Kosovë para konfiskimit përfshin një sërë elementesh të mundshme: ngrirja (neni 264 i KPP), sekuestrimi i përkohshëm (neni 112 i KPP), konfiskimi i përkohshëm (neni 267), masat e përkohshme për sigurimin e pasurisë (neni 268 i KPP). Arkitektura dhe terminologjia e parashikuar në nenet e ndryshme të KPP-së (versioni në anglisht) duken të jenë shumë të ndërlikuara, ku parashihen një sërë procesesh paralele dhe/ose përsëritje për ngrirjen dhe sekuestrimin.

294. Për shembull, neni 264 parasheh një urdhër të lëshuar nga Prokurori i Shtetit që është i vlefshëm për 72 orë, gjatë kësaj kohe Prokurori duhet menjëherë t'i bëjë një kërkesë gjyqtarit të procedurës paraprake për një "urdhër ndalues" për t'i ngrirë pasuritë. Urdhri ndalues zgjat fillimisht 30 ditë ku gjatë kësaj kohe dhe me një njoftim paraprak caktohet brenda 3 javëve seanca dëgjimore për të shqyrtuar ndonjë kundërshtim nga ata që preken prej urdhrit ndalues. Në seancë, gjyqtari mund të marrë vendim për sekuestrim afatgjatë. Në të njëjtën kohë ekziston edhe një sistem paralel sipas nenit 112 të KPP-së, sipas të cilit prokurori mund të lëshojë urdhër të përkohshëm të sekuestrimit, që zgjat 5 ditë dhe ai duhet të kërkojë nga gjyqtari i procedurës paraprake të lëshojë urdhër për sekuestrimin e përkohshëm, që pastaj zgjat deri në përfundimin e procedurës penale. Ekziston edhe dispozita në nenin 267, që kërkon nga prokurori të paraqesë kërkesë për sigurimin e pasurisë brenda 60 ditëve nga konfiskimi i përkohshëm i saj. Gjatë diskutimeve në terren nuk u bë e qartë se cila është procedura që ndiqet normalisht nga autoritetet e Kosovës dhe se si ato e interpretojnë logjikën e KPP-së. Për

më tepër, u konfirmua se edhe gjyqtarët shpesh i përziejnë dispozitat e ndryshme që kanë të bëjnë me ngrirjen dhe konfiskimin, për shembull ata dërgojnë urdhra tek AAPSK-ja të merret me pronat e ngrira, gjë që nuk është në sferën e saj të përgjegjësisë.

295. Për më tepër, ekziston edhe mundësia e ngrirjes nga NjIF-i që mundëson pezullimin e transaksioneve për një periudhë deri në 48 orë. Sikurse është shtjelluar në kuadër të RM 6, urdhrat e ngrirjes së NjIF-it çojnë drejt një mesatareje të sekuestrimit për një vit, që është pothuajse e papërfillshme. Prandaj, duket se kjo masë e përkohshme nuk ka pothuajse asnjë rezultat në aspektin e efektivitetit për sistemin e sekuestrimit dhe konfiskimit.

296. Në përgjithësi, autoritetet e Kosovës janë pajtuar që dispozitat dhe procedurat e konfiskimit kanë nevojë për reformim dhe kanë bërë propozimet e nevojshme për projektin e ri të KP-së dhe KPP-së.

297. Autoritetet e Kosovës ofruan vetëm statistika të grumbulluara për ngrirjen dhe sekuestrimin e bërë sipas KPP-së, gjë që e bën të pamundur gjykimin e efektivitetit të elementeve të ndryshme të sistemit të ngrirjes ose sekuestrimit të përshkruar më sipër.

298. Statistikat e siguruara nga autoritetet e ndryshme po ashtu japin një pamje shumë të ndryshme sa i përket vëllimit dhe numrit të sekuestrimeve dhe konfiskimeve. Autoritetet e ndryshme, si KKLKE dhe AAPSK mbajnë të dhënat e veta, të cilat rrjedhin nga burime të ndryshme. Në të njëjtën kohë, disa nga këto të dhëna nuk janë mjaftueshëm të detajuara që të mundësojnë dhënien e gjykimit të duhur mbi efektivitetin e sistemit.

299. KKLKE mban statistika për fondet e ngrira plus sekuestrimet dhe statistika të veçanta për konfiskimet.

Tabela 20:

Periudha	Gjithsej sekuestrime dhe ngrirje (euro)	Gjithsej konfiskime (euro)
Janar-dhjetor 2017	15.237.208,76	1.330.133,88
Janar-dhjetor 2016	60.411.328,00 – 70.411.328,00	1.222.005,86
		+(333.534,92)
Janar-dhjetor 2015	20.568.934,00	70.487,00
Janar-dhjetor 2014	31.000.000,00	525.854,91 – 1.025.854,91

300. Me sa duket, këto statistika janë nxjerrë nga databaza e Prokurorisë së Shtetit dhe nuk janë ndarë sipas llojit të veprës penale. Ajo çka këto statistika paraqesin është vëllimi shumë i ulët i konfiskimeve përfundimtare kundrejt sekuestrimit dhe ky është një trend shumëvjeçar, që mund të shpjegohet me vështirësi duke iu referuar vonesës së rasteve të bartura nga viti në vit.

301. Në të njëjtën kohë, raportet e KKLKE paraqesin analizë të detajuar të rezultateve të konfiskimit dhe raste specifike në themel të tyre. Për shembull, sa i përket statistikave të konfiskimit nga viti 2017, këto pothuajse janë gjeneruar tërësisht nga gjykimi i Gjykatës së Apelit lidhur me rastin e gjykatësit të Klinës (shih përshkrimin e rastit në RM 6 dhe 7), që arrinte në 1.2 milionë euro. Në të njëjtën kohë, ekipi i vlerësimit u informua se më pas, në vitin 2018, Gjykata Supreme e ktheu rastin për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë, prandaj vëllimi i konfiskimeve për vitin 2017 sërish bëhet i papërfillshëm.

302. Duhet vënë në dukje se rasti i gjyqtarit të Klinës është shumë tregues sa i përket përmasës së tij ndërkombëtare, pasi përfshinte gjurmimin dhe sekuestrimin e pasurisë që gjyqtari e kishte përfituar jashtë vendit. Për më tepër, prokurori i rastit paraqiti propozim për konfiskim në bazë të nenit 6 të Ligjit për Kompetencat e Zgjerruara për Konfiskim, që iu paraqiti ekipit të vlerësimit si kryesisht jofunksional për shkak të mospërputhjeve me KPP-në. Ky është qartazi rast i tentimit për ta përdorur këtë ligj (ka pasur edhe disa tentativa të tjera), mirëpo deri më tani nuk janë marrë vendime përfundimtare për konfiskim sipas këtij ligji.

303. Duhet të theksohet se deri në vitin 2016 edhe prokurorët e EULEX-it kanë kontribuar për një pjesë të pasurive të sekuestruara (rreth 25 milionë euro në vitin 2016).

304. Mekanizmat statistikorë në dispozicion të autoriteteve të Kosovës për fat të keq nuk japin mundësinë për të bërë dallimin ndërmjet dobive të sekuestruara/konfiskuara të krimit kundrejt mjeteve/instrumenteve të përdorura. Mirëpo nga rastet e përfunduara deri tani është e qartë se këto mjete/instrumente po konfiskohen rregullisht.

305. Shifrat nga viti 2016 janë gjeneruar nga pak raste të mëdha, më i madhi prej të cilëve është rasti NATA (shih përshkrimin e rastit në RM 7), i cili u mbyll në tremujorin e fundit të vitit 2016 me një konfiskim të përgjithshëm prej rreth 600.000 euro, përfshirë dy apartamente, një hotel, dy prona me tokë, 11 automjete dhe 44.000 euro në para të gatshme.

306. Një nga konfiskimet më të mëdha të vitit 2016 rezultoi në 400.000 euro të konfiskuara dhe u arrit si rezultat i marrëveshjes për pranimin e fajësisë dhe kthimin e fondit në buxhetin e Ministrisë së Shëndetësisë. Rasti kishte të bënte me keqpërdorimin e detyrës zyrtare nga një zyrtar i Ministrisë së Shëndetësisë dhe me mashtrim, ndaj nuk pati akuza për pastrim parash.

307. Një tjetër rast që ndodhi në vitin 2016 i njohur si PAKR. nr. 216/15 ia vlen të theksohet, pasi rezultoi në konfiskimin e dy apartamenteve me vlerë 122.000 euro, ku përfshihej edhe një palë e dëmtuar. Pala u udhëzua të ngrejë padi civile për të marrë kompensim.

308. Për më tepër, një shifër e veçantë prej 330.000 euro përfshinte kthim të tatimeve në buxhetin e shtetit nga një grup këngëtarësh (i ashtuquajtur rasti "Estrada"), që ekipi i vlerësimit nuk mund ta konsiderojë konfiskim, edhe pse pa dyshim ai ka kontribuar në zvogëlimin e ekonomisë së hirtë dhe është vetëm pjesërisht i rëndësishëm në lidhje me konfiskimin.

309. Rasti "Vëllezërit Kqira – Paradiso" (shih gjithashtu përshkrimin në kuadër të RM 7) është një shembull i qartë, ku në vitin 2016 u sekuestruan hotele që u vlerësuan nga AAPSK-ja në 2.5 milionë euro, megjithatë më pas gjyqtari i liri pasuritë duke mos arritur të shohë lidhjen e drejtpërdrejtë në mes të veprës penale dhe blerjes së pasurisë. Ky rast tregon potencialisht mungesën e aftësisë së qëndrueshme të autoriteteve të Kosovës të konfiskojnë të ardhura të tërthorta nga krimi, edhe pse në rastin NATA të ardhurat e tërthorta qartazi u konfiskuan.

310. AAPSK-ja vuri në dispozicion këto statistika:

Tabela 21: Statistikat e integruara për vitin 2016

Statusi	Nr. i vendimeve	Vlera (euro)
Sekuestrim	73	3.052.712,55
Konfiskim	26	749.449,60
Ankand	13	104.981,58
Përdorim	5	56.020,00
Kthim	19	762.013,00

Tabela 22: Statistikat e integruara për vitin 2017

Statusi	Nr. i vendimeve	Vlera (euro)
Sekuestrim	78	868.848,80
Konfiskim	39	387.231,51
Ankand	9	106.454,69
Përdorim	3	48.500,00
Kthim	18	57.864,40
Sekuestrim i parave të gatshme		186.835,23
Konfiskim i parave të gatshme		47.470,98

311. Statistikat e AAPSK janë më të moderuara se sa ato të KKLKE (p.sh. për vitin 2016). Nuk është krejtësisht e qartë për ekipin e vlerësimit se çfarë përbën bazë për mospërputhje. Për më tepër, AAPSK-ja ka ofruar të dhënat në vijim për ekipin e vlerësimit sa i përket vitit 2017 në lidhje me kategorizimin e pasurisë së sekuestruar dhe konfiskuar, të ndarë sipas llojit të pasurisë:

Tabela 23:

Kategoria e pasurisë	Vlera e pasurive në sekuestrim (euro)	Vlera e pasurive në konfiskim (euro)
Mjete transporti	267.065,10	22.901,80
Asete patundshmërie	-	363.000,00
Stoli (ar dhe argjend)	594.906,70	-
Pajisje elektronike	3.791,00	1.240,25

Tjetër	3.086,00	89,46
Gjithsej	868.848,80	387.231,51

312. Nga këto statistika rezulton se vlera për vitin 2017 është përafërsisht 387.000 euro, që është në mospërputhje me informacionin në raportin e KKLKE, sidomos nëse nuk merret parasysh rasti i gjyqtarit të Klinës si konfiskim përfundimtar.

313. Në përgjithësi, të gjitha kategoritë e statistikave paraqesin mospërputhje të konsiderueshme ndërmjet sekuestrimeve dhe konfiskimeve, gjë që shfaq edhe njëherë kapacitetet e konsiderueshme që janë investuar nga autoritetet e zbatimit të ligjit për të gjurmuar pasuritë në fazën e hetimit dhe paaftësinë në përgjithësi të zinxhirit të drejtësisë penale për t'i çuar përpara këto masa të përkohshme drejt fazës përfundimtare të konfiskimit. Për më tepër, rritjet e konfiskimeve në vitin 2014 dhe 2016 u pasuan nga rënie të konsiderueshme në vitin 2015 dhe 2017 (duke marrë parasysh vendimin për rigjykimin e gjyqtarit të Klinës). Mund të shihet, që ngritjet ishin përgjithësisht rezultat i tre ose katër rasteve të rëndësishme, të cilat gjeneronin vëllimin e përgjithshëm të konfiskimeve. Kjo vërteton me të vërtetë përfundimet e arritura nga KKLKE se rezultatet e siguruar deri tani janë disi josistematike. Kjo tregon se Kosova ende nuk i ka krijuar të gjitha elementet e një sistemi efektiv të konfiskimit.

314. Sipas legjislacionit të Kosovës, pasuria me vlerë korresponduese mund të konfiskohet, mirëpo ekipit të vlerësimit nuk iu soll në dijeni ndonjë rast ku kjo të ishte bërë në praktikë. Përveç kësaj, ndërsa në raportin e mëparshëm të vlerësimit të PECK u vërejt se mjetet që synonin të përdreshin për një vepër penale nuk ishin mbuluar në mënyrë të qartë, ekipi i vlerësimit kuptoi se në praktikë, sendet e tilla do të sekuestrroheshin dhe janë sekuestruar. Për këtë, u soll një shembull jo i ndërlidhur me PP-në (konfiskimi i një automjeti me një hapësirë të fshehtë për fshehjen e drogës, që dukej hapur se do të përdorej për trafikimin e drogës, edhe pse brenda saj nuk u gjet drogë). Megjithatë, nuk ishte e qartë nëse u bënë konfiskime përfundimtare për këto sende.

315. AAPSK-ja është institucion i mirëorganizuar për administrimin e pasurive, që tashmë ka përvojë të shumëllojshme në administrimin e llojeve të ndryshme të pasurive, përfshirë operacione të tilla si dhënia me qira e patundshmërive, nëse kjo përcaktohet se sjell fitime të konsiderueshme. Edhe pse ekipit të vlerësimit iu përmend se AAPSK-ja ka 7 profesionistë të angazhuar në vlerësim, me sa duket ka pasur probleme me mungesën e një ekspertize të specializuar të vlerësimit, për shembull, të metaleve dhe gurëve të çmuar. AAPSK-ja shpesh zgjedh ta shesë pasurinë e sekuestruar edhe para se të silllet gjykimi i formës së prerë nëse konsiderohet se pasuritë do të zhvlerësohen shpejt. Me sa duket, në praktikë janë ngritur probleme për këtë nga anëtarët e Këshillit Prokurorial të Kosovës, duke shkaktuar kështu disa pengesa në përpjekjet për të rritur efektivitetin e masave të përkohshme nga KKLKE. Duhet të theksohet se, ndërkohë që standardet ndërkombëtare nuk përshkruajnë ndonjë funksion specifik për të shitur pasuritë përpara vendimit përfundimtar, kjo praktikë nuk është në kundërshtim me standardet ndërkombëtare dhe duhet të ndiqet nëse autoritetet e konsiderojnë atë si zgjidhje më efektive për zhvlerësimin e shpejtë të llojeve të caktuara të pasurive.

316. Fondet, të cilat administrohen nga AAPSK-ja si rezultat i konfiskimeve, më pas transferohen në buxhetin e shtetit. Nuk ka fond special të parashikuar për pasurinë e konfiskuar. Në raste të caktuara, sendi mund të ruhet për përdorim nga vetë autoritetet (p.sh. automjetet).

317. Rasti i vetëm deri më tani që përfshin riatdhesimin e pasurive nga jashtë me të cilin janë përballur autoritetet dhe ku është përfshirë AAPSK-ja është rasti i gjykatësit të Klinës. Duket se në këtë rast ka pasur përpjekje për të bashkëndarë dhe riatdhesuar pasuritë e mbajtura në një vend fqinj, megjithatë marrëveshja nuk mundi të arrihej për shkak të vështirësive juridike dhe teknike për të gjetur pajtim me homologët e huaj.

Konfiskimi i transaksioneve ndërkufitare të deklaruara në mënyrë të rreme ose të padeklaruara të parave të gatshme / INB-ve

318. Për shkak të pozicionit gjeografik dhe diasporës së madhe jashtë, Kosova përballet me një sërë rreziqesh të veçanta lidhur me lëvizjen fizike ndërkufitare të parave të gatshme dhe sendeve me vlerë. Është e qartë që grupet kriminale të organizuara rajonale dhe ndërkombëtare të cilat janë përfshirë në menaxhimin e trafikimit me narkotikë përgjatë rrugës ballkanike përfaqësohen mirë në Kosovë; grupet e organizuara gjithashtu janë të përfshira në

kontrabandimin ndërkufitar të mallrave dhe migrantëve, si dhe trafikimin me qenie njerëzore dhe armë. Pjesëtarët e diasporës së madhe kosovare jashtë vendit marrin pjesë dhe veprojnë si organizatorë të grupeve të krimit të organizuar ndërkombëtar me lidhje me Kosovën. Pastrimi i parave që ndodh ka si rezultat një element të rëndësishëm ndërkufitar. Paratë e gatshme shërbejnë si një nga mjetet për lëvizjen e fondeve brenda dhe jashtë Kosovës, gjë që është demonstruar në disa nga rastet e lartpërmendura (p.sh. shih përshkrimin e rastit "rajonat të pastrimit të parave" në kuadër të RM 6 dhe 7). Tipologjia e përbashkët duket të jetë transportimi i parave të gatshme në Kosovë nga persona fizikë dhe më pas, depozitimi në llogari bankare, ose për qëllime të investimit të mëtejshëm në mallra të ndryshme në Kosovë (p.sh. patundshmëri) ose transferimi më pas jashtë vendit. Ekipi i vlerësimit u informua nga autoritetet se grupet kriminale dhe individët duket se e konsiderojnë këtë lëvizje të fondeve në Kosovë të vlefshme për shkak të besimit të tyre në kontrollet e dobëta për PPP/LFT-në nga bankat në Kosovë. Një rast i tillë, i cili filloi me deklarin e parave të gatshme nga një i huaj në kufi aktualisht po hetohet nga Dogana e Kosovës (shih përshkrimin në RM 7).

319. Për më tepër, ekipi i vlerësimit u informua se qytetarët e Kosovës kanë përdorur mekanizma të transportimit të parave përmes operatorëve turistikë dhe yjeve të estradës që udhëtojnë jashtë vendit për të siguruar grumbullimin dhe lëvizjen e parave të gatshme brenda dhe jashtë Kosovës nga/për pjesëtarët e diasporës. Autoritetet e menaxhimit kufitar (Qendra e Menaxhimit të Integruar të Kufirit) janë shumë të vetëdijshëm për tipologjinë, e konsiderojnë atë me rrezikshmëri të lartë dhe kanë zhvilluar sinjalizues të veçantë të shpërndarë në pikat e kalimit kufitar. Autoritetet e tjera konsiderojnë se kjo praktikë ka marrë fund nga fundi i viteve 1990 dhe nuk janë posaçërisht të vetëdijshëm për faktin se ajo vazhdon edhe në ditët e sotme. Një sërë rastesh që kanë të bëjnë me transportimin e parave të gatshme u identifikuan nga QMIK kohët e fundit, megjithatë nuk ishte e qartë se si saktësisht ata i trajtuan këto raste dhe nëse janë aplikuar sanksione.

320. Për më tepër, kontrabanda e metaleve dhe gurëve të çmuar në Kosovë duket të jetë një çështje madhore e identifikuar edhe nga QMIK dhe që është shënjestruar në disa operacione të zbatimit të ligjit në shkallë të gjerë, që kanë rezultuar me sekuestime edhe në kufi, edhe me kontrole dhe sekuestime në bizneset e tregtarëve të metaleve dhe gurëve të çmuar në Kosovë. Në këtë kontekst, vlerësimi gjithëpërfshirës i rrezikut në sektorin e TMGÇ-ve duhet të bëhet nga autoritetet e Kosovës, përfshirë edhe rishikimin e treguesve potencialë për rreziqet e ndërlidhura me FT-në.

321. Kosova ka zbatuar një sistem të deklarimit në pajtim me nenin 33 të Ligjit për PPP/LFT-në. Përkufizimi i nenit 2, paragrafi 1.17 për instrumentet monetare që duhen deklaruar është mjaft i gjerë sa për të përfshirë të gjitha instrumentet e kërkuara sipas përkufizimit të fjalorit në Rekomandimet e FATF-së. Regjimi i deklarimit zbatohet për çdo person që hyn ose del nga Kosova, si dhe për çdo person që dërgon ose pranon instrumente monetare me anë të postës, dërgesave të mallrave ose korrierëve tregtarë. Pragu është vendosur në 10.000 euro ose më shumë.

322. Sipas paragrafit 7 të nenit 33 të Ligjit për PPP/LFT-në, DK-ja ka fuqinë të konfiskojë instrumentet monetare në kufi që dyshohet se janë të ardhura nga krimi. Kjo duhet t'i njoftohet menjëherë Prokurorit për hetim. DK-ja gjithashtu duhet të informojë NjIF-in.

323. Statistikat në vijim janë paraqitur në lidhje me deklaratat fizike ndërkufitare, megjithatë nuk është bërë ndonjë kategorizim sipas vendndodhjes gjeografike (pikës së kalimit kufitar). Gjithashtu, do të ishte e dobishme të kuptohej përqindja e vëllimit të valutës së transportuar nga personat fizikë dhe juridikë, pasi del se vëllimet kryesore të paraqitura në këtë tabelë me gjasë janë gjeneruar nga transporti fizik i valutës nga bankat.

Tabela 24: Numri dhe vëllimi i deklarimeve¹⁴

Vitet	Personat juridikë	Personat fizikë	Vëllimi hyrës	Vëllimi dalës
2017	664	444	CHF 3.651.877,30 EUR 258.196.446,98 GBP 14.240,00 NOK 606.000,00 RSD 9.573.812.200,00 USD 1.937.300,00	AUD 77.070,00 BAM 680,00 CAD 277.450,00 CHF 28.312.550,00 DKK 2.889.300,00 EUR 3.121.095.205,00 GBP 6.337.530,00

¹⁴ Këto shifra përfshijnë transportimin masiv të parave të gatshme brenda dhe jashtë Kosovës nga bankat.

Vitet	Personat juridikë	Personat fizikë	Vëllimi hyrës	Vëllimi dalës
				HRK 405.260,00 NOK 24.865.350,00 RUB 5.000,00 SEK 9.616.150,00 USD 10.632.010,00
2016	732	424	CAD 19.750,00 CHF 5.314.900,00 DIN 73.232.680,00 EUR 94.512.311,56 GBP 50.000,00 NOK 6.000,00 USD 3.184.900,00	AUD 658.590,00 CAD 1.976.225,00 CHF 441.794.253,50 DKK 4.437.150,00 EUR 681.658.166,75 GBP 17.704.000,00 HKD 38.000,00 HRK 752.705,00 NOK 151.948.100,00 SEK 14.055.140,00 USD 36.186.200,00 MKD 25.000.000,00
2015	606	658	CHF 9.651.595,52 DIN 6.502.110.000,00 EUR 78.964.390,01 HRK 12.880,00 SEK 200.000,00 USD 5.378.710,45	ALL (Lek) 4.781.000,00 AUD 2.002.665,00 CAD 1.120.820,00 CHF 394.626.580,00 DKK 3.100.750,00 EUR 620.629.669,87 GBP 13.433.500,00 HKD 895.000,00 HRK 821.745,00 NOK 98.975.110,00 SEK 28.734.950,00 USD 43.689.340,00

324. Duket se duke pasur parasysh fluksin e udhëtarëve drejt dhe jashtë Kosovës dhe potencialisht vëllimin e parave të gatshme që transportohen nga dhe për komunitetin e diasporës, këto shifra të deklaratave të personave fizikë janë shumë të ulëta. Në vitin 2017, autoritetet e Kosovës nisën një fushatë për të informuar udhëtarët për detyrimin e tyre që të deklarojnë, mirëpo nuk është e qartë nëse kjo ka rezultuar në ndonjë ndryshim.

325. Janë paraqitur statistikat në vijim lidhur me deklaratat e rreme:

Tabela 25:

Vitet	Deklarime të rreme	Pasuri të mbajtura
2017	4	67.430 EUR 497.500 ALL
2016	2	6.802 EUR
2015	6	32.665,50 EUR 5.000 USD

326. Autoritetet kanë konfirmuar gjithashtu se në vitin 2018 ka pasur 3 raste për tentative të transportimit të mjeteve monetare të falsifikuara në vlerën mbi 10.000 euro. Për më tepër, në një rast është identifikuar shuma prej më shumë se 2.1 milionë euro në valutë të falsifikuara dhe është konfiskuar në kufi në bazë të profileve të rrezikut të zhvilluara nga QKMK-ja.

327. Ka pasur një dyshim për pastrim parash në vitin 2015 (rasti ende nuk ka përfunduar). Mirëpo në përgjithësi, këto statistika nuk përputhen me nivelin e lartë të vetëdijesimit të autoriteteve të Kosovës lidhur me rreziqet që kanë të bëjnë me transportin ndërkufitar të parave të gatshme. Gjithashtu, nga statistikat e dhëna rezulton se pavarësisht njohurive, në fund të fundit efektiviteti i përpjekjeve është ende i ulët në këtë fazë. Duket se pjesa më e madhe e MIK, duke qenë strukturë efektive dhe e integruar mirë ku hyjnë edhe MPB dhe DK, ende përqendrohet kryesisht te prioritetet tradicionale të zbatimit të ligjit për të luftuar kontrabandimin dhe forma të tjera të krimit ndërkufitar, duke mos synuar ende gjerësisht PP/FT-në që ndodh nërmjet transportit fizik ndërkufitar të parave të gatshme, edhe pse janë ndërmarrë masa për t'i zgjeruar këto përpjekje.

328. Për më tepër, nuk është aspak e qartë se si statistikat e mësipërme ndërlidhen me shifrat për RTG-të që Dogana e Kosovës raporton te NjIF-i, pasi që duket qartë se numri i deklaratave nuk përkon as me numrin e RTG-ve, as me numrin e transaksioneve të përfshira.

Tabela 26:

	2014		2015		2016	
	RTG	Transaksione	RTG	Transaksione	RTG	Transaksione
Dogana e Kosovës	12	2.005	12	1.264	12	2.087

329. Sa i përket konfiskimeve përfundimtare, statistikat e pasurive të mbajtura që janë paraqitur më sipër, dukej se përfaqësonin 25% të gjobës për deklarim të rremë të parave të gatshme. Nuk janë ofruar statistika lidhur me rastet e konfiskimit të parave të gatshme ose instrumenteve të negociueshme të bartësit (INB) në bazë të dyshimeve për PP ose FT.

Qëndrueshmëria e rezultateve të konfiskimit me rreziqet e PP/FT-së dhe politikat e prioritetet vendore për PPP/LFT-në

330. AAPSK-ja ka siguruar statistika me kategorizim të përafërt sipas veprave penale, mirëpo në këto statistika, sekustrimi dhe konfiskimi janë paraqitur bashkë, duke e bërë kështu të vështirë nxjerrjen e përfundimeve të sakta.

Tabela 27: Veprat penale për të cilat janë sekustruar ose konfiskuar pasuri

Nr. i rasteve	Lloji i veprës penale	Vlera e pasurive (euro)
2016		
6	Skema piramidale	296.22
1	Fajde	17.700,00
15	Falsifikim	9.359,35
4	Grabitje	2.192,00
1	Grup terrorist	142.00
1	Keqpërdorim i detyrës	204.00
9	Kontrabandim	15.696,00
3	Krim i organizuar	34.078,50
4	Pastrim parash	2.699.556,00
35	Narkotikë	129.071,72
7	Vjedhje	15.326,00
6	Të ndryshme	181.869,04
2017		
11	Skemë piramidale	80.051,37
8	Kontrabandim	25.200,09
16	Falsifikim	18.155,95
1	Pastrim parash	45.000,00
4	Terrorizëm	11.236,10
4	Prostitucion- trafikim	399.278,37
1	Grup kriminal	655.440,70
8	Mashtrim, shmangie, deklarim i rremë	14.465,45
6	Vjedhje	51.368,35
3	Grabitje	9.300,00
1	Rrezikim i personave të mbrojtur	1.000,00
13	Të ndryshme	30.955,98
2018		
6	Skemë piramidale	205.203,66
1	Fajde	29.000,00
5	Falsifikim	140.300,00
12	Narkotikë	48.477,13
1	Terrorizëm	5,00

Nr. i rasteve	Lloji i veprës penale	Vlera e pasurive (euro)
7	Të ndryshme	97.610,00

331. Duhet të theksohet se këto statistika janë të përafërta, duke marrë parasysh shpjegimin e dhënë nga AAPSK-ja se urdhrat për konfiskim që pranon shpesh përmbajnë më shumë se një lloj vepre, duke e bërë të vështirë për ta bërë ndarjen.

332. Ajo çka vlen të theksohet është përpjesëtimi i konsiderueshëm ndërmjet shifrave të lidhura me PP-në në statistikat e përgjithshme. Në të njëjtën kohë, mungesa praktike e shifrave të konsiderueshme në lidhje me korrupsionin, si dhe me trafikimin dhe kontrabandën me narkotikë qartazi nuk përkon me profilin e rrezikut të Kosovës. Gjithashtu, nuk është e qartë se pse shifrat e ofruara nuk duket të pasqyrojnë konfiskimet lidhur me rastet e fundit të terrorizmit, të cilat u gjykuan në Kosovë.

333. Sa i përket llojeve të pasurive që i nënshtrohen sekuestrimit dhe konfiskimit, nga statistikat e AAPSK të treguara më lart, si dhe nga rastet e përshkruara më lart, është e qartë se llojet mbizotëruese të pasurisë janë patundshmëritë, metalet dhe gurët e çmuar si dhe paratë e gatshme. Kjo në përgjithësi përkon me profilin e rrezikut të Kosovës.

Përfundimi

334. Në përgjithësi mund të thuhet se pavarësisht nga prioritetet e përcaktuara nga autoritetet e Kosovës sa i takon çështjes së konfiskimit dhe përpjekjeve të konsiderueshme të KKLKE, korniza dhe rezultatet e sistemit të konfiskimit në Kosovë përballen me sfida të mëdha. Ka ende mungesë të përpjekjeve sistematike në sistemin prokurorial dhe gjyqësor në përgjithësi, përfshirë të gjithë prokurorët dhe gjyqtarët që merren me rastet e krimit që sjell përfitim, për të identifikuar dhe trajtuar siç duhet konfiskimin. Faktorët që i kontribuojnë kësaj përfshijnë mungesën e njohurive dhe të kapaciteteve si dhe interpretimin e ngushtë gjyqësor. Për më tepër, sekuestrimet dhe konfiskimet nuk pasqyrojnë plotësisht profilin e rrezikut të Kosovës, sa i përket veprave penale mbizotëruese, duke marrë parasysh edhe nivelin dhe fushëveprimin e rreziqeve ndërkufitare.

335. **Kosova ka arritur nivel të ulët të efektivitetit me Rezultatit e Menjëhershëm 8.**

KAPITULLI 4. FINANCIMI I TERRORIZMIT DHE FINANCIMI I PËRHAPJES

Gjetjet kryesore dhe veprimet e rekomanduara

Gjetjet kryesore

RM 9

- Autoritetet kanë shfaqur të kuptuar të duhur të rreziqeve nga terrorizmi që prekin Kosovën dhe rajonin, megjithatë vetëdijesimi dhe përqendrimi i tyre te financimi i terrorizmit nuk është i barabartë dhe ende nuk ka rezultuar në zhvillimin dhe zbatimin e ndonjë mekanizmi strategjik për zbutjen e rrezikut strategjik të FT-së.
- Përkundër dënimeve të shumta lidhur me terrorizmin dhe kapacitetit të përgjithshëm të autoriteteve hetuese të Kosovës për të ndërmarrë hetime financiare në mënyrë specifike në rastet e ndërlidhura me terrorizmin, në lidhje me veprat penale të FT-së nuk është zhvilluar asnjë ndjekje penale edhe në rastet kur aspektet e financimit dukeshin të identifikuar qartë. Duhet t'i kushtohet përqendrim i mëtutjeshëm ndjekjes penale të pavarur të FT-së. Ka pasur vetëm një dënim përfundimtar për FT-në.
- Masat alternative që zbatohen kur nuk ka mundësi të arrihet dënimi nuk duket se sigurojnë ndonjë rezultat të qëndrueshëm, sidomos në sektorin e OJQ-ve.
- Korniza ligjore për ndjekjen penale të aspekteve të ndryshme të veprës penale të FT-së ka mangësi dhe duhet të qartësohet dhe fuqizohet.

RM 10

- Pavarësisht të kuptuarit të rreziqeve të financimit të terrorizmit në Kosovë dhe në rajon dhe të disa masave lehtësuese, autoritetet nuk kanë zbatuar ndonjë sistem gjithëpërfshirës të sanksioneve financiare të shënjestruara. Mungon korniza ligjore për sanksione të shënjestruara.
- Autoritetet e Kosovës janë përpjekur të vlerësojnë rreziqet e ndërlidhura me OJF-të edhe pse këto përpjekje as nuk u bënë me kohë, as nuk rezultuan në identifikimin adekuat të sektorit specifik të OJF-ve që bartnin rrezikun më të madh apo të masave zbutëse për to. Nga njëra anë, mungesa e qasjes së përqendruar ndaj OJF-ve u përcaktua nga mangësitë në vlerësimin e rreziqeve të FT-së në sektor, por doli edhe nga përfshirja e disa OJF-ve në ekonominë joformale dhe shmangien nga tatimi.
- Mbikëqyrja dhe ngritja e vetëdijes në sektorin e OJF-ve është komprometuar nga mungesa e bashkëpunimit të mjaftueshëm, mosangazhimi i disa autoriteteve, mungesa e burimeve të mjaftueshme apo kombinimi i këtyre faktorëve.
- Me përjashtim të privimit të pasurisë në kuadër të hetimeve dhe ndjekjeve penale lidhur me terrorizmin, sistemi në Kosovë nuk ka gjeneruar rezultate konkrete në drejtim të privimit të aseteve.

RM 11

- Mekanizmi i zbatimit të sanksioneve të FP-së është i ngjashëm me atë për FT-në. Megjithatë, korniza e SFSH-ve në pajtim me Rezolutën 1718, 1737 dhe rezolutat pasuese nuk është zbatuar dhe nuk është pjesë e legjisllacionit kosovar. Deri tani nuk janë ngrirë as mjete ose fonde të ndërlidhura me FP-në.
- Kosova ka krijuar sistem juridik për të zbatuar sanksione financiare të shënjestruara në lidhje me financimin e terrorizmit, megjithatë mangësi teknike serioze vënë në

pikëpyetje efektivitetin e sistemit. Mekanizmat e përcaktimit dhe të ngrirjes nuk arrijnë të sigurojnë që masat e ngrirjes mund të kryhen pa vonesë, sidomos në rastet urgjente.

- Ndryshe nga shumica e bankave, subjektet e tjera raportuese nuk janë në dijeni të sanksioneve të OKB-së lidhur me financimin e përhapjes. Sektori bankar ka njohuri të përgjithshme sa i përket ekzistencës së "listave" që duhet të shqyrtohen, por shumë pak njohuri për dallimet ndërmjet FT-së dhe FP-së.
- Një aspekt pozitiv i sistemit është përdorimi i përhapur i sistemeve automatike ose manuale të kontrollit që mbështeten në databazat komerciale që zbatohen nga një sërë pjesëmarrësish nga sektori privat, kryesisht bankat. Ndërkohë që përdorimi i databazave komerciale është pozitiv, duket se mbështetja te to është e tepruar pa ndonjë vlerësim të dallimit ndërmjet SFSH-ve që kanë të bëjnë me FT-në, atyre që janë krijuar për të ngrirë asetet e lidhura me ASHM-të dhe llojet e tjera të sanksioneve që nuk janë të ndërlidhura. IF-të dhe BPCJF-të me të cilët ekipi i vlerësimit u takua në terren nuk ishin në gjendje të shpjegojnë se cilat masa shtesë duhet të ndërmerren për të zbuluar fondet ose asetet e tjera në pronësi ose të kontrolluara, drejtpërdrejt ose tërthorazi, nga persona apo subjekte të përcaktuara.
- Edhe kur subjektet raportuese janë të vetëdijshme, për shkak të mungesës së kornizës rregullative për SFSH-të e ndërlidhura me përhapjen e ASHM-ve, asnjë autoritet nuk do të kishte fuqinë për t'i vënë në zbatim këto sanksione të OKB-së dhe për të ngrirë asetet përkatëse. Ekziston një mekanizëm i tërthortë për ngrirjen e aseteve që zbatohet për FT-në, përmes një Udhëzimi Administrativ të lëshuar nga NjIF-i pas pranimit të raportit që sugjeron se fondet të mbahen lidhur me ndonjë individ ose subjekt të përmendur në sanksione, kjo sidoqoftë nuk mund të përdoret për sanksione që kanë të bëjnë me FP-në. Institucionet financiare dhe BPCJF-të që mund të posedojnë fonde ose asete të tjera që i mbulon regjimi i sanksioneve të FP-së nuk kanë, për rrjedhojë, asnjë detyrim që të ngrijnë asetet dhe nuk pranojnë asnjë udhëzim se çfarë duhet të bëjnë në këto rrethana.
- Për më tepër, autoritetet kanë ofruar dëshmi të pamjaftueshme për të demonstruar nivelin e kënaqshëm të bashkërendimit dhe bashkëpunimit (përfshirë informacion / shkëmbim të inteligjencës) me të gjitha autoritetet përkatëse në lidhje me çështjet e FP-së. Mungesa e mbikëqyrjes së disa ofruesve të shërbimeve (përveç bankave) në lidhje me zbatimin e detyrimeve të SFSH-ve gjithashtu ngre shqetësime.
- Fakti që ka shumë pak udhëzime se si të zbatohen sanksionet e FP-së është një tjetër vështirësi. I vetmi udhëzues ekzistues në fakt ka të bëjë me raportimin e transaksioneve të dyshimta për FT-në te NjIF-i, ku bëhet lidhja me OKB-në, BE-në dhe OFAC-un, por kjo nuk konsiderohet e mjaftueshme për të siguruar ngrirjen e përshtatshme dhe pa vonesë të aseteve. Për më tepër, vetë autoritetet nuk kanë demonstruar njohuri apo tendencë për të mbikëqyrur zbatimin e RKSKB-ve në lidhje me luftimin e FP-së.

Veprimet e rekomanduara

RM 9

- Autoritetet duhet të zgjerojnë përqendrimin e tyre strategjik për FT-në dhe të marrin në konsideratë integrimin e rrezeve specifike të tyre në strategjitë e tjera përkatëse apo duke miratuar instrumente specifike që sigurojnë veprime të duhura kundër FT-së. Si pjesë e kësaj përpjekjeje, autoritetet duhet të ndërmarrin masa shtesë për të vlerësuar dhe trajtuar plotësisht ndikimin e përdorimit të parave të gatshme dhe lëvizjeve ndërkufitare të tyre në lidhje me rreziqet e financimit të terrorizmit.
- Autoritetet e Kosovës duhet të zhvillojnë një vlerësim për mjaftueshmërinë e bazës ligjore për ndjekjen penale të FT-së, sidomos në rastin e Ligjit për Ndalimin e Bashkimit në Konfliktet të Armatosura, por edhe në lidhje me elementët e mbetur të FT-së ashtu siç kërkohet nga standardet ndërkombëtare.
- Autoritetet duhet të bazohen te ndjekjet e shumta penale lidhur me terrorizmin dhe të bëjnë përpjekje të bashkërenduara për të vlerësuar dënimet në rastet e lidhura me

terrorizmin në mënyrë që të vendosin për veprime të mëtejshme praktike dhe të sigurojnë udhëzimet e duhura për të inkurajuar hetimin dhe ndjekjen penale të elementëve të FT-së në të gjitha rastet.

- Trajnimet shtesë, sidomos në gjyqësor, duhet të përqendrohen në mënyrë specifike te hetimet financiare dhe ndjekja penale e elementeve të FT-së për të gjitha aktivitetet e dyshuara terroriste, përfshirë financimin e LHT-ve dhe personave lokalë që u bashkohen grupeve parashtarake apo terroriste në zonat e konfliktit.
- Autoritetet kompetente hetuese duhet të rrisin përqendrimin e tyre në aspektet e FT-së jashtë kuadrit të rasteve specifike të lidhura me terrorizmin të rekrutimit dhe lëvizjes së luftëtarëve terroristë dhe përtej konsideratave të efektivitetit për të parandaluar aktivitete terroriste, pa komprometuar përpjekjet për këto të fundit.
- Autoritetet duhet të adresojnë çështjet e efektivitetit të përdorimit të masave alternative. Meqenëse pezullimi i OJF-ve potencialisht mund të jetë një mjet i dobishëm parandalues, autoritetet duhet të marrin në konsideratë rregullimin e këtij instrumenti në mënyrë që të lejojnë përdorimin efektiv të tij duke siguruar masa të duhura korigjuese për të parandaluar keqpërdorimin e këtyre kompetencave.

RM 10

- Duhet të zbatohet urgjent një sistem i sanksioneve financiare të shënjestruara dhe i masave që sigurojnë privimin e plotë të aseteve.
- Autoritetet duhet të vlerësojnë nënsektorët e OJF-ve në rrezik, përfshirë çdo aktivitet të parregulluar dhe pa monitorim, në mënyrë që të zbatohet një qasje e përqendruar dhe të merren masa të tjera institucionale për regjistrimin, monitorimin apo kontrollin. Përveç kësaj, autoritetet duhet të miratojnë dhe vënë në zbatim me urgjencë veprimet e parashikuara në planin për analizën sektoriale të OJF-ve sidomos lidhur me sanksionet e shënjestruara, organizatat fetare, kompetencat për të pezulluar aktivitetet e OJF-ve. Përveç mbikëqyrjes për qëllime të PPP/LFT-së, autoritetet e Kosovës duhet të shqyrtojnë edhe masa dhe autoritet shtesë për të siguruar mbikëqyrjen gjithëpërfshirëse dhe të bashkërenduar të regjistrimit dhe aktiviteteve në vazhdim të OJF-ve.
- Të gjitha autoritetet kompetente për regjistrim dhe mbikëqyrje duhet të sigurojnë se sensibilizimi i sektorit të OJF-ve kryhet rregullisht dhe mbulon edhe nënsektorët përkatës të OJF-ve.
- Autoritetet e Kosovës duhet të shqyrtojnë masa të mëtejshme në bashkëpunim me OJF-të për të siguruar mekanizma vetërregullues që të vlerësojnë dhe menaxhojnë rreziqet e FT-së.

RM 11

Kosova duhet të marrë masa për të fuqizuar aftësinë e vet që të parandalojë financimin e përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë duke miratuar legjislacion që parasheh masa për ekzekutimin e sanksioneve financiare të shënjestruara lidhur me RKSQB-të përkatëse. Autoritetet kosovare duhet të miratojnë legjislacion të ri sa më shpejt të jetë e mundur për të rregulluar SFSH-të e lidhura me FP-në dhe të zhvillojnë sensibilizimin e duhur për zbatimin e shpejtë dhe efektiv të programit, duke u ofruar subjekteve raportuese udhëzime të detajuara.

336. Rezultatet e Menjëhershme përkatëse të shqyrtuara dhe të vlerësuara në këtë Kapitull janë RM 9-11. Rekomandimet përkatëse për vlerësimin e efektivitetit në këtë seksion janë R.5-8.

Rezultati i Menjëhershëm 9 (Hetimi dhe ndjekja penale e FT-së)

Ndjekja penale/dënimi i llojeve të aktivitetit të FT-së në përputhje me profilin e rrezikut të Kosovës

337. Gjatë vlerësimit të mëparshëm të Kosovës për zbatimin e standardeve të FATF-së u gjet se vepra e FT-së ishte pjesërisht në përputhje me standardin për shkak të një sërë mangësish të ndërlidhura kryesisht me vetë veprën e terrorizmit dhe elementin e dashjes së kriminalizimit të veprave të ndryshme terroriste të parapara nga nëntë traktatet sipas shtojcës së konventës së FT-së. Ndryshimet që u bënë në periudhën pas vlerësimit të mëparshëm kanë të bëjnë me përfshirjen e veprës së FT-së në Ligjin për PPP/LFT-në dhe të një vepre penale të ndërlidhur me financimin e aktiviteteve të organizimit, rekrutimit, udhëheqjes ose trajnimit të personave ose grupeve të personave për t'iu bashkuar konflikteve të armatosura jashtë territorit të vendit në Ligjin për Ndalimin e Bashkimit me Konfliktet e Armatosura Jashtë Territorit të Shtetit. Siç është theksuar në rekomandimin përkatës në Shtojcën e Pajtueshmërisë Teknike, kjo metodë e kriminalizimit shton një shtresë kompleksiteti të interpretimit të dispozitave të FT-së dhe krijon mospërputhje ndërmjet përkufizimeve. Për më tepër dhe me rëndësi edhe më të madhe, vepra e financimit në Ligjin për Ndalimin e Bashkimit me Konfliktet e Armatosura në të vërtetë do të kufizonte ndjeshëm aftësinë e autoriteteve të Kosovës për të ndjekur penalisht një sërë aktiviteteve, sidomos në lidhje me individë që udhëtojnë drejt zonave të konfliktit me qëllim të bashkimit me konfliktin e armatosur dhe me mbështetjen logjistike të LHT-ve që kalojnë nëpër territorin e Kosovës ose mbështeten pa ndonjë element të organizimit apo udhëheqjes. Kjo do të shpjegonte deri diku, sikurse theksohet edhe më poshtë, numrin shumë të kufizuar të dënimeve për FT-në pavarësisht numrit të dënimeve në lidhje me terrorizmin dhe me personat që udhëtojnë për t'iu bashkuar me organizatat terroriste ose zonat e konfliktit.

338. Sa i përket identifikimit dhe shënjestrimit të rreziqeve të mëdha që lidhen me FT-në, VKR-ja e kryer nga autoritetet e Kosovës ka rëndësi të kufizuar dhe, për më tepër, duket se bie në kundërshtim me disa nga gjetjet që kanë të bëjnë me kërcënimet dhe rreziqet e terrorizmit të identifikuar nga autoritetet. Për shembull, burimi i jashtëligjshëm i identifikuar i fondeve të përdorura kryesisht për FT-në nuk duket të mbështetet nga të kuptuarit e autoriteteve për gjendjen aktuale të FT-së dhe zhvillimin e kërcënimeve. Të kuptuarit e përdorimit të organizatave jofitimprurëse (OJF) për të lëvizur ose shmangur fonde të ligjshme për qëllime të financimit të udhëtimit të personave drejt zonave të konfliktit, radikalizimit apo nxitjes së islamit politik është shumë i përgjithësuar dhe nuk ofron bazë të duhur për përqendrimin e mëtejshëm të përpjekjeve të autoriteteve.

339. Autoritetet e Kosovës mbështeten në disa strategji përkatëse kombëtare të miratuara pas VKR-së që paraqesin më shumë hollësi sa i përket shënjestrimit të rreziqeve madhore në lidhje me terrorizmin. Këtu përfshihen Strategjia Kombëtare kundër Terrorizmit dhe Plani i Veprimit 2018-2022, Strategjia Kombëtare për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Joformale, Pastrimit të Parave, Financimit të Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2014-2018 dhe Strategjia për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Radikalizimit që çon në Terrorizëm 2015-2020. Autoritetet gjithashtu kanë sfaqur shkallë të konsiderueshme të të kuptuarit të rreziqeve dhe kërcënimeve të mëdha që lidhen me terrorizmin.

340. Sfidat kryesore me të cilat ballafaqohet Kosova sa i përket terrorizmit janë të ndërlidhura me ekstremizmin me bazë fetare dhe, në një masë më të vogël, të motivuar nga nacionalizmi dhe politika, duke gjykuar nga rastet që janë paraqitur nga autoritetet dhe ku ka pasur dënime. Kërcënimet kryesore janë identifikuar në ndërlidhje me sulmet terroriste nga anëtarët e organizatave terroriste, ku hyjnë edhe përfshirja e luftëtarëve të huaj terroristë, celulat joaktive ose radikalizimi i simpatizantëve dhe mbështetësve; indoktrinimi me ideologji ekstremiste; migrimi i paligjshëm, duke marrë parasysh pozicionin gjeografik të Kosovës dhe dukurinë e luftëtarëve të huaj.

341. Në një masë të madhe, këto kërcënime janë të ndërlidhura me përmasën ndërkufitare dhe kështu, kërkojnë përpjekje të konsiderueshme dhe kundërmasa përkatëse. Në mesin e këtyre vektorëve rajonalë dhe ndërkombëtarë të kërcënimit, elementët kryesorë që vihen re janë indoktrinimi nga ideologji ekstremiste islamike të importuara në Kosovë nga Lindja e Mesme, bashkë me motivimin nga konflikti në Siri dhe Irak, që ka rezultuar për shembull në një numër të konsiderueshëm të personave nga Kosova që udhëtojnë drejt zonave të konfliktit me qëllim të pjesëmarrjes në konflikt. Një problem i rëndësishëm lidhur me këtë të fundit dhe evoluimi i kërcënimit ka të bëjë me integrimin e të kthyerve dhe rreziqet e mundshme që sjellin

këto. Ndhimesa e propagandës, përfshirë atë përmes internetit¹⁵, në kombinim me vështirësitë ekonomike dhe sociale është shënuar gjithashtu si faktor kryesor për kërcënimin. Zhvillimet e lartpërmendura ishin faktorë edhe në numrin relativisht të konsiderueshëm të përgatitjeve për sulme terroriste në Kosovë dhe në rajon, si dhe në përpjekjet për të kryer vepra terroriste, të cilat u penguan nga institucionet e sigurisë në Kosovë.

342. Në lidhje specifike me FT-në, autoritetet e Kosovës duket se përqendrohen kryesisht në kërcënimin që ka të bëjë me OJF-të që financohen nga fonde me origjinë të paqartë dhe për qëllime të radikalizimit dhe promovimit të asaj që në strategjitë e miratuar është quajtur si "Islam politik", fonde këto me origjinë specifike që mund të përdoren për qëllime të FT-së, rolin e konsiderueshëm të vetëfinancimit të pjesëtarëve posaçërisht të varfër dhe të privuar të shoqërisë kosovare që mbështeten në ndihmën e paqëllimtë të familjes ose të afërmeve, përdorimin e konsiderueshëm të parave të gatshme për aktivitetet terroriste. Sipas autoriteteve të Kosovës, lëvizja e fondeve përmes sistemit financiar formal duket të jetë e kufizuar dhe kryesisht ka të bëjë me OJF-të dhe zakonisht kalon nëpër organizatat ombrellë ose sponsorët në vende të tjera përveç zonave të veçanta gjeografike të cilat mund të lidhen me zonat e konfliktit. Ndhimesa në radikalizim është rreziku kryesor i identifikuar pa ndonjë provë të lidhjes me aktivitetet terroriste. Përveç kësaj, autoritetet nuk mund të vëzhgojnë ndonjë lidhje të këtij lloji të financimit me organizatat terroriste të mëdha (të caktuara) si në aspektin e fondeve hyrëse, ashtu edhe dalëse. Në të njëjtën kohë, bashkëbiseduesit të cilët vlerësuesit i takuan në terren mohuan në masë të madhe çdo tregues të financimit të konsiderueshëm nga jashtë dhe mbështetjen e personave që udhëtojnë për t'u bashkuar me konfliktet e armatosura, përfshirë financimin e familjeve të tyre. Është vërejtur gjithashtu se në një numër të madh të atyre rasteve familjet udhëtuan bashkërisht, me gjasë për shkak të mungesës së mjeteve të duhura për të qëndruar në Kosovë kur anëtarit i familjes u largua për në zonat e konfliktit. Në të njëjtën kohë, nuk është e qartë se deri në ç'masë autoritetet e Kosovës e kanë eksploruar çështjen e disa fondeve të përdorura nga të kthyerit nëse ishin përfitime nga pjesëmarrja e tyre në zonat e konfliktit, duke rritur kështu rrezikun e mundshëm të PP-së të lidhur me FT-në.

343. Autoritetet e Kosovës nuk siguruan asnjë konfirmim për ndonjë përfshirje të personave që banojnë në Kosovë lidhur me aktivitetet të FT-së për qëllime të propagandës, përfshirë përmes internetit, sipas analizës gjithëpërfshirëse të autoriteteve kompetente.

344. Autoritetet nuk gjetën që dukuria e hawala-s të jetë me ndonjë rëndësi të madhe për rrezikun nga FT-ja në Kosovë. Nuk kishte gjetje të tjera të vlerësuesve për të konfirmuar në praktikë praninë e kësaj dukurie.

345. Bazuar në përfundimet e lartpërmendura, përdorimi i parave të gatshme duket se paraqet rrezik më të madh se çdo financim tjetër që mund të kalojë përmes sistemit financiar formal. Pavarësisht identifikimit të parave të gatshme si burim kryesor financimi, autoritetet kanë identifikuar rrezikun që rrjedh nga përdorimi i përhapur tradicional i dërguesve të parave të gatshme në forma të ndryshme, përfshirë paratë e gatshme të transportuara në sasi të mëdha nga disa persona që hyjnë dhe dalin nga territori i Kosovës (p.sh. shoferët e autobusëve), agjencitë e udhëtimit potencialisht vazhdojnë të organizojnë transmetimin e fondeve, disa raste të caktuara të transportit të paligjshëm të metaleve të çmuara. Megjithatë, këto forma të lëvizjes së parave të gatshme nuk u paraqitën si ndonjë përqendrim specifik sa i përket FT-së, pasi dukej se kryesisht vetëfinancimi dhe financimi brenda hapësirës së kufizuar të komunitetit lokal kishte më rëndësi. Nuk duket të jetë identifikuar asnjë rast i ndonjë krimi madhor të terrorizmit që të jetë i lidhur me këtë lloj lëvizjeje të parave. Ekipi ende vlerëson se këto lëvizje të parave të gatshme përbëjnë rrezik të konsiderueshëm, për shkak të lidhjeve të aktiviteteve terroriste në rajon dhe në Evropë dhe përdorimit të gjerë të parave të gatshme për financimin e aktivitetit terrorist, sikurse dëshmohet me një sërë rastesh të hetimeve dhe dënimeve për terrorizëm.

346. Asnjë lidhje nuk mund të krijohet nga autoritetet ndërmjet krimit të organizuar të mundshëm dhe FT-së, edhe pse disa lidhje (të mundshme) me fenomenin relativisht të gjerë të trafikimit të armëve në rajon u vërejtën nga disa nga të intervistuarit si një rrezik potencial. Kosova ka një numër të konsiderueshëm dënimesh për terrorizmin. Janë diskutuar shumë raste me autoritetet dhe duket se ato korrespondojnë me profilin e rrezikut të terrorizmit si u shtjellua më sipër. Në të njëjtën kohë, numri i dënimeve për trafikim të paligjshëm të armëve duket të jetë jashtëzakonisht i lartë. Vlerësuesit konsiderojnë, madje kjo vihet në duke edhe

¹⁵ Duke marrë parasysh edhe depërtimin e lartë të internetit në Kosovë në krahasim me vendet e rajonit. Shih f. 33 të Foreign Terrorist Fighters, Manual for Judicial Training Institutes South-Eastern Europe (Luftëtarët e Huaj Terroristë, Doracaku për Institutet Gjyqësore të Trajnimit Evropë Juglindore), UNODC, 2017.

nga disa prej bashkëbiseduesve, se mund të ketë lidhje ndërmjet krimit të përhapur të trafikimit të paligjshëm të armëve me dukurinë e terrorizmit dhe FT-së dhe kjo dukuri përbën rrezik të konsiderueshëm në aspektin e sigurimit të mbështetjes materiale për terrorizmin. Një rast i tillë që përfshinte elementin e trafikimit të paligjshëm të armëve ishte i lidhur me terrorizmin e mundshëm politikisht të motivuar.

Tabela 28: Dënime për terrorizëm dhe trafikim të paligjshëm të armëve

	2013	2014	2015	2016	2017
	Persona				
Dënime për terrorizëm dhe vepra të ndërlidhura me terrorizmin (rekrutimi, organizimi, udhëtimi, etj.)	22	15	16	17	7
Trafikimi i paligjshëm i armëve	89	177	145	192	219

347. Sa i përket dënimeve në Kosovë, shumica e rasteve kanë të bëjnë me persona që udhëtojnë nga Kosova për në zonat e konfliktit ose luftëtarët e huaj terroristë, ku përfshihet rekrutimi dhe mbështetja. Kjo është e vlefshme për disa raste të mëdha të diskutuara me autoritetet, përfshirë rastin "Imami" dhe "Përkrahje për Sirinë" ashtu siç shtjellohet më poshtë, rastet e LHT-ve që u ndaluan në aeroportin e Prishtinës dhe Shkupit. Gjithashtu, u diskutuan edhe shumë raste të tjera që kanë të bëjnë me aktivitete të ndërlidhura me terrorizmin, përfshirë edhe përpjekjet terroriste në rajon me motivim të mundshëm etno-nacionalist. Duke marrë parasysh numrin e rasteve dhe natyrën e tyre është për t'u shqetësuar që në vetëm një rast aspektet e FT-së të këtyre aktiviteteve janë ndjekur penalisht dhe është dhënë një dënim.

348. Rasti iu paraqit vlerësuesve pas vizitës në terren, edhe pse vlerësuesit kryen një numër të konsiderueshëm takimesh për të adresuar çështjet e FT-së gjatë vizitës në terren me një numër autoritetesh të ndryshme. Kjo ngre shqetësime në lidhje me vëmendjen koherente dhe gjithëpërfshirëse të autoriteteve në lidhje me aspektet e FT-së të rasteve të lidhura me terrorizmin. Në këtë rast, vihet re se ndonëse aktivitetet ishin të lidhura kryesisht me udhëtimin në zonat e konfliktit për t'u bashkuar me organizatat terroriste, aktakuza kryesore ishte për rekrutim dhe kjo lejoi që FT-ja të ndiqej gjithashtu. Vërehet se shumtë e përfshira ishin shumë të vogla, duke përfaqësuar vëmendjen e autoriteteve në aspektin e FT-së edhe për shumtë më të vogla (ndryshe nga rastet e diskutuara më poshtë).

349. Në të njëjtën kohë, vihet re se në një numër të rasteve të ndërlidhura me terrorizmin, FT-ja nuk është ndjekur. Rasti *Imami* përfshinte aktakuza të 7 personave për: rekrutim për terrorizëm në pajtim me nenin 139 në lidhje me nenin 31 të KP-së, nxitje të urrejtjes, përçarjes ose mosdurimit kombëtar, racor, fetar apo etnik në pajtim me nenin 147, paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KP-së, organizimin dhe pjesëmarrjen në grup terrorist në pajtim me nenin 143, paragrafi 2 të KP-së, mbajtjen në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve në pajtim me nenin 374, paragrafi 2 të KP-së. Duke pasur parasysh karakterin shumë të organizuar të aktiviteteve të personave dhe shtrirjen e aktiviteteve, përfshirë ligjëratat dhe sigurimin e fondeve për persona që të udhëtojnë në zonat e konfliktit, si dhe indikacione nga disa dëshmitarë lidhur me financimin, mungesa e aktakuzës për FT duket një lëshim i rëndësishëm. Për më tepër, financimi është përmendur në mënyrë të qartë në shtjellimin e aktiviteteve të të pandehurve në vendimin gjyqësor. Duke e marrë parasysh këtë lëshim, nuk është e qartë nëse hetimi është përqendruar në atë se cili ishte burimi i fondeve të përdorura në rastin Imami.

350. Rasti *Mbështetje për Sirinë* kishte të bënte me dënimin e një personi për organizimin, mbështetjen dhe pjesëmarrjen në grup terrorist në pajtim me nenet 137 dhe 139 të KP-së së Kosovës. Sipas aktakuzës është vërtetuar se i akuzuari ka bashkëpunuar me persona të tjerë që ishin anëtarë të organizatave terroriste ose persona të dënuar për vepra terroriste, duke kontribuar në rekrutimin e personave për të qenë pjesë e këtyre organizatave terroriste dhe duke u vënë atyre personave në dispozicion zotërimet e tij apo të saj për të ndihmuar dhe mbështetur aktivitetet terroriste. Me veprime konkrete, ai ka inkurajuar dhe mbështetur të dënuarit për vepra terroriste për të qenë pjesë e grupeve terroriste. Kjo u bë duke siguruar fonde dhe burime materiale dhe duke lejuar që automjetet e tij të përdoreshin nga këta njerëz për të shkuar në zonat e luftës në Siri. I pandehuri ka paguar biletat e aeroplanit për personat e tjerë që të udhëtonin në zonat e luftës në Siri për t'u bashkuar me organizatat terroriste. Sipas aktakuzës, blerja e biletave të avionit është kryer përmes llogarisë së një personi të afërt dhe fillimisht, fondet janë depozituar dhe janë marrë për shitje të veturave. Fondet nga kjo llogari u përdorën për të paguar disa bileta avioni për personat e dyshuar që udhëtonin për në zonat e konfliktit, por nuk u vërtetua përtej çdo dyshimi të arsyeshëm se R. ishte personi që financonte

biletat e aeroplanit për shkak të përdorimit të kësaj llogarie të veçantë. Për më tepër, u pagua qira për një xhami të improvizuar, ku strehoheshin njerëz që kishin mbështetur dhe marrë pjesë në organizata terroriste edhe pse ka pasur rrethana shtesë të bazuara lidhur me pjesën e financimit që janë të tërthorta dhe nuk janë të lidhura me të pandehurin. Gjykata e hodhi poshtë pikën e fundit.

351. Rasti Mbështetje për Sirinë mund të konsiderohet si situatë tipike e FT-së edhe kur marrim parasysh hedhjen poshtë të disa prej akuzave për mungesë të dëshmive të mjaftueshme. Është e qartë se, në radhë të parë, prokuroria nuk e ka përfshirë aktakuzën për FT pavarësisht nga elementet e dukshme që mbështesin këtë përfundim në aktakuzë. Për më tepër, rasti duket të jetë i lidhur me rastin Imami ku organizimi dhe pjesëmarrja në organizatën terroriste ishte e qartë. Vlerësuesit e kuptojnë këtë rast që të ketë një aspekt të qartë dhe të konsiderueshëm të FT-së, përkatësisht që fondet e fituara ligjërisht janë përdorur për të lehtësuar terrorizmin dhe rekrutimin. Nuk është e qartë pse në këtë rast nuk është ndjekur FT-ja (që nuk përfshihet në aktakuzë dhe në dënimin përfundimtar). Pikëpamja e prokurorisë ishte se aktakuza u përqendrua në elementin e rekrutimit për shkak të fazës së avancuar të hetimit të kësaj veprë penale në rast, ndërsa në të njëjtën kohë sanksioni i parashikuar në KP do të ishte i barasvlershëm. Kjo është parë si kundërproduktive sa i përket ndjekjes së rasteve të FT-së. Në të njëjtën kohë, kjo duket se është në përputhje me parimin e "përthithjes" në politikën penale që u vu re dhe u pohua nga disa bashkëbisedues gjatë raundit të mëparshëm të vlerësimit në mënyrë specifike në lidhje me rastet e PP-së, pavarësisht konkluzioneve të raportit në lidhje me mungesën e "bazës së duhur ligjore" për interpretim të tillë juridik. Në bazë të intervistave, vështirësitë për ndjekjen penale të FT-së në këtë rast kishin të bënin edhe me sigurimin e mbështetjes materiale kur nuk ka pasur ndonjë lëvizje aktuale të fondeve (ose janë përdorur shuma tepër të vogla), duke e shkurajuar prokurorinë që ta ndjekë më tej FT-në. Rasti Mbështetje për Sirinë paraqet një pikë të mirë në këtë drejtim për sa kohë që u gjet se financimi i drejtpërdrejtë i xhamisë bëhej me shuma tepër të vogla (nën 100 euro). Një shpjegim tjetër i autoriteteve në terren është se, meqë rasti lidhej me rekrutimin, i cili në vetvete përfshin aspektin e financimit, asnjë ndjekje penale për FT nuk ishte e mundur. Kjo nuk konsiderohet se i kontribuon ndonjë politike koherente në lidhje me trajtimin e aspekteve të FT-së.

352. Një rast i tentativës për terrorizëm në Shqipëri në vitin 2016 gjatë lojës së futbollit Shqipëri-Izrael kishte gjithashtu të bënte me bashkëpunimin e ngushtë me Shqipërinë dhe me një sërë arrestimesh të bëra në Kosovë (19), ku kryesisht u hetuan aktivitetet dhe u ngritën aktakuzat. Duke diskutuar elementin e financimit, ishte e qartë se të pandehurit kishin përdorur kryesisht para të gatshme dhe gjithashtu u zbuluan disa lidhje me financim të mundshëm nga një person në zonat e konfliktit, gjë që nuk ishte e mundur të ndiqej më tej për shkak të arsyeve objektive (personave të vrarë). Për më tepër, u diskutua për vështirësitë ekstreme materiale të personave të përfshirë. Megjithatë, sipas vlerësuesve, kjo konsiderohet si tregues se lëvizja e fondeve nga zonat e konfliktit në Kosovë apo vende të tjera që do të përdoren për qëllime të FT-së është rrezik real që duhet të eksplorohej më tej, ndoshta edhe në këtë rast.

353. Prokuroria Speciale e Kosovës do të ishte përgjegjëse për ndjekjen penale të rasteve që kanë të bëjnë me financim të terrorizmit në bazë të interpretimit që i bëjnë autoritetet Ligjit për Prokurorinë Speciale të Kosovës, Kodit Penal të Kosovës dhe Kodit të Procedurës Penale të Kosovës. Në të njëjtën kohë, vërehet se nuk ka ndonjë kompetencë të përcaktuar qartë në nenin 5 të Ligjit për Prokurorinë Speciale të Kosovës. Mungesa e kompetencës së duhur duket se ka ndikim të ndjekja penale e FT-së dhe vendimet për të ndjekur raste të FT-së, duke pasur parasysh numrin e përgjithshëm të ndjekjeve penale dhe dënimeve të ndërlidhura me raste të FT-së. Vepra e FT-së bie nën juridiksionin e Departamentit për Krime të Rënda të gjykatave përkatëse në pajtim me nenin 21, paragrafi 4 të Kodit të Procedurës Penale.

354. Hetimi i rasteve të FT-së do të zhvillohej nga Drejtoria kundër Terrorizmit e PK-së dhe vetëm në disa rrethana të caktuara Drejtoria do të kërkojë ndihmë teknike nga Drejtoria për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit në PK dhe rezultatet u përdorën nga Drejtoria kundër Terrorizmit dhe iu bashkëngjitën rastit të hetuar. Vetëm në qershor të vitit 2018, një ekip hetuesish financiarë i përbërë nga dy zyrtarë policie u krijua brenda Drejtorisë kundër Terrorizmit për të mundësuar hetimet financiare dhe trajtimin e të gjitha aspekteve të lidhura me terrorizmin nga stafi i kësaj drejtorie. Ekipi i vlerësimit ka kuptuar, si dhe u vërtetua nga ndryshimet strukturore të diskutuara më lart, se autoritetet po kujdesen për të siguruar alokimin e duhur të burimeve edhe për qëllimet e hetimit të plotë të aspekteve të FT-së dhe të kuptuarit e fenomeneve të FT-së.

355. Vlerësuesve iu dha vetëm një rast i aktakuzës dhe dënimit për FT-në i një lënde siç u shtjellua më lart. Duke marrë parasysh rreziqet e identifikuara nga terrorizmi, serioziteti i

problemit të personave nga Kosova që janë bashkuar me aktivitetet në zonat e konfliktit, numrin e OJF të pezulluara, mangësitë dhe treguesit e tjerë lidhur me OJF të caktuara dhe potencialin për financimin e tyre nga jashtë, si dhe ndikimin rajonal dhe më gjerë të aktiviteteve terroriste me lidhje me Kosovën, mungesa e aktakuzave dhe dënimeve nuk mund të shpjegohet krejtësisht nga faktorë objektivë të vetëfinancimit ose financimit të paqëllimtë nga anëtarët e familjes. Një sërë faktorësh strukturorë, siç u përmendën më lart, po pengojnë ndjekjen penale të suksesshme të FT-së, por rëndohen nga mungesa e përqendrimit të duhur dhe shënjestrit të veprave të FT-së.

Identifikimi dhe hetimi i FT-së

356. Sikurse u përmend më lart, Drejtoria kundër Terrorizmit e PK-së në bashkëpunim me njësinë përkatëse brenda Drejtorisë për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit të PK-së, si dhe me AKI-në dhe NjIF-in janë institucionet kompetente përgjegjëse për monitorimin e dukurive të FT-së dhe zhvillimin e analizave përkatëse, kërkimeve dhe hetimeve për të zbuluar dhe hetuar rastet e FT-së.

357. Bazuar në informacionet e ofruara gjatë vizitës në terren, të tre institucionet përqendrohen fuqimisht në veprime parandaluese lidhur me terrorizmin dhe potencialisht, në shumicën e rasteve, me FT-në. Kjo bëhet në bazë të punës së policisë të udhëhequr nga inteligjenca dhe monitorimin e zhvillimin e inteligjencës financiare nga NjIF-i bazuar në informacionin e marrë në përputhje me legjislacionin për PPP/LFT-në, kryesisht RTD-të.

358. PK-ja ka përmendur disa hetime lidhur me FT të mundshëm. Në vitin 2014 janë realizuar 3 hetime formale kundër 3 personave fizikë dhe në vitin 2015 u zhvilluan 4 hetime kundër 4 personave. Për vlerësuesit, numri i personave të hetuar është tregues për mungesën e hetimeve lidhur me skemat më të sofistikuara, komplekse dhe të organizuara të FT-së (pra kryesisht hetimet që lidhen me rastet e vetëfinancimit). Këto raste nuk sollën rezultate konkrete. Duke krahasuar numrin e hetimeve për FT-në me hetimet dhe dënimet për terrorizëm për periudhën 2012-2017, hetimet formale për FT-në të kryera nga autoritetet e Kosovës duken të shpërpjesëtuar dhe nuk ka gjasa të jenë efektive, gjë që shpjegon pjesërisht mungesën e dënimeve për FT-në, siç u shtjellua më lart. Arsyet për praktikitet dhe vendimet e prokurorisë për të mos shfrytëzuar plotësisht mundësitë e aktakuzave për FT-në mbi bazën e provave të mbledhura janë po ashtu faktorë që kontribuojnë për të shkrajuar deri diku ndonjë përqendrim të mëtejshëm të rreptë mbi aspektet e FT-së.

359. PK-ja i ka informuar vlerësuesit se në secilin rast të hetimit të terrorizmit, pavarësisht se mbështeten në burimet e inteligjencës së PK-së, ka edhe informacion të mbledhur nga NjIF-i me qëllim që të bëhen përpjekje për të identifikuar transaksionet e mundshme dhe lëvizjet e fondeve të ndërlidhura si dhe personat shtesë të përfshirë në terrorizëm ose aktivitete të lidhura me to. Numri i kërkesave jepet më poshtë.

Tabela 29: Kërkesa nga PK-ja për NjIF-in të ndërlidhura me terrorizmin, përfshirë FT-në e mundshëm

	2014	2015	2016	2017
Kërkesat	17	9	20	21
Personat (fizikë dhe juridikë) të përfshirë	125	16	35	29

Tabela 30: Kërkesa nga AKI-ja për NjIF-in, të ndërlidhura me terrorizmin, përfshirë FT-në e mundshëm

	2014	2015	2016	2017
Kërkesat	23	19	28	31

360. AKI-ja gjithashtu bashkëpunon në një shkallë të gjerë me NjIF-in, kryesisht lidhur me identifikimin e inteligjencës financiare përkatëse nga NjIF-i. Informacioni kryesisht përdoret për kontrolle fillestare dhe vendim për masat e tjera që duhen zbatuar.

Shembull

Në rastin e OJQ "K.", aktakuza ishte për veprën penale të krimit të organizuar sipas nenit 33 paragrafi 5, në lidhje me nenin 24 paragrafi 1, 3 dhe 4 të Ligjit nr. 03/L-196 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit; i ndryshuar me Ligjin nr. 04/L-178. Gjatë hetimit u konstatua se i pandehuri dhe OJQ "K." kishin mbështetur financiarisht disa OJQ të tjera pa raportuar paraprakisht në Njësinë e Inteligjencës Financiare dhe kishin përdorur para të gatshme në kundërshtim me detyrimet e tyre sipas Ligjit për PPP/LFT-në. Në këtë rast, nuk u gjet asnjë lidhje specifike me terrorizmin (duke gjykuar nga aktakuza), mirëpo rasti tregoi qartë aftësinë e NjIF-it dhe hetuesve për t'u përqendruar në lëvizje të financimit dhe financiare.

361. NjIF-i ka shfaqur përfshirje të konsiderueshme jo vetëm për shkak të shkëmbimit të informatave të lartpërmendura, por edhe në bazë të monitorimit dhe analizës së informacionit të vet, që u përqendrua në dy fusha kryesore – aktivitetet e OJF-ve lidhur me keqpërdorimet e mundshme për qëllime të FT-së dhe rastet e LHT-ve ose personave nga Kosova që udhëtojnë për/kthehen nga zonat e konfliktit. Numri i RTD-ve të pranuar në lidhje me FT të mundshëm paraqitet më poshtë.

Tabela 31: RTD të pranuar nga NjIF-i lidhur me FT-në

Subjekti raportues	2014	2015	2016	2017
Banka	15	23	19	10
Të tjerë, përfshirë: (Mbikëqyrës) (BPCJF)	1	3	17 (1) (15)	8 (8)
Gjithsej	16	26	36	18

362. RTD-të e pranuar nga NjIF-i tregojnë një rritje të dukshme në vitet 2015 dhe 2016 që do të korrespondojnë me rrezikun më të madh në Kosovë në lidhje me luftëtarë të huaj terroristë (më tutje: LHT) ose persona nga Kosova që udhëtojnë për në zonat e konfliktit dhe çështjet e migracionit që mund të kenë gjithashtu një komponent të ndërlidhur me terrorizmin. Në periudhën 2014-2017, NjIF-i hapi për analizë 141 raste të dyshuara të financimit të terrorizmit. Rreth 54 OJF ishin kinse të përfshira në këto raste.

363. Pamja e paraqitur nga disa raste të paraqitura nga NjIF-i do të zbulonte disa transaksione të pezulluara nga NjIF-i, përfshirë një rast prej më shumë se gjysmë milioni euro i pezulluar për dyshime të FT-së. NjIF-i ka demonstruar aftësinë e vet për të vepruar në mënyrë që të kontrollojë dyshimin që nuk është vërtetuar në rastin në fjalë të pezullimit të konsiderueshëm të fondeve. U demonstrua aftësia për të ndjekur persona të mundshëm, përfshirë edhe listat vendore të vendeve të ndryshme bazuar në raportime nga sektori bankar. Raportet e NjIF-it paraqesin një nxitës të konsiderueshëm për kontrole të tjera për FT-në dhe hetime nga autoritetet përkatëse.

364. Faktorët e tjerë që do të mund të pengonin identifikimin dhe hetimin u shtjelluan me autoritetet që u takuan në terren dhe deklarohen si kryesisht të ndërlidhur me vetëfinancimin duke përdorur shuma jashtëzakonisht të ulëta, financimin nëpërmjet familjes ose të afërmve dhe mungesën e financimit të konsiderueshëm që kalon përmes sistemit formal të financimit. U identifikuan gjithashtu disa fonde që shkonin nga familja për kthimin e luftëtarëve që iu ishin bashkuar zonave të konfliktit, por nuk u identifikuan raste të FT-së mbi këtë bazë (p.sh. në lidhje me pagesë të mundshme të shpërblimit). Për më tepër, autoritetet nuk konsideruan të mundur asnjë rast hetimi apo ndjekjeje lidhur me transferimin e zbuluar të fondeve nga zonat e konfliktit apo juridiksionet përreth që lidhen me personat që marrin pjesë në konflikte (p.sh. PP i mundshëm me elemente të FT-së). Përveç kësaj, vlerësuesit u informuan se dëshmimi i FT-së dhe pjesëmarrja e shumë të kthyerve në zonat e konfliktit në aktivitete që lidhen direkt me ose në mbështetje të terrorizmit u bënë gjithnjë e më të vështira pasi të kthyerit janë të vetëdijshëm për pasojat e veprimtarisë së tyre. Aftësia e OJF-ve të dyshuara për të fshehur lëvizjet e fondeve duke u fshehur pas aktiviteteve humanitare është vërejtur nga autoritetet si një arsye për të mos qenë në gjendje të identifikojnë rastet e FT-së që do të ndiqeshin penalisht, pavarësisht nga masat që janë ndërmarrë për pezullimin e OJF-ve (shih më poshtë nën masat e tjera të përdorura dhe RM 10). Gjithashtu, është vërejtur se disa OJF dhe personat që i kontrollojnë ato kanë dalë nga Kosova, por njëkohësisht disa nga OJF-të thuhet se kanë

vazhduar aktivitetet e tyre nën tjetër maskim ose pavarësisht pezullimit formal (shih më poshtë).

365. Bazuar në informatat e ofruara nga bashkëbiseduesit dhe pavarësisht nga përpjekjet e autoriteteve për të kuptuar plotësisht të gjitha aspektet e rasteve të terrorizmit, vlerësuesit janë të shqetësuar se në një sërë rastesh ishte i nevojshëm përqendrim shtesë te komponenti i FT-së dhe kjo gjë nuk ishte zbatuar plotësisht sa herë që aktiviteti i terrorizmit apo i ndërlidhur me terrorizmin ishte ndërprerë. Kjo është dëshmuar edhe nga disa raste konkrete hetimi të përmendura nga autoritetet e Kosovës.

366. Siç është diskutuar në terren, një pengesë e mundshme për hetimin e plotë të FT-së ka të bëjë me identifikimin dhe ndjekjen e rasteve ku aktivitetet e propagandës së lidhur me terrorizmin janë të përhapura dhe ndodhin jashtë kuadrit të institucioneve specifike fetare. Rasti Imami u diskutua si rast specifik ku ndjekja penale ishte e mundur për shkak të aktiviteteve që kryesisht ndodhën në një xhami dhe që mundësuan identifikimin dhe veprimin e mëtijshëm. Në të njëjtën kohë, fakti që në këtë rast nuk u ndoq penalisht asnjë aktakuzë për FT dhe se elementet e identifikuar për financimin e aktiviteteve specifike u hodhën poshtë për shkak të mungesës së provave të mjaftueshme, kjo kërkon vlerësim të mëtijshëm dhe veprime të mundshme nga ana e autoriteteve.

367. U zbulua një rast i përdorimit të rrjeteve sociale për grumbullimin në tentativë të fondeve që do të përdorehin për qëllime terrorizmi. Një llogari e përdorur në këtë proces u mbyll dhe u shpall dënimi. Në të njëjtën kohë, ekipi i vlerësimit nuk mund të konfirmojë se janë ndërmarrë veprime të mjaftueshme për të ndjekur edhe një dënim për FT duke pasur parasysh tipologjinë dhe qëllimin e qartë të aktivitetit dhe instrumentet financiare të identifikuar.

368. Ekipi i vlerësimit u informua për të paktën dy raste kur vepra e FT-së ishte aktualisht në një fazë të avancuar hetimi. Një nga rastet kishte të bënte me një raport të NjIF-it lidhur me transaksionet që ndodhën nga/drejt zonave pranë zonave të konfliktit, që rezultuan në hetimin e disa personave për FT. Në një rast tjetër, elementi i FT-së u identifikua dhe u analizua tërësisht duke përfshirë lidhjet me një numër vendesh të huaja të përdorura për të lëvizur fondet. NjIF-i u përfshi në përpjekjet hetimore. Megjithatë, rasti ende nuk ka përfunduar dhe kështu, vlerësuesit nuk janë në gjendje të japin ndonjë konkluzion përfundimtar mbi efektivitetin e autoriteteve në këtë rast.

369. Përveç rasteve të përmendura, autoritetet e Kosovës kanë ofruar ndihmë të ndërsjellë juridike në masë të konsiderueshme në lidhje me terrorizmin që korrespondon kryesisht me përmasat ndërkombëtare dhe rajonale të kërcënimit. Nuk është e qartë nëse ndonjë prej kërkesave ka përfshirë FT-në. Është gjithashtu interesante që një sërë kërkesash kanë të bëjnë me pastrimin e parave ose krime të tjera, por pa ndonjë informacion specifik për rastet, nuk mund të nxirren përfundime të mëtijshme.

370. Në vitin 2014, ka pasur 3 kërkesa hyrëse që kanë të bëjnë me terrorizmin, njëra prej të cilave është e regjistruar edhe për PP. Kishte 6 kërkesa dalëse të bëra nga autoritetet e Kosovës. Është interesante se tri nga rastet kanë përfshirë edhe PP të mundshëm dhe një nga rastet ka përfshirë krimin ekonomik dhe trafikimin me qenie njerëzore.

371. Analiza e kërkesave për vitin 2015 tregon dy kërkesa hyrëse lidhur me terrorizmin dhe tri kërkesa dalëse për NNJ-në. Një nga kërkesat dalëse me sa duket ka të bëjë me krimin e organizuar.

372. Në vitin 2016 kishte 4 kërkesa hyrëse dhe 5 kërkesa dalëse të NNJ-së për terrorizëm.

373. Statistikat për vitin 2017 tregojnë 4 kërkesa hyrëse të NNJ-së për terrorizëm, njëra prej të cilave përfshinte posedim ose përdorim të paautorizuar të armëve dhe pastrim të parave. Pati 4 kërkesa dalëse nga autoritetet e Kosovës për terrorizëm.

374. Pavarësisht nivelit të lartë të ekonomisë joformale në Kosovë dhe përdorimit të përhapur të korrierëve të parave të gatshme, përfshirë edhe mjaft raste të kontrabandimit të metaleve të çmuara dhe monitorimit përmes sistemit të Menaxhimit të Integruar të Kufirit (MIK), vlerësuesit nuk u vunë në dijeni për ndonjë rast të rëndësishëm të gjeneruar nga ky sistem lidhur me FT të mundshëm. Ka pasur indikacione se informacioni do t'u sigurohet autoriteteve kompetente në rast dyshimi në lidhje me fondet e transportuara përtej kufijve, por nuk ka pasur ndonjë RTD të ndërlidhur me FT-në të raportuar në NjIF për periudhën 2014-2017. Gjithashtu, është vërejtur se asnjë rast i FT-së nuk është hapur në bazë të informacioneve të RTG-ve.

Integrimi me strategjitë vendore

375. Rreziqet e ndërlidhura me FT-në duket se janë të ndara nga krimet e tjera të terrorizmit në strategjitë kundër terrorizmit dhe po ashtu nuk mbulojnë nga hollësi të përshtatshme vepruese në Strategjinë dhe Planin e Veprimit që shënjestron ekonominë joformale dhe pastrimin e parave, financimin e terrorizmit dhe krimet financiare. Pavarësisht nga trajtimi përkatës i FT-së në lidhje me rreziqet që lidhen me ekonominë joformale dhe pastrimin e parave, nuk ekzistojnë rreziqe specifike në lidhje me llojet e veprimtarisë terroriste të vëzhguara dhe nuk ka ndonjë përditësim sa i përket evolimit të kërcënimeve terroriste në Kosovë, rajon dhe në nivel global. Shumica e çështjeve të diskutuara si pjesë e kësaj strategjie kanë të bëjnë në mënyrë rigorozë me dobësitë e sistemit të hetimit dhe ndjekjes penale të rasteve të FT-së. Plani i veprimit përqendrohet më shumë në zbatimin e duhur të standardeve ndërkombëtare në këtë drejtim, që është me rëndësi, por e pamjaftueshme për shkak të mungesës së specifikimeve të mëtejshme në lidhje me rreziqet dhe masat e duhura që duhet të ndërmerren.

376. Autoritetet e përfshira në hetimin dhe ndjekjen penale të terrorizmit dhe FT-së duket të janë të vetëdijshme në përgjithësi për rreziqet specifike që lidhen kryesisht me ndjekjet penale dhe dënimet për terrorizëm si dhe, në një masë të caktuar, për shërbimet lokale të ofruara në lidhje me, për shembull, lëvizjen e parave të gatshme dhe duket se kanë qenë duke monitoruar një lloj rreziku të tillë. Disa interpretime të rasteve të terrorizmit dhe mundësisë për të ndjekur elementët e FT-së duket të jenë të dëmshme për konceptimin e një qasjeje gjithëpërfshirëse në këtë drejtim në nivelin strategjik. Ndarja e lartpërmendur e FT-së nga terrorizmi në nivelin strategjik (sikurse u shtjellua më sipër në lidhje me hetimet) duket të jetë kundërproduktive për kuptimin e përgjithshëm të rreziqeve nga FT-ja dhe integrimin e hetimeve të FT-së në përpjekjet dhe strategjitë kombëtare kundër terrorizmit.

377. Ndonëse nuk u është dhënë vlerësuesve, Strategjia për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Radikalizimit që çon në Terrorizmin 2015-2020 duket se rezulton në përpjekje të konsiderueshme nga autoritetet e Kosovës siç përshkruhet më poshtë (Masat e tjera).

Përdorimi i masave të drejtësisë penale, rregullative dhe të tjera për të ndërprerë aktivitetet të FT-së

378. Autoritetet e Kosovës duket se kanë ndërmarrë masa shtesë në rastet kur nuk mund të sigurojnë dënimin. Kryesisht, këto masa përmbajnë ndalimin e hyrjes në Kosovë, deportime nga autoritetet e Kosovës dhe pezullim të OJF-ve.

379. Shtetasit e huaj që dyshohet se janë përfshirë në aktivitetet të ndërlidhura me terrorizmin janë arrestuar në Kosovë dhe më pas janë deportuar. Në vitin 2016, ka pasur tri deportime nga autoritetet e Kosovës. Në mungesë të statistikave të tjera të detajuara dhe informacionit specifik për raste të deportimit, ekipi i vlerësimit nuk mund të vlerësojë efektivitetin e përdorimit të këtyre masave.

380. Autoritetet e Kosovës kanë ndërmarrë veprime lidhur me pezullimin e OJF-ve në pajtim me nenin 16, paragrafi 4 të Ligjit nr. 04/L-57 për Lirinë e Asociimit në Organizata Joqeveritare që parasheh ndalimin e financimit të organizatave veprimtaria e të cilave konsiderohet i paligjshëm në Kosovë dhe me të drejtën ndërkombëtare. DRNOJQ-ja është fuqizuar që të ekzekutojë pezullimin në pajtim me nenin 18, paragrafi 1 të Udhëzimit Administrativ QRK-nr. 02/2014 për Regjistrimin dhe Funksionimin e Organizatave Joqeveritare pas kërkesës me shkrim dhe arsyetimit nga agjencitë e autorizuar të sigurisë. Departamenti për Organizata Joqeveritare pranë Ministrisë së Administratës Publike ka pezulluar aktivitetet e disa organizatave joqeveritare. Nga këto 5 OJQ u dyshuan për nxitjen e ideologjisë radikale fetare, por sipas autoriteteve më pas u ndoqën dhe u hetuan për PP. Nuk është e qartë nëse janë arritur rezultate të mëtejshme. Dy organizata ishin të lidhura me motivim nacionalist (radikal) dhe pjesa tjetër kanë qenë të orientuara nga fetë dhe dyshohen për përhapjen e ideologjisë fetare ekstremiste.

381. Potencialisht, këto kompetenca të DRNOJQ-së, duke vepruar bashkë me institucionet përkatëse të sigurisë ku kuptohet se hyn edhe AKI-ja, do të ishin mjet i dobishëm për të ndërmarrë veprime alternative kur nuk është e mundur të sigurohet dënimi për FT-në dhe në rast se OJQ-të potencialisht janë të përfshira në FT real. Megjithatë, ky mjet duket se ka efektshmëri të kufizuar duke pasur parasysh faktin se në shumë raste nuk ka rezultuar në pezullimin e aktiviteteve për shkak të mungesës së kontrollit të mëtejshëm. Për më tepër, personat e përfshirë në kontrollin e OJF-ve përkatëse nuk u penguan që të hapin OJF të reja ose të vazhdojnë aktivitetet përmes personave të tjerë juridikë. Ka pasur vetëm disa raste kur personat përgjegjës më në fund kanë ndërprerë aktivitetet dhe janë larguar nga vendi. Për më

tepër, këto pezullime duhet të konfirmohen në baza vjetore dhe me kërkesa të veçanta nga institucionet e sigurisë.

382. Vërehet gjithashtu se disa nga këto organizata janë regjistruar në fillim të viteve 2000 dhe disa prej tyre kanë vepruar për një periudhë të konsiderueshme kohe para se të bëhen subjekte të veprimit nga ana e autoriteteve të sigurisë dhe DRNOJQ-së. OJF-të u pezulluan vetëm në vitin 2014 pas miratimit të Udhëzimit Administrativ të lartpërmendur.

383. Për më tepër, përfshirja e kufizuar e DRNOJQ-së në proces për shkak të karakterit formal të procedurës dhe mungesa e masave të mjaftueshme në regjistrimin dhe proceset e vazhdueshme të kontrollit siç përshkruhet në RM 10, do ta dëmtonin më tej zbatimin e masave të tilla administrative. Në tri vitet e fundit nuk ka pasur raste pezullimi dhe autoritetet thjesht kanë konfirmuar pezullimet e mëparshme. Procedura vetë u është nënshtruar polemikave të mëdha për shkak të mungesës së ndonjë kontrolli nga jashtë mbi procesin, p.sh. kontroll nga gjykata. Duke marrë parasysh numrin e konsiderueshëm të OJQ-ve të pezulluara dhe përdorimin e masës së përkohshme për të siguruar ndërprerje të përhershme të aktiviteteve, ekipi i vlerësimit ka vështirësi në vlerësimin e përshtatshmërisë së masave të ndërmarra në kontekstin e FT-së, që nuk përfshijnë përcjelljen e rasteve me procedura penale në gjykatë. Për më tepër, vlerësuesit kanë shqetësime sa i përket veprimeve në lidhje me OJF-të se mos nuk janë mjaftueshëm bindëse, se mos kanë kontribuar që këto aktivitete të maskohen më tej duke i bërë më të vështira për t'u ndjekur penalisht, p.sh. duke i bërë aktivitetet më të shpërndara dhe duke u mbështetur në forma të tjera përveç OJF-ve. Pikëpamjet e disa prej bashkëbiseduesve nga sektori privat që vlerësuesit takuan në terren mund të jenë të rëndësishme në këtë drejtim pasi shpalosin se rreziqet kryesore do të kishin të bënin me disa organizata fetare që veprojnë jashtë çdo sistemi formal të akreditimit apo regjistrimit. Prandaj, këto masa alternative që përdoren aktualisht duhet të plotësohen nga përpjekjet e shtuara për ekzekutim.

384. Autoritetet identifikuan në vlerësimin e tyre të rrezikut sektorial në vitin 2018 një sërë mangësish që kufizojnë efektivitetin e veprimeve kundër OJF-ve, por ky vlerësim nuk është përfundimtar dhe nuk është e qartë se çfarë veprimi është parashikuar për të siguruar efektivitetin e masave dhe nëse këto gjetje merren parasysh si pjesë e përpunimit të ndryshimeve legjislative për lirinë e asociimit.

Përfundimi i përgjithshëm për Rezultatit e Menjëhershëm 9

385. Pavarësisht mangësive të VKR-së për Kosovën, autoritetet kompetente të Kosovës duket se janë kryesisht të vetëdijshme për rreziqet e mëdha që ndërlidhen me terrorizmin në nivel vendor, rajonal dhe global, ashtu sikurse paraqitet nga strategjitë e miratuara kundër radikalizimit dhe terrorizmit dhe intervistave të kryera.

386. Pavarësisht një niveli të caktuar të të kuptuarit të metodave të ndryshme të FT-së, nuk u demonstroi qartë se autoritetet do të përqendroheshin në mënyrë të barabartë në çështjet e FT-së që përbën një dukuri me specifikat e veta si një nga llojet e krimi financiar.

387. Ka ende disa mangësi që mbesin në kriminalizimin e terrorizmit dhe respektivisht, financimit të terrorizmit në Kosovë përmes KP-së, Ligjit për PPP/LFT-në dhe Ligjit për Ndalimin e Bashkimit në Konfliktet e Armatosura jashtë Territorit të Shtetit. Megjithatë, autoritetet e Kosovës kanë bërë përpjekje të konsiderueshme dhe kanë shfaqur arritje të mëdha në parandalimin dhe ndjekjen e veprimtarive terroriste, më vete dhe në bashkëpunim me vendet e rajonit si dhe me partnerë të tjerë ndërkombëtarë. Në të njëjtën kohë, pavarësisht hetimeve që përfshijnë përpjekje të përbashkëta të agjencive vendore dhe ndërkombëtare, ka pasur ndjekje penale/dënime të kufizuara për FT-në.

388. Janë vënë në zbatim masa alternative në rastet kur nuk ishte e mundur të arrihej dënimi. Edhe pse kanë potencialin për të sjellë përfitime, ato duket se kryesisht janë kufizuar nga mangësi strukturore sa i përket mbikëqyrjes së OJF-ve.

389. **Kosova ka arritur nivel të ulët të efektivitetit me Rezultatit e Menjëhershëm 9.**

Rezultati i Menjëhershëm 10 (Masat parandaluese për FT-në dhe sanksionet financiare)

Zbatimi pa vonesë i sanksioneve financiare të shënjestruara për FT-në

390. Kosova nuk ka vënë në zbatim sanksione financiare të shënjestruara në asnjë formë sistematike për shkak të mungesës së bazës së duhur ligjore sikurse shtjellohet në kuadër të Rekomandimit 6 në Shtojcën e Përputhshmërisë Teknike.

391. Në këtë aspekt, janë ndërmarrë disa masa sporadike. Një shembull ka të bëjë me masat e ndërmarra për të arritur vetëdijesim dhe raportim nga subjektet që mbulon legjislacioni për PPP/LFT-në. Janë dhënë shembuj të RTD-ve që janë dorëzuar pranë NjIF-it në bazë të përputhjeve me entitetet e përcaktuara edhe nga Këshilli i Sigurimit të OKB-së nën Rezolutat përkatëse dhe nga shtetet anëtare të OKB-së. Përveç sistemit të Menaxhimit të Integruar të Kufirit që zbatohet në Kosovë, duket se po merren parasysh edhe këto rreziqe, edhe pse në praktikë asgjë nuk mund të demonstrohet. Përveç kësaj, shënjestrimi i subjekteve të përcaktuara në lista ndodhi në momente të ndryshme në bashkëpunim me vendet e tjera.

Qasja e shënjestruar, sensibilizimi dhe mbikëqyrja e organizatave jofitimprurëse në rrezik

392. Autoritetet e Kosovës nuk i kanë vlerësuar si duhet në VKR rreziqet e ndërlidhura me OJF-të. Gjetjet nga vlerësimi i rrezikut nuk mund të konsiderohen si një mjet i dobishëm për të përcaktuar politikat praktike dhe masat zbutëse dhe nuk i kontribuojnë mjaftueshëm të kuptuarit të përgjithshëm të kërcënimeve sektoriale. Megjithatë, si rezultat i monitorimit të bërë nga autoritetet e sigurisë dhe të zbatimit të ligjit, një sërë OJF u identifikuan se paraqisnin kërcënim për radikalizimin dhe u pezulluan, ashtu si edhe shtjellohet në RM 9, gjë që konsiderohet të jetë nxitës kryesor për përfshirjen e vazhdueshme të OJF-ve edhe nën legjislacionin e mëparshëm, edhe atë aktual të PPP/LFT-së të vitit 2016. Një tjetër shpjegim mund të lidhet me përdorimin në dukje të gjerë të OJF-ve për qëllime jashtë ligjit për lirinë e asociimit. Janë lëshuar 60 refuzime për regjistrim të OJF-ve vetëm në vitin 2018, bazuar në aktivitete që bien ndesh me lirinë e asociimit, p.sh. biznes apo aktivitete të tjera. Nuk është paraqitur asnjë rast refuzimi për arsye të lidhura me terrorizmin ose FT-në.

393. Masat e ndërmarra në lidhje me përpjekjet e autoriteteve përgjegjëse për LFT-në nuk u përqendruan në ndonjë nëngrup specifike të OJF-ve, edhe pse masat për të siguruar shënjestrim më efektiv duket se janë ndërmarrë tashmë në vitet 2015-2016 përmes analizës së bashkërenduar nga NjIF-i për flukset e ndërlidhura me OJF-të, ku kryesisht vlerësohet burimi i financimit dhe rreziqet gjeografike të flukseve dhe pasojat e tyre për OJF-të në Kosovë. Ky ushtrim, pavarësisht se rezultoi me raste të mundshme për hetime të mëtejshme, nuk rezultoi me ndonjë masë të duhur të shënjestruar për këtë sektor.

394. Në vitet 2017-2018 u bënë tentativa për një qasje më të përqendruar për vlerësimin sektorial të rrezikut në sektorin jofitimprurës, në bashkëpunim me OJF-të. Vlerësimi i rrezikut të OJF-ve u mbështet në përfshirjen e një sërë OJF-ve e autoriteteve dhe u identifikuan një sërë dobësish specifike strukturore. Shumica e tyre konsiderohen nga bashkëbiseduesit kompetentë se kryesisht janë të vlefshme dhe thelbësore dhe ato analizohen më poshtë. Megjithatë, rreziqet specifike që ndërlidhen me nën-grupin e organizatave që bartin rreziqet më të mëdha nuk u identifikuan. Një shembull i rëndësishëm është se disa nga rreziqet e kuptuara nga OJF-të në lidhje me p.sh. struktura rajonale të aktiviteteve të ndërlidhura me terrorizmin nuk duket të jenë identifikuar në vlerësimin sektorial dhe nuk duket të jenë ndjekur nga masa specifike. Janë vërejtur disa mospërputhje sa i përket gjetjeve të vlerësimit sektorial të rrezikut, opinioneve të autoriteteve përkatëse dhe sektorit privat. Kështu, vlerësimi i rrezikut ende nuk mund të konsiderohet si bazë e mjaftueshme për zbatimin e qasjes së shënjestruar.

395. Nga vlerësimi sektorial i rrezikut u ngritën një sërë çështjesh që përqendrohen kryesisht në aftësinë për të përdorur paratë e gatshme, fondet e transferuara, llogaridhënien e OJF-ve, përshtatshmërinë dhe kontrollet e duhura dhe mospërputhjet ndërmjet aktiviteteve të deklaruar kundrejt atyre reale të OJF-ve. Kjo kryesisht korrespondon me gjetjet dhe pikëpamjet e përfaqësuesve të OJF-ve me të cilët është bashkëbiseduar në terren. Megjithatë, sipas mendimit të bashkëbiseduesve nga sektori privat, kjo nuk do të paraqitej si ndonjë bazë faktike që tregon përfshirjen e OJF-ve në FT.

396. Një çështje e rëndësishme e identifikuar në lidhje me rregullimin e OJF-ve dhe që gjithashtu merret me vlerësimin e rrezikut sektorial kishte të bënte me besueshmërinë e regjistrave të mbajtur në lidhje me OJF-të dhe procesin e regjistrimit dhe masat e zbatuara për

të siguruar që informacioni është i përditësuar. Para së gjithash, vërehen vështirësi dhe mangësi specifike lidhur me mbledhjen e informatave të plota (sidomos kur bëhet fjalë për financimin dhe identifikimin e personave kontrollues) posaçërisht në lidhje me OJF-të që kanë pjesëmarrje të huaj. Vlen të përmendet se ato përbëjnë rreth një të katërtën e të gjitha OJF-ve në Kosovë. Është e qartë që ka bashkëpunim ndërmjet autoriteteve, sidomos ndërmjet DRNOJQ-së në njërin anë dhe NjIF-it, PK-së dhe AKI-së në anën tjetër. Megjithatë, vështirësitë në këtë drejtim janë ende të pranishme dhe ato përbëjnë pengesë të konsiderueshme. Siç është vërejtur në vlerësimin sektorial (pavarësisht mospajtimit nga DRNOJQ-ja) si dhe nga sektori privat, regjistri nuk konsiderohet të jetë mjaftueshëm i përditësuar. Gjithashtu, vlen të përmendet se ka pasur vonesa dhe pengesa në mbajtjen e hollësive të plota mbi personat e përfshirë dhe mbi informacionin bazë të OJF-ve.

397. Për më tepër, ka shumë pak gjasa që problemi të ketë të bëjë vetëm me OJF-të pasive (pa aktivitet operativ) duke pasur parasysh numrin e madh të OJF-ve që marrin mbështetje publike (vlerësohet nga përfaqësuesit e sektorit që të jenë rreth 3.000). Vështirësi të dukshme janë vërejtur sa i përket identifikimit të organizatave aktive dhe pasive pasi nuk ekzistojnë detyrime për raportim dhe mbikëqyrje për këtë. Nuk ka gjithmonë persona që do të ishin përgjegjës për komunikimin e informacionit. Kjo çështje përkeqësohet më tej nga DRNOJQ-ja që përqendrohet vetëm në OJF-të që veprojnë në të mirë të publikut dhe nuk merren masa të tjera të konsiderueshme për OJF-të e tjera. Disa ndryshime dhe një databazë e re u zbatuan në vitin 2017, megjithëse pa zgjidhur shumicën e çështjeve të ngutshme.

398. Disa nga aktivitetet e caktuara mbikëqyrëse të ATK-së synonin raportimin financiar të OJF-ve edhe në lidhje me kërkesat specifike për deklaratat tatimore, por situata në përgjithësi duket e pandryshuar në këtë drejtim, duke marrë parasysh problemet e NjIF-it për të identifikuar dhe kontaktuar OJF të përzgjedhura si pjesë e vlerësimit të rrezikut, edhe në vitin 2017. Vlerësimi i disa bashkëbiseduesve ishte se më pak se 10% e OJF-ve mbajnë dokumentacionin e duhur për shkak të mungesës së trajnimit ose mungesës së qasjes proporcionale ndaj segmentit specifik që bart rreziqe të mëdha. Kjo gjë gjithashtu do të kishte një efekt të dëmshëm në raportimin financiar.

399. Fakti që disa organizata fetare mund të përfaqësojnë një zonë të hirtë sa i përket regjistrimit dhe kontrollit komprometon ngjashëm aftësinë aktuale të autoriteteve për të pasur një pasqyrë të të gjithë sektorit dhe për t'i përqendruar përpjekjet e tyre në fushat e rrezikut. Kjo çështje është ngritur në vlerësimin sektorial si "mungesë e akreditimit kombëtar për OJQ-të fetare" dhe gjithashtu përbënte shqetësim për shumë OJF që u takuan në terren.

400. Autoritetet kanë sensibilizuar sektorin e OJF-ve dhe kanë bërë një sërë trajnimesh. ATK-ja u përfshi në trajnimet e sektorit të OJF-ve kryesisht për qëllime tatimore dhe zbatimin e masave që do të mundësonin zbatimin më efektiv të masave të përgjegjësisë financiare. Këto masa duhet të vlerësohen në dritë të raportimit të mangët financiar që u përmend nga disa bashkëbisedues dhe përdorimit në dukje të gjerë të OJF-ve për qëllime ekonomike, në kundërshtim me kërkesat e Ligjit për Lirinë e Asociimit. Pavarësisht përfitimit të këtyre trajnimeve në kuptim të përgjegjësisë, vihet re se nuk ka ndonjë përqendrim të veçantë që do t'u kontribuonte përpjekjeve për FT-në dhe, për më tepër, bashkëbiseduesit e takuar në terren nuk konfirmonin efektin e këtyre trajnimeve në vetëdijësimin e OJF-ve. Nuk ka pasur ndonjë sensibilizim domethënës nga ana e NjIF-it (trajnimi i vetëm është mbajtur në vitin 2014 me 16 persona nga OJF-të) edhe pse është vërejtur përpjekja e bashkëpunimit për vlerësimin sektorial. Nuk ka pasur aspak përfshirje nga ana e DRNOJQ-së për sensibilizim. Sipas OJF-ve, mungesa e sensibilizimit është problemi më i madh, por nuk ka pasur ndonjë konsensus konkret për autoritetin që do të marrë përgjegjësinë kryesore për këtë. Është gjithashtu e qartë se në strukturën ekzistuese institucionale nuk ka burime të mjaftueshme të dedikuara për detyrën e sensibilizimit të duhur, ndoshta me përjashtim të ATK-së.

Tabela 32: Trajnimet nga ATK-ja për OJF-të

Viti	Numri i punëtorive – temave	Temat e prezantuara
2018	5	Tatimi mbi të ardhura dhe kontributet pensionale, taksa për qira, TVSH dhe rimbursimi i TVSH, tatimi korporativ – deklaratat vjetore e DK, raportimi i blerjeve mbi 500 euro.
2017	26	Deklarata Vjetore dhe Deklaratat për Raportime Financiare, Aplikimi i Taksës Kthyesë të TVSH për të ofruar shërbime në sektorin e ndërtimit brenda vendit; Libri i Raportimit të Blerjeve dhe Shitjeve përmes sistemit

Viti	Numri i punëtorive – temave	Temat e prezantuara
		elektronik – EDI; Ligji për Administratën Tatimore dhe Procedurat; Ligji për Taksën mbi Vlerën e Shtuar; Ligji për Taksa për të Ardhurat Personale; Ligji për të Ardhurat Korporative; trajtimi i OJQ-ve për Taksa dhe Paga e Kontribute Pensionale; Trajtimi i OJQ-ve për Taksën mbi Qira; Trajtimi i OJQ-ve për TVSH – rimbursim të TVSH; Trajtimi i OJQ-ve për Taksën Korporative – Deklarata Vjetore CD; Raportimi i blerjeve mbi 500 euro; Deklarata për Sistemin Elektronik – EDI; Sistemi i taksave në Kosovë; Informata të Përgjithshme për TVSH; Tarifa e fiksuar e TVSH për fermerë; Rimbursimi i TVSH; taksa burimore (përqendrimi te taksa në burim sipas kategorive të veçanta); Trajtimi i tokave të marra me qira; Deklarimi i taksave; Aplikimi për Tarifën Kthyese të TVSH për shërbime të blera jashtë Kosovës; Trajtimi i borxhit, donacionit dhe deklarimi i TVSH.
2016	21	Deklarimet vjetore të bizneseve individuale (PD); Deklarata vjetore e Korporatës (CD); Deklarata e partneritetit (DO); Raportimi i blerjeve mbi 500 euro; Raportimi i deklaratave financiare; Raportimi financiar i ndërmarrjeve në Kosovë; Taksa për paga dhe kontribute pensionale; Taksa për qira; TVSH dhe rimbursimi i TVSH; Libri i raportimit të blerjeve dhe shitjeve përmes sistemit elektronik – EDI; Aplikimi për taksën kthyese të TVSH për shërbime të ofruara në sektorin e ndërtimit brenda vendit; taksa në burim të pagës dhe kontributet pensionale; Qëllimi dhe objektivi i sistemeve të taksave në përgjithësi (Ligji për Administratën Tatimore dhe Procedurat, TVSH, TPI dhe TCI); Informata të nevojshme për të vetëpunësuarit; Detyrimet dhe përgjegjësitë ndaj ATK; Detyrimi për të paguar TVSH kur ofron shërbime në sektorin e ndërtimit – Aplikimi për Tarifën Kthyese të TVSH brenda vendit; Deklarata dhe pagesa e sigurimit shëndetësor; Zhvillime në ATK që synojnë përmbushjen e detyrimeve tatimore.
2015	24	Deklarata vjetore e bizneseve individuale (PD); Deklarata vjetore e korporatave (CD); Deklarata e partneritetit (DO); Raportimi i blerjeve mbi 500 euro; tatimi në burim; Lehtësime në deklarim dhe pagesë të taksave – Sistemi i ri elektronik – EDI; Taksa për paga dhe kontribute pensionale; Taksa për qira; TVSH dhe rimbursimi i TVSH; raportimi i blerjeve mbi 500 euro; Taksa për korporata – deklarata vjetore – CD; Deklarata përmes sistemit elektronik – EDI; Taksa e Vlerës së Shtuar – TVSH; Taksa për të ardhura personale – TPI; taksa për të ardhura korporative – TCI; zbatimi i pakos së re të taksave; Ligji nr. 05/L-037 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar; Ligji nr. 05/L-029 për Tatimin mbi të Ardhurat e Korporatave; Ligji nr. 05/L-028 për Tatimin mbi të Ardhurat Personale; Ligji nr. 05/L-043 për Faljen e Borxhit Publik; Udhëzimi Administrativ nr. 03/2015 për zbatimin e ligjit nr. 05/L-037 për TVSH; Ligji nr. 05/L-043 për Faljen e Borxhit Publik; Udhëzimi Administrativ nr. 03/2015 për zbatimin e ligjit nr. 05/L-037 për TVSH; trajtimi i kontratave afatgjate në ndërtim nga aspekti i kontabilitetit dhe tatimeve.

401. Mbikëqyrja e sektorit të OJF-ve bëhet nga ATK-ja dhe NjIF-i në përputhje me kompetencat e tyre përkatëse. Kështu, ATK-ja përqendrohet në kontrollin e tatimeve në mënyrë që të konstatohet baza për aplikimin e përjashtimeve tatimore. Këto kryesisht ndërlidhen me rimbursimin e TVSH-së, verifikimin e faturave etj. Ndodhin edhe inspekte në bazë të kërkesave specifike për institucionet kompetente, por kjo nuk tejkalon verifikimin e fondeve dhe shpenzimeve. NjIF-i ka inspektuar gjatë viteve të fundit rreth 10 OJQ për qëllime pajtueshmërie me Ligjin për PPP/LFT-në. Disa prej tyre janë identifikuar se nuk janë në përputhje me ligjin në fjalë. Me qëllim të përmirësimit të masave ndaj PP/FT-së, NjIF-i ka nxjerrë masa përmirësuese (rekomandime). Pas këtyre veprimeve, shumica e këtyre OJQ-ve kanë ndërmarrë veprime për të zbatuar ligjin. Rezultatet e inspektimeve kryesisht tregojnë mungesë të njohurive për masat e kërkuara nga legjislati për PPP/LFT-në pavarësisht se ai është në fuqi (lidhur me OJF-të) prej një periudhe kohore të konsiderueshme. Vlerësuesit gjithashtu u vunë në dijeni për masat shtesë që janë marrë, p.sh. për një OJQ që nuk ka ndërmarrë masa përmirësuese, NjIF-i ka nxjerrë urdhër për ngrirjen e fondeve dhe ka proceduar rastin për ndjekje penale nga prokuroria kompetente. Veprimi nga NjIF-i u pasua me masa të sekuestrimit me vendim të gjykatës. Dy OJF të tjera u pezulluan si rezultat i mbikëqyrjes. Ata përsëri tentuan të hapin organizata të tjera me emra të ndryshëm. Një prej tyre tentoi të hapë dy ose tre OJF të reja me emra të

ndryshëm. Edhe duke pasur parasysh shënjestrimin e OJF-ve në bashkëpunim me inteligjencën dhe PK-në, aktivitetet mbikëqyrëse duket se përgjithësisht janë të pamjaftueshme dhe nuk janë në gjendje të sjellin ndryshime të konsiderueshme sa i përket vetëdijesimit dhe zbatimit të masave të PPP/LFT-së, përveç mungesës së përqendrimit të mëtejshëm krahas shkëmbimit të informacionit me zbatimin e ligjit. Efektiviteti vlerësohet gjithashtu duke marrë parasysh rezultatet relativisht të kufizuara të masave të pezullimit sikurse shtjellohet në RM 9. Sa i përket rezultateve që lidhen me numrin e RTD-ve nga OJF-të, vërehet mungesa e plotë e raporteve të tilla.

402. Efektet e sensibilizimit nga NjIF-i janë të dukshme në monitorimin dhe raportimin që bëjnë bankat sipas kërkesave të legjislationit për PPP/LFT-në. Rreth një e treta e RTD-ve të pranuar nga NjIF-i lidhur me FT të mundshëm gjatë periudhës 2014-2017 kanë pasur të bëjnë me aktivitetet e OJF-ve. Në të njëjtën kohë, një sërë bashkëbiseduesish theksuan masat e sigurisë nëpër banka që kanë ardhur si rezultat i punës së bankave për t'i nxjerrë OJF-të jashtë sistemit financiar formal. Kjo duhet të shihet në lidhje me vëzhgimet e bëra për vlerësimin e rrezikut sektorial në temën e përdorimit të parave të gatshme që ende përbën problem të konsiderueshëm përkundër kërkesave të pragut në legjislationin për PPP/LFT-në. Kjo shihet qartë si një çështje që kërkon përmirësim të mëtejshëm të efektivitetit të mbikëqyrjes, por gjithashtu është çështje e zbatimit të një qasjeje praktike të përqendruar ndaj OJF-ve.

Privimi nga pasuritë dhe dobitë e FT-së

403. Ashtu siç është theksuar, nuk ka pasur sanksione të shënjestruara të zbatuara nga autoritetet e Kosovës në mënyrë sistematike dhe kjo është vërejtur edhe në vlerësimin sektorial të rrezikut të OJF-ve si çështje me rëndësi që kërkon veprim urgjent për të mundësuar shënjestrimin e personave dhe organizatave të përcaktuara.

404. Sa i përket identifikimit të pasurive dhe instrumenteve të FT-së vërehet se ka pasur ndjekje penale apo dënime të kufizuara për FT-në, kështu që ka mundur të bëhet privimi i kufizuar i pasurisë, ndryshe nga privimi i pasurisë në rastet e lidhura me terrorizmin, që kryesisht ka të bëjë me instrumentet, ashtu siç u shtjellua në RM 9.

405. Sa i përket identifikimit të pasurive të tilla si pjesë e raportimit të transaksioneve të dyshimta dhe hetimeve lidhur me FT të mundshëm, janë diskutuar një sërë rastesh që kanë rezultuar në gjurmimin e këtyre pasurive. Ashtu siç është cekur më lart, NjIF-i i ka identifikuar pasuritë e tilla të mundshme në bazë të dyshimit për FT si rezultat i aktiviteteve mbikëqyrëse dhe të RTD-ve të marra nga bankat, e në disa raste edhe nga autoritetet publike. Identifikimi i fondeve që lidhen me aktivitetet e OJF-ve të dyshuara për FT rezultoi në veprime të ngrirjes në disa raste që më vonë u liruan, pas kontrolleve të plota mbi prejardhjen dhe qëllimin. Në të njëjtën kohë, NjIF-i ka zhvilluar një analizë në vitet 2015-2016 në bashkëpunim me BQK-në për të gjitha transaksionet që lidhen me një sërë juridiksionesh dhe më pas u hapën disa raste. Përkundër shumave të mëdha të përfshira dhe disa rasteve të hetimeve të mëtejshme, vlerësuesit nuk u informuan nëse u siguruan fonde të konsiderueshme. Sa i përket rreziqeve të personave që udhëtojnë për t'u bashkuar me zonat e konfliktit, aktivitetet e NjIF-it kanë rezultuar në të paktën një rast në identifikimin e lëvizjes së fondeve nga zonat fqinje të zonës së konfliktit dhe kështu autoritetet hetuese ndërmorën veprime të mëtejshme për FT të mundshëm. Siç është cekur edhe në pjesë të tjera të këtij raporti, nuk ka pasur ndonjë veprim nga autoritetet për të kontrolluar nëse ndonjë PP i ndërlidhur me FT-në po ndodh në ndonjërin nga rastet, sidomos lidhur me të kthyerit apo për të siguruar fonde në këtë drejtim.

406. Sa i përket privimit të pasurive për terrorizëm, statistikat e siguruar nga AAPSK-ja tregojnë për pak raste dhe shuma të papërfillshme që janë sekuestruar dhe konfiskuar. Këtu hyn një rast në vitin 2016 për shumën 142 euro, 4 raste në vitin 2017 për 11.236,10 euro dhe një rast në vitin 2018 për 5 euro.

Koherenca e masave me profilin e përgjithshëm të rrezikut të FT-së

407. Autoritetet e Kosovës kanë demonstruar se kanë të kuptuar të konsiderueshëm për kërcënimet terroriste në territorin e tyre, por jo edhe të aspekteve të ndërlidhura me FT-në, pavarësisht përpjekjeve të konsiderueshme për të kuptuar mënyrën e veprimit në aktivitetet përkatëse të ndërlidhura me terrorizmin. Nuk është demonstruar, as në nivel strategjik, as në nivel operativ, se FT do të ishte një përparësi e barabartë për parandalimin dhe ndjekjen penale të veprimtarive terroriste në përputhje me rrezikun.

408. Kosova ka zhvilluar elementet kryesore strukturore të nevojshme për ndjekjen e suksesshme të rasteve të FT-së dhe në shumë raste, autoritetet kanë demonstruar veprime të bashkërenduara në raste të mundshme të FT-së. Megjithatë, nuk është arritur asnjë rezultat dhe nuk ka pasur identifikim të rëndësishëm të pasurisë. Masat e ndërmarra në lidhje me OJF-

të janë të pamjaftueshme ose zbatohen me një vonesë të konsiderueshme edhe për shkak të mungesës së identifikimit të nënsektorëve që bartin rreziqet kryesore; OJF-të nuk janë shënjestruar si duhet lidhur me kërcënimet nga FT-ja. Pavarësisht të të kuptuarit të rreziqeve të FT-së sa i përket dobësive dhe kërcënimeve që lidhen me ekonominë joformale, është vënë përqendrim i pamjaftueshëm në kërcënimet e FT-së në lidhje me paratë e gatshme në Kosovë.

409. Së fundmi, por jo për nga rëndësia, Kosova nuk ka zbatuar asnjë regjim gjithëpërfshirës për të shënjestruar personat dhe pasuritë në pajtim me kërkesat e KS të OKB-së sa i përket FT-së.

Përfundimi i përgjithshëm për Rezultatin e Menjëhershëm 10

410. Kosova nuk ka vënë në zbatim në asnjë mënyrë sistematike sanksionet e shënjestruara sipas RKSKB-ve 1267 dhe 1373. Ka disa përpjekje prej disa autoriteteve, sidomos NjIF-it, DK-së dhe Policisë Kufitare, për të zbatuar masa të caktuara parandaluese dhe specifike në lidhje me RKSKB-të e përmendura, por ato konsiderohen të një rëndësie anësore në mungesë të mekanizmave të tjerë ligjorë.

411. Duket se një sërë mangësish legjislative si dhe joefektiviteti i administratës ndikojnë në zbatimin e masave parandaluese kundër OJF-ve, më e rëndësishmja ndër të cilat duket të jetë mungesa e kompetencave administrative për pezullim të përhershëm të aktiviteteve të OJF-ve kur nuk është e mundur të arrihet dënimi penal. Përpjekjet e konsiderueshme nga AZL-të dhe NjIF-i nuk duket të pasqyrohen si duhet në mbikëqyrjen e zgjeruar formale dhe në ndryshimin e praktikave administrative.

412. Gjithashtu, vërehet se numri i pezullimeve të përkohshme të OJF-ve nuk ka sjellë ndonjë shtysë të fortë drejt miratimit të një qasjeje gjithëpërfshirëse për këtë sektor, edhe pse autoritetet e Kosovës kanë filluar përpjekje të pjesshme për të siguruar zhvillimin e mëtejshëm të masave lehtësuese sipas rrezikut.

413. Autoritetet e Kosovës kanë shfaqur privimin efektiv të terroristëve nga instrumente (zakonisht shuma të vogla ose pasuri me vlerë relativisht të kufizuar sikurse tregohet në RM 9), por nuk ka ndonjë sukses të konsiderueshëm me përqendrimin te pasuritë e mundshme të OJQ-ve ose financuesve të terroristëve.

414. **Kosova ka arritur nivel të ulët të efektivitetit me Rezultatin e Menjëhershëm 10.**

Rezultati i Menjëhershëm 11 (Sanksionet financiare për FP-në)

Zbatimi pa vonesë i sanksioneve financiare të shënjestruara të ndërlidhura me financimin e përhapjes

415. Kosova nuk ka ndërmarrë masa të duhura legjislative apo masa të tjera për të zbatuar pa vonesë sanksionet financiare të shënjestruara (në vijim: SFSH) të ndërlidhura me Rezolutat e OKB-së për luftimin e përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë. Ndonëse ekzistojnë ligje të përgjithshme për zbatimin e sanksioneve ndërkombëtare, këto ligje nuk janë përdorur për të zbatuar RKSKB-të në lidhje me FP-në.

416. Për më tepër, nuk ekziston ndonjë mekanizëm për zbatimin e SFSH-ve të OKB-së lidhur me FP-në. E vetmja masë e ndërmarrë është që lista e sanksioneve të Këshillit të Sigurimit të OKB-së për persona dhe subjekte të përcaktuara publikohet në faqen e internetit të NjIF-it, duke informuar subjektet e rregulluara jo vetëm për SFSH-të e ndërlidhura me FT-në, por edhe për SFSH-të që kanë të bëjnë me FP-në.

Identifikimi i pasurive dhe fondeve që mbahen nga persona/entitete të përcaktuar dhe ndalimet

417. Institucionet më të mëdha financiare, kryesisht bankat që janë filiale ose degë të një grupi ndërkombëtar, kanë krijuar procese dhe sisteme për zbatimin e SFSH-ve të ndërlidhura me FP-në (shih edhe RM 10). Institucionet financiare dhe BPCJF-të mund të përdorin faqen e internetit të NjIF-it si burim informacioni, edhe pse ka shumë pak njohuri se listat e publikuara në faqen e internetit të NjIF-it përmbajnë të dhëna që shkojnë përtej SFSH-ve të ndërlidhura me FP-në.

418. Subjektet e tjera raportuese përveç bankave dukshëm nuk janë në dijeni të regjimit të sanksioneve të OKB-së lidhur me FP-në. Ndërsa në sektorin bankar ka njohuri të përgjithshme

për ekzistencën e "listave" që duhet të shqyrtohen, ka shumë pak njohuri për dallimet ndërmjet FT-së dhe FP-së. Në sektorin e BPCJF-ve dhe në rastin e institucioneve financiare jobankare, njohuritë janë të papërfillshme.

419. Nuk janë identifikuar përputhje me RKS KB-të që kanë të bëjë me FP-në, dhe deri tani nuk është ngrirë asnjë pasuri e ndërlidhur me FP-në.

420. Në dritë të faktit se nuk ka dispozita ligjore për zbatimin e SFSH-ve që kanë të bëjnë me FP-në, është e paqartë se çfarë hapash mund të ndërmerren nga subjektet në rast se ka përputhje. Për më tepër, institucionet financiare, BPCJF-të dhe autoritetet shtetërore nuk kanë kompetenca dhe procedura përkatëse për të vënë në zbatim masat e duhura lidhur me ngrirjen e pasurive të personave dhe subjekteve të përcaktuar.

421. Autoritetet kosovare kanë argumentuar se ekziston një mekanizëm i tërthortë për ngrirjen e pasurive që ndërlidhet me FT-në përmes një Udhëzimi Administrativ të nxjerrë nga NjIF-i pas pranimit të një raporti që sugjeronte se fondet mbahen në lidhje me një individ ose entitet të përmendur në sanksione, mirëpo ky nuk mund të zbatohet në sanksione që ndërlidhen me FP-në. Institucionet financiare dhe BPCJF-të që mund të kenë në posedim fonde ose pasuri të tjera të mbuluara nga regjimi i sanksioneve të FP-së nuk kanë detyrim të ngrijnë pasuritë dhe nuk marrin asnjë udhëzim se çfarë duhet të bëjnë në rrethana të tilla.

Të kuptuarit që kanë IF-të dhe BPCJF-të për detyrimet dhe respektimi i tyre

422. Njohuritë që kanë subjektet raportuese për detyrimet e tyre për të ngrirë pasuritë sipas RKS KB-ve 1718 dhe 1737 janë shumë të kufizuara. Siç u përmend më lart, me përjashtim të bankave më të mëdha, shumica e subjekteve raportuese nuk kishin njohuri për regjimin e sanksioneve të OKB-së lidhur me FP-në.

423. Janë nxjerrë shumë pak udhëzime se si të zbatohen sanksionet e FP-së. Udhëzimi i vetëm në fakt ka të bëjë me raportimin e transaksioneve të dyshimta për FT-në te NjIF-i, ku është bërë lidhje me sanksionet nga OKB-ja, BE-ja dhe OFAC-u, mirëpo kjo nuk konsiderohet e mjaftueshme për të siguruar ngrirjen e duhur dhe në kohë të pasurive. Ai gjithashtu përqendrohet te raportimi i transaksioneve dhe aktivitetit të ndërlidhur me FT-në dhe për këtë arsye ka pak rëndësi për subjektin raportues për të kuptuarit e veprimeve që duhen ndërmarrë për të ngrirë pasuritë e ndërlidhura me FP-në.

424. Për më tepër, vetë autoritetet nuk kanë demonstruar vetëdijen dhe prirjen e nevojshme për të mbikëqyrur zbatimin e RKS KB-ve në lidhje me luftimin e FP-së. As vetë vlerësuesit nuk ishin të kënaqur me nivelin e bashkërendimit dhe bashkëpunimit në nivel vendor.

Autoritetet kompetente të cilat sigurojnë dhe monitorojnë pajtueshmërinë

425. Nuk ka legjisllacion që të parashohë mekanizëm të njohur publikisht për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga RKS KB-të përkatëse për RM 11. Për më tepër, ekipi i vlerësimit nuk ka pranuar ndonjë informacion që të tregojë se autoritetet mbikëqyrëse monitorojnë institucionet financiare dhe BPCJF-të për pajtueshmërinë e tyre me detyrimet e ndërlidhura me SFSH-të për FP-në.

426. Përveç mosekzistencës së një kornize ligjore për zbatimin e SFSH-ve të ndërlidhura me FP-në, nuk është caktuar asnjë autoritet kompetent për të vënë në zbatim këtë detyrim. Asnjë autoriteti nuk i është dhënë kompetenca për të siguruar as për të monitoruar pajtueshmërinë e zbatimit të SFSH-ve të OKB-së për FP-në.

427. Për më tepër, nuk del që autoritetet mbikëqyrëse të kenë ndërmarrë ndonjë veprim specifik rregullativ për mospajtueshmërinë me SFSH-të që kanë të bëjnë me regjimin e FP-së. Kjo duket se rrjedh nga fakti që autoriteteve mbikëqyrëse nuk u është caktuar ndonjë funksion i veçantë në këtë drejtim.

Përfundimi i përgjithshëm për Rezultatit e Menjëhershëm 11

428. Kosova nuk ka ndërmarrë masa legjisllative ose masa të tjera të duhura për të zbatuar pa vonesë sanksionet financiare të ndërlidhura me RKS KB-të që kanë të bëjnë me luftimin e FP-së të ASHM-ve. Përveç bankave më të njohura, subjektet e tjera raportuese nuk janë në dijeni të regjimit të sanksioneve të OKB-së lidhur me FP-në. Duke pasur parasysh mungesën e një kornize rregullative për SFSH-të që kanë të bëjnë me përhapjen e ASHM-ve, asnjë autoritet nuk ka fuqinë për t'i zbatuar këto sanksione të OKB-së dhe për të ngrirë çdo pasuri të ndërlidhur të identifikuar. Prandaj, sistemi i luftimit të FP-së në përgjithësi nuk mund të konsiderohet të jetë efektiv.

429. **Kosova ka arritur nivel të ulët të efektivitetit me Rezultatin e Menjëhershëm 11.**

KAPITULLI 5. MASAT PARANDALUESE

Gjetjet kryesore dhe veprimet e rekomanduara

Gjetjet kryesore

- Të kuptuarit e rreziqeve të PP/LFT-së dallon dukshëm ndërmjet përfaqësuesve të sektorit privat. Krahas vetëdijesimit të duhur për faktorë rrethorë të rrezikut dhe segmente me rrezikshmëri më të lartë, subjektet raportuese kanë pikëpamje shumë më pak eksplicite sa i përket metodave dhe modeleve me të cilat kryesit mund të keqpërdorin sistemet financiare dhe jofinanciare në Kosovë për pastrim të parave ose financim të terrorizmit.
- Bankat dhe deri sa është në përpjesëtim me ekspozimin e tyre ndaj rrezikut, institucionet e tjera financiare (përveç zyrave të këmbimit valutor) shfaqin një nivel të caktuar të të kuptuarit të rreziqeve të PP-së. Të kuptuarit e rreziqeve nga FT është i kufizuar kryesisht në përdorimin e listave të publikuara nga OKB-ja, BE-ja dhe OFAC-u. Zyrat e këmbimit valutor dhe praktikisht të gjithë BPCJF-të kanë shumë më pak, nëse kanë, të kuptuar dhe vlerësim për rreziqet e PP/FT-së. Përfshirja dhe vetëdijesimi për rrezikun në nivel vendor dhe sektorial si mjet për të përmirësuar të kuptuarit e rreziqeve të PP/FT-së dhe detyrimeve të PPP/LFT-së është minimal në mesin e bankave dhe joekzistent në mesin e institucioneve të tjera financiare dhe BPCJF-ve.
- Bankat dhe institucionet e tjera financiare (me përjashtim të zyrave të këmbimit valutor) i përshkruajnë mirë kornizat e tyre të zbutjes së rrezikut, ku përfshihen të tri linjat e mbrojtjes (zyra kryesore, funksioni i pajtueshmërisë, auditimi i brendshëm). Ata raportojnë se i kanë zbatuar kërkesat e Ligjit për PPP/LFT-në për të vlerësuar dhe dokumentuar periodikisht rreziqet e tyre. Megjithatë, gjetjet e autoriteteve mbikëqyrëse, si dhe intervistat e ekipit të vlerësimit, paraqesin mospërputhje me këtë kërkesë.
- Duket se efektshmëria e zbatimit të masave zbutëse në përpjesëtim me rreziqet duket se zbatohet kryesisht nëpër banka, në një masë të arsyeshme në institucionet e tjera financiare, dhe nuk ekziston në zyrat e këmbimit valutor dhe të gjithë BPCJF-të.
- Bankat dhe institucionet e tjera financiare (përveç zyrave të këmbimit valutor) shfaqin se kanë njohuri të mira për kërkesat e zbatueshme në Ligjin për PPP/LFT-në dhe rregulloret përkatëse lidhur me KDK-në dhe ruajtjen e të dhënave. Megjithatë, të kuptuarit e pronësisë përfituese kufizohet ekskluzivisht në atë të zotërimit direkt të 25% ose më shumë aksioneve në një kompani, ashtu siç përcaktohet me Ligjin për PPP/LFT-në. Në mesin e BPCJF-ve, vetëm noterët dhe, deri diku avokatët, raportojnë se zbatojnë masa shumë bazike të KDK-së si identifikimi i klientëve dhe verifikimi i identitetit të tyre.
- Bankat dhe institucionet e tjera financiare (me përjashtim të zyrave të këmbimit valutor) janë në gjendje të shpjegojnë në mënyrë të kuptueshme politikat dhe procedurat e tyre për zbatimin e masave të shtuara ndaj PEP-ëve dhe ato të përcaktuara nga FATF-ja për vendet me rrezikshmëri më të lartë dhe, kur është e mundur, për marrëdhëniet korresponduese bankare, teknologjitë e reja dhe transfertat bankare. Megjithatë, verifikimi i burimit të fondeve shpesh është bërë në mënyrë formale.
- Edhe pse legjislati i Kosovës nuk zbaton sanksione financiare që shënjestrojnë FT-në dhe FP-në, në praktikë, të gjitha bankat dhe institucionet financiare jobankare raportojnë se përdorin listat e publikuara nga OKB-ja, BE-ja dhe OFAC-u për të identifikuar përputhjet e mundshme me emrat e personave dhe subjekteve të përcaktuara. BPCJF-të kanë pak ose, në shumicën e rasteve, aspak njohuri për masat e shtuara ose specifike që duhet të zbatohen në lidhje me SFSH-të dhe në situata me rrezik më të lartë.
- Performanca e raportimit të transaksioneve të dyshimta ka shumë dallim ndërmjet

subjekteve të Ligjit për PPP/LFT-në, ku bankat dhe, në një masë shumë më të vogël, kompanitë e transferimit të parave dhe institucionet mikrofinanciare, mbeten të vetmet burime të raportimit të transaksioneve të dyshimta. Për më tepër, duket se ekziston një performancë shumë e ndryshme e raportimit të RTD-ve edhe ndërmjet bankave. Deklaratat e autoriteteve për përmirësimin e cilësisë së RTD-ve janë disi në kundërshtim me numrin në zbritje të vazhdueshme të raportimeve nga NjIF-i për agjencitë e zbatimit të ligjit si përqindje e numrit të RTD-ve të pranuar.

- Diskutimet për proceset e raportimit të RTD-ve të bankave paraqesin praktikën e mundshme të trajtimit sipërfaqësor të alarmimeve, si dhe sfidat me cilësinë e raporteve të RTD-ve të paraqitura. Masat për parandalimin e nxjerrjes së informacionit nëpër banka duken të jenë në nivel të duhur, gjë kjo që mundësohet nga funksioni i veçantë i pajtueshmërisë me PPP-në me qasje ekskluzive në analizat dhe raportimet e ndërlidhura me RTD-në.
- Zbatimi i kontrolleve të brendshme dhe procedurave nga bankat dhe institucionet e tjera financiare (përveç zyrave të këmbimit valutor) duket se nxjerrin rezultate të mira, gjë që nuk mund të supozohet për zyrat e këmbimit valutor dhe BPCJF-të për shkak të mungesës së njohurive për PPP/LFT-në nga njëra anë dhe fushëveprimi i intensitetit të pamjaftueshëm të mbikëqyrjes nga ana tjetër.
- Bankat flasin për pasigurinë lidhur me interpretimin aktual të autoriteteve se si duhet të arrihet pavarësia e funksionit të PPP-së në aspektin e masave institucionale. Gjithashtu, zbatimi i detyrimeve të ndërlidhura me PEP-ët duket se shkon përtej kërkesës së Standardeve të FATF-së, duke krijuar kështu vështirësi të arsyeshme për subjektet raportuese me aktivitetet të lartë në transaksione.

Veprimet e rekomanduara

Sa i përket **të kuptuarit të rreziqeve të PP/FT-së dhe detyrimeve të PPP/LFT-së**, Kosova duhet të marrë masa për të:

- Nxitur të kuptuarit më të mirë nga subjektet raportuese të metodave dhe modeleve specifike me të cilat kryesisht mund të keqpërdorin sistemet financiare dhe jofinanciare në Kosovë;
- Avancuar të kuptuarit nga subjektet raportuese të rreziqeve të FT-së përtej përdorimit të listave të publikuara nga OKB-ja, BE-ja dhe OFAC-u;
- Siguruar përfshirje më të mirë të subjekteve raportuese në vlerësimet vendore dhe sektoriale të rrezikut si mjet për të përmirësuar të kuptuarit e rreziqeve të PP/FT-së dhe detyrimeve të PPP/LFT-së.

Sa i përket **zbatimit të masave për zbutjen e rrezikut**, Kosova duhet të ndërmarrë masa për të:

- Siguruar zbatimin e duhur të kërkesës për subjektet raportuese që periodikisht të vlerësojnë dhe dokumentojnë rreziqet e tyre;
- Ofruar udhëzime specifike për subjektet raportuese se si të përgatisin dhe zhvillojnë vlerësime të rrezikut;
- Siguruar zbatimin e duhur të masave zbutëse në raport me rreziqet nga të gjitha subjektet raportuese në përgjithësi dhe nga zyrat e këmbimit valutor dhe të gjitha BPCJF-të në veçanti.

Sa i përket **zbatimit të KDK-së dhe kërkesave për ruajtje të të dhënave**, Kosova duhet të ndërmarrë masa për të:

- Nxitur të kuptuarit për pronësinë përfituese përtej asaj të zotërimit të drejtpërdrejtë të 25% apo më shumë aksioneve në një kompani;
- Konsideruar që t'u japë më shumë udhëzime dhe fleksibilitet subjekteve raportuese kur të vendosin për shpeshësinë e përditësimit të plotë të informacionit të KDK-së,

sidomos në lidhje me klientët me rrezikshmëri të ulët;

- Siguruar zbatim të duhur të masave përkatëse të KDK-së nga të gjitha subjektet raportuese në përgjithësi, dhe nga zyrat e këmbimit valutor dhe të gjithë BPCJF-të në veçanti.

Sa i përket **zbatimit të masave të shtuara ose specifike**, Kosova duhet të ndërmarrë masa për të:

- Përcaktuar dhe zbatuar masa më efektive për verifikimin e burimit të fondeve, si përcaktimi i standardeve minimale për prova dokumentare të pranueshme për këtë;
- Siguruar zbatim efektiv të sanksioneve financiare që shënjestrojnë FT-në dhe FP-në, si dhe zbatim uniform nga të gjitha subjektet raportuese të masave të ndjeshme ndaj rrezikut bazuar në faktorin e rrezikshmërisë së vendit;
- Kërkuar që bankat dhe kompanitë e transferimit të parave të mbajnë softuer të avancuar për shqyrtimin e transaksioneve që të mundësojë analiza të rregullta ose rast pas rasti të transaksioneve në dhe nga lokacionet fqinje me zonat me rrezikshmëri më të lartë.

Sa i përket **detyrimeve për raportim dhe nxjerrje të informacionit**, Kosova duhet të ndërmarrë masa për të:

- Zhvilluar rregulla dhe praktika për dhënien e informatave kthyesë të përgjithshme dhe specifike për subjektet raportuese lidhur me raportimin e RTD-ve;
- Rishikuar listat e indikatorëve për identifikimin e dyshimeve për PP dhe FT duke marrë parasysh karakteristikat e klientëve, transaksionet ose marrëdhëniet e biznesit, si dhe tiparet specifike të llojeve të ndryshme të subjekteve raportuese;
- Vendosur parametra të cilësisë së RTD-ve dhe për të zbatuar kërkesa të përcaktuara qartë dhe të rrepta të gjenerimit dhe raportimit të RTD-ve.

Sa i përket **kontrolleve dhe procedurave të brendshme**, Kosova duhet të ndërmarrë masa për të:

- Siguruar zbatimin e duhur të programeve përkatëse për PPP/LFT-në nga të gjitha subjektet raportuese në përgjithësi dhe nga zyrat e këmbimit valutor dhe të gjithë BPCJF-të në veçanti.

Sa i përket **faktorëve që pengojnë zbatimin efektiv**, Kosova duhet të ndërmarrë masa për të:

- Shqyrtuar rishikimin e qasjes ndaj interpretimit të arritjes së pavarësisë së funksionit të PPP-së duke pasur parasysh katër elementët bazë të konceptit të pavarësisë që qëndron në themel të kësaj (shih më poshtë);
- Shqyrtuar krijimin e filtrave të arsyeshëm për përjashtime nga miratimi i drejtuesve të lartë për transaksione të ndërlidhura me PEP-ët ashtu siç përcaktohen në Ligjin për PPP/LFT-në.

430. Rezultati i Menjëhershëm përkatës i shqyrtuar dhe i vlerësuar në këtë kapitull është RM 4. Rekomandimet përkatëse për vlerësimin e efektivitetit në këtë seksion janë R.9-23.

Rezultati i menjëhershëm 4 (Masat parandaluese)

Të kuptuarit e rreziqeve të PP/FT-së dhe detyrimeve për PPP/LFT-në

431. Të kuptuarit e rreziqeve të PP/FT-së dallon dukshëm ndërmjet përfaqësuesve të sektorit privat. Mangësia e përbashkët se si subjektet raportuese kuptojnë dhe interpretojnë rrezikun është se ata janë të vetëdijshëm për shembull, për ekonominë e bazuar në para të gatshme si faktor rrethor i rrezikut dhe të sektorit të ndërtimit si segment me rrezikshmëri të lartë, por

kanë pikëpamje shumë më pak të qarta mbi metodat dhe modelet përmes të cilave kryesisht mund të keqpërdorin sistemet financiare dhe jofinanciare në Kosovë për të pastruar paratë ose për të financuar terrorizmin.

432. Bankat dhe deri diku në përpjesëtim me ekspozimin e tyre ndaj rrezikut, institucionet e tjera financiare (me përjashtim të zyrave të këmbimit valutor) shfaqin një nivel të caktuar të të kuptuarit të rreziqeve të PP-së, karakteristike për Kosovën. Tipologjitë më të shpeshta të PP-së janë të lidhura me shmangien nga tatimi nëpërmjet përdorimit të llogarive personale për aktivitetet ndërmarrëse dhe qarkullimin në shkallë të gjerë të parave të gatshme; me mekanizma të paqëndrueshëm në financimin e ndërtimeve rezidenciale dhe ndërtime të tjera të dokumentuara si transaksione të këmbimit në fazën e zhvillimit dhe kompensime në natyrë në fazën e realizimit; dhe depozitat dhe/ose transfertat pa artikullim të arsyeshëm të burimit të fondeve. Të kuptuarit e rreziqeve të FT-së është i kufizuar kryesisht me përdorimin e listave të publikuara nga OKB-ja, BE-ja dhe OFAC-u. Kjo nuk është në përpjesëtim me ekspozimin faktik të Kosovës ndaj rreziqeve të FT-së përmes sektorit të gjerë të OJF-ve cenueshmëria e të cilit ende është për t'u vlerësuar kundrejt këtyre rreziqeve.

433. Perceptimi i rrezikut të institucioneve financiare përveç bankave duket të jetë i duhur dhe i mbështetur në tiparet specifike të mbulimit gjeografik të aktiviteteve të tyre, bazës së klientëve, produkteve dhe shërbimeve, si dhe metodave të tyre të shpërndarjes. Për shembull, institucionet mikrofinanciare ofrojnë kredi me tavan prej 25 mijë euro (që aplikohet në shumën e përgjithshme të të gjitha kredive që i janë dhënë huamarrësit dhe personave të ndërlidhur), ku shumica dërrmuese e huamarrësve janë individë dhe shuma mesatare e kredisë është rreth 2 mijë euro. Ose, institucionet mikrofinanciare, kompanitë e lizingut dhe shoqëritë e sigurimeve nuk pranojnë dhe bëjnë pagesa në para të gatshme – të gjitha faturat dhe pagesat duhet të bëhen nga / në një llogari bankare. Aktorët kryesorë në tregun e IMF-ve dhe IFJB-ve janë pjesë e grupeve më të mëdha financiare ndërkombëtare¹⁶ dhe sistemeve globale të pagesave¹⁷, pra të përfshira nën një shtresë shtesë të politikave dhe kontrolleve grupore kundrejt pajtueshmërisë me PPP/LFT-në.

434. Zyrat e këmbimit valutor dhe praktikisht të gjithë BPCJF-të kanë shumë më pak, nëse kanë, të kuptuarit dhe vlerësim të rreziqeve të PP/FT-së. Kjo nuk duket të jetë në përpjesëtim me ekspozimin ndaj rrezikut faktik, duke pasur parasysh faktorët e rëndësishëm rrethorë (që janë paraqitur në analizën për RM 1) me ndikim negativ të situatës e përgjithshme e rrezikut.

435. Përfshirja në dhe vetëdijesimi për vlerësimet e rrezikut në nivel vendor dhe sektorial si mjete për të përmirësuar të kuptuarit e rreziqeve të PP/FT-së dhe detyrimeve të PPP/LFT-së është minimal në mesin e bankave dhe joekzistent në mesin e institucioneve të tjera financiare dhe BPCJF-ve. Kjo do të thotë se vlerësimet e iniciuara dhe të zhvilluara nga autoritetet duhet të bëhen më shumë gjithëpërfshirëse lidhur me sektorin privat përmes ndihmesave përkatëse në fazën e zbatimit dhe komunikimit të duhur në fazën e shpërndarjes.

Zbatimi i masave për zbutjen e rrezikut

436. Bankat dhe institucionet e tjera financiare (me përjashtim të zyrave të këmbimit valutor) përshkruajnë në mënyrë të papenguar kornizat e tyre për zbutjen e rrezikut ku përfshihen të tri linjat e mbrojtjes, domethënë zyra pritëse/funksioni i shërbimit ndaj klientit që ka përgjegjësi për identifikimin dhe komunikimin e alarmimeve për PP/FT, funksionin e pajtueshmërisë që ka përgjegjësi për kryerjen e masave të PPP/LFT-së dhe funksionin e auditimit të brendshëm, i ngarkuar me testimin e pavarur të të gjithë zbatimit të kërkesave të PPP/LFT-së. Ata raportojnë se kanë zbatuar kërkesat e Ligjit për PPP/LFT-në për të vlerësuar dhe dokumentuar periodikisht rreziqet e tyre. Autoritetet i paraqesin këto vlerësime si gurrthemeli për krijimin e kornizës për identifikim, vlerësim dhe zbutje të rrezikut, që thekson zbatimin e qasjes së bazuar në rrezik. Megjithatë, gjetjet nga mbikëqyrja, si dhe intervistat e ekipit të vlerësimit tregojnë ndryshime në pajtueshmërinë me këtë kërkesë, ku shumë institucione financiare ende përpunojnë metodologjitë dhe praktikatat më të mira për vlerësimin e rrezikut.

437. Cilësia e ushtrimit të vlerësimit të rrezikut ndryshon në varësi të kapaciteteve të institucionit financiar dhe raporti për një bankë që u vu në dispozicion të vlerësuesve kishte mangësi strukturore dhe përmbajtësore që minojnë dobinë e tij për qëllime praktike. Shumica e institucioneve të tjera financiare dhe të gjithë BPCJF-të nuk e kanë zbatuar ende këtë kërkesë të Ligjit për PPP/LFT-në. Ekziston nevojë e qartë për më shumë udhëzime në përgatitjen dhe

¹⁶ P.sh. Raiffeisen Bank International, BNP Paribas

¹⁷ P.sh. Western Union, MoneyGram

zhvillimin e vlerësimeve të rrezikut nga subjektet raportuese, mundësisht në formën e një metodologjie që artikulon parimet dhe metodat e përgjithshme, si dhe qasjet specifike – duke marrë parasysh madhësinë dhe rrezikun e ekspozimit të llojeve të bizneseve individuale – të zbatueshme për vlerësime të tilla.

438. Trajtimi i klientëve i mbështetur në rrezik nënkupton kategorizimin e tyre në grupe me rrezik të lartë, të mesëm dhe të ulët (ndonjëherë edhe përcaktimin e një tjetër kategorie “shumë të lartë” rreziku). Rregulli i përgjithshëm është zbatimi i shtuar, standard dhe i thjeshtuar i KDK-së, respektivisht, i klientëve të vlerësuar si me rrezikshmëri të lartë, të mesme dhe të ulët. Në të gjitha bankat dhe institucionet e tjera financiare (me përjashtim të zyrave të këmbimit valutor) këto vlerësime të rrezikut thuhet se janë zbatuar në softuerin bazë operativ, duke lehtësuar kështu procesin vendimmarrës në lidhje me masat e duhura të zbatueshme. Disa banka raportojnë se zbatojnë masa standarde të KDK-së edhe për klientë me rrezik të ulët. Kategoria e rrezikut e përcaktuar fillimisht i nënshtrohet shqyrtimit në bazë të ndryshimeve thelbësore në faktorët përbërës të rrezikut.

439. Në përgjithësi, efektiviteti i zbatimit të masave zbutëse në përpjesëtim me rreziqet duket që kryesisht ndodh te bankat dhe në një shkallë të arsyeshme edhe tek institucionet e tjera financiare si dhe është joekzistent për zyrat e këmbimit valutor dhe të gjitha BPCJF-të.

Zbatimi i KDK-së dhe kërkesat për ruajtjen e të dhënave

440. Bankat dhe institucionet e tjera financiare (përveç zyrave të këmbimit valutor) shfaqin njohuri të mira për kërkesat e zbatueshme në Ligjin për PPP/LFT-në dhe rregulloret përkatëse lidhur me shtyllat e regjimit parandalues, domethënë KDK-në dhe ruajtjen e të dhënave. Me sa kuptohet, pjesë e procesit të KDK-së është identifikimi i klientëve dhe pronarëve përfitues, verifikimi i identitetit të tyre, verifikimi i kompetencave të personave të autorizuar, përcaktimi i qëllimit dhe natyra e synuar e marrëdhënies së biznesit dhe zhvillimi i monitorimit të vazhdueshëm të transaksioneve. Asnjë nga subjektet raportuese nuk raporton të ketë praktika të mbështetjes së përcaktuar nga FATF-ja të palë të treta që të kryejnë disa elemente të caktuara të masave të KDK-së.

441. Megjithatë, të kuptuarit e pronësisë përfituese kufizohet vetëm në zotërimin e drejtpërdrejtë të 25% ose më shumë aksioneve në një kompani ashtu siç përcakton Ligji për PPP/LFT-në. Nacionet e pronësisë përfituese përmes zotërimit të tërthortë të aksioneve të kompanisë dhe, më e rëndësishmja, përmes kontrollit efektiv, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, mbi klientin pa asnjë aksion vështirë se kuptohen dhe nuk duket se zbatohen ndonjëherë në praktikë.

442. Përditësimi i informatave të KDK-së bëhet në baza vjetore, dyvjeçare dhe trevjeçare për klientët me rrezik përkatësisht të lartë, të mesëm dhe të ulët. Në këtë drejtim, sektori privat kërkon më shumë udhëzime dhe, kur është e përshtatshme, më shumë fleksibilitet për të vendosur mbi frekuencën e përditësimit të plotë të informacionit të KDK-së veçanërisht në lidhje me klientët me rrezik të ulët. Nëse autoritetet zgjedhin të lejojnë një fleksibilitet të tillë, në radhë të parë duhet të sigurohet zbatimi i duhur i qasjes së bazuar në rrezik dhe në veçanti, kategorizimi i duhur i rrezikut të klientëve që bëhet përmes rishikimeve të rregullta të profilit të tyre të rrezikut.

443. Në mesin e BPCJF-ve, vetëm noterët dhe, në një masë të kufizuar, avokatët (kur firmat e avokatëve ofrojnë mbështetje juridike për transaksionet e mëdha ekonomike) raportojnë se zbatojnë masa shumë themelore të KDK-së si identifikimi i klientëve dhe verifikimi i identitetit të tyre. Megjithatë, edhe këto BPCJF nuk e kuptojnë siç duhet konceptin e pronësisë përfituese; as nuk e shohin nevojën për identifikimin e palëve, përveç atyre që vijnë në zyrat e tyre për shërbime noteriale ose juridike. BPCJF-të e tjera nuk zbatojnë asnjë masë të KDK-së.

444. Të gjitha subjektet raportuese i referohen një periudhe minimale 5-vjeçare (ose në disa raste edhe më të gjatë) të mbajtjes së të gjitha dokumenteve, të dhënave dhe informacioneve të tjera të mbledhura gjatë aktiviteteve të tyre të biznesit.

Zbatimi i masave të shtuara ose specifike

445. Bankat dhe institucionet e tjera financiare (me përjashtim të zyrave të këmbimit valutor) janë në gjendje të shpjegojnë në mënyrë të kuptueshme politikat dhe procedurat e tyre për zbatimin e masave të shtuara për PEP-ët dhe vendet me rrezikshmëri më të lartë sipas përcaktimit të FATF-së dhe, kur është e mundur, për marrëdhëniet korresponduese bankare, teknologjite e reja dhe transfertat bankare.

446. Monitorimi i vazhdueshëm i shtuar, përditësimet më të shpeshta të informacionit të KDK-së dhe, në rastin e PEP-ëve, miratimi nga drejtuesit e lartë i veprimtarisë së lidhur me

transaksionet janë masat kryesore të kujdesit të shtuar që aplikohen për klientët me rrezikshmëri të lartë. Verifikimi i burimit të fondeve, që kërkohet në rast të transaksioneve me para të gatshme mbi 10 mijë euro dhe çdo transaksioni me klientë me rrezikshmëri më të lartë (përfshirë PEP-ët), shpesh kufizohet në plotësimin e fushës përkatëse të formularit të posaçëm të zhvilluar nga BQK-ja me tekstin që lexon "kursimet", "ndihma financiare" dhe të ngjashme.

447. Edhe pse kuptohet se në një ekonomi të bazuar fuqishëm në para të gatshme dhe në ndërlidhje me flukse të konsiderueshme nga diaspora e madhe e kosovarëve që jetojnë jashtë, klientët shpesh mund të kenë vështirësi në shpjegimin e burimit të fondeve, ndaj vlerësuesit konsiderojnë se duhen përcaktuar dhe ekzekutuar masat më efektive si, për shembull, standardet minimale për dëshmi dokumentare të pranueshme për burimin e fondeve për t'u siguruar që fondet me origjinë potencialisht të paligjshme nuk hyjnë në ekonomi në përgjithësi dhe në sistemin financiar në veçanti.

448. Verifikimi i statusit të PEP-ëve bëhet duke shfrytëzuar listën e Agjencisë kundër Korrupsionit në rastin e PEP-ëve vendorë dhe të databazave komerciale¹⁸ për PEP-ë të huaj dhe përfaqësues të organizatave ndërkombëtare. Lista e Agjencisë kundër Korrupsionit siguron emrat, mbiemrat dhe të dhënat e tjera për identifikimin e zyrtarëve të nivelit të lartë dhe funksionarëve publikë, ashtu siç përcaktohen me Ligjin për PPP/LFT-në. Shumica e klientëve PEP-ë raportohen se janë vendorë. Të kuptuarit e pamjaftueshëm të nocionit të pronësisë përfituese mund të ketë ndikim të konsiderueshëm negativ mbi efikasitetin e masave që synojnë përcaktimin e pronarëve përfitues në lidhje me individët dhe personat juridikë.

449. Rrjeti korrespondues i llogarive të bankave nuk është i gjerë. Përveç llogarive të NOSTRO/LORO që mbahen nga banka të tjera që veprojnë në Kosovë, bankat kanë llogari NOSTRO pranë bankave të mëdha evropiane¹⁹ dhe amerikane, si dhe me bankat e tyre mëmë²⁰. Bankat në Kosovë nuk ofrojnë shërbime korrespondente, nuk i drejtohen shërbimit të pagueshëm përmes llogarive të përkohshme dhe janë shumë mirë në dijeni të përgjegjësive të tyre në kuadër të marrëdhënieve bankare korresponduese sikurse përcaktohet me Ligjin për PPP/LFT-në.

450. Bankat dhe institucionet e tjera financiare janë mjaft konservatore sa i përket zhvillimit dhe zbatimit të produkteve dhe praktikave të reja të biznesit, përfshirë mekanizmat e reja të shpërndarjes, si dhe përdorimin e teknologjive të reja. Ato janë pa të meta në përshkrimin e proceseve dhe procedurave për vlerësimin dhe zbutjen e rreziqeve para lansimit apo përdorimit të produkteve, praktikave dhe teknologjive të tilla, nëse ka të tilla.

451. Bankat raportojnë se përdorin sistemin SWIFT për të gjitha transfertat bankare hyrëse dhe dalëse ndërkufitare. Ato nuk janë të përfshira si institucione ndërmjetëse në transfertat elektronike, gjë që është e arsyeshme duke pasur parasysh rolin e tyre në marrëdhëniet korrespondente me bankat e tjera. Kompanitë e transferimit të parave përdorin sistemet e tyre (si Western Union dhe MoneyGram). Praktika uniforme shfaqet te kërkesa për refuzimin e çdo transferte elektronike kur mungon informacioni për origjinën ose përfituesin.

452. Për sa i përket zbatimit të sanksioneve financiare të shënjestruara për FT-në dhe FP-në, legjislati në fuqi nuk parasheh masa për të ngrirë pa vonesë pasuritë e personave apo subjekteve të përfshirë në terrorizëm e përhapje dhe në financimin e tyre. Megjithatë, në praktikë, të gjitha bankat dhe institucionet financiare jobankare raportojnë se përdorin listat e publikuara nga OKB-ja, BE-ja dhe OFAC-u, ose duke i zbatuar në softuerin bazë operativ (në rastin e të gjitha bankave dhe kompanive të transferimit të parave) ose duke i përdorur për kërkime manuale (në rastin e institucioneve të tjera financiare jobankare, me përjashtim të zyrave të këmbimit valutor) për të identifikuar përputhjet e mundshme me emrat e personave dhe subjekteve të përcaktuara.

453. Për sa i përket qasjes ndaj juridiksioneve të përcaktuara dhe të identikuara nga FATF-ja si me rrezikshmëri më të lartë, bankat dhe kompanitë e transferimit të parave raportojnë se kanë zbatuar në softueret bazë operative kriteret e rrezikshmërisë më të lartë lidhur me vendin e regjistrimit apo operimit të klientit (faktori i rrezikshmërisë së vendit), duke iu referuar kryesisht listave të ofruara nga kompania mëmë dhe/ose ato të publikuara në faqen e internetit të FATF-së (duke ndjekur lidhjen në faqen e NjIF-it). Kompanitë e lizingut këshillojnë zbatimin e masave të shtuara në rast të marrëdhënieve dhe transaksioneve me klientët nga vendet me rrezikshmëri më të lartë, nëse ka. Shoqëritë e sigurimeve deklarojnë se ato nuk i shesin

¹⁸ Për shembull si World Check dhe Dow Jones Watch list etj.

¹⁹ Ndodhen në Gjermani, Austri, Francë, Zvicër, Belgjikë etj.

²⁰ Ndodhen në Turqi, Shqipëri, "Ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë".

produktet e sigurimit të jetës për jorezidentët/të huajt. Zyrat e këmbimit të valutave dhe BPCJF-të nuk marrin ndonjë masë të ndjeshme ndaj rrezikut bazuar në faktorin e rrezikshmërisë së vendit.

454. Sa i përket qasjes ndaj vendeve me rrezikshmëri më të lartë, do të ishte e dobishme për bankat dhe kompanitë e transferimit të parave që të mirëmbajnë softuer të avancuar për shqyrtimin e transaksioneve që mundësojnë analiza të rregullta ose rast pas rasti të transaksioneve, përfshirë kartën e kreditit ose pagesat direkte, në dhe nga vendet fqinje me zonat e konfliktit në Evropën Lindore ose Lindjen e Mesme. Kjo është e rëndësishme duke pasur parasysh praninë e konsiderueshme të bankave me marrëdhënie të gjera (kompanitë mëmë) që gjenden dhe veprojnë në vendet e afërta me ato zona.

455. Në përgjithësi, BPCJF-të kanë pak ose, në shumicën e rasteve, aspak njohuri për masat e shtuara ose specifike dhe kryesisht i referohen praktikave të tyre operative kur merren me klientë brenda aktiviteteve rutinore të punës, por jo si masa specifike parandaluese të rëndësishme për PPP/LFT-në. Prandaj, zbatimi i dobët i masave parandaluese nga ana e tyre është rezultati i drejtpërdrejtë i hamendësuar i njohurive të pamjaftueshme në fushën e PPP/LFT-së.

Detyrimet për raportim dhe zbulimi

456. Tabela më poshtë paraqet disa statistika lidhur me numrin e RTD-ve të paraqitura te NjIF-i për periudhën 2014-2017:

Tabela 33: RTD-të e paraqitura te NjIF-i

	2014	2015	2016	2017
Institucione financiare				
Banka	234	350	438	683
Institucione mikrofinanciare	-	2	6	5
Zyra për këmbimin valutor	1	-	-	-
Kompani për transfertat parash	58	39	34	34
BPCJF				
Noterë	-	-	2	-
Subjekte të tjera raportuese				
Dogana	1	4	1	-
Mbikëqyrës sektorialë	-	2	2	4
Të tjerë	1	1	2	2
Gjithsej RTD	295	398	485	728

457. Performanca e raportimit të transaksioneve të dyshimta dallon shumë ndërmjet subjekteve të Ligjit për PPP/LFT-në. Ndërkohë që lidhur me numrat absolutë ekziston një dinamikë e dukshme pozitive në raportimin e RTD-ve gjatë periudhës 2014-2017 me një rritje mesatare vjetore prej rreth 40%, bankat dhe në një masë shumë më të vogël, kompanitë e transferimit të parave dhe institucionet mikrofinanciare mbeten të vetmet burime të raportimit të transaksioneve të dyshimta. Nga ana tjetër, ka një rritje vjetore prej rreth 20% të numrit të RTG-ve (domethënë raporteve për transaksionet në para të gatshme që kapërcejnë pragun e 10 mijë eurove) që paraqiten pranë NjIF-it, të cilat, edhe nëse merren si rezultat i hamendësuar i rritjes së aktivitetit ekonomik në Kosovë, janë sërish tregues i përdorimit të vazhdueshëm të parave të gatshme me implikime të konsiderueshme sa i përket rreziqeve të mundshme të PP/FT-së.

458. Për më tepër, duket se ka një performancë tepër të ndryshueshme të raportimit të RTD-ve edhe ndërmjet bankave, ku disa prej tyre ndjehen të kënaqura me zbatimin e kërkesave për raportim duke paraqitur RTG-të dhe duke e shpjeguar këtë me madhësinë e vogël të biznesit apo profilin e ulët të rrezikut nga baza e klientëve, gjë që në të vërtetë nuk është vetëjustifikim i plotë dhe duhet të mbështetet nga një sistem plotësisht funksional i kontrolleve të brendshme. Të gjithë përfaqësuesit e sektorit privat theksojnë rëndësinë që ka për ta të marrin informata kthyesë më të përgjithshme dhe më specifike nga NjIF-i lidhur me pajtueshmërinë me kërkesat e PPP/LFT-së në përgjithësi dhe me punën e raportimit të RTD-ve në veçanti.

459. NjIF-i ka nxjerrë dy lista të veçanta të treguesve për identifikimin e dyshimeve për PP-në dhe FT-në. Këto lista me shumë tregues të përkufizuar me formulime të njëjta / të ngjashme patjetër do të përfitonin nga një prezantim i strukturuar i treguesve për dyshime lidhur me karakteristikat e klientëve (p.sh. identiteti, statusi, sjellja), transaksionet ose marrëdhëniet e

biznesit (p.sh. natyra, lloji, zbatimi metoda), si dhe treguesit për dyshime specifike për llojet e ndryshme të institucioneve financiare dhe BPCJF-ve.

460. NjIF-i i referohet cilësisë së përmirësuar të RTD-ve gjatë periudhës së 2-3 viteve të fundit, por megjithatë, nuk përshkruan qartë kriteret për matjen e kësaj cilësie. Kjo deklaratë është disi në mospërputhje me përqindjen gjithnjë e në zvogëlim të raportimeve nga agjencitë e zbatimit të ligjit në përpjesëtim me numrin e RTD-ve të pranuar (treguesit për periudhën 2015-2017 janë përkatësisht 22%, 21% dhe 15%). Kjo mund të vërë në pah, para së gjithash, nevojën për të përcaktuar qartë parametrat e cilësisë së RTD-ve dhe së bashku me vënien në zbatim të masave të përshtatshme institucionale për kontrollin e pajtueshmërisë me kërkesat e raportimit të RTD-ve (siç përshkruhet në analizën për RM 3) dhe përmirësimin e treguesve të aktivitetit të dyshimtë (siç përshkruhet më sipër), për të zbatuar kërkesat e gjenerimit dhe raportimit të RTD-ve të përcaktuara saktësisht dhe të zbatueshme.

461. Diskutimet rreth proceseve të raportimit të RTD-ve nga bankat paraqesin praktikën e mundshme të trajtimit sipërfaqësor të alarmimeve që gjeneron softueri bazë operativ në bazë të tipologjive të përfshira dhe treguesve të aktivitetit të dyshimtë. Në veçanti, disa banka raportojnë se merren me 25-30 alarmime në ditë për anëtar të stafit, gjë që nuk duket të jetë ushtrim realist nëse bëjmë një analizë gjithëpërfshirëse për çdo alarmim, duke marrë parasysh të gjithë faktorët e rrezikut përkatës. Edhe raportimi mbrojtës duket të jetë pjesë e praktikave aktuale.

462. Masat për parandalimin e zbulimit duket të jenë në një nivel të duhur nëpër banka, gjë kjo që mundësohet nga funksioni i veçantë i PPP-së me qasje të vetme në analizat dhe raportimet e ndërlidhura me RTD-të. Përmendet trajnimi dhe edukimi i stafit të përfshirë drejtpërdrejt në shërbimin ndaj klientit për masat parandaluese që parandalojnë zbulimin.

Kontrollet dhe procedurat e brendshme

463. Në përgjithësi, zbatimi i kontrolleve dhe procedurave të brendshme nga bankat dhe institucionet e tjera financiare (me përjashtim të zyrave të këmbimit valutor) duket se prodhon rezultate të shëndosha, sikurse konstatohet edhe nga gjetjet e mbikëqyrjes. Kjo nuk mund të hamendësohet për zyrat e këmbimit valutor apo BPCJF-të për shkak të mungesës së njohurive për PPP/LFT-në nga njëra anë dhe fushëveprimin dhe intensitetin të pamjaftueshëm të mbikëqyrjes nga ana tjetër.

464. Bankat raportojnë se kanë zbatuar programe të PPP/LFT-së që përmbajnë politika, procedura dhe kontrolle me elemente të përfshira për të luftuar PP/FT-në. Këto përfshijnë funksion të pavarur të pajtueshmërisë së PPP-së, procedura për përzgjedhjen e punonjësve, programin e trajnimit të stafit dhe një funksion të auditimit të pavarur të brendshëm. Marrëveshjet e duhura të qeverisjes, të tilla si miratimi i politikave dhe procedurave nga Bordi dhe komunikimi me drejtuesit dhe stafin raportohen se janë themeluar. Masat e mëtejshme të kontrollit përfshijnë, ndër të tjera, monitorimin e performancës së stafit me përgjegjësitë e PPP/LFT-së dhe marrjen e masave korrigjuese sipas nevojës.

Faktorët që pengojnë zbatimin efektiv

465. Bankat i referohen pasigurisë së interpretimit aktual të autoriteteve lidhur me atë se si duhet të arrihet pavarësia e funksionit të PPP-së në aspekt të marrëveshjeve institucionale. Bankave sidomos nuk u lejohet të kenë funksionin të PPP-së në kuadër të strukturës më të gjerë të pajtueshmërisë (që është përgjegjëse, ndër të tjera, për pajtueshmërinë ligjore dhe rregullative) nën dritën e mospërputhjes së perceptuar ndërmjet rregullores së NjIF-it mbi funksionin e pajtueshmërisë dhe kriterëve të përshtatshme e të duhura për zyrtarin e pajtueshmërisë në njërin anë, dhe rregullores së BQK-së për qeverisjen korporative të bankave nga ana tjetër. Vlerësuesit rekomandojnë rregullimin e hollësishëm dhe harmonizimin e këtij interpretimi me standardet dhe praktikën më të mira ndërkombëtare, sidomos duke pasur parasysh katër elementet themelore që janë në themel të konceptit të pavarësisë (pra, statusi zyrtar, kreu i funksionit, shmangia e konfliktit të interesit dhe qasja në informacion dhe personel).

466. Për më tepër, sipas Ligjit për PPP/LFT-në, kur klienti ose pronari përfitues përcaktohet të jetë PEP, subjektet raportuese duhet të marrin miratimin e drejtuesit të lartë jo vetëm për krijimin apo vazhdimin e marrëdhënies së biznesit, por edhe për kryerjen e çdo transaksioni tjetër të rastit pavarësisht nga shumica, qëllimi dhe parametrat e tjerë të rrezikut të transaksionit. Kjo shkon përtej kërkesave të standardeve të FATF-së dhe raportohet se krijon vështirësi të ndryshme për subjektet raportuese me aktivitet të lartë transaksionesh, sidomos për bankat, sa i përket alokimit të burimeve për shqyrtimin dhe miratimin e transaksioneve me sa duket me standard ose me rrezik të ulët. Vendosja e filtrave të arsyeshëm për përjashtime

(të tilla si pragu monetar prej disa qindra eurosh, lloje të caktuara të transaksioneve si pagesat e shërbimeve) do ta përmirësonte zbatimin kuptimplotë dhe joformal të kësaj kërkesë.

Përfundimet e përgjithshme për RM 4

467. Ndër subjektet raportuese, bankat janë institucionet më efektive në zbatimin e masave parandaluese në përpjesëtim me rreziqet e tyre, ndërsa IF-të e tjera dhe BPCJF-të shfaqin të kuptuar sipërfaqësor dhe shpesh u mungojnë kornizat e duhura për zbutjen e rreziqeve. Raportimi i RTD-ve është shumë i pabarabartë në të gjithë sektorët, përfshirë bankat, dhe raportimi shpesh është sipërfaqësor dhe joefektiv.

468. **Kosova ka arritur nivel të moderuar të efektivitetit me Rezultatin e Menjëhershëm 4.**

KAPITULLI 6. MBIKËQYRJA

Gjetjet kryesore dhe veprimet e rekomanduara

Gjetjet kryesore

- NjIF-it, BQK-së dhe mbikëqyrësve të tjerë sektorialë u janë caktuar përgjegjësi të përbashkëta për mbikëqyrjen e pajtueshmërisë së institucioneve financiare dhe BPCJF-ve me PPP/LFT-në. Në praktikë, kjo marrëveshje mund të ketë ndikim në mungesën e efikasitetit të regjimit mbikëqyrës në rastin e bankave dhe institucioneve financiare dhe është jofunksionale në rastin e NjIF-it dhe mbikëqyrësve të tjerë sektorialë.
- Ekzistojnë një sërë masash të hyrjes në treg në sektorin financiar me mungesa të elementëve për t'i parandaluar bashkëpunëtorët e kriminelëve të hyjnë në tregun financiar si zotërues (ose pronarë përfitues) të ndonjë interesi apo kontrolli të konsiderueshëm. Për më tepër, flitet për një numër të madh të personave pa regjistrim apo licencim të përfshirë në aktivitetin e këmbimit valutor dhe në aktivitetin e huadhënies.
- Sa i përket BPCJF-ve, masave të caktuara për sektorin e lojërave të fatit u mungojnë gjithashtu elementet për të parandaluar hyrjen në treg të bashkëpunëtorëve të kriminelëve. Nuk është e qartë nëse janë marrë masa përkatëse në lidhje me noterët, avokatët, auditorët dhe kontabilistët. Nuk ka kërkesa hyrëse për agjentët e patundshmërive apo tregtarët e metaleve dhe gurëve të çmuar.
- Në mesin e mbikëqyrësve, NjIF-i dhe BQK-ja demonstrojnë në përgjithësi të kuptuar të duhur të rreziqeve të PP/FT-së. Megjithatë, ekziston një cilësi e pabarabartë në produktet e vlerësimit të rrezikut që janë mjete për të ndërtuar më tej kapacitetet për identifikimin dhe të kuptuarit e rreziqeve. Gjithashtu, duket se zbatimi i dispozitave të profilizimit të rrezikut në doracakët përkatës të mbikëqyrjes nuk rezulton në prodhim dhe rishikim të rregullt të dokumenteve të shkruara që të artikulojnë qartë gjetjet dhe konkluzionet rreth profilin të rrezikut të subjekteve individuale të mbikëqyrura. Mbikëqyrësit e tjerë sektorialë kanë një të kuptuar mjaft të turbullt lidhur me ndërlikimet specifike të rrezikut të PP/FT-së në lidhje me bizneset dhe profesionet e mbikëqyrura prej tyre.
- NjIF-i dhe BQK-ja kanë kompetenca të përshtatshme dhe pavarësi operative për të ekzekutuar funksionin e tyre mbikëqyrës. Divizioni përkatës i BQK-së duket se ka burime të përshtatshme të personelit, por nuk është kështu në NjIF duke pasur parasysh mungesën e marrëveshjeve për ndarjen e përgjegjësisë mbikëqyrëse me mbikëqyrësit sektorialë nga njëra anë dhe numrin e madh të subjekteve të mbikëqyrur nga NjIF-i nga ana tjetër. Mangësitë në praktikën e profilizimit të rrezikut duket se kanë ndikim negativ në të gjitha fazat e mëvonshme (p.sh. planifikimi, ekzekutimi dhe ndjekja) të ciklit mbikëqyrës.
- Inspektimet e kryera nga NjIF-i dhe BQK-ja mbulojnë fusha të ndryshme dhe konstatojnë parregullsi të ndryshme në aktivitetet e subjekteve raportuese lidhur me përmbushjen e kërkesave të PPP/LFT-së dhe rekomandojnë veprime për adresimin e mangësive dhe dobësive të identifikuar. Duket se lidhur me kontrollin e pajtueshmërisë së institucioneve financiare, ekziston një dyfishim i përpjekjeve në punën e bërë nga NjIF-i dhe BQK-ja dhe, deri në një farë mase, një kundërshti me funksionin mbikëqyrës të NjIF-it.
- Prodhimi i raporteve të inspektimit nuk pasohet nga ekzekutimi i sanksioneve proporcionale dhe zbindëse të përcaktuara me Ligjin për PPP/LFT-në. Mungesa e përpjesëtimin të gjobave të përcaktuara me Ligjin për PPP/LFT-në shihet si një arsye e mundshme e praktikave joefektive të sanksionimit për mospajtimin me kërkesat përkatëse.
- Sa i përket sektorit financiar, mbikëqyrësit kanë mekanizma, kanale dhe praktika të përshtatshme të komunikimit për të promovuar të kuptuar të qartë të detyrimeve të

PPP/LFT-së dhe të rreziqeve të PP/FT-së ndërmjet bankave dhe, në një masë më të vogël, institucioneve të tjera financiare. E njëjta gjë është vetëm pjesërisht e vërtetë për BPCJF-të. Ekziston një shqetësim i përgjithshëm në lidhje me informatat kthyesë të përgjithshme dhe specifike që u jepen subjekteve raportuese për raportimin e RTD-ve, gjë që duket se pengon përmirësimin e performancës së raportimit.

Veprimet e rekomanduara

Sa i përket **strukturës së përgjithshme të kornizës mbikëqyrëse**, Kosova duhet të marrë masa për të:

- Siguruar se NjIF-i dhe mbikëqyrësit e tjerë negocionë dhe lidhin marrëveshje që përcaktohen me Ligjin për PPP/LFT-në për të mundësuar një mekanizëm funksional për përgjegjësi të përbashkët mbikëqyrëse;
- Siguruar se mekanizmi për përgjegjësi të përbashkët mbikëqyrëse ofron: 1) lidhur me BQK-në – një zgjidhje praktike për çështjen e kontrollit adekuat të pajtueshmërisë së institucioneve financiare, ndër të tjera, me kërkesat e raportimit të RTD-ve; dhe 2) lidhur me mbikëqyrësit e tjerë sektorialë – një kornizë të zbatueshme për përdorimin e burimeve të mbikëqyrësve sektorialë për kontrollin e pajtueshmërisë së BPCJF-ve me kërkesat përkatëse të PPP/LFT-së.

Sa i përket **licencimit, regjistrimit dhe kontrolleve të tjera të hyrjes në treg**, Kosova duhet të marrë masa për të:

- Përfshirë elementet që mungojnë, sipas rastit, për të parandaluar kriminelët ose bashkëpunëtorët e tyre që të hyjnë në tregjet financiare dhe jofinanciare si bartës (ose pronarë përfitues) të interesave apo kontrolleve të konsiderueshme apo që të marrin funksione drejtuese;
- Bëjnë përpjekje të fuqishme për ekzekutimin e masave efektive për t'i përfshirë në sistemin e rregulluar aktivitetet e palicencuara të këmbimit valutor dhe huadhënies;
- Konsideruar futjen e kërkesave të hyrjes në treg për agjentët e patundshmërive dhe tregtarët e metaleve dhe gurëve të çmuar.

Sa i përket **identifikimit të mbikëqyrësve dhe të kuptuarit e rreziqeve të PP/FT-së**, Kosova duhet të marrë masa për të:

- Korrigjuar mangësitë strukturore/përmbajtësore dhe për të përmirësuar cilësinë e produkteve të vlerësimit të rrezikut, si vlerësimi i rrezikut kombëtar dhe sektorial;
- Zbatuar dispozita të profilizimit të rrezikut në doracakët përkatës për mbikëqyrje të NjIF-it dhe BQK-së, në mënyrë që të prodhojnë dhe rishikojnë rregullisht dokumentet e shkruara, duke artikuluar në mënyrë të qartë gjetjet dhe konkluzionet rreth profilin të rrezikut të subjekteve individuale të mbikëqyrura;
- Zhvilluar doracakë ose instrumente të ngjashme për mbikëqyrësit e tjerë sektorialë që mundësojnë identifikimin dhe të kuptuarit e rreziqeve të PP/FT-së, ndër të tjera, edhe përmes profilizimit të duhur të rrezikut të subjekteve të tyre të mbikëqyrura.

Sa i përket **mbikëqyrjes së bazuar në rrezik të pajtueshmërisë me kërkesat e PPP/LFT-së**, Kosova duhet të marrë masa për të:

- Siguruar burime të mjaftueshme të personelit për të kontrolluar pajtueshmërinë e institucioneve financiare dhe BPCJF-ve me kërkesat e PPP/LFT-së;
- Siguruar që gjetjet me shkrim dhe konkluzionet e praktikave të përmirësuara të profilizimit të rrezikut zbatohen vazhdimisht në të gjitha fazat (p.sh. planifikimi, ekzekutimi dhe ndjekja) e ciklit mbikëqyrës.

Sa i përket **veprimeve korrigjuese dhe sanksioneve**, Kosova duhet të ndërmarrë masa për të:

- Siguruar vendosjen e sanksioneve proporcionale dhe zhbindëse që parashihen nga Ligji për PPP/LFT-në për mospajtueshmërinë e konstatuar nga subjektet raportuese;
- Të marrë në konsideratë zhvillimin e një sërë rregullash për zbatim koherent (të bazuar në përparësi) të sanksioneve që përjashtojnë interpretimin diskrecional dhe vullnetar se çfarë përbën shkelje apo prishje të detyrimeve të PPP/LFT-së;
- Të marrë në konsideratë rishikimin e gjobave të përcaktuara nga Ligji për PPP/LFT-në për të siguruar proporcionalitet më të mirë për rëndësinë e mospajtueshmërisë dhe koherencës me gjobat e përcaktuara për parregullsi që nuk kanë të bëjnë me PPP/LFT-në.

Sa i përket **promovimit të të kuptuarit të qartë të detyrimeve të PPP/LFT-së dhe rreziqeve të PP/FT-së**, Kosova duhet të marrë masa për të:

- Intensifikuar përdorimin e mekanizmave, kanaleve dhe praktikave të komunikimit për të promovuar të kuptuarit në mesin e subjekteve raportuese me kapacitet më të ulët, sidomos BPCJF-të;
- Rritur investimet në ofrimin e udhëzimeve dhe trajnimit për kategori të ndryshme të subjekteve raportuese pas vlerësimit të nevojave.

469. Rezultati i Menjëhershëm përkatës i shqyrtuar dhe i vlerësuar në këtë kapitull është RM 3. Rekomandimet përkatëse për vlerësimin e efektivitetit në këtë seksion janë R.26-28 & R.34 & 35.

Rezultati i menjëhershëm 3 (Mbikëqyrja)

Struktura e përgjithshme e kornizës mbikëqyrëse

470. NjIF-it, BQK-së dhe mbikëqyrësve të tjerë sektorialë u caktohet përgjegjësia për mbikëqyrjen e pajtueshmërisë së institucioneve financiare dhe BPCJF-ve me PPP/LFT-në. Ligji për PPP/LFT-në përcakton që kjo përgjegjësi mund të ndahet ndërmjet NjIF-it dhe mbikëqyrësve sektorialë në bazë të marrëveshjeve individuale specifike me shkrim. Deri në kohën e vizitës në terren, nuk ishte arritur asnjë marrëveshje e tillë. Sidoqoftë, BQK-ja ushtron funksionin e vet për mbikëqyrje të kujdesshme, si dhe autorizimin për kontrollin e përputhshmërisë së institucioneve financiare me të gjitha kërkesat e zbatueshme të PPP/LFT-së, përveç atyre që raportojnë te NjIF-i (për të cilat ky i fundit ka kompetencë mbikëqyrëse të vetme). Sa i përket BPCJF-ve, NjIF-i praktikisht bart tërësinë e përgjegjësisë për mbikëqyrjen e pajtueshmërisë së tyre me PPP/LFT-në për sa kohë që mbikëqyrësit përkatës sektorialë nuk ndërhyjnë dhe praktikisht nuk janë të përfshirë në atë sferë.

471. Ndarja praktike e përgjegjësisë mbikëqyrëse ndërmjet NjIF-it dhe BQK-së është çështje që duket se shkakton paqartësi të konsiderueshme dhe për pasojë joefikasitet të regjimit mbikëqyrës, si rezultat i interpretimeve të ndryshme të dispozitave të neneve 34-38 të Ligjit për PPP/LFT-në.

472. Në veçanti, NjIF-i i interpreton këto dispozita se ligjërisht e lejojnë BQK-në të kontrollojë pajtueshmërinë e institucioneve financiare me të gjitha kërkesat e Ligjit përveç asaj për raportimin te NjIF-i²¹. Në praktikë, kjo do të thotë se BQK-ja ka qasje në të gjitha të dhënat, dokumentet dhe informacione të tjera, përveç: 1) faktit nëse një RTD për një person ose transakcion është paraqitur pranë NjIF-it; dhe 2) përmbajtjen e çdo RTD-je të paraqitur në NjIF. Për këtë çështje, NjIF-i thekson se sa herë që BQK-ja duhet të konstatojë nëse ndonjë RTD për ndonjë person apo transakcion potencialisht të dyshimtë i është dërguar NjIF-it, kjo mund të bëhet duke kërkuar nga NjIF-i lejen për qasje në faktet e raportimit, por jo në përmbajtjen e RTD-së. Ka pasur shumë pak raste kur është dhënë qasje e tillë me miratim përmes një skeme me anë të së cilës banka komerciale kërkon lejen e NjIF-it dhe më pas siguron qasje të BQK-së.

473. Pastaj, së bashku me një interpretim disi të ngjashëm juridik të dispozitave në Ligjin për PPP/LFT-në mbi përgjegjësinë e përbashkët të përgjegjësisë mbikëqyrëse, BQK-ja e shqyrton çështjen e lartpërmendur nga këndvështrimi se meqë NjIF-i ka kompetencë të vetme për të

²¹ Sikurse përcaktohet në nenin 26 të Ligjit.

kontrolluar pajtueshmërinë me kërkesën për raportimin e RTD-ve, përpjekjet e BQK-së duhet të kufizohen në mënyrë të arsyeshme për të konstatuar zbatimin e të gjitha kërkesave përkatëse deri në pikën ku subjekti raportues vendos të paraqesë apo jo RTD dhe jo më shumë se sa thjesht për çështje parimore. Prandaj, vetë fakti se nëse një person apo transaksion i dyshimtë është raportuar te NjIF-i dhe përmbajtja e çdo RTD-je të raportuar mbeten jashtë fushëveprimit të inspektimeve të kryera në terren nga BQK-ja. Kjo praktikë shpjegohet gjithashtu me synimin për të mos ndërhyrë në funksionin mbikëqyrës të një agjencie tjetër qeveritare. Si rezultat, treguesit sasiorë dhe cilësorë të performancës së raportimit të RTD-ve nuk i nënshtrohen kontrollit mbikëqyrës gjithëpërfshirës dhe koherent.

474. Për të trajtuar këtë zbraçeti të konsiderueshme në regjimin mbikëqyrës të PPP/LFT-së, autoritetet duhet të gjejnë urgjentisht një zgjidhje që përfshin bashkëpunimin ndërmjet agjencive dhe elementët rregullative ndërmjet agjencive, në mënyrë që të sigurohet se zinxhiri i plotë i vlerave të masave parandaluese të zbatuara nga institucionet financiare, dhe në mënyrë specifike raportimi i RTD-ve si arritje logjike e atij zinxhiri, kontrollohet për pajtueshmëri në mënyrë të pandërprerë dhe të qëndrueshme. Për të arritur këtë objektiv, NjIF-i dhe BQK-ja duhet në radhë të parë të negociojnë dhe të lidhin marrëveshje siç parashihet nga Ligji për PPP/LFT-në.

475. Në mesin e alternativave të mundshme për zgjidhjen e çështjes së kontrollit të papë papërshtatshëm të pajtueshmërisë me kërkesat e raportimit të RTD-ve, autoritetet mund të marrin në shqyrtim: 1) caktimin ose transferimin²² e një apo disa pjesëtarëve të stafit, kryesisht në cilësinë e zyrtarëve ndërlidhës të BQK-së ose NjIF-it ose anasjelltas, të autorizuar për të pasur qasje në të dhënat e RTD-ve sipas marrëveshjeve përkatëse të sigurisë dhe konfidencialitetit dhe me përgjegjësi për të kontrolluar të gjithë procesin e gjenerimit dhe raportimit të RTD-ve; ose 2) sigurimin se NjIF-i është e informuar çdo herë për të gjitha gjetjet e inspektimeve të BQK-së lidhur me pajtueshmërinë e subjekteve raportuese me masat parandaluese deri në atë pikë ku këto të vendosin nëse do të paraqesin RTD apo jo dhe ajo është e detyruar të përcjellë secilin rast të dështimit faktik për t'i raportuar NjIF-it. Vlerësuesit supozojnë se mund t'i jepet parapëlqim alternativës së parë për sa kohë që mundëson zgjidhje më gjithëpërfshirëse të çështjes.

Licencimi, regjistrimi dhe kontrole të tjera për hyrjet në treg

476. Në sektorin financiar ekzistojnë një sërë masash të hyrjes në treg që duhet të përmirësohen duke futur në përdorim, ndër të tjera, dispozita për të parandaluar bashkëpunëtorët e kriminelëve të hyjnë në tregun financiar si zotërues (ose pronarë përfitues me) pjesëmarrje të konsiderueshme apo kontrolluese. BQK-ja, si autoriteti kompetent me funksion të vetëm për licencimin dhe regjistrimin e bankave dhe institucioneve të tjera financiare, zbaton një proces të strukturuar, që varësisht nga lloji i subjektit që do të licencohet, përfshin vlerësimin e strukturës së pronësisë dhe qeverisjes, planet strategjike dhe operative, kontrollet e brendshme dhe menaxhimin e rrezikut, si dhe pëlqimin paraprak të mbikëqyrësit vendor (në rast të licencimit të degës së ndonjë banke të huaj). Këto masa parashikojnë ndalimin e hyrjes në sistem të pjesëmarrësve potencialisht guaskë.

477. Raportohet se kontrollet për përshtatshmërinë e aksionarëve kryesorë (përfshirë pronarët përfitues përfundimtarë) dhe drejtuesve të lartë, dosjeve të pastra penale, si dhe për përvojën përkatëse profesionale dhe pajtueshmërinë me standardet e reputacionit zhvillohen rregullisht. BQK-ja u referohet disa dhjetëra refuzimeve për regjistrimin e anëtarëve të bordit, menaxherëve të lartë, auditorëve të brendshëm dhe stafit tjetër kryesor për shkaqe të tilla si papërshtatshmëria për shkak të çështjeve të reputacionit²³, mungesa e përvojës së duhur profesionale, mospërmbushja e standardeve arsimore, procedurat e hapura të falimentimit lidhur me aplikantin, etj. BQK-ja gjithashtu është në gjendje të zbatojë veprime kthyese, domethënë të tërheqë licencën ose regjistrimin e një institucioni, ose të kërkojë largimin e drejtuesit të lartë. Deri më tani, asnjë veprim i tillë nuk është iniciuar kundër bankave apo pjesëmarrësve të tjerë të mëdhenj të tregut financiar.

478. Janë bërë referime për ekzistencën e një numri të madh të personave pa regjistrim apo licencim që janë të përfshirë në veprimtarinë e këmbimit të valutës (të ashtuquajturit ndërmjetës anësorë apo tregtarë të rrugës) dhe në aktivitete të huadhënies (i ashtuquajturit biznes i fajdeve). Po të jetë kështu, autoritetet duhet të bëjnë përpjekje të fuqishme në drejtim të zbatimit të masave efektive për t'i sjellë këta persona në sistemin e rregulluar duke pasur

²² Cilido që të jetë termi më i praktikuar në ligjin e Kosovës.

²³ Në bazë të opinionit të Agjencisë kundër Korrupsionit.

parasysh rreziqet shumë të larta të PP-së së ndërlidhur me aktivitete të tilla të paregjistruara në mospërputhje të dukshme me çdo kërkesë të PPP/LFT-së.

479. Sa i përket BPCJF-ve, masat në dispozicion për sektorin e lojërave të fatit që përbëhet nga operatorë të makinave të fatit, bastoreve sportive dhe lotarive²⁴ duhet të përmirësohen sa i përket parandalimit të bashkëpunëtorëve të kriminelëve që të hyjnë në treg. Nuk ka kërkesa hyrëse për agjentët e patundshmërive apo tregtarët e metaleve dhe gurëve të çmuar. Edhe pse kjo nuk është kërkesë e detyrueshme e Standardeve të FATF-së, është shqetësim i madh pasi minimizon aftësinë e autoriteteve për të njohur dhe arritur tek individët dhe personat praktikisht të përfshirë në këto aktivitete, kundrejt një prapavije me rreziqe të larta që lidhen sidomos me sektorin e ndërtimit dhe ekonomisë në hije.

480. Noterët, avokatët, auditorët dhe kontabilistët licencohen dhe / ose certifikohen, por nuk është e qartë nëse masat në dispozicion parashohin parandalimin e kriminelëve ose bashkëpunëtorëve të tyre nga të qenit i akredituar në mënyrë profesionale apo të zotërojnë (ose të jenë pronarë përfitues me) pjesëmarrje të konsiderueshme ose kontrolluese, apo të mbajnë funksione drejtuese në këto BPCJF.

Identifikimi i mbikëqyrësve dhe të kuptuarit e rreziqeve të PP/FT-së

481. Në mesin e mbikëqyrësve, NjIF-i dhe BQK-ja tregojnë pikëpamje dhe të kuptuar të rreziqeve të PP/FT-së mjaft të avancuara. Ata përshkruajnë rrjedhshëm faktorët me ndikim të përgjithshëm në situatën e rrezikut në sektorin financiar dhe jofinanciar dhe artikulojnë tipologjitë ose modelet që mund të përdoren nga kryesit e veprave të pastrimit të parasë së paligjshme apo financimit të terrorizmit. Ky kuptim i rrezikut lehtësohet edhe nga vlerësimi kombëtar i rrezikut i kryer në vitin 2013. Teksa pranohen dobiet e këtij ushtrimi në përgjithësi dhe gjetjet e VKR-së së vitit 2013 në veçanti, vlerësuesit vënë në dukje mangësitë strukturore dhe përmbajtësore të raportit të VKR-së (siç paraqitet në analizën për RM 1) dhe theksojnë nevojën për rritjen e cilësisë së produkteve të vlerësimit të rrezikut si mjet për të ndërtuar më tej kapacitetet për identifikimin dhe kuptimin e rreziqeve.

482. Procedurat Standarde të Operimit për Mbikëqyrjen e Përputhshmërisë së NjIF-it (2017) dhe Doracaku i Shqyrtimit/Inspektimit kundër Pastrimit të Parave të BQK-së (2014) përcaktojnë proceset për profilizimin e rrezikut të institucioneve individuale financiare. Në veçanti, i pari ndërton kornizë më të gjerë për mbikëqyrjen e bazuar në rrezik sipas analizës së përgjithshme të rrezikut²⁵, klasifikimit në bazë të rrezikut²⁶ dhe shënjestrimit të subjekteve të mbikëqyrura bashkërisht me modalitetet e mbikëqyrjes të bazuara mbi ngacmues dhe rotacion. I dyti, edhe pse kryesisht i referohet mbikëqyrjes së bankave dhe kryesisht duke u përqendruar në aspektin e mbikëqyrjes në terren, përcakton ciklin mbikëqyrës²⁷ që përfshin fazën e të kuptuarit të karakteristikave unike apo profilit të rrezikut të subjekteve të mbikëqyrura të informuara nga gjetjet e inspektimeve të mëparshme, të dhënat për aktivitetin e tyre operativ dhe transaksionet etj.

483. Megjithatë, duket se dispozitat për profilizimin e rrezikut edhe në procedurat e NjIF-it, edhe në doracakun e BQK-së janë zbatuar për të udhëhequr paraprakisht përpjekjet e mbikëqyrësve pa prodhuar apo rishikuar dokumente të zakonshme me shkrim ku artikulohen qartë gjetjet dhe konkluzionet rreth profilit të rrezikut të subjekteve të mbikëqyrura individuale. Produkte të tilla të profilizimit të rrezikut janë të nevojshme nëse autoritetet duan të sigurojnë proces të qëndrueshëm të mbikëqyrjes që nuk përfill ndikimet e shkaktuara nga faktorë të tillë si, për shembull, qarkullimi i stafit.

484. Të tjerë mbikëqyrës sektorialë, ndërkohë që shfaqin njohuri të përgjithshme për faktorët rrethorë (si ekonomia e bazuar në para të gatshme) dhe segmentet më të larta të rrezikut (si

²⁴ Në Kosovë nuk ka kazino të licensuara apo funksionale.

²⁵ Analiza e rrezikut të përgjithshëm përbëhet nga katër fazat në vijim: 1) mbledhja e informacionit për të identifikuar rreziqet e PP/FT-së, 2) identifikimi dhe vlerësimi i rrezikut; 3) veprimi mbi vlerësimin e PP/FT-së për të zbutur rreziqet; dhe 4) monitorimi dhe veprimet në vijim.

²⁶ Ushtrimi klasifikues duhet të bëhet nga vlerësimi i rrezikut të brendshëm të institucionit kundrejt një shkalle të paracaktuar dhe pastaj bëhet vlerësimi i cilësisë së sistemit të vet të PPP/LFT-së kundrejt një tjetër shkalle të paracaktuar dhe shumëfishimit të rezultateve përkatëse për këto të dyja që të arrihet përcaktimi përfundimtar i rrezikut.

²⁷ I gjithë cikli mbikëqyrës përbëhet nga katër fazat në vijim: 1) të kuptuarit e institucionit (karakteristikat e veta unike ose profilet e rrezikut); 2) vlerësimi i rreziqeve të institucionit (identifikimi i rrezikut të PP/FT-së); 3) planifikimi/caktimi i afateve për punën mbikëqyrëse (zhvillimi i fushëveprimit dhe dokumentimit të planit të punës); dhe 4) kryerja e inspektimeve në terren (testimi dhe konfirmimi i të dhënave të siguruara nga institucioni).

sektori i ndërtimit), kanë një të kuptuar mjaft të paqartë lidhur me implikimet specifike të rrezikut të PP/FT-së në lidhje me bizneset dhe profesionet e mbikëqyrura prej tyre. Ata nuk kanë doracakë apo instrumente të ngjashme që mundësojnë identifikimin dhe të kuptuarit e rreziqeve të PP/FT-së, ndër të tjera, edhe përmes profilizimit të duhur të rrezikut të subjekteve që mbikëqyrin. Disa vlerësime sektoriale dhe tematike të rrezikut, si ato në industrinë e lojërave të fatit dhe sektorin e ndërtimit, mund të lehtësojnë përmirësimin e të kuptuarit të rrezikut nga mbikëqyrësit nëse dhe kur të shndërrohen në instrumente praktike të menaxhimit të rrezikut (p.sh. strategji, plane të veprimit dhe mjete të monitorimit).

Mbikëqyrja e bazuar në rrezik e përputhshmërisë me kërkesat e PPP/LFT-së

485. NjIF-i dhe BQK-ja kanë kompetenca të duhura dhe pavarësi operative për të zbatuar funksionin e tyre mbikëqyrës. Që të dyja agjencitë përdorin metoda të mbikëqyrjes, si mbikëqyrja nga distanca dhe inspektimet në terren dhe përdorin mjete për mbikëqyrje si procedurat standarde të operimit dhe doracakët. Sa i përket përshtatshmërisë së burimeve mbikëqyrëse, Divizioni i Parandalimit të Pastrimit të Parave, që varet nga zëvendësguvernatori i BQK-së, raporton se ka personel të mjaftueshëm dhe, kur është e nevojshme, mbështetet nga divizionet përkatëse të Departamentit të Mbikëqyrjes Bankare (që është gjithashtu përgjegjës për mbikëqyrjen e IMF-ve dhe IFJB-ve).

486. Për dallim, mjaftueshmëria e burimeve të NjIF-it në raport me përgjegjësinë e saj për mbikëqyrjen e të gjitha BPCJF-ve nuk është e qartë dhe do të ishte një objektiv vështirë i arritshëm nëse nuk arrihen marrëveshje për ta shpërndarë atë përgjegjësi në mënyrë të barabartë ndërmjet NjIF-it dhe mbikëqyrësve sektorialë (sikurse përshkruhet në seksionin mbi strukturën e përgjithshme të kornizës mbikëqyrëse) ose, nëse stafi i NjIF-it nuk rritet dukshëm për të qenë në gjendje të merret me detyrat e veta mbikëqyrëse (sidomos duke pasur parasysh numrin e madh të BPCJF-ve që veprojnë në sektorin jofinanciar). Nga këto dy alternativa, e para duket të jetë më e përshtatshme për shkaqe të koston dhe të efikasitetit.

487. Planifikimi, ekzekutimi dhe përcjellja përkufizohen si pjesë përbërëse të ciklit të mbikëqyrjes, si brenda NjIF-it, ashtu edhe BQK-së. Procedurat Standarde të Operimit për Mbikëqyrjen e Përputhshmërisë së NjIF-it (2017) dhe Doracaku i Shqyrtimit/Inspektimit kundër Pastrimit të Parave të BQK-së (2014) përcaktojnë proceset për planifikimin vjetor të bazuar në rrezik dhe zbatimin e mbikëqyrjes. Planifikimi raportohet të bëhet çdo vit dhe të formalizohet përmes hartimit të planeve vjetore të mbikëqyrjes të miratuara përkatësisht nga Drejtori i NjIF-it dhe Zëvendësguvernatori i BQK-së. Përcjellja përfshin monitorimin e zbatimit të rekomandimeve mbikëqyrëse, udhëzimeve dhe vendimeve. Programi i pajtueshmërisë së PPP/LFT-së, kontrollet e brendshme, sistemi i klasifikimit të rrezikut të klientëve, procedurat e KDK-së, si dhe raportimi i parave të gatshme dhe transaksioneve të dyshimta janë ndër fushat e përcaktuara me udhëzime mbikëqyrëse për ekzaminim gjatë inspektimeve në terren.

488. Megjithatë, mangësitë në praktikat e profilizimit të rrezikut të NjIF-it dhe BQK-së duket se kanë ndikim negativ në të gjitha fazat e mëvonshme (p.sh planifikimi, ekzekutimi dhe ndjekja) të ciklit mbikëqyrës. Kjo konfirmohet nga analiza e planeve vjetore të inspektimit dhe treguesve të performancës mbi mbikëqyrjen. Për shembull, aktivitetet e planifikuara dhe të zbatuara nga NjIF-i për kontrollin e pajtueshmërisë së subjekteve raportuese në vitin 2017 paraqiten më poshtë:

Tabela 34:

Subjekti raportues	Planifikuar		Zbatuar		Performanca		Gjithsej subjekte raportuese	Mbulimi i planifikuar në nivel industrie	Mbulimi real në nivel industrie
	Në distancë	Në vend	Në distancë	Në vend	Në distancë	Në vend			
Banka	2	1	10	1	500%	100%	10	30%	110%
Institucione mikrofinanciare	3	0	11	0	367%	0%	11	27%	100%
Shoqëri sigurimi	3	1	0	0	0%	0%	15	27%	0%
Kompani për transfertë parash	0	3	5	0	-	0%	5	60%	100%
Këmbimore	0	4	0	32	0%	800%	41	10%	78%
Lojëra fati	0	5	0	0	0%	0%	42	12%	0%
Noterë	0	10	12	1	-	10%	74	14%	18%
Avokatë	0	10	0	0	0%	0%	840	1%	0%
Auditorë	0	3	0	0	0%	0%	20	15%	0%

Subjekti raportues	Planifikuar		Zbatuar		Performanca		Gjithsej subjekte raportuese	Mbulimi i planifikuar në nivel industrie	Mbulimi real në nivel industrie
	Në distancë	Në vend	Në distancë	Në vend	Në distancë	Në vend			
Agjentë të patundshmërisë	0	5	0	0	0%	0%	46	11%	0%
TMGÇ	-	0	0	0	-	-	411	0%	0%
Gjithsej	8	42	38	34			1515		

489. Nga tabela e mësipërme arsyetimi i përzgjedhjes së një pjese të bankave, IMF-ve dhe kompanive të sigurimeve për mbikëqyrjen e planifikuar në distancë dhe mbikëqyrja reale e një grupi të ndryshëm të bankave, IMF-ve dhe kompanive të transferimit të parave nuk është e qartë, edhe sepse në rastin më të mirë, kjo metodë e mbikëqyrjes duhet të mbulojë të gjitha subjektet raportuese në një mënyrë të tillë që mundëson profilizimin e tyre të bazuar në rrezik dhe përcaktimin e mëtejshëm për kontrollin në terren. Pastaj, përzgjedhja e grupit të subjekteve raportuese të planifikuara për inspektimet në terren dhe treguesit faktikë të performancës shumë të ndryshëm nuk duket se rrjedhin nga ndonjë gjykim i bazuar në rrezik lidhur me rreziqet sektoriale ose individuale. Në përgjithësi, treguesit e performancës janë mjaft të ulët dhe tregojnë probleme që së paku ndërlidhen me burimet e personelit. Së fundi, mbulimi në nivel industrie i aktiviteteve të planifikuara dhe të zbatuara është shumë i pabarabartë dhe nuk është tregues i ndonjë shënjestre për periudhat që përfundojnë ciklin e plotë në çdo industri²⁸.

490. Sa i përket aktiviteteve mbikëqyrëse të planifikuara dhe të vëna në zbatim nga BQK-ja, më poshtë paraqitet një pamje sigurisht e ndryshme në strukturë, por disi e ngjashme në natyrë:

Tabela 35:

Subjekti raportues	2016			2017			Gjithsej subjekte raportuese	Mbulimi real në nivel industrie (2017)
	Planifikuar	Zbatuar	Performanca	Planifikuar	Zbatuar	Performanca		
Banka	6	6	100%	6	7	117%	10	70%
Institucione financiare jobankare	1	1	100%	2	1	50%	55	2%
Institucione mikrofinanciare	2	2	100%	2	3	150%	11	27%
Shoqëri sigurimi	2	2	100%	1	0	0%	15	0%
Kompani për transferim parash	0	0	0%	0	0	-	24	0%
Gjithsej	11	11		11	11		115	

491. Në tabelën e mësipërme, ndërkohë që treguesit e performancës janë mjaft të lartë (me inspektime të zbatuara në të vërtetë ndonjëherë edhe më shumë se ato të planifikuara), përsëri, mbulimi i aktiviteteve të planifikuara në nivel industrie është shumë i pabarabartë dhe nuk është tregues i shënjestrave për periudhat kohore që të plotësojnë ciklin e plotë në çdo industri. Kjo nuk duket të jetë në përpjesëtim me rreziqet më të larta që lidhen me lloje të aktuara të IFJB-ve, siç janë zyrat e këmbimit valutor. Gjithashtu, arsyetimi prapa shënjestrave individuale të inspektimeve nuk është i qartë në mungesë të një dokumenti formal që artikulon gjetjet dhe konkluzionet e ushtrimit të profilizimit të rrezikut individual.

Veprime korigjuese dhe sanksione efektive, proporcionale dhe zbindëse

492. Raportet e pastruara të inspektimeve të zhvilluara nga BQK-ja mbulojnë fusha të ndryshme dhe konstatojnë parregullsi në institucione financiare si mjaftueshmëria e stafit të PPP-së; procesi i thithjes së klientëve; identifikimi, verifikimi dhe përditësimi i të dhënave të klientit; kategorizimi i klientëve në bazë të rrezikut; përkufizimi dhe zbatimi i treguesve për monitorimin e transaksioneve; zbatimi i programeve të trajnimit etj. Mbikëqyrësit rekomandojnë

²⁸ P.sh. inspektimi i së paku tri bankave në vit duke mbuluar kështu të gjithë industrinë brenda tri viteve.

veprime për të korigjuar parregullsitë e identifikuar brenda një afati të caktuar ose në mënyrë të vazhdueshme.

493. Inspektimet e kryera nga NjIF-i mbulojnë fusha të ndryshme dhe konstatojnë parregullsi të ndryshme në institucionet financiare dhe BPCJF-të lidhur me politikat dhe procedurat e brendshme të PPP/LFT-së; identifikimin dhe regjistrimin e klientëve; raportimin e transaksioneve të dyshimta; trajnimin dhe ndërtimin e kapaciteteve etj. Raportet e pastruara të inspektimeve të tilla rekomandojnë veprime për adresimin e dobësive dhe mangësive të identifikuar, duke vendosur përsëri afate të prera ose duke përcaktuar zbatimin e vazhdueshëm. Prandaj, ndërsa në rastin e BPCJF-ve këto inspektime nga NjIF-i janë mjetet e duhura për të siguruar përputhshmërinë me kërkesat e PPP/LFT-së, në rastin e institucioneve financiare fakti që NjIF-i bën inspektime me mbulim dhe hollësi të ngjashme me ato të BQK-së duket të jetë dyfishim i përpjekjeve dhe, deri në njëfarë mase, në kundërshtim me funksionin mbikëqyrës të NjIF-it sikurse e parasheh Ligji për PPP/LFT-në i cili përcakton që ajo të kontrollojë përputhshmërinë e institucioneve financiare me kërkesat për vlerësimin dhe parandalimin e rrezikut dhe vetëm të raportimit të RTD-ve.

494. Nuk duket të jenë shqiptuar sanksione proporcionale dhe zbindëse të parapara me Ligjin për PPP/LFT-në për subjektet raportuese pas nxjerrjes së raporteve të inspektimit qoftë nga NjIF-i qoftë nga BQK-ja. Sidomos në vitin 2016 sanksionet e vendosura nga NjIF-i dhe BQK-ja arritën në 4 vërejtje me shkrim dhe dy gjoba në vlerë prej 12.000 euro sa i përket vetëm bankave. Në vitin 2017, treguesit përkatës ishin një vërejtje me shkrim dhe një gjobë prej 20.000 euro vetëm për bankat. Me këtë, mbikëqyrja nuk ka identifikuar ndonjë shkelje tjetër të PPP/LFT-së me të gjitha subjektet e tjera raportuese që mbikëqyren nga distanca ose në terren. Mbikëqyrësit shpjegojnë se kjo gjë pasqyron faktin se bankat e kanë përmirësuar pajtueshmërinë e tyre me PPP/LFT-në gjatë viteve të fundit dhe në shumicën e rasteve, mangësitë e konstatuara gjatë inspektimeve në terren paraqesin mospërputhje të vogla ose siç përcaktohet me Ligjin për PPP/LFT-në, "shkelje të rastit ose të izoluar", për të cilat nuk zbatohen sanksione; përkundrazi, rekomandohet që subjektet raportuese t'i adresojnë këto mospërputhje në mënyrën dhe afatin e duhur.

495. Sidoqoftë, raportet e inspektimit të NjIF-it dhe BQK-së u referohen gjetjeve që duken mjaftueshëm të rënda për t'u sanksionuar (p.sh. zbatimi i treguesve të transaksioneve të dyshimta të PP/FT-së), ndërsa intervistat e vlerësuesve me subjektet raportuese tregojnë se disa nga kërkesat e Ligji për PPP/LFT-në nuk zbatohen në mënyrë koherente (p.sh. kërkesa për vlerësimin e rrezikut). Në kontekstin e një përkufizimi shumë specifik të shkeljeve dhe sanksioneve në Ligjin për PPP/LFT-në dhe duke marrë parasysh hendekun e madh që lidhet me kontrollin e pajtueshmërisë me kërkesat e raportimit të RTD-ve (sikurse përshkruhet në seksionin mbi strukturën e përgjithshme të kornizës mbikëqyrës), vlerësuesit priren të hamendësojnë se ose inspektimet nuk janë mjaftueshëm gjithëpërfshirëse për të mundësuar identifikimin e parregullsive, ose identifikimi nuk pasohet nga vendosja e sanksioneve sikurse e kërkon Ligji për PPP/LFT-në, ose situata përfshin kombinime të këtyre faktorëve dhe faktorëve të tjerë të mundshëm që pengojnë praktikën e përshtatshme sanksionuese.

496. Sa i përket prapavijës së zbatimit joefektiv të sanksioneve proporcionale si masë parandaluese ndaj mosrespektimit të kërkesave të PPP/LFT-së, përfaqësuesit e sektorit privat i referohen natyrës joproportionale të gjobave të përcaktuara nga Ligji për PPP/LFT-në për ato që janë përcaktuar si shkelje të legjislacionit shumë të rënda, të rënda dhe të lehta. Këto gjoba janë disa herë më të larta se sa ato për shkeljen e kërkesave për kujdesin sipas ligjeve bankare dhe ligjeve për veprimtari të tjera financiare dhe duket se, në mungesë të precedentëve të mjaftueshëm të zbatimit në praktikë, ekziston mundësia për interpretim diskrecional dhe vullnetar se çfarë do të përbënte shkelje apo mospërmbushje të një detyrimi të PPP/LFT-së.

497. Në përgjithësi, shpërpjesëtimi i gjobave të përcaktuara në Ligjin për PPP/LFT-në mund të jetë një nga arsytet në themel të joefektivitetit të praktikave të sanksionimit për mosrespektimin e kërkesave përkatëse.

Promovimi i të kuptuarit të qartë të detyrimeve të PPP/LFT-së dhe rreziqeve të PP/FT-së

498. Sa i përket sektorit financiar, edhe NjIF-i, edhe BQK-ja kanë mekanizma, kanale dhe praktika të duhura të komunikimit për të nxitur të kuptuarit e qartë të detyrimeve të PPP/LFT-së dhe rreziqet e PP/FT-së në mesin e bankave dhe, në një masë më të vogël, institucioneve financiare të tjera. E njëjta gjë është vetëm pjesërisht e vërtetë për BPCJF-të, nga të cilat agjentët e patundshmërive dhe tregtarët e metaleve dhe gurëve të çmuar nuk u nënshtrohen kontroleve të hyrjes në treg, pra mezi njihen dhe janë të arritshëm vetëm në mënyrë sporadike për qëllime të mbikëqyrjes dhe vetëdijesimit. Në lidhje me të gjitha BPCJF-të, nevojitet shumë

më tepër trajnim, udhëzim dhe informata kthyesë për të siguruar një nivel të duhur të të kuptuarit të detyrimeve të PPP/LFT-së dhe rreziqeve të PP/FT-së.

499. Në praktikë, ofrimi i udhëzimeve dhe trajnimit duket të jetë një fushë ku në përgjithësi, mbikëqyrësit dhe sidomos NjIF-i duhet të investojnë në mënyrë të konsiderueshme më shumë burime. Ndërkohë që bankat dhe disa institucione të tjera financiare raportojnë se mbajnë rregullisht takime dhe diskutime me NjIF-in, shumica e IFJB-ve dhe BPCJF-ve pak a shumë nuk i kujtojnë kontaktet më të fundit me mbikëqyrësit për udhëzime lidhur me aktivitete rutinë të biznesit apo trajnime të rregullta. Duke pasur parasysh nivelin e ulët të vetëdijesimit për PPP/LFT-në në mesin e këtij grupi të dytë të subjekteve raportuese dhe më pas, mosrespektimin e hamendësuar të detyrimeve të tyre sipas Ligjit për PPP/LFT-në, atyre duhet t'u jepet prioritet si përfitues të përpjekjeve të autoriteteve në këtë drejtim. Përpjekjet e tilla do të ishin më efektive nëse paraprihen nga vlerësimi i nevojave ndërmjet kategorive të ndryshme të subjekteve raportuese.

500. Ka një shqetësim të përgjithshëm lidhur me informatat kthyesë të përgjithshme dhe specifike që u jepen subjekteve raportuese për raportimin e RTD-ve. Bankat, të cilat janë pothuajse i vetmi burim i RTD-ve i referohen mungesës së praktikës së rregullt për të dhënë informata kthyesë mbi dobinë e raporteve të tyre, gjë që sigurisht se do të ndihmonte në përmirësimin e raporteve të ardhshme. Disa prej tyre theksojnë se informatat kthyesë të përgjithshme janë dhënë një herë në vitin 2018 për RTD-të e dorëzuara në vitin 2016. Ekziston një marrëveshje unanime mes bankave që informatat kthyesë të rregullta janë të një rëndësie kyçe për të zhvilluar praktikat e raportimit në kuptim sasior dhe cilësor. Institucione të tjera financiare, si dhe të gjitha BPCJF-të nuk raportojnë ndonjë informatë kthyesë të marrë nga NjIF-i.

Përfundimet e përgjithshme për Rezultatin e Menjëhershëm 3

501. Regjimi mbikëqyrës në Kosovë, i udhëhequr kryesisht nga BQK-ja dhe NjIF-i, përfshin një sërë përbërësish funksionalë, megjithatë, ka zbrazëti të konsiderueshme lidhur me hyrjen në treg, vlerësimin e rrezikut dhe praktikën e administrimit të rrezikut, sidomos për sektorin jobankar si dhe mbivendosje të mbikëqyrjes dhe mbulim/praktika të njëpasnjëshme të inspektimeve që ndikojnë dukshëm në efektivitetin e përgjithshëm.

502. Kosova ka arritur nivel të moderuar të efektivitetit me Rezultatin e Menjëhershëm 3.

KAPITULLI 7. PERSONAT DHE MARRËVESHJET JURIDIKE

Gjetjet kryesore dhe veprimet e rekomanduara

Gjetjet kryesore

- Sipas ligjeve të Kosovës, të gjithë personat juridikë duhet të regjistrohen. Informacioni bazë është i disponueshëm publikisht përmes Regjistrin të Bizneseve (ARBK) dhe si i tillë, është transparent. Edhe pse nuk ka një regjistër të mirëfilltë të pronësisë përfituese, bankat dhe institucionet financiare duket se janë përgjithësisht të vetëdijshme për nevojën që të identifikojnë pronarin përfitues të një subjekti juridik ose marrëveshjeje, megjithatë, të kuptuarit e asaj që përbën pronësi përfituese ndryshon. Për më tepër, në raste të caktuara shërbimet ende ofrohen nëse pronari përfundimtar fshihet pas strukturave komplekse.
- Nuk duket të ketë ndonjë proces për verifikimin e informacionit që i ofrohet Regjistrin të Bizneseve apo për të kontrolluar nëse informacioni duhet të përditësohet. Përderisa ekziston kërkesë ligjore për ndryshimin e informacionit bazë në lidhje me të gjithë personat juridikë që duhet të raportohen në Regjistrin e Bizneseve brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga ndryshimet e bëra, mosrespektimi nuk i nënshtrohet asnjë ndëshkimi. Megjithatë, përshtatshmëria, saktësia dhe aktualiteti i pjesës më të madhe të informacionit në regjistër duket të jenë të kënaqshme.
- Autoritetet nuk i kanë vlerësuar rreziqet e PP/FT-së lidhur me llojet e personave juridikë të krijuar në Kosovë. Për më tepër, përdorimi i mundshëm i ndërmjetësuesve mashtrues dhe përdorimi i paligjshëm i të emëruarve nuk janë hulumtuar mjaftueshëm dhe haset në shumë pak vlerësim të rreziqeve të paraqitura nga këto dukuri.
- Kosova përdor mekanizma bazë për t'u siguruar se informacioni për pronësinë përfituese është i saktë dhe i përditësuar. Autoritetet e zbatimit të ligjit dhe NjIF-i përdorin informacionin ekzistues të siguruar nga bankat sipas kërkesave të tyre të KDK-së. Meqë ka pasur shumë pak hetime që përfshijnë përdorimin e personave juridikë dhe nevojën për të marrë informacion mbi pronësinë përfituese, Policia e Kosovës dukej se nuk kishte njohuri nëse në raste të tilla ata do të ishin në gjendje të merrnin informata të përshtatshme, të sakta dhe aktuale përtej informacionit në dispozicion në Regjistrin e Bizneseve dhe prej kujt do të ishin në gjendje t'i siguronin ato.
- Informacioni për pronësinë përfituese në përgjithësi mbahet nga bankat, edhe pse është shumë e dyshimtë nëse institucionet e tjera financiare dhe BPCJF të jenë në dijeni të këtij detyrimi. Bankat kryesisht mbështeten në Regjistrin e Bizneseve për informacione mbi aksionarët, e megjithatë, me përjashtim të bankave që janë filiale të grupeve më të mëdha, shumë pak siguri është dhënë sa i përket rastit të klientëve të shoqërive tregtare të përfshira në juridiksione të huaja se a ka njohuri se si të marrin informacion mbi pronësinë përfituese dhe si të konstatohet se informacioni i dhënë është i vërtetë. Mbështetja ndonjëherë kryhet mbi bazën e deklaratave të bëra nga klientët dhe ky modalitet ngre çështje që lidhen me mungesën e saktësisë dhe vërtetësisë së informacionit të mbledhur.
- Gjatë punës së vet mbikëqyrëse, BQK-ja vlerëson nivelin e verifikimit të informacionit mbi pronësinë përfituese nga subjektet raportuese ndërkohë që zhvillon inspektime në terren. BQK-ja kontrollon nëse ai është i përshtatshëm, i saktë dhe aktual. Efektiviteti i kornizës së sanksioneve të BQK-së është i diskutueshëm sikurse edhe efekti zbindës i sanksioneve. Edhe pse ka pasur zbrazëti të rastit që janë identifikuar lidhur me pronësinë përfituese, asnjë gjobë nuk është vënë ndonjëherë.
- Duket të ketë të kuptuar shumë të kufizuar të rreziqeve të paraqitura nga personat juridikë dhe marrëveshjet juridike. Autoritetet nuk duket të vlerësojnë se çdo vend përballet me rrezikun e pronësisë indirekte të personave juridikë dhe marrëveshjeve

juridike përmes strukturave komplekse dhe se mund të ketë interes në investimin e fondeve të paligjshme përmes subjekteve të shoqërive tregtare të përfshira në një vend tjetër. Ata as nuk kanë njohuri të mjaftueshme për mekanizmat me anë të të cilëve marrëveshje juridike si trustet dhe fondacionet mund të krijohen në një vend të huaj dhe të përdoren për të vepruar brenda territorit të një juridiksioni tjetër. Në të vërtetë, autoriteti i vetëm që gjatë pjesës së vlerësimit në terren ka demonstruar nivel të dukshëm të kuptuarit të konceptit të kontrollit që ushtrohet nga një palë e tretë që nuk është zyrtarisht pronar i një personi juridik, ishte Administrata Tatimore e Kosovës.

- Sektori financiar dhe BPCJF-të po ashtu nuk e vlerësojnë mjaftueshëm faktin se edhe pse shumica e klientëve të tyre janë vendas, është shumë e mundur që pronësia të fshihet nëpërmjet strukturave komplekse dhe përdorimit të të emëruarve. Dështimi për ta vlerësuar këtë rrezik i ekspozon ata ndaj të qenit të përdorur pa dashur për qëllime të PP/FT-së.
- Korniza ligjore në Kosovë nuk i njeh trustet, edhe pse funksionimi i marrëveshjeve juridike të përcaktuara sipas ligjit të huaj nuk ndalohej. Ekipi i vlerësimit nuk është bindur se autoritetet apo subjektet raportuese kanë njohuri të duhura për rreziqet e PP/FT-së që lidhen me marrëveshjet juridike pasi që ata nuk kanë njohuri të mjaftueshme të strukturave të tyre dhe natyrës së aktiviteteve të tyre.

Veprimet e rekomanduara

Kosova duhet të ndërmarrë masa për të fuqizuar aftësinë e saj për identifikim të pronësisë përfituese dhe për të kufizuar keqpërdorimin e personave juridikë dhe marrëveshjeve juridike për qëllime të PP/FT-së të tilla si:

- Kryerja e një vlerësimi të rrezikut në nivel vendor që shqyrton llojet e ndryshme të personave juridikë me qëllim vlerësimin e dobësive dhe tërheqjes të tyre për t'u keqpërdorur për qëllime të PP/FT-së;
- Përfshirja e një ndëshkimi administrativ që mund të vendoset për mosnjohim të ARBK-së lidhur me ndryshimet në zotërimin e aksioneve;
- Rritja e nivelit të mbikëqyrjes dhe numrit të inspektimeve në terren, sidomos në lidhje me sektorin e BPCJF-ve, për të siguruar, ndër të tjera, që informacioni i pronësisë përfituese po mblidhet dhe mirëmbahet;
- Vendosja e sanksioneve administrative zbindëse, efektive dhe proporcionale si në sektorin financiar, ashtu edhe në sektorët e BPCJF-ve sa herë që identifikohen shkelje në lidhje me detyrimin për të mbajtur informacion mbi pronësinë përfituese;
- Rritja e nivelit të vetëdijesimit brenda Policisë së Kosovës për mënyrën se si personat juridikë dhe marrëveshjet juridike mund të përdoren për qëllime të PP-së dhe FT-së, për mënyrën se si mund të krijohen marrëveshje juridike në juridiksione të huaja dhe si ato mund të veprojnë në Kosovë dhe nevojën për të siguruar qasje në të dhënat e pronësisë përfituese me qëllim të ndjekjes së hetimeve vendore dhe për t'ia dhënë këtë informacion homologëve të huaj kur bëhet kërkesa për informacion.

503. Rezultati i menjëhershëm përkatës i shqyrtuar dhe i vlerësuar në këtë kapitull është RM 5. Rekomandimet përkatëse për vlerësimin e efektivitetit në këtë seksion janë R. 24 dhe 25.

Rezultati i Menjëhershëm 5 (Personat dhe marrëveshjet juridike)

Disponueshmëria publike e informacionit për krijimin dhe llojet e personave dhe marrëveshjeve juridike

504. Informacioni për krijimin e llojeve të ndryshme të personave juridikë në Kosovë është në dispozicion të publikut. Legjislacioni nuk parasheh krijimin dhe funksionimin e trusteve dhe marrëveshjeve të tjera juridike në Kosovë. Edhe pse nuk ka ndonjë kornizë ligjore që të lejojë krijimin e marrëveshjeve juridike sipas ligjit në Kosovë, nuk ka as ndalim. Prandaj, trustet dhe marrëveshjet juridike si fondacionet, mund të regjistrohen si aksionarë të kompanive të

përfshira në Kosovë, mund të kenë qasje në shërbimet e subjekteve të detyruara dhe mund të blejnë pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme në Kosovë.

505. Regjistri i Bizneseve të Kosovës (ARBK) ofron informacione pa pagesë për publikun përmes faqes së vet të internetit (<https://arbk.rks-gov.net>). Informacioni i dhënë përfshin llojin e personit juridik, emërtimin e personit juridik, bashkë me numrin e regjistrimit, datën e themelimit, adresën, emrat e personave të autorizuar dhe emrat e pronarëve. Informacioni mbi llojet dhe format e personave juridikë që mund të krijohen në Kosovë gjithashtu është në dispozicion të publikut.²⁹

506. Aktualisht, Regjistri i Bizneseve përmban gjithsej 161.155 shoqëri. Nga këto, 128.976 janë të regjistruara si BI, 3.503 si OP, 87 si ShKM, 27.061 si SHPK, 513 si SHA, 809 si shoqëri të huaja tregtare, 133 si kooperativa bujqësore, 30 si ndërmarrje shoqërore, 10 si ndërmarrje publike, me 33 shoqëri nën juridiksionin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Identifikimi, vlerësimi dhe të kuptuarit e rreziqeve të PP/FT-së dhe dobësive të subjekteve juridike

507. VKR-ja e vitit 2013 nuk shqyrton llojet e ndryshme të personave juridikë me qëllim të vlerësimit të dobësive dhe joshjes së tyre për t'u keqpërdorur për qëllime të PP/FT-së. Paraqet shqetësim që VKR-ja as që përmend kalimthi në ndonjë nga gjetjet e veta çështjen e informacionit të pronësisë përfutuese, apo përdorimin e personave juridikë për qëllime të PP-së. Mirëpo kjo përmendet në SOCTA, që pranon si përdorimin e kompanive guaskë ashtu edhe të kompanive offshore në aktivitetet të PP-së në Kosovë, por nuk ofron ndonjë gjetje tjetër të hollësishme apo rekomandime për këtë çështje.

508. As rreziqet nuk u ndërlidhën me keqpërdorimin e personave juridikë të shqyrtuar gjatë rishikimeve të tjera të përgjithshme dhe sektoriale të bëra pas përfundimit të VKR-së, përveç sektorit të OJF-ve (shih gjithashtu RM 1, 9 dhe 10). Në të vërtetë, asnjëherë nuk është paraqitur një vështrim i përgjithshëm i kërcënimit, cenueshmërisë dhe ndikimit të personave juridikë, lidhjeve të tyre me shmangien nga tatimi, korrupsionin, kontrabandën, krimin e organizuar, ekonominë e zezë dhe transfertat bankare. As nuk ka ndonjë të kuptuar të qartë të numrit të aksionarëve të personave juridikë të regjistruar që janë ose individë të huaj, ose subjekte të huaja, ose administratorë të huaj të besuar trusti.

509. Për më tepër, duket se asnjëherë nuk janë vlerësuar informacione të tjera rrethimore siç janë qëllimet për të cilat përdoren personat juridikë dhe mënyra e pronësisë së tyre. Gjatë pjesës së vlerësimit në terren, u bë e qartë se edhe pse është e mundur për një person juridik në Kosovë të jetë në pronësi të një aksionari të huaj (që mund të jetë person fizik ose juridik që banon ose i inkorporuar në një juridiksion të huaj), ARBK-ja nuk konsideron se marrëveshjet e tilla paraqesin rrezik më të lartë ose të paktën të ndryshëm nga personat juridikë që janë thjesht vendorë. Edhe pse shumica dërrmuese e shoqërive të përfshira në Kosovë janë në pronësi të personave fizikë, kur pronësia i është dhënë personave juridikë, nuk duket që të jetë bërë ndonjë dallim nëse ai person juridik vepron si i emëruar, administrator i besuar ose në cilësinë e një të mirëbesuari apo që ndodhet në ndonjë juridiksion të huaj offshore. Është gjithashtu e qartë se përdorimi i mundshëm i personave ndërmjetës mashtrues nuk është hulumtuar në mënyrë të mjaftueshme dhe është hasur shumë pak vlerësim i rreziqeve të paraqitura nga ky fenomen.

510. Përveç kësaj, nuk ka dëshmi që dobësitë dhe rreziqet e personave juridikë të jenë marrë ndonjëherë parasysh për të hartuar strategji për të luftuar rrezikun nga PP-ja dhe FT-ja që mbizotëron në Kosovë.

511. I vetmi përjashtim ku kjo ndodh është sektori i OJF-ve, që është shqyrtuar nga ana e autoriteteve në vitin 2018 si ushtrim i veçantë i vlerësimit të rrezikut. Pavarësisht nga disa mangësi dhe mospërputhje metodologjike, raporti i vlerësimit të rrezikut vuri në dukje rreziqe dhe dobësi të dobishme në sektorin e OJQ-ve. Sa i përket kornizës rregullative dhe mbikëqyrëse, u vërejt në veçanti se: ka mungesë të akreditimit vendor për OJQ-të fetare (që nga ekipi i vlerësimit konsiderohet si një nga faktorët kryesorë të cenueshmërisë në kontekstin e FT-së); databaza qeveritare e OJQ-ve është e vjetërsuar dhe e pasaktë; ekziston periudhë e kufizuar kohore e pezullimit të OJQ-ve që dyshohen për lidhje me FT-në; ka mungesë të kapaciteteve brenda Departamentit të Regjistrimit të OJQ-ve. Vlerësimi vë në dukje një numër vështirësish, të përjetuara nga institucionet financiare në identifikimin dhe monitorimin e

²⁹ Legjislacioni i ri që rregullon informacionin themelor të pronësisë ishte miratuar në kohën e vizitës në terren, megjithatë u soll në vëmendje të ekipit vlerësues vetëm pas saj, prandaj nuk mund të merret parasysh për qëllimet e këtij vlerësimi .

aktiviteteve financiare të OJQ-ve, në veçanti: vështirësi me verifikimin e burimeve të financimit të OJQ-ve të huaja; keqidentifikim i qëllimshëm i klasifikimit të OJQ-ve për të fshehur natyrën e vërtetë të aktiviteteve; OJQ të mbyllura më parë të lidhura me FT-në të cilat janë rihapur sërish me emërtime të reja; banka që mbajnë llogari joaktive të OJQ-ve dhe në pamundësi për të kontrolluar me saktësi statusin aktual. Këto gjetje janë të rëndësishme sa i përket formulimit të politikave të ardhshme, megjithatë duke qenë se vlerësimi i OJQ-ve është finalizuar vetëm kohët e fundit, është e pamundur të gjykohet se deri në ç'masë do të merren realisht parasysh nga autoritetet politikat e rekomanduara aty.

Masa zbutëse për të parandaluar keqpërdorimin e personave dhe marrëveshjeve juridike

512. Autoritetet e Kosovës kanë ndërmarrë një sërë hapash që synojnë parandalimin dhe lehtësimin e keqpërdorimit të personave juridikë. Këtu hyn, siç u tha më lart, transparencja e informacionit themelor përmes regjistrimit dhe kërkesa për përditësimin e informacionit në ARBK brenda 15 ditësh, detyrimet e KDK-së për subjektet e detyruara, ndalimi i lëshimit të aksioneve të bartësve dhe sigurimi i qasjes në informata nga autoritetet.

513. Sa i përket transparencës, informacioni që ka ARBK-ja është publikisht në dispozicion dhe transparent. ARBK-ja kontrollon që informacioni që i është siguruar të jetë i plotë dhe vepron mbi prezumimin se të dhënat e ofruara janë të sakta, sepse dokumentet e paraqitura në zyrën e regjistrimit duhet të jetë dokumente origjinale ose kopje të origjinaleve të certifikuara nga noteri dhe paraqitja e të dhënave të rreme në zyrën e regjistrimit përbën vepër penale sipas dispozitave të përgjithshme të Kodit Penal (neni 403).

514. Ekziston detyrimi ligjor sipas nenit 17.8 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare që kërkon se çdo ndryshim i informacionit bazë (përfshirë ndryshime në aksione) lidhur me të gjithë personat juridikë t'i raportohen ARBK-së brenda pesëmbëdhjetë ditëve që nga dita kur bëhen këto ndryshime. Megjithatë, nuk duket të ketë ndonjë proces për verifikimin se informacioni i sigurohet Regjistrimit të Bizneseve apo për të kontrolluar nëse ai ka nevojë për përditësim. Nuk është e mundur as të jepet gjobë për mosnjohim të ARBK-së për ndryshime në aksione. Diskutimet në terren nxorën në pah disa shqetësime sa i përket saktësisë së të dhënave në ARBK në rrethanat e dobësive të lartpërmendura, që priren të ngrenë dyshime sa i përket aftësisë së autoriteteve për të garantuar integritetin dhe besueshmërinë e të dhënave.

515. ARBK-ja nuk ka vëzhguar apo raportuar ndonjë dështim në përshtatshmërinë, saktësinë apo freskinë e informacionit që ruan dhe nuk ka pasur raste në gjykatë lidhur me dështimin për dhënie të informacionit në ARBK apo për sigurim të informacionit të gabuar në ARBK.

516. Në mungesë të një regjistri të pronarëve përfitues, vetëm subjektet raportuese kanë informacione mbi pronësinë përfituese, në rastet kur ky informacion është i ndryshëm nga pronësia themelore, pasi ato u nënshtrohen kërkesave të pronësisë përfituese sipas Ligjit për PPP/LFT-në. Prandaj, informacioni mbi pronësinë përfituese është në dispozicion vetëm nga subjektet raportuese.

517. Edhe pse nuk ka regjistër të pronësisë përfituese, bankat dhe institucionet financiare më të mëdha duket se janë përgjithësisht të vetëdijshme për nevojën e tyre që të identifikojnë pronarin përfitues të personit juridik ose marrëveshjes juridike dhe çfarë duhet bërë për të konfirmuar pronësinë. Udhëzimet e siguruara nga BQK-ja në udhëzimin e datës 26 dhjetor 2017 për identifikimin e pronarëve përfitues kanë ndihmuar potencialisht në këtë drejtim. Në të vërtetë, duket se ka raste kur pragu prej 25% është injoruar dhe struktura e plotë e pronësisë dhe kontrollit është identifikuar dhe verifikuar. Megjithatë, nga pjesa në terren e vlerësimit ka rezultuar se nuk ndodh kështu në shumicën e rrethanave dhe shërbimet mund të ofrohen në rrethana të caktuara nëse pronari përfundimtar fshihet përmes strukturave komplekse. Fakti se ka mangësi të konsiderueshme në mbikëqyrjen e BPCJF-ve dhe se nuk ka pasur dënime nga ndonjë organ mbikëqyrës për banka ose institucione financiare për mosruajtjen e informacionit mbi pronësinë përfituese tregon se mangësitë në sistem lënë hapësirë për keqpërdorim të mundshëm.

518. Autoritetet kanë ndërmarrë një sërë masash kryesisht operative për të parandaluar keqpërdorimin e OJF-ve për qëllime të financimit të terrorizmit, megjithatë këto ishin kryesisht të kufizuara në pezullim të përkohshëm të aktiviteteve (shih RM 9 dhe 10), dhe, për pasojë, nuk është ndërmarrë asnjë masë tjetër parandaluese lidhur me atë sektor.

Qasje me kohë në informacion të përshtatshëm, të saktë dhe aktual për pronësinë bazë dhe përfituese të personave juridikë dhe marrëveshjeve juridike

519. ARBK-ja nuk verifikon saktësinë, përshtatshmërinë dhe aktualitetin e informacionit të pranuar pasi ky funksion nuk është brenda rolit të regjistrimit vendor të personave juridikë, sikurse nuk ka dispozita të qarta që kërkojnë që personat juridikë të mbajnë informata bazë të përshtatshme, të sakta dhe aktuale të pronësisë. Edhe pse ARBK-ja nuk ka vërejtur ndonjë problem me përshtatshmërinë, saktësinë ose aktualitetin e informacionit të mbajtur, ky informacion nuk mund të konsiderohet plotësisht i besueshëm në mungesë të mekanizmave të kontrollit ose sanksioneve kuptimplote lidhur me mosnjohimin për ndryshime në informacionin e pronësisë.

520. Sa i përket cilësisë së informacionit mbi pronësinë përfituese, vetëm subjektet raportuese që u nënshtrohen kërkesave të KDK-së janë të detyruara të marrin informacion mbi pronësinë përfituese dhe të përditësojnë ndryshimet në pronësinë përfituese. Paragrafët përkatës në kuadër të RM 4 japin informacion të mëtejshëm mbi KDK-në nga subjektet raportuese.

521. Është shqetësuese kur vihet re se autoritetet mbështeten tërësisht tek informacioni që mban ARBK-ja. Kur investimet bëhen përmes personave juridikë që janë të inkorporuar jashtë Kosovës, ARBK-ja nuk ka asnjë njohuri për pronësinë përfundimtare të atij subjekti, që do të thotë se mbështetja do të duhej të vendoset te subjektet raportuese që mund të ofrojnë shërbime për atë person juridik. Mirëpo mund të ketë situata kur një investim bëhet në Kosovë nga një person juridik që nuk është vendosur në Kosovë, por në një juridiksion tjetër. Nëse personit juridik nuk i ofrohen shërbime bankare ose të tjera nga ndonjë subjekt i sektorit financiar, do të jetë shumë e mundur që investimi të bëhet pa identifikuar pronarin përfitues përfundimtar. Nëse vetëm BPCJF-të, si noterët dhe agjentët e patundshmërive, përdoren për transaksione që ndodhin në Kosovë, ku niveli i mbikëqyrjes është i ulët (shih RM 4) dhe banka që përdoret për transferimin e fondeve është një bankë e huaj, ka shumë të ngjarë që autoritetet kompetente përkatëse, siç janë organet e zbatimit të ligjit, kurrë nuk do të ishin në gjendje të identifikonin pronarin përfitues dhe të kalonin atë informacion te homologët e tyre të huaj.

522. Prandaj, bankat kanë rol kyç në aftësinë e autoriteteve të Kosovës që të kenë qasje në afat në informata të përshtatshme, të sakta dhe aktuale rreth pronësisë përfituese. Kjo është veçanërisht e vërtetë, pasi që të gjitha subjektet juridike në Kosovë janë të detyruara të mbajnë një llogari bankare. Përfaqësuesit e bankave u shprehën bindshëm para ekipit të vlerësimit se nuk do të hyjnë në marrëdhënie biznesi përveç nëse pronari përfitues identifikohet, megjithatë ka dallime në të kuptuarit se çfarë është pronësia përfituese. Duke pasur parasysh mungesën e sanksioneve që shqiptohen nga autoritetet mbikëqyrëse për shkak të mungesës së disponueshmërisë së informacionit të pronësisë përfituese ose informacioneve të pasakta mbi pronësinë, mund të ngrihen dyshime për efektivitetin e kontroleve. Shumica e BPCJF-ve nuk ishin në dijeni të detyrimeve të tyre për të identifikuar pronarin përfitues dhe shumica dërrmuese e operatorëve dhe profesionistëve të intervistuar nuk mund të bënin asnjë dallim ndërmjet pronësisë dhe kontrollit. Edhe përfaqësuesit më të sofistikuar të sektorit të BPCJF-ve, siç janë noterët dhe auditorët nga katër firma të mëdha nga arritën t'i bindnin vlerësuesit se informacioni përfitues kërkohej pa dallim nga klientët dhe mbahej në dosje. Këto gjetje sugjerojnë se KDK-ja përkatëse për pronarët përfitues nuk është gjithnjë në dispozicion dhe se autoritetet kosovare nuk do të kenë gjithmonë qasje në informacione përfituese për qëllime të hetimeve vendore ose për shkëmbimin ndërkuftar të informacionit.

523. Meqenëse është e mundur për personat juridikë të blejnë patundshmëri, BPCJF-të qartazi kanë rol të rëndësishëm për t'u siguruar se është vënë në dispozicion informacioni për pronësinë përfituese sa i përket sektorit të patundshmërive dhe të ndërtimit. Këta sektorë janë veçanërisht të rëndësishëm pasi janë identifikuar nga praktikisht të gjithë të intervistuarit nga sektori privat si zona më e rrezikshme për pastrimin e parave në Kosovë. Nuk është e detyrueshme që të përdoren agjentë të patundshmërive për blerjen e pronës së patundshme, por kur ata përdoren, ata duhet të verifikojnë identitetin e pronarëve përfitues dhe ky informacion duhet të vihet në dispozicion të mbikëqyrësit gjatë inspektimeve në terren. Nga intervistat e bëra gjatë vlerësimit rezultoi se agjentët e patundshmërive nuk po e bëjnë KDK-në dhe pronësia përfituese nuk është në dispozicion. As klientët e pasurive të patundshme nuk i nënshtrohen vlerësimit të rrezikut. Mungesa e mbikëqyrjes së duhur të këtyre operatorëve, pavarësisht nga gjetjet e vlerësimit të rrezikut specifik të sektorit të biznesit të ndërtimit në tetor 2017 në Kosovë, lë derën hapur për shitje të pronës pa ditur se kush është pronari përfitues i fundit i shoqërisë blerëse dhe nuk mbahen shënime për qëllime evidentimi.

Mekanizmi për të identifikuar pronësinë përfituese të kompanive blerëse nëpërmjet llogarive bankare të mbajtura në banka nuk do të ishte mjeti më efektiv në këtë rast.

524. Përfundime të ngjashme mund të arrihen në lidhje me noterët dhe avokatët e përfshirë në transaksionet e patundshmërive, të cilët demonstruan shumë pak njohuri për detyrimet e PPP/LFT-së gjatë pjesës së vlerësimit në terren dhe në praktikë bëjnë dukshëm shumë pak përpjekje, nëse i bëjnë, për të identifikuar pronarin përfitues (përveç një avokati të veçantë që përfaqësonte një firmë të përfshirë rregullisht në transaksione të mëdha komerciale, i cili mundi të japë shembuj se çfarë informacioni i pronësisë përfituese kërkohet dhe i cili tregoi për situata kur biznesi është refuzuar për shkak të mungesës së informacionit të pronësisë përfituese). Përveç këtij avokati të vetëm, të gjithë noterët, profesionistët juridikë dhe agjentët e patundshmërive e takuar në terren u konfirmuan vlerësuesve se informatat e pronësisë përfituese nuk ruhen. Disa auditorë dhe kontabilistë, shumica e të cilëve përfaqësonin firma të mëdha të auditimit dhe firma shumëkombëshe, ishin në të njëjtën situatë si profesionistët e tjerë, ndërsa disa të tjerë shfaqnin më shumë njohuri lidhur me kërkesat për të marrë informacion mbi pronësinë përfituese. Kjo situatë, e përkeqësuar nga fakti se niveli i mbikëqyrjes dhe sanksionimit të BPCJF-ve është shumë i ulët³⁰, i jep shkas mundësive reale që në situatat kur për transaksione nuk përdoren banka kosovare, autoritetet kompetente nuk do të ishin në gjendje të kishin qasje në informacionin e përshtatshëm, të saktë dhe aktual të pronësisë përfituese.

525. Në të vërtetë, ka pasur shumë pak hetime që kanë të bëjnë me përdorimin e personave juridikë dhe sipas Policisë së Kosovës ka pasur shumë pak situata ku ka pasur nevojë të marrin informacion mbi pronësinë përfituese. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se mund të ketë raste të tjera të mundshme ku kërkohen hetime dhe që nuk janë identifikuar për shkak të vetëdijesimit dhe njohurive të kufizuara rreth çështjeve të shoqërive tregtare dhe përdorimit të personave juridikë dhe marrëveshjeve juridike të huaja. Policia e Kosovës ishte e mendimit se të gjitha informatat mbi të dhënat e pronarit përfitues mbahen nga ARBK-ja dhe nga bankat, por nuk mund të thonë se çfarë duhet bërë në ato situata kur informacioni nuk është i disponueshëm. Policia e Kosovës duket të mos ketë dijeni nëse në raste të tilla ata do të ishin në gjendje të merrnin informata të përshtatshme, të sakta dhe aktuale përtej informacioneve të disponueshme në Regjistrin e Biznesit dhe prej kujt do të ishin në gjendje t'i merrnin ato.

526. Edhe pse NjIF-it i është dhënë kompetenca për të pasur qasje në informacion nga subjektet, gjë që ende mund të jetë problematike në ato raste kur informacioni nuk merret për herë të parë si pjesë e procesit të KDK-së, ligji hesht sa i përket kompetencave të Policisë së Kosovës për të marrë këtë informacion. Të anketuarit nga forcat policore të pranishëm gjatë vlerësimit në terren pohuan se deri më tani, në disa raste që përfshinin persona juridikë, pronësia e personit juridik është marrë gjithmonë nga ARBK-ja. Nuk ka pasur raste kur Policia ka bërë kërkesë për informim për homologët e tyre të huaj dhe në ato raste kur kanë pranuar kërkesë nga ndonjë polici e huaj, Policia e Kosovës deklaroi se ata do të ishin në gjendje të merrnin informacion mbi pronësinë përfituese nëpërmjet një kërkesë për informacion në ARBK, Doganë, ATK dhe NjIF. Qasja e drejtpërdrejtë në informacionin bankar është e mundur vetëm në rrethanat e një hetimi të hapur formal. Nuk ka pasur ndonjë njohuri sa i përket mundësisë që pronësia përfituese pas strukturave komplekse të mos jetë aq e lehtë për t'u deshifruar.

527. Sikurse u tha më lart, autoritetet nuk duket të vlerësojnë se çdo vend përballet me rrezikun e pronarëve të huaj të personave juridikë dhe marrëveshjeve juridike të cilët mund të jenë të interesuar të investojnë fonde të fituara në mënyrë të paligjshme përmes subjekteve juridike të përfshira në Kosovë ose që marrëveshjet juridike si trustet dhe fondacionet mund të krijohen në një vend të huaj dhe të përdoren për të operuar brenda territorit të Kosovës. Autoriteti i vetëm që ka demonstruar një nivel të lavdërueshëm të të kuptuarit të situatave ku kontrolli i është dhënë një pale të tretë që nuk është zyrtarisht pronar i një ndërmarrjeje, ishte ATK-ja. ATK-së i janë dhënë kompetenca për të hetuar personat që përfitojnë nga veprimtaria e një kompanie dhe për ta mbajtur atë person përgjegjës për aktivitetet e kompanisë. Kjo kompetencë mund të ushtrohet edhe në rastet e PP-së dhe madje edhe nëse personi nuk është zyrtarisht aksionar i një kompanie.

528. Sa i përket marrëveshjeve juridike, ashtu siç u tha më lart në raport, këto nuk mund të krijohen sipas ligjit të Kosovës. Subjektet raportuese janë të detyruara të përmbushin të gjitha kërkesat e KDK-së nëse ato kryejnë transaksione ku përfshihen trustet e huaja dhe marrëveshje të tjera juridike. Sipas informacioneve të ofruara gjatë pjesës në terren të vlerësimit, nuk ka

³⁰ Në rastin e noterëve, 35 inspektive janë realizuar në fakt në katër vitet e fundit, por pavarësisht nga disa dështime të identifikuara në lidhje me informacionin përfitues, asnjë sanksion administrativ nuk është shqiptuar asnjëherë.

pasur hetime, ndjekje penale apo kërkesa për ndihmë të ndërsjellë juridike që kanë pasur të bëjnë me marrëveshje juridike. Nuk ka pasur as raste ku kanë qenë të përfshira trustet. Nëse kjo i atribuohet mungesës së trusteve apo të marrëveshjeve të tjera juridike të përfshira në transaksione tregtare në Kosovë apo nëse kjo është shkaktuar nga mungesa e njohurive dhe përvojës në këtë fushë, kjo nuk mund të thuhet nga vlerësuesit. Prandaj, saktësia, përshtatshmëria dhe aktualiteti i informacionit të mbajtur nga subjektet raportuese për trustet e huaja dhe marrëveshjet e tjera juridike nuk është testuar kur është përdorur si provë.

Efektiviteti, proporcionaliteti dhe zhbindja nga sanksionet

529. Sanksionet administrative të zbatueshme për subjektet raportuese për mungesën e sigurimit apo mosruajtjen e informacionit për pronësinë përfituese janë si vijon: ose një vërejtje private ose një gjobë ndërmjet 20.000 euro dhe një shumë që nuk tejkalon 5% të vlerës neto të subjektit raportues. Në të kundërt, gjoba mund të jetë e barabartë me shumën e vëllimit ekonomik të një transaksioni plus 50% të asaj vlere, por jo më pak se 20.000 euro. Gjithashtu është e mundur që të vendoset një gjobë e prerë prej 30.000 euro. Gjithashtu, janë të mundshme gjobat për individët përgjegjës për shkelje dhe që mbajnë poste administrative apo menaxhuese brenda subjektit.

530. BQK-ja dhe NjIF-i kanë bërë një sërë ekzaminimesh mbikëqyrëse në terren dhe në disa prej këtyre inspektimeve është konstatuar se ka pasur shkelje të detyrimit për të ruajtur informacionin e pronësisë përfituese, që të jetë i saktë, i përshtatshëm dhe i përditësuar. Pavarësisht identifikimit të këtyre shkeljeve, nuk është shqiptuar asnjëherë ndonjë sanksion. Nga autoritetet mbikëqyrëse pritet të zbatohen dispozitat sanksionuese në mënyrë që të sigurojnë se detyrimet e zbatueshme në ligj merren seriozisht nga subjektet raportuese dhe zbatohen në mënyrë të përpiktë. Sidoqoftë, është konsideruar pikëpamja se ndëshkimi maksimal i zbatueshëm me ligj nuk është mjaft zbindës për subjektin raportues me mjete të konsiderueshme, si p.sh. bankat, ndaj vlere e ndëshkimeve duhet të rishikohet.

531. Paraqitja e të dhënave të rreme tek ARBK-ja do të përbënte vepër penale sipas nenit 403 të Kodit Penal që dënohet me burgim nga 3 muaj deri në pesë vjet. Edhe pse deri tani nuk janë regjistruar ndjekje penale për raste të tilla, dënimi penal për një vepër të tillë konsiderohet të jetë mjaftueshëm zbindës.

532. Neni 17.8 i Ligjit për Shoqëritë Tregtare kërkon nga personat juridikë që ta informojnë ARBK-në për çdo ndryshim në të dhënat e regjistruara brenda një periudhe prej 15 ditësh. Mirëpo ligji nuk parashikon asnjë gjobë për mospërmbushje të këtij afati dhe do të duhej që gjoba e cila do të përfshihej për mosnjohim të jetë efektive, proporcionale dhe zbindëse.

Përfundimet e përgjithshme për Rezultatin e Menjëhershëm 5

533. VKR-ja dhe vlerësimet e tjera të rrezikut të kryera në nivel kombëtar nuk shqyrtojnë llojet e ndryshme të personave juridikë me qëllim të vlerësimit të dobësive të tyre dhe të joshjes për t'u keqpërdorur për qëllime të PP/FT-së (përveç OJF-ve). Nuk ka as ndonjë dëshmi se dobësitë dhe rreziqet e personave juridikë të jenë marrë ndonjëherë parasysh për të hartuar strategjinë e vendit për të luftuar rrezikun nga PP-ja dhe FT-ja që mbizotëron në Kosovë.

534. Edhe pse janë ndërmarrë hapa të caktuar nga autoritetet e Kosovës për të frenuar keqpërdorimin e personave juridikë dhe marrëveshjeve juridike, nuk duket të ketë ndonjë proces për verifikimin e informacionit që i është dhënë ARBK-së ose për të kontrolluar nëse kërkohet përditësimi. Nuk është as e mundur të jepet dënim për mosnjohim të ARBK-së për ndryshimet në aksione.

535. Në mungesë të regjistrimit të pronarëve përfitues, informacioni i pronësisë përfituese është në dispozicion vetëm nga subjektet raportuese. Përderisa bankat dhe një sërë institucionesh financiare duket të jenë mjaft të vetëdijshme për atë se çfarë duhet bërë për të konfirmuar pronësinë përfituese, shumica dërrmuese e subjekteve të tjera nuk përcaktojnë se kush është pronari përfitues kur ofrojnë shërbime për personat juridikë dhe marrëveshjet juridike.

536. Në rastet kur BPCJF-të me seli në Kosovë përdoren për të kryer ndonjë transaksion, por bankat e përfshira në transaksion qëllon të jenë të huaja, ekziston mundësia reale që autoritetet kompetente të mos jenë në gjendje të kenë qasje në informacion e përshtatshëm, të saktë dhe aktual për pronësinë përfituese. Ky skenar pa dyshim do të ndikojë negativisht në aftësinë për të ndjekur hetimet vendore të krimit financiar dhe me siguri do të pengojë shkëmbimin ndërkufitar të informacionit për pronarin përfitues. Në një vend ku pretendohet gjerësisht nga bashkëbiseduesit se industria e ndërtimit dhe blerja e patundshmërive janë joshëse për qëllime të pastrimit të parave, pamundësia për të konstatuar pronarët përfitues të personave juridikë

që blejnë pasuri në Kosovë është mangësi serioze. Niveli i ulët i vetëdijesimit brenda Policisë së Kosovës për mënyrën se si personat juridikë dhe marrëveshjet juridike mund të keqpërdoren për qëllime të PP/FT-së dhe mungesa e ndërveprimit me homologët e huaj në raste të tilla e bën juridiksionin edhe më të ndjeshëm ndaj PP-së dhe FT-së përmes përdorimit të personave juridikë dhe marrëveshjeve juridike, pronësia e të cilëve fshihet nga struktura komplekse.

537. Kosova ka arritur nivel të ulët të efektivitetit lidhur me Rezultatin e Menjëhershëm 5.

KAPITULLI 8. BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

Gjetjet kryesore dhe veprimet e rekomanduara

Gjetjet kryesore

- Autoritetet e Kosovës kanë krijuar një sistem gjithëpërfshirës dhe bëjnë përpjekje të konsiderueshme për të ofruar një gamë të gjerë të NNJ-së, mirëpo disa çështje që kanë të bëjnë me kërkesat legjislative dhe procedurat e ndërlikuara të bashkëpunimit ndërkombëtar të NNJ-së kanë ndikim në afatin e ndihmës. Autoritetet kanë marrë masa përmirësuese, por nevojiten masa të mëtejshme për të adresuar çështjet e mbetura.
- Sistemet dhe procedurat për përcaktimin e prioriteteve të kërkesave të NNJ-së që ka pranuar Kosova nuk janë zbatuar nga të gjitha autoritetet.
- Autoritetet e Kosovës nuk kanë demonstruar përdorim aktiv të NNJ-së për qëllime të hetimit dhe ndjekjes penale të PP-së dhe FT-së në Kosovë.
- NjIF-i shkëmben aktivisht informata për PP-në, veprat e ndërlidhura dhe FT-në, që përdoren në analizat e veta dhe për të mbështetur përpjekjet e AZL-ve. Vlerësuesit nuk kanë ndonjë tregues për ndonjë çështje që ka të bëjë me afatin e ofrimit të informacionit. Megjithatë, mangësitë e identifikuar nën RM 6 sa i përket qasjes në informacion mund të ndikojnë në efektivitetin e bashkëpunimit.
- Pavarësisht përpjekjeve të rëndësishme të AZL-ve për shkëmbim të informacionit ndërkombëtar, nuk u demonstrua mjaftueshëm se ato përqendrohen si duhet në rastet e PP-së dhe FT-së. Bashkëpunimi mbikëqyrës në këtë drejtim duket të jetë i kufizuar.
- Mangësitë e përgjithshme lidhur me qasjen në informacionin për pronësinë përfituese ndikojnë edhe në bashkëpunimin ndërkombëtar.

Veprimet e rekomanduara

- Autoritetet e Kosovës duhet të ndërmarrin masa të mëtejshme legjislative dhe të zbatojnë mekanizma shtesë të bashkëpunimit ndërinstitucional për të siguruar afatin e përgjigjeve ndaj kërkesave për NNJ-në.
- Autoritetet duhet të përqendrohen më tej në përdorimin e bashkëpunimit të drejtpërdrejtë, të sigurojnë se ka bazë formale të përshtatshme për këtë bashkëpunim dhe të zbatojnë masa për të monitoruar dhe shmangur si duhet teprinë në këtë bashkëpunim, kudo që ligjërisht është e mundur.
- Autoritetet e Kosovës duhet të sigurojnë prioritizimin sistematik të rasteve të NNJ-së nga të gjitha institucionet kompetente bazuar në procedurat e brendshme të avancuara dhe sistemet e menaxhimit të rasteve.
- Autoritetet e Kosovës duhet të ndërmarrin masa urgjente për të vlerësuar arsyet e rënies së përdorimit të kanalit të bashkëpunimit të NNJ-së për ndjekjen e rasteve të PP-së dhe për të siguruar që në të gjitha rastet e mundshme të PP-së ndihma juridike ndërkombëtare të shfrytëzohet si duhet bazuar vetëm mbi prioritetet hetimore dhe pavarësisht pengesave procedurale që mund të jenë të ndërlidhura me praktikën e krijuara (si është theksuar nën RM 7).
- NjIF-i duhet të zhvillojë më tej aftësinë për qasje në afat dhe përdorim të të gjitha informatave, sidomos të informacionit ku ka qasje të tërthortë nga burime të jashtme, për qëllime të shkëmbimit ndërkombëtar të informacionit.
- AZL-të e Kosovës duhet të kërkojnë bashkëpunim ndërkombëtar në mënyrë proaktive për të siguruar se të gjitha rastet e mundshme të PP-së dhe FT-së eksplorojnë si duhet.
- Duhet të organizohet rregullisht trajnim i vazhdueshëm dhe i qëndrueshëm për të gjitha autoritetet hetuese të Kosovës se si të kërkojnë dhe të përdorin ndihmën juridike ndërkombëtare.

538. Rezultati i Menjëhershëm përkatës i shqyrtuar dhe i vlerësuar në këtë kapitull është RM 2. Rekomandimet përkatëse për vlerësimin e efektivitetit në këtë seksion janë R. 36-40.

Rezultati i Menjëhershëm 2 (Bashkëpunimi ndërkombëtar)

Ofrimi dhe kërkimi konstruktiv dhe në afat i NNJ-së dhe ekstradimit

539. Profili i rrezikut të Kosovës e bën sigurimin e bashkëpunimit ndërkombëtar një çështje me rëndësi të madhe. Kjo ndërlidhet jo vetëm me lidhjet rajonale dhe me pasurinë me origjinë kriminale në vendet fqinje, por edhe me komunitetin e madh të diasporës që ka Kosova në vendet e BE-së dhe të Zonës Ekonomike Evropiane. Shumica e rasteve të terrorizmit të diskutuara gjithashtu duket se kanë një përmasë të rëndësishme të huaj, në nivel rajonal dhe më gjerë në nivel evropian, duke përfshirë por jo vetëm objektivat e veprimtarive terroriste në rajon, çështjen e LHT-ve dhe pjesëtarët e komuniteteve vendore që u bashkohen terroristëve ose organizatave paraushtarake, fenomenin e OJF-ve dhe financimin e tyre.

540. Ofrimi i ndihmës juridike në çështjet penale mbështetet në një kornizë ligjore mjaft të gjerë në Kosovë edhe pse ndikohet nga disa faktorë që kryesisht lidhen me numrin e kufizuar të marrëveshjeve ndërkombëtare³¹ (edhe pse zbutet nga zbatimi i parimit të reciprocitetit në bashkëpunim dhe përpjekjet aktive të autoriteteve për të siguruar marrëveshje të mëtejshme) dhe sidomos nga çështjet që ndërlidhen me afatin dhe mungesën e afateve specifike, përfshirë procedurat e vështira në disa raste.

541. Kërkesat hyrëse për NNJ-në në Kosovë trajtohen përmes një mekanizmi të centralizuar që në shumë raste ndikohet nga çështje të cilat janë të dëmshme për efektivitetin. Procedurat përfshijnë autoritetin qendror në Ministrinë e Drejtësisë, por kërkojnë edhe përdorimin e kanaleve diplomatike (edhe pse nuk ka pasur raste të përdorimit të kanaleve diplomatike në praktikë). Për më tepër, prokuroria dhe gjykatat janë të përfshira në procedurë. Procedura stërzgjatet nga devijime të rastit derisa kërkesa të arrijë tek autoriteti kompetent për ekzekutim. Në rastin e kërkesave për ekstradim në Kosovë procedurat e ankimit pas vendimit përfundimtar të gjykatave parashihen në nenet 28-30 të Ligjit për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështje Penale dhe këto shtojnë kompleksitetin dhe ndikojnë në afatin e ekzekutimit, ndonjëherë më shumë se 6 muaj. Gjendja ndikohet negativisht nga mungesa e afateve të rrepta për ekzekutimin e kërkesave në secilën fazë. Po ashtu, përkundër përdorimit të një sistemi të avancuar të menaxhimit të rasteve në autoritetin qendror pranë Ministrisë së Drejtësisë, një sistem i tillë nuk zbatohet në prokurori dhe në gjykata, ku është raportuar se rastet menaxhohen me regjistra të shtypur në letër. Për më tepër, vërehet se në një sërë rastesh efektiviteti i bashkëpunimit mund të ndikohet negativisht nga detyrimi për dërgimin e kërkesës në Prokurorinë Themelore përkatëse përkundër faktit se rasti mund të jetë në kompetencën e p.sh. në rastet e PP-së të PSRK-së, gjë që shton një element të panevojshëm në zinxhirin e ekzekutimit. Autoritetet janë të vetëdijshme për shumicën e efekteve negative dhe kanë ndërmarrë hapa për të korrigjuar situatën edhe pse këto nuk janë finalizuar deri në fund të vizitës në terren dhe rrjedhimisht nuk janë marrë parasysh.

542. Përcaktimi i pikave të kontaktit në Prokuroritë Themelore në vitin 2017 kishte për qëllim t'i kontribuonte efektivitetit dhe afatit të bashkëpunimit sidomos në lidhje me çështjet prioritare dhe mundëson tejkalimin e disa komplikimeve të përmendura më lart.

543. Bashkëpunimi i drejtpërdrejtë me homologët e huaj nuk lejohet me përjashtim të rasteve urgjente sipas nenit 4, paragrafi 2 të Ligjit për NNJ-në, që mundëson dhënien e ndihmës edhe nëse kërkesa është pranuar drejtpërdrejt (që duhet pasuar me konfirmim me shkrim përmes kanalit zyrtar). Në praktikë, komunikimi i drejtpërdrejtë ndërmjet prokurorive duket të jetë gjerësisht i shfrytëzueshëm dhe i dobishëm për përpjekjet e prokurorëve. Shumë raste u diskutuan dhe shembuj pozitivë u janë ofruar vlerësuesve nga Ministria e Drejtësisë dhe autoritetet përkatëse të përfshira në bashkëpunim të drejtpërdrejtë, pavarësisht nga mungesa e statistikave gjithëpërfshirëse. Gjithashtu, vihet re se në shumë raste përdorimi i këtij sistemi do

³¹ Marrëveshja për Ndhimë të Ndërsjellë Juridike, Ekstradim dhe Transferim të Personave të Dënuar me Republikën e Shqipërisë, Marrëveshja për Ndhimë të Ndërsjellë Juridike, Ekstradim dhe Transferim të Personave të Dënuar me "Ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë", Marrëveshja për Bashkëpunim Juridik në Çështje Penale me Republikën Federale të Gjermanisë, Marrëveshja për Ndhimë të Ndërsjellë Juridike me Republikën e Hungarisë, Marrëveshja për Ndhimë të Ndërsjellë Juridike dhe Ekstradim me Republikën e Italisë, Marrëveshja për Ndhimë të Ndërsjellë Juridike me Republikën e Kroacisë, Marrëveshja për Transferim të Personave të Dënuar me Republikën e Zvicrës, Marrëveshja për Ndhimë të Ndërsjellë Juridike me Republikën e Turqisë, Marrëveshja për Transferim të Personave të Dënuar me Belgjikën.

të ndikohej negativisht nga mungesa e marrëveshjeve formale për këtë qëllim. Një çështje tjetër që mund të ndikojë në efektivitet është mungesa e njoftimit të rregullt të Ministrisë së Drejtësisë për bashkëpunimin e drejtpërdrejtë që mund të ketë gjithashtu efekt të dëmshëm në afat, duke pasur parasysh kërkesat për konfirmim zyrtar pas bashkëpunimit të drejtpërdrejtë dhe ngatërresave të mundshme apo dyfishimit të përpjekjeve.

544. Kërkesat për NNJ-në të pranuar nga Departamenti për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar pranë Ministrisë së Drejtësisë në lidhje me gamën e veprave penale të ndryshme për periudhën 2015-2017 është midis 85 dhe 96 në vit. Krimet me të cilat kishin të bënin shumica e kërkesave përfshinin falsifikimin dhe piraterinë e produkteve (gjithsej 96 raste për atë periudhë), grabitjen ose vjedhjen (gjithsej 51 raste); trafikimin me qenie njerëzore dhe kontrabandimin me migrantë (gjithsej 27 raste); shfrytëzimin seksual (gjithsej 16 raste) dhe trafikimin e paligjshëm të lëndëve narkotike dhe substancave psikotrope (gjithsej 17 raste).

545. Autoritetet e Kosovës kanë siguruar statistikën e mëposhtme për kërkesat lidhur me PP-në. Kërkesat e pranuar për PP-në ishin përkatësisht 5 në vitin 2015, një në vitin 2016 dhe 4 në vitin 2017 nga numri i lartpërmendur i kërkesave të pranuar në vit. Vërehet se në vitin 2015 Departamenti kompetent për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar pranë Ministrisë së Drejtësisë ka dërguar 3 përgjigje lidhur me kërkesat për PP-në, në vitin 2016 ka pasur dy përgjigje dhe në vitin 2017 4 përgjigje. Vizita në terren konfirmoi se refuzimi i bashkëpunimit ka ndodhur në rrethana shumë të kufizuara (vetëm në një rast në 5 vitet e fundit) në lidhje me arsye kushtetuese dhe në asnjë mënyrë nuk mund të interpretohet si ndikim negativ në sigurimin e bashkëpunimit. Nuk janë ofruar statistika të tjera për të demonstruar kohën për ekzekutimin e kërkesave dhe në këtë drejtim nuk mund të dilet në asnjë konkluzion përfundimtar. Gjatë vizitës në terren u diskutuan disa raste specifike për të përcaktuar kohën e nevojshme për ofrimin e ndihmës së duhur. Për disa raste të ardhura për NNJ (nga Rumania, Franca, etj.) u deshën mesatarisht 6-8 muaj për të ofruar ndihmë edhe pse këto janë konsideruar nga autoritetet e Kosovës si çështje komplekse që përfshijnë shumë subjekte dhe, në këtë mënyrë, nuk tregojnë mjaft efektivitetin e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar të ofruar nga Kosova. Megjithatë, përkundër simpatisë së disa vlerësuesve me këtë pikëpamje, nuk janë ofruar statistika gjithëpërfshirëse që mund të demonstrojnë efektivitetin. Vërehet se në vitin 2017 masat u zbatuan në lidhje me sigurimin e komunikimit të drejtpërdrejtë me prokurorinë përmes pikave kontaktuese që i kanë kontribuar një procedurë më efikase. Po ashtu autoritetet e Kosovës kanë demonstruar aftësinë për të reaguar me shpejtësi në rastet me prioritet të lartë duke ndjekur bashkëpunimin efikas dhe procedurat e bashkërendimit (p.sh. në rastet e ndërlidhura me terrorizmin). Komunikimi i drejtpërdrejtë po i kontribuon edhe afatshmërisë, edhe pse vlerësuesit nuk mund të konfirmonin ndikimin e tij të saktë. Lidhur me cilësinë e ndihmës së dhënë, autoritetet kanë vërejtur kënaqshmërinë e përgjithshme të një sërë vendesh që kanë kërkuar ndihmë, edhe pse në mungesë të komenteve të pavarura të pranuar në kuadër të projektit të vlerësimit aktual nga vendet partnere nuk është e mundur që të arrihet në ndonjë përfundim në këtë drejtim.

546. Autoritetet e Kosovës nuk mbajnë statistika të veçanta lidhur me kërkesat për FT-në ndaj në këtë drejtim nuk mund të arrihet ndonjë përfundim pasi duket se nuk ka pasur raste të shkëmbimit të informacionit në lidhje me FT-në. Lidhur me terrorizmin, ka pasur 12 kërkesa të NNJ-së (edhe për rastet e filluara në vitet e mëparshme) për periudhën 2015-2017. Vlerësuesve iu paraqitën disa raste të ndërlidhura me terrorizmin ku ishin siguruar informata kthyesë jashtëzakonisht të shpejta, brenda disa orësh dhe informacioni i kërkuar u është siguruar autoriteteve kërkuese.

547. Kërkesat për ekstradim ishin 11 për vitin 2015, 13 për vitin 2016 dhe 28 për vitin 2017. Asnjë nga këto kërkesa nuk ishin të ndërlidhura me PP-në. Po ashtu, nuk ka asnjë informacion për ndonjë kërkesë për ekstradim në Kosovë që të ndërlidhet me financimin e terrorizmit, edhe pse ka pasur gjithsej 5 kërkesa të ndërlidhura me terrorizmin. Megjithatë, sa i përket efektivitetit të ekzekutimit të kërkesave për ekstradim në përgjithësi, vërehet se procedura ligjore e ankimit pas vendimit përfundimtar të gjykatës (domethënë pas kohës së nevojshme për të vlerësuar kërkesën dhe për të arritur në përfundim) në të vërtetë do t'i shtonte mesatarisht 6 muaj procedurës dhe ky mjet juridik është përdorur gjerësisht nga personat që kërkohen të ekstradohen.

548. Çështja e kriminalitetit të dyfishtë deri më tani nuk është parë se paraqet ndonjë shqetësim për autoritetet e Kosovës, edhe pse kërkesat ligjore në këtë drejtim janë të zbatueshme, ashtu siç shtjellohen në shtojcën e Përputhshmërisë Teknike.

549. Autoriteti qendror i NNJ-së në Kosovë përdor një sistem të sofistikuar të menaxhimit të rasteve për vlerësim të detajuar dhe për të zhvilluar NNJ-në, edhe pse ai mund të përfitojë nga

përmirësimi dhe shtimi i karakteristikave të tjera që lehtësojnë prioritizimin e rasteve, p.sh. mundësia për njoftime/alarme, etj. Gjithashtu vihet re se aktualisht asnjë statistikë e gjeneruar nga sistemi nuk u ka siguruar vlerësuesve kohën e reagimit dhe gjithashtu duhen adresuar disa çështje që lidhen me praktikën e vendosur në mbajtjen e statistikave, për shembull, mungojnë statistika për FT-në si një vepër e veçantë.

550. Ndihma juridike ndërkombëtare lidhur me sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive për periudhën 2014-2018 ishte mjaft e kufizuar. Është vërejtur se të gjitha kërkesat drejtuar autoriteteve të Kosovës janë ekzekutuar, mirëpo nuk ka përfundime të mëtejshme për efektivitetin apo shpjegimin e përdorimit të rrallë të NNJ-së për qëllime të tilla, duke pasur parasysh mungesën e informatave mbi rastet specifike.

Tabela 36: Rastet e NNJ-së për sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive, 2014-2018

Lloji i rastit	Kategoria e rastit	Nënkategoria	Nga	Për	Statusi
Sekuestrim	Penale	Vjedhje	Gjykata Themelore Gjakovë, dega Rahovec	Itali	I hapur
Ngrirje	Penale	Shmangie nga tatimi	Gjermani	Prokuroria Themelore Prishtinë	Ekzekutuar
Konfiskim	Penale	Trafikim i lëndëve narkotike	Zvicër	Gjykata Themelore Prishtinë	Ekzekutuar
Konfiskim	Penale	Trafikim droge, pastrim parash	Gjermani	Gjykata Themelore Gjakovë	Ekzekutuar

551. Kërkesat dalëse (rastet e reja të iniciuara) për NNJ-në në lidhje me PP-në ishin 4 nga gjithsej 22 kërkesa për vitin 2015, një nga 12 për vitin 2016 dhe dy nga 9 kërkesa për vitin 2017. Duke marrë parasysh këto statistika, është shqetësuese për vlerësuesit që rastet e reja të kërkesave në lidhje me PP-në në fakt janë duke u zvogëluar dhe kryesisht korrespondojnë me gjetjet në kuadër të RM 6 dhe RM 7. Këto statistika të kombinuara me numrin përgjithësisht të ulët të kërkesave mund të jenë tregues i përdorimit të pamjaftueshëm të potencialit të NNJ-së nga autoritetet e Kosovës.

552. Duke pasur parasysh kërkesat shtesë për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështje penale brenda rasteve tashmë të iniciuara të bashkëpunimit, ka një numër të konsiderueshëm të kërkesave që kanë të bëjnë me PP-në (nga gjithsej 250 kërkesa shtesë për 2015-2017 brenda rasteve të iniciuara), përfshirë kërkesat për ekstradim.

553. Këto kërkesa tregojnë aftësinë dhe angazhimin aktiv të autoriteteve të Kosovës në bashkëpunim me një sërë vendesh jashtë marrëveshjeve të arritura. Kërkesat përafërsisht i korrespondojnë kërcënimeve ndërkufitare me të cilat përballet Kosova, me theks të veçantë në bashkëpunimin rajonal që nuk duket i pabazuar.

Shembull – Rasti i gjyqtarit nga Klina

Një rast ku NNJ-ja është përdorur për të identifikuar pasuritë jashtë vendit ishte ai i ish-gjyqtarit të diskutuar në kuadër të RM 6 dhe RM 7. Në këtë rast, u gjet se ish-gjyqtari kishte transferuar pasuritë jashtë vendit, në Mal të Zi dhe se pasuria u identifikua dhe më pas u sekuestrua e pastaj konfiskimi përfundimtar u vendos nga gjykata. Megjithatë, nuk është e qartë nëse konfiskimi është ekzekutuar në të vërtetë në lidhje me këtë pasuri.

554. Në të njëjtën kohë, Kosova ka shfaqur aftësinë për të bashkëpunuar me vende të tjera në një sërë rastesh që kanë të bëjnë me terrorizmin, edhe pse autoritetet e Kosovës nuk kanë

demonstruar plotësisht përdorimin e bashkëpunimit juridik për qëllime të ndjekjes së rasteve të FT-së në vetvete. Janë vetëm tre raste të kërkesave për FT të ofruara nga autoritetet e Kosovës për vitin 2018.

Shembull – Përdorimi i ekstradimit në hetime të FT-së

Një rast i hapur ndërlidhet me përgatitjen e veprimtarisë terroriste dhe respektivisht FT-në të kryer nga një vend i BE-së. U identifikuan disa transaksione nga vendi përkatës dhe u lidhën me një person në Kosovë. Fondet duhej të përdroreshin për qëllime të FT-së. U iniciua kërkesa për ekstradim për të njëjtin person (i cili ishte ekstraduar). Çështja filloi me komunikimin e drejtpërdrejtë të prokurorive. Pastaj u përgatit kërkesa zyrtare ndërkombëtare për ndihmë në lidhje me ekstradimin.

555. Duke pasur parasysh përdorimin jashtëzakonisht të kufizuar të NNJ-së për qëllime të sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurive, Kosova nuk ka demonstruar efektivitet në këtë drejtim.

556. Në të njëjtën kohë, nuk është e mundur të arrihet në përfundime të mëtejshme lidhur me efektivitetin me të cilin autoritetet e Kosovës po përdorin kanalin e NNJ-së për të ndjekur rastet e PP-së dhe FT-së në dritën e mungesës së statistikave të tjera dhe komenteve të pavarura mbi: cilësinë e kërkesave, numrin e refuzimeve, kohën e nevojshme për ekzekutimin e këtyre kërkesave, kërkesat për shtyrje, kërkesat specifike në lidhje me FT-në etj.

Ofrimi dhe kërkimi për forma të tjera të bashkëpunimit ndërkombëtar për qëllime të PPP/LFT-së

NjIF

557. NjIF-i angazhohet në mënyrë aktive në bashkëpunimin ndërkombëtar dhe shkëmbimin e informacionit në bazë të kompetencave të veta të gjera sipas Ligjit për PPP/LFT-në, Marrëveshjeve të Mirëkuptimit të arritura me një sërë vendesh dhe në respektim të rreptë të parimeve të Grupit Egmont si anëtare e kësaj organizate që nga viti 2017. NjIF-i nuk ka nevojë për Marrëveshje Mirëkuptimi si parakusht për shkëmbimin e informacionit, mirëpo ka arritur 16 Marrëveshje Mirëkuptimi, përfshirë rishikimet dhe ripërtëritjet e Marrëveshjeve të Mirëkuptimit me disa vende, duke shfaqur kështu përpjekje shtesë për t'u angazhuar në shkëmbim të informacionit me partnerët rajonalë më të rëndësishëm.

Tabela 37: MM të nënshkruara nga NjIF-i

Juridiksioni	Viti
Shqipëria (DPPPP)	2009
"Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë" (MLPD)	2009
Mali i Zi (APML)	2009
San Marino (FIA)	2009
Sllovenia (OMLP)	2009
Kroacia (AMLO)	2010
Turqia (MASAK)	2012
Republika Çeke (FAU-CR)	2012
Finlanda (FIU)	2013
Polonia (GIIF)	2014
Shqipëria (DPPPP) – ripërtëritje	2014
Hungaria (HFIU)	2015
"Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë" (FIO) – ripërtëritje	2015
Gana (FIC)	2015
Lituania (FNNT)	2016
Jordania (AMLU)	2018

558. Shkëmbimi ndërkombëtar i informacioneve të NjIF-it rregullohet edhe nga tre PSO të brendshme për përdorimin e sistemit goAML, shkëmbimin ndërkombëtar të informacionit dhe funksionin e inteligjencës dhe analizës së NjIF-it. Nuk ka rregulla të rrepta për prioritizimin të përfshira në këto PSO, por ekziston një praktikë e krijuar nga NjIF-i që merr parasysh shkallën e rrezikut që përdoret për funksionin analitik të njësisë. Kërkesat e pranuar prioritizohen në varësi të rastit dhe llojit të kërkesës dhe në përputhje me parimet për shkëmbimin e informacionit. Kriteret shtesë janë hartuar në kuadër të dy PSO-ve të reja të propozuara.

Tabela 38: Shkëmbimi ndërkombëtar i informacionit nga NjIF-i

Bashkëpunimi ndërkombëtar	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	Gjithsej
Kërkesa ndërkombëtare të pranuar nga NjIF-i	10	10	7	19	18	16	33	113
Kërkesa ndërkombëtare të ekzekutuara nga NjIF-i	11	13	6	20	18	14	22	104
Kërkesa ndërkombëtare të refuzuara nga NjIF-i	0	0	0	0	0	0	0	0
Ndarje spontane e informacionit të pranuar nga NjIF-i	0	0	2	1	1	1	7	12
Mesatarja e ditëve për t'iu përgjigjur kërkesave ndërkombëtare nga NjIF-i	49	33	26	29	23	16	13	
Arsyet e zbatuara për refuzim	0	0	0	0	0	0	0	0
Kërkesat e dërguara nga NjIF-i	/	/	/	25	18	13	37	93
Ndarje spontane e informacionit të dërguar nga NjIF-i	3	0	3	6	8	11	5	36
GJITHSEJ (kërkesat dhe informacioni dalës)	/	0	3	31	26	24	42	129

559. Deri më tani, asnjë kërkesë ndërkombëtare nuk është refuzuar. Mesatarja e ditëve për përgjigjet ndaj kërkesave ndërkombëtare ka rënë ndjeshëm në vitin 2017, që gjë konsiderohet si përparim në adresimin e kërkesave për shkëmbim ndërkombëtar të informacionit. Për këtë qëllim, NjIF-i i kushton vëmendje të veçantë kërkesave ndërkombëtare dhe bën përpjekje për të ekzekutuar në mënyrë efikase kërkesat ndërkombëtare në kohën e duhur dhe pa vonesa të paarsyeshme. Në këtë kontekst, koha mesatare e reagimit në vitin 2017 ishte 13 ditë edhe pse ishte relativisht më e gjatë në vitet e mëparshme. NjIF-i ka hartuar dhe përcaktuar afatet e mëposhtme për t'iu përgjigjur kërkesave:

Tabela 39:

Llojet e përgjigjeve	Përgjigja brenda
Negative (nuk u gjet informacion)	2 ditëve
Informacioni në dispozicion nga databaza e NjIF-it	5 ditëve
Informacioni jashtëm aty ku NjIF-i ka qasje dhe që është në dispozicion të publikut (burime të hapura)	5 ditëve
Informacion jashtë NjIF-it ku nuk ka qasje direkte	30 ditëve
Përgjigje ndaj kërkesave urgjente	Sa më parë që të jetë e mundur

560. Vlerësuesit nuk kanë shqetësime sa i përket aftësisë së NjIF-it për të siguruar informacionin në dispozicion në kohën e duhur dhe në bazë të prioritetit që i është dhënë shkëmbimit të informacionit. Qasja e tërthortë në disa lloje të caktuara të informacionit dhe mangësitë në mirëmbajtjen e disa databazave të caktuara siç është shënuar në kuadër të RM 6 mund të ketë një efekt të dëmshëm mbi aftësinë e NjIF-it që të ofrojë bashkëpunim

gjithëpërfshirës dhe me kohë në disa rrethana dhe sidomos kur duhet përdorur informacion nga burimet e jashtme.

561. Deri në vitin 2016, shumica e kërkesave për shkëmbim ndërkombëtar të informacionit midis NjIF-eve ishin kërkesa nga vendet e rajonit, ndërsa në vitin 2017 rreth 52% e kërkesave vinin nga vendet e BE-së. Rreth 24% ishin nga vendet e rajonit, ndërkohë që përqindja e njëjtë ishte nga vendet e tjera jashtë kontinentit. Ky trend vlerësohet në përputhje me profilin e rrezikut të Kosovës, diasporën e saj të konsiderueshme dhe fluksin e jashtëm të konsiderueshëm.

562. Legjislacioni në fushën e PPP/LFT-së i jep NjIF-it autoritetin që të shkëmbejë informacion në mënyrë spontane me çdo homolog të huaj që zbaton funksione të ngjashme dhe i nënshtrohet detyrimeve të ngjashme për të ruajtur konfidencialitetin, pavarësisht nga natyra e homologut dhe brenda kornizës ligjore vendore të secilës palë. Prandaj, është e diskutueshme nëse NjIF-i ka të drejtë për bashkëpunim të drejtpërdrejtë me johomologë. NjIF-i do të angazhohej në mënyrë aktive në bashkëpunimin diagonal në përputhje me parimet e Grupit Egmont dhe do të sigurote konfidencialitetin e informacionit të shkëmbyer duke përdorur kanalën NjIF me NjIF.

563. Me qëllim të ofrimit të një spektri të gjerë të bashkëpunimit ndërkombëtar, ndërmjet viteve 2013 dhe 2017, NjIF-i ka ndarë me homologët e huaj gjithsej 48 raporte spontane të inteligjencës që janë shpërndarë dhe pranuar për qëllime të analizimit dhe hetimit të mëtejshëm. Kjo tregon një trend gjithnjë e në rritje të shpërndarjes së raporteve të tilla të inteligjencës.

564. Përveç shkëmbimit të kërkesave ndërkombëtare, për qëllime të parandalimit dhe luftimit të pastrimit të parave, NjIF-i ka vazhduar aktivitetin e shpërndarjes së raporteve spontane, duke dërguar 11 raporte spontane në vitin 2016 dhe 5 në vitin 2017, raporte këto për dyshimet e gjetura gjatë analizimit të rasteve të bazuara në informacionin e siguruar nga homologët e huaj. Informacioni i shkëmbyer ndërmjet homologëve nuk përdoret si provë, por vetëm në mënyrë të autorizuar dhe për qëllime të inteligjencës. Po ashtu, vihet re se për periudhën 2014-2017 NjIF-i, në bazë të shkëmbimit ndërkombëtar të informacionit, ka ngrirë fonde në vlerë prej rreth një të tretës së të gjitha fondeve të ngrira brenda kompetencës së vet.

Shembull – Identifikimi i pasurive në bazë të bashkëpunimit të NjIF-it pas kërkesës për NNJ

Pas pranimit të një RTD-je nga një prej subjekteve raportuese, NjIF-i ka analizuar dhe identifikuar se përmbajtja e raportit përfshin edhe shtetas të huaj nga vendi B. Të dhënat nga burimet e hapura tregojnë përfshirjen e tyre në aktivitete të paligjshme në vendin e origjinës. NjIF-i ka paraqitur menjëherë kërkesë për informacion në vendin B dhe në bazë të përgjigjes së tyre dhe analizave të tjera të kryera, NjIF-i ka lëshuar urdhër për të ngrirë transaksionet në një shumë të konsiderueshme prej rreth një milion euro. Në këtë rast, NjIF-i ka dërguar raport të detajuar spontan në vendin B dhe njëkohësisht e ka njoftuar Prokurorin Special për ngrirjen e fondeve.

Ndërkohë, lëvizjet e fondeve u identifikuan në më shumë se 15 vende të tjera ku NjIF-i dërgoi kërkesë dhe nga shumica e këtyre vendeve mori përgjigje se ka transaksione të dyshimta edhe në ato vende.

Gjithashtu, pas një kohe të shkurtër, NjIF-i dhe autoritetet e tjera kompetente pranuan nga vendi B kërkesë për ndihmë të ndërsjellë juridike në këtë fushë dhe për masa të sekuestrimit.

Shembull – Identifikimi i pasurive në bazë të bashkëpunimit të NjIF-it pas kërkesës për NNJ

NjIF-i ka pranuar një raport spontan nga një prej NjIF-eve rajonale në lidhje me një grup personash të cilët po kryenin transferta të dyshimta në para të gatshme drejt vendit A. Shumë shpejt, NjIF-i bëri një analizë të të dhënave financiare dhe e dërgoi raportin për hetime të mëtejshme në njësinë përkatëse policore. Ndërkohë, kjo njësi tashmë po e hetonte këtë rast të kimit të organizuar dhe veprat e tjera të ndërlidhura. Raporti i NjIF-it dhe informacioni spontan nga vendi A ngritën edhe më shumë dyshime për përfshirje në pastrimin e parave, përveç shkeljeve të tjera.

Hetuesit e policisë dhe analistët e NjIF-it mbajtën kontakte të vazhdueshme dhe bënë përpjekje maksimale për të gjurmuar dhe identifikuar të gjitha pasuritë që eventualisht mund të ishin gjeneruar nga veprimtaria kriminale, duke përfshirë pasuri jashtë vendit. Pasuritë në vlerë deri në 4 milionë euro u sekuestruan.

Eventualisht, pas hetimit dhe gjykimit me sukses, personat e përfshirë në këtë rast u dënuan me burgim dhe gjobë.

Shembull – Ngrirja e pasurive në një vend tjetër me kërkesë të NjIF-it

NjIF-i pranoi informacion nga njësinë përkatëse policore se një kompani vendore u mashtrua nga një shtetas i vendit B. Ky mashtrim dyshohej se lidhej me krimin kibernetik. Pas analizimit të të dhënave dhe hulumtimeve në burime të hapura, u konstatua se personi që kinse ishte i përfshirë në mashtrim ishte i përfshirë në disa aktivitete kriminale në vendin B.

Prandaj, me qëllim të parandalimit të një veprë penale, NjIF-i dërgoi kërkesë urgjente në vendin B, me qëllim të ngrirjes së transaksionit dhe për ta parandaluar personin X që të tërhiqte fonde në vendin B.

Kërkesa rezultoi e suksesshme dhe fondet u kthyen në vendin e origjinës dhe kështu u parandalua krimi kibernetik.

565. NjIF-i tregon kujdes të konsiderueshëm për t'u siguruar për konfidencialitetin dhe sigurinë e informacionit që ruan dhe për shkëmbimet në kuadër të fushëveprimit të vet.

Agjencitë e zbatimit të ligjit

566. Njësia Bashkërenduese Ndërkombëtare për Zbatimin e Ligjit (ILECU) është njësi brenda Ministrisë së Punëve të Brendshme të Kosovës që ka përgjegjësi në ofrimin e një game të gjerë shkëmbimesh operative të informacionit, edhe në emër të DK-së dhe ATK-së në lidhje me aktivitetet e tyre hetimore. Dokumenti themelues³² i ILECU-t përcakton afatet kohore të sakta për ofrimin e informacionit nga homologët në Kosovë, përfshirë në raste shumë urgjente dhënien e menjëhershme të informacionit, brenda 24 orëve në raste urgjente dhe brenda tri (3) ditëve të punës në rastet prioritare. Afati kohor për rastet normale është brenda shtatë (7) ditëve të punës.

567. Pavarësisht aftësisë së AZL-ve që të përdorin të gjithë pushtetin e tyre për të siguruar informacion, për shkak të kufizimeve në marrjen e të dhënave financiare, kompetencat e NjIF-it përdoren kryesisht në këtë aspekt.

568. Deri më tani, Kosova ka nënshkruar 74 marrëveshje bashkëpunimi policor me 18 vende të ndryshme dhe 5 organizata (FRONTEX, CEPOL, OLAF, SEEFEG dhe TSC). Nga këto 74 marrëveshje, 27 mbulojnë bashkëpunimin e përgjithshëm policor, 28 mbulojnë bashkëpunimin ndërkufitar, 9 në aspekt operativ dhe 10 marrëveshje ndërmjet Policisë së Kosovës dhe EULEX-it. Gjithashtu, sa i përket vendeve me të cilat nuk ka marrëveshje bashkëpunimi, zbatohet

³² MM për Bashkërendim dhe Mbështetje për ILECU-n e vitit 2011.

parimi i reciprocitetit si në aspekt të shkëmbimit të informacionit dhe procedurave për ndihmë juridike, ashtu edhe në aspekt të ekstradimeve.

Tabela 40:

Bashkëpunimi ndërkombëtar	2014		2015		2016		2017	
	PP	FT	PP	FT	PP	FT	PP	FT
Kërkesa hyrëse								
Kërkesa ndërkombëtare të pranuar nga autoritetet e zbatimit të ligjit lidhur me PP-në	4		1		10		9	
Kërkesa ndërkombëtare të ekzekutuara	4		1				3	

569. PK-ja gjithashtu merr pjesë në ekipe të përbashkëta hetimore dhe janë dhënë shembuj për nisma të tilla me hetuesit zviceranë, si dhe me Belgjikën dhe Francën, që kanë pasur për qëllim identifikimin e pasurive në Kosovë që janë me origjinë kriminale.

570. Nuk është siguruar asnjë informacion lidhur me kërkesat e dërguara nga AZL të Kosovës në lidhje me PP-në. Sipas autoriteteve, në vitin 2017 ILECU i Policisë së Kosovës ka trajtuar 136 raste (kërkesa) të krimeve ekonomike dhe financiare nga gjithsej 3.318 raste të reja që kishin të bënin me bashkëpunimin policor ndërkombëtar. Nga këto statistika nuk mund të nxirret asnjë informacion i rëndësishëm për qëllime të PPP/LFT-së. Vlerësuesit e konsiderojnë këtë si një çështje me interes madhor dhe pengesë për të arritur në përfundime për efektivitetin e përdorimit të kanalit të ILECU-t me qëllim të ndjekjes së rasteve të PP-së. Pavarësisht disa shembujve të përmendur në lidhje me përdorimin e shkëmbimit të zbatimit të ligjit, vlerësuesit nuk janë në gjendje ta marrin këtë si të mjaftueshme për të demonstruar përdorimin e duhur të këtij kanali dhe ndihmesën e tij në efektivitetin e sistemit të PPP/LFT-së në Kosovë.

571. Dogana e Kosovës shkëmben informacion në pajtim me 12 marrëveshjet ndërkombëtare për bashkëpunimin e ndërsjellë në çështje doganore me vende të tjera. Këtu hyjnë Shqipëria, Finlanda, Italia, Turqia, Polonia, Sllovenia, Hungaria, "Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë", Mali i Zi, Franca, Austria dhe Mbretëria e Bashkuar. Përveç kësaj, shkëmbimi i informacionit bëhet edhe përmes ILECU-t. DK-ja ka pranuar në vitet 2016 dhe 2017 nga një kërkesë për secilin vit lidhur me PP-në (nga gjithsej 74 dhe 61 kërkesa respektivisht) dhe ka siguruar informacionin brenda 30 ditësh. Në vitin 2017 ka pasur një kërkesë dalëse për informacion.

572. ATK-ja bashkëpunon në bazë të MM-ve për bashkëpunim për shmangien e taksimit të dyfishtë. Statistikat janë paraqitur më poshtë. Sipas autoriteteve, duket se ATK-ja ka ndërmarrë një nivel të konsiderueshëm të bashkëpunimit lidhur me PP-në, edhe pse autoritetet nuk kanë paraqitur ndonjë rast specifik për të vlerësuar më tej këtë bashkëpunim. Ekipi i vlerësimit kupton se në bazë të shembujve të dhënë, ky bashkëpunim ka të bëjë rreptësisht me çështje tatimore, sidomos shmangien nga tatimi dhe jo me PP-në në vetvete.

Tabela 41:

Bashkëpunimi ndërkombëtar nga ATK-ja	2014		2015		2016		2017	
	PP	FT	PP	FT	PP	FT	PP	FT
Kërkesa hyrëse								
Kërkesa ndërkombëtare të pranuar nga autoritetet tatimore lidhur me PP-në	6		7		4		4	
Kërkesa ndërkombëtare të ekzekutuara	6		7		4		4	
Kërkesa ndërkombëtare të refuzuara	0		0		0		0	
GJITHSEJ	12	0	14	0	8	0	8	
Mesatarja e kohës së ekzekutimit (në ditë)	11		6		8		8	
Kërkesat dalëse								
Kërkesat e dërguara nga autoritetet tatimore lidhur me PPP/LFT-në në veçanti	6		3		2		4	
Numri i kërkesave të dërguara dhe	6		3		2		4	

Bashkëpunimi ndërkombëtar nga ATK-ja	2014		2015		2016		2017	
	PP	FT	PP	FT	PP	FT	PP	FT
Kërkesa hyrëse								
të ekzekutuara nga autoritetet e huaja								
Numri i kërkesave të dërguara dhe të refuzuara nga autoritetet e huaja	0		0		0		0	
Mesatarja e kohës së ekzekutimit (ditë kalendarike)	33		114		65		71	
GJITHSEJ	12	0	6	0	4	0	8	

573. BQK-ja ka diskutuar me ekipin e vlerësimit shkëmbimin e informacionit për qëllime mbikëqyrëse në këndvështrimin e PP-së dhe janë përmendur disa raste veprimesh të ndërmarra në lidhje me refuzimin e regjistrimit të subjekteve. Në të njëjtën kohë, në mungesë të statistikave të sakta dhe të përshkrimit të rasteve të shkëmbimit të informacionit, nuk është e mundur të arrihet në përfundim për shkëmbimin e mjaftueshëm të informacionit të ndërmarrë nga mbikëqyrësi.

Ofrimi i informacionit dhe përgjigja ndaj kërkesave për pronësi bazë dhe përfituese të personave dhe marrëveshjeve juridike

574. Autoritetet e Kosovës në mënyrë aktive shkëmbejnë informacion ku përfshihet edhe nevoja për të identifikuar pronësinë dhe kontrollin e personave juridikë. Në Kosovë nuk njihen dhe nuk janë regjistruar marrëveshje juridike që do të përbënin pengesa të konsiderueshme për identifikimin e personave kontrollues.

575. Mangësitë e përgjithshme të identifikuar në lidhje me regjistrin e biznesit në Kosovë do të zbatoheshin edhe në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar dhe të aftësisë së autoriteteve të Kosovës për të siguruar informacion të saktë dhe me kohë. Nuk ka mekanizma (regjistri i pronësisë përfituese, regjistri i llogarive) që do të mundësonte shkëmbimin e identifikimit të shpejtë të pronësisë përfituese, aq më tepër kur Regjistri i Bizneseve përmban të dhëna të pasakta ose ka mungesa në informacione. Mangësitë në lidhje me identifikimin e pronësisë përfituese nga subjektet raportuese përveç bankave do të zbatoheshin gjithashtu në këtë rrethanë.

576. Shkëmbimi i informacionit të NjIF-it, edhe pse me kohë dhe efikas, do të kërkonte kohë shtesë për qasje të tërthortë në informacionin përkatës. Vlerësuesit kanë shqetësime sa i përket mundësisë së AZL-ve që ta sigurojnë këtë informacion duke përdorur kompetencat e tyre, kur ky informacion nuk është lehtësisht në dispozicion në regjistrin e biznesit për shkak të qasjes së kufizuar në të dhënat financiare jashtë kornizës së një hetimi formal.

Përfundimi i përgjithshëm për Rezultatit e Menjëhershëm 2

577. Edhe pse MD-ja bën përpjekje të konsiderueshme për të bashkërenduar NNJ-në dhe kërkesat për ekstradim në mënyrë efektive, kompleksiteti i mekanizmit në fazat të tij të shkallëzuara të mëtejshme është i dëmshëm me raste për afatshmërinë dhe efikasitetin e bashkëpunimit, sidomos në lidhje me kërkesat për ekstradim.

578. Situata ndikohet negativisht nga mungesa e afateve të rrepta për ekzekutimin e kërkesave në secilën fazë. Për më tepër, pavarësisht përdorimit të një sistemi të avancuar të menaxhimit të rasteve nga autoriteti qendror në Ministrinë e Drejtësisë, asnjë sistem i tillë nuk zbatohet në Prokurori. Deri në vitin 2017 nuk është demonstruar ndonjë ofrim i afatshëm i ndihmës juridike në çështjet penale. Disa ndryshime të ndërmarra në vitin 2017 duket se i kanë kontribuar afatshmërisë dhe bashkëpunimit të drejtpërdrejtë ndërmjet autoriteteve dhe kjo ka pasur ndikim pozitiv të bashkëpunimi.

579. Autoritetet e Kosovës nuk kanë demonstruar se kanë kërkuar në mënyrë aktive bashkëpunim lidhur me çështjet e FT-së, pavarësisht nga përdorimi i gjerë i NNJ-së në rastet e ndërlidhura me terrorizmin. Për më tepër, kanali i NNJ-së nuk duket që të jetë përdorur mjaftueshëm në rastet e PP-së që kanë iniciuar autoritetet e Kosovës dhe vlerësuesit janë të shqetësuar nga mbështetja gjithnjë e më e vogël në këtë bashkëpunim. Janë dhënë disa shembuj lidhur me bashkëpunimin aktual që po zhvillohet për identifikimin e pasurive, por përsëri në rrethana shumë të kufizuara lidhur me sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive.

580. Bashkëpunimi i vënë në zbatim nga NjIF-i është aktiv dhe mbështetet si në kërkesa, ashtu edhe në informacion spontan. Sikurse dëshmohet nga të dhënat e ofruara për vlerësuesit, praktika e NjIF-it përkon me kërkesat e brendshme dhe praktikat më të mira ndërkombëtare. Rastet e paraqitura dhe diskutimet i kanë mundësuar ekipit të vlerësimit të arrijë në përfundime se informacioni i pranuar përdoret gjerësisht në funksionin analitik të NjIF-it; ai u ofrohet gjerësisht autoriteteve kompetente dhe përdoret në lidhje me PP-në, veprat e ndërlidhura penale të mundshme dhe qëllimet e FT-së.

581. Kompetencat për bashkëpunim policor dhe shkëmbim të informacionit përdoren gjerësisht, mirëpo për shkak të mungesës së statistikave specifike nuk është e qartë se deri në ç'masë ato janë të lidhura me rastet e PP-së dhe FT-së. Bashkëpunimi i autoriteteve doganore në Kosovë gjithashtu duket të jetë shumë aktiv edhe pse rrallëherë ndërlidhet specifikisht me PP-në. Nuk është demonstruar nëse BQK-ja do të angazhohet në mënyrë aktive në bashkëpunim ndërkombëtar sidomos për qëllime të PP-së dhe FT-së.

582. Kosova ka arritur nivel të moderuar të efektivitetit me Rezultatin e Menjëhershëm 2.

SHTOJCA E PËRPUTHSHMËRISË TEKNIKE

1. Kjo shtojcë ofron një analizë të hollësishme të nivelit të përputhshmërisë me 40 Rekomandimet e FATF-së në rendin e tyre numerik. Ajo nuk përfshin tekstin përshkrues mbi situatën ose rreziqet e vendit dhe kufizohet në analizën e kritereve teknike për çdo Rekomandim. Ajo duhet lexuar së bashku me Raportin e Vlerësimit të Ndërsjellë (RVN).

Rekomandimi 1 – Vlerësimi i rrezikut dhe zbatimi i qasjes së bazuar në rrezik

2. **Kriteri 1.1** (*Pjesërisht i përmbushur*) – Autoritetet e Kosovës ndërmorën një Vlerësim Kombëtar të Rrezikut (VKR) në vitin 2013, i cili u bashkërendua nga Njësia e Inteligjencës Financiare të Kosovës (NjIF) dhe u hartua me mbështetjen e një Grupi Punues për VKR-në. Përveç VKR-së, janë kryer vlerësime sektoriale për të vlerësuar rreziqet e PP-së në sektorin e ndërtimit, sektorin e lojërave të fatit dhe për organizatat jofitimprurëse. Shqyrtime mbi shtrirjen e ekonomisë joformale në Kosovë po ashtu kryhen në mënyrë periodike, e cila ka një marrëdhënie të tërthortë por të rëndësishme me vlerësimin e rrezikut të PP-së. Autoritetet e Kosovës gjithashtu kanë bërë të ditur se puna e vazhdueshme e vlerësimit të rrezikut kryhet në baza të vazhdueshme nga Dogana e Kosovës, përkatësisht Njësia e Përbashkët për Inteligjencë, Analizë të Rrezikut dhe Kërcënimeve dhe nga Policia e Kosovës në bashkëpunim me Njësinë e Inteligjencës Financiare.
3. Vlerësimi i rrezikut ka mangësi të mëdha metodologjike, në nivelin e VKR-së, vlerësimeve sektoriale, përfshirë ngatërrimin e kërcënimeve, dobësive dhe pasojave. Procesi i SOCTA-s dhe mekanizmi operativ nuk i kompensojnë tërësisht këto mangësi. Për më tepër, rreziqet e PP/FT-së nuk janë identifikuar në pjesën më të madhe.
4. **Kriteri 1.2** (*Kryesisht i përmbushur*) – VKR-ja u krye në bazë të një neni specifik në Ligjin për PPP/LFT-në (neni 27) dhe Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Financave (MF) nr. 04/2013 që detajon procesin dhe fushëveprimin e VKR-së, si dhe mekanizmat e ndërlidhur për menaxhimin e rrezikut. Sipas këtij udhëzimi, fushëveprimi dhe kriteret e VKR-së janë përcaktuar nga MF-ja, e cila gjithashtu merr vendimin për të filluar procesin e VKR-së. Sipas të njëjtit Udhëzim, vetë VKR-ja kryhet nga NjIF-i, ndërsa agjencitë e tjera dhe subjektet raportuese janë të detyruara ta mbështesin atë në këtë punë. Për ushtrimin e VKR-së së vitit 2013, Grupi i Punës përbëhej nga një varg agjencish qeveritare, duke përfshirë por pa u kufizuar në Bankën Qendrore, Autoritetin Tatimor, Policinë, Këshillin Prokurorial, Doganën, si dhe aktorët e jashtëm, si Thesari amerikan dhe një projekt i financuar nga BE-ja për luftimin e krimit financiar. Procesi i VKR-së po ashtu përfshinte subjekte të sektorit privat. Një Vlerësim i Kërcënimit të Krimit të Rëndë dhe atij të Organizuar është kryer gjithashtu, i cili përmban disa elemente të analizës së rrezikut për PP-në, megjithatë nuk është krijuar asnjë bashkërendim ndërmjet proceseve të SOCTA-s dhe VKR-së. Kjo e çon ekipin e vlerësimit të përfundojë se ndërsa është bërë një përcaktim, ai nuk ka funksionin e plotë që të bashkërendojë veprimet për të vlerësuar rreziqet.
5. **Kriteri 1.3** (*Kryesisht i përmbushur*) – Sipas nenit 18 të Ligjit për PPP/LFT-në VKR-ja duhet të kryhet çdo tri vite, edhe pse sipas një Rregulloreje paraprake të NjIF-it, kërkesa ka qenë e përcaktuar për çdo 5 vite. Deri më tani, VKR-ja e parë dhe e vetme është kryer në vitin 2013. Autoritetet e Kosovës kanë ndërmarrë vlerësime sektoriale të rrezikut që nga VKR-ja e fundit dhe kanë njoftuar se planifikojnë të ndërmarrin një VKR të dytë në vitin 2018, gjë që do të thotë se hendeku midis VKR-ve do të arrijë 5 vjet. Një afat kohor prej 5 vitesh duket të jetë tepër i gjatë duke pasur parasysh rrezikun në kontekstin e Kosovës.
6. **Kriteri 1.4** (*Kryesisht i përmbushur*) – Mekanizmi i shpërndarjes për VKR-në vendoset nga Qeveria, e cila pranon raportin e VKR-së për miratim nga MF-ja me rekomandime për shpërndarje. VKR-ja fillimisht ishte klasifikuar dhe u ishte shpërndarë vetëm autoriteteve kompetente. Në vitin 2016, autoritetet e Kosovës e kanë shpërndarë VKR-në te subjektet e sektorit privat në sistemin e NjIF-it (goAML), megjithatë kjo nuk përfshinte një numër të madh të BPCJF-ve. Kohëzgjatja ndërmjet miratimit të raportit dhe shpërndarjes te sektori privat vlerësohet të jetë e gjatë pa arsye.
7. **Kriteri 1.5** (*Kryesisht i përmbushur*) – Raporti Kombëtar i Vlerësimit të Rrezikut ka shërbyer si një nga dokumentet bazë për zhvillimin e Strategjisë Kombëtare të Kosovës për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Joformale, Pastrimit të Parave, Financimit të

Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2014-2018 dhe Planit të Veprimit për të njëjtën periudhë. Strategjia deklaron zbutjen e rrezikut si prioritet në zhvillimin e kornizës së politikave të PPP/LFT-së, dhe është konsideruar nga vetë autoritetet e Kosovës për të qenë një mjet i menaxhimit të rrezikut të PP/FT-së. Për më tepër, autoritetet e Kosovës kanë informuar se zbatimi i Strategjisë është integruar në vendimmarrje në aspektin e buxhetit dhe planeve të performancës së ministrive dhe institucioneve publike përgjegjëse, megjithëse dokumentet e vetme që tregojnë këtë janë ofruar nga NjIF-i dhe BQK-ja. Qeveria shqyrton përparimin e arritur kundrejt treguesve të performancës së Strategjisë çdo 6 muaj për të parë nëse nevojiten përshtatje në masat e zbutjes së rreziqeve. Për më tepër, rishikimet e fundvitit gjithashtu kryhen nga Qeveria për të përcaktuar nëse vlerësimi i rrezikut dhe fushëveprimi i menaxhimit janë ende të përshtatshme. Një varg agjencish u kontribuojnë këtyre shqyrtimeve. Nuk duket se këto veprime rishikimi ripërkthehen në rindarje periodike të buxhetit.

8. Një Plan i Performancës dhe Burimeve u zhvillua për Njësinë e Inteligjencës Financiare të Kosovës për periudhën 2015-2017 dhe një Plan i Ri i Performancës 2018-2020 u hartua në vitin 2018. Autoritetet e Kosovës informojnë se këto plane janë të bazuara dhe marrin parasysh prioritetet e VKR-së. Politika të përshtatura sipas rrezikut në fushën e operacioneve të zbatimit të ligjit duket se janë ngritur nga Dogana e Kosovës dhe Administrata Tatimore e Kosovës (ATK); si dhe në fushën e mbikëqyrjes, në një masë të kufizuar, nga BQK-ja dhe NjIF-i.
9. **Kriteri 1.6** (*Nuk aplikohet*) – Në përputhje me nenin 14, nënparagrafi 1.11.3 të Ligjit për PPP/LFT-në, NjIF-i mund të nxjerrë akte nënligjore me qëllim që të përjashtojë disa subjekte raportuese nga detyrimet për të raportuar. Udhëzimi Administrativ i NjIF-it nr. 1/2017 parasheh përjashtime të caktuara për raportimin e RTG-ve/pragut (p.sh. pagesat e detyrimeve komunale, pagesat e taksave), të cilat janë jashtë kërkesave të detyrueshme të raportimit të Rekomandimeve të FATF-së.
10. **Kriteri 1.7** (*Nuk është përmbushur*) – Nuk ekziston asnjë mekanizëm legjislativ ose rregullator, ku subjektet raportuese janë të detyruara të marrin parasysh rreziqet e larta të PP/FT-së të identifikuar nga autoritetet e Kosovës dhe as t'i përfshijnë ato në vlerësimet e tyre të rrezikut. Institucionet financiare janë të lira të përcaktojnë vetë rreziqe të larta të PP/FT-së, në përputhje me dispozitat e nenit 18 të Ligjit për PPP/LFT-në.
11. **Kriteri 1.8** (*Pjesërisht i përmbushur*) – Masat e thjeshtuara për zbatimin e Rekomandimeve të FATF-së nuk janë parashikuar nga legjislacioni i Kosovës, përveç kujdesit të duhur të thjeshtuar (shih kriterin 1.12). Në të njëjtën kohë, KDK-ja e thjeshtuar nuk është kalibruar për ndonjë proces identifikimi të rrezikut të ndërmarrë nga autoritetet.
12. **Kriteri 1.9** (*Pjesërisht i përmbushur*) – IF-të dhe BPCJF-të u nënshtrohen mbikëqyrjes dhe sanksioneve (neni 17.2.9 dhe neni 18 i Ligjit për PPP/LFT-në) për zbatimin e kërkesave që lidhen me vlerësimin e rrezikut dhe zbutjen e rreziqeve dhe mangësitë e identifikuar në këtë drejtim (shih rekomandimet 26, 28 dhe 35).
13. **Kriteri 1.10** (*Pjesërisht i përmbushur*) – IF-të dhe BPCJF-të duhet të përcaktojnë nivelin e rrezikut ndaj të cilit janë të ekspozuara gjatë ushtrimit të biznesit të tyre nëpërmjet ofrimit të produkteve, shërbimeve, vendndodhjes së tyre gjeografike dhe mekanizmave e kanaleve të shpërndarjes (neni 18.2 i Ligjit për PPP/LFT-në).
 - a. Të gjitha subjekteve raportuese u kërkohet të paraqesin vlerësimet e tyre të rrezikut te NjIF-i, gjë që e bën kërkesën për dokumentimin e tyre të nënkuptuar.
 - b. Subjekteve raportuese nën mbikëqyrjen e BQK-së u kërkohet që në mënyrë të qartë të përcaktojnë nivelin e tyre të përgjithshëm të rrezikut/profilin e rrezikut për organizatën (neni 7 i Rregullores së BQK-së për PPP/LFT-në). Opsionet për zbutjen e rrezikut nga subjektet raportuese nuk ofrohen në mënyrë të qartë, ku shembulli i vetëm konkret është kujdesi i duhur i shtuar.
 - c. Subjektet raportuese duhet të mbajnë vlerësime të përditësuara, vetëm kur ato përcaktojnë se rreziku i PP/FT-së është i lartë (neni 22.1 i Ligjit për PPP/LFT-në). Duket se nuk ka asnjë detyrim për të përditësuar vlerësimet e rrezikut në rrethana të tjera.
 - d. Ekziston një mekanizëm i paraparë në nenin 18.2 të Ligjit për PPP/LFT-në, i cili kërkon që subjektet raportuese të paraqesin vlerësimet e tyre të rrezikut te NjIF-i dhe Banka Qendrore.

14. **Kriteri 1.11** (*Pjesërisht i përmbushur*) – Subjekteve raportuese u kërkohet të nxjerrin politika dhe procedura të shkruara për të parandaluar dhe zbuluar PP/FT-në (neni 17.2). Gama e temave që duhet të adresohen në mënyrë të qartë në këto procedura sipas Ligjit për PPP/LFT-në nuk përfshin qartësisht zbutjen e rreziqeve; po ashtu nuk kërkohet që këto politika dhe procedura të miratohen nga drejtuesi i lartë i organizatës. Përjashtim bëjnë subjektet raportuese që i raportojnë BQK-së:
- Për të gjitha subjektet raportuese po ashtu nuk ka asnjë kërkesë për të monitoruar zbatimin e kontrolleve të orientuara nga rreziku dhe për t'i rritur ato nëse është e nevojshme, përveç përditësimit të listës së treguesve të dyshimtë.
 - Në rastet kur identifikohen rreziqe të larta, institucionet financiare duhet të ndërmarrin kujdes të duhur të shtuar (neni 22.1 i Ligjit për PPP/LFT-në).
15. **Kriteri 1.12** (*Kryesisht i përmbushur*) – Kujdesi i duhur i thjeshtuar mund të zbatohet nga subjektet raportuese në pajtim me nenin 23 të Ligjit për PPP/LFT-në, në situata kur subjekti e ka identifikuar rrezikun të jetë i ulët dhe kjo është konfirmuar nga NjIF-i dhe mbikëqyrësit sektorialë, megjithëse në praktikë kjo nuk ka ndodhur kurrë.

Vlerësimi dhe përfundimi

16. Kosova ka realizuar një VKR, tri vlerësime sektoriale të rrezikut dhe një SOCTA; megjithatë në një nivel teknik dhe metodologjik rreziqet e PP/FT-së në Kosovë nuk janë identifikuar si duhet dhe funksioni i bashkërendimit të vlerësimit të rrezikut nuk është gjithëpërfshirës. Autoritetet e Kosovës nuk kanë siguruar shpërndarjen e duhur të raportit të VKR-së te sektori privat. Disa elemente të rishpërndarjes së burimeve të bazuara në rezultatet e VKR-së janë vënë në zbatim për NjIF-in dhe BQK-në por jo në mënyrë specifike për autoritetet e tjera. Masat e zbutjes së rrezikut janë integruar në Strategjinë për PPP/LFT-në, Planin e Veprimit, kornizën mbikëqyrëse (në një masë të kufizuar) dhe operacionet e zbatimit të ligjit. Nuk janë lejuar përjashtime nga kërkesat e FATF-së. Rreziqet e larta të identifikuar nga autoritetet e Kosovës nuk janë adresuar në nivelin e subjekteve raportuese dhe nuk lejohen masa të thjeshtuara përveç KDK-së të thjeshtuar. KDK-ja e thjeshtuar nuk është kalibruar për ndonjë proces identifikimi të rrezikut të ndërmarrë nga autoritetet. Vlerësimi i rrezikut dhe politikat e kontrollit të brendshëm për IF-të dhe BPCJF-të janë përcaktuar të kenë një numër mangësish.
17. **Kosova është pjesërisht në përputhje me Rekomandimin 1.**

Rekomandimi 2 – Bashkëpunimi dhe bashkërendimi kombëtar

18. **Kriteri 2.1** (*I përmbushur*) – Qeveria e Kosovës miratoi një Strategji Kombëtare dhe Planin Veprues pesëvjeçar për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Joformale, Pastrimit të Parave, Financimit të Terrorizmit dhe Krimeve Financiare (2014-2018). Një plan veprimi që i bashkangjitet Strategjisë përshkruan aktivitete konkrete për arritjen e objektivave specifike dhe qëllimeve të zbatimit në Strategji, identifikon se cili institucion publik ka përgjegjësinë kryesore për zbatimin dhe raportimin, si dhe jep një afat dhe kostot e vlerësuara për zbatimin. Që të dy dokumentet përpilohen në bazë të VKR-së dhe duhet të rishikohen rregullisht. Qeveria shqyrton përparimin e arritur kundrejt treguesve të performancës së Strategjisë çdo 6 muaj dhe përsëri në baza vjetore. Po ashtu, është ndërtuar një proces monitorimi për të rishikuar dhe vlerësuar zbatimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit (shih gjithashtu kriterin 1.5). Përveç kësaj, në shtator 2017 Kosova miratoi Strategjinë Kombëtare dhe Planin e Veprimit kundër Terrorizmit (2018-2022), si dhe strategjitë në fushën e luftimit të krimit të organizuar dhe menaxhimit të kufirit.
19. **Kriteri 2.2** (*I përmbushur*) – Qeveria e Kosovës është përgjegjëse për përcaktimin e politikave strategjike lidhur me PP/FT-në. Për këtë qëllim, Kosova ka themeluar një Grup Punues Qeveritar (GPQ) i cili është përgjegjës për hartimin, rishikimin, miratimin, zbatimin dhe monitorimin e Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit 2014-2018 dhe mbledhet të paktën dy herë në vit. Njësia e Inteligjencës Financiare e Kosovës (NjIF) nën Ministrinë e Financave është kompetente për të përcaktuar politikat shtetërore për PPP/LFT-në (në përputhje me Ligjin nr. 05/L-096 për PPP/LFT-në (2016)). Bordi mbikëqyrës i NjIF-it kryen detyra bashkërenduese për politikën e nivelit të lartë të PPP/LFT-së në bashkëpunim me institucionet e tjera dhe palët e interesuara, dhe mbledhet të paktën dy herë në vit. Ai gjithashtu është përgjegjës për bashkërendimin dhe bashkëpunimin në lidhje me hartimin dhe zbatimin e strategjive të tjera të nivelit kombëtar.

20. **Kriteri 2.3** (*Pjesërisht i përmbushur*) – Në nivelin e politikave, bashkërendimi kryhet nga GPQ me pjesëmarrjen e Ministrit të Financave (kryesues), Ministrit të Drejtësisë, Ministrit të Punëve të Brendshme, Ministrit të Tregtisë dhe Industrisë, Ministrit të Punës dhe Mirëqenies Sociale, Drejtorit të Policisë së Kosovës, Drejtorit të Doganës së Kosovës, Drejtorit të Administratës Tatimore të Kosovës, Kryeprokurorit të Shtetit, Guvernatorit të Bankës Qendrore të Kosovës, Kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Drejtorit të Agjencisë Kosovare kundër Korrupsionit dhe Drejtorit të Njësisë së Inteligjencës Financiare të Kosovës. Më tej, GPQ po ashtu përfshin përfaqësues nga institucionet private dhe të sektorit të tretë në aktivitetet e veta. Mbështetës i GPQ-së është Sekretariati dhe Grupi Punues Teknik, të dy të kryesuar nga Ministria e Financave, ky i fundit vepron si pikë qendrore e institucioneve të përfaqësuara dhe mbledh informacionin e nevojshëm për monitorimin e zbatimit të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit. Përveç kësaj, sipas Ligjit për PPP/LFT-në, Bordi Mbikëqyrës i NjIF-it ka të drejtë të krijojë grupe punuese për të bashkërenduar aktivitetet në lidhje me PP/FT-në. Në janar 2014, u emërua një Koordinator Kombëtar për Luftimin e Krimit Ekonomik (KKLKE) me qëllim kryesor rritjen e bashkëpunimit ndërmjet të gjitha institucioneve përkatëse, veçanërisht në lidhje me promovimin e rritjes së efikasitetit të prokurorisë për të luftuar krimin ekonomik dhe rritjen e efektivitetit të masave të konfiskimit. Puna e Koordinatorit Kombëtar për Luftimin e Krimit Ekonomik mbikëqyret nga Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) dhe Këshilli Konsultativ i kryesuar nga Ministri i Drejtësisë. Koordinatorë të tjerë kombëtarë janë për çështjet kundër terrorizmit dhe të menaxhimit të kufirit në nivel të Ministrit të Brendshëm dhe Zëvendësministrit të Brendshëm. Nuk duket të ketë dëshmi megjithatë se bashkërendimi i politikave ndërmjet fushave të PPP/LFT-së, kundër terrorizmit dhe menaxhimit të kufirit është duke u zhvilluar.
21. Në nivelin operativ, autoritetet e Kosovës kanë miratuar një Marrëveshje gjithëpërfshirëse për Shkëmbimin e Informacionit, Vlerësimin e Rrezikut dhe Bashkërendimin ndërmjet Institucioneve dhe Agjencive të Zbatimit të Ligjit, e cila gjithashtu krijon disa grupe bashkërendimi për qëllime të luftimit dhe parandalimit të krimeve ekonomike dhe financiare, përfshirë Grupin e Nivelit Strategjik, Grupin e Nivelit Taktik dhe Grupin e Nivelit Analitik (Menaxhimi i Cilësisë). Përveç kësaj, për Doganën e Kosovës, bashkërendimi operativ bëhet në bazë të marrëveshjeve dypalëshe ndërmjet institucioneve përkatëse, me zyrtarët ndërlidhës për të lehtësuar shkëmbimin e informacionit në NjIF, Njësinë e Bashkëpunimit Ndërkombëtar për Zbatimin e Ligjit (ILECU) dhe Qendrën Kombëtare për Menaxhimin e Kufirit (QKMK). Ekzistojnë ende një sërë çështjesh të bashkërendimit operativ dhe shkëmbimit të informacionit midis autoriteteve të ndryshme (shih RM 1 dhe 6).
22. **Kriteri 2.4** (*Nuk është përmbushur*) – Ministria e Punëve të Jashtme është përgjegjëse për bashkërendimin e zbatimit të sanksioneve të lidhura me FP-në (në përputhje me Ligjin nr. 03/L-183 për Zbatimin e Sanksioneve Ndërkombëtare). Përveç kësaj, Kosova ka themeluar një Komision për kontrollin e tregtisë së mallrave strategjike (sipas Ligjit nr. 04/L-198 për Tregtinë e Mallrave Strategjike, që përfshin armët e shkatërrimit në masë sipas nenit 1(6)), i përbërë nga pesë anëtarë dhe zëvendësanëtarë, që përfaqësojnë: Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, Ministrinë e Punëve të Jashtme, Ministrinë e Forcës së Sigurisë, Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Doganën e Kosovës.
23. Plani i Veprimit (2014-2018) gjithashtu tregon se bashkërendimi i sanksioneve të ndërlidhura me FP-në ndërmerret nga Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave dhe Koordinatori Kombëtar për Luftimin e Krimit Ekonomik. Sidoqoftë, nuk është ofruar asnjë dokument tjetër mbështetës në lidhje me bashkërendimin e tillë për ekipin e vlerësimit.

Vlerësimi dhe përfundimi

24. Kosova ka krijuar një sistem të fuqishëm për hartimin dhe bashkërendimin e politikave të PPP/LFT-së nën kujdesin e Ministrisë së Financave dhe NjIF-it. Bashkërendimi i zbatimit të ligjit bëhet përmes mekanizmave ndër-institucionalë dhe me përfshirjen e Koordinatorit Kombëtar për Luftimin e Krimit Ekonomik. Në të njëjtën kohë, ka pak dëshmi të bashkërendimit me mekanizmat e ndërlidhur në fushën kundër terrorizmit dhe menaxhimit të integruar të kufirit. Nuk janë themeluar mekanizma bashkërendimi lidhur me FP-në.
25. **Kosova është kryesisht në përputhje me Rekomandimin 2.**

Rekomandimi 3 – Vepra e pastrimit të parave

26. Në Raportin e Vlerësimit për PPP/LFT-në të vitit 2014, Kosova u vlerësua si pjesërisht në përputhje me Rekomandimet e mëparshme 1 dhe 2 të FATF-së. Vlerësimi identifikoi një numër të mangësive, përfshirë faktin se vepra penale e manipulimit të tregut nuk mbulohej si një vepër penale kryesore e ndërlidhur me PP-në; rregullimin e papërshtatshëm të nivelit të kërkuar të provës për veprat e ndërlidhura penale; formulimin e paqartë dhe të papërshtatshëm të dispozitës që përcakton mbulimin e vetëpastrimit; harmonizimin e kërkuar ndërmjet Ligjit për PPP/LFT-në dhe Kodit Penal (KP) në kuptim të konceptit dhe terminologjisë në lidhje me veprat ndihmëse; përjashtimin e shmangies nga tatimi nga sfera e veprave potenciale kryesore të ndërlidhura me PP-në; dhe vetëpastrimin që nuk konsiderohet të jetë i ndëshkueshëm së bashku me veprën penale kryesore. Pasiguria serioze në legjislacion është vërejtur në raportin e vitit 2014 në lidhje me bazat e përgjegjësive penale të personave juridikë, së bashku me dispozitat e paefektshme dhe sanksionet e buta ndaj personave juridikë për vepra penale (shkalla e ulët e dënimit) dhe nevojën për harmonizim në mes të Ligjit për PPP/LFT-në dhe KP apo Ligjit për Përgjegjësinë Penale të Personave Juridikë për Vepra Penale (Ligji për PPPJ) në lidhje me standardin e dijenisë së aplikueshme në rast të veprave të PP-së.
27. **Kriteri 3.1** (*I përmbushur*) – Vepra e PP-së pasqyron pjesën më të madhe të terminologjisë së veprës model të PP-së siç përcaktohet në paragrafin (1) të nenit 6 të Konventës së Palermos. Llojet kryesore të aktiviteteve të pastrimit të parave të përmendura në nënparagrafët (a/i), (a/ii) dhe (b/i) të paragrafit (1) të nenit 6 të Konventës së Palermos janë në fakt të trajtuara dhe të mbuluara në mënyrë të përshtatshme nga formulimi i ligjit.
28. Kodi Penal (neni 308) thekson se kryerja e veprës penale të pastrimit të parave dënohet sipas Ligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit. Neni 56 i Ligjit për PPP/LFT-në më tej përkufizon veprën e pastrimit të parave duke dhënë elementet e hollësishme të veprës. Përderisa legjislacioni penal për PPP-në i Kosovës tashmë ishte në përputhje të konsiderueshme me formulimin e Konventave të Vjenës dhe Palermos në lidhje me elementet kryesore të veprës penale, ky standard është ndjekur edhe më shumë nga miratimi i Ligjit të ri për PPP/LFT-në. Për më tepër, duket se Kosova ka trajtuar çështjet e ngritura në Raportin e Vlerësimit të vitit 2014 për PPP/LFT-në në lidhje me disa vepra penale të brendshme "shtesë" dhe përkufizimin e dyfishtë të pastrimit të parave.
29. **Kriteri 3.2** dhe **Kriteri 3.3** – (*Kryesisht të përmbushur*) – Një regjim për të gjitha krimet është miratuar në ligjet e Kosovës. Paragrafi 1.3 i nenit 2 të Ligjit për PPP/LFT-në, në fakt, e përcakton aktivitetin kriminal si "çdo lloj përfshirjeje kriminale në kryerjen e një vepre penale siç përcaktohet në bazë të legjislacionit në fuqi". Të ardhurat nga vepra penale (paragrafi 1.41) janë përkufizuar si "çdo pasuri e përfituar në mënyrë direkte apo indirekte nga vepra e ndërlidhur penale". Pastaj ligji vazhdon për të specifikuar se pasuria e fituar në mënyrë indirekte nga vepra e ndërlidhur penale përfshin pasurinë në të cilën më vonë është konvertuar, transformuar ose përzier çdo pasuri e përfituar në mënyrë direkte nga vepra e ndërlidhur penale si dhe të ardhurat, kapitali apo përfitimet e tjera ekonomike të realizuara nga pasuria e tillë në çfarëdo kohe të kryerjes së veprës penale (Vepra e ndërlidhur penale i referohet "çdo vepre penale e cila gjeneron të ardhura nga vepra penale" – neni 2, paragrafi 1.47). Për këtë arsye, të gjitha veprat penale të rënda duket se mbuloohen nga këto dispozita të përgjithshme në legjislacion, me përjashtim të manipulimit të tregut, i cili ende nuk është paraqitur si vepër penale që nga vlerësimi i fundit.
30. **Kriteri 3.4** (*I përmbushur*) – Vepra e PP-së shtrihet në çdo lloj pasurie, pavarësisht nga vlera, që përfaqëson në mënyrë direkte apo indirekte të ardhurat nga krimi, sipas përcaktimit të "të ardhurave nga vepra penale" në paragrafin 1.41 të nenit 2 të Ligjit për PPP/LFT-në, të përmendur në paragrafin më sipër. Prandaj ky kriter është përmbushur plotësisht.
31. **Kriteri 3.5** (*I përmbushur*) – Sipas Ligjit për PPP/LFT-në, një person nuk duhet të dënohet për një vepër të ndërlidhur penale kur provohet se pasuria është e ardhur nga vepra penale. Neni 56, paragrafët 3.1 dhe 3.2, përcaktojnë që personi mund të dënohet për vepër penale të pastrimit të parave madje edhe nëse nuk ka qenë asnjëherë i dënuar për vepër të ndërlidhur penale prej të cilës janë fituar të ardhurat nga krimi në veprën penale të pastrimit të parave. Paragrafi 2 i të njëjtit nen gjithashtu parasheh që të ardhurat nga vepra penale nuk ka nevojë të dëshmohen se vepra penale e pastrimit të parave ekziston, gjë që nënkupton se dënimi për veprën penale të ndërlidhur nuk është i nevojshëm.

32. **Kriteri 3.6** (*I përmbushur*) – Ky kriter trajtohet nëpërmjet dispozitave të nenit 56, paragrafi 3.3 të Ligjit për PPP/LFT-në. Kjo dispozitë u jep gjykatave të Kosovës juridiksion mbi një veprë penale të pastrimit të parave, edhe kur vepra penale e ndërlidhur nga e cila janë nxjerrë të ardhurat e krimit ka ndodhur jashtë vendit.
33. **Kriteri 3.7** (*I përmbushur*) – Ky kriter plotësohet përmes paragrafit 3.2 të nenit 56 i cili thekson se i njëjti person mund të ndiqet dhe të dënohet në procedura të veçanta për vepra penale të pastrimit të parave dhe të veprës së ndërlidhur penale prej të cilës është nxjerrë pasuria e fituar me anë të veprës penale të PP-së.
34. **Kriteri 3.8** (*I përmbushur*) – Nuk ka referim specifik në Ligjin për PPP/LFT-në për nxjerrë përfundimin e dashjes kriminale nga rrethana objektive faktike. Megjithatë, formulimi i paragrafit 1 të nenit 56, i cili u referohet kritereve objektive të “arsyes për të ditur”, duket se sugjeron se nëse ekzistojnë rrethana objektive që kryesi potencial i veprës ka qenë i vetëdijshëm për informata të mjaftueshme për të supozuar se ka pasur dijeni për të ardhurat e krimit, atëherë do të ekzistonte elementi i kërkuar mendor për veprën penale të PP-së. Neni 22 i Kodit Penal, i cili përcakton si parim të përgjithshëm se dijenia, dashja, pakujdesia ose qëllimi i kërkuar si element i veprës penale mund të nxirret nga rrethanat faktike, zbatohet gjithashtu.
35. **Kriteri 3.9** (*I përmbushur*) – Vepra penale e pastrimit të parave është e dënueshme me burgosje deri në dhjetë (10) vjet dhe me gjobë deri në tri (3) herë më të madhe në vlerë të pasurisë e cila është subjekt i veprës penale. Kjo është përshkruar në nenin 56, paragrafi 1 të Ligjit për PPP/LFT-në. Dënimi për veprën penale mund të shihet si proporcional me natyrën e rëndë të veprës dhe mjaftueshëm zbindës.
36. **Kriteri 3.10** (*Pjesërisht i përmbushur*) – Përgjegjësia penale për personat juridikë trajtohet në nenin 40, paragrafi 1 të Kodit Penal, ku thuhet se personi juridik është përgjegjës për veprën penale të personit përgjegjës fizik i cili ka kryer veprë penale duke vepruar në emër të personit juridik me qëllim të përfitimit të dobisë për atë person juridik. Ky formulim duket se përjashton rastet kur një person përgjegjës fizik nuk mund të identifikohet qartë, gjë që shpesh ndodh në strukturat e mëdha të korporatave, ku përgjegjësitë janë të shpërndara në mënyrë të konsiderueshme.
37. Përgjegjësia e personit juridik ekziston edhe nëse veprimet e personit juridik kanë qenë në kundërshtim me politikat e afarizmit ose me urdhrat e personit juridik. Neni 40 KP gjithashtu thekson se përgjegjësia e personit juridik bazohet në fajësinë e personit përgjegjës. Edhe pse kjo nuk përbën një shkelje të drejtpërdrejtë të standardeve të PPP/LFT-së, tendenca më e fundit në zbatimin e përgjegjësisë penale ndaj personave juridikë lejon zbatimin e të ashtuquajturës mbrojtje të pajtueshmërisë, e cila nuk do të ishte e mundur nëse do të mbahej formulimi aktual.
38. Duhet të theksohet se tekstet që parashohin përgjegjësinë e personave juridikë në Ligjin për PPP/LFT-në (neni 60) dhe KP ndryshojnë dhe kërkojnë harmonizim.
39. Për më tepër, ekziston një ligj i veçantë, Ligji nr. 04/L-030 për Përgjegjësinë e Personave Juridikë për Veprat Penale (Ligji për PPPJ) i cili rregullon përgjegjësinë e personave juridikë për veprat penale dhe përcakton sanksionet penale që mund të shqiptohen për personat juridikë dhe dispozitat speciale që e rregullojnë procedurën e zbatueshme kundër personit juridik. Ligji për PPPJ parasheh sanksione penale sipas nenit 9(1), i cili parashikon një gjobë jo më të vogël se 1.000 euro dhe jo më shumë se 100.000 euro.
40. Për më tepër, neni 9(2) përcakton që në rastin e veprave penale të kryera nga persona juridikë, kur dënimi i paraparë është burgim prej pesëmbëdhjetë (15) ditë deri në tri (3) vite, gjykata mund të shqiptojë gjobë ndaj personit juridik që varion nga 1.000 deri në 5.000 euro. Në rastin e veprave penale me dënim me burg prej tri (3) deri në tetë (8) vite, gjykata mund të shqiptojë gjobë që varion nga 5.000 deri në 15.000 euro. Kur dënimi i paraparë është burgim prej tetë (8) deri në njëzet (20) vite, mund të shqiptohet gjoba prej 15.000 deri në 35.000 euro, ndërsa për veprat penale ku dënimi mund të jetë me burg të përjetshëm, gjoba e shqiptuar nga gjykata varion nga 35.000 euro deri në 100.000 euro.
41. Proporcionaliteti dhe zbindja për gjobën maksimale prej 100.000 euro në rastin e përgjegjësisë penale të personave juridikë, edhe kur vepra, nëse kryhet nga një person fizik, do të sillte një dënim me burgim që tejkalon njëzet vjet, nuk do të ishte e përshtatshme. Një gjobë e tillë nuk ka shumë gjasa t’i pengojë shoqëritë tregtare që të mos kryejnë vepra penale që kanë përfitim të madh financiar. Mungesa e lidhjes ndërmjet dënimit të vendosur dhe përfitimit të nxjerrë nga krimi e bën më pak të mundshme që dënimi i shqiptuar të konsiderohet proporcional me peshën e një veprë penale të caktuar.

42. Për më tepër, është vërejtur se nuk duket të ketë legjislacion specifik që lejon procedura paralele penale, civile apo administrative dhe nuk është e qartë nëse kjo është e lejuar sipas parimeve të përgjithshme të legjislacionit.
43. **Kriteri 3.11** (*I përmbushur*) – Neni 56, paragrafi 1.6 i Ligjit për PPP/LFT-në thekson se një vepër penale kryhet nëse një person "merr pjesë në, bashkëpunon dhe ndihmon për të kryer, nxit, lehtëson dhe këshillon në kryerjen e ndonjë prej veprimeve të përmendura në nën-paragrafët 1.1 deri në 1.5. të këtij paragrafi". Pjesëmarrja, bashkëpunimi, komploti (bashkimi kriminal/marrëveshja), ndihma dhe nxitja (shtytja) dhe lehtësimi duket se mbulohen nga kjo dispozitë. Tentativa përmendet në mënyrë specifike në tekst në paragrafët 1.1 deri në 1.5.

Vlerësimi dhe përfundimi

44. Shumica e kriterëve janë përmbushur. Megjithatë, mungesa e proporcionalitetit dhe shqiptimit të sanksioneve zbindëse si për personat fizikë edhe juridikë dhe mospërfshirja e manipulimit të tregut si vepër penale e ndërlidhur mbeten pengesat kryesore në arritjen e përputhshmërisë së plotë me këtë Rekomandim.
45. **Kosova është kryesisht në përputhje me Rekomandimin 3.**

Rekomandimi 4 – Konfiskimi dhe masat e përkohshme

46. Në Raportin e Vlerësimit për PPP/LFT-në të vitit 2014, Kosova u vlerësua në mospërputhje me Rekomandimin e mëparshëm 3 të FATF-së. Vlerësimi identifikoi një numër mangësish teknike, përfshirë faktin se nuk kishte asnjë procedurë ose standard prove në Kodin e Procedurës Penale (KPP) për të lejuar konfiskimin e mjeteve të destinuara për përdorim në një vepër penale, një konflikt midis dispozitave të konfiskimit të palës së tretë në Kodin Penal (KP) dhe në nenet mbështetëse të KPP-së, një standard i pajustificueshëm i lartë i provës për një palë të tretë në mirëbesim, mungesa e autoritetit për të ndërmarrë hapa për të parandaluar ose anuluar veprimet (kontraktore ose të tjera) ku personat e përfshirë e dinin apo do të duhej ta dinin që, si pasojë e këtyre veprimeve, autoritetet do të paragjykoeshin në aftësinë e tyre për të rikthyer pasurinë që i nënshtrohet konfiskimit; efektiviteti i ulët i masave ekzistuese për shkak të pamjaftueshmërisë së ndjekjeve penale që rezultojnë në nivele të ulëta konfiskimi të të ardhurave nga krimi; mungesa e statistikave kuptimplota për sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurisë dhe mungesa e gjurmimit dhe rikthimit aktiv të aseteve nga ana e AZL-ve dhe autoriteteve të prokurorisë kur ndjekin ndonjë krim që sjell përfitim.
47. **Kriteri 4.1** – Korniza e sekuestrimit dhe konfiskimit rregullohet me Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale i cili parasheh konfiskimin e sendeve të mbajtura nga të pandehurit apo palët e treta.
48. Sipas nenit 69 të KP-së, sendet e *përdorura* apo të destinuara për kryerjen e veprës penale apo sendet të cilat janë rezultat i kryerjes së veprës penale do të konfiskohen, edhe kur nuk janë pronë e kryesit ose nëse konfiskimi është në dobi të sigurisë së përgjithshme ose për arsye të moralit. Për më tepër, konfiskimi i detyrueshëm i një sendi mund të sigurohet me ligj.
49. Ligji po ashtu parasheh që askush nuk mund ta mbajë dobinë pasurore të fituar me anë të kryerjes së veprës penale dhe dobia pasurore konfiskohet nga gjykata e cila konstaton kryerjen e veprës penale (neni 96). Kjo përfshin të gjitha veprat që gjenerojnë të ardhura nga vepra penale, duke përfshirë PP-në, FT-në dhe vepra penale të tjera të ndërlidhura.
50. Më tej, dobia pasurore duhet t'i konfiskohet kryesit apo kur konfiskimi nuk është i mundshëm, kryesi detyrohet të paguajë shumën e të hollave e cila i përgjigjet dobisë së fituar pasurore. Nëse dobia pasurore është transferuar te një person tjetër, ajo mund t'i konfiskohet personit të cilit i është bartur pa kompensim ose me kompensim që nuk i përgjigjet vlerës reale, nëse personi i tillë e ka ditur ose është dashur ta dijë se dobia pasurore është fituar me kryerjen e veprës penale. Kur dobia pasurore është bartur tek anëtarët e familjes, dobia konfiskohet nga anëtarë i familjes, përveç nëse anëtarë familjar dëshmon se si kompensim ka dhënë vlerën e plotë (neni 97).
51. Për të kryer konfiskimin e dobisë pasurore, duhet të ndërmerret procedura penale dhe të përfundojë me aktgjykim përmes të cilit i akuzuari shpallet fajtor (neni 280 i KPP-së) përveç në rastet kur pasuria ka prejardhje nga veprat e korrupsionit (neni 281 i KPP-së).

Prokurori duhet të renditë pasurinë që i nënshtrohet konfiskimit në aktakuzë (neni 274 i KPP-së). Nëse një gjë e tillë nuk bëhet, atëherë kjo lë mundësinë që të bëhet kërkesë nga pronari për lirim të pasurisë.

52. Për konfiskimin e pasurisë së *përdorur* në një vepër penale (mjetet), prokurori duhet të dëshmojë në shqyrtimin kryesor se pasuria është përdorur në veprën penale (neni 283 i KPP-së). Nuk është plotësisht e qartë nëse një aktgjykim fajësues është i nevojshëm me qëllim të konfiskimit të mjeteve të tilla përveç pasurisë që i nënshtrohet konfiskimit automatik në pajtim me nenin 282 të KPP-së (sendet pasurore që janë të rrezikshme apo të jashtëligjshme). Megjithatë, KPP-ja nuk përfshin ndonjë standard të provave apo procedurës për konfiskimin përfundimtar të mjeteve qëllimi i përdorimit të tyre cilave ka qenë kryerja e veprës penale gjë që ngre dyshimin lidhur me mundësinë e konfiskimit të tyre përfundimtar.
53. Në bazë të dispozitave ligjore të mësipërme, kriteri 4.1 (a), (b) dhe (d) *janë përmbushur kryesisht*, edhe pse disa dispozita të caktuara të KPP-së përcaktojnë kufizime të caktuara që dobësojnë regjimin e konfiskimit. Sa i përket kriterit 4.1(c), fondet mund të konfiskohen kur ato janë të ardhura nga një vepër terroriste, ose nëse ato përdoren për të financuar veprat e terrorizmit. Është e dyshimtë nëse fondet mund të konfiskohen mbi bazën e financimit të terroristëve apo organizatave terroriste pa ndonjë lidhje specifike me një vepër terroriste (p.sh. nevojat sociale, mjekësore, udhëtimi etj.). Prandaj, kriteri 4.1(c) është *përmbushur vetëm pjesërisht*.
54. **Kriteri 4.2(a)** (*I përmbushur*) – Organet e zbatimit të ligjit të tilla si PK-ja dhe DK-ja kanë kompetenca të mjaftueshme për të kontrolluar dhe sekuestruar pasurinë që është, ose dyshohet të jetë, e ardhur nga krimi (neni 105 KPP).
55. **Kriteri 4.2(b)** (*Kryesisht i përmbushur*) – Neni 264 i KPP-së përcakton një sistem për ngrirjen e përkohshme të pasurive që janë të ardhura nga krimi ose prova në hetim, si një masë parandaluese për të parandaluar largimin ose shpërndarjen. Kjo përfshin një urdhër të lëshuar nga Prokurori i Shtetit dhe i cili është i vlefshëm për 72 orë, gjatë kësaj kohe Prokurori duhet menjëherë t'i bëjë një kërkesë gjyqtares për procedurën paraprake për një "urdhër ndalues" për t'i ngrirë pasuritë. Urdhri ndalues zgjat fillimisht 30 ditë ku gjatë kësaj kohe dhe me një njoftim paraprak caktohet brenda 3 javëve seanca dëgjimore për të shqyrtuar ndonjë kundërshtim nga ata që preken prej urdhrit ndalues. Neni 112 gjithashtu lejon sekuestrimin e përkohshëm të sendeve dhe përkufizimi përfshin dob të pasurore të fituara nga kryerja e një veprë penale. Është e paqartë nga hartimi nëse kjo ka të bëjë vetëm me sendet e gjetura gjatë një kontrolli, pasi ky seksion vazhdon pas neneve që kanë të bëjnë me kontrollin dhe pa urdhër të gjykatës. Gjuha e tekstit nuk është koherente pasi i referohet sekuestrimit të përkohshëm dhe konfiskimit të përkohshëm në të njëjtin formulim.
56. Sistemi i masave të përkohshme në Kosovë para konfiskimit përfshin: ngrirjen (neni 264 i KPP-së), sekuestrimin e përkohshëm (neni 112 i KPP-së), konfiskimin e përkohshëm (neni 267 i KPP-së) dhe masa të përkohshme për sigurimin e pasurisë (neni 268 i KPP-së). Megjithatë, terminologjia e përdorur në nenet e ndryshme të KPP-së duket të jetë jokohërente dhe ngre dyshime nëse sistemi i masave të përkohshme mund të funksionojnë në praktikë (shih RM 8).
57. **Kriteri 4.2 (c)** (*Nuk është përmbushur*) – Duket se nuk parashihet kompetencë në ligj për të ndërmarrë hapa për të parandaluar ose anuluar veprimet, kontraktore ose të tjera, kur personat e përfshirë e dinin ose duhet ta kishin ditur se si rezultat i këtyre veprimeve autoritetet do të paragjykoreshin në aftësinë e tyre për të rikthyer pasurinë që i nënshtrohet konfiskimit.
58. **Kriteri 4.2 (d)** (*I përmbushur*) – Masat e duhura hetimore mund të merren nga autoritetet e Kosovës, siç parashihet më tej në paragrafët që kanë të bëjnë me Rekomandimet 30 dhe 31.
59. **Kriteri 4.3** (*I përmbushur*) – Sipas nenit 270 të KPP-së, palëve të treta u jepet mundësia për t'i shprehur kundërshtimet e tyre ndaj çdo mase të përkohshme të ndërmarrë në lidhje me pasurinë e tyre që është përdorur si mjet në një vepër penale. Në lidhje me këtë, pala e tretë duhet të vërtetojë se nuk ka ditur ose nuk ka mundur ta dijë për përdorimin e pasurisë në kryerjen e veprës penale, se pasuria nuk mund të përdoret prapë për vepër penale dhe se masat e përkohshme dëmtojnë në mënyrë të paarsyeshme interesat e palës së tretë.

60. Në rastet kur pasuria e palës së tretë është e lidhur me dobinë pasurore të fituar nga vepra penale, kjo palë e tretë duhet të vërtetohet se:
- ai/ajo ka pasur të drejtë pronësore në pasuri për më shumë se 6 muaj para konfiskimit të përkohshëm të pasurisë;
 - ai/ajo ka paguar çmimin e tregut për të drejtën pronësore në ndërtesë, pasuri të paluajtshme, pasuri të luajtshme apo aset;
 - ai/ajo nuk ka ditur për veprimet që kanë mbështetur veprën penale;
 - i dyshuari apo i pandehuri nuk do të mund të shfrytëzonte, shkëmbente ose në ndonjë formë tjetër të siguronte qasje në ndërtesën, pasurinë e paluajtshme, pasurinë e luajtshme ose asetin; dhe
 - masa e përkohshme e propozuar do të dëmtonte në mënyrë të paarsyeshme të drejtat e personit që kundërshton atë.
61. **Kriteri 4.4** (*I përmbushur*) – Ligji nr. 05/L-049 për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar përcakton funksionet dhe përgjegjësitë e Agjencisë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar. Neni 19 i të këtij ligji jep informata për administrimin e pasurisë së konfiskuar, ku Agjencia “ruan dhe kontrollon pasurinë e cila është urdhëruar të konfiskohet dhe siguron mbrojtjen”. E njëjta dispozitë autorizon agjencinë të ndërmarrë masat e nevojshme për ruajtjen e përshtatshme dhe sigurimin e pasurisë së konfiskuar, si dhe të ruajë vlerën e pasurisë. Neni 18 gjithashtu parasheh administrimin e pasurive të sekuestruara. Në lidhje me largimin e pronës, neni 19, paragrafi 4 i po këtij ligji thotë se Agjencia mund të bëjë shitjen e sendeve ose dorëzimin e tyre për shfrytëzim nga Qeveria.

Vlerësimi dhe përfundimi

62. Përderisa korniza ligjore për konfiskimin dhe masat e përkohshme është në përputhje me shumicën e kriterëve, janë një numër kriteresh të rëndësishme që nuk përmbushen, përfshirë kërkesën për të identifikuar dhe gjurmuar asetet dhe kërkesën për të qenë në gjendje për të ndërmarrë hapa për të parandaluar ose anuluar veprimet që paragjykojnë ngrirjen e aseteve ose sekuestrimin ose rikthimin e pasurisë që i nënshtrohet konfiskimit. Është gjithashtu e paqartë se deri në çfarë mase është i mundur konfiskimi i pasurive të lidhura me financimin e terroristeve apo organizatave terroriste pa një lidhje specifike me një vepër terroriste. Për më tepër, ekziston një numër i procedurave të mbivendosura për masa të përkohshme, të cilat krijojnë pështjellim në zbatimin e tyre në praktikë.
63. **Kosova është pjesërisht në përputhje me Rekomandimin 4.**

Rekomandimi 5 – Vepra e financimit të terrorizmit

64. Rekomandimi i Posaçëm II në Raportin e Vlerësimit të vitit 2014 është vlerësuar si pjesërisht në përputhje për shkak të disa mangësive në kriminalizimin e financimit të terrorizmit, më me rëndësi në kriminalizimin e dyfishtë të FT-së, mungesën e kriminalizimit të financimit të një terroristi individual (për çdo qëllim) në KP, mbulimin e mangët të “veprës së terrorizmit” siç kërkohet nga paragrafi (1) i nenit 2 të Konventës së FT-së, dhe sanksionet nuk konsiderohen zbindëse.
65. **Kriteri 5.1** (*Pjesërisht i përmbushur*) – Financimi i terrorizmit kriminalizohet si vepër e ndarë në nenin 138 të Kodit Penal në kuadër të lehtësimit të terrorizmit³³. Përveç kësaj, dispozitat e mëposhtme të KP-së janë të zbatueshme për veprën e FT-së: neni 144 paragrafi 4 (Përgatitja e veprave terroriste ose veprave penale), neni 137 paragrafi 3 (Ndihma në kryerjen e terrorizmit) dhe neni 139 (Rekrutimi për terrorizëm). Akti terrorist interpretohet duke iu referuar nenit 136 dhe përkufizimit të “terrorizmit, veprimit terrorist ose veprës së terrorizmit” në nenin 135 të KP.
66. Meqenëse këto dispozita nuk kanë ndryshuar që nga raporti i mëparshëm i vlerësimit, të njëjtat mangësi të identifikuar në atë raport vlejné.

³³ Paragrafi 1 i nenit 138 parasheh që “Kushdo që në çfarëdo mënyre të drejtpërdrejtë ose të tërthortë ofron, kërkon, mbledh ose fsheh fonde apo mjete të tjera materiale me dashje, dijeni apo bazë të arsyeshme për të besuar se do të përdoren tërësisht ose pjesërisht për apo nga grupi terrorist, apo për kryerjen e veprës terroriste, dënohet me burgim prej pesë (5) deri në pesëmbëdhjetë (15) vjet”.

67. Kështu, kriminalizimi i veprave penale të ndryshme terroriste të përshkruara në nëntë traktatet e bashkëngjitura në të njëjtën Konventë sipas paragrafit (1) (a) të nenit 2 është i kufizuar për shkak të mosmbulimit të plotë të të gjitha këtyre veprave si terrorizëm lidhur kryesisht me elementin e dashjes të paragrafit 1 të nenit 135.
68. Vepra "e përgjithshme" terroriste nuk është plotësisht në përputhje me përkufizimin e dhënë në paragrafin (1) (b) të nenit 2 për shkak të ngushtimit potencial të fushës së çdo akti që ka për qëllim të shkaktojë vdekjen duke iu referuar vetëm veprave të caktuara penale, si dhe pasigurisë në lidhje me zbatueshmërinë e përkufizimit të një vepre terroriste në nenin 135 për veprat penale të lidhura me terrorizmin në nenet 137, 139-144.
69. Në të njëjtën kohë, financimi i terrorizmit përkufizohet shprehimisht si vepër penale në nenin 57 të Ligjit për PPP/LFT-në dhe lidhur me përkufizimin e FT-së në nenin 2 të të njëjtit ligj. Pasojat negative të kriminalizimit të dyfishtë të FT-së mbeten plotësisht siç përshkruhet në Raportin e mëparshëm të Vlerësimit pa kontribuar në pajtueshmërinë me Konventën e FT-së për shkak të zbatueshmërisë së të njëjtave përkufizime të KP.
70. Gjithashtu, vihet re se financimi i udhëtimit me qëllim të pjesëmarrjes në një konflikt të armatosur jashtë territorit të Kosovës parashihet gjithashtu në nenin 3, paragrafi 2 të Ligjit nr. 05/L-002 për Ndalimin e Bashkimit me Konfliktet e Armatosura jashtë Territorit të Shtetit. Megjithatë, financimi mbulon vetëm veprimtarinë e përcaktuar në paragrafin 1 të të njëjtit nen, domethënë organizimin, rekrutimin, udhëheqjen ose trajnimin e personave ose grupeve të personave. Kështu, financimi i individëve që bashkohen, marrin pjesë në zonat e konfliktit, nxitja e të tjerëve dhe sigurimi i mbështetjes logjistike mbeten jashtë fushëveprimit të veprës së financimit të terrorizmit. Vërehet në këtë rast se vepra e përgjithshme e FT-së e paraparë në nenin 138 nuk do të ishte e mjaftueshme për shkak të mungesës së ndonjë referimi ndaj terrorizmit në Ligjin për Ndalimin e Bashkimit me Konfliktet e Armatosura jashtë Territorit të Shtetit.
71. Projekti i ri i propozuar i Kodit Penal ruan shtrirjen e përkufizimit të terrorizmit, aktit terrorist ose veprës terroriste të KP aktual. Në të njëjtën kohë, dispozita e propozuar për lehtësimin e terrorizmit, ndonëse e zgjeron fushëveprimin e veprës penale (e diskutuar më poshtë në kriteret përkatëse), ende nuk i zgjidh plotësisht mangësitë e lartpërmendura.
72. **Kriteri 5.2 (Pjesërisht i përmbushur)** – Në vlerësimin e veprës penale të FT-së në Kodin Penal siç është diskutuar më lart, mangësia më e rëndësishme në lidhje me kriterin 5.2 mbetet mungesa e mbulimit lidhur me financimin e terroristit individual.
73. Kriminalizimi në nenin 57 të Ligjit për PPP/LFT-në nuk e zgjidh tërësisht situatën lidhur me financimin e terroristit individual për çfarëdo qëllimi. Çështja e dispozitave penale kundërshtuese mbetet.
74. Neni 131 i propozuar i projektit të KP-së i korigjon këto mangësi duke përfshirë financimin e terroristëve individualë për çdo qëllim dhe duke përfshirë një përkufizim të terroristit në nenin 128 në përputhje me kërkesat e FATF-së. Sidoqoftë, ekziston njëfarë pasigurie në lidhje me përjashtimin e nenit 131 nga dispozita e shprehur në nenin 139, ku përcaktohet se nuk do të jetë e nevojshme, për sa i përket veprave penale të përmendura në nenet 132, 133, 134 dhe 137, që të krijohet një lidhje me një vepër tjetër penale në KP.
75. **Kriteri 5.2 (bis) (Pjesërisht i përmbushur)** – Nuk ka ndonjë dispozitë të qartë lidhur me financimin e udhëtimit ose të dhënies ose pranimit të trajnimit në kuadër të KP-së. Për sa i përket KP-së, elementet e financimit të udhëtimit për qëllime të kryerjes, planifikimit, përgatitjes ose pjesëmarrjes në një vepër terroriste mund të përfshihen në dispozitën e përgjithshme të nenit 138, mangësitë në kriminalizimin e financimit të terroristëve individualë dhe pasiguria lidhur me çfarëdo mbulimi të financimit të trajnimit (neni 140) ose financimit të veprave në nenin 144, ndikon shumë në përputhshmërinë me këtë kriter.
76. Ligji nr. 05/L-002 për Ndalimin e Pjesëmarrjes në Konflikte të Armatosura jashtë Territorit të Shtetit (neni 3, paragrafi 2) nuk mund të konsiderohet se mbulon kërkesat për financimin e udhëtimit për qëllime terroriste ose FT, kur udhëtimi i tillë nuk ka të bëjë me aktivitetet terroriste të ndodhura jashtë rrethanave të konfliktit të armatosur. Për më tepër, neni 3, paragrafi 2 i Ligjit për Ndalimin e Pjesëmarrjes në Konflikte të Armatosura jashtë Territorit të Shtetit mbulon vetëm veprimtarinë e përcaktuar në paragrafin 1 të të njëjtit nen, domethënë organizimin, rekrutimin, udhëheqjen ose trajnimin e personave ose grupeve të personave. Kështu, financimi i individëve që bashkohen, marrin pjesë në zonat e konfliktit, nxitja e të tjerëve dhe sigurimi i mbështetjes logjistike, po ashtu hiqen nga fushëveprimi i veprës së financimit të terrorizmit.

77. Projekti i ri i KP-së, në mënyrë të qartë, paraqet në nenin 137 veprën penale të udhëtimit për qëllime të terrorizmit. Megjithatë, paqartësia mbetet në lidhje me masën deri në të cilën financimi i terrorizmit (lehtësimi) i mbulon edhe udhëtimet për qëllime terrorizmi.
78. **Kriteri 5.3** (*I përmbushur*) – Kriteri 5.3 është përmbushur plotësisht (si në KP ashtu edhe në Ligjin aktual për PPP/LFT-në).
79. **Kriteri 5.4** (*Kryesisht i përmbushur*) – Neni 138 i KP nuk kërkon që fondet të përdoren në të vërtetë për të kryer ose tentuar të kryhet një vepër terroriste ose që ka një lidhje me një vepër specifik terroriste, pasi dispozita e paragrafit 1 e ndan financimin për qëllim të kryerjes së veprës terroriste nga financimi i organizatave terroriste.
80. Sidoqoftë, në rastin e nenit 57 të Ligjit për PPP/LFT-në, i cili përcakton se mjetet “do të përdoren në mënyrë të plotë ose pjesërisht për të kryer një akt terrorist, nga një terrorist; ose nga një organizatë terroriste”, qëllimi i përgjithshëm i kryerjes së aktit terrorist mbetet i lidhur me financimin e një terroristi ose organizate terroriste.
81. Neni 139 i propozuar i projektit të KP në të vërtetë paraqet shqetësime të tjera lidhur me lidhjet me një akt terrorist të caktuar, siç diskutohet në kriterin 5.2.
82. **Kriteri 5.5** (*Kryesisht i përmbushur*) – Në kontekstin e KP-së, kriteri është përmbushur plotësisht përmes nenit 22. Nuk është e qartë nëse kjo dispozitë do të zbatohet edhe në kontekstin e dispozitave penale të Ligjit për PPP/LFT-në.
83. **Kriteri 5.6** (*I përmbushur*) – Sanksionet mund të konsiderohen proporcionale dhe zhbindëse sidomos pas amendamenteve të paraqitura në nenin 57 të Ligjit të ri për PPP/LFT-në, i cili parasheh dënime me burgim (ekuivalent me KP-në) dhe një sanksion financiar njëkohësisht me dënimin (i cili më herët ishte alternativë ndaj burgimit dhe kështu komprometonte regjimin e sanksioneve).
84. Sanksionet në nenin e propozuar 131 të projektit të ri të KP-së janë ekuivalente me sanksionet e lartpërmendura në nenin 57 të Ligjit për PPP/LFT-në.
85. **Kriteri 5.7** (*Pjesërisht i përmbushur*) – Nuk janë bërë ndryshime në legjislacion që nga raporti i mëparshëm i vlerësimit, përveç ndryshimit të kërkesave përkatëse të Ligjit për PPP/LFT-në nga neni 34 deri në nenin 60. Kështu, mospërputhjet e gjetura në raportin e mëparshëm të vlerësimit mbeten të vlefshme, përfshirë mospërputhjet e brendshme ndërmjet paragrafëve të nenit 40 të KP-së (respektivisht neni 5 të Ligjit për Përgjegjësinë e Personave Juridikë për Veprat Penale) dhe mospërputhjen me nenin 60 të Ligjit për PPP/LFT-në.
86. Neni 37 i propozuar i projektit të ri të KP-së në praktikë do të barazonte çdo interpretim kontradiktor me nenin 60 të Ligjit për PPP/LFT-në duke miratuar dhe sqaruar kërkesat e përgjithshme të nenit 60. Sidoqoftë mbetet konflikti me Ligjin për Përgjegjësinë e Personave Juridikë, si dhe mungesa e qartësisë për zbatimin e dispozitës ekuivalente të propozuar (paragrafi 3 i nenit 37 të projektit) në paragrafin 2 të nenit 40 të KP të tanishëm. Për më tepër, vlejné mangësitë e identifikuara sipas kriterit 3.10.
87. **Kriteri 5.8** (*Kryesisht i përmbushur*) – Tentativa dhe veprat penale ndihmëse mbulohen nga nenet 28 (tentativa), 32 (shtytja), 31 (bashkëkryerja), 33 (ndihma), 34 (bashkimi kriminal), 35 (marrëveshja për të kryer vepër penale) dhe kërkesat e nenit 145 të KP. Dispozitat përkatëse të Ligjit për PPP/LFT-në janë paragrafët 2 dhe 4 që përfshijnë ndihmën, nxitjen (mbështjetja), lehtësimin ose këshillimin e kryerjes së veprës penale. Ndërsa neni 57, paragrafi 1 i Ligjit për PPP/LFT-në shprehimisht përfshin organizimin ose drejtimin e të tjerëve, KP nuk ka dispozitë të ngjashme në nenin 138. Një problem tjetër mbetet formulimi i ndryshëm i përdorur në paragrafin 4 të nenit 57 të Ligjit për PPP/LFT-në në krahasim me KP pa qartësuar më tej konceptet themelore.
88. Neni 131 i propozuar i projektit të ri të KP-së do të përfshinte elementët e organizimit dhe drejtimit të të tjerëve në veprën e FT-së.
89. **Kriteri 5.9** (*I përmbushur*) – Kriteri 5.9 është përmbushur plotësisht.
90. **Kriteri 5.10** (*I përmbushur*) – Duke marrë parasysh mungesën e ndonjë kufizimi përkatës në nenin 138 të KP-së dhe nenin 57 të Ligjit për PPP/LFT-në, nuk ka efekt dëmtes të mungesës së legjislacionit specifik pozitiv që e zbaton këtë kriter.

Vlerësimi dhe përfundimi

91. Disa mangësi të identifikuar në vlerësimin e mëparshëm mbeten të vlefshme, përfshirë mangësitë në kriminalizimin e veprave të ndryshme terroriste të përshkruara në nëntë traktatet e renditura në shtojcën e Konventës së FT-së dhe veprës "gjenerike" të një akti terrorist që nuk janë plotësisht në përputhje me standardet. Në të njëjtën kohë, mundësia për të ndjekur penalisht financimin e udhëtimit është e kufizuar nga dispozitat ekzistuese të KP-së dhe Ligji për Ndalimin e Bashkimit me Konfliktet e Armatosura jashtë Territorit të Shtetit.
92. **Kosova është pjesërisht në përputhje me Rekomandimin 5.**

Rekomandimi 6 – Sanksionet financiare të shënjestruara lidhur me terrorizmin dhe financimin e terrorizmit

93. Raporti i mëparshëm i vlerësimit e vlerësoi Rekomandimin e Posaçëm III si në mospërputhje për shkak të mungesës së mekanizmave për zbatimin e sanksioneve financiare të shënjestruara. Vërehet se asnjë ndryshim nuk ka ndodhur pavarësisht nga miratimi i një Ligji të ri për PPP/LFT-në që mund të ketë disa lidhje indirekte me zbatimin e sanksioneve të shënjestruara (siç është përmendur më poshtë) dhe madje edhe në atë rast nuk janë miratuar mekanizma përkatës për aplikim gjithëpërfshirës.
94. **Kriteri 6.1** dhe **Kriteri 6.2** (Nuk është përmbushur) – Nuk ka mekanizma specifike ligjorë apo institucionale në Kosovë lidhur me kriterin 6.1. Ligji nr. 03/L-183 ka të bëjë me Zbatimin e Sanksioneve Ndërkombëtare, përfshirë sanksionet financiare. Sanksionet financiare përcaktohen sipas nenit 2 paragrafi 1 si "kufizimet në të drejtat e subjekteve, ndaj të cilëve zbatohen sanksionet ndërkombëtare, për të menaxhuar, përdorur apo disponuar para të gatshme, letra me vlerë, mallra, të drejta të tjera dhe të drejta pronësore, kufizime pagese për subjektet ndaj të cilëve zbatohen sanksione ndërkombëtare, kufizime të tjera për aktivitetet financiare". Në zbatim të nenit 3 paragrafi 1 të Ligjit për Zbatimin e Sanksioneve Ndërkombëtare, sanksionet ndërkombëtare përcaktohen dhe ndryshohen me vendim të Qeverisë së Kosovës, e cila duhet të jetë baza e mekanizmave përkatës për sanksione të ndryshme. Asnjë mekanizëm i tillë nuk ekziston në lidhje me propozimin e personave apo subjekteve për përcaktime sipas Rezolutës 1267/1989 dhe 1988 dhe atyre pasuese të Këshillit të Sigurimit të OKB-së. Në praktikë, qeveria mund të miratojë një vendim për të propozuar personat për përcaktim në baza *ad hoc*. Megjithatë, kjo është problematike për shkak të mungesës së një mekanizmi formal dhe aktiv, përfshirë kompetencat specifike dhe kriteret për identifikimin e atyre personave dhe propozimin e tyre. Sipas nenit 10, Ministria e Punëve të Jashtme bashkërendon zbatimin e sanksioneve ndërkombëtare në Kosovë dhe u siguron personave fizikë dhe juridikë informacione. Në praktikë, nuk ekzistojnë mekanizma të posaçëm për zbatimin e standardeve ndërkombëtare në lidhje me RKSKB-të e përmendura. Në të njëjtën kohë, neni 11 parasheh institucionet përgjegjëse në përgjithësi për zbatimin dhe mbikëqyrjen e sanksioneve.
95. Konstatimi i mësipërm është i vlefshëm edhe për kriterin 6.2. Pavarësisht nga prania e disa autoriteteve që kanë kompetenca sipas Ligjit për Sanksionet Ndërkombëtare, nuk ekzistojnë procedura të veçanta ose ndonjë kërkesë tjetër në lidhje me Rezolutat përkatëse të KS të OKB-së.
96. **Kriteri 6.3** (Nuk është përmbushur) – Përkundër mungesës së mekanizmave dhe procedurave zyrtare, autoritetet përgjegjëse për analizimin, hetimin dhe ndjekjen penale të financimit të terrorizmit mund të mbledhin ose të kërkojnë informata në praktikë që do të ishin të nevojshme për të përmbushur kriteret për përcaktim brenda kompetencave të tyre përkatëse. Megjithatë, kjo nuk mund të konsiderohet se përmbush kriteret pasi që kjo nuk do të bëhet në mënyrë sistematike, sipas një standardi bazë dhe nuk do të zbatohet në të gjitha rastet sipas Rezolutave përkatëse të KS të OKB-së.
97. **Kriteri 6.4** (Nuk është përmbushur) – Sanksionet financiare të shënjestruara nuk janë zbatuar.
98. **Kriteri 6.5** (Nuk është përmbushur) – Me gjithë përcaktimin e disa autoriteteve sipas Ligjit për Zbatimin e Sanksioneve Ndërkombëtare siç u diskutua më lart, asnjë autoritet nuk është caktuar në përputhje me standardet dhe procedurat e kërkuara sipas kriterit 6.5. Ekzistojnë disa kërkesa të pjesëshme (p.sh. në nenin 8 të ligjit të përmendur) për personat dhe subjektet për zbatimin e sanksioneve financiare të cilat nuk janë të zbatueshme për shkak të mungesës së mekanizmave të domosdoshëm institucionale përkatës për zbatimin (përfshirë komunikimin, mbikëqyrjen etj.). Kërkesa e Udhëzimit Administrativ të NjIF-it

nr. 03/2015 për Parandalimin dhe Zbulimin e Financimit të Terrorizmit kuptohet si një mekanizëm që synon zbulimin e rasteve të mundshme të financimit të terrorizmit dhe jo si një mekanizëm formal që mund të çojë në vendosjen e sanksioneve të shënjestruara për terrorizmin dhe FT, të paktën jo në baza të rregullta dhe jo për të gjitha subjektet raportuese për shkak të nivelit të ndryshëm të kontroleve të brendshme të kërkuara midis sektorëve të ndryshëm. Për më tepër, ky mekanizëm nuk zbatohet për të gjithë personat dhe subjektet në Kosovë, që është qëllimi i sanksioneve të RKS KB-ve. Gjithashtu, nuk është e qartë nëse është krijuar ndonjë formë bashkëpunimi për këtë qëllim me autoritetet e tjera që do të kishin kompetencë të konsiderueshme në këtë drejtim (duke mos lejuar transaksione me pasuritë e personave të përcaktuar), përfshirë Departamentin për Regjistrim dhe Ndërlidhje me OJQ-të (DRNOJQ), Regjistrin e Bizneseve dhe Kadastrën.

99. **Kriteri 6.6** (Nuk është përmbushur) – Nuk janë zbatuar procedura të tilla specifike.

Vlerësimi dhe përfundimi

100. Autoritetet nuk kanë zbatuar ndonjë mekanizëm në sistem për sanksionet financiare të shënjestruara që lidhen me terrorizmin dhe financimin e terrorizmit.

101. **Kosova është në mospërputhje me Rekomandimin 6.**

Rekomandimi 7 – Sanksionet financiare të shënjestruara lidhur me përhapjen

102. Rekomandimi 7 parasheh kërkesa të reja që nuk kanë qenë pjesë e Raportit të Vlerësimit paraprak për PPP/LFT-në të vitit 2014.

103. **Kriteri 7.1** (Nuk është përmbushur) – Ligji nr. 03/L-183 ka të bëjë me Zbatimin e Sanksioneve Ndërkombëtare, përfshirë sanksionet financiare. Sanksionet financiare përkufizohen në nenin 2, paragrafi 1 si "kufizimet në të drejtat e subjekteve, ndaj të cilëve zbatohen sanksionet ndërkombëtare, për të menaxhuar, përdorur apo disponuar para të gatshme, letra me vlerë, mallra, të drejta të tjera dhe të drejta pronësore, kufizime pagese për subjektet ndaj të cilëve zbatohen sanksione ndërkombëtare, kufizime të tjera për aktivitetet financiare". Neni 3, paragrafi 1 i këtij ligji parashikon që Qeveria e Kosovës përcakton dhe ndryshon zbatimin e të gjitha sanksioneve ndërkombëtare të përcaktuara në Rezolutat e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, si dhe vendimet e organizatave të tjera ndërkombëtare për sanksionet ndërkombëtare. Për më tepër, neni 6 thekson se Qeveria e Kosovës zbaton gjithashtu vendimet e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) dhe organizatave të tjera ndërkombëtare anëtare e të cilave është Kosova ose në të cilat merr pjesë, duke rekomanduar vendosjen e sanksioneve ndërkombëtare ndaj subjekteve të veçanta.

104. Ministria e Punëve të Jashtme e Kosovës është përgjegjëse për zbatimin e përjashtimeve të përcaktuara në nenin 4 paragrafi 2 të të njëjtit ligj.

105. Neni 1, paragrafi 2 i Ligjit nr. 04/L-198 për Tregtinë e Mallrave Strategjike përcakton qëllimin e ligjit i cili është që "ta avancojë sigurinë shtetërore dhe interesat e politikës së jashtme të Kosovës, drejt përmbushjes së detyrimeve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare në lidhje me mospërhapjen e armëve të shkatërrimit në masë dhe mallrave të tjera strategjike të shfrytëzuara për qëllime ushtarake dhe t'i kontribuojë përpjekjeve ndërkombëtare dhe rajonale për rregullimin e tregtisë me mallrat strategjike".

106. Pavarësisht nga sa u cek më sipër, është konstatuar se RKS KB-ja 1718 në lidhje me Republikën Popullore Demokratike të Koresë dhe RKS KB-ja 1737 lidhur me Republikën Islamike të Iranit nuk janë zbatuar sipas ligjeve të Kosovës. Për më tepër, Rekomandimi 7 kërkon zbatimin e sanksioneve financiare të shënjestruara "pa vonesë", në përputhje me përkufizimin e FATF-së që do të thotë "në mënyrë ideale, brenda disa orëve nga një përcaktim". Në këtë aspekt, nuk duket se ka ndonjë referim në ligj për zbatueshmërinë e një kornize të përshtatshme kohore brenda të cilës duhet të zbatohen dhe shqiptohen sanksionet e shënjestruara.

107. **Kriteri 7.2** (Pjesërisht i përmbushur) – Ligji nr. 03/L-183 për Zbatimin e Sanksioneve Ndërkombëtare u referohet institucioneve të ndryshme përgjegjëse për bashkërendimin e zbatimit dhe mbikëqyrjes së zbatimit të sanksioneve ndërkombëtare (veçanërisht nenet 10 dhe 11). Siç është përcaktuar në nenin 10 paragrafi 1, Ministria e Punëve të Jashtme është e caktuar për të bashkërenduar zbatimin e sanksioneve ndërkombëtare në Kosovë, ndërsa

neni 11 paragrafi 1/1.2 thekson se institucionet përgjegjëse për mbikëqyrjen e zbatimit të sanksioneve financiare janë Ministria e Punëve të Brendshme, Policia e Kosovës nën bashkërendimin e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Ministria e Ekonomisë dhe Financave.

108. **Kriteri 7.2 (a – f)** – Nuk ka dëshmi se Kosova kërkon që të gjithë personat fizikë dhe juridikë të ngrijnë fonde ose pasuri të tjera të personave dhe subjekteve të përcaktuar dhe të kenë mekanizma në këtë drejtim. Gjithashtu, nuk ekzistojnë masa për mbrojtjen e të drejtave të palëve të treta *bona fides* që veprojnë në mirëbesim gjatë zbatimit të detyrimeve të Rekomandimit 7.
109. **Kriteri 7.3 (Nuk është përmbushur)** – Nuk ka masa për monitorimin dhe sigurimin e përputhshmërisë nga institucionet financiare dhe BPCJF-të me ligjet përkatëse apo mjetet detyruese që rregullojnë detyrimet.
110. **Kriteri 7.4 (Nuk është përmbushur)** – Nuk është zhvilluar dhe zbatuar asnjë procedurë për të paraqitur kërkesa për çregjistrim në Këshillin e Sigurimit të OKB-së në rastin e personave dhe subjekteve të përcaktuara që nuk plotësojnë ose pushojnë së plotësuari kriteret për përcaktim.
111. **Kriteri 7.5 (Nuk është përmbushur)** – Nuk ekzistojnë masa për të lejuar shtimin të llogaritë e ngrira të interesave apo të ardhurave të tjera të pagueshme në këto llogari ose pagesave të detyrueshme sipas kontratave, marrëveshjeve ose detyrimeve që kanë lindur para datës në të cilën llogaritë u janë nënshtruar sanksioneve financiare të shënjestruara.

Vlerësimi dhe përfundimi

112. Kosova nuk ka miratuar legjislacion apo masa dhe procedura të kënaqshme për zbatimin e sanksioneve financiare të shënjestruara për të qenë në pajtim me Rezolutat e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara lidhur me parandalimin, shtypjen dhe ndërprerjen e përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë dhe financimin e tyre.
113. **Kosova është në mospërputhje me Rekomandimin 7.**

Rekomandimi 8 – Organizatat Jofitimprurëse (OJF)

114. Kosova u vlerësua në mospërputhje me Rekomandimin e Posaçëm VIII të FATF-së sipas vlerësimit paraprak për shkak të një numri të konsiderueshëm mangësish. Këtu përfshihej: mungesa e një vlerësimi të rrezikut të sektorit, mungesa e sensibilizimit, mungesa e mbikëqyrjes në sferën e kujdesit; mungesa e mbikëqyrjes për PPP/LFT-në; asnjë detyrim për të ruajtur informacionin mbi qeverisjen e organizatës në mënyrë të vazhdueshme në të gjitha rastet; mungesa e sanksioneve në sferën e kujdesit për të gjitha shkeljet e Ligjit për OJQ-të; konfliktet ndërmjet Ligjit për PPP/LFT-në dhe Ligjit për OJQ-të; mungesa e dispozitave për fuqizimin e DRNOJQ-së për të kërkuar çfarëdo informacioni tjetër sipas nevojës; dhe, shqetësimet mbi identifikimin e OJQ-ve që duhet të hetohen dhe, për pasojë, edhe mundësia e hetimeve.
115. Nuk ka pasur asnjë ndryshim në Ligjin për Lirinë e Asociimit të OJQ-ve që nga raporti i mëparshëm i vlerësimit, pra Kosova mban në një masë të madhe mangësitë e vërejtura kryesisht në lidhje me statusin e mbikëqyrjes së kujdesshme dhe rolin e DRNOJQ-së, megjithëse siç është theksuar më poshtë ligji i ri për PPP/LFT-në është miratuar duke sqaruar më tej disa çështje që lidhen me OJQ-të.
116. Sektori i OJQ-ve në Kosovë, në pajtim me Ligjin për Lirinë e Asociimit të OJQ-ve, përfshin shoqatat dhe fondacionet. E para është një organizatë me anëtarësim e themeluar nga të paktën tre persona dhe kjo e fundit është një organizatë pa anëtarësim e themeluar për të menaxhuar pronat dhe pasuritë. Përveç kësaj, OJQ-të e huaja dhe ndërkombëtare që plotësojnë kërkesat e nenit 4 të Ligjit mund të jenë nën juridiksionin e ligjit. Logjika e Ligjit duket se i lejon OJQ-të e huaja të vazhdojnë të operojnë në Kosovë pa iu nënshtruar kërkesave të regjistrimit dhe mbikëqyrjes nga institucionet e Kosovës. Përveç kësaj, është e dyshimtë që OJQ-të e huaja i nënshtrohen kërkesës së përgjithshme për shoqatat dhe fondacionet vendore (neni 6, paragrafi 6) që të mos angazhohen në aktivitete që nuk janë në përputhje me instrumentet themeluese dhe statutet përkatëse. Në të njëjtën kohë, vërehet se OJQ-të vendore dhe të huaja që bien nën juridiksionin e ligjit i nënshtrohen kërkesës së nenit 4 të Ligjit për mosshpërndarjen e të ardhurave e fitimeve dhe për të mos

ofruar përfitime për ndonjë themelues, drejtor, zyrtar, anëtar, punonjës ose donator përveç shpërblimit të arsyeshëm për punën e kryer.

117. Vërehet gjithashtu që OJQ-të mund të regjistrohen edhe si institucione mikrofinanciare me kapital relativisht të madh dhe, si të tilla, mund të marrin pjesë gjithashtu në një masë të kufizuar në pronësinë e bankave. E gjithë ngre çështjen e një vlerësimi plotësues përkatës të rreziqeve të ndërlidhura dhe masave zbutëse, veçanërisht duke pasur parasysh burimet e rëndësishme që duhet të menaxhohen në parim.
118. Organizatat fetare (qendrat fetare) përjashtohen nga fushëveprimi i Ligjit për Lirinë e Asociimit të Organizatave Joqeveritare dhe nuk kërkohet autorizim për to. Nuk është ofruar fare informacion për ekipin e vlerësimit në lidhje me profilin e rrezikut dhe gjasat e keqpërdorimit në atë sektor.
119. **Kriteri 8.1** (*Nuk është përmbushur*) – Autoritetet e Kosovës kanë ndërmarrë, por ende nuk kanë përfunduar, një vlerësim përkatës të rreziqeve sektoriale të OJQ-ve që do të lejonte identifikimin gjithëpërfshirës dhe të duhur të të gjitha OJQ-ve që do të bien nën përkufizimin e FATF-së (pavarësisht përpjekjeve të rëndësishme në zgjedhjen e shembullit të duhur të OJQ-ve për qëllimet e vlerësimit të rrezikut sektorial). Për më tepër, vlerësimi synonte të identifikojë natyrën e kërcënimeve të paraqitura për OJQ-të, të shqyrtojë përshtatshmërinë e masave në funksion të reagimeve proporcionale dhe të kryejë një rivlerësim periodik të rreziqeve. Në të njëjtën kohë, vihet re se të gjitha OJQ-të vazhdojnë të jenë subjekte raportuese sipas ligjit të ri për PPP/LFT-në, me detyrime edhe më të gjera krahasuar me legjislacionin e mëparshëm. Kjo lidhet me kuptimin e rreziqeve të qenësishme që lidhen me sektorin e OJQ-ve nga autoritetet kosovare, megjithëse ky kuptim është ende i hapur për diskutim duke marrë parasysh mungesën e informacionit të mëtejshëm mbi konkluzionet dhe disponueshmërinë e kufizuar të informacionit për të vërtetuar këto rreziqe në lidhje me secilën nga autoritetet kompetente.
120. **Kriteri 8.2** (*Pjesërisht i përmbushur*) – (a) Ligji për Lirinë e Asociimit të OJQ-ve dhe Ligji për PPP/LFT-në përcaktojnë kërkesat lidhur me promovimin e përgjegjshmërisë, integritetit dhe besimit të publikut në administrimin dhe menaxhimin e OJF-ve. Këto përfshijnë kërkesat për regjistrimin pranë autoritetit kompetent në Ministrinë e Administratës Publike (Departamenti për Regjistrimin dhe Ndërlidhjen me OJQ-të (DRNOJQ)), si dhe paraqitjen e një sërë informacionesh mbi themeluesit, përfaqësuesit e autorizuar, organin drejtues, bordin, qëllimin dhe shkallën e aktiviteteve, dhe procedurat për zgjedhjen dhe shkarkimin e anëtarëve drejtues. Ekzistojnë kërkesa të hollësishme në lidhje me qeverisjen e brendshme dhe konfliktet e interesit etj. OJQ-të që kanë statusin e përfituesit publik u nënshtrohen kërkesave të mëtejshme raportuese në pajtim me nenet 17-19 të Ligjit për Lirinë e Asociimit të OJQ-ve (Ligji për OJQ-të). Autoriteti kompetent për regjistrim gjithashtu mund të kërkojë informacione të mëtejshme në lidhje me dokumentet specifike që duhet të dorëzohen për regjistrim dhe të përditësohen rregullisht ose kur ndodh një ndryshim. Të gjitha informacionet që lidhen me regjistrimin duhet të jenë në dispozicion të publikut.
121. Neni 29 i Ligjit për PPP/LFT-në përcakton procedurat e mëtejshme të llogaridhënies duke përfshirë kufizimet për transaksione të caktuara në para të gatshme, mbajtjen e të dhënave për të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet, emërimin e një zyrtari të pajtueshmërisë (i cili, sipas nenit 21, teorikisht duhet t'i nënshtrohet vlerësimit sipas kriterëve "i duhur" dhe "i përshtatshëm") dhe parandalimin e keqpërdorimit duke kërkuar nga OJQ-të që të marrin masat e përshtatshme të kujdesit të duhur.
122. Sidoqoftë, aspektet pozitive të regjimit janë komprometuar nga mangësi të caktuara, disa prej të cilave janë vërejtur në raportin e mëparshëm të vlerësimit. Këto përfshijnë mungesën e përshtatshmërisë dhe kërkesat korresponduese përkatëse në Ligjin për OJQ-të, si dhe kufizimet e kompetencave të autoritetit kompetent për të kërkuar informacione të mëtejshme, përfshirë pasurinë dhe burimet e përdorura. Arsyet për mohimin e regjistrimit nuk duket të kenë plotësisht në konsideratë rreziqet e rëndësishme që lidhen me FT-në ose pastrimin e parave siç dëshkohet nga përfshirja e OJQ-ve si një kategori sipas kërkesave të PPP/LFT-së. Vërehet, në të njëjtën kohë, se nuk ekzistojnë kërkesa për identifikimin e pronësisë përfituese të OJQ-ve (veçanërisht aty ku ato mund të ndryshojnë nga themeluesit ose drejtuesit për shkak të kontrollit indirekt). Një tjetër çështje e ngjashme duket të lindë nga mungesa e kërkesës për personat fizikë të përfshirë në drejtim për të paraqitur të dhënat e plota të identifikimit gjatë regjistrimit ose përditësimit (përveç emrave dhe adresës). Një çështje gjithashtu mund të lidhet me kërkesat për paraqitjen e pasqyrave financiare për OJQ-të me status të përfituesit publik që nuk duket se janë në përputhje me standardet e miratuara të kontabilitetit në lidhje me personat e

tjerë juridikë (p.sh. ndryshe nga ato që zbatohen për OJQ-të që janë IMF sipas Ligjit për Bankat).

123. **Kriteri 8.2(b)** – Autoritetet e Kosovës kanë ndërmarrë një fushatë informuese bazuar në disa strategji kombëtare të përqendruara në financimin e terrorizmit, terrorizmin, ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizimin. Në pajtim me nenin 14, paragrafi 1.9 të Ligjit për PPP/LFT-në, NjIF-i duhet të organizojë dhe kryejë trajnime të rregullta, përfshirë vetëdijesim dhe sensibilizim në lidhje me parandalimin e pastrimit të parave, veprave të ndërlidhura penale dhe financimin e terrorizmit si dhe detyrimet e subjekteve raportuese. Kjo kërkesë mbulon të gjitha subjektet raportuese, përfshirë OJQ-të.
124. Në të njëjtën kohë, vërehet se Ligji për OJQ-të nuk përmban kërkesa të shprehura për mbulimin me kontaktim dhe informim. Autoritetet tatimore kryejnë informimin e OJQ-ve brenda fushës së kompetencës së tyre.
125. **Kriteri 8.2(c)** – Nuk ka kërkesa formale apo ndonjë veprim material të ndërmarrë që do të plotësonin këtë kriter dhe që sigurojnë bashkëpunim me OJQ-të, edhe pse OJQ-të janë përfshirë në grupin e punës të krijuar për të vlerësuar rreziqet sektoriale.
126. **Kriteri 8.2(d)** – Ky kriter mbulohet nga kërkesat e nenit 29, paragrafët 1 dhe 2 të Ligjit për PPP/LFT-në, i cili ka përfshirë kërkesa të qarta për kryerjen e të gjitha transaksioneve të të ardhurave dhe shpenzimeve nëpërmjet bankave dhe institucioneve financiare të licencuara nga BQK-ja. Kjo kërkesë nuk zbatohet në lidhje me p.sh. transaksionet në mallra (siç janë donacionet në natyrë, ose furnizimi në natyrë për përfituesit).
127. **Kriteri 8.3** (*Kryesisht i përmbushur*) – Masa shtesë vlejné lidhur me numrin e OJQ-ve që janë përfituese publike si dhe për OJQ-të që janë po ashtu IMF. Në të njëjtën kohë, nuk është demonstruar se këto masa shtesë janë të lidhura me rrezikun e FT-së dhe jo kryesisht në p.sh. rreziqet e keqpërdorimit tatimor ose shpërdorimet e fondeve shtetërore.
128. **Kriteri 8.4** (*Pjesërisht i përmbushur*) – Çështjet që lidhen me mbikëqyrjen nga DRNOJQ-ja janë shënuar siç duhet në raportin e mëparshëm të vlerësimit dhe janë ende të vlefshme në kontekstin e kriterit 8.3. Dispozita përkatëse e Ligjit për PPP/LFT-në (neni 34) ende kërkon që kompetenca përkatëse e DRNOJQ-së të zbatohet në mënyrë efektive në lidhje me çështjet e mbikëqyrjes së kujdesshme, por edhe në aspektin e parandalimit të PPP/LFT-së që duket se i është besuar mbikëqyrësve të kujdesshëm gjithashtu. Çështja do të komplikohet më tej nga përgjegjësia mbikëqyrëse e BQK-së mbi aktivitetet specifike të IMF-ve si OJQ.
129. Këto çështje janë përkeqësuar më tej nga mungesa e një qasjeje të synuar në mbikëqyrje bazuar në vlerësimin e rrezikut dhe duke u përqendruar në OJF-të në rrezik.
130. Ligji për OJQ-të parasheh sanksione për pezullimin ose revokimin e regjistrimit si dhe revokimin e statusit të përfituesit publik të OJQ-ve. Në të njëjtën kohë, mbeten mangësitë siç u përmendën më parë në lidhje me p.sh. kërkesën për shpërndarjen e të ardhurave dhe përditësimin e informacionit mbi menaxhimin. Në pajtim me nenin 11 të Ligjit për OJQ-të, zyrtarët, drejtorët dhe punonjësit e OJQ-ve të regjistruara janë personalisht përgjegjës për shkeljet që shkaktohen me dashje, me pakujdesi ose me moskryerje të detyrës, por nuk ka dispozita korresponduese për të siguruar që ky detyrim realizohet në praktikë me anë të çfarëdo sanksionesh. Po ashtu nuk është e qartë se si do të zbatohen në praktikë dispozitat e neneve 13 deri 16 të Ligjit për OJQ-të në lidhje me udhëheqjen e brendshme, operacionet financiare ose konfliktet e interesit.
131. Shkeljet e dispozitave të Ligjit për PPP/LFT-në nga OJQ-të konsiderohen të rënda dhe i nënshtrohen sanksionimit sipas nenit 44 të ligjit. Sanksionet që mund të konsiderohen efektive, proporcionale dhe zbindëse në lidhje me OJQ-të mund të vendosen gjithashtu te personat fizikë përgjegjës për shkeljet sipas nenit 44, paragrafi 2.
132. **Kriteri 8.5** (*Pjesërisht i përmbushur*) (**a**) – Ligji për OJQ-të nuk parasheh ndonjë mekanizëm në lidhje me bashkëpunimin e autoritetit kompetent sipas ligjit (DRNOJQ). Për më tepër, nuk është siguruar ose kërkohet që të krijohet ndonjë mekanizëm nëpërmjet instrumenteve ligjore shtesë në lidhje me bashkëpunimin e mundshëm me autoritetet e tjera të cilat mund të kenë rëndësi të madhe për mbikëqyrjen e OJQ-ve, përfshirë BQK-në (mbi IMF-të), autoritetet tatimore (pasi përjashtimet tatimore dhe respektivisht rimëkëmbja në rast të revokimit janë thelbësore dhe një numër kufizimesh vlejné për aktivitetet e OJQ-ve), autoritetet doganore (në lidhje me paratë e bartura përtej kufirit dhe që potencialisht kontribuojnë në aktivitetet e OJQ-ve, donacionet në natyrë etj.), NjIF-i (çdo dyshim të PP/FT-së ose veprës së ndërlidhur penale, kontrollet e listave të RKSKB-ve,

etj.), AZL-të (në lidhje me çështjet nëse menaxhimi dhe pronësia e OJQ-ve janë të përshtatshme dhe të duhura), dhe regjistri i bizneseve. Një Marrëveshje Mirëkuptimi për shkëmbimin e informacionit ndërmjet NjIF-it dhe DRNOJQ-së u nënshkrua në vitin 2011, por nuk duket se mundëson procedura të qarta për shkëmbimin e informacionit për qëllime regjistrimi dhe as për përcaktimin për shembull nëse menaxhimi dhe pronësia e OJQ-ve janë të përshtatshme dhe të duhura. Asnjë informacion nuk është ofruar për praninë e ndonjë marrëveshje bashkëpunimi që mund të jetë e rëndësishme në këtë rrethanë.

133. Një shqetësim tjetër mbetet mungesa e kompetencave të DRNOJQ-së për të kërkuar të gjithë informacionin përkatës nga OJQ-të, përveç nëse është pjesë e procesit të regjistrimit. Çështja po përkeqësohet edhe nga interpretimi i Ligjit për OJQ-të nga vetë DRNOJQ-ja në kuptimin që nuk ka ndonjë kompetencë për të kryer mbikëqyrje të kujdesshme të OJQ-ve. Kështu, disa kufizime dhe kërkesa për aktivitetet e OJQ-ve i lihen lirisë së veprimit të OJQ-ve pa ndonjë aftësi për të konstatuar zbatimin e tyre, përfshirë aktivitetet e OJQ-ve me status të përfituesit publik, shpërndarjen e pasurive të mbetura të OJQ-së pas revokimit të regjistrimit, transaksionet me subjektet e lidhura, kufizimet në shpërndarjen e dividendëve dhe fitimit, veprimtaritë e OJQ-ve që mbeten në mënyrë të rreptë brenda kufijve të Instrumenteve Themeluese ose statuteve, dhe financimi i partive politike etj. Kështu, asnjë instrument për të identifikuar informata të tilla të rëndësishme nuk mund të gjendet në nivelin e parë të mbikëqyrjes së OJQ-ve (p.sh. autoriteti regjistruar).
134. NjIF-i në anën tjetër ka qasje të gjerë në informata nga subjektet raportuese (në pajtim me nenin 14, paragrafi 4 dhe nenin 29 të Ligjit për PPP/LFT-në). Çështja e lartpërmendur lidhur me qasjen e informacionit specifik në informatat e OJQ-ve dhe kufizimet potenciale duhet të sqarohet në këtë drejtim. Në të njëjtën kohë, vërehet se këto informata të OJQ-ve nuk janë informacione të pranuar apo qasura në mënyrë sistematike (p.sh. informata mbi të ardhurat dhe shpenzimet ofrohen nga OJQ-të sipas kërkesës në bazë të nenit 29) dhe për këtë arsye kufizon disi aftësinë e autoriteteve për të identifikuar rastet e keqpërdorimit të OJQ-ve duke marrë parasysh kompetencat e lartpërmendura të DRNOJQ-së. NjIF-i i kërkohet të bashkëpunojë me të gjitha autoritetet përkatëse në pajtim me nenin 14, paragrafi 3 të Ligjit për PPP/LFT-në, por as në këtë rast nuk ofrohet informacion i mtejshëm për ndonjë procedurë dhe rregullore specifike në lidhje me bashkëpunimin me DRNOJQ-në. Për më tepër, interpretimi i ekipit vlerësues i nenit 15 të Ligjit për PPP/LFT-në do të ishte që nuk mund të sigurohej ndonjë shpërndarje specifike nga burimet vetjake të NjIF-it të DRNOJQ, p.sh. në kuadër të aktivitetit të vet për të përcaktuar nëse ekzistojnë rreziqe keqpërdorimi për qëllime të FT-së. Nuk është e qartë nëse NjIF-i (ose ndonjë autoritet tjetër) gjithashtu shkëmben informacion me DRNOJQ-në në mënyrë të rregullt në lidhje me personat e përcaktuar në kuadër të RSKB-ve, të cilat duhet të jenë jashtëzakonisht të rëndësishme duke marrë parasysh mangësitë në zbatimin e sanksioneve të shënjestrura siç kërkohet në Rekomandimin 6 të FATF-së.
135. **Kriteri 8.5 (b)** (*Nuk është përmbushur*) – Asnjë informacion nuk është dhënë nga autoritetet e Kosovës në lidhje me ndonjë ekspertizë dhe ngritje të kapaciteteve, procedurave të veçanta operative ose mekanizmave të tjerë që plotësojnë këtë kriter.
136. **Kriteri 8.5(c)** (*Pjesërisht i përmbushur*) – Kriteri mund të përmbushet vetëm pjesërisht në varësi të mbështetjes të procedurave në Ligjin për OJQ-të dhe informatat e qasura dhe të përpunuara nga DRNOJQ për kufizimet e lartpërmendura. Vërehet gjithashtu se nuk ka në dispozicion të dhëna të plota dhe të përditësuara të të gjithë personave që kanë të bëjnë me pronësinë dhe menaxhimin e OJQ-ve, si dhe mangësitë e lartpërmendura të lidhura me mungesën e kërkesave për identifikimin e duhur të pronësisë përfituese të OJQ-ve.
137. **Kriteri 8.5(d)** (*I përmbushur*) – NjIF-i ka kompetenca të gjera për të kërkuar informata nga OJQ-të duke konsideruar se ato janë subjekte raportuese sipas Ligjit për PPP/LFT-në përveç detyrimeve të tjera sipas Ligjit për PPP/LFT-në. Përveç kësaj, NjIF-i është e autorizuar që të sigurojë informacionin përkatës për qëllimet e këtij kriteri. Mund të lindë një çështje në lidhje me sigurimin e informatave të duhura, në kohë dhe të rregullta për OJQ-të lidhur me personat e përcaktuar nga RSKB-të përkatëse.
138. **Kriteri 8.6** (*I përmbushur*) – NjIF-i u bë anëtare e Grupit Egmont në vitin 2017, duke respektuar parimet e tij të shkëmbimit të informacionit, përfshirë edhe qëllimet e kriterit 8.6. Autoritetet e Kosovës gjithashtu angazhohen në bashkëpunimin policor nëpërmjet Njësisë për Bashkëpunim Ndërkombëtar në Zbatimin e Ligjit (ILECU). Në të njëjtën kohë, instrumenti i ndihmës së ndërsjellë juridike është gjithashtu i zbatueshëm përgjatë linjave të përshkruara në Rekomandimin 37.

Vlerësimi dhe përfundimi

139. Mungesa e qasjes së bazuar në rrezik, ndikon negativisht në të gjitha masat e tjera. Ka mangësi të konsiderueshme në lidhje me regjistrimin, sensibilizimin dhe mbikëqyrjen e sektorit për qëllimet e LFT-së.
140. **Kosova është pjesërisht në përputhje me Rekomandimin 8.**

Rekomandimi 9 – Ligjet e fshehtësisë për institucionet financiare

141. Në Raportin e Vlerësimit për PPP/LFT-në të vitit 2014, Kosova u vlerësua kryesisht në përputhje me Rekomandimin e mëparshëm 4 të FATF-së. Vlerësimi identifikoi se kishte nevojë për qartësi ligjore për të hequr fshehtësinë për BQK-në në lidhje me dispozitat e Ligjit për PPP/LFT-në përtej çështjeve të kujdesit.
142. **Kriteri 9.1** (Kryesisht i përmbushur) – Analiza e ligjeve të fshehtësisë së institucioneve financiare në raport me zbatimin e papenguar të masave për PPP/LFT-në në Kosovë është dhënë më poshtë:
143. *Qasja në informacion nga autoritetet kompetente* – Sipas nenit 63 të Ligjit për PPP/LFT-në, fshehtësia profesionale nuk mund të përdoret si arsye për refuzimin e sigurimit të informatave që duhen zbuluar apo të mblidhen dhe ruhen në pajtim me Ligjin dhe kërkojnë qoftë nga NjIF-i, qoftë nga policia lidhur me një hetim për PP/FT-në të urdhëruar apo të kryer nën mbikëqyrjen e prokurorit apo gjyqtarit hetues. Kjo dispozitë nuk cenon informacionin që i nënshtrohet privilegjit të avokatit-klientit siç përcaktohet në paragrafin 7 të nenit 31 dhe paragrafin 5.2 të nenit 35 të Ligjit për PPP/LFT-në.
144. *Shkëmbimi i informacioneve ndërmjet autoriteteve vendore kompetente* – Paragrafi 1 i nenit 15 të Ligjit për PPP/LFT-në përcakton që NjIF-i mund të shpallë vetëm informacionin si më poshtë tek organet publike apo qeveritare ose te subjektet raportuese, nëse shpallësja e tillë konsiderohet si e nevojshme nga NjIF-i, apo do t'i shërbente ose do të ndihmonte NjIF-in që të kryejë detyrat e veta. Një informacion i tillë mund të përfshijë të gjitha të dhënat identifikuese për një person ose subjekt, mbi një transaksion, si dhe çdo e dhënë tjetër që gjykohej e përshtatshme për parandalimin dhe luftimin e PP-së, veprave penale të ndërlidhura dhe FT-së. Sipas paragrafit 2 të të njëjtit nen, informacioni mund të zbulohet tek autoritetet vendore me kompetenca përkatëse, përfshirë organet e zbatimit të ligjit. Autoritetet gjithashtu i referohen marrëveshjes së mirëkuptimit të arritur në prill të vitit 2011 ndërmjet Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Financave dhe Prokurorit të Shtetit për shkëmbimin e informacioneve për funksionalizimin e Njësisë Bashkërenduese Ndërkombëtare për Zbatimin e Ligjit (ILECU) në Policinë e Kosovës si një mjet plotësues që lehtëson ndarjen e informacionit midis autoriteteve vendore kompetente.
145. Paragrafi 2 i nenit 38 të Ligjit për PPP/LFT-në përcakton që BQK-ja dhe mbikëqyrësit e tjerë sektorialë duhet të informojnë menjëherë me shkrim NjIF-in sa herë që, gjatë kryerjes së detyrave brenda kompetencave të tyre, dyshojnë apo identifikojnë aktivitete që janë ose mund të jenë të lidhura me PP/FT-në. Paragrafi 2 i nenit 74 të Ligjit për BQK-në përcakton se, pavarësisht nga kërkesat e fshehtësisë të vendosura mbi BQK-në, ajo mund të zbulojë informacione jopublike tek autoritetet rregullatore dhe mbikëqyrëse gjatë kryerjes së detyrave të saj.³⁴
146. Në të njëjtën kohë, nuk është e qartë nëse mund të merren informata nga autoritetet kompetente që kanë të bëjnë me analizën strategjike duke pasur parasysh se asnjë dispozitë specifike për marrjen e informacionit nga autoritetet kompetente (p.sh. autoritetet mbikëqyrëse ose mbikëqyrësi i OJF-ve) për qëllimin konkret të identifikimit të tendencave është përfshirë në Ligjin për PPP/LFT-në. Prandaj, nuk është e qartë nëse mund të bëhet thirrje në kufizime të fshehtësisë profesionale, për të parandaluar një bashkëpunim të tillë, pasi përjashtimi sipas nenit 63 i referohet në përgjithësi informacionit të shpallur sipas Ligjit për PPP/LFT-në. Një shembull është Ligji për bankat, i cili në nenin 80 parashikon zbulimin e informacionit të marrë nga BQK-ja në bazë të kushteve të fshehtësisë vetëm në pajtim me Ligjin për BQK-në.

³⁴ Nenet 83 dhe 113 të Ligjit për Bankat, IMF-të dhe IFJB-të kërkojnë që të gjitha institucionet financiare në Kosovë të jenë në pajtim me Ligjin për PPP/LFT-në dhe neni 23 i Ligjit për BQK-në e autorizon këtë të fundit që të mbikëqyrë të gjitha institucionet financiare në Kosovë për pajtueshmëri me legjislacionin.

147. *Shkëmbimi i informacioneve ndërmjet autoriteteve kompetente në nivel ndërkombëtar* – Paragrafi 4 i nenit 15 të Ligjit për PPP/LFT-në përcakton se NjIF-i mund të shkëmbejë ndërkombëtarisht të gjitha informatat që mund të jenë të arritshme apo të qasshme, spontanisht ose me anë të kërkesës, me çdo homolog të huaj që kryen funksione të ngjashme dhe që u nënshtrohet detyrimeve të ngjashme për ruajtjen e konfidencialitetit, pavarësisht nga natyra e homologut, dhe brenda kornizës ligjore vendore të secilës palë. Informacioni i shkëmbyer përdoret vetëm për qëllimin e kërkuar, me pëlqimin paraprak të agjencisë që e ka dhënë atë dhe vetëm për qëllime të luftimit të PP-së, veprave penale të ndërlidhura dhe FT-së.
148. Nuk ka kërkesa ligjore lidhur me NNJ-në ose llojet e tjera të bashkëpunimit të AZL-ve nën analizat përkatëse sipas Rekomandimeve 37-40 për të vendosur kushte tepër të kufizuara për shkëmbimin e informacionit, përfshirë mundësinë për të shkëmbyer informata ku përfshihen çështjet tatimore, fshehtësia profesionale (neni 63 i Ligjit për PPP/LFT-në), si dhe natyra e statusi i autoritetit homolog (brenda qëllimeve të përcaktuara të ligjit).
149. Dispozita në paragrafin 2 të nenit 74 të Ligjit për BQK-në, i cili lejon që ajo të japë informacione jopublike tek autoritetet rregullatore dhe mbikëqyrëse gjatë kryerjes së detyrave të tyre, mund të interpretohet duke përfshirë dhënien e informacioneve shpjeguese autoriteteve rregullatore dhe mbikëqyrëse të huaja po ashtu.
150. Paragrafi 1 i nenit 79 të Ligjit për Bankat, IMF-të dhe IFJB-të përcakton se BQK-ja mund të shkëmbejë informacione mbi çështjet mbikëqyrëse me autoritetet mbikëqyrëse financiare në Kosovë dhe në vende të tjera. Shkëmbimi i një informacioni të tillë mund të përfshijë informata konfidenciale, me kusht që BQK-ja të jetë e kënaqur që informacioni do të përdoret për qëllime mbikëqyrëse dhe do t'i nënshtrohet një trajtimi konfidencial që është i ngjashëm me atë që do të kërkohej nga BQK-ja.
151. *Shkëmbimi i informacioneve ndërmjet institucioneve financiare* – Ligji për PPP/LFT-në parasheh detyrimin e bankave dhe institucioneve të tjera financiare që të marrin masat në lidhje me institucionet përgjegjëse në rastin e bankave korrespondente ndërkufitare ose marrëdhënieve të tjera të ngjashme siç është përcaktuar në Rekomandimin 13 (paragrafi 4 i nenit 22), për të marrë dhe për të transmetuar informacionet e nevojshme tek institucionet financiare përfituese në rastin e transfertave bankare siç parashihet në Rekomandimin 16 (paragrafët 6 dhe 7 të nenit 24) dhe të zbatojnë programet për PPP/LFT-në, përfshirë politikat dhe procedurat e shkëmbimit të informacionit siç përcaktohet në Rekomandimin 18 (paragrafi 5 i nenit 24). Në këtë drejtim, nuk është e qartë nëse ligjet e Kosovës pengojnë ndarjen e informacionit ndërmjet institucioneve financiare, kur kjo kërkohet me Rekomandimin 17.

Vlerësimi dhe përfundimi

152. Faktet dhe rrethanat në vijim janë konsideruar se përcaktojnë vlerësimin për Rekomandimin 9:
- Ekipit të vlerësimit nuk i janë ofruar referime në dispozitat ligjore që mundësojnë shkëmbimin e informacionit ndërkombëtarisht nga mbikëqyrësit e tjerë përveç NjIF-it dhe BQK-së për qëllime të PPP/LFT-së.
 - Nuk është e qartë nëse ligjet e Kosovës pengojnë shkëmbimin e informacionit ndërmjet institucioneve financiare, kur kjo kërkohet me Rekomandimin 17.
 - Nuk duket të jetë rasti që informacioni i nevojshëm për analizën strategjike të PPP/LFT-së të kryer nga NjIF-i mund të sigurohet nga autoritetet e tjera.
153. **Kosova është kryesisht në përputhje me Rekomandimin 9.**

Rekomandimi 10 – Kujdesi i duhur ndaj klientit

154. Në Raportin e Vlerësimit për PPP/LFT-në të vitit 2014, Kosova u vlerësua se ishte pjesërisht në përputhje me Rekomandimin e mëparshëm 5 të FATF-së. Vlerësimi identifikoi mangësi teknike të ndërlidhura, ndër të tjera, me këto çështje: paqartësi juridike mbi detyrimin për të zbatuar masat e plota të KDK-së; mungesë e ndalimit të qartë për mbajtjen e llogarive në emra fiktivë; prag i paqartë për transfertat bankare; detyrim i pamjaftueshëm ligjor për të identifikuar pronarin përfitues për marrëveshjet juridike dhe policat e sigurimit të jetës; mungesë e udhëzimit mbi detyrimin për të kuptuar strukturën e pronësisë dhe të kontrollit të klientit dhe qëllimin e natyrën e synuar të marrëdhënies së biznesit; detyrim i pamjaftueshëm për të ushtruar monitorim të vazhdueshëm të marrëdhënieve të biznesit në

të gjitha rrethanat përtej klientëve me rrezikshmëri të lartë; mungesë e udhëzimeve për zbatimin e qasjes së bazuar në rrezik; dhe, mospërputhje në kohën e procesit të verifikimit kundrejt kohës së procesit të identifikimit.

155. **Kriteri 10.1** (*I përmbushur*) – Paragrafi 1 i nenit 24 të Ligjit për PPP/LFT-në ndalon bankat dhe institucionet e tjera financiare të mbajnë llogari anonime apo llogari në emra fiktivë.

Kur kërkohet KDK-ja

156. **Kriteri 10.2** (*Pjesërisht i përmbushur*) – Paragrafi 2 i nenit 19 i Ligjit për PPP/LFT-në përcakton se subjektet raportuese duhet të zbatojnë masat e kujdesit të duhur ndaj klientit kur: 1) krijojnë marrëdhënie afariste; 2) kur realizojnë transaksione të rastit në para të gatshme në vlerë prej dhjetëmijë (10.000) euro ose më shumë, apo vlerës ekuivalente në valutë të huaj, nëse është kryer si një transaksion i vetëm ose disa transaksione që janë të ndërlidhura³⁵; 3) kur ekzistojnë dyshime rreth saktësisë dhe mjaftueshmërisë së të dhënave identifikuese të marra të klientit; dhe 4) kur ka dyshim për pastrim të parave ose financim të terrorizmit.³⁶ Autoritetet këshillojnë që termi “të ndërlidhura” interpretohet në kuptimin e “transaksioneve të shumëfishta” siç parashihet me paragrafin 2 të nenit 24 të Ligjit për PPP/LFT-në.

157. Për më tepër, paragrafi 2 i nenit 24 të Ligjit për PPP/LFT-në përcakton që, përveç detyrimeve të lidhura me KDK-në të përcaktuara në nenin 19 të ligjit, bankat dhe institucionet e tjera financiare duhet të verifikojnë identitetin dhe, në rastin e personave fizikë, gjithashtu verifikojnë datën e lindjes së të gjithë klientëve kur: 1) hapin llogari bankare; 2) pranojnë aksione, bono thesari, ose letra të tjera me vlerë për t’i ruajtur në kasafortë; 3) ofrojnë lehtësira për depozita të sigurta; 3) kryejnë transfertë bankare vendore ose ndërkombëtare të fondeve³⁷; 5) para kryerjes së transaksioneve të rastit; dhe 6) angazhohen në çdo transaksion të vetëm në para të gatshme³⁸ prej 10.000 euro ose më shumë. Në lidhje me këtë të fundit, transaksionet në para të gatshme të shumëfishta trajtohen si një transaksion i vetëm nëse banka ose institucioni financiar është në dijeni se transaksionet kryhen nga ose në emër të një personi ose subjekti dhe shuma e përgjithshme prej 10.000 euro ose më shumë është bërë në një ditë të vetme.

158. Prandaj, Ligji për PPP/LFT-në nuk kërkon që bankat dhe institucionet e tjera financiare të ndërmarrin të gjitha masat e zbatueshme të kujdesit të duhur të klientit (në krahasim me vetëm identifikimin e klientit dhe verifikimin e identitetit) në rast të: a) transaksioneve në para jo të gatshme³⁹ mbi pragun e përcaktuar prej 10.000 euro⁴⁰; dhe, b) transaksioneve që janë transferta bankare dhe kryhen nëpërmjet institucioneve financiare të ndryshme nga bankat.

Masat e kërkuara të KDK-së për të gjithë klientët

159. **Kriteri 10.3** (*Kryesisht i përmbushur*) – Sipas paragrafit 1.1 të nenit 19 të Ligjit për PPP/LFT-në, masat e KDK-së që zbatohen nga të gjitha subjektet raportuese përfshijnë identifikimin e klientit dhe verifikimin e identitetit të klientit “me anë të burimeve të pavarura, dokumenteve, të dhënave ose informacioneve të besueshme”. Sipas paragrafit 3.1 të të njëjtit nen, një person fizik identifikohet duke paraqitur një dokument zyrtar

³⁵ Nëse shuma e transaksionit nuk dihet në kohën e veprimt, identifikimi bëhet në momentin kur shuma bëhet e njohur ose pragu është arritur.

³⁶ Dispozita të ngjashme janë të përfshira në paragrafin 2 të nenit 17 të Rregullores së BQK-së për PPP/LFT-në.

³⁷ Paragrafi 2(e) i nenit 17 të Rregullores së BQK-së për PPP/LFT-në përdor shprehjen “gjatë kryerjes së një transferte elektronike goftë vendore apo ndërkombëtare” të fondeve, e cila mund të interpretohet në një mënyrë që kërkon identifikimin dhe verifikimin e identitetit në rast të të gjitha transfertave bankare dhe jobankare; megjithatë, përderisa kjo dispozitë përcakton detyrimet për subjektet raportuese përtej fushëveprimit dhe mbulimit të atyre të artikuluara në Ligjin për PPP/LFT-në, ajo mund të kundërshtohet në rast të një mosmarrëveshje ligjore.

³⁸ Autoritetet paraqesin se “transaksionet në para të gatshme” i referohen çdo lloj transaksioni (p.sh. depozita në para, transfertë elektronike, këmbim valutor, tërheqje e parave të gatshme).

³⁹ Për shembull, pranimit i çeqeve të udhëtarëve dhe të tjera, urdhërpagesat, tregtia në instrumente të tregut të parasë, letrat me vlerë të transferueshme etj.

⁴⁰ Pasi që dispozita në paragrafin 2 të nenit 24 të Ligjit për PPP/LFT-në për të gjitha transaksionet e rastit (pavarësisht nga shuma) kërkon identifikimin dhe vetëm verifikimin e identitetit, gjë që nuk përbën marrjen e të gjitha masave të zbatueshme të KDK-së.

original që nuk i ka skaduar afati⁴¹ në të cilin gjendet edhe fotografia e këtij personi. Adresa dhe data e lindjes së personit verifikohen me paraqitjen e dokumenteve të cilat ofrojnë dëshmi. Këtu, formulimi "më anë të burimeve të pavarura, dokumenteve, të dhënave ose informacioneve të besueshme", që përcaktohen si "burime të pavarura" një subjekt që nuk lidhet dhe nuk përshkruan domosdoshmërisht cilësitë e "dokumenteve, të dhënave ose informacioneve të besueshme", krijon pasiguri nëse kërkesa e FATF-së për të "përdorur dokumente, të dhëna ose informacion të besueshme nga burime të pavarura" është plotësuar.

160. Hollësitë e identifikimit dhe verifikimit të identitetit të subjekteve juridike siç janë shoqëritë tregtare, OJQ-të ose subjektet politike (siç janë përcaktuar në paragrafin 3.2 të nenit 19 të Ligjit për PPP/LFT-në), si dhe të subjekteve dhe marrëveshjeve të tjera juridike (të përcaktuara në paragrafin 4 të nenit 19 të Ligjit për PPP/LFT-në) janë paraqitur në analizën për kriterin 10.9 më poshtë.
161. **Kriteri 10.4** (*Pjesërisht i përmbushur*) – Paragrafi 7 i nenit 19 të Ligjit për PPP/LFT-në përcakton që personat që veprojnë si agjentë të autorizuar duhet të paraqesin dokumente në pajtim me paragrafin 3 të këtij neni për vete dhe për personin ose subjektin autorizues si dhe duhet të japin një dokument që i autorizon ata të kryejnë transaksione në emër të atij personi ose subjekti. Për rrjedhojë, kjo kërkesë nuk mbulon situatat në të cilat subjektet raportuese: a) angazhohen në marrëdhënie me persona që pretendojnë të veprojnë në emër të klientit përtej fushëveprimit të kryerjes së transaksioneve (domethënë kur ata përpiqen të krijojnë marrëdhënie biznesi pa kryer një transaksion); dhe b) merren me personat juridikë, përveç shoqërive tregtare, OJQ-ve ose subjekteve politike të përcaktuara në paragrafin 3.2 të nenit 19 të Ligjit për PPP/LFT-në, si dhe me marrëveshjet juridike.
162. Përveç kësaj, kërkesa për agjentët e autorizuar për paraqitjen e dokumenteve të caktuara nuk përbën një kërkesë që subjektet raportuese të "identifikojnë dhe të verifikojnë identitetin e ... çdo personi që pretendon të veprojë në emër të klientit" siç kërkohet sipas kriterit 10.4.
163. Dispozita në paragrafin 8 të nenit 19 të Ligjit për PPP/LFT-në që thotë se, pavarësisht nga të vepruarit në pajtueshmëri me paragrafët 3 deri në paragrafin 7 të këtij neni (domethënë ato për identifikimin dhe verifikimin e identitetit të klientëve dhe agjentëve të autorizuar), "subjekti raportues merr masat e duhura shtesë për të identifikuar çdo person ose subjekt në emër të të cilit personi që përfshihet në një transaksion vepron... [si klient që i nënshtrohet KDK-së], duke përfshirë edhe pronarin ose mbajtësin e të drejtës së pronësisë", nuk është mjaft e qartë për të dhënë një fushë specifike të objekteve dhe subjekteve, si dhe veprimet që duhen ndërmarrë sipas kësaj dispozite.
164. **Kriteri 10.5** (*Pjesërisht i përmbushur*) – Paragrafi 1.36 i nenit 1 të Ligjit për PPP/LFT-në e përcakton pronarin përfitues si person fizik i cili përfundimisht zotëron ose kontrollon klientin dhe/ose personin fizik në emër të të cilit është duke u kryer një transaksion apo aktivitet ose personi i cili kryesisht ushtron kontroll efektiv mbi një subjekt juridik ose marrëveshje juridike. Ky përkufizim është përafërsisht i atij nga fjalori i FATF-së. Hollësitë e përkufizimit të pronarëve përfitues të subjekteve dhe marrëveshjeve juridike, si dhe të informacionit të përdorur për identifikimin dhe verifikimin e identitetit janë paraqitur në analizën për kriteret 10.10-10.11.
165. Sipas paragrafit 1.2 të nenit 19 të Ligjit për PPP/LFT-në, masat e KDK-së që zbatohen nga të gjitha subjektet raportuese përfshijnë "identifikimin e pronarit përfitues" dhe, kur subjektet raportuese konsiderojnë se rreziku i PP/FT-së është i lartë, ato marrin "masa të arsyeshme për të verifikuar identitetin e tij" në mënyrë që të ky të bindet se ata e dinë se kush është pronari përfitues. Për pasojë, kjo dispozitë nuk kërkon që subjektet raportuese: a) të përdorin informata ose të dhëna përkatëse nga një burim i besueshëm kur marrin masa të arsyeshme për të verifikuar identitetin e pronarit përfitues, dhe b) të marrin masa të tilla në situata të ndryshme nga ato që konsiderohen të jenë me rrezikshmëri të lartë.⁴²

⁴¹ Autoritetet parashtrojnë se "dokumenti zyrtar" nënkupton një dokument të lëshuar nga autoritetet përgjegjëse (p.sh. një pasaportë, patentë shoferi, dokument identifikimi) që mban fotografi dhe të dhëna personale të mbajtësit (p.sh. emri, mbiemri, data e lindjes dhe numri identifikues personal), të përcaktuar në Ligjin nr. 03/L-037 për Dokumentet e Udhëtimit, Ligjin nr. 03/L-099 për Letërnjoftimin etj.

⁴² Sipas paragrafit 2(b) të nenit 8 të Rregullores së BQK-së për PPP/LFT-në, kujdesi i duhur i klientit përfshin "përcaktimin e pronarit përfitues dhe marrjen e masave të duhura të bazuara në rrezik për të verifikuar identitetin e tij/saj", që mund të interpretohet në një mënyrë që kërkon zbatimin e masave të arsyeshme

166. **Kriteri 10.6** (*I përmbushur*) – Sipas paragrafit 1.3 të nenit 19 të Ligjit për PPP/LFT-në, masat e KDK-së që zbatohen nga të gjitha subjektet raportuese përfshijnë të kuptuarit dhe marrjen e informacionit për qëllimin dhe natyrën e synuar të marrëdhënies së biznesit.
167. **Kriteri 10.7** (*Pjesërisht i përmbushur*) – Sipas paragrafit 1.4 të nenit 19 të Ligjit për PPP/LFT-në, masat e KDK-së që duhet të aplikohen nga të gjitha subjektet raportuese përfshijnë "kryerjen e monitorimit në vazhdimësi të marrëdhënies së biznesit, përfshirë mbikëqyrjen e transaksioneve të kryera gjatë gjithë kësaj marrëdhënie, për të siguruar që transaksionet të cilat po kryhen janë në pajtim me njohuritë për klientin, profilin e biznesit dhe të rrezikut, përfshirë, aty ku është e nevojshme, burimin e fondeve dhe garantimin që dokumentet, të dhënat ose informacionet mbahen të rifreskuara".
168. Paragrafi 1 i nenit 22 të Ligjit për PPP/LFT-në më tej përkufizon se kur subjektet raportuese përcaktojnë se rreziku i pastrimit të parave apo financimit të terrorizmit është ngritur, ata marrin masa të arsyeshme për "të mbajtur të përditësuar informacionet e mbledhura në pajtim me nenin 19", masa për të zvogëluar këto rreziqe dhe zbatojnë masat e nevojshme të kujdesit të duhur të shtuar për të monitoruar profilin e biznesit dhe të rrezikut, duke përfshirë burimin e fondeve, dhe "të sigurojnë që të dhënat dhe informacionet e tjera janë mbajtur të përditësuar".
169. Dispozitat e mësipërme në nenet 19 dhe 22 sigurisht që e përsërisin njëra-tjetrën duke kërkuar të mbajnë të përditësuar "dokumente, të dhëna ose informacione" në një rast dhe "të dhënat dhe informacionet e tjera" në rastin tjetër, duke krijuar kështu pasiguri nëse këto kërkesa lidhen në të njëjtin fushëveprim (ose të ndryshëm) dhe përbërjen e "dokumenteve, të dhënave ose informacionit të mbledhur në procesin e KDK-së" siç kërkohet në kriterin 10.7(b). Ekziston një tjetër mbivendosje dy herë brenda tekstit të paragrafit 1 të nenit 22 kur kërkohet për të mbajtur të përditësuar "informacionet e mbledhura në pajtim me nenin 19" dhe "të dhënat dhe informacionet e tjera".
170. Asnjë nga dispozitat e mësipërme nuk u kërkon subjekteve raportuese që të sigurojnë që dokumentet, të dhënat ose informatat e mbledhura në procesin e KDK-së janë "të rëndësishme" dhe se kjo arrihet "duke ndërmarrë shqyrtime të të dhënave ekzistuese", gjë në fakt është e ndryshme nga "monitorimi në vazhdimësi i marrëdhënies së biznesit" ku duhet të referohet dispozita në paragrafin 1.4 të nenit 19.

Masat specifike të KDK-së që kërkojnë për personat juridikë dhe marrëveshjet juridike

171. **Kriteri 10.8** (*Pjesërisht i përmbushur*) – Sipas paragrafit 1.2 të nenit 19 të Ligjit për PPP/LFT-në, në rastin e identifikimit të pronarit përfitues të klientit, kur subjektet raportuese konsiderojnë se rreziku i PP/FT-së është i lartë, atyre u kërkohet të marrin masa të përshtatshme dhe të bazuara në rrezik për të kuptuar strukturën e pronësisë dhe të kontrollit të klientëve që janë persona juridikë, truste dhe marrëveshje juridike të ngjashme. Prandaj, kjo dispozitë nuk kërkon që subjektet raportuese të kuptojnë strukturën e pronësisë dhe kontrollit të klientëve në situata të ndryshme nga ato që konsiderohen të jenë me rrezikshmëri të lartë⁴³. Për më tepër, kërkesa për të marrë "masa të bazuara në rrezik" duket se shkon përtej kërkesës së FATF-së sipas kriterit 10.8, për aq sa mund të interpretohet se lejon marrjen e shumë pak (ose aspak të) masave drejt kuptimit të strukturës së pronësisë dhe kontrollit të klientit sa herë që rreziku i PP/FT-së konsiderohet të jetë i mesëm ose i ulët.
172. Sipas paragrafit 1.3 të nenit 19 të Ligjit për PPP/LFT-në, masat e KDK-së që zbatohen nga të gjitha subjektet raportuese përfshijnë të kuptuarit dhe marrjen e informacionit për qëllimin dhe natyrën e synuar të marrëdhënies së biznesit, të tilla që subjektet raportuese mund të zhvillojnë profilin e biznesit dhe rrezikut të klientëve të tyre.

për verifikimin e identitetit të pronarit përfitues në situata të ndryshme nga ato që konsiderohen të rrezikshme; megjithatë, përderisa kjo dispozitë përcakton detyrimet për subjektet raportuese përtej fushëveprimet dhe mbulimit të atyre të artikuluar në Ligjin për PPP/LFT-në, ajo mund të kundërshtohet në rast të një mosmarrëveshje ligjore.

⁴³ Sipas paragrafit 4 të nenit 10 të Rregullores së BQK-së për PPP/LFT-në, për klientët të cilët janë persona juridikë, institucionet financiare duhet të "marrin masa të konsiderueshme, që të zbulojnë pronarët dhe strukturën e kontrollit të subjektit", e cila mund të interpretohet në një mënyrë që kërkon të kuptojë strukturën e pronësisë dhe kontrollit të klientëve në situata të ndryshme nga ato që konsiderohen të jenë me rrezikshmëri të lartë; megjithatë, përderisa kjo dispozitë përcakton detyrimet për subjektet raportuese përtej fushëveprimet dhe mbulimit të atyre të artikuluar në Ligjin për PPP/LFT-në, ajo mund të kundërshtohet në rast të një mosmarrëveshje ligjore.

173. **Kriteri 10.9** (*Kryesisht i përmbushur*) – Paragrafi 3.2 i nenit 19 të Ligjit për PPP/LFT-në përcakton se të gjitha subjektet raportuese identifikojnë klientët e tyre dhe, në rast të personave juridikë, verifikojnë identitetin e tyre me paraqitjen e: a) certifikatës së regjistrimit të biznesit të lëshuar në pajtim me Ligjin për Shoqëritë Tregtare në Kosovë; b) certifikatën e regjistrimit të një OJQ-je të lëshuar në pajtim me Ligjin për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare; dhe c) vërtetimin e regjistrimit të subjektit politik sipas legjislacionit në fuqi. Sipas paragrafit 4 të të njëjtit nen, nëse subjekti nuk është shoqëri tregtare, OJQ apo subjekt politik, subjektet raportuese marrin çfarëdo dokumenti ose dokumente të tjera të cilat mundësojnë verifikimin e identitetit të subjektit, formës juridike, adresës, drejtorëve, personave të besuar, si dhe dispozitave që rregullojnë autoritetin e agjentëve, zyrtarëve, ose drejtorëve që janë të angazhuar në subjektin në fjalë. Për rrjedhojë, dispozitat e mësipërme nuk kërkojnë marrjen e informacionit për vendin kryesor të biznesit të një personi juridik ose marrëveshjeje nëse është i ndryshëm nga adresa e zyrës së regjistruar.
174. **Kriteri 10.10** (*Pjesërisht i përmbushur*) – Përveç përkufizimit të pronarit përfitues, siç parashihet me paragrafin 1.36 të nenit 1 të Ligjit për PPP/LFT-në, nënparagrafi 1 përkufizon se, në rastin e personave juridikë, pronari përfitues duhet të përfshijë të paktën: a) personin fizik, i cili ka në pronësi ose kontrollon përfundimisht një subjekt juridik nëpërmjet pronësisë ose kontrollit të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të një përqindjeje të mjaftueshme të aksioneve ose të drejtave të votës në atë subjekt juridik, përfshirë edhe mbajtësit e pronësisë mbi aksionet bartëse^{44 45 46 47}; dhe b) personin fizik, i cili përndryshe ushtron kontrollin në menaxhimin e subjektit juridik.
175. Siç është përcaktuar në analizën për kriterin 10.5, subjektet raportuese nuk janë të detyruara të marrin masa të arsyeshme për të verifikuar identitetin e pronarit përfitues në situata të ndryshme nga ato që konsiderohen të jenë me rrezikshmëri të lartë. Për më tepër, nuk ekziston kërkesë për të përcaktuar identitetin e personit(ave) fizik(ë) përkatës, i cili mban pozitën e zyrtarit të lartë drejtues, në rastet kur nuk identifikohen persona fizikë sipas përcaktimit të pronarit përfitues siç parashihet në paragrafin 1.36 të nenit 1 të Ligjit për PPP/LFT-në.
176. Së fundmi, gjuha në paragrafin 1.2 të nenit 19 të Ligjit për PPP/LFT-në artikulon se masat e KDK-së që duhen aplikuar nga të gjitha subjektet raportuese përfshijnë "identifikimin e pronarit përfitues dhe/ose të personit ose personave fizikë të cilët kontrollojnë drejtpërdrejt ose tërthorazi njëzet e pesë për qind (25%) ose më shumë të një personi juridik" lë hapësirë për interpretimin që, në rastin e personave juridikë, kërkesa për identifikimin e personit fizik, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, që kontrollojnë 25% ose më shumë (siç supozohet, aksione) të një personi juridik është një opsion që për shkak të lidhjes "dhe/ose" mund të përdoret në vend të dhe në mënyrë të ndërsjellë me atë për identifikimin e pronarit përfitues të një subjekti juridik siç përcaktohet në paragrafin 1.36 të nenit 1 të Ligjit për PPP/LFT-në.
177. **Kriteri 10.11** (*Pjesërisht i përmbushur*) – Përveç përcaktimit të pronarit përfitues siç parashikohet në paragrafin 1.36 të nenit 1 të Ligjit për PPP/LFT-në, nënparagrafi 1.36.2 përcakton se, në rastin e personave juridikë si fondacione dhe marrëveshje juridike siç janë trustet, të cilat administrojnë dhe shpërndajnë fonde, pronari përfitues duhet të përfshijë: a) kur përfituesit e ardhshëm janë përcaktuar tashmë – personin fizik i cili është përfitues i 25% ose më shumë të pasurisë së marrëveshjes juridike ose subjektit juridik; b) kur përfituesit e ardhshëm ende nuk janë përcaktuar – klasa e personave në interesin kryesor të të cilëve është ngritur ose funksionon marrëveshja juridike ose subjekti juridik; dhe c) personin fizik, i cili ushtron kontroll mbi 25% ose më tepër të pasurisë së një marrëveshjeje juridike ose subjekti juridik. Për pasojë, ky përkufizim nuk përcakton si pronarë përfitues

⁴⁴ Përqindja e aksioneve prej njëzet e pesë për qind (25%) e më tepër dhe/apo përqindja prej njëzet e pesë për qind (25%) e më tepër e interesit në pronësi në klientin i cili zotërohet nga personi fizik do të jetë tregues i pronësisë së drejtpërdrejtë.

⁴⁵ Përqindja e aksioneve prej njëzet e pesë për qind (25%) e më tepër ose përqindja prej njëzet e pesë për qind (25%) e më tepër e interesit në pronësi në klientin i cili zotërohet nga një person juridik i cili është nën kontrollin e personit(ve) fizik(ë), apo nga disa persona juridikë të cilat janë nën kontrollin e një personi(ve) fizik(ë) do të jetë një tregues i pronësisë së tërthortë.

⁴⁶ Një përqindje prej 25% e më tepër e aksioneve quhet e mjaftueshme për të plotësuar këtë kriter.

⁴⁷ Duke përjashtuar rastet kur kjo është një kompani e regjistruar në një treg të rregulluar që u nënshtrohet rregullave të publikimit sipas standardeve ndërkombëtare të cilat sigurojnë transparencë adekuate të informacionit për pronësinë.

përfituesit të cilët identifikohen nga karakteristika të caktuara, siç kërkohet sipas kriterit 10.11 (a), fusnota 36.

178. Siç është përcaktuar në analizën për kriterin 10.5, subjektet raportuese nuk janë të detyruara të marrin masa të arsyeshme për verifikimin e identitetit të pronarit përfitues në situata të ndryshme nga ato që konsiderohen të jenë me rrezikshmëri të lartë. Për më tepër, nuk ka kërkesë për të përcaktuar identitetin e themeluesit, administratorit (administratorëve) të besuar dhe kujdestarit (nëse ka), ndërsa në lidhje me përfituesit dhe personat e tjerë fizikë që ushtrojnë kontroll përfundimtar efektiv mbi trustin (përfshirë përmes një zinxhiri kontrolli/pronësie), vetëm ata që përfitojnë ose ushtrojnë kontroll mbi 25% ose më shumë të pasurisë së marrëveshjes juridike duhet të identifikohen.
179. Për më tepër, ligji nuk përcakton se, kur përfituesit e trusteve përcaktohen sipas karakteristikave ose sipas klasës, subjektet raportuese duhet të marrin informacion të mjaftueshëm në lidhje me përfituesit për t'u siguruar që ata do të jenë në gjendje të përcaktojnë identitetin e përfituesit në kohën e pagesës ose kur përfituesi synon të ushtrojë të drejtat e fituara. Së fundi, nuk ka kërkesë për të identifikuar personat në pozita të barasvlershme ose të ngjashme me llojet e tjera të marrëveshjeve juridike.
180. Natyrisht, mungesa e gjuhës siç përkufizohet nga FATF-ja për trustet dhe marrëveshjet e ngjashme në Ligjin për PPP/LFT-në pasqyron faktin se ligji i Kosovës nuk i njeh trustet si një lloj i veçantë i rregullimit juridik dhe, për pasojë, përdorimi i kushteve të lidhura me trustin në Ligjin për PPP/LFT-në ka rëndësi teorike vetëm në ndjekjen e përmbushjes fjalë për fjalë të standardit të FATF-së.
181. Paragrafi 7 i nenit 10 të Rregullores së BQK-së për PPP/LFT-në thekson se për marrëveshje të tjera juridike siç janë trustet, përveç identifikimit të administratorit të besuar, themeluesit dhe/ose drejtorit, institucionet financiare duhet të identifikojnë, kur përfituesit janë përcaktuar, përfituesit e trustit prej 25% ose më shumë të pronësisë ose, kur përfituesit nuk janë përcaktuar, klasifikimin e personave në interesin e të cilëve është lidhur ose funksionon marrëveshja juridike. Për llojet e tjera të marrëveshjeve juridike, institucionet financiare duhet të identifikojnë personat me pozitë të barasvlershme ose të ngjashme. Këto dispozita, madje edhe kur ofrojnë gjuhë më të mirë drejt pajtueshmërisë me kërkesat sipas kriterit 10.11, përcaktojnë detyrime për subjektet raportuese përtej fushëveprimit dhe mbulimit të atyre të artikuluar në Ligjin për PPP/LFT-në dhe, për këtë arsye, mund të kundërshtohen në rast të mosmarrëveshjes juridike.

KDK-ja për përfituesit e policave të sigurimit të jetës

182. **Kriteri 10.12** (*Pjesërisht i përmbushur*) – Sipas paragrafëve 5.1-5.3 të nenit 19 të Ligjit për PPP/LFT-në, për bizneset e sigurimeve të jetës dhe sigurimet e tjera të ndërlidhura me investime, subjektet raportuese, përveç kujdesit të duhur ndaj klientit, identifikojnë përfituesit edhe: 1) kur përfituesi identifikohet si person i emëruar fizik ose juridik, subjektet raportuese regjistrojnë emrin e personit; 2) kur përfituesi është i përcaktuar bazuar në karakteristika ose klasa ose në ndonjë mënyrë tjetër, subjektet raportuese marrin dhe ruajnë informacion të mjaftueshëm për përfituesit në mënyrë të tillë që subjekti raportues të ketë mundësinë të përcaktojë identitetin e përfituesit gjatë kohës së pagesës; dhe 3) në të dy rastet, verifikojnë identitetet e përfituesve në përputhje me dispozitat e këtij neni gjatë kohës së pagesës. Për pasojë, kjo dispozitë nuk u kërkon subjekteve raportuese: a) të ndërmarrin veprimet e mësipërme sapo përfituesi identifikohet ose përcaktohet; dhe b) kur përfituesi identifikohet si një marrëveshje juridike me emër, për të regjistruar emrin e marrëveshjes.
183. **Kriteri 10.13** (*Kryesisht i përmbushur*) – Sipas paragrafit 5.4 të nenit 19 të Ligjit për PPP/LFT-në, për bizneset e sigurimeve të jetës dhe sigurimet e tjera të ndërlidhura me investime, subjektet raportuese, përveç kujdesit të duhur ndaj klientit në përputhje me këtë ligj, identifikojnë përfituesit edhe kur përfituesi i identifikuar është person juridik ose marrëveshje juridike dhe subjekti raportues vendos se një përfitues i tillë paraqet rrezikshmëri të lartë, atëherë subjekti raportues merr masa të arsyeshme për të identifikuar dhe verifikuar identitetin e pronarit përfitues të përfituesit në kohën e pagesës. Për rrjedhojë, ligji nuk kërkon që subjektet raportuese të përfshijnë përfituesin e një police të sigurimit të jetës si një faktor të rëndësishëm rreziku në përcaktimin nëse masat e KDK-së së shtuar janë të zbatueshme.

Koha e verifikimit

184. **Kriteri 10.14** (*Pjesërisht i përmbushur*) – Neni 19 të Ligjit për PPP/LFT-në, i cili ofron rrethanat në të cilat duhet të zbatohen masat e KDK-së (përfshirë verifikimin e identitetit)

përdor gjuhën "kur ...", që do të thotë se koha e përshtatshme për zbatimin e masave të tilla është para ose, më së voni, gjatë realizimit të rrethanave të tilla. Megjithatë, siç tregohet në analizën për kriterin 10.5 dhe kriteret 10.10-10.11, nuk kërkohet verifikimi i identitetit të pronarit përfitues në situata të ndryshme nga ato që konsiderohen të rrezikshme, domethënë në situata të tilla kërkesa sipas kriterit 10.14 për të verifikuar identitetin e pronarit përfitues para ose gjatë rrjedhës së krijimit të një marrëdhënieje biznesi ose kryerja e transaksioneve për klientët e rastit nuk është përbushur.

185. Paragrafi 2 i nenit 24 të Ligjit për PPP/LFT-në përcakton që, përveç detyrimeve të lidhura me KDK-në të përcaktuara në nenin 19 të ligjit, bankat dhe institucionet e tjera financiare duhet të verifikojnë identitetin e të gjithë klientëve kur: 1) hapin llogari bankare; 2) pranojnë aksione, bono thesari, ose letra të tjera me vlerë për t'i ruajtur në kasafortë; 4) ofrojnë lehtësira për depozita të sigurta; 3) kryejnë transfertë bankare vendore ose ndërkombëtare të fondeve; 5) para kryerjes së transaksioneve të rastit; dhe 6) angazhohen në çdo transaksion të vetëm në vlerën prej 10.000 euro ose më shumë.
186. Për rrjedhojë, dispozita e mësipërme nuk kërkon që bankat dhe institucionet e tjera financiare: a) të verifikojnë identitetin e pronarit përfitues para ose gjatë zhvillimit të marrëdhënies së biznesit ose kryerjes së transaksioneve për klientët e rastit; dhe b) të verifikojnë identitetin e klientit para ose gjatë zhvillimit të marrëdhënies së biznesit, përveç atyre të specifikuara në paragrafin 2 të nenit 24.
187. **Kriteri 10.15** (*Nuk është përbushur*) – Paragrafi 1 i nenit 17 të Ligjit për PPP/LFT-në përcakton një detyrim të përgjithshëm sipas të cilit veprimet dhe masat për parandalimin dhe zbulimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit merren nga të gjitha subjektet raportuese para, gjatë, dhe pas ekzekutimit të transaksionit ose krijimit të marrëdhënies së biznesit. Kjo megjithatë nuk përbën kërkesë që subjektet raportuese të miratojnë procedurat e administrimit të rrezikut në lidhje me kushtet në të cilat një klient mund të shfrytëzojë marrëdhënien e biznesit para verifikimit.

Klientët ekzistues

188. **Kriteri 10.16** (*Pjesërisht i përbushur*) – Neni 68 i Ligjit për PPP/LFT-në përcakton që subjektet raportuese zbatojnë dispozitat e reja të këtij ligji për klientët ekzistues në bazë të materialitetit dhe rrezikut si pjesë e monitorimit të vazhdueshëm të llogarive dhe marrëdhënieve të biznesit. Sipas paragrafit 1.4 të nenit 19 të Ligjit për PPP/LFT-në, masat e KDK-së që duhet të zbatohen nga të gjitha subjektet raportuese përfshijnë "kryerjen e monitorimit në vazhdimësi të marrëdhënies së biznesit" ... [për të] garantuar që "dokumentet, të dhënat ose informacionet mbahen të përditësuara".
189. Dispozita e mësipërme nuk përbën kërkesë për subjektet raportuese që të kryejnë kujdesin e duhur ndaj klientëve ekzistues duke marrë parasysh nëse dhe kur janë ndërmarrë më parë masat e KDK-së dhe përshtatshmëria e të dhënave të mbledhura.

Qasja e bazuar në rrezik

190. **Kriteri 10.17** (*Pjesërisht i përbushur*) – Paragrafi 2 i nenit 18 të Ligjit për PPP/LFT-në u kërkon të gjitha subjekteve raportuese të përcaktojnë në mënyrë periodike rrezikun e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit ndaj të cilit janë të ekspozuara gjatë ofrimit të shërbimeve dhe produkteve të tyre, vendndodhjes gjeografike dhe mekanizmave e kanaleve të shpërndarjes. Këtij formulimi i mungojnë "transaksionet" si objekt potencial me rreziqet e ndërlidhura të PP/FT-së (siç dalin nga kërkesat në kriterin 1.10⁴⁸).
191. Paragrafi 5 i nenit 18 të Ligjit për PPP/LFT-në më tej kërkon që të gjitha subjektet raportuese, në mënyrë të vazhdueshme, përcaktojnë rrezikun e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit të paraqitur nga klientët e tyre dhe çdo person tjetër për të cilin ofrojnë shërbime financiare dhe profesionale. Kur subjektet raportuese përcaktojnë se rreziku i pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit është i lartë, ato marrin masat e përcaktuara në paragrafin 1 të nenit 22 të këtij ligji.

⁴⁸ Sipas paragrafit 2 të nenit 7 të Rregullores së BQK-së për PPP/LFT-në, "institucionet financiare duhet të përgatisin një analizë të rrezikut dhe hartojnë vlerësimin e rrezikut për klientët, marrëdhëniet e biznesit, produktet ose transaksionet në lidhje me mundësinë e keqpërdorimit të tyre për pastrimin e parave ose financimin e terrorizmit", duke shtuar kështu "transaksionet" si send i mundshëm me rreziqe që lidhen me PP/FT-në; megjithatë, për aq sa kjo dispozitë përcakton një detyrim për subjektet raportuese përtej fushëveprimit dhe mbulimit të asaj që është artikuluar në Ligjin për PPP/LFT-në, kjo mund të kundërshtohet në rast të një mosmarrëveshjeje ligjore.

192. Për pasojë, brenda nenit 18 të Ligjit për PPP/LFT-në ekziston një shkëputje ndërmjet rrezikut të PP/FT-së të përcaktuar në lidhje me objektet e specifikuar në paragrafin 2 (p.sh. shërbimet, produktet, vendndodhja gjeografike dhe mekanizmat e shpërndarjes) dhe ato të specifikuar në paragrafin 5 (domethënë klientët dhe personat e tjerë), për të cilat nevojitet KDK-ja e shtuar. Për më tepër, kërkesa për të "përcaktuar" rrezikun e PP/FT-së nuk është domosdoshmërisht ajo që "të ndërmarrë hapat e duhur për të identifikuar, vlerësuar dhe kuptuar rreziqet e tyre të PP/FT-së" (si rrjedhojë e kërkesës në kriterin 1.10).
193. Për më tepër, sipas paragrafit 1 të nenit 22, në prani të rrezikut të lartë të PP/FT-së, subjektet raportuese marrin masa të arsyeshme për "të mbajtur të përditësuara informacionet e mbledhura në pajtim me nenin 19", dhe zbatojnë masat e nevojshme të kujdesit të duhur të shtuar për të monitoruar profilin e biznesit dhe të rrezikut, duke përfshirë burimin e fondeve, dhe "sigurojnë që të dhënat dhe informacionet e tjera janë mbajtur të përditësuara". Siç tregohet në analizën për kriterin 10.7, referimet e përsëritura dhe të mbivendosura për të mbajtur informacionin e përditësuar të KDK-së krijojnë pasiguri rreth objekteve të kësaj mase si një përbërës kyç i KDK-së së shtuar.
194. Në lidhje me këtë, ligji nuk përcakton se çfarë mund të jenë përbërës të tjerë të masave të shtuara të KDK-së⁴⁹ në krahasim me ato standarde të përcaktuara në nenin 19 të Ligjit për PPP/LFT-në (përsëri, të lidhura me monitorimin e marrëdhënieve të biznesit dhe mbajtjen e informatave të KDK-së të përditësuara). Disa masa shtesë⁵⁰ kërkohen sipas paragrafit 2 të nenit 22 për marrëdhëniet në distancë (jo ballë-për-ballë), të cilat megjithatë janë vetëm një nga shumë faktorë të mundshëm të situatave potencialisht me rrezik më të lartë që kërkojnë KDK të shtuar.
195. Për bankat dhe institucionet e tjera financiare, masat shtesë në rast të KDK-së së shtuar janë përcaktuar në paragrafin 5 të nenit 18 të Rregullores së BQK-së për PPP/LFT-në dhe përfshijnë, ndër të tjera, marrjen e informacionit dhe dokumenteve shtesë për verifikimin e identitetit të klientit dhe të pronarit përfitues sipas nevojës, sqarimin e burimit të pasurisë dhe burimit të fondeve, natyrën e synuar të marrëdhënies së biznesit si dhe rritjen e monitorimit dhe shqyrtimit të marrëdhënieve të biznesit, transaksioneve dhe llogarive, frekuencën e përditësimit të informacionit në dispozicion për identifikimin e klientit, nivelit të rrezikut dhe profilin e biznesit dhe rritjen e raportimit periodik të drejtuesit të lartë.
196. **Kriteri 10.18** (*Pjesërisht i përmbushur*) – Sipas nenit 23 të Ligjit për PPP/LFT-në, kur subjektet raportuese identifikojnë fushat me rrezik më të ulët, NjIF-i mund t'i lejojë ata të aplikojnë masa të thjeshtuara të KDK-së. Para se të aplikojnë për leje të NjIF-i, subjektet raportuese duhet të përcaktojnë se marrëdhënia e biznesit ose transaksioni përfaqëson një nivel të ulët rreziku. Me këtë, ata duhet të sigurojnë monitorim të duhur për të mundësuar zbulimin e transaksioneve të pazakonshme ose të dyshimta. Në vlerësimin e rrezikut të PP/FT-së⁵¹, subjektet raportuese duhet të marrin në konsideratë të paktën faktorë dhe situata që potencialisht paraqesin një rrezik më të ulët, i cili do të përcaktohet nga NjIF-i në bashkëpunim me mbikëqyrësit sektorialë.
197. Për pasojë, dispozitat e mësipërme nuk kërkojnë në mënyrë të qartë që aplikimi i KDK-së së thjeshtuar lejohet vetëm kur identifikohen rreziqe më të ulëta përmes analizës së duhur të rreziqeve nga juridiksioni (NjIF-i) ose subjektet raportuese. Ato gjithashtu nuk përcaktojnë shprehimisht se masat e thjeshtuara duhet të jenë në përpjesëtim me faktorët e rrezikut më të ulët, por nuk janë të pranueshme sa herë që ekziston dyshimi për PP/FT ose zbatohen skenarë të rrezikut më të lartë. Ligji nuk përcakton se çfarë mund të jenë përbërësit e këtyre masave të KDK-së së thjeshtuar⁵² në krahasim me ato standarde të përcaktuara në nenin 19 të Ligjit për PPP/LFT-në.

⁴⁹ Për shembull, rritja e numrit dhe koha e kontroleve të aplikuara, zgjedhja e modeleve të transaksioneve që kanë nevojë për ekzaminim të mëtejshëm, marrja e informatave shtesë dhe përditësimi më i rregullt i të dhënave identifikuese të klientit dhe pronarit përfitues, marrja e informatave shtesë mbi natyrën e synuar të marrëdhënies së biznesit, marrja e miratimit të drejtuesve të lartë për të filluar ose vazhduar marrëdhënien e biznesit për klientët përveç PEP-ëve.

⁵⁰ Të tilla që kërkojnë që pagesa e parë të bëhet përmes një llogarie të hapur në emrin e klientit në një bankë.

⁵¹ Që sipas paragrafit 4 të nenit 23 të Ligjit për PPP/LFT-në mund të lidhen me llojet e klientëve, vendndodhjen gjeografike të shteteve, produktet e veçanta, shërbimet, mekanizmat e kanalet e shpërndarjes, por jo me, për shembull, transaksionet.

⁵² Të cilat mund të përcaktohen duke përdorur logjikën e njëjtë sikurse ajo që përdoret për përcaktimin e përbërësve të KDK-së së shtuar.

Mosplotësimi i kënaqshëm i KDK-së

198. **Kriteri 10.19** (*Pjesërisht i përmbushur*) – Paragrafi 9 i nenit 19 të Ligjit për PPP/LFT-në përcakton se në rastet kur subjekti raportues nuk mundet të plotësojë masat e kujdesit të duhur ndaj klientit, pronarit përfitues ose përfituesit të biznesit të sigurimit të jetës dhe investimeve të tjera të ndërlidhura, në përputhje me këtë nen transaksioni nuk duhet të kryhet, marrëdhënia e biznesit duhet të ndërpritet ose të mos fillohet si dhe llogaria duhet të mbyllet. Një veprim i tillë është pa paragjykim për subjektin raportues që të dorëzojë një RTD dhe informata shitesë të NjIF-i, në përputhje me paragrafët 1.1 dhe 2 të nenit 26 të ligjit.

199. Për pasojë, dispozita e mësipërme nuk kërkon në mënyrë të qartë që subjektet raportuese të mos hapin llogarinë, të mos fillojnë marrëdhëniet e biznesit ose të mos kryejnë transaksionin, apo të ndërpresin marrëdhënien e biznesit, kurdoherë që nuk janë në gjendje të zbatojnë të gjitha masat përkatëse të KDK-së (dhe jo vetëm ato të përcaktuara në nenin 19 të Ligjit për PPP/LFT-në). Gjithashtu, duke përcaktuar që subjektet raportuese nuk janë të kufizuara në rastin e paraqitjes së një RTD-je në pajtim me nenin 26 të ligjit (domethënë kurdoherë që ato kanë dyshime të PP/FT-së), ligji nuk kërkon në mënyrë të qartë që subjektet raportuese të marrin në konsideratë të paraqesin një RTD në raport me klientin sa herë që nuk janë në gjendje të zbatojnë masat përkatëse të KDK-së (domethënë pavarësisht nga dyshimi i PP/FT-së).⁵³

KDK-ja dhe nxjerrja e informacionit

200. **Kriteri 10.20** (*Nuk është përmbushur*) – Legjislacioni në fuqi nuk përcakton që në rastet kur subjektet raportuese formojnë një dyshim të PP/FT-së dhe ato besojnë në mënyrë të arsyeshme se kryerja e procesit të KDK-së do të paralajmërojë klientin, ata duhet të lejohen të mos ndjekin procesin e KDK-së dhe, në vend të kësaj, duhet të kërkohet të paraqesin një RTD.

Vlerësimi dhe përfundimi

201. Faktet dhe rrethanat në vijim janë konsideruar se përcaktojnë vlerësimin për Rekomandimin 10:

- Bankat dhe institucionet e tjera financiare nuk janë të detyruara të ndërmarrin të gjitha masat e zbatueshme të kujdesit të duhur të klientit në rast të: a) transaksioneve të rastit jo në para të gatshme mbi pragun e caktuar prej 10.000 euro; dhe, b) transfertave bankare të kryera nëpërmjet institucioneve financiare jobankare (kriteri 10.2);
- Kërkesa për përdorimin e dokumenteve, të dhënave ose informacionit të besueshëm dhe të pavarur nuk është përcaktuar qartë (kriteri 10.3);
- Kërkesa për të verifikuar autorizimin e çdo personi që pretendon të veprojë në emër të klientit nuk mbulon situatat në të cilat subjektet raportuese: a) angazhohen në marrëdhënie me persona që pretendojnë të veprojë në emër të klientit përtej fushëveprimit të kryerjes së transaksioneve; dhe b) merren me persona juridikë, përveç shoqërive tregtare, OJQ-ve ose subjekteve politike, si dhe me marrëveshje juridike (kriteri 10.4);
- Dispozita për të përcaktuar pronësinë përfituese nuk kërkon që subjektet raportuese: a) të përdorin informata ose të dhëna përkatëse nga një burim i besueshëm kur marrin masa të arsyeshme për të verifikuar identitetin e pronarit përfitues, dhe b) të marrin masa të tilla në situata të ndryshme nga ato që konsiderohen të jenë me rrezikshmëri të lartë (kriteri 10.5);
- Dispozitat për kujdesin e duhur të vazhdueshëm nuk kërkojnë që subjektet raportuese të sigurojnë që dokumentet, të dhënat ose informatat e mbledhura në procesin e KDK-së janë të rëndësishme dhe se kjo arrihet duke ndërmarrë shqyrtime të të dhënave ekzistuese (kriteri 10.7);

⁵³ Paragrafi 9 i nenit 9 të Rregullores së BQK-së për PPP/LFT-në siguron një gjuhë më të qartë duke kërkuar që institucionet financiare të konsiderojnë paraqitjen e një RTD-je kur nuk janë në gjendje të përmbushin kërkesat e identifikimit dhe verifikimit të klientit; megjithatë, përderisa kjo dispozitë përcakton detyrime për subjektet raportuese përtej fushëveprimit dhe mbulimit të atyre të artikuluar në Ligjin për PPP/LFT-në, kjo mund të kundërshtohet në rast të një mosmarrëveshje ligjore.

- Subjekteve raportuese nuk u kërkohet të kuptojnë strukturën e pronësisë dhe kontrollit të klientëve në situata të ndryshme nga ato që konsiderohen të jenë me rrezikshmëri të lartë (kriteri 10.8);
- Nuk ka kërkesë për të mbledhur informata për vendin kryesor të biznesit të një personi ose marrëveshje juridike nëse ai është i ndryshëm nga adresa e zyrës së regjistruar (kriteri 10.9);
- Nuk ka kërkesë për të përcaktuar identitetin e personit fizik përkatës, i cili mban pozitën e zyrtarit të lartë drejtues, në rastet kur nuk identifikohen persona fizikë sipas përkufizimit të pronarit përfitues (kriteri 10.10);
- Përfituesit e marrëveshjeve juridike të identifikuar me karakteristika të caktuara nuk janë përcaktuar si pronarë përfitues dhe kërkesat për identifikimin e pronarëve përfitues në rast të marrëveshjeve juridike nuk përcaktohen siç duhet (kriteri 10.11);
- Dispozitat për përfituesit e policave të sigurimit të jetës nuk u kërkojnë subjekteve raportuese: a) të ndërmarrin veprimet e duhura sapo përfituesi identifikohet ose përcaktohet, dhe b) kur përfituesi identifikohet si një marrëveshje juridike me emër, për të regjistruar emrin e marrëveshjes (kriteri 10.12);
- Subjekteve raportuese nuk u kërkohet që të përfshijnë përfituesin e një police të sigurimit të jetës si një faktor të rëndësishëm rreziku në përcaktimin nëse masat e KDK-së së shtuar janë të zbatueshme (kriteri 10.13);
- Në situata të ndryshme nga ato që konsiderohen të jenë me rrezikshmëri të lartë, nuk kërkohet verifikimi i identiteti të pronarit përfitues para ose gjatë zhvillimit të marrëdhënies së biznesit ose kryerjes së transaksioneve për klientët e rastit (kriteri 10.14);
- Subjekteve raportuese nuk u kërkohet të miratojnë procedurat e administrimit të rrezikut në lidhje me kushtet në të cilat një klient mund të shfrytëzojë marrëdhënien e biznesit para verifikimit (kriteri 10.15);
- Nuk ekziston kërkesë për subjektet raportuese që të kryejnë kujdesin e duhur ndaj klientëve ekzistues duke marrë parasysh nëse dhe kur janë ndërmarrë më parë masat e KDK-së dhe përshtatshmëria e të dhënave të mbledhura (kriteri 10.16);
- Kërkesa për kryerjen e kujdesit të duhur të shtuar kur rreziqet e PP/FT-së janë më të larta nuk është përcaktuar siç duhet (kriteri 10.17);
- Elementet dhe parakushtet për lejimin e KDK-së të thjeshtuar nuk janë përcaktuar siç duhet (kriteri 10.18);
- Nuk ka kërkesa të qarta në lidhje me subjektet raportuese që të mos hapin llogarinë, të mos fillojnë marrëdhëniet e biznesit ose të mos kryejnë transaksionin, ose të ndërpresin marrëdhënien e biznesit, kur nuk janë në gjendje të zbatojnë të gjitha masat përkatëse të KDK-së (kriteri 10.19); dhe
- Nuk ka dispozita për të parandaluar nxjerrjen e informacionit (kriteri 10.20).

202. **Kosova është pjesërisht në përputhje me Rekomandimin 10.**

Rekomandimi 11 – Ruajtja e të dhënave

203. Në Raportin e Vlerësimit për PPP/LFT-në të vitit 2014, Kosova u vlerësua në mospërputhje me Rekomandimin e mëparshëm 10 të FATF-së. Vlerësimi identifikoi mangësi teknike lidhur me: mungesën e dispozitave për fillimin e periudhës së ruajtjes për transaksionet e ndërlidhura të rastit; mungesën e udhëzimeve për metodologjinë e ruajtjes së të dhënave; mungesën e kompetencave ligjore për zgjatjen e periudhës (5) pesëvjeçare të ruajtjes si për transaksionet ashtu edhe për të dhënat identifikuese sipas nevojës; mospërputhshmërinë me standardet ndërkombëtare për kohën e fillimit të periudhës së ruajtjes për të dhënat identifikuese; dhe, paqartësinë për disponueshmërinë e të dhënave për autoritetet kompetente.

204. **Kriteri 11.1 (I përmbushur)** – Sipas paragrafit 1 të nenit 20 të Ligjit për PPP/LFT-në, subjektet raportuese mbajnë "të gjitha të dhënat për informatat e mbledhura në pajtim me këtë ligj", përfshirë informatat "për të mundësuar rindërtimin e transaksioneve, që janë ekzekutuar ose është tentuar të ekzekutohen" për së paku 5 vite pas tentimit për ekzekutim ose ekzekutimit të transaksionit⁵⁴. Në lidhje me këtë dispozitë, mund të thuhet

⁵⁴ Sipas paragrafit 1.4 të nenit 20 të Ligjit për PPP/LFT-në, kur informacioni për transaksionin lidhet me një raport të dorëzuar në NJIF për sa i përket një akti apo transaksioni të dyshimtë, periudha (5) pesëvjeçare fillon nga data e dorëzimit të raportit në përputhje me nenin 26 të këtij ligji.

se kërkesa më e gjerë për të ruajtur të gjitha të dhënat (madje, e së bashku me to, edhe "të dhënat" më pak të qarta "për informatat") dhe informacionet që lejojnë rindërtimin e transaksioneve, me sa duket përfshin të gjitha të dhënat e nevojshme për transaksionet, siç kërkohet në kriterin 11.1.

205. Paragrafët 1 dhe 2 të nenit 16 të Rregullores së BQK-së për PPP/LFT-në theksojnë se institucionet financiare duhet të mbajnë të gjitha të dhënat e nevojshme të transaksioneve vendore dhe ndërkombëtare për të paktën 5 vite pas përfundimit të transaksionit ose përfundimit të transaksionit të fundit në një seri transaksionesh të lidhura (ose më gjatë nëse kërkohet nga NjIF-i, BQK-ja ose organi tjetër kompetent në raste të veçanta). Kjo kërkesë zbatohet pavarësisht nëse marrëdhënia e biznesit është duke vazhduar ose është ndërprerë.
206. **Kriteri 11.2** (*Pjesërisht i përmbushur*) – Sipas paragrafit 1.1 të nenit 20 të Ligjit për PPP/LFT-në, subjektet raportuese duhet të ruajnë kopjet e dokumenteve që dëshmojnë identitetin e klientit, mbajtëseve të së drejtës së pronës të marra në pajtim me këtë ligj, llogaritë e dosjeve dhe korrespondencën biznese, për së paku pesë (5) vjetët e fundit, pas përfundimit të marrëdhënies biznese. Paragrafi 1.2 i të njëjtit nen më tej kërkon mbajtjen e raporteve me shkrim të krijuara në përputhje me nenin 25 të këtij ligji, domethënë analizat për transaksionet e ndërlikuara dhe të pazakonshme dhe ato me klientët nga vendet të cilat janë në mospërputhje, për së paku pesë (5) vjet pas tentimit për ekzekutim ose ekzekutimit të transaksionit⁵⁵.
207. Për rrjedhojë, dispozitat e mësipërme nuk u kërkojnë subjekteve raportuese që të mbajnë të gjitha të dhënat e marra përmes masave të KDK-së, përveç identifikimit të klientëve dhe pronarëve përfitues, rezultatet e analizave të ndërmarrë përveç atyre të përcaktuara në nenin 25 të ligjit, përmes masave të KDK-së dhe çdo analize të ndërmarrë në lidhje me transaksionet e rastit (për sa kohë që periudha e mbajtjes është e përcaktuar "për së paku 5 vjetët e fundit pas përfundimit të marrëdhënies biznese").
208. **Kriteri 11.3** (*I përmbushur*) – Gjuha e paragrafit 1 të nenit 20 të Ligjit për PPP/LFT-në, siç është përcaktuar në analizën për kriterin 11.1 më sipër, nuk është mjaft specifike që të kërkojë që të dhënat e transaksioneve të jenë të mjaftueshme për të ofruar dëshmi për ndjekjen penale të veprës penale. Megjithatë, paragrafi 2 i nenit 16 të Rregullores së BQK-së për PPP/LFT-në shprehimisht thekson se të dhënat për transaksionet duhet të jenë të mjaftueshme për të mundësuar rindërtimin e transaksioneve individuale në mënyrë që të ofrojnë, nëse është e nevojshme, dëshmi për ndjekjen penale të aktivitetit kriminal.
209. **Kriteri 11.4** (*I përmbushur*) – Sipas paragrafit 1 të nenit 20 të Ligjit për PPP/LFT-në, subjektet raportuese mbajnë të gjitha të dhënat për informatat e mbledhura në pajtim me këtë ligj dhe sigurojnë se dokumentacioni dhe informacionet përcjellëse të jenë të gatshme dhe në dispozicion të NjIF-it, si dhe të autoriteteve të tjera kompetente.
210. Paragrafët 6 dhe 8 të nenit 16 të Rregullores së BQK-së për PPP/LFT-në kërkojnë që institucionet financiare të vënë në dispozicion, sipas kërkesës së NjIF-it, BQK-së apo çdo autoriteti tjetër kompetent, të gjitha të dhënat dhe informatat në dispozicion për një klient, pronarin përfitues ose mbajtësin e autorizimit dhe të gjitha të dhënat e kërkuara të transaksionit, në formën dhe mënyrën e plotë, me kohë dhe të kuptueshme. Institucionet financiare duhet të ruajnë në kopje në mënyrë elektronike dhe të vënë në dispozicion në formë të lexueshme për NjIF-in, BQK-në dhe autoritetet kompetente sipas legjislacionit në fuqi.

Vlerësimi dhe përfundimi

211. Shumica e kriterëve janë përmbushur. Megjithatë, meqenëse kërkesa për të ruajtur të gjitha të dhënat e siguruar përmes masave të KDK-së dhe rezultatet e analizave nuk është gjithëpërfshirëse (kriteri 11.2), Kosova nuk mund të konsiderohet se është në përputhje të plotë me këtë Rekomandim.

212. **Kosova është kryesisht në përputhje me Rekomandimin 11.**

⁵⁵ Dispozita të ngjashme janë të përfshira në paragrafin 3 dhe 4 të nenit 16 të Rregullores së BQK-së për PPP/LFT-në.

Rekomandimi 12 – Personat e ekspozuar politikisht

213. Në Raportin e Vlerësimit për PPP/LFT-në të vitit 2014, Kosova u vlerësua se ishte pjesërisht në përputhje me Rekomandimin e mëparshëm 6 të FATF-së. Vlerësimi identifikoi mangësi teknike lidhur me: mangësitë në përkufizimin e personit të ekspozuar politikisht (PEP); mungesën e qartësisë juridike në zbatimin e masave të shtuara për PEP-ët vendorë; mungesën e detyrimit për të identifikuar nëse një pronar përfitues është ose bëhet PEP; mungesën e detyrimit për miratimin e drejtuesve të lartë për vazhdimin e marrëdhënies së biznesit me një PEP; mungesën e detyrimit për të pasur sisteme të përshtatshme të menaxhimit të rrezikut; dhe, detyrimin e paqartë juridik për të identifikuar burimin e pasurisë.
214. Sipas paragrafit 1.33 të nenit 2 të Ligjit për PPP/LFT-në, person i ekspozuar politikisht nënkupton: a) persona fizikë të huaj apo vendorë, të cilët janë ose kanë qenë të ngarkuar me funksione të larta publike, si dhe drejtorët, zëvendësdrejtorët dhe anëtarët e bordeve ose pozicionet ekuivalente në organizatat ndërkombëtare; b) anëtarët e familjes së kategorive të personave të përmendur në shkronjën "a" të këtij paragrafi; dhe c) personat e njohur si bashkëpunëtorë të ngushtë me kategoritë e personave të përmendur në shkronjën "a" të këtij paragrafi.
215. Si të tillë, përveç personave të caktuar si PEP-ë "parësorë" për shkak të funksioneve të rëndësishme publike që u janë besuar apo u besohen, përkufizimi i PEP-it i cakton anëtarët e familjes dhe bashkëpunëtorët e ngushtë të këtyre personave si PEP-ë "dytësorë", duke futur kështu paqartësi juridike si për qëllimin ashtu edhe për mbulimin e masave që duhet të zbatohen në lidhje me anëtarët e familjes dhe bashkëpunëtorët e ngushtë të kategorisë së fundit (p.sh. anëtari i familjes i shkallës së dytë ose çdo anëtar pasardhës apo bashkëpunëtori i ngushtë i anëtarit të familjes së shkallës së parë ose bashkëpunëtori i ngushtë i një PEP-i "primar").
216. Lista e funksioneve të larta publike kryesisht transpozon dispozitat përkatëse në Fjalorin e FATF-së (dhe Direktivën (BE) 2015/849, e njohur gjithashtu si Direktiva e 4^{ët} për PPP-në) me përjashtim të faktit se nuk parasheh kategoritë e personave, të cilët mbajnë apo iu janë besuar funksionet e larta publike, në formën e shembujve, duke kufizuar kështu nocionin e PEP-ëve në mënyrë specifike për ato funksione të artikuluar në Ligjin për PPP/LFT-në⁵⁶. Për më tepër, lista e paraparë në paragrafin 1.33 të nenit 2 të Ligjit për PPP/LFT-në nuk përfshin disa funksione të rëndësishme, vendore dhe ndërkombëtare, siç janë zyrtarët e rëndësishëm të partive politike (përveç anëtarëve të bordeve drejtuese të partive politike), zyrtarët e lartë gjyqësorë (përveç anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, të Gjykatës Supreme apo të ndonjë organi tjetër gjyqësor të nivelit të lartë) dhe zyrtarët e lartë ushtarakë.
217. Përcaktimi i anëtarëve të familjes dhe i bashkëpunëtorëve të ngushtë transpozon dispozitat përkatëse të Direktivës (BE) 2015/849.
218. **Kriteri 12.1** (*Pjesërisht i përmbushur*) – Paragrafi 5 i nenit 22 të Ligjit për PPP/LFT-në kërkon që subjektet raportuese të marrin masa të arsyeshme për të përcaktuar nëse klientët e tyre, pronarët përfitues dhe përfituesit e bizneseve të sigurimeve të jetës ose investimeve të tjera të ndërlidhura ose, sipas rastit, pronari përfitues i përfituesit (i fundit në kohën e pagesës) janë persona të ekspozuar politikisht vendas, të huaj apo në organizatat ndërkombëtare, siç përcaktohet me këtë ligj. Paragrafi 2(e) i nenit 5 të Rregullores së BQK-së për PPP/LFT-në përcakton që politikat dhe procedurat e brendshme të bankave dhe institucioneve të tjera financiare duhet të përcaktojnë procedurën për identifikimin e PEP-ëve. Për pasojë, kjo dispozitë nuk kërkon që subjektet raportuese të vendosin sisteme të menaxhimit të rrezikut – në krahasim me marrjen (e një sërë) masash të arsyeshme – për të përcaktuar nëse një klient ose një pronar përfitues është PEP i huaj.
219. Sipas paragrafit 5 të nenit 22 të Ligjit për PPP/LFT-në, nëse përcaktimi i tillë rezulton që një klient ose pronari përfitues që është përcaktuar si i tillë të jetë një person i ekspozuar politikisht, atëherë subjektet raportuese duhet a) të marrin miratimin e një menaxheri të lartë të subjektit raportues për të krijuar apo për të vazhduar marrëdhënien e biznesit, ose për të kryer transaksionin e rastit; b) të marrin masa të përshtatshme për të identifikuar origjinën e pasurisë së klientit dhe origjinën e pasurive të përdorura në marrëdhënie ose

⁵⁶ Ndërsa Fjalori i FATF-së parasheh listën e funksioneve të larta vetëm si shembuj, me përjashtim të personave të cilëve u është besuar një funksion i rëndësishëm nga një organizatë ndërkombëtare, për të cilët referimi është shumë specifik dhe përfshin anëtarët drejtues të lartë, domethënë drejtorët, zëvendësdrejtorët dhe anëtarët e bordit ose funksionet ekuivalente, siç përcaktohet në paragrafin 1.33 të nenit 2 të Ligjit për PPP/LFT-në.

transaksion; dhe c) të sigurojnë monitorimin e vazhdueshëm dhe të shtuar të llogarisë dhe marrëdhënies. Për pasojë, kjo dispozitë nuk kërkon marrjen e masave të arsyeshme për të përcaktuar burimin e pasurisë së pronarëve përfitues të identifikuar si PEP-ë.

220. **Kriteri 12.2** (*I përmbushur*) – Masat e parapara me Ligjin për PPP/LFT-në në lidhje me PEP-ët janë njësoj të zbatueshme për PEP-ët e brendshëm, ndërkombëtarë dhe atyre në organizatat ndërkombëtare, pasi që të gjitha këto kategori personash janë të mbuluara me përkufizimin e PEP-ëve në paragrafin 1.33 të nenit 2 të Ligjit për PPP/LFT-në. Prandaj, përcaktimi i statusit PEP të një klienti ose një pronari përfitues bëhet siç përshkruhet në analizën për kriterin 12.1 dhe “të gjitha masat e arsyeshme” të specifikuar në kriterin 12.1 (b) deri (d) kërkojnë në të gjitha (përfshirë rrezikun më të lartë) marrëdhëniet e biznesit me PEP-ët.
221. **Kriteri 12.3** (*Pjesërisht i përmbushur*) – Anëtarët e familjes dhe bashkëpunëtorët e ngushtë me PEP-ët përfshihen vetë në përkufizimin e PEP-ëve; prandaj, të gjitha kërkesat përkatëse të kriteve 12.1 dhe 12.2, siç përshkruhen më sipër, janë të zbatueshme për ta. Megjithatë, ekziston një paqartësi juridike, siç përshkruhet në preambulën e analizës për këtë Rekomandim, lidhur me shtrirjen dhe mbulimin e masave që duhet të zbatohen në lidhje me anëtarët e familjes dhe bashkëpunëtorët e ngushtë të PEP-ëve.
222. **Kriteri 12.4** (*Pjesërisht i përmbushur*) – Paragrafi 6 i nenit 22 të Ligjit për PPP/LFT-në përcakton se në rastin e përfituesve të sigurimit të jetës, të biznesit apo investimeve të tjera të ndërlidhura ose, kur është e zbatueshme, pronarët përfitues të përfituesit, kur është përcaktuar se ata janë persona të ekspozuar politikisht vendas, të huaj ose në organizatat ndërkombëtare siç përcaktohet në këtë ligj dhe ka rreziqe më të larta të identifikuar, subjektet raportuese duhet të: a) informojnë një menaxher të lartë të subjektit raportues para pagimit të policës; b) të kryejnë kontroll të shtuar mbi të gjithë marrëdhënien e biznesit dhe mbajtësin e policës; dhe c) të konsiderojnë raportimin për transaksion të dyshimtë.
223. Për pasojë, kjo dispozitë nuk parasheh që përcaktimi nëse përfituesi dhe/ose, kur është e nevojshme, pronari përfitues i përfituesit është PEP duhet të ndodhë, më së voni, në kohën e pagesës.

Vlerësimi dhe përfundimi

224. Faktet dhe rrethanat në vijim janë konsideruar se përcaktojnë vlerësimin për Rekomandimin 12:
- Subjekteve raportuese nuk u kërkohej të vendosin sisteme të menaxhimit të rrezikut për të përcaktuar nëse një klient ose një pronar përfitues është PEP (kriteri 12.1);
 - Ekziston paqartësi juridike lidhur me shtrirjen dhe mbulimin e masave që duhet të zbatohen në lidhje me anëtarët e familjes dhe bashkëpunëtorët e ngushtë të PEP-ëve (kriteri 12.3); dhe
 - Nuk parashihet që përcaktimi nëse përfituesi dhe/ose, kur është e nevojshme, pronari përfitues i përfituesit është PEP duhet të ndodhë, më së voni, në kohën e pagesës (kriteri 12.4).
225. **Kosova është pjesërisht në përputhje me Rekomandimin 12.**

Rekomandimi 13 – Korrespondenca bankare

226. Në Raportin e Vlerësimit për PPP/LFT-në të vitit 2014, Kosova u vlerësua kryesisht në përputhje me Rekomandimin e mëparshëm 7 të FATF-së. Vlerësimi identifikoi mangësi teknike lidhur me: mungesën e përkufizimit të marrëdhënieve bankare korrespondente; mungesën e qartësisë juridike për të dalluar bankat “korrespondente” dhe “respondente”; dhe, mungesën e detyrimit për të identifikuar nëse banka e huaj (“respondente”) i është nënshtruar një hetimi për PP-në ose FT-në apo një veprimi rregullator.
227. **Kriteri 13.1** (*Kryesisht i përmbushur*) – Paragrafët 4.1-4.4 të nenit 22 të Ligjit për PPP/LFT-në përcaktojnë detyrimet për bankat dhe institucionet e tjera financiare në rastet e një marrëdhënie bankare me bankat korrespondente apo marrëdhënie të ngjashme.
228. Gjuha e kësaj dispozite, megjithëse me siguri ka ardhur në afërsi me terminologjinë e FATF-së, nuk duket të jetë mjaftueshëm e qartë për të paraparë pajtueshmërinë me kërkesat e FATF-së sipas kriterit 13.1, përfshirë edhe kërkesat për institucionet financiare korrespondente të zbulojnë nëse respondenti ka qenë subjekt i një hetimi për PP/FT-në ose veprimi rregullator.

229. Dispozita shumë më të qarta janë përcaktuar në nenin 14 të Rregullores së BQK-së për PPP/LFT-në, të cilat praktikisht përsërisin dhe interpretojnë në mënyrë të dobishme kërkesat e përcaktuara në kriterin 13.1 për mbledhjen e informacionit mbi institucionin respondent (duke përfshirë nëse i është nënshtruar hetimit apo veprimeve rregullatore për PP/FT-në), vlerësimin e kontroleve të PPP/LFT-së, marrjen e miratimit të drejtuesit të lartë para vendosjes së marrëdhënieve të reja korresponduese dhe kuptimin e qartë të përgjegjësiave të PPP/LFT-së të secilit institucion. Megjithatë, gjuha e këtij neni është shumë e saktë dhe u referohet vetëm bankave, duke lënë mënjanë marrëdhëniet e tjera të ngjashme, të cilat megjithatë raportohet se nuk ekzistojnë në Kosovë.
230. **Kriteri 13.2** (*Kryesisht i përmbushur*) – Paragrafi 4.5 i nenit 22 të Ligjit për PPP/LFT-në përcakton detyrimet për bankat dhe institucionet e tjera financiare në rast të përdorimit të llogarive të përkohshme (për pagesa) nga respondentët e tyre. Përsëri, gjuha e kësaj dispozite nuk është mjaft e qartë për të siguruar pajtueshmërinë me kriterin 13.2. ndërsa neni 14 i Rregullores së BQK-së për PPP/LFT-në parashtrohet kërkesa shumë më të qarta për parakushtet për të lejuar përdorimin e llogarive të përkohshme (për pagesa) përmes bankave respondente. Sikurse në rastin e kriterit 13.1, gjuha e këtij neni është shumë e saktë dhe u referohet vetëm bankave duke lënë përsëri mënjanë marrëdhëniet e ngjashme.
231. **Kriteri 13.3** (*Kryesisht i përmbushur*) – Paragrafi 1.7 i nenit 2 të Ligjit për PPP/LFT-në e përcakton një bankë guaskë si “një bankë ose institucion i angazhuar me aktivitete ekuivalente, i themeluar në një shtet ku nuk ka prezencë fizike, e cila bën të mundur menaxhimin dhe drejtimin pa u shoqëruar me ndonjë grup financiar të rregulluar”. Kjo duket se ka lënë anash disa elemente të përcaktimit të FATF-së për një bankë guaskë, domethënë mungesën e pranisë fizike në vendin në të cilin banka është e licencuar (në krahasim me atë që vetëm është inkorporuar) dhe mungesën e lidhjes me një grup financiar të rregulluar i cili është subjekt i mbikëqyrjes efektive të konsoliduar (në krahasim me detyrimin për mbikëqyrje joefektive dhe/ose të pakonsoliduar).
232. Paragrafi 7 i nenit 22 të Ligjit për PPP/LFT-në përcakton se “ndërmjetësit financiarë nuk mund të hapin ose të mirëmbajnë llogaritë korresponduese me një bankë fiktive (guaskë) ose një bankë e cila është e njohur që lejon përdorimin e llogarive të veta nga banka fiktive”. Autoritetet e interpretojnë termin “ndërmjetës financiar” si term që përfshin të gjitha institucionet e përfshira në ofrimin e shërbimeve të ndërmjetësimit financiar (domethënë të gjitha bankat dhe institucionet e tjera të licencuara dhe që operojnë në Kosovë).

Vlerësimi dhe përfundimi

233. Faktet dhe rrethanat në vijim janë konsideruar se përcaktojnë vlerësimin për Rekomandimin 13:
- Marrëdhëniet ndërmjet institucioneve të tjera financiare përveç bankave nuk mbulohen (kriteri 13.1 dhe kriteri 13.2); dhe
 - Përkufizimi i bankës guaskë anashkalon disa elemente të caktuara të përkufizimit të FATF-së (kriteri 13.3).
234. **Kosova është kryesisht në përputhje me Rekomandimin 13.**

Rekomandimi 14 – Shërbimet e transferimit të parave apo valutës

235. Në Raportin e Vlerësimit për PPP/LFT-në të vitit 2014, Kosova u vlerësua se ishte pjesërisht në përputhje me Rekomandimin e mëparshëm të Posaçëm VI të FATF-së. Vlerësimi identifikoi mangësi teknike që ndërlihen, ndër të tjera, me: mungesën e një funksioni ligjor për BQK-në për të zbatuar kompetencat e saj mbikëqyrëse të kujdesshme sipas legjisllacionit financiar për qëllimet e Ligjit për PPP/LFT-në; mungesën e qartësisë juridike për llojin e agjentëve që mund të emërohen; mungesën e detyrimit për ofruesit e ShTPV-ve të mbajnë një listë të agjentëve; mungesën e sanksioneve administrative efektive, proporcionale dhe zbindëse kur ofruesi i ShTPV-ve nuk është person juridik; dhe, një numër i vogël i ekzaminimeve në terren.
236. **Kriteri 14.1** (*I përmbushur*) – Sipas paragrafit 1 të nenit 3 të ligjit për Sistemet e Pagesave, bankat dhe institucionet e tjera financiare jobankare mund të angazhohen në shërbimet e pagesave të përcaktuara me autorizim. Neni 94 i Ligjit për Bankat, IMF-të dhe IFJB-të përcakton që institucionet financiare jobankare mund të angazhohen në llojin e aktivitetit “transferimin dhe pranimin e parave, ose të shërbimeve të pagesave, për

pagesat që kryhen brenda dhe jashtë vendit⁵⁷. Neni 92 i të njëjtit ligj përcakton se regjistrimi i institucionit financiar jobankar (IFJB) miratohet për një periudhë të pacaktuar kohore dhe nuk mund të transferohet. Neni 23 i ligjit për BQK-në parasheh që Banka Qendrore është ekskluzivisht përgjegjëse për, ndër të tjera, licencimin dhe regjistrimin e bankave dhe institucioneve të tjera financiare. Të gjitha IFJB-të e regjistruara duhet të regjistrohen në regjistrin e institucioneve financiare të mbajtur nga BQK-ja. Sipas Rregullores së BQK-së për Regjistrimin, Mbikëqyrjen dhe Veprimtarinë e agjentëve të IFJB-ve, domethënë personat që veprojnë në emër të një IFJB-je për ushtrimin e veprimtarisë së shërbimit të pagesave, miratohen nga BQK-ja, kurse kur një agjent është bankë, një degë e një banke të huaj ose një institucion financiar i regjistruar, IFJB-ja njofton BQK-në.

237. **Kriteri 14.2** (I përmbushur) – Neni 91 i Ligjit për Bankat, IMF-të dhe IFJB-të përcakton që asnjë person nuk mund të angazhohet në biznesin e një IFJB-je pa u regjistruar së pari në BQK sipas dispozitave të këtij ligji dhe pa qenë gjatë gjithë kohës në pajtueshmëri me këtë ligj dhe me rregulloret dhe urdhëresat në fuqi të nxjerra nga BQK-ja. Sipas paragrafit 1 të nenit 3 të ligjit për Sistemet e Pagesave, bankat dhe IFJB-të mund të angazhohen në shërbimet e pagesave të përcaktuara me autorizim. Paragrafi 1 i nenit 21 të të njëjtit ligj përcakton se çdo person që bie në kundërshtim me dispozitën në fjalë është fajtor për vepër penale dhe, me dënim, mund t'i nënshtrohet burgimit deri në 7 vjet dhe gjobës deri në 30 mijë euro.
238. **Kriteri 14.3** (I përmbushur) – Paragrafi 1 i nenit 16 të Ligjit për PPP/LFT-në përcakton bankat dhe institucionet e tjera financiare (përfshirë ShTPV-të) si subjekte raportuese për qëllime të këtij ligji. Prandaj, të gjitha detyrimet e subjekteve raportuese sipas Ligjit për PPP/LFT-në zbatohen për ofruesit e ShTPV-ve, ku BQK-ja dhe NjIF-i ndajnë përgjegjësitë për mbikëqyrjen e zbatimit të këtyre detyrimeve siç përkrahur në analizën për Rekomandimet 26 dhe 27. Me qëllim të marrjes së autorizimit për kryerjen e ShTPV-ve, bankave dhe institucioneve e tjera financiare u kërkohet nga paragrafi 3.14 i nenit 3 të Ligjit për Sistemet e Pagesave të ofrojnë dëshmi për aftësinë për të vepruar në përputhje me Ligjin për PPP/LFT-në.
239. **Kriteri 14.4** (I përmbushur) – Paragrafi 1.1 i nenit 1 të ligjit për Sistemin e pagesave përcakton agjentët si persona që veprojnë në emër të bankave ose institucioneve të tjera të pagesave për të ofruar disa nga shërbimet e tyre. Neni 13 i të njëjtit ligj përcakton se bankat dhe institucionet e tjera të autorizuara të pagesave do të lejohen të përdorin agjentë me autorizim të veçantë nga BQK-ja. Në rastin e lëshimit të autorizimit, BQK-ja e rendit agjentin në një regjistër të disponueshëm për publikun. Institucionet e pagesave duhet të sigurojnë që agjentët që veprojnë në emër të tyre të informojnë shfrytëzuesit e shërbimit të pagesave për këtë fakt.
240. **Kriteri 14.5** (I përmbushur) – Paragrafi 4 i nenit 24 të Ligjit për PPP/LFT-në kërkon që bankat dhe institucionet financiare të sigurojnë se personat fizikë apo juridikë që veprojnë si degë, filiale apo agjentë në emër të tyre janë të përfshirë në programet për parandalimin dhe luftimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, si dhe monitorohen për sa i përket pajtueshmërisë me dispozitat e këtij ligji.

Vlerësimi dhe përfundimi

241. Të gjitha kriteret që përcaktojnë kërkesat në lidhje me shërbimet e transferimit të parave ose vlerave janë përmbushur. **Kosova është në përputhje me Rekomandimin 14.**

Rekomandimi 15 – Teknologjitë e reja

242. Në Raportin e Vlerësimit për PPP/LFT-në të vitit 2014, Kosova u vlerësua se ishte kryesisht në përputhje me Rekomandimin e mëparshëm 8 të FATF-së. Vlerësimi identifikoi mangësitë teknike që lidhen me paqartësinë juridike në zbatimin e marrëdhënieve të biznesit në distancë.
243. **Kriteri 15.1** (I përmbushur) – Paragrafi 1 i nenit 18 të Ligjit për PPP/LFT-në përcakton që NjIF-i siguron në mënyrë periodike dhe bashkërendon vlerësimin kombëtar të rrezikut për sa i përket PP/FT-së, për të identifikuar dhe vlerësuar rrezikun dhe për t'i bërë rekomandime Qeverisë në përcaktimin e politikave, strategjive dhe masave për

⁵⁷ Posta e Kosovës [është e regjistruar](#) si ofrues i ShTPV-ve e angazhuar në "shërbime pagese për pagesa juridike, letërnjoftim personal, regjistrimin e automjeteve, tatime dhe pagesa të tjera".

menaxhimin e rrezikut dhe për të zvogëluar rreziqet e identifikuar. Paragrafi 3 i të njëjtit nen përcakton që, për këtë qëllim, subjektet raportuese identifikojnë dhe vlerësojnë më tej rreziqet e PP/FT-së që mund të lindin në lidhje me zhvillimin e produkteve të reja dhe praktikave të reja të biznesit, përfshirë mekanizmat dhe kanalet e reja të shpërndarjes dhe përdorimin e teknologjive të reja dhe atyre në zhvillim për produkte të reja ose ekzistuese.

244. **Kriteri 15.2** (*I përmbushur*) – Dispozitat e paragrafit 3 të nenit 18 të Ligjit për PPP/LFT-në dhe të paragrafit 8 të nenit 7 të Rregullores së BQK-së për PPP/LFT-në kërkojnë që institucionet financiare të identifikojnë dhe vlerësojnë rreziqet e PP/FT-së që mund të lindin në lidhje me: a) zhvillimin e produkteve dhe praktikave të reja të biznesit, përfshirë mekanizmat e rinj të shpërndarjes; b) përdorimin e teknologjive të reja dhe atyre në zhvillim, si për produktet e reja ashtu edhe për ato ekzistuese. Një vlerësim i tillë i rrezikut duhet të bëhet para futjes në përdorim të produkteve të reja, praktikave të biznesit dhe teknologjive të reja ose në zhvillim.

Vlerësimi dhe përfundimi

245. Të gjitha kriteret që përcaktojnë kërkesat lidhur me teknologjitë e reja janë përmbushur.
Kosova është në përputhje me Rekomandimin 15.

Rekomandimi 16 – Transfertat elektronike

246. Në Raportin e Vlerësimit për PPP/LFT-në të vitit 2014, Kosova u vlerësua se ishte pjesërisht në përputhje me Rekomandimin e mëparshëm të Posaçëm VII të FATF-së. Vlerësimi identifikoi mangësitë teknike lidhur me: mungesën e qartësisë juridike për shkak të mungesës së përkufizimit të terminologjisë së përdorur; mungesën e lidhjes në masat e KDK-së ndërmjet transfertave elektronike dhe kujdesit të duhur ndaj klientit; paqartësinë juridike për mbajtjen e të dhënave lidhur me transfertat bankare; mungesën e udhëzimeve për përdorimin e transfertave bankare në grumbull dosjesh; përdorimin e pakushtëzuar të një numri unik referimi; mungesën e detyrimit për bankat dhe institucionet e tjera financiare që të kenë procedura të bazuara në rrezik për të shqyrtuar transfertat bankare; dhe shqetësimet për zbatimin e sanksioneve.
247. Sipas paragrafit 9 të nenit 24 të Ligjit për PPP/LFT-në, kërkesat për transfertat elektronike nuk zbatohen për transfertat të ekzekutuara si rezultat i transaksioneve me kartë krediti ose kartë debiti, me kusht që numri i kartës së kreditit ose kartës së debitit të shoqërojë transfertën e rezultuar nga transaksioni, dhe nuk do të zbatohet për transfertat midis bankave dhe/ose institucioneve financiare ku të dy, iniciatori dhe përfituesi, janë banka apo institucione financiare që veprojnë në emër të tyre. Për rrjedhojë, kjo dispozitë nuk përcakton që kërkesat e transfertës elektronike mund të braktisen në rast të transfertave që rrjedhin nga një transaksion duke përdorur një kartelë krediti ose debiti ose parapagimi, nëse ato përdoren vetëm për blerjen e mallrave ose shërbimeve dhe se ato duhet të zbatohen sa herë që një kartelë krediti ose debiti ose parapagimi përdoret si sistem i pagesave për të kryer një transfertë elektronike prej një personi te personi tjetër, duke siguruar gjithashtu që informacioni i nevojshëm duhet të përfshihet në mesazh.

Institucionet financiare urdhëruese

248. **Kriteri 16.1** (*Pjesërisht i përmbushur*) – Paragrafi 1.44 i nenit 2 të Ligjit për PPP/LFT-në përcakton transfertat elektronike si çfarëdo transaksioni i kryer në emër të personit iniciues, fizik dhe juridik, përmes një institucioni financiar me anë të mjeteve elektronike me qëllim të vënies së një sasive të të hollave në dispozicion të një personi përfitues në një institucion tjetër financiar.
249. Paragrafi 6 i nenit 24 të Ligjit për PPP/LFT-në kërkon që bankat dhe institucionet financiare aktivitetet e të cilave përfshijnë transfertat elektronike të marrin dhe verifikojnë emrin e plotë, numrin e llogarisë, adresën, ose në mungesë të adresës numrin e dokumentit të identifikimit, ose datën dhe vendin e lindjes, duke përfshirë kur është e nevojshme emrin e institucionit financiar, të autorit të transfertave të tilla. Informacioni përfshihet në mesazhin ose formularin e pagesës që shoqëron transfertën. Nëse nuk ka numër llogarie, një numër unik referimi e shoqëron transfertën.
250. Paragrafët 1 dhe 2 i nenit 13 të Rregullores së BQK-së për PPP/LFT-në më tej kërkojnë që bankat dhe institucionet e tjera financiare duhet të marrin dhe të mbajnë informacion të plotë të iniciuesit (autorit) të transfertave elektronike dhe të verifikojnë, që informacioni është i saktë dhe kuptimplotë. Informacionet e tilla duhet të përmbajnë së paku: a) emrin

e iniciuesit; b) numrin e llogarisë së iniciuesit ose një numër unik referimi nëse nuk e ka numrin e llogarisë; c) adresën, numrin personal të identifikimit të iniciuesit, datën dhe vendin e lindjes; d) emrin e përfituesit; e) numrin e llogarisë së përfituesit ku llogaria e tillë është përdorur për të procesuar transaksionin.

251. Për pasojë, dispozitat e mësipërme nuk kërkojnë që: a) numri i llogarisë së iniciuesit që shoqëron transfertën elektronike është veçanërisht numri i llogarisë që përdoret për të procesuar transaksionin (në krahasim me numrin e çdo llogarie tjetër të iniciuesit); b) në mungesë të një llogarie iniciuese, numri unik i referimit: b.1) është ai i transaksionit specifik (në krahasim me ndonjë numër tjetër unik referimi që mund t'i caktohet klientit); b.2) është ai që lejon gjurmueshmërinë e transaksionit; dhe c) në mungesë të një llogarie përfituese dhe kur numri i llogarisë së iniciuesit përdoret për të procesuar transaksionin (domethënë një numër unik i referimit të transaksionit nuk gjenerohet si pjesë e informacionit të kërkuar të iniciuesit), një numër referimi unik i transaksionit që lejon gjurmueshmërinë e transaksionit shoqëron transfertën elektronike.
252. **Kriteri 16.2** (*Pjesërisht i përmbushur*) – Legjislacioni në fuqi nuk specifikon në mënyrë specifike rastet kur disa transfertat individuale ndërkufitare elektronike nga një iniciues i vetëm grupohen në një grumbull dosjesh për transmetim të përfituesit. Paragrafi 3 i nenit 13 të Rregullores së BQK-së për PPP/LFT-në kërkon që bankat dhe institucionet financiare duhet të përfshijnë informacion të plotë të iniciuesit, siç përcaktohet në paragrafin 2 të të njëjtit nen (domethënë, duke përfshirë emrin e përfituesit dhe numrin e llogarisë së përfituesit kur një llogari e tillë përdoret për procesim të transaksionit), në mesazh ose në formën e pagesës që shoqëron transfertën. Rrjedhimisht, për transmetimin e informacioneve në grumbull dosjesh, mangësitë e identifikuara në analizën për kriterin 16.1 (në lidhje me informacionin e kërkuar dhe të saktë të iniciatorit dhe informacionin e plotë të përfituesit) janë të rëndësishme po ashtu për qëllimet e kriterit 16.2.
253. **Kriteri 16.3** (*Nuk aplikohet*) – Legjislacioni në fuqi nuk përcakton një prag minimal për zbatimin e kërkesave të transfertës elektronike, pra këto kërkesa zbatohen për të gjitha transfertat bankare pavarësisht nga shuma.
254. **Kriteri 16.4** (*I përmbushur*) – Paragrafi 1 i nenit 13 të Rregullores së BQK-së për PPP/LFT-në parasheh që bankat dhe institucionet e tjera financiare të verifikojnë në të gjitha rastet (domethënë, pavarësisht nëse dhe duke përfshirë kur ekzistojnë dyshime të PP/FT-së) se informacioni i plotë i iniciuesit, siç përcaktohet në paragrafin 2 të të njëjtit nen, është i saktë dhe kuptimplotë.
255. **Kriteri 16.5** (*Pjesërisht i përmbushur*) – Paragrafi 4 i nenit 13 të Rregullores së BQK-së për PPP/LFT-në parasheh që, në rastin e transfertave të brendshme elektronike, është e mjaftueshme për institucionin financiar urdhërues të përfshijë vetëm numrin e llogarisë së iniciatorit ose kur nuk ekziston një numër i llogarisë një numër identifikues unik, së bashku me mesazhin ose formën e pagesës, duke siguruar se informacioni i plotë i iniciatorit mund të vihet në dispozicion të bankës ose institucionit tjetër financiar përfitues edhe për NjIF-in ose BQK-në.
256. Rrjedhimisht, kjo dispozitë kërkon që informacioni i iniciuesit të vihet në dispozicion, në mënyrë të pandryshueshme, të NjIF-it ose BQK-së dhe nuk kërkon vënien në dispozicion të këtyre informatave për autoritete të tjera përkatëse, siç janë organet e zbatimit të ligjit ose autoritetet e prokurorisë. Për më tepër, mangësitë e identifikuara në analizën për kriterin 16.1 (në lidhje me mungesën e specifikimit në lidhje me numrin e llogarisë dhe numrin unik të referimit) janë të rëndësishme po ashtu për qëllimet e kriterit 16.5.
257. **Kriteri 16.6** (*Nuk aplikohet*) – Legjislacioni në fuqi nuk parasheh mjete të tjera që mund të përdoren për të vënë informacionin që shoqëron transfertat elektronike vendase në dispozicion të institucioneve financiare përfituese dhe autoriteteve përkatëse.
258. **Kriteri 16.7** (*Pjesërisht i përmbushur*) – Paragrafi 2 i nenit 20 të Ligjit për PPP/LFT-në parasheh që në rastin e transfertave elektronike, bankat dhe institucionet financiare mbajnë një regjistër të të gjitha informatave përkatëse për sa i përket pagesit dhe që shoqërojnë një transfertë, të gjitha informatat e marra për pagesin dhe të gjitha informatat që shoqërojnë një transfertë kur ato veprojnë respektivisht si dërgues për një periudhë prej pesë (5) vitesh nga data e ekzekutimit të transaksionit. Kjo dispozitë e përgjithshme që u referohet "të gjithë informatave që shoqërojnë një transfertë" nuk përbën kërkesë që institucionet financiare urdhëruese të ruajnë informacionin e mbledhur të përfituesit në rast të transfertave elektronike, në përputhje me Rekomandimin 11.

259. Në lidhje me këtë, kërkesa, sipas paragrafit 8 të nenit 13 të Rregullores së BQK-së për PPP/LFT-në që përcakton se institucionet financiare urdhëruese duhet të mbajnë informacionin e plotë të iniciuesit që shoqëron transferimin e fondeve për një periudhë prej 5 vjetësh, gjithashtu nuk përmbush kërkesat në kriterin 16.7 për aq sa nuk parasheh ruajtjen e të gjitha informacioneve të përfituesit dhe sigurisht përjashton mbajtjen e informacionit të tillë që mund të nxirret nga kërkesa e paragrafit 2 të nenit 20 të Ligjit për PPP/LFT-në për të ruajtur "të gjitha informatat e tjera që shoqërojnë një transfertë kur [bankat dhe institucionet e tjera financiare] veprojnë si iniciues".
260. **Kriteri 16.8** (*Nuk është përmbushur*) – Legjislacioni në fuqi nuk përcakton që institucioni financiar urdhërues nuk lejohet të ekzekutojë transfertën bankare nëse nuk përputhet me të gjitha kërkesat përkatëse siç janë përcaktuar në analizën për kriteret 16.1 deri në 16.7 më sipër.

Institucionet financiare ndërmjetësuese

261. **Kriteri 16.9** (*Pjesërisht i përmbushur*) – Sipas paragrafit 7 të nenit 24 të Ligjit për PPP/LFT-në, bankat dhe institucionet financiare ruajnë këtë informacion dhe e transmetojnë atë në momentin kur veprojnë si ndërmjetësues në zinxhirin e pagesave. Rrjedhimisht, në lidhje me kërkesën për të mbajtur të gjitha informacionet e iniciuesit dhe përfituesit që shoqërojnë një transfertë elektronike, mangësitë e identifikuar në analizën për kriterin 16.1 janë të rëndësishme gjithashtu për qëllimet e kriterit 16.9.
262. **Kriteri 16.10** (*I përmbushur*) – Paragrafi 2 i nenit 20 për PPP/LFT-në parasheh që në rastin e transfertave elektronike, bankat dhe institucionet financiare mbajnë një regjistër të të gjitha informatave përkatëse për sa i përket pagesit dhe që shoqërojnë një transfertë, të gjitha informatat e marra për pagesin dhe të gjitha informatat që shoqërojnë një transfertë kur ato veprojnë respektivisht si ndërmjetës për një periudhë prej pesë (5) vitesh nga data e ekzekutimit të transaksionit. Paragrafi 10 i nenit 13 të Rregullores së BQK-së për PPP/LFT-në më tej parasheh që institucioni financiar ndërmjetësues duhet të mbajë shënime për të gjitha informatat të cilat shoqërojnë transferimin e fondeve për një periudhë prej pesë (5) viteve. Këto kërkesa zbatohen në të gjitha rastet dhe nuk kufizohen në situatat kur kufizimet teknike pengojnë informacionet e kërkuara të iniciuesit ose të përfituesit që shoqërojnë një transfertë elektronike ndërkufitare të mbeten me një transfertë elektronike vendore të ndërlidhur.
263. **Kriteri 16.11** (*Pjesërisht i përmbushur*) – Paragrafi 10 i nenit 24 të Ligjit për PPP/LFT-në përcakton që nëse bankat ose institucionet financiare pranojnë transferta bankare të cilat nuk e përmbajnë informacionin e plotë mbi autorin, ato duhet të marrin masa për të siguruar dhe verifikuar informacionin që mungon nga institucioni që bën porosinë ose përfituesi. Për pasojë, kjo dispozitë nuk nënkupton që institucionet financiare ndërmjetëse të marrin masa të arsyeshme, të cilat janë në përputhje me përpunimin e drejtpërdrejtë, për të identifikuar transfertat elektronike ndërkufitare që nuk përmbajnë informacionin e kërkuar për iniciuesin apo informacionin e kërkuar për përfituesin.
264. **Kriteri 16.12** (*Pjesërisht i përmbushur*) – Sipas paragrafit 10 të nenit 24 të Ligjit për PPP/LFT-në, nëse bankat ose institucionet financiare pranojnë transferta bankare të cilat nuk e përmbajnë informacionin e plotë mbi autorin, ato duhet të marrin masa për të siguruar dhe verifikuar informacionin që mungon, ose përndryshe ata e refuzojnë pranimin e transfertës dhe i raportojnë për këtë NjIF-it. Për pasojë, kjo dispozitë nuk përbën kërkesë që institucionet financiare ndërmjetëse të kenë politika dhe procedura të bazuara në rrezik për të përcaktuar: a) kur duhet të ekzekutojnë, refuzojnë ose pezullojnë një transfertë elektronike, e cila nuk përmban informacionet e kërkuara për iniciuesin ose përfituesin; dhe b) veprimet e duhura përcjellëse.

Institucionet financiare përfituese

265. **Kriteri 16.13** (*Pjesërisht i përmbushur*) – Paragrafi 5 i nenit 13 të Rregullores së BQK-së për PPP/LFT-në përcakton që institucionet financiare përfituese duhet të kenë procedura për ndjeshmëri të rrezikut për të identifikuar dhe vëzhguar transfertat elektronike, që nuk janë të shoqëruara me informacion të plotë të iniciuesit. Për rrjedhojë, kjo dispozitë nuk kërkon që institucionet financiare përfituese të marrin masa të arsyeshme⁵⁸ për të identifikuar transfertat elektronike ndërkufitare të cilat nuk kanë informacionin e kërkuar për përfituesin.

⁵⁸ Këto mund të përfshijnë monitorimin pas ngjarjes ose monitorimin në kohë reale sipas mundësisë.

266. **Kriteri 16.14** (*Pjesërisht i përmbushur*) – Paragrafi 2 i nenit 24 të Ligjit për PPP/LFT-në përcakton që, përveç detyrimeve që lidhen me KDK-në të parapara në nenin 19 të këtij ligji, bankat dhe institucionet financiare verifikojnë identitetin e të gjithë klientëve (p.sh. përfshirë përfituesit e transfertave elektronike) kur, ndër të tjera, kryejnë transfertat elektronike vendore ose ndërkombëtare të fondeve. Në këtë drejtim, mungesa në lidhje me transaksionet që janë transfertat elektronike dhe kryhen nëpërmjet institucioneve financiare të ndryshme nga bankat, siç përcaktohet në analizën për kriterin 10.2, është e rëndësishme edhe për qëllimet e kriterit 16.14.
267. Paragrafi 2 i nenit 20 të Ligjit për PPP/LFT-në parasheh që, në rastin e transfertave elektronike, bankat dhe institucionet financiare mbajnë një regjistër të të gjitha informatave përkatëse për sa i përket paguesit dhe që shoqërojnë një transfertë, të gjitha informatat e marra për paguesin dhe të gjitha informatat që shoqërojnë një transfertë kur ato veprojnë respektivisht si institucion përfitues për një periudhë prej pesë (5) vitesh nga data e ekzekutimit të transaksionit. Kjo dispozitë e përgjithshme që u referohet “të gjitha informacioneve të tjera që shoqërojnë një transfertë” nuk përbën kërkesë për institucionet financiare përfituese që informacionet e verifikuara për identitetin e përfituesit të mbledhura në rast të transfertave bankare të ruhen në përputhje me Rekomandimin 11.
268. **Kriteri 16.15** (*Pjesërisht i përmbushur*) – Paragrafi 5 i nenit 13 të Rregullores së BQK-së për PPP/LFT-në përcakton që institucionet financiare përfituese duhet të kenë procedura për ndjeshmëri të rrezikut për të identifikuar dhe vëzhguar transfertat elektronike, që nuk janë të shoqëruara me informacion të plotë të iniciuesit. Sipas paragrafit 10 të nenit 24 të Ligjit për PPP/LFT-në, nëse bankat ose institucionet financiare pranojnë transfertat bankare të cilat nuk e përmbajnë informacionin e plotë mbi autorin, ato duhet të refuzojnë pranimin e transfertës dhe i raportojnë për këtë NjIF-it. Për rrjedhojë, kjo dispozitë nuk përbën kërkesë që institucionet financiare përfituese të kenë politika dhe procedura të bazuara në rrezik për të përcaktuar: a) kur duhet të ekzekutojnë, refuzojnë ose pezullojnë një transfertë elektronike, e cila nuk përmban informacionet e kërkuara për përfituesin; dhe b) veprimet e duhura përcjellëse.

Operatorët e shërbimeve të transferimit të parasë apo vlerave

269. **Kriteri 16.16** (*I përmbushur*) – Paragrafi 1 i nenit 16 të Ligjit për PPP/LFT-në përcakton bankat dhe institucionet e tjera financiare (përfshirë ShTPV-të) si subjekte raportuese për qëllime të këtij ligji. Në përputhje me këtë, të gjitha detyrimet e subjekteve raportuese sipas Ligjit për PPP/LFT-në, përfshirë edhe ato për transfertat bankare, zbatohen për ofruesit e ShTPV-ve. Paragrafi 4 i nenit 24 të Ligjit për PPP/LFT-në kërkon që bankat dhe institucionet financiare të sigurojnë se personat fizikë apo juridikë që veprojnë si degë, filiale apo agjentë në emër të tyre janë të përfshirë në programet për parandalimin dhe luftimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, si dhe monitorohen për sa i përket pajtueshmërisë me dispozitat e këtij ligji.
270. **Kriteri 16.17** (*Pjesërisht i përmbushur*) – Legjislacioni në fuqi nuk u referohet në mënyrë specifike situatave kur ofruesit e ShTPV-ve kontrollojnë si anën urdhëruese ashtu edhe atë përfituese të një transfertat elektronike. Sipas paragrafit 10 të nenit 24 të Ligjit për PPP/LFT-në, nëse bankat ose institucionet financiare pranojnë transfertat bankare të cilat nuk e përmbajnë informacionin e plotë mbi autorin, ato duhet të refuzojnë pranimin e transfertës dhe i raportojnë për këtë NjIF-it. Për pasojë, kjo dispozitë nuk përbën kërkesë që bankat dhe institucionet e tjera financiare: a) të marrin parasysht të gjitha informatat nga pala përfituese; dhe b) të paraqesin një RTD në secilin vend të prekur nga transfertat elektronike e dyshimtë.

Zbatimi i sanksioneve financiare të shënjestruara

271. **Kriteri 16.18** (*Nuk është përmbushur*) – Legjislacioni në fuqi nuk kërkon që bankat dhe institucionet e tjera financiare të ndërmarrin veprime të ngrirjes dhe të veprojnë në përputhje me ndalimet nga kryerja e transaksioneve për personat dhe subjektet e përcaktuara në kontekstin e transfertave elektronike, sipas detyrimeve të përcaktuara në RKSKB-të lidhur me parandalimin dhe shtypjen e terrorizmit dhe financimit të terrorizmit, si RKSKB-të 1267 dhe 1373, dhe rezolutat e tyre pasardhëse.

Vlerësimi dhe përfundimi

272. Faktet dhe rrethanat në vijim janë konsideruar se përcaktojnë vlerësimin për Rekomandimin 16:

- Dispozitat për transfertat elektronike nuk kërkojnë që: a) numri i llogarisë së iniciuesit që shoqëron transfertën elektronike është veçanërisht numri i llogarisë që përdoret për të procesuar transaksionin; b) në mungesë të një llogarie iniciuese, numri unik i referimit: b.1) është ai i transaksionit specifik; b.2) është ai që lejon gjurmueshmërinë e transaksionit; dhe c) në mungesë të një llogarie përfituese dhe kur numri i llogarisë së iniciuesit përdoret për të procesuar transaksionin, një numër referimi unik i transaksionit që lejon gjurmueshmërinë e transaksionit shoqëron transfertën elektronike (kriteri 16.1);
- Të njëjtat mangësi janë të rëndësishme në lidhje me rregullimin e transfertave në grumbull dosjesh (kriteri 16.2);
- Informacioni i iniciuesit për transfertat e brendshme elektronike kërkohet që të vihet në dispozicion, në mënyrë të pandryshueshme, të NjIF-it ose BQK-së, por jo të autoriteteve të tjera përkatëse dhe mangësitë e identifikuar në analizën për kriterin 16.1 janë të rëndësishme për transfertat e brendshme elektronike (kriteri 16.5);
- Institucioneve financiare urdhëruese nuk u kërkohet të ruajnë informacionin e mbledhur të përfituesit, në përputhje me Rekomandimin 11 (kriteri 16.7); dhe nuk ndalohej ekzekutimi i transfertës bankare nëse nuk është në përputhje me të gjitha kërkesat përkatëse të specifikuara në kriteret 16.1 deri në 16.7 (kriteri 16.8);
- Mangësitë e identifikuar në analizën për kriterin 16.1 janë të rëndësishme në lidhje me institucionet financiare ndërmjetëse në transfertat elektronike ndërkufitare (kriteri 16.9);
- Institucioneve financiare ndërmjetëse nuk u kërkohet që të marrin masa të arsyeshme, të cilat janë në përputhje me përpunimin e drejtpërdrejtë, për të identifikuar transfertat elektronike ndërkufitare që nuk përmbajnë informacionin e kërkuar për iniciuesin apo informacionin e kërkuar për përfituesin (kriteri 16.11); dhe të kenë politika dhe procedura të bazuara në rrezik, për të përcaktuar: a) kur duhet të ekzekutojnë, refuzojnë ose pezullojnë një transfertë elektronike, e cila nuk përmban informacionet e kërkuara për iniciuesin ose përfituesin; dhe b) veprimet e duhura përcjellëse (kriteri 16.12);
- Institucioneve financiare përfituese nuk u kërkohet të marrin masa të arsyeshme për të identifikuar transfertat elektronike ndërkufitare të cilat nuk kanë informacionin e kërkuar për përfituesin (kriteri 16.13);
- Verifikimi i identitetit të përfituesit përballet me mangësitë e përcaktuara në analizën për kriterin 10.2. Institucioneve financiare përfituese nuk u kërkohet që të ruajnë informacionet e verifikuara për identitetin e përfituesit në përputhje me Rekomandimin 11 (kriteri 16.14); dhe të kenë politika dhe procedura të bazuara në rrezik, për të përcaktuar: a) kur duhet të ekzekutojnë, refuzojnë ose pezullojnë një transfertë elektronike, e cila nuk përmban informacionet e kërkuara për përfituesin; dhe b) veprimet e duhura përcjellëse (kriteri 16.15);
- Bankat dhe institucionet e tjera financiare që kontrollojnë si anën urdhëruese ashtu edhe atë përfituese të një transferte elektronike nuk janë të detyruara: a) të marrin parasysh të gjitha informatat nga pala përfituese; dhe b) të paraqesin një RTD në secilin vend të prekur nga transfertat elektronike e dyshimtë (kriteri 16.17); dhe
- Legjislacioni në fuqi nuk kërkon që bankat dhe institucionet e tjera financiare të ndërmarrin veprime të ngrirjes dhe të veprojnë në përputhje me ndalimet nga kryerja e transaksioneve për personat dhe subjektet e përcaktuara në kontekstin e transfertave elektronike, sipas detyrimeve të përcaktuara në RSKB-të lidhur me parandalimin dhe shtypjen e terrorizmit dhe financimit të terrorizmit (kriteri 16.18).

273. **Kosova është pjesërisht në përputhje me Rekomandimin 16.**

Rekomandimi 17 – Mbështetja te palët e treta

274. Në Raportin e Vlerësimit për PPP/LFT-në të vitit 2014, Kosova u vlerësua në mospërputhje me Rekomandimin e mëparshëm 9 të FATF-së. Vlerësimi identifikoi mangësitë teknike që lidhen me mungesën e dispozitave të qarta juridike dhe, për rrjedhim, mungesën e kriterëve për mbështetje që bëhet në praktikë.

275. **Kriteri 17.1** (Nuk është përmbushur) – Legjislacioni në fuqi është i heshtur në lidhje me mbështetjen te institucionet financiare dhe BPCJF-të të palëve të treta për të kryer elemente të caktuara të masave të KDK-së (identifikimi i klientit, identifikimi i pronarit përfitues dhe të kuptuarit e natyrës së biznesit) ose për prezantimin e biznesit. Kjo do të

thotë që një mbështetje e tillë, edhe pse nuk lejohet në mënyrë të qartë, as nuk është e ndaluar në mënyrë specifike në Kosovë dhe, për rrjedhojë, nuk ekzistojnë kushte ose detyrime të zbatueshme në rast se subjektet raportuese e praktikojnë atë në baza rutinore ose *ad hoc*.

276. **Kriteri 17.2** (*Nuk është përmbushur*) – Legjisllacioni në fuqi nuk ofron rregullime dhe kushte për përcaktimin e vendeve në të cilat mund të vendoset pala e tretë.
277. **Kriteri 17.3** (*Nuk është përmbushur*) – Sipas paragrafit 5 të nenit 24 të Ligjit për PPP/LFT-në, bankat dhe institucionet financiare zbatojnë programe në kuadër të grupit që mbulojnë degët e tyre të huaja dhe filialet, në të cilat grupi zotëron shumicën e pronësisë, kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, përfshirë politikat dhe procedurat për shkëmbimin e informatave brenda grupit për qëllime të këtij ligji. Kjo, megjithatë, mund të merret se siguron pajtueshmëri të pjesshme me kriterin 17.3 (a) (në lidhje me programet për PPP/LFT-në në nivel të gjerë në pajtim me Rekomandimin 18), ndërsa të gjitha elementet e tjera të kriterit 17.3 nuk përmbushen.

Vlerësimi dhe përfundimi

278. Asnjë nga kriteret e Rekomandimit 17 nuk është përmbushur.
279. **Kosova është në mospërputhje me Rekomandimin 17.**

Rekomandimi 18 – Kontrollet e brendshme dhe degët e filialet e huaja

280. Në Raportin e Vlerësimit për PPP/LFT-në të vitit 2014, Kosova u vlerësua pjesërisht në përputhje me Rekomandimin e mëparshëm 15 të FATF-së, dhe në mospërputhje me Rekomandimin e mëparshëm 22 të FATF-së. Vlerësimi identifikoi mangësi teknike të ndërlidhura, ndër të tjera, me: mungesën e kriterëve të përshtatshme për emërimin e zyrtarit të pajtueshmërisë; mungesën e roleve dhe përgjegjësi të përcaktuara në mënyrë të përshtatshme të zyrtarit të pajtueshmërisë; mungesën e dispozitave ligjore të përshtatshme për kompetencat e zyrtarit të pajtueshmërisë për qasje në kohë në informacion; funksionin e kufizuar të auditimit të brendshëm në testimin e sistemit të raportimit dhe të identifikimit sipas Ligjit për PPP/LFT-në; mungesën e statistikave për trajnim; mospërputhjen ligjore në shqyrtimin e detyrimeve për rekrutët e rinj; dhe, mungesën e dispozitave ligjore ose rregullatore për zbatimin e masave të PPP/LFT-së për degët dhe filialet jashtë Kosovës.
281. **Kriteri 18.1** (*Pjesërisht i përmbushur*) – Paragrafët 1 dhe 2 të nenit 17 të Ligjit për PPP/LFT-në përcaktojnë një detyrim të përgjithshëm që veprimet dhe masat për parandalimin dhe zbulimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit merren nga të gjitha subjektet raportuese para, gjatë, dhe pas ekzekutimit të transaksionit ose krijimit të marrëdhënies afariste. Për këtë qëllim, subjekteve raportuese u kërkohet të nxjerrin politika dhe procedura të brendshme të shkruara, të vendosin dhe zbatojnë kontrolle për parandalimin dhe zbulimin e PP/FT-së. Për pasojë, kjo dispozitë nuk kërkon që programet e subjekteve raportuese kundër PP/FT-së të konsiderojnë rreziqet e PP/FT-së dhe madhësinë e biznesit.
282. **Rregullat për menaxhimin e pajtueshmërisë** – Sipas paragrafit 2.4 të nenit 17 të Ligjit për PPP/LFT-në, politikat, procedurat dhe kontrollet e subjekteve raportuese duhet të parashohin emërimin e zyrtarit të pajtueshmërisë. Neni 21 i ligjit përcakton detyrimin për emërimin e zyrtarit të pajtueshmërisë (si dhe zëvendësin e zyrtarit të pajtueshmërisë në baza të përhershme për bankat) në një pozicion me kompetenca që lejojnë një performancë efektive dhe cilësore të të gjitha detyrave të përcaktuara në ligj në mënyrë të pandikuar. Rregulla të tjera të menaxhimit të pajtueshmërisë përfshijnë sigurimin e funksionit të pajtueshmërisë me qasje në të dhëna, informacione dhe dokumentacion, burime njerëzore, materiale, TI dhe burime të tjera, hapësirë për zyrë dhe kushte teknike.
283. Funksioni i pajtueshmërisë për bankat udhëhiqet nga një menaxher i lartë dhe është i pavarur nga të gjitha funksionet e tjera të subjektit raportues, me kusht që ky të ketë kapacitete të mjaftueshme administrative për këtë. Për pasojë, me përjashtim të bankave, nuk ka asnjë dispozitë që kërkon emërimin e zyrtarit të pajtueshmërisë në nivelin drejtues.
284. **Përzgjedhja e punonjësve** – Sipas paragrafit 5 të nenit 21 të Ligjit për PPP/LFT-në, NjIF-i nxjerr akte nënligjore për të përkufizuar kriteret për "i përshtatshëm" dhe "i duhur" për zyrtarë të pajtueshmërisë. Për këtë qëllim, në vitin 2017 NjIF-i nxori Rregulloren

nr. 01/2017, e cila përcakton kriteret për përshtatshmëri për funksionin e pajtueshmërisë në banka dhe lloje të caktuara të institucioneve të tjera financiare⁵⁹. Për rrjedhojë, këto kritere nuk janë përcaktuar për të gjitha llojet e institucioneve financiare, dhe nuk ka kritere të ngjashme/procedura të shqyrtimit⁶⁰ të vendosura për punësimin e stafit në funksione të rëndësishme për PPP/LFT-në (p.sh. punonjësit përgjegjës për kontaktimin e klientëve, kryerjen e transaksioneve, kryerjen e KDK-së dhe masave të ndërlidhura).

285. Paragrafi 2 i nenit 20 të Rregullores së BQK-së për PPP/LFT-në thekson se institucionet financiare do të zbatojnë masa të përgjithshme për të siguruar që punonjësit e tyre, sidomos stafi që ka kontakt me klientët ose ekzekutimin e transaksioneve dhe stafi brenda funksionit për PPP/LFT-në, nuk kanë një të kaluar kriminale ose nuk janë objekt i një ndjekje të vazhdueshme penale për krime financiare, terrorizmi ose ndonjë krim tjetër të rëndë që mund ta vë në dyshim besueshmërinë e tyre.
286. *Trajnimi i vazhdueshëm* – Sipas paragrafit 2.5 të nenit 17 të Ligjit për PPP/LFT-në, politikat, procedurat dhe kontrollet e subjekteve raportuese duhet të parashohin sigurimin e organizimit dhe financimit të programit për trajnimin dhe aftësimin e të punësuarve mbi përgjegjësitë e parapara me këtë ligj. Për më tepër, sipas paragrafit 4.4 të nenit 21 të Ligjit për PPP/LFT-në, subjektet raportuese janë të detyruara të sigurojnë për zyrtarin e pajtueshmërisë trajnim të vazhdueshëm profesional për parandalimin e PP/FT-së. Paragrafi 3 i nenit 20 të Rregullores së BQK-së për PPP/LFT-në më tej parasheh që bankat dhe institucionet financiare do të sigurojnë rregullisht, të paktën një herë në vit, trajnime mbi PPP/LFT-në për të gjithë stafin që kanë kontakt me klientët ose bëjnë ekzekutimin e transaksioneve.
287. *Funksioni i auditimit të pavarur* – Sipas paragrafit 2.6 të nenit 17 të Ligjit për PPP/LFT-në, politikat, procedurat dhe kontrollet e subjekteve raportuese duhet të parashohin krijimin e organeve të përshtatshme të kontrollit të rregullt të brendshëm për zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe funksionin e auditimit për të testuar sistemin e raportimit dhe identifikimit, përveç për subjektet me numër të kufizuar të stafit. Për pasojë, kjo dispozitë nuk kërkon disponueshmërinë e një funksioni të auditimit të pavarur për një fushë dhe numër të paidentifikuar të institucioneve financiare “me numër të kufizuar të stafit”, ndërsa kërkesa për testimin nëpërmjet auditimit mbulon vetëm sistemet e raportimit dhe identifikimit, duke lënë anash përbërësit e tjerë të sistemit të PPP/LFT-së.
288. Paragrafi 1 i nenit 21 të Rregullores së BQK-së për PPP/LFT-në më tej parasheh që departamenti i auditimit të brendshëm të institucioneve financiare duhet të kryejë auditim së paku një herë në vit për të siguruar, që politikat dhe procedurat për PPP/LFT-në janë zbatuar plotësisht dhe në përputhje me të gjitha kërkesat e Ligjit për PPP/LFT-në dhe këtë Rregullore.
289. **Kriteri 18.2** (*Pjesërisht i përmbushur*) – Legjislati në fuqi nuk përcakton një përkufizim të grupeve financiare. Sipas paragrafit 5 të nenit 24 të ligjit të PPP-LFT-së, bankat dhe institucionet financiare zbatojnë programe në kuadër të grupit që mbulojnë degët e tyre të huaja dhe filialet në të cilat grupi zotëron shumicën e pronësisë, kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Megjithatë, as ligji as rregulla të tjera nuk specifikojnë se këto programe në nivel grupi duhet të jenë të përshtatshme (përveç që të jenë të zbatueshme) për të gjitha degët dhe filialet në të cilat grupi zotëron shumicën e pronësisë dhe që ato të përfshijnë masat e përcaktuara në kriterin 18.1 (domethënë rregullat për menaxhimin e pajtueshmërisë, përzgjedhjen e punonjësve, trajnimin e punonjësve dhe funksionin e auditimit të pavarur).
290. *Politikat dhe procedurat e shkëmbimit të informacionit* – Paragrafi 5 i nenit 24 të Ligjit për PPP/LFT-në përcakton se programet e PPP/LFT-së të zbatuara nga bankat dhe institucionet e tjera financiare dhe mbulimi i degëve të tyre të huaja dhe filialeve në të cilat grupi zotëron shumicën e pronësisë duhet të përfshijë politikat dhe procedurat për shkëmbimin e informatave brenda grupit për qëllime të këtij ligji (p.sh. përfshirë KDK-në dhe menaxhimin e rrezikut të PP/FT-së).
291. *Ofrimi dhe pranimi i informacioneve nga/te degët dhe filialet* – Dispozita e përgjithshme në paragrafin 5 të nenit 24 të Ligjit për PPP/LFT-në që përcakton disponueshmërinë e politikave dhe procedurave të shkëmbimit të informacionit brenda grupit për qëllime të ligjit

⁵⁹ Të tilla si kompanitë e sigurimeve, institucionet mikrofinanciare, agjencitë e transferimit të parave dhe zyrat e këmbimit valutor.

⁶⁰ Për të paraparë, ndër të tjera, standarde arsimore dhe profesionale, kërkesa për të kaluar të pastër kriminale etj.

nuk kërkon në mënyrë specifike që, në funksionet e pajtueshmërisë, auditimit dhe/ose të PPP/LFT-së në nivel grupi, degët dhe filialet: 1) të ofrojnë informacionet e klientit, llogarisë dhe transaksionit kur është e nevojshme për qëllimet e PPP/LFT-së⁶¹; dhe 2) të marrin informacione të tilla kur është e përshtatshme dhe e duhur për menaxhimin e rrezikut⁶².

292. *Masat mbrojtëse për fshehtësinë dhe nxjerrjen e informacionit* – Dispozita e përgjithshme e paragrafit 5 të nenit 24 të Ligjit për PPP/LFT-në që përcakton zbatimin e programeve për PPP/LFT-në brenda grupit për qëllime të ligjit nuk kërkon në mënyrë specifike që këto programe në nivel grupi duhet të përfshijnë mbrojtje të përshtatshme të konfidencialitetit dhe përdorimit të informacionit të shkëmbyer, përfshirë masat mbrojtëse për të parandaluar nxjerrjen e informacionit.

293. **Kriteri 18.3** (*Nuk është përmbushur*) – Paragrafi 4 i nenit 24 të Ligjit për PPP/LFT-në përcakton se bankat dhe institucionet financiare monitorojnë pajtueshmërinë e personave fizikë apo juridikë, që veprojnë si degë, filiale apo agjentë në emër të tyre, me dispozitat e këtij ligji. Për pasojë, legjislacioni i zbatueshëm nuk parasheh që, kur kërkesat minimale për PPP/LFT-në të vendit pritës janë më pak të rrepta se ato në Kosovë, bankat dhe institucionet e tjera financiare duhet të sigurojnë që degët e tyre të huaja dhe filialet, në të cilat grupi zotëron shumicën e pronësisë, të zbatojnë masat e PPP/LFT-së në përputhje me kërkesat në Kosovë deri në masën që ligjet dhe rregulloret e vendit pritës e lejojnë këtë. Më e rëndësishmja, nuk ka asnjë kërkesë për të siguruar që, kur vendi pritës nuk lejon zbatimin e duhur të masave të PPP/LFT-së në përputhje me kërkesat në Kosovë, bankat dhe institucionet e tjera financiare të aplikojnë masa të përshtatshme shtesë për menaxhimin e rreziqeve të PP/FT-së, dhe të informojë mbikëqyrësit në Kosovë.

Vlerësimi dhe përfundimi

294. Faktet dhe rrethanat në vijim janë konsideruar se përcaktojnë vlerësimin për Rekomandimin 18:

- Subjekteve raportuese nuk u kërkohej të zbatojnë programe kundër PP/FT-së duke pasur parasysh rreziqet e PP/FT-së dhe madhësinë e biznesit (kriteri 18.1); me përjashtim të bankave, nuk ka asnjë dispozitë që kërkon emërimin e zyrtarit të pajtueshmërisë në nivelin drejtues (kriteri 18.1 (a)); procedurat e përzgjedhjes së punonjësve/kriteret nuk janë përcaktuar për të gjitha llojet e institucioneve financiare (kriteri 18.1 (b)); disponueshmëria e një funksioni të auditimit të pavarur nuk kërkohej për një fushë dhe numër të përditifikuar të institucioneve financiare “me numër të kufizuar të stafit” (kriteri 18.1 (c));
- Legjislacioni nuk specifikon që programet në nivel grupi kundër PP/FT-së duhet të jenë të përshtatshme për të gjitha degët dhe filialet në të cilat grupi zotëron shumicën e pronësisë; dhe se ato duhet të përfshijnë masat e përcaktuara në kriterin 18.1 (kriteri 18.2); nuk ka kërkesë që, në funksionet e pajtueshmërisë, auditimit dhe/ose të PPP/LFT-së në nivel grupi, degët dhe filialet: 1) të ofrojnë informacionet e klientit, llogarisë dhe transaksionit kur është e nevojshme për qëllimet e PPP/LFT-së; dhe 2) të marrin informacione të tilla kur është e përshtatshme dhe e duhur për menaxhimin e rrezikut (kriteri 18.2 (b)); legjislacioni nuk kërkon që programet në nivel grupi kundër PP/FT-së të përfshijnë mbrojtje të përshtatshme të konfidencialitetit dhe përdorimit të informacionit të shkëmbyer, përfshirë masat mbrojtëse për të parandaluar nxjerrjen e informacionit (kriteri 18.2 (c)); dhe
- Nuk ka dispozita të cilat kërkojnë që: 1) kur kërkesat minimale për PPP/LFT-në të vendit pritës janë më pak të rrepta se ato në Kosovë, bankat dhe institucionet e tjera financiare të sigurojnë që degët e tyre të huaja dhe filialet, në të cilat grupi zotëron shumicën e pronësisë, të zbatojnë masat e PPP/LFT-së në përputhje me kërkesat në Kosovë deri në masën që ligjet dhe rregulloret e vendit pritës e lejojnë këtë; dhe 2) kur vendi pritës nuk lejon zbatimin e duhur të masave të PPP/LFT-së në përputhje me kërkesat në Kosovë, bankat dhe institucionet e tjera financiare të aplikojnë masa të përshtatshme shtesë për menaxhimin e rreziqeve të PP/FT-së dhe informojnë mbikëqyrësit në Kosovë (kriteri 18.3).

⁶¹ Të cilat duhet gjithashtu të përfshijnë informacionin dhe analizën e transaksioneve ose aktiviteteve që duken të pazakonshme (nëse një analizë e tillë është bërë) dhe mund të përfshijë një RTD, informacionin e tij të ndërlidhur ose faktin se një RTD është dorëzuar.

⁶² Vendi përcakton fushën dhe shtrirjen e informacionit që duhet ndarë, bazuar në ndjeshmërinë e informacionit dhe rëndësinë e tij në menaxhimin e rrezikut të PPP/LFT-së.

295. **Kosova është pjesërisht në përputhje me Rekomandimin 18.**

Rekomandimi 19 – Vendet me rrezikshmëri më të lartë

296. Në Raportin e Vlerësimit për PPP/LFT-në të vitit 2014, Kosova u vlerësua se ishte pjesërisht në përputhje me Rekomandimin e mëparshëm 21 të FATF-së. Vlerësimi identifikoi mangësi teknike lidhur me: moszbatimin e detyrimeve për marrëdhëniet me "institucionet e tjera financiare"; mungesën e udhëzimeve për përcaktimin e vendeve me rrezikshmëri më të lartë; mungesën e kërkesave për të shqyrtuar sfondin dhe qëllimin e transaksioneve; mungesën e kërkesës së qartë për ruajtjen e rezultateve të shqyrtimit; dhe, mungesën e dispozitave ligjore ose të tjera për autoritetet që të zbatojnë kundërmasa.

297. **Kriteri 19.1** (*Pjesërisht i përmbushur*) – Në mbështetje të paragrafit 6 të nenit 18 të Ligjit për PPP/LFT-në, të gjitha subjektet raportuese zbatojnë masat e kujdesit të duhur të shtuar që janë efektive dhe në përpjesëtim me rreziqet e identifikuara për marrëdhëniet dhe transaksionet e biznesit me persona fizikë dhe juridikë, përfshirë institucionet financiare nga shtetet që mund të përcaktohen nga NjIF-i, bazuar në masat ndërkombëtare ndaj shteteve të tilla. Për pasojë, kjo dispozitë bën që aplikimi i kujdesit të shtuar të kushtëzohet nga vendimi që duhet të merret nga NjIF-i, në kundërshtim me kërkesën në kriterin 19.1 për institucionet financiare që të aplikojnë KDK-në e shtuar kur kjo kërkohet nga FATF-ja. Autoritetet i referohen udhëzimit të lëshuar nga NjIF-i më 8 maj 2018 i cili rekomandon zbatimin e KDK-së së shtuar për personat fizikë dhe juridikë që ndërlidhen me juridiksionet e renditura nga FATF-ja. Megjithatë udhëzimi përcakton se mosrespektimi i këtij udhëzuesi përbën shkelje administrative në përputhje me paragrafin 1.7 të nenit 43 të Ligjit për PPP/LFT-në, statusi juridik i udhëzimit si një akt jo i detyrueshëm nuk parasheh pajtueshmërinë me kërkesat e kriterit 19.1.

298. Paragrafi 2 i nenit 25 të Ligjit për PPP/LFT-në thekson se subjektet raportuese i kushtojnë vëmendje të veçantë marrëdhënieve afariste dhe transaksioneve me personat, duke përfshirë personat juridikë dhe marrëveshjet juridike dhe institucionet financiare nga ose në vende që nuk i aplikojnë ose i aplikojnë në mënyrë të pamjaftueshme standardet ndërkombëtare përkatëse për PPP/LFT-në. Ky paragraf po ashtu nuk siguron pajtueshmëri me kërkesën e kriterit 19.1.

299. **Kriteri 19.2** (*Pjesërisht i përmbushur*) – Siç përcaktohet me paragrafin 6 të nenit 18 të Ligjit për PPP/LFT-në, NjIF-i përcakton kundërmasat e duhura, efektive dhe proporcionale për t'u zbatuar në lidhje me marrëdhëniet e biznesit dhe transaksionet me personat fizikë dhe juridikë, përfshirë institucionet financiare, nga vende të caktuara. Ndërsa kjo dispozitë mundëson zbatimin e kundërmasave proporcionale nga ana e autoriteteve në mënyrë të pavarur nga ndonjë thirrje nga FATF-ja për ta bërë këtë, ajo nuk përbën kërkesë që kundërmasat e tilla të zbatohen pa dështim sa herë që FATF-ja bën thirrje për ta bërë këtë.

300. **Kriteri 19.3** (*Pjesërisht i përmbushur*) – [Uebfaqja e NjIF-it](#) ofron vegëzat për në FATF, MONEYVAL, Groupin Egmont dhe në uebfaqe të tjera përkatëse. Përveç kësaj, ekipi i vlerësimit nuk është informuar për masat e vendosura në drejtim të përmbushjes së kriterit 19.3. Ekipi i vlerësimit konsideron se ka hapësirë për përmirësim në ndërmarrjen e veprimeve proaktive (të tilla si sigurimi i informacionit të përditësuar mbi deklaratat më të reja, listat e rishikuara, botimi i njoftimeve të reja etj.) për të siguruar që institucionet financiare të këshillohen për shqetësimet rreth dobësive në sistemet e PPP/LFT-së së vendeve të tjera.

Vlerësimi dhe përfundimi

301. Faktet dhe rrethanat në vijim janë konsideruar se përcaktojnë vlerësimin për Rekomandimin 19:

- Subjekteve raportuese nuk u kërkohet të aplikojnë kujdes të shtuar për marrëdhëniet e biznesit dhe transaksionet me persona nga shtetet për të cilët kërkohet nga FATF-ja (kriteri 19.1);
- Nuk ka kërkesa për të zbatuar kundërmasa në përpjesëtim me rreziqet kur kjo kërkohet nga FATF-ja (kriteri 19.2); dhe
- Masat për të siguruar që institucionet financiare janë të këshilluara për shqetësimet rreth dobësive në sistemet e PPP/LFT-së së vendeve të tjera nuk janë të mjaftueshme (kriteri 19.3).

302. **Kosova është pjesërisht në përputhje me Rekomandimin 19.**

Rekomandimi 20 – Raportimi i transaksioneve të dyshimta

303. Në Raportin e Vlerësimit për PPP/LFT-në të vitit 2014, Kosova u vlerësua pjesërisht në përputhje me Rekomandimin e mëparshëm 13 të FATF-së, dhe në mospërputhje me Rekomandimin e mëparshëm të Posaçëm 22 të FATF-së. Vlerësimi identifikoi mangësi teknike lidhur me: mungesën e detyrimit të raportimit në situatat kur informacioni në dispozicion tregon aktivitetet e mundshme të PP-së ose FT-së; mungesën e informatave kthyesë specifike dhe strategjike dhe udhëzimeve për subjektet raportuese që çojnë në RTD me cilësi të ulët dhe kërkesa të shumta për informacion shtesë që sjellin një barrë të tepruar mbi NjIF-in dhe industrinë; asnjë detyrim raportimi për transaksionet që dyshohet të jenë të lidhura me FT-në; dhe shqetësimet për mosparaqitjen e RTG-ve të dyshimta si RTD dhe për rezultatin e RTD-ve që mund të përfshijnë çështje tatimore.
304. **Kriteri 20.1** (*Kryesisht i përmbushur*) – Paragrafi 1.1 i nenit 26 të Ligjit për PPP/LFT-në përcakton se të gjitha subjektet raportuese raportojnë te NjIF-i, sipas mënyrës dhe formës së specifikuar nga NjIF-i, të gjitha aktivitetet ose transaksionet e dyshimta brenda njëzetekatër (24) orëve nga koha kur aktiviteti ose transaksioni është identifikuar si i dyshimtë.
305. Paragrafi 1.2 i nenit 2 të Ligjit për PPP/LFT-në përcakton një veprim ose transaksion të dyshimtë si “një akt ose transaksion ose një akt ose transaksion i tentuar, që krijon dyshim të arsyeshëm se pasuria e përfshirë në aktin apo transaksionin, ose në aktin ose transaksionin e tentuar, është produkt i krimit apo ndërlidhet me financimin e terrorizmit dhe interpretohet në përputhje me çdo akt nënligjor të lëshuar nga NjIF-i për aktet apo transaksionet e dyshimta”.
306. Të ardhurat nga vepra penale janë përkufizuar në paragrafin 1.41 të të njëjtit nen si “çdo pasuri e përfituar në mënyrë direkte apo indirekte nga vepra e ndërlidhur penale. Pasuria e fituar në mënyrë indirekte nga vepra e ndërlidhur penale përfshin pasurinë në të cilën më vonë është konvertuar, transformuar ose përzier çdo pasuri e përfituar në mënyrë direkte nga vepra e ndërlidhur penale si dhe të ardhurat, kapitali apo përfitimet e tjera ekonomike të realizuara nga pasuria e tillë në çfarëdo kohe të kryerjes së veprës penale”.
307. Detyrimi për raportim kufizohet më tej nga mangësitë në kriminalizimin e pastrimit të parave (përfshirë mungesën e kriminalizimit të manipulimit të tregut) dhe financimit të terrorizmit, siç përcaktohet respektivisht në analizën për Rekomandimin 3 dhe Rekomandimin 5.
308. **Kriteri 20.2** (*I përmbushur*) – Detyrimi për të raportuar mbulon të gjitha transaksionet e dyshimta, përfshirë ato të tentuara, pavarësisht nga shuma e transaksionit.

Vlerësimi dhe përfundimi

309. Faktet dhe rrethanat në vijim janë konsideruar se përcaktojnë vlerësimin për Rekomandimin 20:
- Detyrimi për raportim kufizohet nga mangësitë në kriminalizimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit (kriteri 20.1).
310. **Kosova është kryesisht në përputhje me Rekomandimin 20.**

Rekomandimi 21 – Zbulimi dhe konfidencialiteti

311. Në Raportin e Vlerësimit për PPP/LFT-në të vitit 2014, Kosova u vlerësua në mospërputhje me Rekomandimin e mëparshëm 14 të FATF-së. Vlerësimi identifikoi mangësi teknike në lidhje me: formulimin e paqartë të mbrojtjes së sigurt për zbulimet nga drejtorët, zyrtarët dhe punonjësit, të përkohshëm ose të përhershëm; mungesën e ndalimit të zbulimit (nxjerrjes së informacionit) në lidhje me bankat dhe institucionet financiare si subjekte; paqartësitë ligjore për ndalimet dhe ndëshkimet për bankat dhe institucionet e tjera financiare; mungesën e ndalimit specifik të zbulimit (nxjerrjes së informacionit) që të zbatohet si për punonjësit e përhershëm edhe të përkohshëm; ndalimin e zbulimit që nuk mbulon situatat kur kryhet apo mund të kryhet një hetim; pasigurinë juridike për mbrojtjen e të dhënave personale të punonjësve të cilët hartojnë raportin apo sigurojnë informacionin; dhe, kufizimet në heqjen e ndalimit të zbulimit në rrethana të veçanta.
312. **Kriteri 21.1** (*I përmbushur*) – Sipas nenit 61 të Ligjit për PPP/LFT-në, “asnjë veprim për përgjegjësinë civile a penale dhe asnjë sanksion profesional nuk mund të ndërmerret ndaj

ndonjë personi apo entiteti ose subjekti raportues, sipas këtij ligji, ose ndaj drejtorëve, zyrtarëve dhe punonjësve të tyre të përkohshëm apo të përhershëm bazuar vetëm në transmetimin e informatave në mirëbesim, dorëzimin e raporteve apo veprimeve të tjera në pajtim me këtë ligj, apo transmetimin vullnetar të informatave në mirëbesim lidhur me aktin apo transaksionin e dyshimtë, dyshimin për pastrimin e parave apo financimin e terrorizmit të NjIF-i". Kjo mbrojtje nuk është e kushtëzuar nga dijenia e saktë dhe dukuria faktike e veprimtarisë kriminale kryesore të ndërlidhur.

313. Për më tepër, paragrafi 7 i nenit 26 të Ligjit për PPP/LFT-në përcakton se NjIF-i, çdo autoritet hetues, i ndjekjes penale, gjyqësor ose administrativ dhe subjektet raportuese ose personat dhe subjektet e tjera që kanë në posedim informata personale të punonjësve ose zyrtarëve të subjekteve raportuese që raportojnë dyshime për pastrim të parave ose financim të terrorizmit ose që ofrojnë informacione lidhur me këtë, qoftë brenda ose te NjIF-i, në përputhje me këtë ligj duhet të mbrojnë dhe mbajnë konfidenciale informata të tilla personale".
314. Së fundi, paragrafi 4.6 i nenit 21 të Ligjit për PPP/LFT-në kërkon që subjektet raportuese të sigurojnë për zyrtarin e pajtueshmërisë "mbrojtje në lidhje me zbulimin e të dhënave rreth zyrtarit të pajtueshmërisë të persona të paautorizuar, si dhe mbrojtjen e procedurave të tjera që cilat mund të ndikojnë në kryerjen pa pengesë të detyrave dhe qasjes së paautorizuar në të dhëna".
315. **Kriteri 21.2 (Kryesisht i përmbushur)** – Paragrafi 4 i nenit 26 përcakton se "subjektet raportuese, drejtorët, zyrtarët, punonjësit e përkohshëm apo të përhershëm të subjektit raportues të cilët përgatisin apo transmetojnë raporte në pajtim me këtë ligj, nuk zbulojnë fakte për raportin që është dorëzuar ose është në proces për t'u dorëzuar, nuk e sigurojnë këtë raport, as nuk e komunikojnë ndonjë të dhënë të përfshirë në atë raport apo për atë raport, përfshirë kur një informacion i tillë është duke u përgatitur për t'u raportuar, apo kur hetimet për pastrim parash ose financim të terrorizmit janë duke ose mund të kryhen, asnjë personi apo subjekti, përfshirë çdo person apo subjekt të përfshirë në transaksionin i cili përfshihet në raport, përveç NjIF-it, pa pasur autorizim me shkrim nga NjIF-i, prokurori publik ose gjykata".
316. Formulimi në dispozitën e mësipërme që ndalon personelin përkatës të subjekteve raportuese "të cilët përgatisin apo transmetojnë raporte në pajtim me këtë ligj" për të zbuluar paraqitjen e RTD-ve ose informatave përkatëse, lë hapësirë për interpretimin se një ndalim i tillë nuk zbatohet për personelin, i cili nuk është i përfshirë në përgatitjen ose transmetimin e raporteve sipas ligjit. Për më tepër, dispozita e heqjes së ndalimit për të zbuluar paraqitjen e RTD-ve ose informatave të lidhura me to "pa pasur autorizim me shkrim nga NjIF-i, prokurori publik ose gjykata" mohon kërkesën sipas kriterit 21.2 që ndalon zbulimin e këtij informacioni te palët e treta (në të vërtetë, përveç NjIF-it, tek e cila paraqitet RTD-ja ose informacioni i ndërlidhur).
317. Dispozitat që ndalojnë zbulimin e faktit të raportimit të një RTD-je ose një informacioni të ndërlidhur të NjIF-i nuk përcaktojnë në mënyrë specifike se këto nuk kanë për qëllim të pengojnë shkëmbimin e informacionit sipas Rekomandimit 18.

Vlerësimi dhe përfundimi

318. Faktet dhe rrethanat në vijim janë konsideruar se përcaktojnë vlerësimin për Rekomandimin 21:
- Dispozitat që ndalojnë nxjerrjen e informacionit shpjegues për paraqitjen e RTD-ve ose informatave përkatëse lënë hapësirë për interpretimin se ato nuk zbatohen për të gjithë personelin e subjekteve raportuese dhe mohojnë kërkesën që ndalon zbulimin e këtij informacioni te palët e treta (përveç NjIF-it tek e cila paraqitet RTD-ja ose informacioni i ndërlidhur) (kriteri 21.2); dhe
 - Nuk ka rregullim specifik për të siguruar që këto dispozita nuk kanë për qëllim të pengojnë shkëmbimin e informacionit sipas Rekomandimit 18 (kriteri 21.2).
319. **Kosova është kryesisht në përputhje me Rekomandimin 21.**

Rekomandimi 22 – BPCJF-të: Kujdesi i duhur ndaj klientit

320. Në Raportin e Vlerësimit për PPP/LFT-në të vitit 2014, Kosova u vlerësua në mospërputhje me Rekomandimin e mëparshëm 12 të FATF-së. Vlerësimi identifikoi mangësi teknike –

përveç dobësive të identifikuar për sektorin financiar sipas Rekomandimeve të mëparshme 5, 6 dhe 8-11 të FATF-së – lidhur me: paqartësitë juridike në Ligjin për PPP/LFT-në për aplikimin e rekomandimeve përkatëse; mungesën e qartësisë mbi atë se kush përbën një klient për BPCJF të caktuara si OJQ-të dhe subjektet politike; mungesën e qartësisë për statusin e lojërave të fatit dhe objekteve të licencuara të lojërave të fatit si subjekte raportuese; fushëveprimin e masave të PPP/LFT-së për profesionin e kontabilistit që nuk mbulon situatat e përcaktuara nga Rekomandimet; dhe mungesën e qartësisë mbi zbatimin e detyrimeve shtesë, sipas Ligjit për PPP/LFT-në, për BPCJF të caktuara.

321. Në analizën e paraqitur më poshtë, mangësitë e identifikuar në lidhje me pajtueshmërinë e institucioneve financiare me kërkesat e FATF-së sipas Rekomandimeve përkatëse janë gjithashtu të rëndësishme, aty ku është e aplikueshme, për BPCJF-të, nëse nuk është specifikuar ndryshe.
322. I është bërë referim analizës së Rekomandimit 10 për mbulimin e përgjithshëm të kërkesave të KDK-së në kuadër të legjislationit të Kosovës. Sipas paragrafit 4 të nenit 31 të Ligjit për PPP/LFT-në, shprehja "transaksione të ndërlidhura" do të thotë të gjitha transaksionet e kryera në mes të klientit dhe profesionistit në fjalë⁶³ brenda një periudhe prej 24 orëve ose të gjitha transaksionet e kryera brenda një periudhe prej më shumë se 24 orëve, nëse marrësi është në dijeni ose ka arsye të jetë në dijeni se secili transaksion është njëri prej një sërë transaksionesh të ndërlidhura. Disa pagesa që i bëhen avokatit për përfaqësim në një rast të vetëm janë transaksione të ndërlidhura.
323. **Kriteri 22.1** (*Pjesërisht i përmbushur*) – Paragrafi 1 i nenit 16 të Ligjit për PPP/LFT-në përcakton BPCJF-të në vijim të përcaktuara nga FATF-ja si subjekte raportuese në bazë të ligjit⁶⁴: a) kazinotë, përfshirë ato në internet dhe objektet e licencuara të lojërave të fatit; b) agjentët e pasurive të patundshme dhe ndërmjetësit e pasurive të patundshme; c) avokatët dhe noterët kur përgatiten, kryejnë ose përfshihen në transaksione për klientët e tyre rreth aktiviteteve të caktuara⁶⁵; d) kontabilistët, auditorët dhe këshilltarët tatimorë; e) ofruesit e shërbimeve për truste dhe kompani që nuk përfshihen diku tjetër në Ligjin për PPP/LFT-në, të cilët ofrojnë shërbime të caktuara për palë të treta në baza tregtare⁶⁶; dhe f) shitësit e metaleve të çmuara dhe gurëve të çmuar.
324. *Kazinotë* – Paragrafi 2 i nenit 30 të Ligjit për PPP/LFT-në përcakton që, në përputhje me dispozitat e neneve 19 dhe 22 të këtij ligji, kazinotë dhe lojërat e fatit verifikojnë dhe regjistrojnë në mënyrë të përhershme identitetin e klientit para se të hyjë në një transaksion ose transaksione të shumta ose të ndërlidhura për të shitur, blerë, transferuar, ose shkëmbyer zhetonët, çipat, ose ndonjë dëshmi tjetër të vlerës në shumën prej 2.000 euro ose më shumë apo vlerës ekuivalente në valutë të huaj⁶⁷. Nëse kazinoja dhe lojërat e fatit nuk janë në gjendje të verifikojnë identitetin e një klienti, ato nuk hyjnë në transaksion. Kjo dispozitë, ndonëse është në përputhje me situatat e përkufizuara nga FATF-ja për kategorinë e përmendur të BPCJF-ve për të qenë në pajtim me kërkesat e Rekomandimit 10, nuk kërkon që ato të zbatohen të gjitha masat e KDK-së (në krahasim me identifikimin e klientit dhe verifikimin e identitetit) sa herë që klientët angazhohen në

⁶³ Paragrafi 1.34 i nenit 2 të Ligjit për PPP/LFT-në përfshin në shprehjen profesionistë në fjalë "avokatët, noterët, kontabilistët, auditorët dhe këshilltarët për tatime".

⁶⁴ Përveç kësaj, Ligji për PPP/LFT-në përcakton si subjekte raportuese: a) personat fizikë dhe juridikë që tregtojnë mallra kur pranojnë pagesa në para të gatshme në vlerë prej 10.000 euro ose më shumë; dhe b) OJQ-të. Brenda kuadrit të këtij vlerësimi, pajtueshmëria e këtyre subjekteve me kornizën e PPP/LFT-së nuk është vlerësuar pasi është jashtë fushëveprimit të Metodologjisë së FATF-së të vitit 2013.

⁶⁵ Aktivitetet transpozojnë ato të parashikuara nga përkufizimi në Fjalorin e FATF-së, me përjashtim të "profesioneve të tjera juridike të pavarura", të cilët nuk janë përcaktuar si profesion i caktuar sipas ligjit.

⁶⁶ Shërbimet transpozojnë ato të parashikuara nga përkufizimi në Fjalorin e FATF-së, me përjashtim të atij kur "kryejnë një funksion të barasvlershëm për një formë tjetër të marrëveshjes juridike", e cila nuk është përcaktuar si një shërbim i caktuar sipas ligjit (përveç kur "veprojnë si (ose marrin masa që një person tjetër të veprojë) administrator i besuar i një trusti ekspres" siç përcaktohet në fjalorin e FATF-së dhe në ligj).

⁶⁷ Për më tepër, sipas paragrafit 3 të nenit 30 të Ligjit për PPP/LFT-në, lojërat e fatit nuk angazhohen në ndonjë nga transaksionet në vijim: a) shkëmbimin e të hollave me të holla me një klient, ose me një pranues tjetër në emër të klientit, në çdo transaksion në të cilën vlera e shkëmbimit është prej 2.000 euro ose më shumë; b) lëshimin e një çeku ose instrumenti tjetër të negociueshëm ndaj një klienti, ose tek një pranues tjetër në emër të klientit, në shkëmbim për të holla në çdo transaksion në të cilën vlera e shkëmbimit është prej 2.000 euro ose më shumë; dhe c) transferimin e fondeve në mënyrë elektronike ose me ndonjë metodë tjetër për një klient, ose tek një pranues tjetër në emër të klientit, në këmbim me të holla në çdo transaksion në të cilën vlera e shkëmbimit është prej 2.000 euro ose më shumë.

transaksione financiare të barabarta me ose mbi pragun e përcaktuar. Për më tepër, ligji nuk kërkon që kazinotë të sigurojnë që ata janë në gjendje të lidhin informacionin e KDK-së për një klient të caktuar me transaksionet që klienti kryen në kazino.

325. Verifikimi dhe regjistrimi i identitetit shtrihet edhe për transaksionet financiare si hapja e një llogarie, përfshirë llogarinë e kursimeve, një transfertë elektronike ose një shkëmbim i monedhës në shumën prej 2.000 euro ose më shumë (apo vlerës ekuivalente në valutë të huaj). Në lidhje me këtë, nuk është e qartë se cilat mund të jenë rastet praktike dhe mekanizmat e aplikueshëm për kazinotë për të hapur një llogari (përfshirë një llogari kursimi), kryerjen e një transferte elektronike ose kryerjen e këmbimit valutor, pasi këto janë llojet e transaksioneve të spikatura për institucionet financiare, por jo për kazinotë. Kjo dispozitë gjithashtu duket të jetë në kundërshtim me paragrafin 3 të nenit 30 që ndalon kazinotë të angazhohen në transaksione të caktuara, përfshirë shkëmbimin e parasë dhe transfertën elektronike në shumën prej 2.000 euro ose më shumë.
326. *Agjentët e pasurive të patundshme* – Legjislacioni në fuqi nuk përcakton situata specifike që i caktojnë agjentët e pasurive të patundshme dhe ndërmjetësit si subjekte raportuese sipas ligjit, domethënë ato zbatohen në kushte të përgjithshme kurdoherë që u referohen të gjitha subjekteve raportuese. Në këtë mënyrë, atyre nuk u kërkohet të jenë në pajtim me kërkesat e Rekomandimit 10 në lidhje me blerësit dhe shitësit e pasurive të paluajtshme. Në lidhje me këtë, autoritetet paraqesin që të dy blerësit dhe shitësit në transaksionet e pasurive të paluajtshme konsiderohen si klientë të agjentëve të pasurive të paluajtshme, duke iu nënshtuar kështu njëllor kërkesave të aplikueshme të KDK-së.
327. *Tregtarët e metaleve të çmuara dhe të gurëve të çmuar*; – Përkufizimi në paragrafin 1.10 të nenit 16 të Ligjit për PPP/LFT-në që përcakton "shitësit e metaleve të çmuara dhe tregtarët me gurë të çmuar" si subjekte raportuese sipas ligjit lë hapësirë për paqartësi juridike nëse shitësit apo tregtarët e metaleve të çmuara dhe gurëve të çmuar mbulohen kur veprojnë në cilësinë e blerësit në transaksionet përkatëse. Autoritetet këshillojnë që këto lloje të BPCJF-ve janë në përputhje me kërkesat e KDK-së të parashtruara në paragrafin 2.2 të nenit 19 të Ligjit për PPP/LFT-në "kur realizojnë transaksione të rastit në para të gatshme në vlerë prej 10.000 euro ose më shumë, apo vlerës ekuivalente në valutë të huaj, nëse është kryer si një transaksion i vetëm ose disa transaksione që janë të ndërlidhura"⁶⁸. Kjo dispozitë duket të jetë në përputhje me situatat e përkufizuara nga FATF-ja për kategorinë e përmendur të BPCJF-ve në përputhje me kërkesat e paraqitura në Rekomandimin 10.
328. *Avokatët, noterët, profesionet e tjera juridike të pavarura dhe kontabilistët (këshilltarët tatimorë)* – Paragrafi 1.6 i nenit 16 të Ligjit për PPP/LFT-në përcakton avokatët dhe noterët si subjekte raportuese kur përgatiten, kryejnë ose përfshihen në transaksione për klientët e tyre rreth aktiviteteve të mëposhtme: blerjen dhe shitjen e pasurive të paluajtshme; menaxhimin e parave, letrave me vlerë ose pasurive të tjera të klientit; menaxhimin e llogarive bankare, kursimeve ose të letrave me vlerë; organizimin e kontributeve të nevojshme për krijimin, funksionimin ose menaxhimin e kompanive; dhe krijimin, funksionimin ose administrimin e personave ose marrëveshjeve juridike, dhe blerjen e shitjen e subjekteve afariste. Me përjashtim të "profesioneve të tjera juridike të pavarura", të cilët nuk janë përcaktuar si subjekte raportuese sipas ligjit, kjo dispozitë duket të jetë në përputhje me situatat e përkufizuara nga FATF-ja për kategorinë e përmendur të BPCJF-ve në përputhje me kërkesat e Rekomandimit 10.
329. I njëjti nen i ligjit përcakton kontabilistët pa e bërë ata të varur nga një lloj specifik i aktivitetit/transaksionit ose ndonjë karakteristike tjetër cilësore ose sasiore për t'u cilësuar si subjekt raportues sipas ligjit. Nëse nuk ka një përkufizim dhe interpretim të qartë të situatave në të cilat kontabilistët bëhen subjekte raportuese sipas ligjit, ky përcaktim i përgjithshëm mund të krijojë pasiguri juridike lidhur me rrethanat që ata të përmbushin kërkesat e Rekomandimit 10.
330. *Ofruesit e shërbimeve për truste dhe kompani* – Paragrafi 1.8 i nenit 16 të Ligjit për PPP/LFT-në përcakton ofruesit e shërbimeve për truste dhe kompani që nuk mbulohen diku tjetër në Ligjin për PPP/LFT-në si subjekte raportuese në bazë të ligjit kur ato u ofrojnë shërbimet e mëposhtme palëve të treta në baza tregtare: duke vepruar si agjentë për

⁶⁸ Megjithatë, ky interpretim nuk duket se rrjedh nga struktura dhe logjika e ligjit, që kërkon kryerjen e KDK-së – pothuajse nga çdo person apo subjekt – në rast të përfshirjes në transaksione në para të gatshme prej 10.000 euro ose më shumë pa e kushtëzuar atë me llojin specifik të veprimtarisë/transaksionit apo me çdo karakteristikë tjetër sasiore ose cilësore për t'u cilësuar si subjekt raportues sipas ligjit.

krijimin e personave juridikë; duke vepruar ose duke caktuar dikë tjetër të veprjë si një drejtor ose sekretar i një kompanie, një ortak i një ortakërie apo një pozitë të ngjashme në lidhje me persona të tjerë juridikë; duke siguruar një zyrë të regjistruar, akomodim ose adresë për biznesin, adresë zyrtare ose me korrespondencë për një kompani, ortakëri ose ndonjë person a marrëveshje tjetër juridike; duke vepruar ose caktuar dikë tjetër të veprjë si administrator i besuar i një trusti të caktuar; duke vepruar ose caktuar dikë tjetër të veprjë si aksionar i emëruar për një person tjetër. Me përjashtim të rastit kur "kryejnë një funksion të barasvlershëm për një formë tjetër të marrëveshjes juridike", i cili nuk është përcaktuar si shërbim sipas ligjit, kjo dispozitë duket të jetë në përputhje me situatat e përkufizuara nga FATF-ja për kategorinë e përmendur të BPCJF-ve në përputhje me kërkesat e Rekomandimit 10.

331. **Kriteri 22.2** (*Pjesërisht i përmbushur*) – Këtu i është bërë referim analizës së Rekomandimit 11 për mbulimin e përgjithshëm të kërkesave për ruajtjen e të dhënave në legjislacionin e Kosovës (me përjashtim të pjesëve të Rregullores së BQK-së për PPP/LFT-në, e cila zbatohet vetëm për bankat dhe institucionet financiare⁶⁹). Ekipi i vlerësimit nuk është pajisur me legjislacion apo mjete të tjera detyruese që përcaktojnë dispozita specifike për të çuar më tej ato të artikuluar në Ligjin për PPP/LFT-në dhe të rëndësishme për pajtueshmërinë e BPCJF-ve me kërkesat për PPP/LFT-në sipas Rekomandimit 11.
332. **Kriteri 22.3** (*Pjesërisht i përmbushur*) – Këtu i është bërë referim analizës së Rekomandimit 12 për mbulimin e përgjithshëm të kërkesave të KDK-së në kuadër të legjislacionit të Kosovës. Ekipi i vlerësimit nuk është pajisur me legjislacion apo mjete të tjera detyruese që përcaktojnë dispozita specifike për të çuar më tej ato të artikuluar në Ligjin për PPP/LFT-në dhe të rëndësishme për pajtueshmërinë e BPCJF-ve me kërkesat për PPP/LFT-në sipas Rekomandimit 12.
333. **Kriteri 22.4** (*Kryesisht i përmbushur*) – Këtu i është bërë referim analizës së Rekomandimit 15 për mbulimin e përgjithshëm të kërkesave të KDK-së në kuadër të legjislacionit të Kosovës (me përjashtim të pjesëve në Rregulloren e BQK-së për PPP/LFT-në të cilat vlejnë vetëm për bankat dhe institucionet e tjera financiare⁷⁰). Ekipi i vlerësimit nuk është pajisur me legjislacion apo mjete të tjera detyruese që përcaktojnë dispozita specifike për të çuar më tej ato të artikuluar në Ligjin për PPP/LFT-në dhe të rëndësishme për pajtueshmërinë e BPCJF-ve me kërkesat për PPP/LFT-në sipas Rekomandimit 15.
334. **Kriteri 22.5** (*Nuk është përmbushur*) – Këtu i është bërë referim analizës së Rekomandimit 17 për mbulimin e përgjithshëm të kërkesave për mbështetje të palët e treta në kuadër të legjislacionit të Kosovës. Ekipi i vlerësimit nuk është pajisur me legjislacion apo mjete të tjera detyruese që përcaktojnë dispozita specifike për të çuar më tej ato të artikuluar në Ligjin për PPP/LFT-në dhe të rëndësishme për pajtueshmërinë e BPCJF-ve me kërkesat për PPP/LFT-në sipas Rekomandimit 17.

Vlerësimi dhe përfundimi

335. Faktet dhe rrethanat në vijim janë konsideruar se përcaktojnë vlerësimin për Rekomandimin 22:

- Legjislacioni nuk kërkon që kazinotë të zbatojnë të gjitha masat e KDK-së (në krahasim me identifikimin e klientit dhe verifikimin e identitetit) sa herë që klientët angazhohen në transaksione financiare të barabarta ose mbi pragun e përcaktuar; dhe për të siguruar që ata janë në gjendje të lidhin informacionin e KDK-së për një klient të caktuar me transaksionet që klienti kryen në kazino (kriteri 22.1 (a)); ekziston hapësirë për paqartësi juridike nëse tregtarët e metaleve të çmuara dhe gurëve të çmuar janë caktuar si subjekte raportuese kur veprjnë në cilësinë e blerësit në transaksionet përkatëse (kriteri 22.1 (c)); "profesionet e tjera juridike të pavarura" nuk janë

⁶⁹ Veçanërisht paragrafi 2 i nenit 16 të Rregullores së BQK-së për PPP/LFT-në, i cili përcakton se të dhënat për transaksionet duhet të jenë të mjaftueshme për të lejuar rindërtimin e transaksioneve individuale në atë mënyrë që të ofrojnë, nëse është e nevojshme, dëshmi për ndjekjen e aktivitetit kriminal, duke mundësuar kështu një vlerësim "i përmbushur" për kriterin 11.3 që mbulon bankat dhe institucionet e tjera financiare, por jo për kriterin 22.2 që mbulon BPCJF-të, për të cilat nuk zbatohet kjo Rregullore.

⁷⁰ Veçanërisht paragrafi 8 i nenit 7 të Rregullores së BQK-së për PPP/LFT-në, i cili, ndër të tjera, kërkon marrjen e masave të përshtatshme për menaxhimin dhe zbutjen e rreziqeve të PP/FT-së që mund të lindin në lidhje me produktet, praktikat dhe teknologjitë e reja, duke mundësuar kështu një vlerësim "i përmbushur" për kriterin 15.2 që mbulon bankat dhe institucionet e tjera financiare, por jo për kriterin 22.4 që mbulon BPCJF-të, për të cilat nuk zbatohet kjo Rregullore.

përcaktuar si subjekte raportuese sipas ligjit (kriteri 22.1 (d)); dhe "kryerja e funksionit të barasvlerëshëm për një formë tjetër të marrëveshjes juridike" nuk është përcaktuar si shërbim i caktuar sipas ligjit (kriteri 22.1 (e)); dhe

- Kërkesat përkatëse janë përmbushur kryesisht në lidhje me Rekomandimet 11 (kriteri 22.2) dhe 12 (kriteri 22.3) dhe nuk janë përmbushur në lidhje me Rekomandimin 17 (kriteri 22.5).

336. **Kosova është pjesërisht në përputhje me Rekomandimin 22.**

Rekomandimi 23 – BPCJF-të: Masat e tjera

337. Në Raportin e Vlerësimit për PPP/LFT-në të vitit 2014, Kosova u vlerësua në mospërputhje me Rekomandimin e mëparshëm 16 të FATF-së. Vlerësimi identifikoi mangësi teknike të ndërlikdhura, ndër të tjera, me: mungesën e kërkesës për disa BPCJF për të paraqitur një RTD kur dyshojnë ose kanë baza të arsyeshme për të dyshuar se fondet janë të ardhura nga një veprimtari kriminale, si dhe për të gjitha BPCJF-të për të raportuar situata ku informacioni në dispozicion tregon se një person mund të jetë ose mund të ketë qenë i përfshirë në PP ose FT; mungesën e ndalimit për drejtorët, zyrtarët dhe punonjësit e disa BPCJF-ve për të zbuluar faktin se një RTD ose informacione të ndërlikdhura me të janë duke iu raportuar apo ofruar NjIF-it; mungesën e kërkesave për të gjitha ose disa BPCJF për të krijuar dhe mbajtur procedura, politika dhe kontrole të brendshme për të parandaluar PP-në dhe FT-në, për të vendosur rregulla të përshtatshme për menaxhimin e pajtueshmërisë, për të emëruar një zyrtar të pajtueshmërisë, për të mbajtur një funksion auditimi me burime të mjaftueshme dhe të pavarur, për të zhvilluar programe të trajnimit të vazhdueshëm të punonjësve, për të vendosur procedura të përzgjedhjes që sigurojnë standarde të larta gjatë punësimit të punonjësve; dështimin për të këshilluar BPCJF-të për shqetësimet në lidhje me dobësitë në sistemet e PPP/LFT-së së shteteve/juridiksioneve të tjera; mungesën e detyrimit për të dokumentuar gjetjet e analizave të transaksioneve të mëdha të ndërlikdhura; dhe mungesën e dispozitave për autoritetet kompetente përkatëse për të ndërmarrë kundërmasa në rrethanat kur një vend ose juridiksion nuk zbaton ose zbaton në mënyrë të pamjaftueshme Rekomandimet e FATF-së.

338. Në analizën e paraqitur më poshtë, mangësitë e identifikuar në lidhje me pajtueshmërinë e institucioneve financiare me kërkesat e FATF-së sipas Rekomandimeve përkatëse janë gjithashtu të rëndësishme, aty ku është e aplikueshme, për BPCJF-të, nëse nuk është specifikuar ndryshe.

339. **Kriteri 23.1** (*Kryesisht i përmbushur*) – Këtu i është bërë referim analizës së Rekomandimit 20 për mbulimin e përgjithshëm të kërkesave të raportimit të RTD-së në kuadër të legjisllacionit të Kosovës. Organizatat vetërregulluese të BPCJF-ve në Kosovë nuk kanë kompetencë të përcaktuar ligjrisht për pranimin e RTD-ve.

340. *Avokatët, noterët, profesionet e tjera juridike të pavarura dhe kontabilistët (këshilltarët tatimorë)* – Sipas paragrafit 6 të nenit 31 të Ligjit për PPP/LFT-në, kërkesa e përfshirë në paragrafin 1.1 të nenit 26 për të raportuar të gjitha aktivitetet ose transaksionet e dyshimta të NjIF-i zbatohet për avokatët dhe noterët sa herë që ata angazhohen në aktivitetet e mëposhtme: 1) ndihma ose përfaqësimi i klientëve në: 1.1) blerjen apo shitjen e pasurisë së paluajtshme ose të organizatave të biznesit; 1.2) trajtimin e parave, letrave me vlerë ose pasurisë tjetër të klientit; 1.3) hapjen ose administrimin e llogarive bankare, librezave të kursimit ose llogarive të letrave me vlerë; 1.4) organizimin e kontributeve të nevojshme për krijimin, funksionimin ose menaxhimin e kompanive; 1.5) krijimin, funksionimin ose menaxhimin e kompanive, trusteeve ose strukturave të ngjashme; ose 2) të vepruarit në emër të ose për klientin në çfarëdo transaksioni financiar apo transaksion mbi të drejtat në pasurinë e paluajtshme.

341. Dispozita e mësipërme ndryshon nga ajo e paraparë në paragrafin 1.6 të nenit 16 të Ligjit për PPP/LFT-në që cilëson avokatët dhe noterët si subjekte raportuese sipas ligjit (siç përkrahë në analizën për kriterin 22.1 (d)). Veçanërisht, artikulli i aktiviteteve të renditura në pikën e parë në paragrafin e mësipërm nuk plotëson kërkesën e FATF-së për aq sa nuk zbatohet në të gjitha situatat kur profesionistët në fjalë angazhohen në një transaksion "në emër të ose për klientin" (meqë kjo e fundit është përcaktuar vetëm në pikën e dytë).

342. Sipas paragrafit 7 të nenit 31 të Ligjit për PPP/LFT-në, avokati nuk jep informacione pa autorizim nga klienti ose me urdhër të gjykatës, të cilat ai apo ajo i ka marrë nga klienti ose i ka mësuar për klientin për ta përfaqësuar klientin në procedurë penale apo gjyqësore pa

autorizim nga klienti ose me urdhër të gjykatës, përveç nëse avokati me arsye beson se klienti kërkon këshillë ose ndihmë nga avokati për të kryer një vepër penale.

343. Për këtë arsye, me përjashtim të "profesioneve të tjera juridike të pavarura" të cilët nuk janë përcaktuar si subjekte raportuese sipas ligjit (dhe, për këtë arsye, nuk janë të detyruar të paraqesin RTD) dhe elementit që mungon në situatat që i caktojnë profesionistët në fjalë si subjekte raportuese sipas ligjit, dispozitat e mësipërme duken të jenë në përputhje me cilësimin e përcaktuar nga FATF-ja për kategorinë e përmendur të BPCJF-ve për të përmbushur detyrimin e raportimit të RTD-ve dhe, aty ku është e aplikueshme, për t'u përjashtuar nga ky detyrim.
344. *Tregtarët e metaleve të çmuara dhe gurëve të çmuar* – Kërkesa e parashtruar në paragrafin 1.1 të nenit 26 për të raportuar të gjitha aktivitetet ose transaksionet e dyshimta të NjIF-i zbatohet për shitësit e metaleve të çmuara dhe tregtarëve të gurëve të çmuar sa herë që cilësohen si subjekte raportuese sipas ligjit (siç përshkruhet në analizën për kriterin 22.1(c). Me përjashtim të "blerësve të metaleve të çmuara dhe gurëve të çmuar" që nuk janë përcaktuar si subjekte raportuese sipas ligjit (dhe për këtë arsye nuk janë të detyruar të paraqesin RTD), kjo duket të jetë në përputhje me cilësimin e përcaktuar nga FATF-ja për kategorinë e përmendur të BPCJF-ve për të përmbushur detyrimin e raportimit të RTD-ve.
345. *Ofruesit e shërbimeve për truste dhe kompani* – Kërkesa e parashtruar në paragrafin 1.1 të nenit 26 për të raportuar të gjitha aktivitetet ose transaksionet e dyshimta të NjIF-i zbatohet për ofruesit e shërbimeve për truste dhe kompani sa herë që cilësohen si subjekte raportuese sipas ligjit (siç përshkruhet në analizën për kriterin 22.1(e). Me përjashtim të rastit kur "kryejnë një funksion të barasvlershëm për një formë tjetër të marrëveshjes juridike", i cili nuk është përcaktuar si shërbim sipas ligjit (dhe, për këtë arsye, nuk mbulohet me kërkesën për të paraqitur RTD), kjo dispozitë duket të jetë në përputhje me situatat e përkufizuara nga FATF-ja për kategorinë e përmendur të BPCJF-ve për të përmbushur detyrimin e raportimit të RTD-ve.
346. **Kriteri 23.2** (*Pjesërisht i përmbushur*) – Këtu i është bërë referim analizës së Rekomandimit 18 për mbulimin e përgjithshëm të kërkesave për kontrollin e brendshëm në legjislacionin e Kosovës (me përjashtim të pjesëve të Rregullores së BQK-së për PPP/LFT-në, e cila zbatohet vetëm për bankat dhe institucionet financiare). Ekipi i vlerësimit nuk është pajisur me legjislacion apo mjete të tjera detyruese që përcaktojnë dispozita specifike për të çuar më tej ato të artikuluar në Ligjin për PPP/LFT-në dhe të rëndësishme për pajtueshmërinë e BPCJF-ve me kërkesat për PPP/LFT-në sipas Rekomandimit 18.
347. Sipas paragrafit 5 të nenit 21 të Ligjit për PPP/LFT-në, NjIF-i nxjerr akte nënligjore për të përkufizuar kriteret për "i përshtatshëm" dhe "i duhur" për zyrtarë të pajtueshmërisë. Sidoqoftë, këto akte nuk janë nxjerrë për BPCJF-të, dhe nuk ka kritere të ngjashme/procedura të përzgjedhjes⁷¹ të vendosura për punësimin e personelit në funksione përkatëse për PPP/LFT-në (p.sh. punonjësit përgjegjës për kontaktimin e klientëve, kryerjen e transaksioneve, kryerjen e KDK-së dhe masave të ndërlidhura).
348. Për më tepër, sipas paragrafit 2.6 të nenit 17 të Ligjit për PPP/LFT-në, politikat, procedurat dhe kontrollat e subjekteve raportuese duhet të parashohin krijimin e organeve të përshtatshme të kontrollit të rregullt të brendshëm për zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe funksionin e auditimit për të testuar sistemin e raportimit dhe identifikimit, përveç për subjektet me numër të kufizuar të stafit. Për pasojë, kjo dispozitë nuk kërkon disponueshmërinë e funksionit të auditimit të pavarur për një fushë dhe numër të përcaktuar të BPCJF-ve "me numër të kufizuar të stafit", ndërsa kërkesa për testimin e auditimit mbulon vetëm sistemet e raportimit dhe identifikimit, duke lënë anash përbërësit e tjerë të sistemit të PPP/LFT-së.
349. **Kriteri 23.3** (*Pjesërisht i përmbushur*) – Këtu i është bërë referim analizës së Rekomandimit 19 për mbulimin e përgjithshëm të kërkesave për vendet me rrezikshmëri më të lartë në kuadër të legjislacionit të Kosovës. Ekipi i vlerësimit nuk është pajisur me legjislacion apo mjete të tjera detyruese që përcaktojnë dispozita specifike përtej atyre të artikuluar në Ligjin për PPP/LFT-në dhe të rëndësishme për pajtueshmërinë e BPCJF-ve me kërkesat për PPP/LFT-në sipas Rekomandimit 19.

⁷¹ Për të paraparë, ndër të tjera, standarde arsimore dhe profesionale, kërkesat për të kaluar të pastër kriminale etj.

350. **Kriteri 23.4** (*Kryesisht i përmbushur*) – Këtu i është bërë referim analizës së Rekomandimit 21 për mbulimin e përgjithshëm të kërkesave të zbulimit dhe konfidencialitetit në kuadër të legjislacionit të Kosovës. Ekipi i vlerësimit nuk është pajisur me legjislacion apo mjete të tjera detyruese që përcaktojnë dispozita specifike përtej atyre të artikuluar në Ligjin për PPP/LFT-në dhe të rëndësishme për pajtueshmërinë e BPCJF-ve me kërkesat për PPP/LFT-në sipas Rekomandimit 21.

Vlerësimi dhe përfundimi

351. Faktet dhe rrethanat në vijim janë konsideruar se përcaktojnë vlerësimin për Rekomandimin 23:

- Cilësimet për avokatët, noterët, profesionet e tjera juridike të pavarura dhe kontabilistët (këshilltarët e tatimeve) për të raportuar transaksione të dyshimta nuk përmbushin kërkesat e FATF-së për aq sa ato nuk zbatohen në të gjitha situatat kur këta profesionistë angazhohen në një transaksion “në emër të ose për klientin”; “profesionet e tjera juridike të pavarura” nuk janë përcaktuar si subjekte raportuese sipas ligjit dhe, për rrjedhojë, nuk janë të detyruar të paraqesin RTD (kriteri 23.1 (a)); blerësit e metaleve të çmuara dhe gurëve të çmuar nuk janë përcaktuar si subjekte raportuese sipas ligjit dhe, për këtë arsye, nuk janë të detyruar të paraqesin RTD (kriteri 23.1 (b)); “kryerja e funksionit të barasvlershëm për një formë tjetër të marrëveshjes juridike” nuk është përcaktuar si shërbim i caktuar sipas ligjit dhe, për këtë arsye, nuk mbulohet me kërkesën për të paraqitur RTD (kriteri 23.1 (c));
- Përveç mangësive të identifikuar në lidhje me pajtueshmërinë me kërkesat e Rekomandimit 18, nuk janë nxjerrë akte nënligjore për përcaktimin e kriterëve “i përshtatshëm” dhe “i duhur” për zyrtarë të pajtueshmërisë së BPCJF-ve dhe nuk janë krijuar procedura të përzgjedhjes për punësimin e personelit në funksione përkatëse për PPP/LFT-në; nuk kërkohet disponueshmëria e një funksioni të auditimit të pavarur për një fushë dhe numër të paidentifikuar të BPCJF-ve “me numër të kufizuar të stafit”, ndërsa kërkesa për testimin e auditimit mbulon vetëm sistemet e raportimit dhe identifikimit, duke lënë anash përbërësit e tjerë të sistemit për PPP/LFT-në (kriteri 23.2); dhe
- Kërkesat përkatëse janë përmbushur pjesërisht në lidhje me Rekomandimet 18 (kriteri 23.2) dhe 19 (kriteri 22.3) dhe kryesisht në lidhje me Rekomandimin 21 (kriteri 23.4).

352. **Kosova është pjesërisht në përputhje me Rekomandimin 23.**

Rekomandimi 24 – Transparenca dhe pronësia përfituese e personave juridikë

353. Në Raportin e Vlerësimit për PPP/LFT-në të vitit 2014, Kosova u vlerësua se ishte pjesërisht në përputhje me Rekomandimin e mëparshëm 33. Një numër mangësish u identifikuan për të mbështetur vlerësimin, të cilat përfshinin mungesën e një detyrimi të drejtpërdrejtë për të informuar Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës (ARBK) mbi ndryshimet në zotërimin e aksioneve dhe drejtimit menjëherë sapo të ndodhin; shqetësimet për saktësinë dhe afatin kohor të informacionit në dispozicion; shqetësimet për kujdesin e duhur për themeluesit dhe aksionarët kryesorë; shqetësimet për afatin kohor të informatave në dispozicion të autoriteteve kompetente; mungesën e procedurave për autoritetet kompetente (përveç ATK-së) për identifikimin nëse një numër shoqëri tregtare i përkasin të njëjtit individ; mungesën e procedurave për autoritetet kompetente për identifikimin e ndërlidhjeve ndërmjet shoqërive tregtare ku disa shoqëri mund të jenë në pronësi të njëra-tjetrës; shqetësimet për lehtësinë e regjistrimit; paqartësinë juridike për shoqëritë e huaja tregtare me aksione të bartësit që janë aksionarë në një SH.A. të regjistruar në Kosovë; dhe, paqartësinë juridike nëse një organizatë e huaj e biznesit me aksione të bartësit mund të regjistrojë një degë në Kosovë, së bashku me çështjet e efektivitetit që rrjedhin prej kësaj.

354. **Kriteri 24.1** (*Kryesisht i përmbushur*) – **(a)** Llojet/format e personave juridikë në vijim përcaktohen në legjislacionin e Kosovës – ortakëria e përgjithshme, shoqëria komandite, shoqëria me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqëria aksionare.

355. Ligji po ashtu përcakton biznesin individual (BI). BI, Ortakëria e Përgjithshme dhe Shoqëria Komandite nuk kanë personalitet juridik, siç janë përcaktuar në nenet 48, 49.4 dhe 66.2 përkatësisht të Ligjit për Shoqëritë Tregtare. Për më tepër, neni 37.1 i ligjit gjithashtu përmend “shoqëritë e huaja tregtare” dhe thekson që “shoqëria e huaj tregtare mund të angazhohet në aktivitete tregtare në Kosovë, njëlloj sikurse edhe shoqëria tregtare e

Kosovës, por vetëm nëse paraprakisht është e regjistruar në Zyrën e Regjistrimit si "shoqëri e huaj tregtare".

356. Ligji nr. 2003/9 për Kooperativat Bujqësore parasheh që çdo kooperativë e bujqve e themeluar në Kosovë duhet të regjistrohet në zyrën e regjistrimit të subjekteve juridike dhe fillon së ekzistuari vetëm pas regjistrimit.
357. **Kriteri 24.1 (b)** – Ligji për Shoqëritë Tregtare parashikon procesin e krijimit të një personi juridik dhe paraqitjen e informacionit bazë në Zyrën e Regjistrimit, e cila njihet si Regjistri i Shoqërive Tregtare dhe Emrave Tregtarë të Kosovës, e themeluar si agjenci brenda Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë (neni 6).
358. Për Shoqëritë me Përgjegjësi të Kufizuar, neni 33.1 kërkon që themeluesi të nënshkruajë dhe të dorëzojë në Zyrën e Regjistrimit statutin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, që përmban emrin zyrtar të shoqërisë, adresën kryesore të biznesit në Kosovë, zyrën e regjistruar dhe emrin e agjentit të regjistruar të shoqërisë në këtë adresë, qëllimin e biznesit, emrin dhe adresën e secilit prej themeluesve të shoqërisë, numrin e personave që do të shërbejnë si drejtorë të shoqërisë si dhe emrin e adresën e tyre, kapitalin themeltar të zotuar, kapitalin e paguar, kapitalin e zotuar që nuk është paguar në kohën e regjistrimit, emrat dhe adresat e pronarëve dhe interesat përkatëse të pronësisë së tyre, së bashku me një deklaratë që vërteton se personi që nënshkruan dhe dorëzon statutin është "person i autorizuar" dhe se ky personi është i autorizuar të nënshkruajë dhe t'ia dorëzojë statutin Regjistrimit.
359. Ndërsa në shkronjën (k) është bërë referimi te pronari dhe te interesi përkatës i pronësisë, termi "pronar" nuk shtrihet gjithashtu në pronësinë përfituese. Në bazë të këtij formulimi dhe interpretimit të tij në praktikë, kriteri është përmbushur pjesërisht.
360. Ngjashëm, neni 35.1 për regjistrimin dhe themelimin e Shoqërive Aksionare kërkon që themeluesi të nënshkruajë dhe dorëzojë në Regjistrim statutin e shoqërisë aksionare që përmban emrin zyrtar të shoqërisë, adresën kryesore të biznesit në Kosovë, zyrën e regjistruar dhe emrin e agjentit të regjistruar të shoqërisë në atë adresë, qëllimin e biznesit, emrin dhe adresën e secilit prej themeluesve të shoqërisë, numrin e anëtarëve që do të jenë në Bordin e drejtorëve të shoqërisë dhe emrat e adresat e tyre, vlerën nominale për secilin aksion të aksioneve të thjeshta, numrin e aksioneve nga aksionet e thjeshta që do të emetohen në kohën e regjistrimit, numrin maksimal të aksioneve të kapitalit të përbashkët që shoqëria është e autorizuar të emetojë, një përshkrim të çdo kategorie të aksioneve të privileguara nëse është e autorizuar, përfshirë vlerën nominale sipas aksionit të secilës kategori, dividendet, likuidimin, të drejtën e votimit dhe të drejtat e preferencat e tjera të lidhura me atë kategori, numrin e aksioneve të kategorisë në fjalë që do të emetohen në kohën e regjistrimit, numrin maksimal të aksioneve të kategorisë në fjalë që shoqëria është e autorizuar t'i emetojë, kapitalin e emetuar; kapitalin themeltar të paguar, pjesën që nuk është paguar në kohën e regjistrimit dhe çdo afat të pagesës (nëse është e aplikueshme), numrin dhe llojin e aksioneve që do të emetohen për kompensim jomonetar në kohën e regjistrimit të shoqërisë, përshkrimin e natyrës së kompensimit të tillë jomonetar, si dhe emrin dhe adresën e çdo personi ose shoqërie që ofron këtë kompensim; shumën (ose shumën e përlogaritur), të të gjitha shpenzimeve të pagueshme nga shoqëria ose që i ngarkohen asaj për punën e bërë në lidhje me regjistrimin dhe themelimin e saj, një përshkrim të çdo përparësie të veçantë që i është dhënë çdo personi ose shoqërie që ka marrë pjesë në punën që çon në regjistrimin dhe themelimin e saj, së bashku me një deklaratë që vërteton se personi që nënshkruan dhe paraqet statutin është "person i autorizuar" dhe se ky person është i autorizuar të nënshkruajë dhe të dorëzojë statutin në zyrën e Regjistrimit.
361. Duke pasur parasysh se ligji nuk arrin të parashohë një detyrim specifik juridik për të pranuar dhe regjistruar të dhënat e pronësisë përfituese, kriteri përmbushet pjesërisht.
362. **Kriteri 24.2** (Nuk është përmbushur) – Autoritetet e Kosovës deri më sot nuk kanë vlerësuar rreziqet e PP/FT-së që rrjedhin nga llojet e ndryshme të personave juridikë.
363. **Kriteri 24.3** (Kryesisht i përmbushur) – Ligji për Shoqëritë Tregtare kërkon që shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqëritë aksionare të paraqesin të dhënat e shoqërisë në Zyrën e Regjistrimit, siç është përshkruar në 24.1 (b) më sipër. Për më tepër, personave juridikë u kërkohet të dorëzojnë dokumentet e shoqërisë në Zyrën e Regjistrimit për qëllime të informimit publik. Kjo përcaktohet në nenin 33.3 dhe 35.4. Siç u tha më parë, gjithashtu kërkohet që të regjistrohen kooperativat bujqësore.

364. Zyra e Regjistrimit e Kosovës ofron informacionin e mëposhtëm pa pagesë për publikun nëpërmjet faqes së vet të internetit (<https://arbk.rks-gov.net>):
- Lloji i personit juridik;
 - Emri i personit juridik;
 - Numri i regjistrimit të personit juridik;
 - Data e themelimit të personit juridik;
 - Adresa e personit juridik;
 - Emrat e personave të autorizuar; dhe
 - Emrat e pronarëve.
365. Në bazë të nenit 11 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare, i cili siguron një listë të informacionit që bëhet publik në lidhje me secilën shoqëri të regjistruar në zyrën e Regjistrimit, është vërtetuar se nuk ka kërkesa specifike ligjore për regjistrin për të marrë, përditësuar dhe publikuar provat për themelimin e personit juridik dhe dokumentet që përcaktojnë kompetencat themelore rregullatore në një person juridik.
366. **Kriteri 24.4** (*Kryesisht i përmbushur*) – Ligji për Shoqëritë Tregtare përcakton të dhënat që duhet të mbajë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar. Këto përfshijnë statutin e shoqërisë, marrëveshjen e shoqërisë, emrat dhe adresat e pronarëve dhe datën kur ata janë bërë pronarë. Nëse ka interesa pronësore me më shumë se një pronar, duhet të mbahet lista e emrave dhe adresave të secilit bashkëpronar dhe dokumenti që i emëron bashkëpronarët. Shoqëria gjithashtu duhet të mbajë emrat dhe adresat e të gjithë menaxherëve, listën e të gjitha transfertave dhe pengjeve apo dhe barrëve të vendosur që i përkasin një interesi pronësor të bërë ose të lejuar nga një pronar, së bashku me kopjet e dokumenteve financiare. Edhe pse neni 87 përfshin një listë të aksionarëve, ai nuk specifikon kërkesën për mbajtjen e numrit të aksioneve të zotëruara nga secili aksionar dhe kategoritë e aksioneve. Megjithatë, ai specifikon që informacioni duhet të mbahet në zyrën e regjistruar (selinë) ose në adresën kryesore të biznesit të personit juridik. Kooperativat bujqësore gjithashtu janë të detyruara të mbajnë në një regjistër anëtarët e kooperativës që tregojnë numrin e aksioneve në pronësi të çdo anëtari, si dhe të dhënat për çdo transfertë të aksioneve.
367. Nga ana tjetër, Ligji për Shoqëritë Tregtare nuk kërkon që shoqëritë aksionare të mbajnë një regjistër të aksionarëve apo anëtarëve të tyre, përfshirë numrin e aksioneve që mban secili aksionar dhe kategoritë e aksioneve. Për pasojë, ky kriter nuk është përmbushur plotësisht.
368. **Kriteri 24.5** (*Pjesërisht i përmbushur*) – Ligji për Shoqëritë Tregtare kërkon që shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqëritë aksionare të paraqesin ndryshimet për të dhënat e shoqërisë, drejtorët apo aksionarët në Zyrën e Regjistrimit, nëpërmjet neneve 34 dhe 36. Megjithatë, masat në vend për të siguruar që informacionet janë të sakta dhe të përditësuara nuk konsiderohen si të kënaqshme. E njëjta mund të thuhet për kooperativat bujqësore.
369. **Kriteri 24.6 (a) dhe (b)** (*I paaplikueshëm*) – Siç është theksuar në kriterin 24.5 më sipër, Ligji për Shoqëritë Tregtare kërkon që shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqëritë aksionare të paraqesin në Zyrën e Regjistrimit ndryshimet që kanë të bëjnë me informacionin mbi personin juridik. Për më tepër, sipas kriterit 24.4 më sipër, Ligji për Shoqëritë Tregtare rendit të dhënat që një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar duhet të mbajë në bazë të nenit 87, i cili gjithashtu përfshin një listë të aksionarëve që duhet të mbahen në zyrën e regjistruar ose adresën kryesore të biznesit të personit juridik. Megjithëse përmenden 'pronarët' e shoqërisë, kjo nuk shtrihet te personat që kanë një interes përfitues në shoqëri kur pronari është një person juridik. Për më tepër, kjo kërkesë për të mbajtur të dhënat e pronarëve nuk përsëritet për shoqëritë aksionare.
370. **Kriteri 24.6 (c)** (*Pjesërisht i përmbushur*) – Megjithëse institucionet financiare mbështeten nga autoritetet kompetente për të marrë disa forma të informacionit mbi pronësinë përfituese, të metat e identifikuara në Rekomandimin 10 nuk e lejojnë ekipin e vlerësimit ta konsiderojë këtë tërësisht si një praktikë të besueshme në rastin e Kosovës.
371. **Kriteri 24.7** (*Nuk është përmbushur*) – Siç është theksuar më sipër, Ligji për Shoqëritë Tregtare kërkon që shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqëritë aksionare të paraqesin në zyrën e regjistrimit ndryshimet që kanë të bëjnë me informacionin mbi personin juridik. Kjo, megjithatë, nuk shtrihet në pronësinë përfituese. Nuk ekziston as edhe ndonjë detyrim ligjor për shoqërinë që në mënyrë specifike të kërkojë mbajtjen e të

dhënave të sakta dhe të përditësuara të pronësisë përfituese. Një kërkesë e tillë nuk zbatohet as për kooperativat bujqësore.

372. **Kriteri 24.8** (*Nuk është përmbushur*) – Në mungesë të një regjistri të pronarëve përfitues nuk ekzistojnë dispozita të cilat krijojnë mekanizma për bashkëpunimin ndërmjet personit juridik dhe autoriteteve kompetente në lidhje me sigurimin e informacionit mbi pronësinë përfituese drejtpërdrejt, nëpërmjet BPCJF-ve ose nëpërmjet ndonjë mekanizmi tjetër të krahasueshëm.
373. **Kriteri 24.9** (*Pjesërisht i përmbushur*) – Ligji për Shoqëritë Tregtare parasheh që Zyra e Regjistrimit duhet të mbajë përherë të gjitha të dhënat dhe dokumentet, përfshirë dokumentet e pranuar ose të regjistruara (neni 18). Në fakt, neni 19 parasheh që Zyra e Regjistrimit duhet të mbajë kopjet origjinale në letër të të dhënave për së paku pesë (5) vite. Të dhënat në letër që janë më të vjetra se pesë (5) vite nuk duhet të shkatërrohen, por të barten në Arkivin e Kosovës. Ligji për PPP/LFT-në gjithashtu parashikon mbajtjen e të dhënave për një periudhë pesëvjeçare në lidhje me subjektet raportuese.
374. Pavarësisht nga sa më sipër, detyrimi për të mbajtur të dhënat për një periudhë prej pesë vjetësh jo domosdoshmërisht ekziston në rastet kur një shoqëri shpërbëhet ose ndryshe pushon së ekzistuari pasi që ligji hesht në këtë çështje. Nuk duhet as të supozohet se kjo kërkesë mbulon ruajtjen e informacionit të pronësisë përfituese pasi ajo nuk përmendet në mënyrë specifike. Për më tepër, Ligji për Kooperativat Bujqësore është i heshtur për këtë çështje.
375. **Kriteri 24.10** (*Pjesërisht i përmbushur*) – Ligji për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit parashikon mundësinë e NjIF-it që të kërkojë nga subjektet raportuese çdo të dhënë, dokument ose informacion të nevojshëm në zbatim të funksioneve të tij. Të dhënat, dokumentet ose informatat duhet të ofrohen brenda afatit kohor të përcaktuar nga NjIF-i (neni 14, paragrafi 1.4). Qasja në informata për NjIF-in dhe autoritetet e tjera është gjithashtu në dispozicion përmes ARBK-së. Megjithatë, ky informacion nuk përfshin informacionet mbi pronësinë përfituese.
376. **Kriteri 24.11** (*Pjesërisht i përmbushur*) – Ligji për Shoqëritë Tregtare thekson, në nenin 141, paragrafi 5, se shoqëritë aksionare nuk janë të autorizuar që të emetojnë dhe nuk duhet të emetojnë aksione ose letra me vlerë të bartësit. Ligji përcakton që çdo aksion ose letrat me vlerë të emetuar në kundërshtim me këtë nen si dhe çdo e drejtë apo pretendim i supozuar që rrjedh si pasojë e këtyre aksioneve ose letrave me vlerë janë të pavlefshme dhe të pazbatueshme.
377. Derisa aksionet e bartësit duken të jenë të ndaluara, garancitë e aksioneve të bartësit nuk janë.
378. **Kriteri 24.12** (*Nuk aplikohet*) – Ligji për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit rendit subjektet raportuese sipas nenit 16 të tij, i cili shërben për mundësinë e ofruesve të shërbimeve për truste dhe kompani (OShTK) për të vepruar si drejtorë ose aksionarë të emëruar. Nuk duket të jetë rasti që të emëruarit të mund të funksionojnë si drejtorë ose aksionarë në një person juridik kosovar sipas legjislacionit të Kosovës.
379. **Kriteri 24.13** (*Nuk është përmbushur*) – Kosova nuk ka aplikuar sanksione proporcionale dhe zhbindëse për personat juridikë dhe fizikë dhe prandaj është në mospërputhje me kërkesat e këtij kriteri.
380. **Kriteri 24.14** (*Nuk është përmbushur*) – Mundësia e organeve të zbatimit të ligjit për të detyruar subjektet raportuese dhe shoqëritë për të siguruar informacionin e pronarit përfitues në kohën e duhur nuk është themeluar me ligj. Për pasojë, nuk konsiderohet e mundur që këto informata të merren dhe të ndahen me homologët e tyre në përputhje me kriterin 24.14, veçanërisht kur ekzistojnë detyrime të konfidencialitetit dhe fshehtësisë profesionale.
381. **Kriteri 24.15** (*Nuk është përmbushur*) – Kriteri nuk plotësohet pasi që Kosova nuk e monitoron cilësinë e ndihmës që pranon nga vendet e tjera në përgjigje të kërkesave për informacion të pronësisë themelore dhe përfituese, ose kërkesave për ndihmë në gjetjen e pronarëve përfitues që jetojnë jashtë Kosovës.

Vlerësimi dhe përfundimi

382. Kosova nuk ka ndërmarrë ndonjë vlerësim të rreziqeve të PP/FT-së që lidhen me llojet e ndryshme të personave juridikë dhe nuk ka mekanizma ekzistues për të identifikuar dhe përshkruar procesin e identifikimit dhe regjistrimit të informacionit të pronësisë përfituese. Jo të gjitha informatat themelore të pronësisë mbi personat juridikë bëhen publikisht të disponueshme nga zyra e regjistrimit dhe shoqëritë aksionare nuk janë të detyruara të mbajnë të gjitha informacionet e aksionarëve. Masat ekzistuese për të siguruar që informacionet në zyrën e regjistrimit janë të sakta dhe të përditësuara nuk konsiderohen si të kënaqshme. Nuk ekzistojnë kërkesa për të siguruar disponueshmërinë e informacionit të pronësisë përfituese, përditësimin ose mirëmbajtjen e tij. Mekanizmat e bashkëpunimit të brendshëm dhe ndërkombëtar për shkëmbimin e informacionit të pronësisë përfituese nuk ekzistojnë në mënyrë specifike. Garancitë e aksioneve të bartësit nuk rregullohen as ndalohen në Kosovë.

383. **Kosova është pjesërisht në përputhje me Rekomandimin 24.**

Rekomandimi 25 – Transparenca dhe pronësia përfituese e marrëveshjeve juridike

384. Në Raportin e Vlerësimit për PPP/LFT-në të vitit 2014, Rekomandimi 34 nuk u konsiderua i aplikueshëm për Kosovën. U konstatua se edhe pse referimet në legjislacionin për PPP/LFT-në u bënë për 'trustet' dhe 'marrëveshjet juridike', kjo ishte më shumë si rezultat i miratimit fjalë për fjalë të Rekomandimeve të FATF-së se sa të zbatueshmërisë së ligjeve në një regjim të vendosur të trusteve në Kosovë. Në fakt, u shpreh se konceptet e trusteve dhe marrëveshjeve të tjera juridike nuk ekzistojnë sipas ligjeve të Kosovës dhe nuk ka infrastrukturë ligjore për krijimin, regjistrimin dhe dhënien e statusit juridik për marrëveshje të tilla.

385. Që nga vlerësimi i fundit, nuk ka pasur legjislacion të ri për të qeverisur themelimin ose rregullimin e trusteve dhe marrëveshjeve të tjera juridike. Megjithatë, Rekomandimet e FATF-së janë rivlerësuar ndërkohë dhe aktualisht sqarojnë se Rekomandimi 25 zbatohet për vendet edhe kur koncepti juridik i trusteve nuk parashihet nga legjislacioni vendor.

386. Autoritetet kanë qenë të qarta kur kanë treguar se nuk ka legjislacion që rregullon themelimin dhe funksionimin e trusteve apo marrëveshjeve të tjera juridike në Kosovë, që do të thotë se trustet nuk mund të themelohen në Kosovë. Sidoqoftë, nuk ka asgjë në ligj që përjashton trustet e huaja, fondacionet apo marrëveshjet e tjera juridike nga lidhja e një marrëdhënieje biznesi me një institucion financiar ose BPCJF në Kosovë. E as nuk është e ndaluar për një administrator të besuar trusti ose ndonjë marrëveshje tjetër juridike për të blerë pasuri në Kosovë.

387. **Kriteri 25.1 (I paaplikueshëm)** – Siç tregohet më lart, në Kosovë nuk ka ligj për trustet dhe Kosova nuk është nënshkruese e Konventës së Hagës për Ligjet e Zbatueshme për Trustet dhe Njohjen e tyre. (a) Në pajtim me kriterin 25.1 (a), ky nuk zbatohet në Kosovë pasi as trustet as marrëveshjet e tjera juridike nuk njihen sipas ligjit të brendshëm. Megjithatë, nuk ka ndalim për trustet e huaja të veprojnë në Kosovë. (b) Nuk ka truste të qeverisura sipas ligjit të Kosovës. (c) Një person që vepron si administrator profesional i besuar i një trusti sipas një ligji të huaj, do të bëhej subjekt i Ligjit për PPP/LFT-në dhe i kërkesave për ruajtjen e të dhënave.

388. **Kriteri 25.2 (I përmbushur)** – Kërkesat e Ligjit për PPP/LFT-në për identifikimin dhe verifikimin e pronarëve përfitues u referohen edhe trusteve e marrëveshjeve juridike dhe palëve të tyre. Kjo kërkesë do të zbatohet për administratorët e besuar të trusteve në pronësi të huaj.

389. **Kriteri 25.3 (Pjesërisht i përmbushur)** – Ndërsa ligji i referohet identifikimit të administratorit të trustit, nuk ka kërkesë të qartë për trustet që të zbulojnë statusin e tyre të subjektet raportuese kur krijojnë një marrëdhënie biznesi ose kryejnë një transaksion mbi pragun. Përveç kësaj, nuk duket se është detyrim që subjektet raportuese të përcaktojnë nëse klienti vepron në emër të dhe (ose) në dobi të një personi tjetër.

390. **Kriteri 25.4 (I përmbushur)** – Nuk duket të ketë dispozita në ligj ose mjete detyruese, të cilat do të parandalonin që trustet të ofrojnë informata tek autoritetet kompetente.

391. **Kriteri 25.5 (Pjesërisht i përmbushur)** – Ligji për PPP/LFT-në zbatohet *de facto* për trustet e huaja edhe pse trustet nuk ekzistojnë/nuk njihen sipas ligjit vendor. Nuk duket të ketë

ndonjë pengesë tjetër përveç atyre të përmendura në kriterin 31.1 për aftësinë e autoriteteve kompetente për të pasur qasje në informacionin e mbajtur nga administratorët e besuar të trusteve të huaja; megjithatë, meqë nuk ka kërkesë që trustet e tilla të deklarojnë statusin e tyre ndaj subjekteve të Ligjit për PPP/LFT-në, nuk ka asnjë mënyrë sistematike për autoritetet kompetente për të përcaktuar nëse subjektet e tilla veprojnë si truste.

392. **Kriteri 25.6** (*Kryesisht i përmbushur*) – Dispozitat e përgjithshme për bashkëpunimin me autoritetet kompetente të vendeve të tjera zbatohen për kërkesat për informacion mbi pronësinë përfituese dhe marrëveshjet e tjera juridike. Sidoqoftë, mungesa e mundshme e informacionit specifik të trustit dhe kufizimet sipas kriterit 25.3 duhet të mbahen parasysh.
393. **Kriteri 25.7** (*I përmbushur*) – Personat që veprojnë si administratorë profesionalë të besuar të një trusti të huaj juridik do t'u nënshtrohen sanksioneve të mjaftueshme proporcionale dhe zbindëse për mospërputhje me kërkesat për KDK-në dhe për ruajtjen e të dhënave në Ligjin për PPP/LFT-në.
394. **Kriteri 25.8** (*I përmbushur*) – Autoriteti për të kërkuar informata të duhura për procedurat penale nga ana e AZL-ve ndaj çdo personi sipas dispozitave të ligjit penal do të zbatohet në këtë drejtim, duke iu nënshtuar ndëshkimit për mosplotësim të kërkesës. Në rastet kur informacioni për një trust mbahet nga një subjekt raportues, dispozitat e Ligjit për PPP/LFT-në do të zbatoheshin. Është vërejtur se nuk ka dispozita të veçanta që të mbulojnë ndonjë gjë tjetër përveç situatave të lartpërmendura.

Vlerësimi dhe përfundimi

395. Kriteret që zbatohen në Kosovë janë përmbushur gjerësisht. Megjithatë sistemi do të përfitonte nga ndryshimet në ligj që do të adresonin në mënyrë të drejtpërdrejtë masat për të parandaluar keqpërdorimin e trusteve/marrëveshjeve juridike. Në veçanti, duhet të merren masa për të përfshirë një kërkesë ligjore kundrejt administratorit të besuar për të zbuluar statusin e tij/saj tek IF-të dhe BPCJF-të kur krijon një marrëdhënie biznesi dhe sanksionet përkatëse.
396. **Kosova është kryesisht në përputhje me Rekomandimin 25.**

Rekomandimi 26 – Rregullimi dhe mbikëqyrja e institucioneve financiare

397. Në Raportin e Vlerësimit për PPP/LFT-në të vitit 2014, Kosova u vlerësua se ishte pjesërisht në përputhje me Rekomandimin e mëparshëm 23 të FATF-së. Vlerësimi identifikoi mangësi teknike lidhur me: mungesën e funksionit për një autoritet mbikëqyrës kompetent të caktuar për nxjerrjen e rregullave dhe rregulloreve për PPP/LFT-në; mungesën e detyrimit për të informuar BQK-në për lirimin nga aksionet; nevojën për të fuqizuar kriteret për miratimin e ndryshimeve në aksione në lidhje me çështje të PPP/LFT-së; dhe, dallimet në përkufizimin e "institucionit financiar".
398. **Kriteri 26.1** (*Kryesisht i përmbushur*) – Përkufizimi i bankave dhe institucioneve të tjera financiare të parapara në paragrafët 1.6 dhe 1.16 të nenit 2 të Ligjit për PPP/LFT-në, si dhe përcaktimi i veprimtarive të lejuara financiare të parapara në paragrafin 1 të nenit 44 (për bankat), paragrafin 3 të nenit 93 (për IMF-të) dhe paragrafin 2 të nenit 94 (për IFJB-të) të Ligjit për Bankat, IMF-të dhe IFJB-të duken të jenë përgjithësisht në përputhje me atë të fjalorit të FATF-së.
399. Sipas paragrafit 3 të nenit 34 të Ligjit për PPP/LFT-në, NjIF-i, BQK-ja dhe mbikëqyrësit e tjerë sektorialë kryejnë mbikëqyrjen e pajtueshmërisë sipas dispozitave të Ligjit për PPP/LFT-në gjatë ushtrimit të kompetencave të tyre në pajtim me atë ligj dhe ligjet e tjera përkatëse. Për këtë qëllim, paragrafi 5 i të njëjtit nen thekson se NjIF-i hyn në marrëveshje specifike individuale me shkrim me mbikëqyrësit e tjerë sektorialë me qëllim të krijimit të kompetencave mbikëqyrëse dhe përgjegjësi, procedurave dhe bashkëpunimit përkatës.
400. Paragrafi 4 i nenit 34 të Ligjit për PPP/LFT-në përcakton që BQK-ja kryen mbikëqyrjen e pajtueshmërisë për subjektet raportuese në nënparagrafët 1.1 dhe 1.2 të nenit 16 të ligjit, pra bankat dhe institucionet e tjera financiare siç janë institucionet mikrofinanciare⁷² dhe

⁷² Përcaktuar si "person juridik i organizuar ose si OJQ sipas ligjit për OJQ-të ose si shoqëri aksionare sipas ligjit për Shoqëritë Tregtare, aktiviteti primar i të cilit është dhënia e kredive dhe ofrimi i një numri të kufizuar të shërbimeve financiare për mikro dhe subjektet e vogla juridike, ekonomitë familjare me të hyra të ulëta dhe personat me të hyra të ulëta".

institucionet financiare jobankare,⁷³ që funksionojnë sipas Ligjit për Bankat, IMF-të dhe IFJB-të. Kjo përforcohet nga dispozita e paragrafit 1 të nenit 23 të ligjit për BQK-në, i cili përcakton që Banka Qendrore është ekskluzivisht përgjegjëse, ndër të tjera, për rregullimin dhe mbikëqyrjen e bankave dhe institucioneve të tjera financiare, siç specifikohet më tej në ligjet përkatëse.

401. Pastaj, paragrafi 3 i nenit 35 të Ligjit për PPP/LFT-në përcakton se NjIF-i mund të kryejë inspektime të pajtueshmërisë në terren duke zbatuar kompetencat e dhëna me këtë ligj edhe te subjektet raportuese me qëllim të vlerësimit të pajtueshmërisë së këtyre subjekteve raportuese me nenin 18 (Vlerësimi dhe parandalimi i rrezikut) dhe nenin 26 (Raportimi të NjIF-i) të këtij ligj. Kjo duket të jetë disi në kundërshtim me dispozitën e paragrafit 1 të nenit 36 të Ligjit për PPP/LFT-në që përcakton se, për qëllime të mbikëqyrjes së pajtueshmërisë së subjekteve raportuese me ligjin dhe me rregullat e rregulloret përkatëse, BQK-ja zbaton kompetencat e saj të mbikëqyrjes së kujdesit, me sa duket në lidhje me inspektimet në terren⁷⁴, me përjashtim të kompetencës për mbikëqyrje të pajtueshmërisë me nenin 26 (Raportimi të NjIF-i) të Ligjit për PPP/LFT-në, për të cilin NjIF-i ka kompetencë ekskluzive mbikëqyrëse.
402. Përgjithësisht, kjo përgjegjësi e përbashkët për mbikëqyrjen e pajtueshmërisë me PPP/LFT-në të bankave dhe institucioneve të tjera financiare duket se bie në kundërshtim me dispozitat e ligjit për BQK-në dhe ligjet e tjera sektoriale mbi funksionin e vetëm mbikëqyrës të BQK-së. Përveç kësaj, nevojitet më shumë qartësi në aspektin e gjuhës shpjeguese juridike që përcakton funksionet mbikëqyrëse të NjIF-it dhe BQK-së për të kontrolluar pajtueshmërinë me çdo kërkesë sipas Ligjit për PPP/LFT-në, përfshirë përmes inspektimeve në terren dhe mbikëqyrjen në distancë.

Hyrja në treg

403. **Kriteri 26.2** (I përmbushur) – Paragrafi 1 i nenit 23 të ligjit për BQK-në përcakton se Banka Qendrore është ekskluzivisht përgjegjëse, ndër të tjera, për licencimin dhe regjistrimin e bankave dhe institucioneve të tjera financiare, ashtu siç përcaktohet më tej në ligjet përkatëse. Sipas paragrafit 1 të nenit 4 të Ligjit për Bankat, IMF-të dhe IFJB-të, BQK-ja ka përgjegjësi ekskluzive për dhënien e licencave për të gjitha bankat dhe regjistrimin e të gjitha Institucioneve Mikrofinanciare dhe Institucioneve Financiare Jobankare⁷⁵ (përfshirë ofruesit e SHTPV-ve dhe të këmbimit valutor), si dhe për lëshimin e lejeve të bankave të huaja në lidhje me themelimin e zyrave përfaqësuese në Kosovë. Kjo përforcohet nga dispozita e paragrafit 1.2 të nenit 8 të ligjit për BQK-në që përcakton, ndër të tjera, funksionin e BQK-së për licencimin dhe regjistrimin e bankave dhe institucioneve të tjera financiare. Manuali i BQK-së për Regjistrimin e IMF-ve dhe IFJB-ve (korrik 2017) përcakton hollësi të mëtejshme të procedurave dhe kërkesave për regjistrimin e këtyre llojeve të institucioneve financiare.
404. Kërkesat dhe procedurat për licencimin e bankave (përfshirë këtu edhe miratimin paraprak, kur plotësohen kushtet, ndër të tjera, si "struktura organizative e bankës së propozuar dhe filialeve të saj do t'i lejojë BQK-së të ushtrojë mbikëqyrje efektive dhe të konsoliduar" siç parashihet në paragrafin 3.2 të nenit 8 të Ligjit për Bankat, IMF-të dhe IFJB-të), si dhe për kapitalin dhe likuiditetin, rregullat për qeverisjen e strukturën organizative, aktivitetet financiare, llogaritë dhe pasqyrat financiare të bankave siç është përcaktuar në legjislacionin në fuqi, pamundësojnë themelimin ose funksionimin e vazhdueshëm të bankave guaskë siç është përcaktuar në fjalorin e FATF-së.⁷⁶

⁷³ Përcaktuar si "personi juridik që nuk është bankë e as institucion mikrofinanciar, që është licencuar nga BQK-ja sipas këtij ligji, për t'u angazhuar në një ose më tepër nga veprimtaritë vijuese: dhënien e kredive, hyrjen në hua dhe kontrata qiradhënie financiare-lizingu, në nënshkrimin, tregtimin, ndërmjetësimin ose shpërndarjen e letrave me vlerë, veprimin si shoqëri investuese ose këshilltar i investimeve apo ofrimin e shërbimeve të tjera financiare siç janë këmbimi valutor; kredit kartat; faktoringun, ose garancitë, ose shërbime të tjera financiare, edukuese-trajnuese, këshillëdhënëse dhe operationale, si dhe veprimtari të tjera sipas përcaktimit nga BQK-ja".

⁷⁴ Titulli i nenit 36 të Ligjit për PPP/LFT-në është "Inspektimi i pajtueshmërisë në vend nga BQK-ja dhe mbikëqyrësit e tjerë sektoriale".

⁷⁵ BQK-ja gjithashtu ka nxjerrë Rregulloren për Licencimin e Bankave dhe Degëve të Bankave të Huaja të datës 9 nëntor 2012 dhe Rregulloren për Regjistrimin, Mbikëqyrjen dhe Veprimtaritë e Institucioneve Financiare Jobankare të datës 28 maj 2015.

⁷⁶ Shih analizën për kriterin 13.3 lidhur me përkufizimin e bankës guaskë në legjislacionin e Kosovës.

405. **Kriteri 26.3** (*Pjesërisht i përmbushur*) – Masat e nevojshme ligjore për të parandaluar që kriminelët të zotërojnë (ose jenë pronarë përfitues me) pjesëmarrje të konsiderueshme ose kontrolluese apo të mbajnë funksione drejtuese në banka janë të parapara në Ligjin për Bankat, IMF-të dhe IFJB-të.
406. Veçanërisht, paragrafi 1 i nenit 7 të ligjit përcakton se kërkesat për licencë për themelimin dhe funksionimin e një banke⁷⁷ shoqërohen, ndër të tjera, me listën e aksionarëve që mbajnë apo do të mbajnë 5% a më shumë të aksioneve të bankës së propozuar dhe pronarëve përfitues përfundimtarë të këtyre aksioneve, si dhe për secilin aksionar kryesor të bankës së propozuar, dëshminë zyrtare nga gjykata që shpalojë çdo dënim për vepra penale nga gjykata penale. Sipas paragrafit 3 të nenit 8 të ligjit, BQK-ja paraprakisht miraton licencën vetëm nëse bindet se aksionarët kryesorë të bankës së propozuar janë të aftë dhe të përshtatshëm.
407. Neni 37 i ligjit parasheh që aplikimet për blerjen ose rritjen e zotërimeve të interesave të kapitalit neto në një bankë duhet të përfshijnë, për secilin aplikant, një deklaratë zyrtare nga gjykata për shpalesjen e çdo dënimi për vepra penale nga gjykatat penale. Asnjë person, që vepron në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, vetëm apo në bashkëveprim me ndonjë person tjetër, nuk mund të bëhet aksionar kryesor ose të rrisë interesin e tij pronësor në një bankë mbi 10, 20, 33, 50 ose 75% të kapitalit pa marrë autorizimin paraprak me shkrim nga BQK-ja.
408. Paragrafi 1.1 i nenit 35 të ligjit përcakton se çdo drejtor dhe menaxher i lartë i një banke duhet të jetë i aftë dhe i përshtatshëm dhe me emër të mirë dhe duhet të plotësojë kriteret e përcaktuara nga BQK-ja në lidhje me kualifikimet, përvojën dhe integritetin. Në të njëjtën kohë, asnjë person nuk mund të konsiderohet si i përshtatshëm dhe i duhur nëse është dënuar nga një gjykatë penale për një vepër penale të dënueshme me burgim për një vit ose më shumë, kur nuk ka ekzistuar opsioni i gjobës. Neni 59 parasheh autoritetin e BQK-së për të pezulluar autorizimin ose për të kërkuar shkarkimin e çdo menaxheri apo punonjësi të një banke që ka kryer me dashje ose në mënyrë të përsëritur ndonjë shkelje të legjislacionit në fuqi.
409. Dispozita të ngjashme për kërkesat e përshtatshmërisë në lidhje me aksionarët dhe menaxherët përcaktohen për siguresit (risiguresit) dhe ndërmjetësit e sigurimeve (nenet 10, 11, 24, 32-35, 118 dhe 126 të Ligjit për Sigurimet).
410. Për rrjedhojë, sa u përket bankave dhe shoqërive të sigurimit, elementi i munguar në krahasim me kërkesat në kriterin 26.3 është mungesa e një gjuhe të qartë për të parandaluar që bashkëpunëtorët e kriminelëve të hyjnë në tregun financiar si zotërues (ose pronarë përfitues) të pjesëmarrjes së konsiderueshme ose kontrolluese.
411. Sa u përket institucioneve të tjera financiare, neni 97 i Ligjit për Bankat, IMF-të dhe IFJB-të përcakton se të gjithë anëtarët e Bordit të drejtorëve të IMF-ve dhe IFJB-ve duhet të jenë "të përshtatshëm dhe të duhur" dhe me reputacion të mirë, duke i plotësuar kriteret e caktuara nga BQK-ja lidhur me kualifikimet, përvojën dhe integritetin e anëtarëve të Bordit të drejtorëve. Para se ta marrin detyrën, anëtarët e bordit të drejtorëve të institucionit mikrofinanciar duhet të kenë miratim me shkrim nga BQK-ja. Për sa u përket IFJB-ve, Rregullorja e BQK-së për Regjistrimin, Mbikëqyrjen dhe Aktivitetet e Institucioneve Financiare Jobankare e datës 28 maj 2015 kërkon më tej kontrollimin e të kaluarës kriminale të aksionarëve kryesorë, drejtorëve dhe menaxherëve të lartë (paragrafi 3.8 i nenit 5), kualifikimin profesional dhe përvojën e drejtorëve dhe menaxherëve të lartë (paragrafi 3.9 i nenit 5). Rregullorja në fjalë i bën gjithashtu reputacionin e mirë, burimet e ligjshme të fondeve të kapitalit të themeluesve, kualifikimet, përvojën dhe reputacionin e anëtarëve të bordit të drejtorëve dhe kryeshefit ekzekutiv (paragrafi 2.1 i nenit 6) parakushte për miratimin e regjistrimit të IFJB-ve.
412. Për rrjedhojë, sa i përket institucioneve financiare jobankare, elementët që mungojnë në krahasim me kërkesat e kriterit 26.3 përfshijnë mungesën e: a) gjuhës së qartë për të parandaluar që personat me të kaluar kriminale⁷⁸ të zotërojnë (ose të jenë pronarë përfitues me) pjesëmarrje të konsiderueshme ose kontrolluese apo të mbajnë funksione

⁷⁷ Duke përfshirë degët e bankave të huaja.

⁷⁸ Në krahasim me kërkesat e përcaktuara për bankat dhe kompanitë e sigurimeve, ku thuhet qartë se një person me dënim të mëparshëm për një vepër penale që cakton dënim me burg nuk konsiderohet si i përshtatshëm dhe i duhur për pozita drejtuese. Dispozita e përgjithshme e kontrollit të "reputacionit të mirë" të aksionarëve dhe menaxherëve të IFJB-ve nuk duket të sigurojë pajtueshmërinë me kërkesat në kriterin 26.3.

drejtuese në një IFJB; dhe b) kërkesa për të parandaluar bashkëpunëtorët e kriminelëve që të bëjnë të njëjtën gjë.

413. Përveç kërkesës së mësipërme për të qenë i përshtatshëm dhe i duhur për bordin e drejtorëve të institucioneve mikrofinanciare të përcaktuara në nenin 97 të Ligjit për Bankat, IMF-të dhe IFJB-të, nuk ka kërkesa për të parandaluar personat me të kaluar kriminale ose bashkëpunëtorët e tyre të zotërojnë (ose të jenë pronarë përfitues me) pjesëmarrje të konsiderueshme ose kontrolluese apo të mbajnë funksione drejtuese në një IMF.⁷⁹

Qasja e bazuar në rrezik për mbikëqyrje dhe monitorim

414. **Kriteri 26.4** (*Pjesërisht i përmbushur*) – Të gjitha institucionet sipas Parimeve Themelore dhe ato të tjera financiare janë përcaktuar si subjekte raportuese në paragrafin 1 të nenit 16 të Ligjit për PPP/LFT-në. Paragrafi 4 i nenit 34 të Ligjit për PPP/LFT-në përcakton se BQK-ja kryen mbikëqyrjen e pajtueshmërisë për bankat dhe institucionet financiare jobankare sipas kompetencave të dhëna me këtë ligj⁸⁰. Ligji për Bankat, IMF-të dhe IFJB-të (neni 38) dhe ligji për Sigurime (neni 11) i referohen aftësisë së BQK-së për të ushtruar mbikëqyrje efektive të konsoliduar, me sa duket edhe për qëllimet e PPP/LFT-së por nuk ka megjithatë dispozita të tjera ligjore ose mjete të tjera detyruese për të siguruar mekanizmat dhe mjetet për zbatimin praktik të saj.
415. Dokumenti i fundit i Vlerësimit të Stabilitetit të Sistemit Financiar nga FMN-ja (VSSF) për Kosovën u përfundua në dhjetor 2012 dhe u publikua në prill 2013. Sipas raportit, "Vlerësimi i Parimeve Themelore të Bazelit ka gjetur një nivel të pabarabartë të përputhshmërisë me standardet ndërkombëtare, kryesisht për shkak të kufizimeve të burimeve. Fushat kryesore që duhet të trajtohen janë: përmirësimet në kornizën ligjore; zhvillimi i një programi mbikëqyrës të bazuar në rrezik, i cili kërkon avancim; mbikëqyrja e konsoliduar dhe bashkërendimi më i ngushtë me mbikëqyrësit e huaj dhe vazhdimi i ngritjes së kapaciteteve në mbikëqyrje". Sa u përket Parimeve Themelore të Sigurimeve (PTHS) të Shoqatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Sigurimeve (IAIS), raporti arrin në përfundimin se "kur vlerësohet sipas parimeve themelore të sigurimeve të IAIS, korniza rregullatore ekzistuese nuk është e plotë dhe është e papërshtatshme". Raporti nuk flet lidhur me pajtueshmërinë e Kosovës me Objektivat dhe Parimet e Rregullimit të Letrave me Vlerë të Organizatës Ndërkombëtare të Komisioneve të Letrave me Vlerë (IOSCO).
416. Një Raport i Stafit i vitit 2017 lidhur me Konsultimin për Artikullin IV i përfunduar në dhjetor 2017 dhe i publikuar në janar 2018 përmbledh, ndër të tjera, statusin e zbatimit të rekomandimeve të FSAP 2012 (Shtojca V). Sipas këtij raporti, disa nga rekomandimet në lidhje me Parimet Themelore të Bazelit të lidhura me PPP/LFT-në (të tilla si kryerja e shqyrtimit gjithëpërfshirës të kornizës ligjore dhe rregullatore të sistemit financiar, rishikimi i legjislationit të PPP-së, futja e mbikëqyrjes së bazuar në rrezik) janë zbatuar plotësisht. Megjithatë, efektiviteti i zbatimit të këtyre dhe rekomandimeve të tjera duhet të testohet ende. Ekipi i vlerësimit nuk ka dhënë informacione përkatëse që mundësojnë një përfundim nëse institucionet financiare sipas Parimeve Themelore janë të rregulluara dhe të mbikëqyrura në përputhje me parimet e zbatueshme të përcaktuara nga IOSCO dhe IAIS lidhur me PPL/LFT-në⁸¹.
417. **Kriteri 26.5** (*Pjesërisht i përmbushur*) – Paragrafi 6 i nenit 34 të Ligjit për PPP/LFT-në thekson se BQK-ja dhe mbikëqyrësit e tjerë sektorialë marrin parasysh rrezikun e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në sektorin në të cilin vepron subjekti raportues. Autoritetet u referohen disa dokumenteve që synojnë të sigurojnë pajtueshmërinë me kërkesat e kriterit 26.5, ku përfshihen veçanërisht: a) *Procedurat Standarde të Operimit për Mbikëqyrjen e Pajtueshmërisë së NjIF-it* (nxjerrë në vitin 2017), të cilat përcaktojnë kuadrin e mbikëqyrjes së bazuar në rrezik të ndërtuar mbi analizën e përgjithshme të rrezikut, vlerësimin e rrezikut të subjekteve të mbikëqyrura dhe përzgjedhjen pasuese të objektivave dhe metodave të ndërhyrjes mbikëqyrëse së bashku me shpeshësinë dhe intensitetin e duhur të ndërhyrjes së tillë; b) Plani i Performancës dhe i Burimeve të NjIF-it 2015-2017 (nxjerrë në vitin 2015); dhe c) Plani i Veprimit i Strategjisë Kombëtare për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Joformale, Pastrimit të Parave, Financimit të

⁷⁹ Shih fusnotën e mëparshme.

⁸⁰ Funkzioni i tillë mbikëqyrës ndahet me NjIF-in për çështjet e lidhura me pajtueshmërinë me nenin 18 (Vlerësimi dhe parandalimi i rrezikut) dhe nenin 26 (Raportimi të NjIF-it) të Ligjit për PPP/LFT-në, siç përcaktohet në analizën për kriterin 26.1.

⁸¹ Siç përshkruhet në fusnotën 59 të Metodologjisë së FATF-së.

Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2014-2018 (nxjerrë në vitin 2014), i cili parashikon veprimin "2.2.1. Zbatimi i aktiviteteve të mbikëqyrjes së pajtueshmërisë për të vlerësuar përputhshmërinë e subjekteve raportuese të PPP/LFT-së me Ligjin për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit", me afat zbatimi të përcaktuar për 31 dhjetor 2018.

418. Në përgjithësi, informacioni i vënë në dispozicion të vlerësuesve nuk mundëson një përfundim nëse shpeshtësia dhe intensiteti i mbikëqyrjes së institucioneve apo grupeve financiare nga BQK-ja në terren dhe në distancë (për çështje të tjera përveç pajtueshmërisë me nenin 18 dhe 26 të Ligjit për PPP/LFT-në) dhe nga NjIF-i (për çështjet që lidhen me pajtueshmërinë me nenet 18 dhe 26 të Ligjit për PPP/LFT-në) përcaktohen në bazë të: (a) rreziqeve dhe politikave të PP/FT-së, kontrolleve të brendshme dhe procedurave që lidhen me institucionin ose grupin, të identifikuar nga vlerësimi i mbikëqyrësve për profilin e rrezikut të institucionit ose grupit; (b) rreziqet e PP/FT-së që janë të pranishme në vend; dhe (c) karakteristikat e institucioneve ose grupeve financiare, në veçanti diversiteti dhe numri i institucioneve financiare dhe shkalla e lirisë së veprimit të lejuar ndaj tyre sipas qasjes së bazuar në rrezik.
419. **Kriteri 26.6** (Pjesërisht i përmbushur) – Autoritetet u referohen *Procedurave Standarde të Operimit për Mbikëqyrjen e Pajtueshmërisë së NjIF-it* (nxjerrë në vitin 2017), të cilat theksojnë se niveli drejtues i NjIF-it monitoron zbatimin e Planit Vjetor të Mbikëqyrjes dhe cakton burimet e veta të inspektimit bazuar në vlerësimin e rrezikut, i cili mbulon dimensionet kryesore të profilit të rrezikut të subjekteve raportuese.
420. Në përgjithësi, informacioni i vënë në dispozicion të vlerësuesve nuk mundëson një përfundim nëse BQK-ja dhe NjIF-i shqyrtojnë vlerësimin e profilit të rrezikut të PP/FT-së së institucioneve ose grupeve financiare (përfshirë rreziqet e mospajtueshmërisë) periodikisht dhe kur ka ngjarje apo zhvillime të mëdha në menaxhimin dhe operacionet e institucionit ose grupit financiar.

Vlerësimi dhe përfundimi

421. Faktet dhe rrethanat në vijim janë konsideruar se përcaktojnë vlerësimin për Rekomandimin 26:
- Përgjegjësia e përbashkët për mbikëqyrjen e pajtueshmërisë së bankave dhe institucioneve të tjera financiare me PPP/LFT-në duket se bie në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për BQK-në dhe ligjet e tjera sektoriale mbi funksionin e vetëm mbikëqyrës të BQK-së; kërkohet më shumë qartësi në aspektin e gjuhës shpjeguese juridike që përcakton funksionet mbikëqyrëse të NjIF-it dhe BQK-së për të kontrolluar pajtueshmërinë me kërkesat e Ligjit për PPP/LFT-në (kriteri 26.1);
 - Lidhur me: 1) bankat dhe shoqëritë e sigurimeve, mungon një gjuhë e qartë për të parandaluar që bashkëpunëtorët e kriminelëve të hyjnë në tregun financiar si zotërues (ose pronarë përfitues) të pjesëmarrjes së konsiderueshme ose kontrolluese; 2) institucionet financiare jobankare, ekziston mungesë e: a) gjuhës së qartë për të parandaluar që personat me të kaluar kriminale të zotërojnë (ose të jenë pronarë përfitues me) pjesëmarrje të konsiderueshme ose kontrolluese apo të mbajnë funksione drejtuese në një IFJB; dhe b) kërkesa për të parandaluar bashkëpunëtorët e kriminelëve që të bëjnë të njëjtën gjë; 3) institucionet mikrofinanciare, nuk ka kërkesa për të parandaluar personat me të kaluar kriminale ose bashkëpunëtorët e tyre që të zotërojnë (ose të jenë pronarë përfitues me) pjesëmarrje të konsiderueshme ose kontrolluese apo të mbajnë funksione drejtuese në një IMF (kriteri 26.3);
 - Rregullimi dhe mbikëqyrja në pajtim me Parimet Themelore nuk është demonstruar; legjislacioni i referohet aftësisë së BQK-së për të ushtruar mbikëqyrje efektive të konsoliduar, me sa duket edhe për qëllimet e PPP/LFT-së, por pa dispozita të tjera ligjore ose mjete të tjera detyruese për të siguruar mekanizmat dhe mjetet për zbatimin praktik të saj (kriteri 26.4);
 - Informacioni i vënë në dispozicion të vlerësuesve nuk mundëson një përfundim nëse shpeshtësia dhe intensiteti i mbikëqyrjes së institucioneve apo grupeve financiare në terren dhe në distancë përcaktohen në bazë të: (a) rreziqeve dhe politikave të PP/FT-së, kontrolleve të brendshme dhe procedurave që lidhen me institucionin ose grupin, të identifikuar nga vlerësimi i mbikëqyrësve për profilin e rrezikut të institucionit ose grupit; (b) rreziqet e PP/FT-së që janë të pranishme në vend; dhe (c) karakteristikat e institucioneve ose grupeve financiare, në veçanti diversiteti dhe numri i institucioneve

financiare dhe shkalla e lirisë së veprimit të lejuar ndaj tyre sipas qasjes së bazuar në rrezik (kriteri 26.5); dhe

- Informacioni i vënë në dispozicion të vlerësuesve nuk mundëson një përfundim nëse BQK-ja dhe NjIF-i shqyrtojnë vlerësimin e profilit të rrezikut të PP/FT-së së institucioneve ose grupeve financiare (përfshirë rreziqet e mospajtueshmërisë) periodikisht dhe kur ka ngjarje apo zhvillime të mëdha në menaxhimin dhe operacionet e institucionit ose grupit financiar (kriteri 26.6).

422. **Kosova është pjesërisht në përputhje me Rekomandimin 26.**

Rekomandimi 27 – Kompetencat e mbikëqyrësve

423. Në Raportin e Vlerësimit për PPP/LFT-në të vitit 2014, Kosova u vlerësua në mospërputhje me Rekomandimin e mëparshëm 29 të FATF-së. Vlerësimi identifikoi mangësi teknike lidhur me: mungesën e një funksioni ligjor për BQK-në për të zbatuar kompetenca mbikëqyrëse të kujdesshme për qëllimet e Ligjit për PPP/LFT-në; mungesën e kompetencës për NjIF-in për të ndërmarrë inspektime në distancë; paqartësinë juridike mbi kompetencat e përgjithshme të NjIF-it për të ndërmarrë inspektime të pakushtëzuara në terren; dhe, mungesën e kompetencave të duhura për zbatimin dhe shqiptimin e sanksioneve ndaj drejtorëve dhe drejtuesve të lartë të institucioneve financiare.

424. **Kriteri 27.1** (*I përmbushur*) – Paragrafi 4 i nenit 34 të Ligjit për PPP/LFT-në përcakton që BQK-ja kryen mbikëqyrjen e pajtueshmërisë për bankat dhe institucionet financiare jobankare sipas kompetencave të dhëna me këtë ligj. Paragrafi 1 i nenit 36 të Ligjit për PPP/LFT-në më tej përcakton se, për qëllime të mbikëqyrjes së pajtueshmërisë së subjekteve raportuese me ligjin dhe me rregullat e rregulloret përkatëse, BQK-ja zbaton kompetencat e saj të mbikëqyrjes së kujdesit, me sa duket në lidhje me inspektimet në terren⁸², me përjashtim të kompetencave për mbikëqyrjen e pajtueshmërisë me nenin 26 (Raportimi të NjIF-i) të Ligjit për PPP/LFT-në, për të cilin NjIF-i ka kompetencë ekskluzive mbikëqyrëse⁸³. Kompetencat e NjIF-it për mbikëqyrjen përcaktohen në paragrafin 3 të nenit 34 dhe më hollësisht në nenin 35 (për inspektimet në terren) dhe nenin 37 (për mbikëqyrjen nga distanca).

425. **Kriteri 27.2** (*Kryesisht i përmbushur*) – Sipas paragrafit 2 të nenit 34 të Ligjit për PPP/LFT-në, mbikëqyrja e pajtueshmërisë së subjekteve raportuese kryhet nëpërmjet inspektimeve në terren dhe mbikëqyrjes nga distanca. Autoriteti i BQK-së për të kryer inspektime të bankave dhe institucioneve të tjera financiare është përcaktuar në paragrafin 2 të nenit 23 të ligjit për BQK-në. Dispozita të ngjashme që përforcojnë autorizimin e BQK-së për inspektime në terren janë dhënë në Ligjin për Bankat, IMF-të dhe IFJB-të (neni 57 dhe 114) dhe Ligji për Sigurime (neni 83). Autoriteti i NjIF-it për të kryer inspektime të bankave dhe institucioneve të tjera financiare është përcaktuar në nenin 35 të Ligjit për PPP/LFT-në. Çështja e pasigurisë në kuptim të gjuhës shpjeguese juridike që përcakton funksionet mbikëqyrëse të NjIF-it dhe BQK-së, përfshirë atë për inspektimet në terren, siç përcaktohet në analizën për kriterin 26.1, është e rëndësishme edhe për qëllimet e kriterit 27.2.

426. **Kriteri 27.3** (*Pjesërisht i përmbushur*) – Sipas nenit 37 të Ligjit për PPP/LFT-në, për qëllime të monitorimit dhe mbikëqyrjes nga distanca të subjekteve raportuese për vlerësimin e pajtueshmërisë me kërkesat e zbatueshme për PPP/LFT-në, NjIF-i dhe BQK-ja mund, përmes një njoftimi me shkrim të dërguar subjektit raportues, të kërkojnë që subjekti raportues të paraqesë, brenda kohës dhe në mënyrën e specifikuar në atë njoftim, çfarëdo dokumentacioni, përfshirë ato të lidhura me procedurat e brendshme të subjektit raportues, dhe dispozitat e paragrafëve 3, 4 dhe 5 të nenit 35 zbatohen në përputhje me situatën.

427. Paragrafët 3-5 të nenit 35, ndërsa përcaktojnë se personat e inspektuar duhet t'u ofrojnë zyrtarëve të autorizuar të gjithë ndihmën e arsyeshme për t'iu mundësuar atyre të kryejnë përgjegjësitë e tyre, gjithashtu parashohin që ata mund të refuzojnë qasjen në lokalet ose dokumentet nëse nuk e vlerësojnë të duhur për të përcaktuar nëse detyrimet për PPP/LFT-

⁸² Titulli i nenit 36 të Ligjit për PPP/LFT-në është "Inspektimi i pajtueshmërisë në vend nga BQK-ja dhe mbikëqyrësit e tjerë sektorialë".

⁸³ Siç tregohet në analizën për kriterin 26.1, kjo duket të jetë disi në kundërshtim me dispozitën e paragrafit 1 të nenit 36 të Ligjit për PPP/LFT-në që përcakton se BQK-ja zbaton kompetencat e saj të mbikëqyrjes së kujdesit me përjashtim të kompetencës për mbikëqyrje të pajtueshmërisë me nenin 26 (Raportimi të NjIF-i) të Ligjit për PPP/LFT-në, për të cilin NjIF-i ka kompetencë ekskluzive mbikëqyrëse.

në janë përmbushur sipas ligjit ose kur informatat i nënshtrohen privilegjit avokat-klient. Në raste të tilla, paraqitja e informacionit përkatës bëhet e detyrueshme nga vendimi i gjyqtarit të procedurës paraprake të gjykatës kompetente. Ky mekanizëm nuk parasheh pajtueshmërinë me kriterin 27.3 që kërkon që kompetenca e mbikëqyrësit për të detyruar shpалosjen ose për të pasur qasje në ndonjë informacion për qëllime mbikëqyrëse nuk duhet të bazohet në nevojën për të kërkuar një urdhër të gjykatës.

428. **Kriteri 27.4** (*Kryesisht i përmbushur*) – Paragrafi 7 i nenit 34 të Ligjit për PPP/LFT-në përcakton që, pas mbikëqyrjes së pajtueshmërisë, NjIF-i, BQK-ja dhe mbikëqyrësit e tjerë sektorialë, ashtu siç përcaktohet në këtë ligj, mund të rekomandojnë masa përmirësuese, shqiptojnë sanksione administrative apo procedojnë çështjen në procedurë penale. Ekzistojnë sanksione disiplinore dhe financiare për mosplotësimin e kërkesave të PPP/LFT-së, përfshirë kompetencën për të hequr (revokuar) – por jo për të kufizuar ose pezulluar – licencën e institucionit financiar, janë në dispozicion siç është përcaktuar në analizën për Rekomandimin 35.

Vlerësimi dhe përfundimi

429. Faktet dhe rrethanat në vijim janë konsideruar se përcaktojnë vlerësimin për Rekomandimin 27:

- Çështja e pasigurisë në kuptim të gjuhës shpjeguese juridike që përcakton funksionet mbikëqyrëse të NjIF-it dhe BQK-së, përfshirë atë për inspektimet në terren, është gjithashtu e rëndësishme në aspektin e pajtueshmërisë me Rekomandimin 27 (kriteri 27.2);
- Mekanizmi për zbatimin e kompetencës së mbikëqyrësit për të detyruar shpалosjen ose për të pasur qasje në çdo informacion të rëndësishëm për monitorimin e përmbushjes së kërkesave të PPP/LFT-së duket se bazohet në nevojën për të kërkuar një urdhër të gjykatës (kriteri 27.3); dhe
- Mbikëqyrësi ka të drejtën të heqë (revokojë) – por jo të kufizojë ose pezullojë – licencën e institucionit financiar për mosplotësimin e kërkesave të PPP/LFT-së (kriteri 27.4).

430. **Kosova është pjesërisht në përputhje me Rekomandimin 27.**

Rekomandimi 28 – Rregullimi dhe mbikëqyrja e BPCJF-ve

431. Në Raportin e Vlerësimit për PPP/LFT-në të vitit 2014, Kosova u vlerësua në mospërputhje me Rekomandimin e mëparshëm 24 të FATF-së. Vlerësimi identifikoi mangësi teknike lidhur me: mungesën e përkufizimit të asaj se çka përbën aksionar “të rëndësishëm”; mospërputhjen e nivelit të zotërimit të aksioneve për identifikimin e zyrtarëve, drejtorëve dhe aksionarëve të kompanive private dhe të kuotura; mungesën e kompetencave ligjore të NjIF-it për të zbatuar qasje mbikëqyrëse të bazuar në rrezik; mungesën e autoritetit mbikëqyrës të caktuar për ndërmarrjet e ndërtimit si subjekte raportuese sipas Ligjit për PPP/LFT-në; mungesën e një sërë sanksionesh që duhen zbatuar në përpjesëtim me peshën e një vepre penale; mungesën e kompetencave të duhura të zbatimit dhe shqiptimit të sanksioneve ndaj drejtorëve apo drejtuesve të lartë të BPCJF-ve për mospërmbushjen e pajtueshmërisë sipas dispozitave të Ligjit për PPP/LFT-në; paqartësinë juridike mbi kompetencat e përgjithshme të NjIF-it për të ndërmarrë inspektime të pakushtëzuara në terren; dhe, mungesën e kompetencës së NjIF-it për të ndërmarrë inspektime në distancë.

Kazinotë

432. Neni 3 i ligjit për Lojërat e Fatit i përkufizon lojërat e fatit si “çdo lojë të luajtur fizikisht me letra, zare, pajisje ose makinë për para, pasuri, çeqe, kredi ose ndonjë përfaqësues tjetër të vlerës”, përfshirë lojërat: ruletë, keno, bingo, black jack, poker, bakarat, pay go, automatët e lojërave automatike dhe bingo me tombola në mjedise të mbyllura. Në të njëjtën kohë, ai ndalon “lojërat elektronike, lojërat online nëpërmjet internetit, hipodromët dhe lojërat e korrespondencës të vendosura në progresion gjeometrik, me korrespondencë dhe me pagesa të shumave të caktuara, të gjitha lojërat të quajtura piramidale” dhe të gjitha lojërat tjera të cilat nuk janë lojëra fati siç përcaktohet me ligj.

433. **Kriteri 28.1** (*Kryesisht i përmbushur*) – Kazinotë, përfshirë kazinotë në internet dhe objekte të licencuara të lojërave të fatit⁸⁴ janë përcaktuar si subjekte raportuese në paragrafin 1.3 të nenit 16 të Ligjit për PPP/LFT-në. Nenet 34, 35 dhe 37 të Ligjit për PPP/LFT-në përcaktojnë funksionin e NjIF-it dhe mbikëqyrësve sektorialë për mbikëqyrjen sipas Ligjit për PPP/LFT-në për këtë kategori të subjekteve raportuese. Neni 4 i ligjit për Lojërat e Fatit përcakton Administratën Tatimore të Kosovës (ATK) si autoritet rregullator të autorizuar, ndër të tjera, për licencimin e lojërave të fatit.
434. *Licencimi* – Sipas nenit 25 të ligjit për Lojërat e fatit, ATK-ja lëshon licencat për kazino, për prodhuesin/shpërndarësin e automatëve për lojëra fati, për operatorët e automatëve, për pikat me pakicë të automatëve për lojëra fati, për pikat e basteve sportive, dhe për tombola bingo në lokale të mbyllura. Neni 30 i ligjit thekson se është e kundërligjshme nëse një person, pa siguruar më parë licencat dhe lejet e kërkuara sipas ligjeve në fuqi, ofron ose zbaton ndonjë aktivitet të lidhur me ndonjë lojë fati, ose lojëra të tjera të ngjashme.
435. *Hyrja në treg* – Sipas neneve 32 dhe 33 të ligjit për Lojërat e Fatit, aplikantët për licencë duhet të plotësojnë disa kriteret të përshtatshëm duke dëshmuar që, ndër të tjera, nuk janë dënuar për një vepër penale të dënueshme më shumë se 6 (gjashtë) muaj në Kosovë apo në ndonjë vend tjetër, nuk kanë kryer ndonjë veprim të papërshtatshëm ose të paligjshëm gjatë menaxhimit të lojërave të fatit, kanë ndershmërinë e përshtatshme për biznesin, kompetencën dhe përvojën në lojëra të fatit dhe do të financojnë biznesin e propozuar nga një burim legal dhe i përshtatshëm. Këto kriteret zbatohen për të gjithë personat e licencuar, të gjithë zyrtarët, drejtorët dhe aksionarët me 5% interes në kompanitë private ose 10% interes ose kontroll mbi kompanitë publike, të gjithë personat të cilët ofrojnë financim ose kanë një kontratë ose ndonjë marrëveshje tjetër financiare ose biznesi me personin e licencuar.
436. Neni 10 i Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Financave nr. 3/2013 përcakton më tutje që ATK-ja "mund të kërkojë informata mbi përshtatshmërinë e cilitdo person i cili i siguron fonde, pasuri të paluajtshme, prona personale, furnizime ose shërbime një subjekti të licencuar të lojërave të fatit". Kjo dispozitë, ndërsa përshkruan fushëveprimin e personave që mund të ushtrojnë një lloj kontrolli mbi – dhe kështu të veprojnë si pronarë përfitues të – lojërave të fatit, vazhdon të mos e ketë elementin e përcaktuar në kriterin 28.1(b) përderisa nuk ofron një gjuhë të qartë për të parandaluar bashkëpunëtorët e kriminelëve që të hyjnë në tregun e lojërave të fatit si zotërues (ose pronarë përfitues) me një pjesëmarrje të konsiderueshme ose kontrolluese.
437. *Mbikëqyrja e pajtueshmërisë* – Sipas paragrafit 3 të nenit 34 të Ligjit për PPP/LFT-në, NjIF-i, BQK-ja dhe mbikëqyrësit e tjerë sektorialë kryejnë mbikëqyrjen e pajtueshmërisë me dispozitat e ligjit gjatë ushtrimit të kompetencave të tyre në pajtim me këtë ligj dhe ligjet e tjera përkatëse. Paragrafi 5 i të njëjtit nen thekson se NjIF-i hyn në marrëveshje specifike individuale me shkrim me mbikëqyrësit e tjerë sektorialë me qëllim të krijimit të kompetencave mbikëqyrëse dhe përgjegjësi, procedurave dhe bashkëpunimit përkatës. ATK-ja siguron mbikëqyrjen e kazinove nëpërmjet Divizionit të Lojërave të Fatit.

BPCJF-të përveç kazinove

438. **Kriteri 28.2** (*Kryesisht i përmbushur*) – NjIF-i është autoriteti i caktuar kompetent përgjegjës për monitorimin dhe sigurimin e pajtueshmërisë së BPCJF-ve me kërkesat për PPP/LFT-në. Siç përshkruhet në analizën për kriteret 26.1 dhe 28.1, përgjegjësia e tillë ndahet me mbikëqyrësit e tjerë sektorialë në bazë të marrëveshjeve individuale të veçanta me shkrim me ta. Për këtë qëllim, autoritetet i referohen Agjencisë së Metrologjisë së Kosovës (siç përcaktohet në Ligjin për Punimet nga Metalet e Çmuara), Odës së Noterëve (siç përcaktohet në Ligjin për Noterinë), Odës së Avokatëve (siç përcaktohet në Ligjin për Avokatinë) dhe Këshillit të Kosovës për Raportimin Financiar (siç përcaktohet në Ligjin për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim) për monitorimin dhe sigurimin e pajtueshmërisë së PPP/LFT-së nga shitësit të metaleve të çmuara dhe gurëve të çmuar, noterët, avokatët, auditorët dhe kontabilistët. Megjithatë, ekipit të vlerësimit nuk i është dhënë referimi në dispozitat në ligjet sektoriale në fuqi që parashohin funksionin e agjencive përkatëse në mënyrë specifike në lidhje me monitorimin e pajtueshmërisë për PPP/LFT-në.

⁸⁴ Paragrafi 1.22 i nenit 3 të ligjit për Lojërat e Fatit përcakton si lojëra të fatit "çdo lojë të luajtur fizikisht me letra, zare, pajisje ose makinë për para, pasuri, çeqe, kredi ose ndonjë përfaqësues tjetër të vlerës".

439. **Kriteri 28.3** (*Pjesërisht i përmbushur*) – Sistemi për monitorimin e pajtueshmërisë me PPP/LFT-në të kategorive të tjera të BPCJF-ve përbëhet nga NjIF-i dhe mbikëqyrësit sektorialë që ndajnë përgjegjësinë mbikëqyrëse me NjIF-in. Një sistem i tillë nuk është plotësisht funksional për shkak të mungesës së marrëveshjeve specifike me shkrim në mes të NjIF-it dhe mbikëqyrësve sektorialë siç përshkruhet në analizën për kriterin 28.2.
440. **Kriteri 28.4** (*Pjesërisht i përmbushur*) – Dispozitat e mëposhtme parashohin rregullimin dhe funksionet e zbatimit të NjIF-it dhe mbikëqyrësve sektorialë:
441. *Kompetencat mbikëqyrëse* – Nenet 34, 35 dhe 37 të Ligjit për PPP/LFT-në përcaktojnë funksionin e NjIF-it dhe mbikëqyrësve sektorialë për mbikëqyrjen e BPCJF-ve sipas Ligjit për PPP/LFT-në. Megjithatë, ekipit të vlerësimit nuk i është dhënë referimi në dispozitat e ligjeve sektoriale në fuqi që parashohin kompetencat e agjencive përkatëse në mënyrë specifike në lidhje me monitorimin e pajtueshmërisë sipas PPP/LFT-së.
442. *Hyrja në treg* – Ekipit të vlerësimit nuk iu referuan dispozita në legjislacionin në fuqi që parashikojnë autorizimin e autoriteteve kompetente për të marrë masat e nevojshme për të parandaluar që kriminelët ose bashkëpunëtorët e tyre të jenë të akredituar në mënyrë profesionale, apo të zotërojnë (ose të jenë pronarë përfitues me) pjesëmarrje të konsiderueshme ose kontrolluese, apo të mbajnë funksione drejtuese në BPCJF përveç lojërave të fatit.
443. *Sanksionet e zbatueshme* – Sanksionet disiplinore dhe financiare për mosplotësimin e kërkesave të PPP/LFT-së janë të zbatueshme siç janë përcaktuar në analizën për Rekomandimin 35.
444. **Kriteri 28.5** (*Pjesërisht i përmbushur*) – Paragrafi 6 i nenit 34 të Ligjit për PPP/LFT-në thekson se mbikëqyrësit sektorialë marrin parasysh rrezikun e pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit në sektorin e veprimtarisë së subjektit raportues përkatës. Kjo dispozitë nuk kërkon që NjIF-i, në cilësinë e agjencisë kryesore përgjegjëse për pajtueshmërinë me PPP/LFT-në të BPCJF-ve, të përdorë qasjen e bazuar në rrezik në mbikëqyrje. Autoritetet u referohen Procedurave Standarde të Operimit për Mbikëqyrjen e Pajtueshmërisë së NjIF-it (të nxjerrë në vitin 2017) me qëllim që të sigurojnë përputhshmërinë me kërkesat e kriterit 28.5, veçanërisht: a) Kapitujt 2, 4, 7 dhe 9 që përkufizojnë përcaktimin e rrezikut, shpeshësinë dhe intensitetin e mbikëqyrjes për PPP/LFT-në; b) Kapitullin 2 që parashihet analizën e rrezikut e cila përbëhet prej katër hapave, duke përfshirë: 1) mbledhjen e informatave për identifikimin e rrezikut të PP/FT-së; 2) identifikimin dhe vlerësimin e rrezikut; 3) veprimet zbutëse bazuar në vlerësimin e rrezikut të PP/FT-së; dhe 4) monitorimin e veprimeve vijuese, renditjen dhe përzgjedhjen të bazuar në rrezik, analizat dalluese dhe mbikëqyrjen e bazuar në rotacion.
445. Në përgjithësi, informacioni i vënë në dispozicion të vlerësuesve nuk mundëson një përfundim nëse mbikëqyrja e BPCJF-ve kryhet duke: a) përcaktuar shpeshësinë dhe intensitetin e saj në bazë të kuptimit të BPCJF-ve të rreziqeve të PP/FT-së, duke marrë parasysh karakteristikat e BPCJF-ve, në veçanti diversitetin dhe numrin e tyre; dhe b) duke marrë parasysh profilin e rrezikut të PP/FT-së të këtyre BPCJF-ve dhe shkallën e lirisë së veprimit të lejuar ndaj tyre sipas qasjes së bazuar në rrezik, kur vlerësohet përshtatshmëria e kontrolleve të brendshme, politikave dhe procedurave të PPP/LFT-së për BPCJF-të.

Vlerësimi dhe përfundimi

446. Faktet dhe rrethanat në vijim janë konsideruar se përcaktojnë vlerësimin për Rekomandimin 28:
- Ka mungesë të gjuhës së qartë për të parandaluar që bashkëpunëtorët e kriminelëve të hyjnë në tregun e lojërave të fatit si zotërues (ose pronarë përfitues) me një pjesëmarrje të konsiderueshme ose kontrolluese (kriteri 28.1(b));
 - Në mungesë të marrëveshjeve të veçanta me shkrim në mes të NjIF-it dhe mbikëqyrësve sektorialë, ligjet e zbatueshme sektoriale nuk parashohin funksionin e agjencive përkatëse mbikëqyrëse për monitorimin dhe sigurimin e pajtueshmërisë së BPCJF-ve me kërkesat për PPP/LFT-në (kriteri 28.2);
 - Sistemi për monitorimin e përmbushjes së kërkesave të PPP/LFT-së nuk është plotësisht funksional për shkak të mungesës së marrëveshjeve specifike me shkrim në mes të NjIF-it dhe mbikëqyrësve sektorialë (kriteri 28.3);
 - Në mungesë të marrëveshjeve të veçanta me shkrim në mes të NjIF-it dhe mbikëqyrësve sektorialë, ligjet e zbatueshme sektoriale nuk parashohin kompetencat e

agjencie përkatëse mbikëqyrëse për kryerjen e funksioneve të tyre të monitorimit dhe sigurimit të pajtueshmërisë me kërkesat për PPP/LFT-në (kriteri 28.4(a));

- Nuk ka dispozita në legjislacionin në fuqi që parashikojnë autorizimin e autoriteteve kompetente për të marrë masat e nevojshme për të parandaluar që kriminelët ose bashkëpunëtorët e tyre të jenë të akredituar në mënyrë profesionale, apo të zotërojnë (ose të jenë pronarë përfitues me) pjesëmarrje të konsiderueshme ose kontrolluese, apo të mbajnë funksione drejtuese në BPCJF përveç lojërave të fatit (kriteri 28.4(b)); dhe
- Informacioni i vënë në dispozicion të vlerësuesve nuk mundëson një përfundim nëse mbikëqyrja e BPCJF-ve kryhet duke: a) përcaktuar shpeshtësinë dhe intensitetin e saj në bazë të kuptimit të BPCJF-ve të rreziqeve të PP/FT-së, duke marrë parasysh karakteristikat e BPCJF-ve, në veçanti diversitetin dhe numrin e tyre; dhe b) duke marrë parasysh profilin e rrezikut të PP/FT-së të këtyre BPCJF-ve dhe shkallën e lirisë së veprimit të lejuar ndaj tyre sipas qasjes së bazuar në rrezik, kur vlerësohet përshtatshmëria e kontrolleve të brendshme, politikave dhe procedurave të PPP/LFT-së për BPCJF-të (kriteri 28.5).

447. **Kosova është pjesërisht në përputhje me Rekomandimin 28.**

Rekomandimi 29 – Njësia e Inteligjencës Financiare (NjIF)

448. Në Raportin e Vlerësimit për PPP/LFT-në të vitit 2014, Kosova u vlerësua se është pjesërisht në përputhje me Rekomandimin e mëparshëm 26. Një numër mangësish, disa prej tyre lidhur me efektivitetin, u identifikuan për të mbështetur vlerësimin, që ndërlidhen, ndër të tjera, me: mangësitë në fushën dhe mënyrën e qasjes së NjIF-it në baza të ndryshme të të dhënave; paqartësinë në kompetencat e NjIF-it për të kërkuar informata shtesë nga subjektet raportuese; nevojën për të miratuar parimet e Grupit Egmont për shkëmbimin ndërkombëtar të informacionit; mungesën e informatave kthyesë nga institucionet e zbatimit të ligjit për shpërndarjet e NjIF-it; mungesën e statistikave mbi rezultatet e informatave të shpërndara nga NjIF-i; informatat kthyesë dhe udhëzimet e pamjaftueshme specifike dhe strategjike për subjektet raportuese; dhe, kërkesat shtesë për informacione që sjellin një barrë të tepruar për NjIF-in dhe industrinë.

449. **Kriteri 29.1** (*I përmbushur*) – Sipas Ligjit për PPP/LFT-në (Ligji nr. 05/L-096 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit) NjIF-i, në kuadër të Ministrisë së Financave, është qendra kombëtare për marrjen dhe analizimin e raporteve të transaksioneve të dyshimta dhe informacioneve të tjera të rëndësishme për pastrimin e parave, veprat e ndërlidhura penale dhe financimin e terrorizmit. Veprat penale kryesore (të kuptuara si të gjitha veprat penale që ndërlidhen, jo disa prej tyre që kanë lidhje më të afërta) mbulohen përmes përcaktimit të aktit ose transaksionit të dyshimtë në nenin 2, paragrafi 1.2 të ligjit të përmendur. Shpërndarja e rezultateve të analizës për dyshimin e pastrimit të parave, veprave të ndërlidhura penale dhe për financimin e terrorizmit parashihet në nenin 15, paragrafi 2 të ligjit.

450. **Kriteri 29.2** (*Kryesisht i përmbushur*) – NjIF-i shërben si agjenci qendrore për marrjen e raporteve të paraqitura nga subjektet raportuese. Sipas nenit 26, subjekteve raportuese iu kërkohet të raportojnë të gjitha aktivitetet ose transaksionet e dyshimta brenda njëzetekatër (24) orëve nga koha kur aktiviteti ose transaksioni është identifikuar si i dyshimtë, të gjitha informatat shtesë të rëndësishme lidhur me transaksionet që janë siguruar nga subjektet raportuese pas raportit, si dhe informata të tjera të kërkuara nga NjIF-i (bazuar në kërkesë, bazuar në kërkesat e monitorimit etj.).

451. Përveç kësaj, NjIF-i është i autorizuar të marrë një gamë të gjerë informacionesh të mëtejshme, përfshirë informacionin e siguruar nga NjIF-e të shteteve të huaja, gjykatat ose autoritetet kompetente për zbatimin e Ligjit për PPP/LFT-në (përfshirë organizatat ndërqeveritare dhe ndërkombëtare në Kosovë), organet qeveritare ose publike, informacione të ofruara vullnetarisht për dyshime të PP/FT-së, transaksionet individuale prej 10.000 euro e më lart, deklaratat e pasurive të paluajtshme dhe informacionet për instrumentet monetare mbi pragun e caktuar të transportuara në kufi, personalisht ose me postë.

452. Raportimi i RTD-ve është (potencialisht) i kufizuar nga faktorët e cekur në Rekomandimin 20.

453. Pasi që neni 16 përfshin vetëm noterët dhe avokatët, nuk është e qartë nëse të gjithë profesionet juridike të pavarura janë të përfshira në fushëveprimin e Ligjit për PPP/LFT-në

dhe, për pasojë, u nënshtrohen kërkesave të raportimit. Subjektet/personat e përfshirë në tregtinë e metaleve dhe gurëve të çmuar janë të kufizuar të shitësit dhe tregtarët në përgjithësi nuk janë të përfshirë.

454. **Kriteri 29.3** (*Kryesisht i përmbushur*) – NjIF-i është e autorizuar sipas nenit 14, paragrafi 1.4 për të kërkuar dhe pranuar brenda afatit kohor të përcaktuar prej saj informacionin e kërkuar për të kryer funksionet e saj. Përveç kësaj, NjIF-i ka të drejtë të grumbullojë informata shtesë të rëndësishme lidhur me transaksionet e dyshimta të raportuara më parë sipas nenit 26, paragrafi 2. Kjo e fundit megjithatë është e kufizuar në një masë nga mungesa e një afati të saktë të përcaktuar për subjektet raportuese për sigurimin e një informacioni të tillë. Për më tepër, NjIF-i mund të sigurojë informata shtesë si rezultat i nxitjes së procedurës së monitorimit të llogarive ose marrëdhënieve të biznesit sipas paragrafit 1.12 të nenit 14. Sigurimi i informacionit nuk mund të kufizohet për arsye të fshehtësisë profesionale.
455. NjIF-i ka të drejtë, sipas nenit 14, paragrafi 1.5 të Ligjit për PPP/LFT-në, të kërkojë nga organet publike ose qeveritare të dhëna, dokumente dhe informata si dhe të ketë qasje në bazat e të dhënave të mbajtura nga këto organe. NjIF-i është gjithashtu e autorizuar për të mbledhur informacione nga burime të hapura dhe bazat e të dhënave komerciale. NjIF-i ka qasje të drejtpërdrejtë në një numër bazash të të dhënave, përfshirë gjendjen civile të popullsisë, bazën e të dhënave të regjistrimit të automjeteve, trungun familjar, eksportin/importin e mallrave dhe shërbimeve, deklarin e mjeteve monetare në pikat kufitare dhe mosdeklarimin e mjeteve monetare, certifikatat e regjistrimit të bizneseve dhe informacionet mbi pronarët, aksionarët, kapitalin fillestar dhe statusin e biznesit. Qasja e drejtpërdrejtë sigurohet gjithashtu në bazën e të dhënave të DRNOJQ-së dhe informata shtesë mund të merren përmes një kërkesë, edhe pse ka probleme me besueshmërinë e të dhënave. Qasja indirekte në informacion është në dispozicion me Policinë e Kosovës (PK) dhe me Autoritetin Tatimor të Kosovës (ATK). Kërkesa e specifikuar për organet publike dhe qeveritare për dhënien e informacionit "pa vonesë" nuk jep një detyrim të qartë dhe mund t'i nënshtrohet interpretimit.
456. Qasja publike është në dispozicion për bazat e të dhënave të një numri agjencish, më e rëndësishmja me Agjencinë e Privatizimit dhe Agjencinë kundër Korrupsionit.
457. **Kriteri 29.4** (*Kryesisht i përmbushur*) – NjIF-i ka të drejtë, në përputhje me nenet 14 dhe 15 të Ligjit për PPP/LFT-në, të kryejë analiza operative duke pranuar dhe analizuar raporte dhe informacione në lidhje me të ardhurat e krimit dhe financimin e terrorizmit si dhe mbledhjen e të gjitha informatave përkatëse që bien brenda kompetencave të NjIF-it dhe shpërndarjen e informacionit mbi transaksionet e dyshimta të veçanta dhe rezultatin e analizës në lidhje me dyshimin për pastrimin e parave, veprat e ndërlidhura penale dhe financimin e terrorizmit.
458. NjIF-i është e autorizuar, në bazë të nenit 14 të Ligjit për PPP/LFT-në, të kryejë analiza strategjike të informatave që i grumbullon dhe pranon, për parandalimin dhe luftimin e pastrimit të parave, veprave të ndërlidhura penale dhe financimit të terrorizmit. Kjo kuptohet se përfshin identifikimin e tendencave dhe modeleve të pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit. Për më tepër, sipas Ligjit për PPP/LFT-në kërkohet shkëmbimi i gjerë i informacionit në mënyrë që të përmbushen funksionet e mbikëqyrjes apo të analizohet efektiviteti përmes statistikave përkatëse, etj. Në të njëjtën kohë, nuk është e qartë nëse të gjitha informatat e duhura (jo vetëm të dhënat statistikore) që mund të merren nga autoritetet kompetente përfshihen në analizën strategjike, duke pasur parasysh se asnjë dispozitë specifike nuk përfshihet në Ligjin për PPP/LFT-në për sigurimin e informacionit nga autoritetet kompetente (p.sh. autoritetet mbikëqyrëse ose mbikëqyrësi i OJF-ve) për qëllimin konkret të identifikimit të trendeve. Prandaj, nuk është e qartë nëse mund të bëhet thirrje në kufizime të fshehtësisë profesionale për të penguar një bashkëpunim të tillë, meqenëse përjashtimi sipas nenit 63 i referohet në përgjithësi informacionit të shpalosur sipas Ligjit për PPP/LFT-në. Një shembull është Ligji për bankat i cili në nenin 80 parashikon zbulimin e informacionit të marrë nga BQK-ja në bazë të kushteve të fshehtësisë vetëm në pajtim me Ligjin për BQK-në.
459. **Kriteri 29.5** (*I përmbushur*) – NjIF-i është e autorizuar, sipas nenit 14, paragrafi 1.10 të Ligjit për PPP/LFT-në, të shpërndajë informacionin dhe rezultatin e analizave tek autoritetet përkatëse. Në të njëjtën kohë, vihet re se kërkesa e gjerë e nenit 15, paragrafi 1 për shpërndarjen e të gjitha autoritetet ose subjektet raportuese, nëse konsiderohet e nevojshme ose do të ndihmonte NjIF-in për kryerjen e funksioneve të saj (pa specifikë të mëtejshme), krijon dyshime të konsiderueshme nëse shpërndarja është e kufizuar tek

autoritetet përkatëse kompetente. Shpërndarja e informacionit bëhet duke përdorur kanale të dedikuara, të sigurta dhe të mbrojtura, përfshirë sistemin goAML dhe korrierët.

460. **Kriteri 29.6** (Kryesisht i përmbushur)

461. **Kriteri 29.6 (a) dhe (c)** – Ligji për PPP/LFT-në paraqet në nenin 14, paragrafi 2 kërkesat për ruajtjen e konfidencialitetit të informacionit dhe përdorimin e informacionit vetëm për qëllimet e Ligjit për PPP/LFT-në. Politikat e detajuara të TI-së janë miratuar. Rregullat për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar janë të zbatueshme për kategoritë e përcaktuara ligjërisht të informacionit të klasifikuar të pranuar, ruajtur dhe shpërndarë në pajtim me Ligjin nr. 03/L-178 për Klasifikimin e Informacioneve dhe Verifikimin e Sigurisë. NjIF-i zbaton rregulloret për Shpërndarjen dhe Transferimin e Informacionit të Klasifikuar, si dhe për Sigurinë Fizike të Informacionit. Qëllimi i këtyre rregulloreve është futja e një sistemi unik për shpërndarjen dhe transferimin e informacionit të klasifikuar për të gjitha institucionet publike (përfshirë NjIF-in) të Kosovës, si dhe për personat të cilëve iu bëhet verifikimi i sigurisë për të garantuar sigurinë fizike të tij. NjIF-i ka miratuar dhe zbatuar disa udhëzime administrative duke përfshirë procedurat standarde të operimit për procesin e punës me bazë në goAML dhe Procedurën Standarde të Operimit për Analizën dhe Procesin e Inteligjencës së NjIF-it – Analiza Strategjike dhe Operative, e cila përcakton rregullat për trajtimin e informacionit. Ligji për PPP/LFT-në paraqet garanci për sigurinë dhe konfidencialitetin e informacionit duke parashikuar sanksione penale në nenin 59 paragrafët 5 dhe 6 lidhur me veprimet e mëposhtme të kryera nga çdo zyrtar i NjIF-it:

- Raportimi me dashje i informacionit ose zbulimi i informacionit në pajtim me paragrafin 1 të nenit 15 të këtij ligji ose zbulimi i informacionit prokurorit publik apo një gjykate, duke e ditur se informacioni i tillë përmban falsitete, pasaktësi ose gabime të rëndësishme;
- Shkatërrimi ose largimi i çfarëdo të dhëne që duhet të mblidhet nga NjIF-i në pajtim me këtë ligj, ndryshe nga çfarë është paraparë me politikën e mbajtjes dhe të shkatërrimit të dokumenteve të krijuar nga NjIF-i;
- Zbulimi i çfarëdo informacioni të përshkruar në paragrafin 1 të nenit 15, ndryshe nga çfarë është paraparë me paragrafin 2 të nenit 15 të këtij ligji, përveç nëse autorizohet me shkrim nga Drejtori i NjIF-it.

462. Megjithatë, nuk është paraparë ndonjë procedurë specifike sa i përket p.sh. mbajtjes së dokumenteve dhe politikës së asgjësimit jashtë fushëveprimit të informacionit të klasifikuar.

463. **Kriteri 29.6 (b)** – Në bazë të Ligjit për Klasifikimin e Informacioneve dhe Verifikimin e Sigurisë, çdo punonjës duhet të certifikohet dhe të kalojë përmes verifikimit të sigurisë për nivelin "konfidencial" të sigurisë. I gjithë stafi profesional i NjIF-it ka leje të nevojshme të sigurisë. Stafi i NjIF-it ka marrë vendimin për nivelin "konfidencial" të sigurisë gjatë periudhës 02/2013 – 05/2013. Trajnimi përkatës u është ofruar stafit të NjIF-it nga AKI-ja.

464. **Kriteri 29.6 (c)** – Objektet e NjIF-it mbrohen dhe sigurohen. Policia e Kosovës ofron siguri 24/7, të gjithë vizitorët identifikohen kur hyjnë në mjediset e NjIF-it dhe shoqërohen. Objekti mbrohet me tel, një sistem alarmi dhe me sistemin CCTV (televizion me qark të mbyllur). Kontrolli elektronik i qasjes përdoret për mbrojtje nga hyrja e personave të paautorizuar në lokalet e NjIF-it. Me qëllim të sigurimit të lokaleve dhe stafit të NjIF-it, në vitin 2015 NjIF-i ka nxjerrë një rregullore nr. FIUAD 77/2015 për Detyrat dhe Përgjegjësitë e Zyrtarëve Policorë të caktuar për mbikëqyrjen e zyrave (lokalet e NjIF-it) dhe ofrimin e sigurisë fizike për NjIF-in. Për më tepër, në vitin 2010, NjIF-i ka nxjerrë një dokument "Detyrat dhe Përgjegjësitë e Policisë që ruan hyrjen e ndërtesës së QIF-së". Asnjë informacion nuk është dhënë në lidhje me procedurat e nevojshme të përzgjedhjes për stafin e NjIF-it.

465. Në lidhje me kërkesat e konfidencialitetit për zyrtarët ndërlidhës, ato rregullohen nga dokumentet e brendshme për caktimin e tyre. Megjithatë, nuk është e qartë nëse këto rregulla do të siguronin të njëjtin nivel të garancive të konfidencialitetit si ato që drejtpërdrejt zbatohen për stafin e NjIF-it (përfshirë të njëjtin nivel të fuqive sanksionuese për moszbatim).

466. **Kriteri 29.7** (I përmbushur) – Ligji për PPP/LFT-në parasheh garanci të duhura të pavarësisë dhe autonomisë operative të NjIF-it nëpërmjet buxhetit autonom dhe vendimeve të pavarura për përdorimin e tij (neni 4, paragrafi 2), propozimit të organizimit të brendshëm administrativ (neni 4, paragrafi 4), kritereve të prera dhe kërkesave të hollësishme për përzgjedhjen e drejtorit të NjIF-it (nenet 11 dhe 12) dhe kritereve të

rrepta për shkarkimin dhe pezullimin (neni 13). Bordi Mbikëqyrës i NjIF-it drejtohet nga Ministri i Financave dhe përbëhet nga zyrtarë të tjerë të nivelit të lartë, përfshirë Ministrin e Punëve të Brendshme, Kryeprokurorin e Kosovës, Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Kosovës, Drejtorin e Administratës Tatimore të Kosovës, Drejtorin e Përgjithshëm të Doganës së Kosovës dhe Guvernatorin e BQK-së.

467. **Kriteri 29.8** (I përmbushur) – NjIF-i plotëson kriterin 29.8 duke zbatuar parimet e Grupit Egmont (shih gjithashtu Rekomandimin 40) dhe duke u bërë anëtare e plotë e Grupit Egmont në vitin 2017.

Vlerësimi dhe përfundimi

468. Nuk ka kërkesa specifike në ligj ose në akt nënligjor për raportimin e informatave shtesë pas një RTD-je tashmë të paraqitur. Nuk ka afate të rrepta në ligj për pranimin e informacionit nga subjektet raportuese. Ekzistojnë disa çështje në lidhje me përzgjedhjen dhe verifikimin e stafit dhe zbatimin e rregullave të informacionit të klasifikuar.

469. **Kosova është kryesisht në përputhje me Rekomandimin 29.**

Rekomandimi 30 – Përgjegjësitë e autoriteteve të zbatimit të ligjit dhe të hetimit

470. Në Raportin e Vlerësimit për PPP/LFT-në të vitit 2014, Kosova u vlerësua në mospërputhje me Rekomandimin e mëparshëm 27. Mangësitë kryesore të identifikuar, të cilat ishin kryesisht të lidhura me efektivitetin, përfshinin: mungesën e statistikave të unifikuar, rritjen e ngarkesës së rasteve në Prokurorinë Speciale të Kosovës (PSRK) në lidhje me rastet e PP-së, mungesën e burimeve brenda PSRK-së dhe nivelet e ulëta të efektivitetit, faktin që Policia e Kosovës (PK) vetëm kohët e fundit ka filluar t'i japë NjIF-it informata kthyesë për rastet, mungesën e informatave kthyesë sistematike të ofruara nga prokurorët në PK dhe organe të tjera të zbatimit të ligjit mbi rezultatet e ndjekjes penale, rënien e madhe të numrit të rasteve të PP-së të raportuara nga PK-ja në PSRK në vitin 2012 (duke treguar efektivitetin në rënie të policisë në ndjekjen e PP-së), vetëdijesimin e pamjaftueshëm në PK lidhur me nevojën për të ndjekur në mënyrë proaktive të ardhurat kriminale kur kanë të bëjnë me krimin që sjell përfitim, vetëdijesimin e pamjaftueshëm në PSRK lidhur me nevojën për të ndjekur penalisht PP-në dhe mungesën e ndonjë kompetence të qartë për të shtyrë apo për të hequr dorë nga arrestimi për qëllime të mbledhjes së dëshmiave ose identifikimin e personave të tjerë të përfshirë.

471. **Kriteri 30.1** (I përmbushur) – Vepra e pastrimit të parave hetohet nga disa autoritete, ku shumica e hetimeve kryhen nga PK-ja. PK-ja ka dy struktura të ndara, të cilat janë të specializuara në hetimin e PP-së: Drejtoria për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit (DHKEK) dhe Divizioni kundër Krimin të Organizuar (DKO). DKO përfshin një Sektor të Integruar për Hetime Financiare (SIHF), i cili është përgjegjës për nisjen e hetimeve financiare paralele në veprat kryesore, si krimi i organizuar, trafikimi me qenie njerëzore, me narkotikë dhe armë, krimi kibernetik etj.

472. Neni 3 i Ligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit parasheh që veprat penale të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit janë kompetencë ekskluzive e Prokurorisë Speciale të Kosovës (PSRK), e themeluar me ligjin për Prokurorinë Speciale të Kosovës. Vepra të tjera penale janë në kompetencë të prokurorëve të shtetit siç përshkruhet në ligjin për Prokurorin e Shtetit dhe Kodin e Procedurës Penale të Kosovës.

473. Sipas nenit 3, paragrafi 3.5 të ligjit për Prokurorinë Speciale, PSRK-së i është dhënë autoriteti dhe përgjegjësia për të kryer funksionet e saj, duke përfshirë kompetencat dhe përgjegjësinë për të zhvilluar hetime dhe ndjekur penalisht krimet që janë në kompetencë të veçantë dhe plotësuese të PSRK-së, në të gjitha prokuroritë dhe gjykatat që veprojnë në Kosovë. Hetimet penale dhe krimet që mund të ndiqen janë të renditura në nenin 5. Këto përfshijnë, në mesin e krimeve të tjera, krimet e financimit të terrorizmit dhe pastrimit të parave.

474. Sipas nenit 70 të Kodit të Procedurës Penale, Policia e Kosovës ka për detyrë të hetojë nëse ekziston dyshimi i arsyeshëm se është kryer një vepër penale e ndjekur sipas detyrës zyrtare, pas pranimit të informacionit për një vepër të dyshuar penale. Kjo përfshin veprën penale të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, si dhe veprat penale të parapara në nenin 2 të Ligjit për PPP/LFT-në.

475. Siç është cekur në paragrafin 471, në kuadër të PK-së ekzistojnë dy struktura që hetojnë PP-në dhe veprat e ndërlidhura. Drejtoria kundër Terrorizmit e Policisë së Kosovës kryen hetime në fushën e financimit të terrorizmit (shih përshkrimin e detajuar në kuadër të RM 7 dhe RM 9 respektivisht). Njësitë e PK-së nuk kanë procedura operative specifike në lidhje me kryerjen e hetimeve financiare, megjithatë janë vendosur procedura standarde të operimit ndërinstitucionale për shënjestrimin e krimeve të rënda.
476. **Kriteri 30.2** (*Kryesisht i përmbushur*) – Ligji nuk përjashton kryerjen e hetimeve financiare paralele. Ai as nuk e kufizon atë në rastet kur vepra penale është kryer në Kosovë. Ekzistenca e njësive të specializuara të hetimit financiar në Policinë e Kosovës, në veçanti SIHF, konfirmon se ekziston korniza strukturore për hetimet financiare. Megjithatë, nuk janë vendosur procedura për hetimet financiare.
477. **Kriteri 30.3** (*Kryesisht i përmbushur*) – Edhe pse asnjë subjekt specifik nuk është caktuar posaçërisht si autoritet përgjegjës për identifikimin dhe gjurmimin e pasurisë së dyshuar që përbën të ardhura nga krimi, njësitë përkatëse të PK-së rregullisht e kryejnë këtë punë, zakonisht sipas kërkesës së departamenteve përkatëse që ndërmarrin hetime për veprën penale të ndërlidhur.
478. **Kriteri 30.4** (*I përmbushur*) – Dogana e Kosovës dhe Autoriteti Tatimor janë gjithashtu të autorizuar të kryejnë hetime financiare në Kosovë në lidhje me PP-në, në fushat e tyre përkatëse që kanë të bëjnë respektivisht me veprat e kontrabandës dhe veprat penale tatimore.
479. **Kriteri 30.5** (*Nuk aplikohet*) – Kompetencat hetuese të Agjencisë Kundër Korrupsionit nuk shtrihen në hetimin (ose pjesëmarrjen në të) të veprave të PP-së që rrjedhin nga korrupsioni.

Vlerësimi dhe përfundimi

480. Autoritetet e Kosovës duhet të vendosin procedura specifike për kryerjen e hetimeve financiare paralele, si dhe për gjurmimin e pasurisë.
481. **Kosova është kryesisht në përputhje me Rekomandimin 30.**

Rekomandimi 31 – Kompetencat e autoriteteve të zbatimit të ligjit dhe të hetimit

482. Në Raportin e Vlerësimit për PPP/LFT-në të vitit 2014, Kosova u vlerësua kryesisht në përputhje me Rekomandimin e mëparshëm 28. Mangësitë ishin kryesisht të natyrës së efektivitetit.
483. **Kriteri 31.1** (*I përmbushur*) – Neni 70, paragrafi 2 i Kodit të Procedurës Penale parasheh mbledhjen e të gjitha informatave për përdorim në procedurën penale. Ligji thekson se Policia e Kosovës heton veprat penale dhe ndërmerr të gjitha masat e nevojshme që të zbulojë vendndodhjen e kryerësit, të ndalojë kryerësin ose ndihmësin e tij nga fshehja ose arratisja, të zbulojë dhe të ruajë gjurmët dhe provat e tjera të veprës penale dhe sendet të cilat mund të shërbejnë si prova, dhe të mbledhë të gjitha informacionet të cilat mund të përdoren në procedurë penale. Kodi i Procedurës Penale parasheh kompetenca të zgjeruara për mbledhjen e informacioneve që mund të jenë të nevojshme për hetimin e veprës së mundshme penale.
484. **Kriteri 31.1(a)** – Kodi i Procedurës Penale parasheh kompetenca për Policinë e Kosovës për të kërkuar paraqitjen e dokumenteve.
485. **Kriteri 31.1(b)** – Kompetenca për të kontrolluar personat dhe lokalet përmbushet përmes nenit 70 të Kodit të Procedurës Penale, paragrafët 3.5 dhe 3.6.
486. **Kriteri 31.1(c)** – Kompetenca për të marrë në pyetje dhe siguruar deklaratat e dëshmitarëve përmbushet përmes nenit 70, paragrafi 3.10 dhe nenit 73 të Kodit të Procedurës Penale.
487. **Kriteri 31.1(d)** – Mundësia për sekuestrimin dhe sigurimin e provave përmbushet përmes dispozitave të nenit 112 të Kodit të Procedurës Penale.
488. **Kriteri 31.2** (*I përmbushur*) – Neni 88 i Kodit të Procedurës Penale parasheh mundësinë e shfrytëzimit të vëzhgimit të fshehtë fotografik ose me video dhe monitorimit të fshehtë të bisedave në vende publike. Regjistrimi i thirrjeve telefonike mund të urdhërohet kundër një

personi apo vendi të caktuar. Përkufizimi i hetimeve apo vëzhgimeve të fshehta rregullohet me nenin 87 të Kodit të Procedurës Penale. Prandaj, kriteri 31.2 është përmbushur.

489. **Kriteri 31.3** është vlerësuar si *kryesisht i përmbushur* mbi bazën e shpjegimeve të dhëna në paragrafët më poshtë.
490. **Kriteri 31.3(a)** – Megjithëse neni 87, paragrafi 1.12 i referohet “zbulimit të të dhënave financiare” si një mjet për vëzhgim ose hetim të fshehtë a teknik, nuk ka hollësi se si Policia është e autorizuar të kryejë veprime të tilla. Regjistri i llogarive që mbahet në BQK nuk ofron qasje për asnjë autoritet, përfshirë NjIF-in.
491. **Kriteri 31.3(b)** – Sipas neneve 87 dhe 88 të Kodit të Procedurës Penale, ligji parasheh mundësinë për të identifikuar pasuritë pa njoftim paraprak të pronarit si teknikë e fshehtë hetimi.
492. **Kriteri 31.4** (*I përmbushur*) – Neni 15 i Ligjit për PPP/LFT-në parasheh mundësinë që NjIF-i të ndajë informata me autoritetet kompetente gjatë kryerjes së hetimeve, edhe pse informacioni mund të përdoret vetëm për qëllime të inteligjencës dhe nuk mund të shfrytëzohet si provë para një gjykate. Paragrafi 1.3 i këtij neni i referohet çdo të dhëne që NjIF-i e konsideron si të nevojshme me qëllim të parandalimit dhe luftimit të PP-së, FT-së dhe veprave të ndërlidhura penale. Prandaj, kriteri është përmbushur.

Vlerësimi dhe përfundimi

493. Autoritetet e zbatimit të ligjit në Kosovë kanë kompetencat e nevojshme për të ndërmarrë hetime të PP-së dhe FT-së, megjithatë nuk ka mekanizma në dispozicion për të identifikuar kontrollin e llogarive.
494. **Kosova është kryesisht në përputhje me Rekomandimin 31.**

Rekomandimi 32 – Korrierët e parave të gatshme

495. Në Raportin e Vlerësimit për PPP/LFT-në të vitit 2014, Kosova u vlerësua kryesisht në përputhje me Rekomandimin e mëparshëm të Posaçëm IX. Mangësitë ishin të lidhura me mungesën e rregullave për ruajtjen e të dhënave në doganë në lidhje me informacionin mbi deklaratat/deklaratat e rreme dhe dyshimet e PP/FT-së dhe mungesën e informatave kthyesë të strukturuar nga prokurorët në doganë.
496. **Kriteri 32.1** (*I përmbushur*) – Kosova ka zbatuar një sistem deklarimi në pajtim me nenin 33 të Ligjit për PPP/LFT-në. Përkufizimi i nenit 2, paragrafi 1.17 për instrumentet monetare për t’u deklaruar është mjaft i gjerë për të përfshirë të gjitha instrumentet e kërkuara sipas përkufizimit të fjalorit në Rekomandimet e FATF-së. Regjimi i deklarimit zbatohet për çdo person që hyn ose del nga Kosova, si dhe për çdo person që dërgon ose pranon instrumente monetare nëpërmjet postës, ngarkesave të mallrave ose korrierëve tregtarë. Pragu është vendosur në 10.000 euro apo më shumë. Format e nevojshme në lidhje me zbatimin e nenit 33 janë miratuar me Udhëzimin e Brendshëm nr. 34/2016 të Ministrisë së Financave të Kosovës. Liria e veprimit e caktuar lejohet në lidhje me mundësinë për të plotësuar informacionin e kërkuar në dokumentacionin ndërkombëtar të mallrave në rastin e paragrafit 2 të nenit 33 (transport me postë, ngarkesa mallrash ose korrierë tregtarë).
497. **Kriteri 32.2** (*I përmbushur*) – Dispozitat e lartpërmendura të Ligjit për PPP/LFT-në kërkojnë deklaratë me shkrim për instrumentet monetare dhe burimin e tyre të verifikueshëm kur shuma është 10.000 euro ose më shumë ose vlera e barasvlershme e tyre në valutë të huaj dhe detyrimi nuk konsiderohet i përmbushur nëse informacioni është i pasaktë apo i paplotë.
498. **Kriteri 32.3** – (*Nuk aplikohet*).
499. **Kriteri 32.4** (*Kryesisht i përmbushur*) – Zyrtarët doganorë kanë kompetenca sipas nenit 33, paragrafi 14 të Ligjit për PPP/LFT-në për të marrë në pyetje dhe kontrolluar personat fizikë, bagazhet dhe mjetet e tyre të transportit dhe mund të sekuestrojnë dhe mbajnë instrumentet monetare në përputhje me dispozitat e të njëjtit nen të Ligjit për PPP/LFT-në. Kjo duhet të interpretohet në lidhje me nenin 33, paragrafët 3, 13, 15 dhe 17 që kërkojnë verifikimin e burimit të fondeve si dhe informimin e autoriteteve përkatëse (prokuroria dhe NjIF-i), kur ekziston dyshimi i arsyeshëm se instrumentet e tilla monetare janë të ardhura nga krimi, ose janë përdorur ose kanë pasur për qëllim të përdoren për të kryer ose për të lehtësuar pastrimin e parave, veprën e ndërlidhur penale nga e cila kanë rrjedhur të

ardhurat nga krimi ose janë të lidhura me financimin e terrorizmit. Këto kërkesa, megjithëse nuk janë përmendur në mënyrë të qartë, kuptohen si përfshirje *de jure* e informacioneve edhe për instrumentet monetare të bartura në emër të personave të tretë dhe personave juridikë.

500. Nuk është e qartë nëse informacionet mund të sigurohen në pajtim me dispozitën e përmendur në Ligjin për PPP/LFT-në nga posta, transportuesi i ngarkesës ose korrieri tregtar (lidhur me paragrafin 2 të nenit 33) dhe të cilët do të jenë të detyruar të japin informacion në këtë rast nëse informacioni është p.sh. i paplotë.
501. **Kriteri 32.5** (*Kryesisht i përmbushur*) – Personat që nuk përmbushin detyrimin sipas paragrafëve 1 dhe 2 të nenit 33 të Ligjit për PPP/LFT-në i nënshtrohen sanksionit financiar (gjobë për kundërvajtje) në pajtim me nenin 33, paragrafi 5 që përbën 25% të shumës së përgjithshme që duhet të deklarohet. Kjo gjithashtu do të zbatohet në rastin e një deklarate të paplotë ose të pasaktë, përfshirë gjithashtu burimin e verifikueshëm të instrumenteve monetare. Ky sanksion nuk paragjykon procedurat penale kundër personit që kryen shkeljen. Ndëshkimi financiar është menjëherë i pagueshëm ose përndryshe instrumentet monetare mund të jenë subjekt i sekuestrimit. Sekuestrimi zbatohet gjithashtu në rastin e dyshimit, deklarimit të pasaktë ose të paplotë sipas paragrafit 15.2 të të njëjtit nen ku vijimi i procedurës është i lidhur me vendimet e prokurorisë sipas paragrafit 19.
502. Ky sanksion nuk paragjykon procedurat penale kundër personit që kryen shkeljen. Asnjë informacion nuk është dhënë nga autoritetet e Kosovës mbi zbatueshmërinë e sanksioneve penale (p.sh. për kontrabandim) në lidhje me paratë e padeklaruar, përveç dyshimit për PP/FT ose të ardhura nga krimi.
503. Në të njëjtën kohë, zbatimi i paragrafit 20 ngre shqetësime në lidhje me efektin zhbindës të sanksioneve duke konsideruar se të gjitha instrumentet monetare të konfiskuara sipas nenit 33, paragrafi 15 (që i referohet sekuestrimit edhe për deklarata të paplota ose të pasakta) duhet t'i kthehen personit në hipotezën e nenit 33, paragrafi 19.3, kur Prokurori informon me shkrim personin në fjalë, Doganën e Kosovës dhe NjIF-in se nuk do të ndërmerren veprime në lidhje me pasurinë e sekuestruar dhe se personi në fjalë mund të kërkojë kthimin e instrumenteve monetare. Kjo procedurë krijon paqartësi juridike në lidhje me zbatueshmërinë e sanksionit financiar në secilin rast të shkeljes së paragrafëve 1 dhe 2 të nenit 33.
504. **Kriteri 32.6** (*I përmbushur*) – Dogana është e detyruar t'i dorëzojë NjIF-it, sipas nenit 33, paragrafi 4, kopjet e të gjitha deklaratave të regjistruara në pajtim me paragrafët 1 dhe 2 dhe të njoftojë NjIF-in për të gjitha deklaratat e pasakta ose të paplota. Informacioni i deklaratës ofrohet në kohë reale në formë elektronike dhe informacioni mbi instrumentet monetare të paregjistruara, përfshirë hollësitë e të dhënave personale të kryesit, shumën e instrumenteve monetare të paregjistruara, shumën e sekuestruar, etj. përmes një platforme online. Përveç kësaj, Dogana e Kosovës detyrohet të zbatojë masat për parandalimin e PP/FT-së, përfshirë përmes paraqitjes së RTD-ve të NjIF-i (paragrafi 13 i nenit 33).
505. **Kriteri 32.7** (*Kryesisht i përmbushur*) – Kosova ka krijuar një mekanizëm të institucionalizuar për bashkëpunimin e të gjitha autoriteteve përkatëse përmes Ligjit për Bashkëpunim ndërmjet Agjencive nr. 04/L-216. Ky akt juridik paraqet themelet e sistemit të Menaxhimit të Integruar të Kufirit që përfshin të gjitha autoritetet kompetente të drejtpërdrejta për menaxhimin e kufirit dhe siguron mekanizma për analizën e rrezikut e kërcënimeve dhe inteligjencën e përbashkët, operacionet e përbashkëta, hetimet e përbashkëta, ndihmën teknike dhe profesionale, arsimin dhe trajnimin.
506. Ky bashkëpunim bazohet gjithashtu në një marrëveshje mirëkuptimi të nënshkruar në vitin 2014, si dhe në procedurat standarde zyrtare të operimit.
507. Ligji për PPP/LFT-në gjithashtu parasheh një mekanizëm të detajuar dhe të qartë për bashkëpunimin në lidhje me arritjen e objektivave specifike të kontrollit të parasë së gatshme në kuadër të Rekomandimit 32.
508. Asnjë informacion nuk është ofruar në lidhje me kontrollin mbi lëvizjen potenciale të fondeve që lidhen me personat e përcaktuar sipas Rezolutave të KS të OKB-së, veçanërisht në mungesë të një kornize ligjore të përshtatshme për zbatimin e sanksioneve.
509. **Kriteri 32.8** (*Kryesisht i përmbushur*) – Neni 33, paragrafët 15-23 parashikojnë procedurën lidhur me, nga njëra anë (paragrafi 15.1), ndalimin e instrumenteve monetare

që janë objekt i shkeljes së kërkesave të deklaramit sipas paragrafëve 1 dhe 2 dhe, nga ana tjetër (paragrafi 15.2), sekuestrimin e instrumenteve monetare në rast dyshimi ose në rast të deklaramit të paplotë ose të pasaktë dhe pamundësisë për të verifikuar burimin e këtyre fondeve. Këto procedura përfshijnë dhënien e informatave për NjIF-in dhe prokurorët, si dhe përcaktojnë veprime të mëtejshme që duhet të ndërmerren nga prokurorët në lidhje me fondet e sekuestruara. Fondet gjithashtu mund të sekuestrohen sipas paragrafit 7 nëse sanksioni financiar prej 25% për shkelje të kërkesës për deklarim nuk i paguhet menjëherë Doganës.

510. Nuk është e qartë se cilat janë pasojat për mbajtjen e instrumenteve monetare dhe çfarë procedure duhet të ndiqet në këtë drejtim. Për më tepër, në nenin 33 ende nuk ka asnjë kërkesë që prokuroria të ofrojë informata kthyesë për Doganën ose NjIF-in në lidhje me masat e mëtejshme të vendosura për kufizimin e instrumenteve monetare në rastet e paragrafit 19.1 dhe 19.2.
511. **Kriteri 32.9** (*Pjesërisht i përmbushur*) – Nuk është dhënë asnjë bazë juridike që autorizon Doganën të bashkëpunojë ndërkombëtarisht dhe të shkëmbejë informata përkatëse për këtë kriter dhe në lidhje me deklaratat, mosdeklarimet, deklaratat e pasakta ose të paplota dhe faktet e mëtejshme të vërtetuara.
512. Megjithatë, vihet re se Dogana e Kosovës mund të bashkëpunojë në bazë të marrëveshjeve të bashkëpunimit me Shqipërinë, Finlandën, Turqinë, Slloveninë, "ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë", Malin e Zi, Francën, Hungarinë dhe Austrinë dhe gjithashtu duke përdorur kanalën ILECU. Këto marrëveshje nuk mund të konsiderohen të mjaftueshme për shkak të rreziqeve që lidhen me paratë e gatshme dhe korrierët e tyre në Kosovë dhe rajon, si dhe rreziqet që lidhen me terrorizmin dhe financimin e terrorizmit, përfshirë luftëtarët e huaj terroristë (LHT). Asnjë informacion për ofrimin specifik të shkëmbimit të informacionit në bazë të këtyre marrëveshjeve nuk është paraqitur në kontekstin e këtij rekomandimi. Asnjë statistikë nuk është dhënë në lidhje me shkëmbimet aktuale që po kryhen.
513. Sidoqoftë, vihet re se NjIF-i, si anëtare e Grupit Egmont dhe marrëse e të gjitha informatave përkatëse nën mekanizmin e kontrollit të parasë së gatshme, do të ishte në gjendje të ofrojë gamën më të gjerë të ndihmës për autoritetet e huaja në bazë të këtij kriteri.
514. Parimet e përgjithshme të legjislacionit të Kosovës në lidhje me ndihmën e ndërsjellë juridike do të zbatoheshin në mungesë të ndonjë dispozite të mëtejshme specifike lidhur me kontrollin e parasë së gatshme.
515. Sa i përket bashkëpunimit dhe ndihmës ndërkombëtare në kuadër të fushëveprimit të Rekomandimit 36 me qëllim të kontrollit të parasë së gatshme, vërehet se shkëmbimi ndërkombëtar është i kufizuar nga pamundësia e zbatimit të kërkesës së kriterit 36.1 në rastin e Kosovës. Në të njëjtën kohë, bashkëpunimi ndërkombëtar gjithashtu mund të kufizohet për shkak të mangësive në kriminalizimin e PP-së dhe FT-së në përputhje me kërkesat e konventave përkatëse (siç është theksuar në rekomandimet përkatëse të FATF-së). Nuk ka asnjë informacion në lidhje me zbatimin e ndonjë prej kërkesave përkatëse të Konventës së Meridës.
516. Në lidhje me ruajtjen e të dhënave, janë vërejtur disa mangësi në raportin e mëparshëm të vlerësimit dhe nuk janë dhënë informata të mëtejshme për ruajtjen e të dhënave nga autoritetet e Kosovës (periudhat e ruajtjes, çështjet e mbrojtjes së të dhënave dhe kufizimet etj.). Për më tepër, nuk ka ende asnjë kërkesë në nenin 33 që prokuroria të ofrojë informata kthyesë për Doganën ose NjIF-in në lidhje me masat e mëtejshme të vendosura për kufizimin e instrumenteve monetare në rastet e paragrafit 19.1 dhe 19.2 të cilat mund të kufizojnë bashkëpunimin ndërkombëtar deri në njëfarë mase.
517. **Kriteri 32.10** (*Pjesërisht i përmbushur*) – Vërehet se rregullat e mbrojtjes së të dhënave personale do të zbatoheshin në pajtim me ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Rregullat e hollësishme për NjIF-in diskutohen në Rekomandimin 29.
518. Asnjë informacion mbi procedurat specifike të aplikuara nga Dogana për ruajtjen, mbrojtjen dhe përpunimin e informacionit nuk është ofruar nga autoritetet e Kosovës.
519. **Kriteri 32.11** (*Kryesisht i përmbushur*) – Sanksionet e parapara në dispozitat ligjore penale përkatëse për PP/FT-në ose veprat e ndërlidhura penale do të zbatoheshin në këtë rast (shih pjesët përkatëse të raportit). Ligji për PPP/LFT-në parasheh procedurat përkatëse në lidhje me paraqitjen e informacionit me qëllim të ndjekjes së hetimeve për PP/FT-në e mundshme apo veprën përkatëse të ndërlidhur penale, si dhe për masat që do të

mundësonin konfiskime. Mangësitë sipas Rekomandimit 4 do të zbatoheshin në këtë drejtim.

Vlerësimi dhe përfundimi

520. Disa kufizime janë të pranishme në lidhje me sigurimin e informacionit nga posta, transportuesi i ngarkesës ose korrieri tregtar. Një pasiguri mbetet në lidhje me zbatueshmërinë e sanksioneve financiare kur Prokuroria vendos që nuk do të ndërmerren veprime në lidhje me pasurinë e sekuestruar dhe se personi në fjalë mund të kërkojë kthimin e instrumenteve monetare. Bashkëpunimi ndërkombëtar do të ndikohej nga numri i kufizuar i marrëveshjeve të bashkëpunimit, disa mangësi në ruajtjen e të dhënave dhe zbatueshmëria e kufizuar e sanksioneve të shënjestruara për FT-në.

521. **Kosova është kryesisht në përputhje me Rekomandimin 32.**

Rekomandimi 33 – Statistikat

522. Në Raportin e Vlerësimit për PPP/LFT-në të vitit 2014, Kosova u vlerësua në mospërputhje me Rekomandimin e mëparshëm 32. Mangësitë lidheshin me: nevojën për bazë juridike për mbajtjen e statistikave të përshtatshme nga të gjitha autoritetet përkatëse dhe subjektet raportuese; nevojën për statistika kuptimplote për pasuritë e sekuestruara dhe të konfiskuara, mungesën e statistikave mbi rezultatet e shpërndarjeve të NjIF-it; mungesën e statistikave të njësuara për të gjykuar për efektivitetin e hetimeve dhe ndjekjeve penale të PP-së; nevojën për statistika më kuptimplote të mbajtura nga autoritetet mbikëqyrëse; mungesën e statistikave gjithëpërfshirëse për kërkesat e NNJ-së në lidhje me PP-në, veprat e ndërlidhura penale dhe FT-në; dhe mungesën e statistikave gjithëpërfshirëse për kërkesat e ILECU në lidhje me PP-në, veprat e ndërlidhura penale dhe FT-në.

523. **Kriteri 33.1** – Neni 39 (Të dhënat statistikore dhe informatat kthyesë) i Ligjit për PPP/LFT-në përcakton se NjIF-i, BQK-ja dhe mbikëqyrësit e tjerë sektorialë, autoritetet e tjera kompetente me përgjegjësi për luftimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, subjektet raportuese si dhe personat ose subjektet e tjera me detyrime ose funksione në pajtim me këtë ligj, duhet të mbajnë të dhëna statistikore gjithëpërfshirëse përkatëse në fushën e tyre të përgjegjësisë. Dogana e Kosovës thekson se sistemi i automatizuar i menaxhimit të rasteve i cili filloi të zbatohet në janar 2017 është një bazë të dhënash që përdoret nga zyrtarët e zbatimit të ligjit, por nuk është e qartë se çfarë informacioni statistikor mund të gjenerohet dhe të mbahet i rëndësishëm për PP/FT përveç mekanizmave të kërkuar të kontrollit të parasë së gatshme. Statistikat e mbajtura nga Departamenti për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Ministrinë e Drejtësisë nuk përmbajnë informacion mbi aktivitetet që lidhen me FT-në.

524. **Kriteri 33.1(a)** (*I përmbushur*) – Informacioni i duhur mbahet nga NjIF-i në këtë drejtim siç kërkohet nga Ligji për PPP/LFT-në si dhe Udhëzimi Administrativ nr. 001/2013 Përgatitja e Statistikave, Raporteve dhe Rekomandimeve lidhur me Pastrimin e Parave dhe Financimin e Terrorizmit.

525. **Kriteri 33.1 (b)** (*Pjesërisht i përmbushur*) – Përveç statistikave që mbahen nga autoritetet brenda kompetencave të tyre, informacioni i integruar statistikor i mbajtur në baza të rregullta është i mangët dhe nuk lejon vlerësim kuptimplotë të efektivitetit të hetimeve, ndjekjeve penale dhe dënimeve të PP/FT-së bazuar në performancën e të gjithë aktorëve (informacione për NjIF-in dhe informacione nga burimet e autoriteteve të zbatimit të ligjit, llojet e ndryshme të PP-së, personat e përfshirë, sanksionet e shqiptuara etj.).

526. **Kriteri 33.1(c)** (*Pjesërisht i përmbushur*) – Statistikat e mbajtura nga autoritetet e ndryshme nuk janë të integruara dhe prandaj nuk përfaqësojnë informata kuptimplota për funksionimin e sistemit si tërësi. Për më tepër, statistikat nuk mbulojnë të gjitha llojet dhe aspekte të ndryshme të nevojshme për të vlerësuar llojet e ndryshme të pasurisë së konfiskuar (p.sh. objekti, instrumentet e përdorura ose që synojnë të përdoren, konfiskimi i barabartë i vlerave etj.).

527. **Kriteri 33.1(d)** (*Pjesërisht i përmbushur*) – Statistikat e detajuara mbahen sipas Ligjit për PPP/LFT-në dhe demonstrohen p.sh. në raportet vjetore të NjIF-it, në lidhje me shkëmbimin ndërkombëtar të informacionit. Statistikat e detajuara në lidhje me kërkesat e NNJ-së mbahen edhe pse disa aspekte të rëndësishme për vlerësimin e efektivitetit nuk janë në dispozicion dhe nuk mbahen statistika të ndara për rastet e FT-së. Statistika të detajuara mbahen edhe në lidhje me bashkëpunimin e zbatimit të ligjit përmes ILECU, edhe

pse ato nuk mundësojnë vlerësim gjithëpërfshirës të bashkëpunimit në rastet e PP-së dhe FT-së. Nuk mbahen statistika nga mbikëqyrësit (përveç NjIF-it) në lidhje me çështjet e PPP/LFT-së dhe nga DK-ja e ATK-ja.

Vlerësimi dhe përfundimi

528. Statistikat e integruara nuk mbahen në një mënyrë për të mundësuar vlerësimin e efektivitetit të sistemit për PPP/LFT-në. Shumica e statistikave që kanë të bëjnë me bashkëpunimin ndërkombëtar, ndonëse të detajuara, nuk mundësojnë monitorimin dhe vlerësimin e çështjeve përkatëse të PPP/LFT-së.
529. **Kosova është pjesërisht në përputhje me Rekomandimin 33.**

Rekomandimi 34 – Udhëzimet dhe informatat kthyesë

530. Në Raportin e Vlerësimit për PPP/LFT-në të vitit 2014, Kosova u vlerësua se ishte pjesërisht në përputhje me Rekomandimin e mëparshëm 25 të FATF-së. Vlerësimi identifikoi mangësi teknike lidhur me: mungesën e një udhëzimi të përgjithshëm e gjithëpërfshirës për subjektet raportuese në përmbushjen e detyrimeve të tyre sipas Ligjit për PPP/LFT-në; mospërputhje në Ligjin për PPP/LFT-në që u kërkon të gjitha subjekteve raportuese të zhvillojnë listat e treguesve të transaksioneve të dyshimta; mospërputhje në Ligjin për PPP/LFT-në që kërkon nga NjIF-i që të japë udhëzime vetëm për “profesionistët në fjalë” dhe për kazinotë; mungesa e kompetencave juridike ose marrëveshjeve të tjera për autoritetet kompetente, përveç NjIF-it, për të nxjerrë udhëzime dhe rregullore; dhe, mungesa e funksionit ligjor për NjIF-in për të dhënë informata kthyesë.
531. **Kriteri 34.1** (*I përmbushur*) – Paragrafi 2 i nenit 66 të Ligjit për PPP/LFT-në përcakton se NjIF-i, BQK-ja dhe autoritetet mbikëqyrëse sektoriale, në çdo kohë dhe në bashkëpunim e bashkërendim të ngushtë me njëra-tjetrën, miratojnë, ndryshojnë apo shfuqizojnë akte nënligjore me qëllim të ofrimit të politikave, udhëzimeve ose udhëzuesve për subjektet raportuese për zbatimin e detyrimeve të këtij ligji dhe për promovimin dhe sigurimin e pajtueshmërisë së subjekteve raportuese me këtë ligj.
532. Përveç autorizimit të lartpërmendur të autoriteteve kompetente (përfshirë mbikëqyrësit) për të krijuar udhëzime, disa dispozita të Ligjit për PPP/LFT-në përmbajnë një gjuhë më specifike në fushat dhe çështjet që duhet ose mund të rregullohen me mjete shtesë.
533. Në veçanti, paragrafi 1.11 i nenit 14 të Ligjit për PPP/LFT-në autorizon NjIF-in të miratojë akte nënligjore, të nxjerrë urdhra dhe udhëzime për çështjet që kanë të bëjnë me sigurimin ose promovimin e pajtueshmërisë me këtë ligj, përfshirë, por pa u kufizuar në: a) përdorimin e formave të standardizuara raportuese; b) aktet ose transaksionet e dyshimta, përfshirë natyrën e akteve ose transaksioneve të dyshimta për qëllime të ligjit si dhe hartimin e listave të treguesve të këtyre akteve dhe transaksioneve; dhe c) lirimin e personave ose subjekteve, apo grup personash ose subjektësh, nga detyrimet e raportimit sipas ligjit si dhe metodat për të raportuar lirime të tilla.
534. Paragrafi 5 i nenit 21 të Ligjit për PPP/LFT-në i jep të drejtë NjIF-it të nxjerrë akte nënligjore për të përcaktuar kriteret për “i përshtatshëm” dhe “i duhur” për zyrtarë të pajtueshmërisë, kërkesat që duhet të përmbushen prej tyre, kompetencat dhe përgjegjësitë e funksionit të pajtueshmërisë dhe çështje të tjera që lidhen me zbatimin e detyrimeve sipas ligjit.
535. Paragrafi 5 i nenit 23 të Ligjit për PPP/LFT-në përcakton se NjIF-i, në bashkëpunim me mbikëqyrësit sektorialë, nxjerr akte nënligjore për subjektet raportuese lidhur me faktorët e rrezikut që merren në konsideratë dhe/ose masat që ndërmerren në situata ku masat e kujdesit të thjeshtuar janë të përshtatshme. Paragrafi 6 i të njëjtit nen përcakton se BQK-ja nxjerr akte nënligjore për të identifikuar faktorët e rrezikut që merren në konsideratë dhe/ose masat që duhet të ndërmerren në situata ku masat e kujdesit të thjeshtuar janë të përshtatshme, për bankat dhe institucionet financiare, dhe paragrafi 8 i nenit 24 të Ligjit për PPP/LFT-në e fuqizon atë për të nxjerrë rregullore në lidhje me transfertat vendore dhe ndërkombëtare të ekzekutuara si transfertat grumbull/bllok transfertash.
536. Paragrafi 6 i nenit 30 të Ligjit për PPP/LFT-në përcakton që NjIF-i dhe autoriteti mbikëqyrës sektorial mund të miratojnë, ndryshojnë ose shfuqizojnë aktet nënligjore në përputhje me politikën, objektivat dhe qëllimet e këtij ligji siç janë të zbatueshme për kazinotë dhe objektet e tjera të licencuara të lojërave të fatit. Më tej, paragrafi 11 i nenit 31 thekson se

NjIF-i dhe mbikëqyrësi sektorial mund të miratojnë, ndryshojnë ose shfuqizojnë aktet nënligjore në përputhje me politikat, objektivat dhe qëllimet e këtij ligji siç janë të zbatueshme për profesionistët në fjalë. Dhe në fund, paragrafi 3 i nenit 39 parasheh që NjIF-i, BQK-ja ose mbikëqyrësi sektorial, nxjerrin akte nënligjore, urdhra ose udhëzime për mbajtjen e statistikave të atyre sektorëve nën fushëveprimin e tyre mbikëqyrës.

537. Në zbatim të dispozitave të mësipërme, NjIF-i ka nxjerrë një numër udhëzimesh administrative, urdhëresash dhe udhëzimesh të tjera që lehtësojnë zbatimin e masave kombëtare të PPP/LFT-së dhe, në veçanti, zbulimin dhe raportimin e RTD-ve (përfshirë urdhëresat administrative që ofrojnë indikatorë të aktivitetit të dyshimtë të PP/FT-së).
538. Ndër autoritetet e tjera kompetente, BQK-ja ka nxjerrë Rregulloren për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit, si dhe Udhëzimin për Identifikimin e Pronarëve Përfitues. Dogana e Kosovës ka nxjerrë një udhëzim të brendshëm për përmbajtjen dhe formën e formularëve/certifikatave standarde të përcaktuara në nenin 33 të Ligjit për PPP/LFT-në (lidhur me lëvizjet e deklaruara ndërkufitare të parave të gatshme dhe instrumenteve të tjera monetare).
539. Paragrafët 5 dhe 6 të nenit 39 të Ligjit për PPP/LFT-në përcaktojnë që NjIF-i njofton subjektet raportuese në lidhje me: a) të dhënat për numrin e RTD-ve; b) rezultatet e shkaktuara nga raportimi i tillë, kur është e zbatueshme; dhe c) informacionet mbi trendët dhe teknikat e PP/FT-së.

Vlerësimi dhe përfundimi

540. Kriteri që përcakton kërkesat në lidhje me vendosjen e udhëzimeve dhe sigurimin e informatave kthyesë është përmbushur.
541. **Kosova është në përputhje me Rekomandimin 34.**

Rekomandimi 35 – Sanksionet

542. Në Raportin e Vlerësimit për PPP/LFT-në të vitit 2014, Kosova u vlerësua se ishte pjesërisht në përputhje me Rekomandimin e mëparshëm 17. Vlerësimi identifikoi mangësi teknike lidhur me: shqetësimet për zbatueshmërinë e dispozitave të caktuara të Ligjit për PPP/LFT-në për qëllime të ndëshkimit administrativ; shqetësimet për veprat penale të dyfishta në Ligjin për PPP/LFT-në dhe legjislacionin financiar të veçantë që përmbajnë sanksione të ndryshme penale; moszbatueshmërinë e sanksioneve ndaj subjekteve raportuese të cilat nuk janë persona juridikë; paqartësinë juridike për zbatimin e sanksioneve për shkelje të detyrimeve që nuk janë të përfshira në Ligjin për PPP/LFT-në; pasigurinë juridike në përcaktimin e një autoriteti kompetent për vendosjen e sanksioneve administrative; pasigurinë juridike për zbatimin e sanksioneve administrative dhe të tjera ndaj drejtorëve dhe drejtuesve të tjerë të lartë të subjekteve raportuese; mungesën e një sërë sanksionesh administrative disiplinore; dhe shqetësimet mbi zbatueshmërinë e sanksioneve administrative të kujdesit dhe të sanksioneve të tjera sipas legjislacionit financiar të veçantë për qëllimet e Ligjit për PPP/LFT-në.

Përkufizimi dhe klasifikimi

543. **Kriteri 35.1 (Pjesërisht i përmbushur)** – Sipas nenit 40 të Ligjit për PPP/LFT-në, dështimi nga subjektet raportuese për t'iu përmbajtur detyrimeve ligjore të parashikuara në këtë ligj, që nuk janë vepra penale, përbëjnë shkelje administrative të cilat klasifikohen si shkelje shumë të rënda, shkelje të rënda dhe shkelje të lehta.
544. Shkeljet shumë të rënda përfshijnë dështimin për të përmbushur detyrimet e raportimit të NjIF-i (neni 26), për të siguruar të dhënat, dokumentet ose informacionet e kërkuara nga NjIF-i (paragrafi 1.4 i nenit 14), për të zbatuar udhëzimet e NjIF-it për të mos kryer transaksione, ose për të siguruar monitorimin e llogarive/marrëdhënieve të biznesit (paragrafi 1.12 i nenit 14), për të ndërmarrë veprimet korrigjuese të rekomanduara nga NjIF-i, BQK-ja ose mbikëqyrësit e tjerë sektorialë dhe për të ngrijë ose bllokuar fondet (neni 27). Shkeljet e rënda përfshijnë dështimin për të përmbushur një numër kërkesash thelbësore sipas Ligjit për PPP/LFT-në ndërsa shkeljet e vogla përcaktohen për të mbuluar të gjitha shkeljet përveç atyre të klasifikuara si shumë të rënda dhe të rënda.
545. Ekzistojnë disa mangësi teknike lidhur me përkufizimin dhe mospërputhjet përmbajtësore në klasifikimin e shkeljeve të kërkesave të PPP/LFT-së.

546. Sa u përket **mangësive teknike**, paragrafi 1.3 i nenit 41 i referohet dështimit të subjekteve raportuese për të përmbushur "detyrimet e nën-paragrafit 1.12 të nenit 14", ndërsa dispozita e përmendur në nenin 14 që përcakton autorizimin e NjIF-it për të lëshuar urdhra për mosekzekutimin e transaksioneve ose monitorimin e llogarive nuk përcakton asnjë detyrim për subjektet raportuese.
547. Pastaj, paragrafi 1.6 i nenit 41 i referohet dështimit të subjekteve raportuese për të përmbushur "detyrimin për të ngrirë ose bllokuar fondet siç përcaktohet në nenin 27" të këtij ligji, ndërsa neni 27 që përcakton detyrimin për ngrirjen e përkohshme të transaksioneve nuk kërkon ngrirjen e fondeve dhe nuk e përdor termin "bllokoj" në lidhje me transaksionet ose fondet.
548. Më tej, paragrafi 1.10 i nenit 43 i referohet dështimit të subjekteve raportuese për të përmbushur "detyrimin e raportimit të NjIF-i, siç përcaktohet në paragrafin 9 të nenit 19 të këtij ligji", ndërsa paragrafi 9 i nenit 19 që përcakton se subjektet raportuese nuk janë të kufizuara në rastin e paraqitjes së një RTD-je në pajtim me nenin 26 të ligjit (domethënë, sa herë që ata kanë dyshime të PP/FT-së) nuk përcakton ndonjë detyrim për t'i raportuar NjIF-it.
549. Në mënyrë të ngjashme, paragrafi 1.21 i nenit 43 i referohet dështimit të subjekteve raportuese për të përmbushur "detyrimin për të ndërmarrë masa për përmirësim pas njoftimit zyrtar të përcaktuar në nënparagrafin 7.1 të nenit 34 të këtij ligji", ndërsa dispozita e përmendur në nenin 34 që përcakton autorizimin e NjIF-it, BQK-së dhe mbikëqyrësve të tjerë sektorialë për të rekomanduar masa përmirësuese nuk përcakton asnjë detyrim për subjektet raportuese. Për më tepër, sjellja e njëjtë e subjekteve raportuese, domethënë "dështimi në përputhje me detyrimin për të ndërmarrë veprime përmirësuese sipas rekomandimit zyrtar të NjIF-it, BQK-së ose mbikëqyrësve të tjerë sektorialë" përkufizohet si shkelje shumë e rëndë sipas paragrafit 1.4 të neni 41.
550. Po ashtu, paragrafi 1.3 i nenit 46 i referohet kompetencës së NjIF-it, BQK-së dhe mbikëqyrësve të tjerë sektorialë që të shqiptojnë "rekomandime për veprime përmirësuese" si një sanksion për shkelje të lehta, gjë që nuk është e duhur për aq sa kërkesa për korrigjimin e një shkelje, sipas përkufizimit, nuk përbën një sanksion.
551. Në pikëpamje të **mospërputhjeve thelbësore**, klasifikimi i shkeljeve nuk duket të bazohet dhe të rrjedhë nga shqyrtimi i duhur i kriterëve kyçe në vijim:
- Natyrë e shkeljes* – e cila dallon sipas kategorive specifike të detyrimeve të shkelura që ndërliohen, ndër të tjera, me vlerësimin e rrezikut të PP/FT-së, KDK-në dhe ruajtjen e të dhënave, kontrollet e brendshme, raportimin e RTD-ve, masat e ngrirjes;
 - Pesha e shkeljes* – e cila dallohet sipas përsëritjes⁸⁵ (p.sh. dështime të shumta të raportimit të RTD-ve kundrejt një rasti të vetëm të mosraportimit), fushëveprimet dhe mbulimit (p.sh. dështimeve të shumta të identifikimit të pronësisë përfituese kundrejt rasteve të pakta të mungesës së adresave të përfituesve në transfertat elektronike), karakteristikat e lëndës (p.sh. marrëdhënie të rëndësishme biznesi kundrejt një transaksioni të vogël të rastit);
 - Forma e shkeljes* – e cila dallohet si e qëllimshme⁸⁶ (p.sh. dështimi i zyrtarit të pajtueshmërisë për të klasifikuar të afërmit e tij si rrezik i lartë) ose sjellja e pakujdesshme (p.sh. dështimi i stafit të shërbimit për klientin për të mbajtur kopjen e dokumentit të identifikimit të klientit) e shkelësit;
 - Pasojat e shkeljes* – të cilat dallohen për humbjen e shkaktuar (p.sh. dështimi për të identifikuar një PEP që ka rezultuar me gjopa të konsiderueshme mbikëqyrëse dhe dëmtimi i reputacionit), ndodhja faktike e PP/FT-së (p.sh. dështimi për të

⁸⁵ Dispozita në paragrafin 2 të nenit 43 që përcakton se "përveç nëse ka indikatorë apo dyshim për pastrim të parave apo financimit të terrorizmit", shkeljet e rënda në lidhje me detyrimet e KDK-së sipas nenit 19 dhe detyrimet e ruajtjes së të dhënave sipas nenit 20 mund të klasifikohen si shkelje të lehta nëse konsiderohen si "shkelje të rastit që mund të jenë të zakonshme dhe të izoluara në bazë të përqindjes së incidenteve në mostrën e pajtueshmërisë" nuk jep kuptimin se rregullatori ka ndjekur një qasje gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme duke marrë parasysh të gjitha kriteret kyçe për klasifikimin e shkeljeve.

⁸⁶ Shkeljet e qëllimshme mund të rezultojnë në shqiptimin e sanksioneve administrative ose penale (kjo e fundit varet nga pasojat dhe interesi/arsye tjetër).

identifikuar personat e përcaktuar nga OKB-ja që kanë rezultuar në një rast të kryerjes së financimit të terrorizmit).

552. Në lidhje me sa më sipër, nuk është e qartë se përse, për shembull, dështimi i subjektit raportues që t'i raportojë NjIF-it një transaksion të vetëm të dyshimtë në vlerën e 10.000 euro apo më shumë (siç kërkohet në nenin 26) është klasifikuar si një shkelje e rëndë, ndërsa dështimi për të aplikuar KDK-në e shtuar (siç kërkohet në nenin 22) klasifikohet si një shkelje e rëndë pa vlerësim të duhur të natyrës dhe peshës, si dhe formës e pasojave të shkeljes.
553. Po ashtu, nuk është e qartë se përse dështimi i subjektit raportues për të njoftuar NjIF-in mbi identitetin e zyrtarit të pajtueshmërisë (siç kërkohet në paragrafin 8 të nenit 21) klasifikohet si shkelje e rëndë, ndërsa dështimi për të caktuar një zyrtar të pajtueshmërisë (siç kërkohet në paragrafin 1 të nenit 21) klasifikohet si një shkelje e lehtë për shkak të specifikimit të gjuhës që përcakton shkeljet duke iu referuar neneve dhe paragrafëve të veçantë në ligj. Në lidhje me këtë të fundit, dështimi për të përmbushur kërkesat e një numri nenesh (p.sh. nenet 28-31) dhe disa paragrafë klasifikohet si një shkelje e lehtë pa ndonjë logjikë të dukshme ose arsyetim themelor.

Sanksionet e zbatueshme

554. Për shkelje shumë të rënda, NjIF-i mund të shqiptojë sanksione administrative si vërejtje publike dhe gjobë prej 50-350 mijë euro (për bankat dhe institucionet e tjera financiare – deri në 700 mijë euro), si dhe të kërkojë revokimin e autorizimit për operim (licencën). Përveç gjobës së shqiptuar ndaj subjektit raportues, për personat fizikë përgjegjës për shkeljen dhe të cilët mbajnë poste administrative apo drejtuese në subjektin raportues mund të shqiptohen gjoba deri në 100.000 euro dhe shkarkimi nga detyra me skualifikim për mbajtjen e posteve.
555. Për shkelje të rënda, NjIF-i, si dhe BQK-ja e mbikëqyrësit e tjerë sektorialë – kur kjo kompetencë jepet sipas marrëveshjeve individuale me NjIF-in në përputhje me paragrafin 5 të nenit 34 të ligjit – mund të vendosin ndëshime administrative si vërejtje private dhe gjobë që varion ndërmjet 20-30.000 euro. Përveç gjobës së shqiptuar ndaj subjektit raportues, një vërejtje private ose publike, një gjobë deri në 20.000 euro dhe pezullim i përkohshëm nga detyra mund të zbatohet për personat fizikë përgjegjës për shkelje dhe të cilët mbajnë poste administrative ose drejtuese në subjektin raportues.
556. Për shkelje të lehta, NjIF-i, si dhe BQK-ja e mbikëqyrësit e tjerë sektorialë – kur kjo kompetencë jepet sipas marrëveshjeve individuale me NjIF-in në përputhje me paragrafin 5 të nenit 34 të ligjit – mund të shqiptojnë sanksione administrative siç është vërejtje private, gjobë që shkon deri në shumën 15.000 euro, dhe rekomandim për veprime përmirësuese.
557. Veç kësaj, neni 47 përcakton se “përveç detyrimit që korrespondon me subjektin raportues, personat që mbajnë poste administrative ose menaxhuese në subjektin raportues mbahen përgjegjës, duke qenë administratorë të vetëm apo organe kolegjiale (borde), janë përgjegjës për çdo shkelje e cila i atribuohet këtyre të fundit”. Në lidhje me këtë, nuk është e qartë se si kjo dispozitë mund të jetë koherente (domethënë në bazë të ndërsjellë ose reciprokisht ekskluzive) kur zbatohet së bashku me ato të neneve 42 dhe 44 që përcaktojnë sanksione në lidhje me personat fizikë përgjegjës për shkelje dhe të cilët mbajnë pozita administrative ose drejtuese në subjektin raportues.
558. Për më tepër, dallimi i madh në shumën e gjobave që mund të zbatohet, nga NjIF-i nga njëra anë dhe BQK-ja e mbikëqyrësit e tjerë sektorialë në anën tjetër, duket se nuk është arsyetuar mjaftueshëm për trajtimin e shkeljeve të bazuara në kriteret e natyrës, peshës, formave dhe pasojave. Fakti që aftësia e BQK-së dhe mbikëqyrësve të tjerë sektorialë të vendosin sanksione është e kushtëzuar nga marrëveshjet individuale me NjIF-in ngre shqetësime rreth zbatueshmërisë së kornizës ndëshkuese si një e tërë.
559. Në përgjithësi, duke pasur parasysh mangësitë teknike në lidhje me përkufizimin dhe mospërputhjet thelbësore lidhur me klasifikimin e shkeljeve siç përshkruhen më lart, nuk duket se Ligji për PPP/LFT-në parasheh ekzistencën e një game sanksionesh proporcionale dhe zbindëse për personat fizikë ose juridikë që dështojnë për të përmbushur kërkesat e PPP/LFT-së.
560. Siç është përmendur në analizën e Rekomandimit 8, ligji për OJQ-të parasheh sanksione për pezullimin ose revokimin e regjistrimit si dhe revokimin e statusit të përfuturit publik

të OJQ-ve. Sa i përket përgjegjësisë së menaxherëve dhe stafit të OJQ-ve, nuk ka dispozita korresponduese për të siguruar që një përgjegjësi e tillë të realizohet në praktikë me anë të çfarëdo sanksionesh. Po ashtu, nuk është e qartë se si do të zbatohen/shqiptohen sanksionet në praktikë për dispozitat e neneve 13 deri në 16 të Ligjit për OJQ-të në lidhje me qeverisjen e brendshme, operacionet financiare ose konfliktet e interesit.

561. Në kuadër të zbatimit të Rekomandimit 6, ligji nr. 03/L-183 për Zbatimin e Sanksioneve Ndërkombëtare parashikon përgjegjësinë për personat fizikë dhe juridikë, megjithatë normat dhe procedurat e hollësishme për administrimin e kësaj përgjegjësie nuk janë vendosur.
562. **Kriteri 35.2 (I përmbushur)** – Siç tregohet në analizën për kriterin 35.1, sanksionet zbatohen jo vetëm për institucionet financiare dhe BPCJF-të, por edhe për drejtorët dhe drejtuesit e tjerë të lartë të tyre.

Vlerësimi dhe përfundimi

563. Faktet dhe rrethanat në vijim janë konsideruar se përcaktojnë vlerësimin për Rekomandimin 35:
- Ekzistojnë disa mangësi teknike lidhur me përkufizimin dhe mospërputhjet thelbësore lidhur me klasifikimin e shkeljeve të kërkesave të PPP/LFT-së (kriteri 35.1); dhe
 - Nuk duket se Ligji për PPP/LFT-në parasheh një gamë sanksionesh proporcionale dhe zhbindëse për personat fizikë ose juridikë që nuk përmbushin kërkesat e PPP/LFT-së (kriteri 35.1).
 - Nuk janë vendosur mekanizmat e sanksioneve për të siguruar pajtueshmërinë me Rekomandimet 6 dhe 8.
564. **Kosova është pjesërisht në përputhje me Rekomandimin 35.**

Rekomandimi 36 – Instrumentet ndërkombëtare

565. Rekomandimi përkatës në Raportin e Vlerësimit të PPP/LFT-së të vitit 2014 është vlerësuar se nuk është i aplikueshëm, i cili mbetet i vlefshëm edhe në lidhje me vlerësimin aktual.
566. Megjithatë, vihet re se zbatimi i disa prej kërkesave të konventave përkatëse është pasqyruar në Rekomandimet përkatëse për kriminalizimin e PP-së dhe FT-së. Asnjë informacion nuk është dhënë nga autoritetet e Kosovës për aspekte të tjera specifike të zbatimit të dispozitave të kërkuara. Asnjë informacion nuk është i disponueshëm për zbatimin e neneve 38, 40, 46, 48, 50-55 dhe 57-58 të Konventës së Meridës.
567. **Rekomandimi 36 nuk është i aplikueshëm për Kosovën.**

Rekomandimi 37 – Ndhimja e ndërsjellë juridike

568. Në Raportin e Vlerësimit të PPP/LFT-së të vitit 2014, Kosova u vlerësua se ishte pjesërisht në përputhje me Rekomandimin e mëparshëm 36 për shkak të mungesës së standardeve të shërbimit lidhur me afatet e kthimit të përgjigjes ndaj kërkesave të huaja që mund të pengonin efektivitetin e sistemit, efektivitetin dhe afatet kohore të përpunimit të kërkesave dhe lëndët e vjetra. Rekomandimi i Posaçëm V u vlerësua si kryesisht në përputhje për shkak të ndikimit të mundshëm të kriminalitetit të dyfishtë të kombinuar me mangësitë në kriminalizimin e FT-së.
569. **Kriteri 37.1 (Kryesisht i përmbushur)** – Ndryshimi i vetëm në legjislaicionin përkatës që ka ndodhur që nga raporti i mëparshëm i vlerësimit është Ligji i ri për PPP/LFT-në. Baza ligjore për ofrimin e ndihmës së ndërsjellë juridike është Ligji nr. 04/L-213 për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Penale (Ligji për NNJ-në) si dhe neni 62 i Ligjit për PPP/LFT-në. Sidoqoftë, ky i fundit nuk përmban ndonjë kërkesë dhe procedura të hollësishme në lidhje me fushëveprimin e tij dhe kështu nuk kontribuon në regjimin tashmë të detajuar. Një përjashtim i mundshëm ka të bëjë me referimin të çdo procedurë gjyqësore që mund të zgjerohet fushën e zbatimit të bashkëpunimit ndërkombëtar, p.sh. me qëllim të shtyrjes së operacioneve sipas Ligjit për PPP/LFT-në.
570. Bashkëpunimi juridik ndërkombëtar zbatohet në pajtim me nenin 1 të Ligjit për NNJ-në në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare ose parimit të reciprocitetit kur mungon një marrëveshje ndërkombëtare. Ligji lejon gamën më të gjerë të ndihmës që u referohet

procedurave të KPP-së, si dhe sigurimin e procedurave të mëtejshme sipas neneve 89 dhe 98.

571. Kërkesat e NNJ-së duhet të kanalizohen përmes departamentit përkatës në Ministrinë e Drejtësisë (Departamenti për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar) edhe pse ligji përcakton përdorimin e kanaleve diplomatike aty ku është e nevojshme. Në të njëjtën kohë, Ligji për PPP/LFT-në kërkon përdorimin e kanaleve diplomatike. Këto dispozita plotësuese potencialisht mund të ndikojnë në kohëzgjatjen e pranimit dhe ekzekutimit të kërkesës lidhur me PP/FT-në.
572. Bashkëpunimi i drejtpërdrejtë me homologët e huaj nuk lejohet me përjashtim të rasteve urgjente sipas nenit 4, paragrafi 2 të Ligjit për NNJ-në, i cili lejon ofrimin e ndihmës edhe nëse kërkesa pranohet drejtpërdrejt (që duhet të pasohet me konfirmim me shkrim përmes kanalit zyrtar).
573. Kriminaliteti i dyfishtë mund të ndikojë vetëm në bashkëpunimin lidhur me NNJ-në për FT-në (të kombinuar me mangësitë në kriminalizimin e FT-së) në një shkallë të kufizuar siç kërkohet shprehimisht vetëm në rastin e masave shtrënguese (kontroll, sekuestrim dhe konfiskim, neni 90 i Ligjit për NNJ-në). Në të njëjtën kohë, nuk është e qartë nëse kërkesa e re e nenit 62 të Ligjit për PPP/LFT-në do të mbulonte gjithashtu FT-në pasi që i referohet hapur terrorizmit.
574. **Kriteri 37.2 (Kryesisht i përmbushur)** – Mekanizmat përcaktohen me Ligjin për NNJ-në (shih më lart). Nuk ekzistojnë dispozita ligjore që specifikojnë afate të qarta për ekzekutimin e kërkesave, megjithëse neni 80, paragrafi 4 i Ligjit për NNJ-në kërkon marrjen parasysh të çdo afati procedural dhe çdo kushti tjetër të përmendur nga shteti kërkues. Mundësia e lartpërmendur për të ekzekutuar një kërkesë drejtpërdrejt sipas nenit 4, paragrafi 2 në raste urgjente gjithashtu konsiderohet e rëndësishme për sa u përket afateve kohore. Kërkesa për dërgimin e kërkesës në Prokurorinë Themelore përkatëse përkundër faktit se rasti mund të jetë në kompetencë të p.sh. në rastet e PP-së të PSRK-së shton një element të panevojshëm në zinxhirin e ekzekutimit.
575. Departamenti përkatës i MD-së është duke përdorur një sistem elektronik të menaxhimit të kërkesave, edhe pse nuk është e qartë nëse ai mund të shërbejë plotësisht për qëllimin e priorizimit dhe monitorimin e progresit. Një sistem i tillë nuk përdoret nga autoritetet e tjera.
576. **Kriteri 37.3 (I përmbushur)** – Neni 2 i Ligjit për NNJ-në kërkon që zbatimi i ligjit t'i nënshtrohet mbrojtjes së interesave të sovranitetit, sigurisë, rendit publik dhe interesave të tjera të Kosovës, siç përcaktohen në Kushtetutë. Neni 85 parasheh shkaqe të veçanta për të refuzuar një kërkesë për NNJ të cilat janë të kufizuara dhe kështu nuk mund të konsiderohen të paarsyeshme ose tepër të kufizuara. Këto përfshijnë rastet kur kërkesa ka të bëjë me një vepër politike; ekzekutimi i kërkesës rrezikon të cenojë sovranitetin, sigurinë, rendin publik ose interesat e tjera themelore të Kosovës; kërkesa është në kundërshtim me sistemin juridik të Kosovës.
577. **Kriteri 37.4 (I përmbushur)** – Arsytet e refuzimit janë theksuar qartë në nenin 85 të Ligjit për NNJ-në dhe nuk përmbajnë as përfshirjen e çështjeve financiare as arsye të lidhura me fshehtësinë. Për më tepër, neni 63 i Ligjit për PPP/LFT-në përcakton se fshehtësia profesionale nuk mund të përdoret si arsye për refuzimin e sigurimit të informatave që duhen zbuluar në pajtim me këtë ligj ose janë mbledhur dhe ruajtur në pajtim me këtë ligj dhe kërkohen qoftë nga NjIF-i, qoftë nga policia lidhur me një hetim për pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit të urdhëruar apo të kryer nën mbikëqyrjen e prokurorit apo gjyqtarit hetues. Përjashtimi i vetëm është rasti i privilegjit ndërmjet avokatit dhe klientit.
578. **Kriteri 37.5 (I përmbushur)** – Çështja i nënshtrohet rregullimit të nenit 5 të Ligjit për NNJ-në që kërkon ruajtjen e konfidencialitetit të kërkesës sipas kërkesës dhe informimin e palës tjetër nëse konfidencialiteti nuk mund të sigurohet.
579. **Kriteri 37.6 (I përmbushur)** – Kriminaliteti i dyfishtë zbatohet vetëm në pajtim me nenin 90 të Ligjit për NNJ-në në lidhje me kontrollin, sekuestrimin dhe konfiskimin.
580. **Kriteri 37.7 (I përmbushur)** – Siç është cekur më lart, kriminaliteti i dyfishtë kërkohet në rrethanat e nenit 90 të Ligjit për NNJ-në dhe dispozita e përmendur nuk kërkon në mënyrë të qartë që vepra të vendoset në të njëjtën kategori ose të përdorë të njëjtën terminologji. Nuk ka informacion të mëtejshëm për të treguar ndonjë interpretim të mundshëm për të kundërtën.

581. **Kriteri 37.8** (I përmbushur) – Sipas nenit 1, paragrafi 4 të Ligjit për NNJ-në dhe nenit 62, paragrafi 2 të Ligjit për PPP/LFT-në, të gjitha procedurat sipas KPP-së janë të zbatueshme. Ligji për NNJ-në zgjeron kompetencat në dispozicion (p.sh. në nenin 89 dhe 98), përkatësisht lidhur me dëgjimin nëpërmjet video-konferencës dhe mundësinë për të përdorur njësitë e përbashkëta të hetimit).

Vlerësimi dhe përfundimi

582. Ndikimi i mundshëm i kufizuar i kriminalitetit të dyfishtë në lidhje me bashkëpunimin për FT-në. Nuk ka afate të rrepta të parapara nga legjislati.

583. **Kosova është kryesisht në përputhje me Rekomandimin 37.**

Rekomandimi 38 – Ndiqja e ndërsjellë juridike: ngrirja dhe konfiskimi

584. Në Raportin e Vlerësimit për PPP/LFT-në të vitit 2014, Kosova u vlerësua si pjesërisht në përputhje me Rekomandimin 38 për shkak të mungesës së konsideratës për themelimin e fondit për konfiskimin e pasurive, mungesën e masave për bashkërendimin e veprimeve të sekuestrimit apo konfiskimit me vendet e tjera si dhe ndarjen e pasurive me vende të tjera, si dhe lidhur me efektivitetin që nuk është dëshmuar.

585. **Kriteri 38.1** (Pjesërisht i përmbushur) – Si neni 62 i Ligjit për PPP/LFT-në ashtu edhe neni 90 i Ligjit për NNJ-në autorizojnë marrjen e veprimeve në reagim të kërkesave të huaja për të identifikuar, ngrirë, sekuestruar apo konfiskuar pasuritë. Në të njëjtën kohë, megjithëse autoritetet e Kosovës nuk kanë dhënë asnjë informacion të mëtijshëm për këtë, procedurat sipas Kapitullit V të Ligjit për NNJ-në ende konsiderohen të zbatueshme për konfiskim bazuar në njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja (veçanërisht neni 74) dhe në pajtim me kushtet e ndryshme për njohje (neni 72). Nuk është specifikuar ndonjë afat kohor për ekzekutimin e kërkesave.

586. Sa i përket pasurisë specifike që mund t'i nënshtrohet konfiskimit, do të zbatoheshin mangësitë teknike sipas regjimit të përgjithshëm të konfiskimit.

587. **Kriteri 38.2** (Nuk është përmbushur) – Nuk ka dispozita ligjore që do të lejonin konfiskimin pa dënim paraprak në shumicën e rasteve. Konfiskimi i pambështetur në dënim do të ishte i mundur vetëm nëse ekziston aktakuzë dhe i pandehuri vdes apo arratiset nga vendi sipas Ligjit për Kompetencat e Zgjera për Konfiskimin e Pasurisë.

588. **Kriteri 38.3** (Nuk është përmbushur) – Autoritetet e Kosovës kanë ofruar informacion se janë në fuqi marrëveshje dypalëshe me një numër vendesh, përfshirë Gjermaninë, Italinë, Hungarinë, "ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë", Kroacinë, Turqinë dhe Shqipërinë.

589. Në të njëjtën kohë, neni 15 i Ligjit nr. 05/L-049 për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar autorizon Agjencinë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AAPSK) për të marrë përsipër përgjegjësinë për pasuritë, kur një kërkesë pranohet në Kosovë nga një shtet tjetër në lidhje me këto pasuri, dhe kur gjykatat në Kosovë e kanë pranuar kërkesën. Kjo, megjithatë, do të zbatohet vetëm nëse ato pasuri janë transferuar në Agjenci për t'u administruar. Kjo nuk duket të jetë një procedurë e detyrueshme dhe do të kufizonte zbatueshmërinë e këtij administrimi të pasurisë nga Agjencia.

590. **Kriteri 38.4** (Pjesërisht i përmbushur) – Nuk ka kufizime në legjislatin e Kosovës në lidhje me ndarjen e pronës së konfiskuar me vendet e tjera, por duket se ajo duhet të bazohet në marrëveshje ndërkombëtare sipas nenit 15 të Ligjit për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar. Neni 75 i Ligjit për NNJ-në po ashtu i referohet mundësisë së marrëveshjeve të tilla. Asnjë informacion i mëtijshëm nuk është dhënë nga autoritetet për të konkluduar në zbatimin e vërtetë të këtij kriteri.

Vlerësimi dhe përfundimi

591. Shumica e kriterëve të Rekomandimit 38 nuk përmbushen.

592. **Kosova është pjesërisht në përputhje me Rekomandimin 38.**

Rekomandimi 39 – Ekstradimi

593. Në raportin e vlerësimit të PPP/LFT-së të vitit 2014, Kosova u vlerësua si pjesërisht në përputhje me Rekomandimin 39 me arsyetimin se futja e procedurës së konfliktit administrativ kundër vendimit përfundimtar të Ministrit të Drejtësisë shkakton çështje të efektivitetit dhe nuk është e mundur që ekstradimi të ekzekutohet pa vonesë.
594. **Kriteri 39.1** (*Pjesërisht i përmbushur*) – Sipas nenit 10 të Ligjit për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Penale (Ligji për NNJ-në), ekstradimi në procedurat penale lejohet për vepra penale të dënueshme me heqje lirie për një periudhë prej së paku një vit dhe me qëllim të ekzekutimit të dënimit – nëse tejkalon 4 muaj. Kështu, PP-ja është një vepër e ekstradueshme. Siç është cekur në raportin e mëparshëm të vlerësimit, ekziston mungesa e sigurisë juridike në lidhje me zbatueshmërinë e ekstradimit ndaj veprës penale të FT-së, duke pasur parasysh kufizimet e ekstradimit në rast të veprave penale politike (neni 14 i Ligjit për NNJ-në), të cilat e përjashtojnë terrorizmin, por jo në mënyrë të qartë financimin e terrorizmit.
595. Afatet janë paraparë në Ligjin për NNJ-në në lidhje me ekzekutimin e hapave të ndryshëm në procesin e marrjes së një vendimi përfundimtar për ekstradimin duke filluar nga pranimi i kërkesës nga Ministria e Drejtësisë, përcjellja në Prokurori dhe procedura gjyqësore pasuese (nenet 20-23 të ligjit). Megjithatë, siç është theksuar në raportin e mëparshëm të vlerësimit, procedurat e ankesës të parapara në nenet 28-30 mund të rezultojnë në vonesa të panevojshme në ekzekutimin e kërkesave për ekstradim. Kjo, së bashku me mungesën e sistemit të menaxhimit të lëndëve për autoritetet përveç Ministrisë së Drejtësisë (përveç mundësisë që MD të kërkojë informata për zhvillimin e rastit në secilën fazë), konsiderohet e dëmshme për zbatimin e kriterit 39.1.
596. Kushtet për ekzekutimin e kërkesave për ekstradim janë paraparë në nenet 9-17 të Ligjit për NNJ-në dhe përfshijnë kriterin e kriminalitetit të dyfishtë. Ky i fundit mund të ketë një efekt të dëmshëm në ekzekutim në lidhje me mangësitë në kriminalizimin e FT-së. Përndryshe, arsyet e refuzimit nuk duken të paarsyeshme ose tepër të kufizuara.
597. **Kriteri 39.2** (*Kryesisht i përmbushur*) – Sipas nenit 6, paragrafi 2 të Ligjit për NNJ-në shtetasit e Kosovës nuk mund të ekstradohen kundër vullnetit të tyre përveç në rastin e marrëveshjes ndërkombëtare. Marrëveshje e ngjashme që lejojnë ekstradimin e shtetasve të Kosovës janë aktualisht në fuqi me Shqipërinë dhe me Shtetet e Bashkuara.
598. Neni 31 i Ligjit për NNJ-në parasheh opsionin për prokurorinë kompetente që të iniciojë procedurë penale kundër personit në Kosovë, nëse ekstradimi është refuzuar. Përkundër këtij opsioni, nuk ka procedura specifike të parapara në ligj për të siguruar zbatimin e duhur ose zbatimin pa vonesë.
599. **Kriteri 39.3** (*Kryesisht i përmbushur*) – Siç u përmend më sipër, kushtet për ekzekutimin e kërkesave për ekstradim parashihen në nenet 9-17 të Ligjit për NNJ-në dhe përfshijnë kërkesën për kriminalitet të dyfishtë. Nuk ka kërkesa ligjore për të vendosur veprën në të njëjtën kategori ose për të përdorur terminologjinë e njëjtë për veprën penale. Asnjë informacion i mëtejshëm (legjislacioni, jurisprudenca) nuk është siguruar nga autoritetet e Kosovës për të konstatuar se kërkesa e kriminalitetit të dyfishtë do të përmbushej bazuar në sjelljen themelore dhe jo në të njëjtën terminologji ose kategori të veprës penale.
600. **Kriteri 39.4** (*I përmbushur*) – Mekanizmat e thjeshtuar janë në përputhje me nenin 24 të Ligjit për NNJ-në, i cili parashikon përkatësisht se një person ekstradohet nëpërmjet procedurës së thjeshtuar të ekstradimit me kusht që të japë pëlqimin për këtë dhe që shteti kërkues ta pranojë ekstradimin përmes procedurës së thjeshtuar. Ekstradimi i bazuar vetëm në urdhër arresti (p.sh. nëpërmjet sistemit të një urdhër arresti evropian) nuk është i mundur pavarësisht kërkesës për të ndërmarrë arrestimin e përkohshëm në këtë rast (neni 22, paragrafi 2 i Ligjit për NNJ-në).

Vlerësimi dhe përfundimi

601. Shqetësime të rëndësishme mbeten në lidhje me aftësinë e autoriteteve për të ekzekutuar kërkesat e ekstradimit pa vonesa të panevojshme.
602. **Kosova është pjesërisht në përputhje me Rekomandimin 39.**

Rekomandimi 40 – Format e tjera të bashkëpunimit ndërkombëtar

603. Në Raportin e Vlerësimit të PPP/LFT-së të vitit 2014, Kosova u vlerësua si kryesisht në përputhje me Rekomandimin 40 dhe Rekomandimin e Posaçëm V ku mangësitë themelore kanë të bëjnë me: efektivitetin në lidhje me bashkëpunimin ndërkombëtar të policisë që nuk është dëshmuar; mungesën e standardeve të shërbimit për afatet e kthimit të përgjigjes ndaj kërkesave të huaja gjë që mund të pengojë efektivitetin; mungesën e autoritetit të NjIF-it për të kërkuar nga subjektet e detyruara informacione në bazë të kërkesës së një NjIF-i të huaj; dhe, mungesën e kompetencave të NjIF-it për të pezulluar apo shtyrë transaksionin me kërkesë të një NjIF-i të huaj.
604. **Kriteri 40.1** (*Kryesisht i përmbushur*) – Neni 62 i Ligjit aktual për PPP/LFT-në parasheh shkallën më të gjerë të bashkëpunimit ndërkombëtar, duke paraparë që autoritetet kompetente të Kosovës të ndërmarrin sigurimin e masave më të gjera të mundshme të bashkëpunimit me autoritetet e shteteve të huaja për të shkëmbyer informacione, hetime dhe procedura gjyqësore lidhur me masat e përkohshme për sigurimin e pasurisë dhe urdhrave për konfiskim në lidhje me mjetet e pastrimit të parave dhe pasurinë e fituar nëpërmjet veprës penale dhe me qëllim të ndjekjes penale të kryerësve të pastrimit të parave dhe aktivitetit terrorist.
605. Neni 92 i Ligjit për NNJ-në përcakton se pa cenuar zhvillimin e hetimeve ose procedurës penale, autoritetet gjyqësore vendore mundën që, pa kërkesë paraprake, t'ia përcjellin autoritetit kompetent të një shteti tjetër informatat e siguruar në kuadër të hetimeve të tyre, kur konsiderojnë se zbulimi i këtyre informatave mund të ndihmojë shtetin pranues në iniciimin apo zhvillimin e hetimeve ose të procedurës penale ose mund të shpien në një kërkesë për ndihmë juridike të ndërsjellë nga shteti pranues.
606. Një çështje mund të lidhet me termin "terrorizëm" të përdorur sipas nenit 62 dhe paqartësisë juridike nëse do t'i referohej edhe FT-së (shih gjithashtu diskutimin përkatës për Rekomandimin 37). Një shqetësim tjetër rrjedh nga referimi të KPP-ja për procedurat që duhen ndjekur për të siguruar gamën më të gjerë të bashkëpunimit ndërkombëtar. Nga njëra anë, kjo ofron siguri se do të zbatohen mjetet e përdorura në vend, por, nga ana tjetër, mbetet nevoja për bazë ligjore specifike për autoritetet e ndryshme për të shkëmbyer informacion jashtë kornizës së hetimeve. Baza ligjore e tillë vendore është e disponueshme për NjIF-in, BQK-në, por jo, p.sh. për Doganën e Kosovës jashtë marrëveshjeve të veçanta ndërkombëtare.
607. Neni përkatës për shkëmbimin e informacionit të NjIF-it është neni 15, paragrafi 4 i Ligjit për PPP/LFT-në, i cili ndjek kërkesat e shkëmbimit të informacionit sipas Parimeve të Grupit Egmont. Për më tepër, NjIF-i tani mund të përdorë, në mënyrë spontane ose sipas kërkesës, të gjitha informatat e qasshme apo të arritshme sipas Ligjit për PPP/LFT-në për qëllimet e shkëmbimit ndërkombëtar të informacionit.
608. **Kriteri 40.2(a)** (*Kryesisht i përmbushur*) – Autoritetet përkatëse bashkëpunojnë në bazë të dispozitave në legjislationin e tyre përkatës, Ligjin për NNJ-në ose dispozitat e përgjithshme përkatëse në Ligjin për PPP/LFT-në. Duket se Dogana nuk ka asnjë bazë ligjore për bashkëpunim jashtë marrëveshjeve ndërkombëtare të lidhura (12 marrëveshje të tilla në bazë të Ligjit për Marrëveshjet Ndërkombëtare, nr. 04/L-052, nenet 4 dhe 12), megjithëse shkëmbimi nëpërmjet ILECU do të përdorej për qëllime të zbatimit të ligjit.
609. **Kriteri 40.2 (b)** (*Kryesisht i përmbushur*) – NjIF-i e kryen shkëmbimin bazuar në Parimet e Grupit Egmont dhe kanaleve përkatëse. Nuk ka asnjë informacion në lidhje me mjetet për të bashkëpunuar të autoriteteve mbikëqyrëse (ose për qëllime mbikëqyrëse). Procedurat për sigurimin e prioritetive në kuadër të bashkëpunimit për NNJ-në diskutohen në rekomandimin përkatës. ILECU gjithashtu është mbështetur në oficerët ndërlidhës të vendeve të tjera të akredituara në Kosovë dhe kanalet indirekte janë në dispozicion për shkëmbim me Interpol dhe Europol. Autoritetet doganore mbështeten në marrëveshjet ndërkombëtare dhe kanalet përkatëse të parapara në ato marrëveshje (aktualisht janë lidhur 12 marrëveshje) si dhe te ILECU.
610. **Kriteri 40.2 (c)** (*Kryesisht i përmbushur*) – Ekziston qasje e qartë dhe e sigurt në lidhje me shkëmbimin e NjIF-it dhe për bashkëpunimin në pajtim me Ligjin për NNJ-në, përfshirë mundësinë për ekzekutim të drejtpërdrejtë në raste urgjente. Një mekanizëm i qartë sigurohet gjithashtu në pajtim me nenin 219 të KPP-së. Asnjë informacion specifik nuk është i disponueshëm në lidhje me bashkëpunimin për qëllime të mbikëqyrjes, si dhe për procedurën e saktë të ndjekur nga ILECU.

611. **Kriteri 40.2 (d)** (*Kryesisht i përmbushur*) – Shkëmbimi policor kryhet nëpërmjet ILECU dhe afatet kohore janë të garantuara nga kërkesat e Marrëveshjes së Mirëkuptimit për Bashkërendim dhe Mbështetje për ILECU-n të vitit 2011.
612. Ekipi i vlerësimit nuk është informuar për ndonjë procedurë specifike për të siguruar shkëmbim të shpejtë në lidhje me autoritetet mbikëqyrëse.
613. **Kriteri 40.2(e)** (*Kryesisht i përmbushur*) – Për NjIF-in, do të zbatoheshin procedurat dhe mbrojtja specifike e shkëmbimit sipas Ligjit për Klasifikimin e Informacioneve dhe Verifikimin e Sigurisë.
614. Neni 5 i Ligjit për NNJ-në parashikon një kërkesë të përgjithshme për kërkesat e NNJ-së që të mbahen konfidenciale duke respektuar kërkesat e shtetit kërkues dhe duke e informuar shtetin kërkues kur nuk është e mundur të respektohen këto kërkesa.
615. Nuk është në dispozicion të ekipit vlerësues informacion për dispozita të tjera mbrojtëse.
616. **Kriteri 40.3** (*I përmbushur*) – Autoritetet e Kosovës kanë ndërmarrë përpjekje të konsiderueshme për të siguruar marrëveshje dypalëshe aty ku është e nevojshme për shkëmbimin e informacionit. Nuk është ofruar informacion mbi marrëveshje të tilla në kuadër të kompetencave të autoriteteve mbikëqyrëse.
617. **Kriteri 40.4** (*I përmbushur*) – Asnjë pengesë nuk është shënuar në lidhje me mundësinë për të siguruar informata kthyesë në pajtim me Ligjin për PPP/LFT-në si dhe Ligjin për NNJ-në. Në të njëjtën kohë, nuk ka procedura specifike në këtë drejtim, përveç parimeve që udhëheqin shkëmbimin e informacionit të NjIF-it.
618. **Kriteri 40.5** (*Kryesisht i përmbushur*) – Nuk ka kërkesa ligjore lidhur me bashkëpunimin për NNJ-në në analizën përkatëse sipas Rekomandimeve 37-39 për të vendosur kushte tepër të kufizuara për shkëmbimin e informacionit, përfshirë mundësinë për të shkëmbyer informata kur përfshihen çështje fiskale, fshehtësia profesionale (neni 63 i Ligjit për PPP/LFT-në), si dhe që lidhen me natyrën dhe statusin e autoritetit homolog (brenda qëllimeve të përcaktuara të ligjit). Në të njëjtën kohë, neni 87 parasheh ekzekutimin e shtyrë ose të pjesshëm nëse ekzekutimi i një kërkesë për ndihmë të ndërsjellë juridike do të dëmtonte hetimet, ndjekjet penale ose procedurat gjyqësore në përputhje me kriterin 40.5(c).
619. Neni 92 i Ligjit për NNJ-në përcakton se, pa cenuar zhvillimin e hetimeve ose procedurës penale, organet gjyqësore vendore mundën që pa kërkesë paraprake, t’ia përcjellin organit kompetent të një shteti tjetër informatat e siguruara në kuadër të hetimeve të tyre, kur konsiderojnë se zbulimi i informatave të tilla mund të ndihmojë shtetin pranues në iniciimin apo zhvillimin e hetimeve ose të procedurës penale, ose mund të shpien në një kërkesë për ndihmë juridike të ndërsjellë nga shteti pranues.
620. Të njëjtat përfundime mund të arrihen në lidhje me bashkëpunimin e NjIF-it.
621. Nuk ka informacion në lidhje me përmbushjen e këtyre kritereve në kuadër të bashkëpunimit doganor dhe atij për qëllime mbikëqyrëse.
622. **Kriteri 40.6** (*Kryesisht i përmbushur*) – Kërkesat e konfidencialitetit në pajtim me Ligjin për PPP/LFT-në dhe Ligjin për NNJ-në, siç janë diskutuar në pjesë të tjera, konsiderohen se sigurojnë mbrojtje të mjaftueshme.
623. Dogana e Kosovës do të kërkohej që t’u përmbahet kërkesave të marrëveshjeve përkatëse për bashkëpunim. Nuk është e qartë se cilat procedura do të zbatoheshin në lidhje me bashkëpunimin për qëllime të mbikëqyrjes.
624. **Kriteri 40.7** (*Kryesisht i përmbushur*) – Bashkëpunimi ndërkombëtar i nënshtrohet kërkesave të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (neni 51 për kushtet e transferimit të të dhënave personale, përfshirë mbrojtjen efektive nga autoriteti pranues, nenet 3 dhe 14), i cili siguron pajtueshmërinë me kriterin për të dhënat personale.
625. Nuk është e qartë se cilat dispozita specifike janë të zbatueshme për autoritetet mbikëqyrëse (përveç NjIF-it).
626. **Kriteri 40.8** (*Kryesisht i përmbushur*) – Ligji për NNJ-në si dhe neni 62 i Ligjit për PPP/LFT-në duket se i lejojnë plotësisht autoritetet kompetente të kryejnë hetimet duke përdorur të gjitha procedurat e zbatueshme për to (të KPP-së). Kompetencat e NjIF-it sipas nenit 14 dhe 15 po ashtu ofrojnë bazë të mjaftueshme ligjore.
627. Nuk është e qartë nëse BQK-ja në cilësinë e mbikëqyrësit mund të kryejë hetime të tilla.

628. Dogana e Kosovës mund të kryejë hetime në emër të homologëve të huaj në pajtim me marrëveshjet e arritura dhe në bazë të kompetencave të veta.
629. **Kriteri 40.9** (*I përmbushur*) – Kompetencat përkatëse të NjIF-it janë paraparë në nenin 14 dhe 15 të Ligjit për PPP/LFT-në.
630. **Kriteri 40.10** (*I përmbushur*) – NjIF-i është anëtare e Grupit Egmont dhe si e tillë zbaton Parimet e tij. Asnjë informacion nuk është dhënë nga autoritetet për procedurat specifike të brendshme të miratuara për sa u përket informatave kthyesë e komenteve, megjithëse duket se nuk ka pengesa ligjore për mundësinë e dhënies së komenteve apo informatave kthyesë.
631. **Kriteri 40.11** (*I përmbushur*) – Kriteri konsiderohet të jetë plotësisht i përmbushur duke pasur parasysh përkufizimin e gjerë të informacionit që mund të sigurohet nga NjIF-i në bashkëpunimin e tij sipas Ligjit për PPP/LFT-në. Reciprociteti nuk kërkohet shprehimisht dhe MM-të janë një mjet shtesë për të lehtësuar shkëmbimin e informacionit, megjithëse ato nuk përbëjnë kusht që të kryhet shkëmbimi.
632. **Kriteri 40.12** (*I përmbushur*) – Paragrafët 1 dhe 2 të nenit 79 të Ligjit për Bankat, IMF-të dhe IFJB-të përcaktojnë që BQK-ja, në kuadër të kompetencave dhe detyrave të saj, mund të shkëmbejë informacione mbi çështjet e mbikëqyrjes me autoritetet mbikëqyrëse financiare në Kosovë dhe në vende të tjera. Neni 80 rregullon fshehtësinë dhe zbatohet së bashku me nenin 74, paragrafi 2 të Ligjit për BQK-në për të mundësuar dhënien e informacionit që u nënshtrohet kërkesave të fshehtësisë së autoriteteve rregullatore dhe mbikëqyrëse ose institucioneve financiare ndërkombëtare publike. Marrëveshjet ndërkombëtare me autoritetet e tjera nuk duket të jenë një kërkesë për shkëmbimin e informacionit edhe pse ato janë paraparë sipas paragrafit 2 të nenit 79 me qëllim lehtësimin e shkëmbimit.
633. **Kriteri 40.13** (*I përmbushur*) – Asnjë dispozitë nuk duket të kufizojë zbatimin e këtij kriteri.
634. **Kriteri 40.14** (*Kryesisht i përmbushur*) – Ligji për bankat si dhe Ligji për PPP/LFT-në sigurojnë qasje të mjaftueshme në informatat e kërkuara për t'u shkëmbyer sipas këtij kriteri, përfshirë si pjesë të mbikëqyrjes për zbatimin e Ligjit për PPP/LFT-në. Qasja në informacionin e transaksionit do të ishte e kufizuar në rrethanat e nenit 26, paragrafi 4 të Ligjit për PPP/LFT-në në lidhje me nenin 36, paragrafi 1 të të njëjtit ligj (transaksionet e dyshimta).
635. **Kriteri 40.15** (*Nuk është përmbushur*) – Nuk ka dispozita specifike që i lejojnë BQK-së të kryejë hetime ose të autorizojë homologët e huaj për të kryer vetë këto hetime.
636. **Kriteri 40.16** (*Kryesisht i përmbushur*) – Neni 80, paragrafi 2 i ligjit për bankat do të zbatohet në lidhje me ruajtjen e konfidencialitetit të informacionit së bashku me nenin 74 të Ligjit për BQK-në. Këto paraqesin kërkesa të përgjithshme dhe nuk është e qartë nëse ka ndonjë kërkesë për të informuar homologët për detyrimet ligjore përkatëse (në nenin 74 të Ligjit për BQK-në) për të zbuluar ose raportuar informacionin.
637. **Kriteri 40.17** (*Kryesisht i përmbushur*) – Marrëveshja për themelimin e ILECU, neni 219 i KPP-së, si dhe dispozitat e diskutuara tashmë të Ligjit për NNJ-në dhe Ligjit për PPP/LFT-në do të zbatoheshin. Në këto raste, mund të shkëmbehet informacioni vendor i disponueshëm sipas Ligjit për PPP/LFT-në dhe Kodin e Procedurës Penale.
638. Mbetet e paqartë se cilat janë bazat ligjore për shkëmbimin e informacionit (inteligjencës) të mbledhur duke përdorur kompetencat e policisë dhe çfarë informacioni mund të mblidhet (jashtë fushës së bashkëpunimit për NNJ-në).
639. Shkëmbimi në lidhje me Europol dhe Interpol është i tërthortë, përmes ndërmjetësimit të institucioneve ndërkombëtare në Kosovë.
640. Disa shqetësime mbeten në lidhje me mundësinë për të shkëmbyer informacione në të gjitha rastet mbi instrumentet duke pasur parasysh mangësitë e identifikuar në Rekomandimin 4.
641. **Kriteri 40.18** (*Pjesërisht i përmbushur*) – Nuk ka asnjë informacion në lidhje me bazën ligjore për përdorimin e kompetencave të Policisë së Kosovës për të kryer hetime dhe për të marrë informata, përfshirë përdorimin e teknikave të posaçme hetimore (jashtë fushëveprimit të Ligjit për NNJ-në dhe nenit 62 të Ligjit për PPP/LFT-në). Ndërsa KPP-ja do

të zbatohet në rastin e hetimeve formale, nuk është e qartë se cilat do të jenë kompetencat për të mbledhur informata bazuar në kërkesën e huaj.

642. Duke pasur parasysh shkëmbimin e tërthortë me Interpol dhe Europol, nuk është e qartë se cilat rregulla aplikohen për të garantuar se kufizimet e përdorimit të vendosura nga autoriteti i kërkuar i zbatimit të ligjit janë të zbatueshme.

643. **Kriteri 40.19** (*I përmbushur*) – Neni 98 i Ligjit për NNJ-në përcakton që autoritetet kompetente të Kosovës, me marrëveshje të ndërsjellë me një ose më shumë shtete, mund të formojnë njësi të përbashkëta hetimore për një qëllim të caktuar dhe për një periudhë të kufizuar kohore, me qëllim të kryerjes së hetimeve në një ose më shumë shtete që kanë formuar njësinë. Periudha kohore mund të zgjatet me marrëveshje ndërmjet palëve.

644. **Kriteri 40.20** (*I përmbushur*) – Shkëmbimi i tërthortë i informacionit është i mundur përmes NjIF-it në pajtim me nenin 15, paragrafi 4 në lidhje me nenin 14, paragrafi 1.5 të Ligjit për PPP/LFT-në.

Vlerësimi dhe përfundimi

645. Nuk ka pengesa të mëdha për bashkëpunimin ndërkombëtar të autoriteteve të Kosovës dhe disa çështje lidhen kryesisht me kompetencat e paqarta të autoriteteve mbikëqyrëse.

646. **Kosova është kryesisht në përputhje me Rekomandimin 40.**

Përputhshmëria me Rekomandimet e FATF-së

Rekomandimi	Vlerësimi	Faktorët në themel të vlerësimit
1. Vlerësimi i rrezikut dhe zbatimi i qasjes së bazuar në rrezik	PP	<ul style="list-style-type: none"> • Identifikimi dhe vlerësimet e rreziqeve kanë mangësi domethënëse metodologjike, përfshirë pësjtjellimin sa i përket dobësive nga kërcënimet dhe pasojave; prandaj, rreziqet e PP/FT-së nuk janë identifikuar si duhet dhe tërësisht. • Mekanizmi i caktuar për bashkërendimin e rreziqeve është i kufizuar në funksionin e vet bashkërendues. • Nuk ka pasur shpërndarje të duhur të raportit të VKR-së te sektori privat. • Rialokimi i burimeve bazuar në rezultatet e VKR-së është vendosur vetëm për NjIF-in dhe BQK-në por jo për autoritetet e tjera. • Rreziqet e larta të identifikuara nga autoritetet e Kosovës nuk janë adresuar në nivelin e subjekteve raportuese. • Kujdesi i duhur i thjeshtuar lejohet pa asnjë lidhje me vlerësimin e rrezikut nga autoritetet.
2. Bashkëpunimi dhe bashkërendimi kombëtar	KP	<ul style="list-style-type: none"> • Ka mangësi në bashkërendimin e politikave të nivelit të lartë dhe bashkërendimin strategjik ndërmjet PPP/LFT-së dhe sektorëve të ndërlidhur. • Nuk ka mekanizma bashkërendues për të luftuar FP-në.
3. Vepra e pastrimit të parave	KP	<ul style="list-style-type: none"> • Dispozitat që përcaktojnë përgjegjësinë e personave juridikë në Ligjin për PPP/LFT-në (neni 60) dhe KP dallojnë. • Ka mungesë të proporcionalitetit dhe efektit zhbndës të dënimeve që jepen si kundër personave juridikë, ashtu dhe atyre fizikë. • Manipulimi i tregut nuk është përfshirë si vepër e ndërlidhur penale.
4. Konfiskimi dhe masat e përkohshme	PP	<ul style="list-style-type: none"> • Ka pasiguri sa i përket kompetencës së autoriteteve për të identifikuar dhe gjurmuar pasuritë dhe aftësisë së tyre për të ndërmarrë hapa që të parandalojnë ose shfuqizojnë veprime që paragjykojnë ngrirjen e aseteve apo sekuestrimin ose kthimin e pasurisë që i nënshtrohet konfiskimit. • Është e paqartë se deri në ç'masë është e mundur të konfiskohen asete që janë të ndërlidhura me financimin e terrorizmit pa ndonjë lidhje specifike me një vepër terroriste. • Ekzistojnë një sërë procedurash të mbivendosura sa i përket masave të përkohshme, që krijojnë pësjtjellim në zbatimin e tyre në praktikë.
5. Vepra e financimit të terrorizmit	PP	<ul style="list-style-type: none"> • Mangësitë në kriminalizimin e veprave të ndryshme terroriste të përshkruara në nëntë traktatet e shtojcës së Konventës së FT-së dhe vepra "gjenerike" e një akti terrorist nuk janë plotësisht në përputhje me standardet përkatëse. • Mundësia për të ndjekur penalisht financimin e udhëtimit të LHT-ve kufizohet nga legjislacioni aktual.
6. Sanksionet financiare	MP	<ul style="list-style-type: none"> • Nuk ka ndonjë mekanizëm në sistem për sanksione

Rekomandimi	Vlerësimi	Faktorët në themel të vlerësimit
të shënjestruara lidhur me terrorizmin dhe FT		financiare të shënjestruara që kanë të bëjnë me terrorizmin apo FT-në.
7. Sanksionet financiare të shënjestruara lidhur me përhapjen	MP	<ul style="list-style-type: none"> Nuk ka legjislacion apo masa e procedura të kënaqshme për të zbatuar sanksione financiare të shënjestruara në përputhje me RKSKB-të lidhur me parandalimin, shtypjen dhe ndërprerjen e përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë dhe financimit të saj.
8. Organizatat jofitimprurëse	PP	<ul style="list-style-type: none"> Ka mangësi të konsiderueshme në lidhje me regjistrimin, sensibilizimin dhe mbikëqyrjen e sektorit për qëllime të LFT-së. Mungesa e qasjes së bazuar në rrezik ndikon negativisht në të gjitha masat e tjera. Organizatat fetare përjashtohen nga fushëveprimi i Ligjit për Lirinë e Asociimit të OJQ-ve. Mungesa në ligj e kërkesave korresponduese për "i përshtatshëm" ose "i duhur". Ekzistojnë kufizime të konsiderueshme sa i përket kompetencës së autoriteteve për të kërkuar informacion shtesë. Nuk ka kërkesa për pronësinë përfutuese të OJQ-ve. Kërkesat ekzistuese të ligjit mund të anashkalohen lehtësisht. Nuk ka ndonjë marrëveshje për bashkëpunim, as bashkëpunim të qartë apo shkëmbim të informacionit ndërmjet autoriteteve.
9. Ligjet e fshehtësisë për institucionet financiare	KP	<ul style="list-style-type: none"> Ekipit të vlerësimit nuk i janë ofruar referime në dispozitat ligjore që mundësojnë shkëmbimin e informacionit ndërkombëtarisht nga mbikëqyrësit e tjerë përveç NjIF-it dhe BQK-së për qëllime të PPP/LFT-së. Nuk është e qartë nëse ligjet e Kosovës pengojnë shkëmbimin e informacionit ndërmjet institucioneve financiare kur kjo kërkohet sipas Rekomandimit 17. Nuk duket të jetë rasti që informacioni i nevojshëm për analizën strategjike të PPP/LFT-së të kryer nga NjIF-i mund të sigurohet nga autoritetet e tjera.
10. Kujdesi i duhur ndaj klientit (KDK)	PP	<ul style="list-style-type: none"> Bankat dhe institucionet e tjera financiare nuk janë të detyruara të ndërmarrin të gjitha masat e zbatueshme të kujdesit të duhur të klientit në rast të: a) transaksioneve të rastit jo në para të gatshme mbi pragun e caktuar prej 10.000 euro; dhe, b) transfertave bankare të kryera nëpërmjet institucioneve financiare jobankare. Kërkesa për përdorimin e dokumenteve, të dhënave ose informacionit të besueshëm dhe të pavarur nuk është përcaktuar qartë. Kërkesa për të verifikuar autorizimin e çdo personi që pretendon të veprojë në emër të klientit nuk mbulon situatat në të cilat subjektet raportuese: a) angazhohen në marrëdhënie me persona që pretendojnë të veprojnë në emër të klientit përtej fushëveprimit të kryerjes së transaksioneve; dhe b) merren me persona juridikë, përveç shoqërive tregtare, OJQ-ve ose subjekteve politike, si dhe me marrëveshje juridike.

Rekomandimi	Vlerësimi	Faktorët në themel të vlerësimit
		<ul style="list-style-type: none"> • Dispozita për të përcaktuar pronësinë përfituese nuk kërkon që subjektet raportuese: a) të përdorin informata ose të dhëna përkatëse nga një burim i besueshëm kur marrin masa të arsyeshme për të verifikuar identitetin e pronarit përfitues, dhe b) të marrin masa të tilla në situata të ndryshme nga ato që konsiderohen të jenë me rrezikshmëri të lartë. • Dispozitat për kujdesin e duhur të vazhdueshëm nuk kërkojnë që subjektet raportuese të sigurojnë që dokumentet, të dhënat ose informatat e mbledhura në procesin e KDK-së janë të rëndësishme dhe se kjo arrihet duke ndërmarrë shqyrtime të të dhënave ekzistuese. • Subjekteve raportuese nuk u kërkohet të kuptojnë strukturën e pronësisë dhe kontrollit të klientëve në situata të ndryshme nga ato që konsiderohen të jenë me rrezikshmëri të lartë. • Nuk ka kërkesë për të mbledhur informata për vendin kryesor të biznesit të një personi ose marrëveshje juridike nëse ai është i ndryshëm nga adresa e zyrës së regjistruar. • Nuk ka kërkesë për të përcaktuar identitetin e personit fizik përkatës, i cili mban pozitën e zyrtarit të lartë drejtues, në rastet kur nuk identifikohen persona fizikë sipas përkufizimit të pronarit përfitues. • Përfituesit e marrëveshjeve juridike të identifikuar me karakteristika të caktuara nuk janë përcaktuar si pronarë përfitues dhe kërkesat për identifikimin e pronarëve përfitues në rast të marrëveshjeve juridike nuk përcaktohen siç duhet. • Dispozitat për përfituesit e policave të sigurimit të jetës nuk u kërkojnë subjekteve raportuese: a) të ndërmarrin veprimet e duhura sapo përfituesi identifikohet ose përcaktohet, dhe b) kur përfituesi identifikohet si një marrëveshje juridike me emër, për të regjistruar emrin e marrëveshjes. • Subjekteve raportuese nuk u kërkohet që të përfshijnë përfituesin e një police të sigurimit të jetës si një faktor të rëndësishëm rreziku në përcaktimin nëse masat e KDK-së së shtuar janë të zbatueshme. • Në situata të ndryshme nga ato që konsiderohen të jenë me rrezikshmëri të lartë, nuk kërkohet verifikimi i identiteti të pronarit përfitues para ose gjatë zhvillimit të marrëdhënies së biznesit ose kryerjes së transaksioneve për klientët e rastit. • Subjekteve raportuese nuk u kërkohet të miratojnë procedurat e administrimit të rrezikut në lidhje me kushtet në të cilat një klient mund të shfrytëzojë marrëdhënien e biznesit para verifikimit. • Nuk ekziston kërkesë për subjektet raportuese që të kryejnë kujdesin e duhur ndaj klientëve ekzistues duke marrë parasysh nëse dhe kur janë ndërmarrë më parë masat e KDK-së dhe përshtatshmëria e të dhënave të mbledhura. • Kërkesa për kryerjen e kujdesit të duhur të shtuar kur rreziqet e PP/FT-së janë më të larta nuk është përcaktuar siç duhet.

Rekomandimi	Vlerësimi	Faktorët në themel të vlerësimit
		<ul style="list-style-type: none"> • Elementet dhe parakushtet për lejimin e KDK-së të thjeshtuar nuk janë përcaktuar siç duhet. • Nuk ka kërkesa të qarta në lidhje me subjektet raportuese që të mos hapin llogarinë, të mos fillojnë marrëdhëniet e biznesit ose të mos kryejnë transaksionin, ose të ndërpresin marrëdhënien e biznesit, kur nuk janë në gjendje të zbatojnë të gjitha masat përkatëse të KDK-së. • Nuk ka dispozita për të parandaluar nxjerrjen e informacionit.
11. Ruajtja e të dhënave	KP	<ul style="list-style-type: none"> • Kërkesa për të ruajtur të gjitha të dhënat e siguruara përmes masave të KDK-së dhe rezultatet e analizave nuk është gjithëpërfshirëse.
12. Personat e ekspozuar politikisht (PEP)	PP	<ul style="list-style-type: none"> • Subjekteve raportuese nuk u kërkohet të vendosin sisteme të menaxhimit të rrezikut për të përcaktuar nëse një klient ose një pronar përfitues është PEP. • Ekziston paqartësi juridike lidhur me shtrirjen dhe mbulimin e masave që duhet të zbatohen në lidhje me anëtarët e familjes dhe bashkëpunëtorët e ngushtë të PEP-ëve. • Nuk parashihet që përcaktimi nëse përfituesi dhe/ose, kur është e nevojshme, pronari përfitues i përfituesit është PEP duhet të ndodhë, më së voni, në kohën e pagesës.
13. Korrespondenca bankare	KP	<ul style="list-style-type: none"> • Marrëdhëniet ndërmjet IFJB-ve nuk mbulohen. • Përkufizimi i bankës guaskë duket se i anashkalon disa elemente të caktuara të përkufizimit të FATF-së.
14. Shërbimet e transferimit të parave apo valutës	P	-
15. Teknologjitë e reja	P	-
16. Transfertat elektronike	PP	<ul style="list-style-type: none"> • Dispozitat për transfertat elektronike nuk kërkojnë që: a) numri i llogarisë së iniciuesit që shoqëron transfertën elektronike është veçanërisht numri i llogarisë që përdoret për të procesuar transaksionin; b) në mungesë të një llogarie iniciuese, numri unik i referimit: b.1) është ai i transaksionit specifik; b.2) është ai që lejon gjurmueshmërinë e transaksionit; dhe c) në mungesë të një llogarie përfituese dhe kur numri i llogarisë së iniciuesit përdoret për të procesuar transaksionin, një numër referimi unik i transaksionit që lejon gjurmueshmërinë e transaksionit shoqëron transfertën elektronike. • Të njëjtat mangësi janë të rëndësishme në lidhje me rregullimin e transfertave në grumbull dosjesh. • Informacioni i iniciuesit për transfertat e brendshme elektronike kërkohet që të vihet në dispozicion, në mënyrë të pandryshueshme, të NjIF-it ose BQK-së, por jo të autoriteteve të tjera përkatëse dhe mangësitë e identifikuar në analizën për kriterin 16.1 janë të rëndësishme për transfertat e brendshme elektronike. • Institucioneve financiare urdhëruese nuk u kërkohet të ruajnë informacionin e mbledhur të përfituesit, në përputhje me Rekomandimin 11;

Rekomandimi	Vlerësimi	Faktorët në themel të vlerësimit
		<p>dhe nuk ndalohej ekzekutimi i transfertës bankare nëse nuk është në përputhje me të gjitha kërkesat përkatëse të specifikuara në kriteret 16.1 deri në 16.7.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Mangësitë e identifikuar në analizën për kriterin 16.1 janë të rëndësishme në lidhje me institucionet financiare ndërmjetëse në transfertat elektronike ndërkufitare. • Institucioneve financiare ndërmjetëse nuk u kërkohet që të marrin masa të arsyeshme, të cilat janë në përputhje me përpunimin e drejtpërdrejtë, për të identifikuar transfertat elektronike ndërkufitare që nuk përmbajnë informacionin e kërkuar për iniciuesin apo informacionin e kërkuar për përfituesin; dhe të kenë politika dhe procedura të bazuara në rrezik, për të përcaktuar: a) kur duhet të ekzekutojnë, refuzojnë ose pezullojnë një transfertë elektronike, e cila nuk përmban informacionet e kërkuara për iniciuesin ose përfituesin; dhe b) veprimet e duhura përcjellëse. • Institucioneve financiare përfituese nuk u kërkohet të marrin masa të arsyeshme për të identifikuar transfertat elektronike ndërkufitare të cilat nuk kanë informacionin e kërkuar për përfituesin. • Verifikimi i identitetit të përfituesit përballet me mangësitë e përcaktuara në analizën për kriterin 10.2. Institucioneve financiare përfituese nuk u kërkohet që të ruajnë informacionet e verifikuara për identitetin e përfituesit në përputhje me Rekomandimin 11; dhe të kenë politika dhe procedura të bazuara në rrezik, për të përcaktuar: a) kur duhet të ekzekutojnë, refuzojnë ose pezullojnë një transfertë elektronike, e cila nuk përmban informacionet e kërkuara për përfituesin; dhe b) veprimet e duhura përcjellëse. • Bankat dhe institucionet e tjera financiare që kontrollojnë si anën urdhëruese ashtu edhe atë përfituese të një transferte elektronike nuk janë të detyruara: a) të marrin parasysh të gjitha informatat nga pala përfituese; dhe b) të paraqesin një RTD në secilin vend të prekur nga transfertat elektronike e dyshimtë. • Legjislacioni në fuqi nuk kërkon që bankat dhe institucionet e tjera financiare të ndërmarrin veprime të ngrirjes dhe të veprojnë në përputhje me ndalimet nga kryerja e transaksioneve për personat dhe subjektet e përcaktuara në kontekstin e transfertave elektronike, sipas detyrimeve të përcaktuara në RKSKB-të lidhur me parandalimin dhe shtypjen e terrorizmit dhe financimit të terrorizmit.
17. Mbështetja te palët e treta	MP	<ul style="list-style-type: none"> • Asnjë nga kriteret e Rekomandimit 17 nuk është përmbyshur.
18. Kontrollat e brendshme dhe degët e filialet e huaja	PP	<ul style="list-style-type: none"> • Subjekteve raportuese nuk u kërkohet të zbatojnë programe kundër PP/FT-së duke pasur parasysh rreziqet e PP/FT-së dhe madhësinë e biznesit; me përjashtim të bankave, nuk ka asnjë dispozitë që kërkon emërimin e zyrtarit të pajtueshmërisë në nivelin drejtues; procedurat e përzgjedhjes së punonjësve/kriteret nuk janë përcaktuar për të

Rekomandimi	Vlerësimi	Faktorët në themel të vlerësimit
		<p>gjitha llojet e institucioneve financiare; disponueshmëria e një funksioni të auditimit të pavarur nuk kërkohet për një fushë dhe numër të pidentifikuar të institucioneve financiare "me numër të kufizuar të stafit".</p> <ul style="list-style-type: none"> Legjislacioni nuk specifikon që programet në nivel grupi kundër PP/FT-së duhet të jenë të përshtatshme për të gjitha degët dhe filialet në të cilat grupi zotëron shumicën e pronësisë; dhe se ato duhet të përfshijnë masat e përcaktuara në kriterin 18.1; nuk ka kërkesë që, në funksionet e pajtueshmërisë, auditimit dhe/ose të PPP/LFT-së në nivel grupi, degët dhe filialet: 1) të ofrojnë informacionet e klientit, llogarisë dhe transaksionit kur është e nevojshme për qëllimet e PPP/LFT-së; dhe 2) të marrin informacione të tilla kur është e përshtatshme dhe e duhur për menaxhimin e rrezikut; legjislacioni nuk kërkon që programet në nivel grupi kundër PP/FT-së të përfshijnë mbrojtje të përshtatshme të konfidencialitetit dhe përdorimit të informacionit të shkëmbyer, përfshirë masat mbrojtëse për të parandaluar nxjerrjen e informacionit. Nuk ka dispozita të cilat kërkojnë që: 1) kur kërkesat minimale për PPP/LFT-në të vendit pritës janë më pak të rrepta se ato në Kosovë, bankat dhe institucionet e tjera financiare të sigurojnë që degët e tyre të huaja dhe filialet, në të cilat grupi zotëron shumicën e pronësisë, të zbatojnë masat e PPP/LFT-së në përputhje me kërkesat në Kosovë deri në masën që ligjet dhe rregulloret e vendit pritës e lejojnë këtë; dhe 2) kur vendi pritës nuk lejon zbatimin e duhur të masave të PPP/LFT-së në përputhje me kërkesat në Kosovë, bankat dhe institucionet e tjera financiare të aplikojnë masa të përshtatshme shtesë për menaxhimin e rreziqeve të PP/FT-së dhe informojnë mbikëqyrësit në Kosovë.
19. Vendet me rrezikshmëri më të lartë	PP	<ul style="list-style-type: none"> Subjekteve raportuese nuk u kërkohet të aplikojnë kujdes të shtuar për marrëdhëniet e biznesit dhe transaksionet me persona nga shtetet për të cilët kërkohet nga FATF-ja. Nuk ka kërkesa për të zbatuar kundërmasa në përpjesëtim me rreziqet kur kjo kërkohet nga FATF-ja. Masat për të siguruar që institucionet financiare janë të këshilluara për shqetësimet rreth dobësive në sistemet e PPP/LFT-së së vendeve të tjera nuk janë të mjaftueshme.
20. Raportimi i transaksioneve të dyshimta	KP	<ul style="list-style-type: none"> Detyrimi për raportim kufizohet nga mangësitë në kriminalizimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.
21. Zbulimi dhe konfidencialiteti	KP	<ul style="list-style-type: none"> Dispozitat që ndalojnë nxjerrjen e informacionit shpjegues për paraqitjen e RTD-ve ose informatave përkatëse lënë hapësirë për interpretimin se ato nuk zbatohen për të gjithë personelin e subjekteve raportuese dhe mohojnë kërkesën që ndalon zbulimin e këtij informacioni te palët e treta (përveç NjIF-it tek e cila paraqitet RTD-ja ose informacioni i ndërlidhur).

Rekomandimi	Vlerësimi	Faktorët në themel të vlerësimit
		<ul style="list-style-type: none"> Nuk ka rregullim specifik për të siguruar që këto dispozita nuk kanë për qëllim të pengojnë shkëmbimin e informacionit sipas Rekomandimit 18.
22. BPCJF-të: Kujdesi i duhur ndaj klientit	PP	<ul style="list-style-type: none"> Legjislati nuk kërkon që kazinotë të zbatojnë të gjitha masat e KDK-së (në krahasim me identifikimin e klientit dhe verifikimin e identitetit) sa herë që klientët angazhohen në transaksione financiare të barabarta ose mbi pragun e përcaktuar; dhe për të siguruar që ata janë në gjendje të lidhin informacionin e KDK-së për një klient të caktuar me transaksionet që klienti kryen në kazino; ekziston hapësirë për paqartësi juridike nëse tregtarët e metaleve të çmuara dhe gurëve të çmuar janë caktuar si subjekte raportuese kur veprojnë në cilësinë e blerësit në transaksionet përkatëse; "profesionet e tjera juridike të pavarura" nuk janë përcaktuar si subjekte raportuese sipas ligjit; dhe "kryerja e funksionit të barasvlershëm për një formë tjetër të marrëveshjes juridike" nuk është përcaktuar si shërbim i caktuar sipas ligjit. Kërkesat përkatëse janë përmbushur kryesisht në lidhje me Rekomandimet 11 dhe 12 dhe nuk janë përmbushur në lidhje me Rekomandimin 17.
23. BPCJF-të: Masat e tjera	PP	<ul style="list-style-type: none"> Cilësimet për avokatët, noterët, profesionet e tjera juridike të pavarura dhe kontabilistët (këshilltarët e tatimeve) për të raportuar transaksione të dyshimta nuk përmbushin kërkesat e FATF-së për aq sa ato nuk zbatohen në të gjitha situatat kur këta profesionistë angazhohen në një transaksion "në emër të ose për klientin"; "profesionet e tjera juridike të pavarura" nuk janë përcaktuar si subjekte raportuese sipas ligjit dhe, për rrjedhojë, nuk janë të detyruar të paraqesin RTD; blerësit e metaleve të çmuara dhe gurëve të çmuar nuk janë përcaktuar si subjekte raportuese sipas ligjit dhe, për këtë arsye, nuk janë të detyruar të paraqesin RTD; "kryerja e funksionit të barasvlershëm për një formë tjetër të marrëveshjes juridike" nuk është përcaktuar si shërbim i caktuar sipas ligjit dhe, për këtë arsye, nuk mbulohet me kërkesën për të paraqitur RTD. Përveç mangësive të identifikuar në lidhje me pajtueshmërinë me kërkesat e Rekomandimit 18, nuk janë nxjerrë akte nënligjore për përcaktimin e kriterëve "i përshtatshëm" dhe "i duhur" për zyrtarë të pajtueshmërisë së BPCJF-ve dhe nuk janë krijuar procedura të përzgjedhjes për punësimin e personelit në funksione përkatëse për PPP/LFT-në; nuk kërkohet disponueshmëria e një funksioni të auditimit të pavarur për një fushë dhe numër të pidentifikuar të BPCJF-ve "me numër të kufizuar të stafit", ndërsa kërkesa për testimin e auditimit mbulon vetëm sistemet e raportimit dhe identifikimit, duke lënë anash përbërësit e tjerë të sistemit për PPP/LFT-në. Kërkesat përkatëse janë përmbushur pjesërisht në lidhje me Rekomandimet 18 dhe 19, dhe kryesisht në lidhje me Rekomandimin 21.

Rekomandimi	Vlerësimi	Faktorët në themel të vlerësimit
24. Transparenca dhe pronësia përfituese e personave juridikë	PP	<ul style="list-style-type: none"> • Kosova nuk ka ndërmarrë ndonjë vlerësim të rreziqeve të PP/FT-së që lidhen me llojet e ndryshme të personave juridikë. • Nuk ekzistojnë mekanizma që të identifikojnë dhe përshkruajnë procesin e identifikimit dhe regjistrimit të informacionit për pronësinë përfituese. • Informacioni themelor për pronësinë e personave juridikë jo gjithnjë është në dispozicion nga Regjistri. • Nga shoqëritë aksionare nuk kërkohet të ruajnë të gjithë informacionin për aksionarët. • Masat ekzistuese për të siguruar se informacioni në Regjistrë është i saktë dhe i përditësuar nuk konsiderohen të jenë të kënaqshme. • Nuk ka ndonjë kërkesë për të siguruar disponueshmërinë e informacionit për pronësinë përfituese, përditësimin apo ruajtjen e tij. • Mekanizmat për bashkëpunimin e brendshëm dhe ndërkombëtar për ndarje të informacionit për pronësinë përfituese nuk ekzistojnë në mënyrë specifike. • Ligji i Kosovës nuk rregullon apo ndalon garancitë e aksioneve të bartësit.
25. Transparenca dhe pronësia përfituese e marrëveshjeve juridike	KP	<ul style="list-style-type: none"> • Nuk ka kërkesa specifike për një administrator të besuar që të shpallë statusin e tij/saj për IF-të dhe BPCJF-të kur krijon marrëdhënie biznesi dhe sanksione përkatëse.
26. Rregullimi dhe mbikëqyrja e institucioneve financiare	PP	<ul style="list-style-type: none"> • Përgjegjësia e përbashkët për mbikëqyrjen e pajtueshmërisë së bankave dhe institucioneve të tjera financiare me PPP/LFT-në duket se bie në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për BQK-në dhe ligjet e tjera sektoriale mbi funksionin e vetëm mbikëqyrës të BQK-së; kërkohet më shumë qartësi në aspektin e gjuhës shpjeguese juridike që përcakton funksionet mbikëqyrëse të NjIF-it dhe BQK-së për të kontrolluar pajtueshmërinë me kërkesat e Ligjit për PPP/LFT-në. • Lidhur me: 1) bankat dhe shoqëritë e sigurimeve, mungon një gjuhë e qartë për të parandaluar që bashkëpunëtorët e kriminelëve të hyjnë në tregun financiar si zotërues (ose pronarë përfitues) të pjesëmarrjes së konsiderueshme ose kontrolluese; 2) institucionet financiare jobankare, ekziston mungesë e: a) gjuhës së qartë për të parandaluar që personat me të kaluar kriminale të zotërojnë (ose të jenë pronarë përfitues me) pjesëmarrje të konsiderueshme ose kontrolluese apo të mbajnë funksione drejtuese në një IFJB; dhe b) kërkesa për të parandaluar bashkëpunëtorët e kriminelëve që të bëjnë të njëjtën gjë; 3) institucionet mikrofinanciare, nuk ka kërkesa për të parandaluar personat me të kaluar kriminale ose bashkëpunëtorët e tyre që të zotërojnë (ose të jenë pronarë përfitues me) pjesëmarrje të konsiderueshme ose kontrolluese apo të mbajnë funksione drejtuese në një IMF. • Rregullimi dhe mbikëqyrja në pajtim me Parimet Themelore nuk është demonstruar; legjislativi i

Rekomandimi	Vlerësimi	Faktorët në themel të vlerësimit
		<p>referohet aftësisë së BQK-së për të ushtruar mbikëqyrje efektive të konsoliduar, me sa duket edhe për qëllimet e PPP/LFT-së, por pa dispozita të tjera ligjore ose mjete të tjera detyruese për të siguruar mekanizmat dhe mjetet për zbatimin praktik të saj.</p> <ul style="list-style-type: none"> Informacioni i vënë në dispozicion të vlerësuesve nuk mundëson një përfundim nëse shpeshtësia dhe intensiteti i mbikëqyrjes së institucioneve apo grupeve financiare në terren dhe në distancë përcaktohen në bazë të: (a) rreziqeve dhe politikave të PP/FT-së, kontrolleve të brendshme dhe procedurave që lidhen me institucionin ose grupin, të identifikuara nga vlerësimi i mbikëqyrësve për profilin e rrezikut të institucionit ose grupit; (b) rreziqet e PP/FT-së që janë të pranishme në vend; dhe (c) karakteristikat e institucioneve ose grupeve financiare, në veçanti diversiteti dhe numri i institucioneve financiare dhe shkalla e lirisë së veprimit të lejuar ndaj tyre sipas qasjes së bazuar në rrezik. Informacioni i vënë në dispozicion të vlerësuesve nuk mundëson një përfundim nëse BQK-ja dhe NjIF-i shqyrtojnë vlerësimin e profilit të rrezikut të PP/FT-së së institucioneve ose grupeve financiare (përfshirë rreziqet e mospajtueshmërisë) periodikisht dhe kur ka ngjarje apo zhvillime të mëdha në menaxhimin dhe operacionet e institucionit ose grupit financiar.
27. Kompetencat e mbikëqyrësve	PP	<ul style="list-style-type: none"> Çështja e pasigurisë në kuptim të gjuhës shpjeguese juridike që përcakton funksionet mbikëqyrëse të NjIF-it dhe BQK-së, përfshirë atë për inspektimet në terren, është gjithashtu e rëndësishme në aspektin e pajtueshmërisë me Rekomandimin 27. Mekanizmi për zbatimin e kompetencës së mbikëqyrësit për të detyruar shpalosjen ose për të pasur qasje në çdo informacion të rëndësishëm për monitorimin e përmbushjes së kërkesave të PPP/LFT-së duket se bazohet në nevojën për të kërkuar një urdhër të gjykatës. Mbikëqyrësi ka të drejtën të heqë (revokojë) – por jo të kufizojë ose pezullojë – licencën e institucionit financiar për mosplotësimin e kërkesave të PPP/LFT-së.
28. Rregullimi dhe mbikëqyrja e BPCJF-ve	PP	<ul style="list-style-type: none"> Ka mungesë të gjuhës së qartë për të parandaluar që bashkëpunëtorët e kriminelëve të hyjnë në tregun e lojërave të fatit si zotërues (ose pronarë përfitues) me një pjesëmarrje të konsiderueshme ose kontrolluese. Në mungesë të marrëveshjeve të veçanta me shkrim në mes të NjIF-it dhe mbikëqyrësve sektorialë, ligjet e zbatueshme sektoriale nuk parashohin funksionin e agjencive përkatëse mbikëqyrëse për monitorimin dhe sigurimin e pajtueshmërisë së BPCJF-ve me kërkesat për PPP/LFT-në. Sistemi për monitorimin e përmbushjes së kërkesave të PPP/LFT-së nuk është plotësisht funksional për shkak të mungesës së

Rekomandimi	Vlerësimi	Faktorët në themel të vlerësimit
		<p>marrëveshjeve specifike me shkrim në mes të NjIF-it dhe mbikëqyrësve sektorialë.</p> <ul style="list-style-type: none"> Në mungesë të marrëveshjeve të veçanta me shkrim në mes të NjIF-it dhe mbikëqyrësve sektorialë, ligjet e zbatueshme sektoriale nuk parashohin kompetencat e agjencive përkatëse mbikëqyrëse për kryerjen e funksioneve të tyre të monitorimit dhe sigurimit të pajtueshmërisë me kërkesat për PPP/LFT-në. Nuk ka dispozita në legjislacionin në fuqi që parashikojnë autorizimin e autoriteteve kompetente për të marrë masat e nevojshme për të parandaluar që kriminelët ose bashkëpunëtorët e tyre të jenë të akredituar në mënyrë profesionale, apo të zotërojnë (ose të jenë pronarë përfitues me) pjesëmarrje të konsiderueshme ose kontrolluese, apo të mbajnë funksione drejtuese në BPCJF përveç lojërave të fatit. Informacioni i vënë në dispozicion të vlerësuesve nuk mundëson një përfundim nëse mbikëqyrja e BPCJF-ve kryhet duke: a) përcaktuar shpeshtësinë dhe intensitetin e saj në bazë të kuptimit të BPCJF-ve të rreziqeve të PP/FT-së, duke marrë parasysh karakteristikat e BPCJF-ve, në veçanti diversitetin dhe numrin e tyre; dhe b) duke marrë parasysh profilin e rrezikut të PP/FT-së të këtyre BPCJF-ve dhe shkallën e lirisë së veprimit të lejuar ndaj tyre sipas qasjes së bazuar në rrezik, kur vlerësohet përshtatshmëria e kontroleve të brendshme, politikave dhe procedurave të PPP/LFT-së për BPCJF-të.
29. Njësitë e Inteligjencës Financiare (NjIF)	KP	<ul style="list-style-type: none"> Nuk ka ndonjë kërkesë ligjore specifike për raportim të informacionit shtesë pas një RTD-je të paraqitur tashmë. Në ligj nuk ka afate të prera për praninë të disa informatave shtesë nga subjektet raportuese. Ekzistojnë disa çështje lidhur me mungesën e rregullave të ruajtjes së dokumenteve dhe politikave e procedurave të përzgjedhjes së stafit.
30. Përgjegjësitë e autoriteteve të zbatimit të ligjit dhe të hetimit	KP	<ul style="list-style-type: none"> Nuk janë vendosur procedura specifike për zhvillimin e hetimeve financiare paralele, si dhe për të gjurmuar pasuritë.
31. Kompetencat e autoriteteve të zbatimit të ligjit dhe të hetimit	KP	<ul style="list-style-type: none"> Nuk ka në dispozicion mekanizma për identifikimin e kontrollit të llogarive.
32. Korrierët e parave të gatshme	KP	<ul style="list-style-type: none"> Ekzistojnë disa kufizime sa i përket sigurimit të informacionit nga posta, transportuesi i ngarkesës ose korrieri tregtar. Ka ende pasiguri sa i përket zbatueshmërisë së sanksioneve financiare në rastet kur prokuroria vendos se nuk do të ndërmerret asnjë veprim lidhur me pasurinë e sekuestruar dhe se personi në fjalë mund të aplikojë për kthimin e instrumenteve monetare. Bashkëpunimi ndërkombëtar cenohet nga numri i kufizuar i marrëveshjeve për bashkëpunim, disa mangësi në mbajtjen e evidencave dhe

Rekomandimi	Vlerësimi	Faktorët në themel të vlerësimit
		zbatueshmëria e kufizuar e sanksioneve të shënjestruara për FT-në.
33. Statistikat	PP	<ul style="list-style-type: none"> • Ka mangësi të statistikave në disa nga sferat e raportuara në atë mënyrë që të mundësojë vlerësimin e efektivitetit të sistemit të PPP/LFT-së. • Shumica e statistikave që kanë të bëjnë me bashkëpunimin ndërkombëtar nuk lejojnë monitorimin apo vlerësimin e çështjeve të rëndësishme të PPP/LFT-së.
34. Udhëzimet dhe informatat kthyesë	P	-
35. Sanksionet	PP	<ul style="list-style-type: none"> • Ekzistojnë disa mangësi teknike sa i përket përkufizimit dhe mospërputhjeve të rëndësishme lidhur me klasifikimin e shkeljeve të kërkesave të PPP/LFT-së. • Nuk janë vënë në dispozicion sanksione proporcionale dhe zbindëse për të trajtuar rastet e personave fizikë ose juridikë që nuk respektojnë kërkesat e PPP/LFT-së. • Mekanizmat për sanksione nuk janë vënë në funksionim për të siguruar pajtueshmërinë me Rekomandimet 6 dhe 8.
36. Instrumentet ndërkombëtare	N/A	-
37. Ndihma e ndërsjellë juridike	KP	<ul style="list-style-type: none"> • Efekti i kriminalizimit të dyfishtë lidhur me bashkëpunimin për FT-në është i kufizuar. • Afatet e parashikuara në ligj nuk janë të rrepta. • Nuk ekzistojnë sisteme të menaxhimit të rasteve të përdorura nga disa autoritete kompetente. • NNJ-ja është ndikuar negativisht nga kompleksiteti i disa procedurave.
38. Ndihma e ndërsjellë juridike: ngrirja dhe konfiskimi	PP	<ul style="list-style-type: none"> • Shumica e kritereve sipas Rekomandimit 38 nuk janë përmbushur.
39. Ekstradimi	PP	<ul style="list-style-type: none"> • Mbesin shqetësime të rëndësishme në lidhje me aftësinë e autoriteteve për të ekzekutuar kërkesat e ekstradimit pa vonesa të panevojshme.
40. Format e tjera të bashkëpunimit ndërkombëtar	KP	<ul style="list-style-type: none"> • Mangësitë teknike ekzistojnë lidhur me kompetencat e paqarta të autoriteteve mbikëqyrëse për të shkëmbyer informacionin.

SHTOJCA II: Gjetjet kyçe të përputhshmërisë së Kosovës me Direktivën e 4^{et} të BE-së për PPP-në

Hyrje dhe fushëveprimi

1. Kjo është një përmbledhje e gjetjeve kyçe në raport me përputhshmërinë teknike të legjislacionit të Kosovës me Direktivën 2015/849 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit e datës 20 maj 2015 për parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave apo financimit të terrorizmit, që ndryshon Rregulloren (BE) nr. 648/2012 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, dhe që shfuqizon Direktivën 2005/60/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit dhe Direktivën e Komisionit 2006/70/EC (siç është ndryshuar nga Direktiva (BE) 2018/843 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 30 maj 2018). Efektiviteti dhe zbatimi i dispozitave përkatëse nga autoritetet e Kosovës dhe subjektet raportuese sipas Ligjit për PPP/LFT-në vlerësohet në bazë të informacioneve të marra dhe të analizuara nën vlerësimin e PECK II të efektivitetit të zbatimit të masave për PPP/LFT-në në Kosovë në linjë me Metodologjinë e FATF-së.
2. Përkufizimet e aplikueshme të PP-së dhe FT-së për qëllimet e sistemit parandalues janë paraparë nga Ligji për PPP/LFT-në, i cili po ashtu i përkufizon edhe veprat penale të PP-së dhe FT-së.
3. Shtrirja e institucioneve financiare të përfshira në nenin 16 të Ligjit për PPP/LFT-në është kryesisht në linjë me përkufizimin e nenit 3(2) të Direktivës (BE) 2015/849 me disa përjashtime që kryesisht kanë të bëjnë me IFJB-të.
4. Autoritetet e Kosovës e kanë zgjeruar shtrirjen e Direktivës tek OJQ-të, të cilat janë të përfshira në nenin 16 të Ligjit për PPP/LFT-në si subjekte të detyruara. Sidoqoftë, autoritetet e Kosovës nuk e kanë demonstruar qartë në këtë rast që QBRr e ka nënvizuar vendimin për të përfshirë këtë kategori të subjekteve raportuese. As VKR-ja dhe as vlerësimet sektoriale të kryera nga autoritetet e Kosovës nuk kanë rezultuar në identifikimin e çfarëdo profesioni dhe kategorie tjetër që të përfshihen në fushëveprimin e Ligjit për PPP/LFT-në.

Vlerësimi i rrezikut dhe qasja e bazuar në rrezik

5. Mangësitë e identifikuar në R. 1 të FATF-së gjithashtu do të vlenin edhe në raport me zbatimin e neneve përkatëse të Direktivës të cilat kërkojnë identifikimin e rreziqeve dhe marrjen e masave të duhura në përpjesëtim me rreziqet, duke përfshirë: mungesën e bashkërendimit në mes të mekanizmave të ndryshëm ekzistues të vlerësimit të rrezikut, dështimin për t'i përditësuar vlerësimet, dështimin për t'ua shpërndarë vlerësimet të gjitha subjekteve raportuese, mungesën e ndarjes së burimeve në përputhje me rreziqet e identifikuar dhe masat e përpjesëtuara të subjekteve raportuese. Masat e thjeshtuara nuk lejohen përveç KDK-së së thjeshtuar.
6. Autoritetet e Kosovës kanë ndërmarrë masa për të zbatuar kërkesat për të identifikuar, vlerësuar, kuptuar dhe zbutur rreziqet e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit përmes Ligjit për PPP/LFT-në. Për më tepër, nuk ka kërkesa për subjektet e detyruara që të marrin parasysh VKR-në me rastin e përcaktimit të rreziqeve ndaj të cilave janë të ekspozuara ato përmes vlerësimit të tyre. Efektiviteti i vlerësimit të rrezikut është komprometuar nga mbulimi i kufizuar dhe moskoherenca ndërmjet vlerësimeve të ndryshme. Ndikimi i raportit të VKR-së së Kosovës i vitit 2013 është i kufizuar nga mangësi metodologjike si dhe praktike dhe nga mungesa e përditësimeve të mjaftueshme. Po ashtu nuk janë theksuar mjaftueshëm çështjet që kanë të bëjnë me FT-në qoftë në vlerësimet e VKR-së apo ato sektoriale. Çështjet e privatësisë së të dhënave nuk janë marrë në konsideratë në mënyrë specifike në ndonjërin prej

vlerësimeve. Nuk ka shenja se autoritetet e Kosovës e kanë marrë në konsideratë vlerësimin e rrezikut mbikombëtar të BE-së si një mjet të dobishëm për të vlerësuar rreziqet e saj.

7. Legjislacioni i Kosovës siguron vetëm pjesërisht hapat e duhur për vlerësimin e përgjithshëm të rrezikut nga subjektet e detyruara. Nuk ka kërkesë të përgjithshme që hapat e ndërmarrë nga subjektet e detyruara duhet të jenë në përpjesëtim me natyrën dhe madhësinë e subjekteve (përveç bankave dhe institucioneve financiare) dhe nuk ka kërkesë për dokumentim. Politikat, kontrollat dhe procedurat që duhet të zbatohen nga subjektet raportuese ndikohen ngjashëm nga një numër i mangësive (shih po ashtu më poshtë).

Kujdesi i duhur ndaj klientit

8. Mbulimi i situatave kur kërkohet KDK-ja sipas Direktivës ndikohet nga mangësitë që lidhen me disa aspekte që mungojnë në lidhje me KDK-në për transaksionet e rastit, nuk ka kërkesë për KDK të plotë të transfertave elektronike për institucionet financiare të tjera përveç bankave, nuk kërkohet KDK i plotë në raport me transaksionet mbi pragun (2.000 euro) për kazinotë. Kërkesat e legjislacionit të Kosovës për identifikimin dhe verifikimin e identitetit të klientit në përgjithësi janë në linjë me Direktivën, përpos për përdorimin e identifikimit elektronik.
9. Mangësitë domethënëse të identifikuar në lidhje me përkufizimin dhe të kuptuarit e pronarit përfitues do të ishin negative për procesin e identifikimit të pronarit përfitues dhe marrjen e masave të arsyeshme për të verifikuar identitetin e atij personi. Verifikimi i pronarit përfitues do të kërkohej vetëm në rast të situatave me rrezikshmëri të lartë dhe nuk ka kërkesa për përdorim të burimeve të besueshme dhe të pavarura. Në lidhje me personat juridikë, trustet, kompanitë, fondacionet dhe marrëveshjet e ngjashme juridike, kërkesa për të marrë masa të arsyeshme për të kuptuar pronësinë dhe strukturën e kontrollit të klientit nuk është plotësuar. Nuk parashihen kërkesa në Ligjin për PPP/LFT-në në raport me identifikimin e pronësisë përfituese në rastin e subjekteve juridike siç janë fondacionet dhe marrëveshjet juridike të ngjashme me trustet. Kërkesat në lidhje me identifikimin dhe verifikimin e përfituesve të trusteve dhe marrëveshjeve të tjera juridike nuk janë plotësuar përpos për bankat dhe institucionet financiare. Për më tepër, ka mangësi në kërkesat për të identifikuar personat që pretendojnë se veprojnë në emër të klientit.
10. Ligji për PPP/LFT-në lejon liri veprimi të kufizuar të subjekteve të detyruara në zbatimin e masave parandaluese në bazë të rrezikut të vlerësuar për shkak të situatave të përkufizuara rreptë të cilat kërkojnë KDK të thjeshtuar apo të shtuar dhe asnjë specifikë tjetër në lidhje me shtrirjen e duhur të aplikimit të masave. Nuk ka kërkesë të qartë për subjektet raportuese që të marrin në konsideratë variablat/faktorët e paraparë në shtojcat e Direktivës me rastin e vlerësimit të rrezikut nga pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit. KDK-ja e thjeshtuar kufizohet më tutje nga kërkesa për miratimin nga NjIF-i, që është një masë domethënëse për zbutjen e rrezikut por, së bashku me mangësitë e tjera të qasjes së bazuar në rrezik, rezulton në moszbatimin e masave të thjeshtuara në praktikë. Situatat e KDSH-së të identifikuar nga Direktiva dhe masat përkatëse janë të mbuluara vetëm pjesërisht në ligjin e Kosovës, ndonëse në disa raste mangësi të caktuara nuk duket se kanë rëndësi praktike (si të kërkesat për marrëdhënie korresponduese që i mbulojnë vetëm bankat dhe jo edhe institucionet financiare, përkufizimi i kufizuar i bankës guaskë, etj.).
11. Ngjashëm me Direktivën, Ligji i Kosovës për PPP/LFT-në njëjtë parasheh KDK të shtuar në raport me PEP-ë të huaj dhe vendorë. Shtrirja e PEP-ëve në Ligjin për PPP/LFT-në në përgjithësi është në pajtim me Direktivën përpos të mungesa e qartësisë në lidhje me mbulimin e personave të ndërlidhur (familjarëve apo bashkëpunëtorëve të ngushtë), si dhe mungesën e listave të personave që kanë lidhje me PEP-ë vendorë. Kërkesa në Ligjin për PPP/LFT-në për të siguruar miratimin e drejtuesit të lartë shkon më tej se Direktiva pasi që i përfshin edhe transaksionet e rastit të cilat, sidoqoftë, do të krijojnë vështirësi domethënëse në aplikimin efikas nga subjektet raportuese (deri në shkallën e të qenit të pazbatueshme). Në lidhje me zbatimin e këtyre masave në praktikë, ekziston

një mbështetje e theksuar në regjimin deklarues, mungesë e të kuptuarit në mesin e IFJB-ve dhe mungesë e mekanizmave verifikues.

12. Nuk mund të konsiderohet se ka garanci të duhura për të aplikuar mbështetje te palët e treta. Dispozitat që e ndalojnë përdorimin e llogarive anonime dhe kasafortave në përgjithësi janë në linjë ndonëse mangësitë e përgjithshme të përmendura më sipër në lidhje me KDK-në do të ndikonin negativisht në masat e miratuara për kasafortat. Garancitë e aksioneve të bartësve nuk janë të mbuluara nga ndalimi kundrejt aksioneve të bartësve siç kërkohet në Direktivë. Një mungesë domethënëse vërehet në raport me mungesën e kërkesave specifike për të lehtësuar rreziqet që ndërlidhen me paratë elektronike.
13. Në ligjin e Kosovës nuk ka detyrime specifike për personat juridikë që të marrin dhe mbajnë informacion për pronësinë përfituese dhe nuk ka mekanizma të centralizuar (regjistra) për të mbajtur dhe për ta bërë këtë informacion të qasshëm.
14. Ka mungesë të efektivitetit të aplikimit të masave të KDK-së në praktikë për shkak të mungesës së të kuptuarit të koncepteve dhe kërkesave lidhur me pronësinë përfituese. Për më tepër, sa i përket BPCJF-ve ka mangësi të mëdha në zbatimin e KDK-së pa marrë parasysh rrezikun.

Detyrimet për raportim

15. Kosova e ka themeluar një NjIF, Njësinë për Inteligjencë Financiare (NjIF), e cila i ka zbatuar mekanizmat e politikave, procedurave dhe bashkëpunimit dhe që i ka në dispozicion burimet për të parandaluar, zbuluar dhe luftuar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit. Efektiviteti i vlerësuar në Rezultatin e Menjëhershëm (RM) 6 konsiderohet si mesatar, kryesisht për shkak të çështjeve që kanë të bëjnë me qasjen në informacionin e përdorur për të zhvilluar inteligjencën financiare, përdorimin e pamjaftueshëm të inteligjencës financiare për hetimet dhe ndjekjet penale të PP-së, mungesën e konherencës në raportet nga subjektet e detyruara me rreziqe madhore.
16. NjIF-i është themeluar në bazë të Ligjit për PPP/LFT-në si njësi operativisht e pavarur dhe autonome. NjIF-i merr jo vetëm RTD-të por edhe informacionet e tjera me rëndësi për PP-në, veprat e ndërlidhura penale dhe FT-në, përfshirë transaksionet me para të gatshme mbi pragun dhe informatat shtesë nga subjektet raportuese dhe autoritetet publike. NjIF-i është në gjendje që të sigurojë informata shtesë nga subjektet raportuese për të gjitha rastet e hapura për analizim, dhe kjo është në linjë me kërkesat e Direktivës.
17. Funkzioni analitik dhe shpërndarës i NjIF-it duket se është i konsoliduar mirë dhe se në parim është në gjendje që të gjenerojë informacione cilësore dhe të dobishme për autoritetet kompetente me disa kufizime në lidhje me përdorimin potencial të pamjaftueshëm të disa prej burimeve të informatave në dispozicion për shkak të kufizimeve të mundshme të burimeve dhe arsyt e përshtatshmërisë në lidhje me disa prioritete të autoriteteve kompetente. Në praktikë, informatat kthyese që i jepen NjIF-it ndryshojnë në cilësi dhe kohën e tyre.
18. NjIF-i e ka bazën e nevojshme ligjore dhe iu përgjigjet në mënyre efektive kërkesave për informacion nga autoritetet kompetente siç kërkohet me Direktivë. Gjithsesi, nuk ka dispozita të qarta që i zbatojnë arsytet për refuzim të parapara në Direktivë, ndonëse arsytet e njëjta do të konsideroheshin nga NjIF-i në praktikë.
19. NjIF-i është plotësisht e autorizuar që të pezullojë transaksionet në bazë të informacioneve që i pranon brenda vendit si dhe në bazë të kërkesave të bazuara me shkrim nga cilado palë homologe e huaj e cila kryen funksione të ngjashme.
20. NjIF-i ka të drejtë që të kryejë analiza operative duke pranuar dhe analizuar raportet dhe informacionet në lidhje me të ardhurat nga krimi dhe financimin e terrorizmit si dhe të mbledhë tërë informacionin e rëndësishëm që bie në kompetencat e NjIF-it dhe të shpërndajë informacion për transaksionet e dyshimta të veçanta dhe rezultatet e

analizave për dyshimin për pastrimin e parave, veprat e ndërlidhura penale dhe financimin e terrorizmit.

21. Në bazë të nenit 14 të Ligjit për PPP/LFT-në, NjIF-i është e autorizuar që të kryejë analiza strategjike të informacionit që e mbledh dhe e pranon, për të parandaluar dhe luftuar pastrimin e parave, veprat e ndërlidhura penale dhe financimin e terrorizmit. Në të njëjtën kohë, nuk është e qartë nëse tërë informacioni përkatës që mund të sigurohet nga autoritetet kompetente është i përfshirë në analizën strategjike për shkak të kufizimeve të fshehtësisë profesionale.
22. NjIF-i është e autorizuar që të sigurojë dhe përdorë (duke iu nënshtruar zbatueshmërisë së kufizimeve të privilegjit juridik) të gjitha të dhënat, dokumentet apo informacionin e nevojshëm për të ndërmarrë funksionet e veta. Pasja në dispozicion e një raporti paraprak nuk është parakusht për të kërkuar, siguruar dhe përdorur informacionet e tilla.
23. NjIF-i nuk ka në dispozicion sisteme të automatizuara në lidhje me informatat mbi pagesat apo llogaritë bankare, si dhe kasafortat, apo mekanizmat që lejojnë identifikimin e bartësve të llogarive, pronarëve të tyre përfitues apo personave që pretendojnë se veprojnë në emër të tyre. Mekanizmat e centralizuar ekzistojnë lidhur me informacionet për PEP-ët (në kuadër të masave kundër korrupsionit dhe duke përjashtuar personat që kanë lidhje me PEP-ët), pjesërisht për patundshmëritë, OJQ-të (që u nënshtrohen një sërë kufizimesh), mjetet motorike.
24. Detyrimi për t'i raportuar transaksionet e dyshimta është i kufizuar në baza të arsyeshme në dyshimin për të ardhura nga aktiviteti kriminal, duke e përjashtuar kështu dijeninë. Detyrimi për raportim do të ishte i kufizuar vetëm nga mangësitë në lidhje me kriminalizimin e PP-së dhe FT-së. Raportimi i RTD-ve është (potencialisht) i kufizuar nga disa mospërputhje në ligj (posaçërisht për IFJB-të). Ekzistojnë ca shqetësime të shprehura nga vlerësuesit në lidhje me cilësinë e raporteve. Niveli i raportimit është tejte i pabarabartë, ku shumica e subjekteve jashtë sektorit bankar rrallëherë i dorëzojnë raportet.
25. Kërkesat për nxjerrje të informacionit në përgjithësi janë plotësuar. Sidoqoftë, nuk është e qartë nëse ndalimi sipas Ligjit për PPP/LFT-në do të vlente për të gjithë punonjësit e subjektit raportues që e dorëzon raportin. Kufizimet ekzistojnë për t'ua zbuluar raportet mbikëqyrësve. Lajmërimi/zbulimi për gjykatën i cili lejohet me ligj nuk do të ishte në linjë me kërkesën e Direktivës në të gjitha rastet. Zbutjet e kërkuara nga Direktiva kryesisht nuk zbatohen siç janë synuar në Direktivë.

Mbrojtja e të dhënave, mbajtja e regjistrave dhe të dhënat statistikore

26. Ligji i Kosovës e përkufizon në terma të përgjithshme informacionin që duhet mbajtur por, dispozita nuk mund të interpretohet prerazi sikur kërkon dëshmi të mjaftueshme mbështetëse, dokumente origjinale apo kopje të pranueshme në procedurat gjyqësore sipas ligjit kombëtar në fuqi, siç kërkohet në shkronjën (b) të paragrafit 1 të nenit 40 të Direktivës. Rregullorja e BQK-së e zgjidh këtë çështje për bankat, por jo për subjektet e tjera. Për më tepër, nuk është e qartë nëse i tërë informacioni i siguruar përmes masave të KDK-së do t'i nënshtrohet kërkesave për ruajtjen e të dhënave. Periudhat për ruajtjen e të dhënave nuk janë tërësisht në linjë me Direktivën.
27. Legjislati i Kosovës në një shkallë të madhe është në pajtim me kërkesat e Direktivës për përpunimin e të dhënave personale me disa mangësi të vogla. Ligji për PPP/LFT-në e parasheh kërkesën që subjektet e detyruara të sigurohen që dokumentet dhe informacionet përcjellëse të jenë të gatshme dhe në dispozicion të NjIF-it dhe të autoriteteve të tjera kompetente, ndonëse jo në të gjitha rastet (posaçërisht për IFJB-të) duke përdorur kanale të sigurta dhe në mënyrë që të sigurohet konfidencialiteti.
28. Ligji për PPP/LFT-në kërkon mirëmbajtjen e statistikave nga të gjitha autoritetet kompetente me qëllim që t'i mundësohet NjIF-it që të rishikojë efektivitetin e sistemit për PPP/LFT-në. Nuk ka detyrime ligjore për institucionet e tjera në lidhje me kategoritë e informacioneve që duhen dhe për konsolidimin e këtij informacioni për të siguruar një rishikim domethënës të sistemit.

Politikat, procedurat dhe mbikëqyrja

29. Ligji për PPP/LFT-në kërkon zbatimin e programeve në kuadër të grupeve financiare që mbulojnë degët dhe filialet në të cilat grupi zotëron shumicën e pronësisë. Sidoqoftë, Kosova nuk i ka zbatuar kërkesat e Direktivës në këtë drejtim për të kërkuar zbatimin efektiv të sistemeve koherente dhe gjithëpërfshirëse për të zbutur rrezikun.
30. Nuk ka kërkesa që politikat, procedurat dhe kontrollat të jenë në përpjesëtim me rreziqet, natyrën dhe madhësinë e subjektit raportues. Një numër i mangësive janë vërejtur në lidhje me efektivitetin, përfshirë mungesën e informatave kthryese të mjaftueshme nga NjIF-i në lidhje me dyshimet e raportuara, nevojën për të përmirësuar strukturën dhe karakterin gjithëpërfshirës të treguesve për raportim, trajtimin sipërfaqësor të alarmeve nga subjektet raportuese, si dhe rregullimet e papërshtatshme institucionale për kontrollimin e pajtueshmërisë me kërkesat e RTD-së, mungesën e vetëdijes së BPCJF-ve. Trajnimi është në përgjithësi i mirë për bankat dhe institucionet financiare por i pamjaftueshëm duke pasur parasysh mungesën e vetëdijes së BPCJF-ve.
31. Në ligjin e Kosovës nuk ka kërkesa për regjistrim për shërbimet e këmbimit të valutave virtuale dhe për ofruesit e kuletave kujdestare si dhe kërkesa për regjistrimin e ofruesve të shërbimeve për truste dhe kompani dhe rrjedhimisht për përshtatshmërinë dhe përputhjen e personave që mbajnë pozita drejtuese apo kontrolluese në ato subjekte. Prandaj, mbikëqyrja efektive nuk është e mundur. Ekzistojnë mangësi domethënëse në lidhje me zyrat për këmbimin e valutave. Nuk ekzistojnë kërkesa për hyrje në treg për agjentët e patundshmërive gjë që rezulton në efektivitetin e dyshimtë të mbikëqyrjes.
32. Një sërë çështjesh vërehen si negative ndaj efektivitetit të mbikëqyrjes, duke përfshirë përgjegjësinë e ndarë në mes të disa mbikëqyrësve për vetëm një lloj të subjektit pa një ndarje të qartë në mes të përgjegjësisë, mangësitë në lidhje me hyrjen në treg dhe operacionet pa licencë apo regjistrim të nevojshëm, masat për të parandaluar pjesëmarrjen e bashkëpunëtorëve të kriminelëve, zbatimin e sanksioneve dhe qasjen e bashkërenduar kundrejt BPCJF-ve. Ekzistojnë kompetencat e mbikëqyrësve për të zhvilluar mbikëqyrje në terren dhe në distancë ndonëse mbesin çështjet që kanë të bëjnë me qartësimin e funksionit të BQK-së dhe NjIF-it në raport me bankat dhe institucionet financiare. Saktësia e mbikëqyrjes së NjIF-it mund të komprometohet nga funksioni i paqartë në disa rrethana. Vëmendje e mëtejshme duhet t'u kushtohet faktorëve të rrezikut dhe nevojitet shpërndarje dhe alokim i mëvonshëm i burimeve. NjIF-i dhe BQK-ja u nënshtrohen kërkesave të konfidencialitetit dhe kërkesave specifike për personelin e tyre. Ekzistojnë standarde në lidhje me konfliktin e interesit për të dy mbikëqyrësit. Nuk ka kërkesa të qarta për të marrë në konsideratë rrezikun në nivel kombëtar, si dhe profilin e rrezikut të institucionit dhe grupit. Ligji për PPP/LFT-në nuk parasheh kërkesa të qarta për NjIF-in që të zbatojë qasjen e bazuar në rrezik ndaj mbikëqyrjes ndonëse procedura standarde të operimit (PSO) për mbikëqyrjen nga NjIF-i janë miratuar në vitin 2017 për këtë qëllim. Duket se profilizimi i rrezikut të subjekteve individuale të mbikëqyrura ka mangësi. Nuk ka tregues se autoritetet i kanë marrë në konsideratë udhëzimet e autoriteteve mbikëqyrëse evropiane (AME) në lidhje me qasjen e bazuar në rrezik (QBRr).
33. Kosova ka zhvilluar një sistem relativisht gjithëpërfshirës të bashkërendimit në nivelin e politikave në raport me çështjet për PPP/LFT-në. Në nivelin operativ, Kosova i ka hartuar dhe zbatuar një numër marrëveshjesh të bashkëpunimit në mes të të gjitha institucioneve përkatëse në këtë kontekst si bazë për bashkëpunimin e tyre përtej dispozitave tashmë të gjera të legjislacionit për PPP/LFT-në. Vërehen mangësi të vogla, përfshirë efektivitetin e pasojave si rezultat i numrit të nismave e forumeve dhe bashkërendimit të duhur e sigurimit të koherencës së tyre.
34. Shkëmbimi ndërkombëtar i informacionit (në kontekstin e Direktivës) nuk pengohet nga kushte të paarsyeshme apo padrejtësisht kufizuese, përfshirë lidhjet me çështjet tatimore, fshehtësinë apo konfidencialitetin, hapjen e një hetimi apo procedure, natyrën dhe statusin e autoritetit kompetent homolog. NjIF-i gëzon të drejtë që të ofrojë ndihmë të plotë ndaj homologëve të saj pa marrë parasysh identifikimin e veprës së ndërlidhur penale, me disa mangësi që lidhen kryesisht me natyrën e qasjes dhe cilësinë e bazave të të dhënave të qasshme. Nuk ka kërkesa për raportim ndërkufitar sistematik. NjIF-i ka

demonstruar një nivel të përgjithshëm të lartë të efektivitetit në lidhje me shkëmbimin përdërisa i respekton kërkesat e nevojshme të konfidencialitetit.

35. Kërkesat respektive për konfidencialitet dhe fshehtësi profesionale janë gjerësisht të vendosura për personelin e NjIF-it dhe BQK-së. Nuk ka pengesa për bashkëpunimin vendor në mes të autoriteteve kompetente pasi Ligji për PPP/LFT-në parasheh kërkesa të detajuara. Gjithsesi, duket se shkëmbimi për qëllimet e analizës strategjike është ndikuar negativisht. Me sa duket nuk ka pengesa për bashkëpunimin ndërkombëtar të BQK-së dhe NjIF-it, përfshirë detyrimin për të mbajtur fshehtësinë profesionale. Në lidhje me efektivitetin e bashkëpunimit, si NjIF-i ashtu edhe BQK-ja duket se janë duke bashkëpunuar ngushtë dhe duke shkëmbyer informacione përkatëse në nivel vendor, ndonëse nuk është e qartë nëse është shfrytëzuar potenciali i plotë i kërkesave të bashkëpunimit duke marrë parasysh mangësitë e vërejtura në lidhje me mbikëqyrjen e bankave dhe institucioneve financiare për kërkesat e raportimit të Ligjit për PPP/LFT-në. BQK-ja nuk e ka demonstruar qartë se shkëmbimi ndërkombëtar i informacionit është duke u zhvilluar efektivisht për qëllimet e PPP/LFT-së.
36. Një numër i mangësive vërehen në lidhje me gjuhën e disa prej shkeljeve të parapara në Ligjin për PPP/LFT-në, të cilat do të rezultojnë në pasiguri juridike në lidhje me aplikimin e tyre (p.sh. në lidhje me shtyrjen e operacioneve, disa prej kërkesave raportuese, etj.). Ekzistojnë çështje të cilat ndikojnë në proporcionalitetin dhe dekurajimin nga sanksionet. Efektiviteti i regjimit është dobësuar nga dyfishimi i përpjekjeve dhe mungesa e zbatimit të sanksioneve proporcionale dhe zbindëse të parapara me Ligjin për PPP/LFT-në. Duket se ka mbulim të dyfishtë në mes të shkeljes administrative në Ligjin për PPP/LFT-në dhe disa prej veprave penale siç janë cekur në të njëjtin ligj, që janë negative për zbatimin e sanksioneve. Kompetencat e duhura për mbikëqyrësit janë kryesisht të vendosura.
37. Ligji për PPP/LFT-në parasheh sanksionet në lidhje me shkeljet e dispozitave për KDK-në, raportimin, ruajtjen e të dhënave dhe kontrollet e brendshme. Sidoqoftë, ekziston një numër i mangësive të cilat janë vërejtur në raport me zbatimin e kërkesave të të gjitha dispozitave të përmendura. Sanksionet dhe masat administrative në fuqi janë shumë më të kufizuara në shtrirje se sa ato që parashihen me Direktivë, posaçërisht për deklaratat publike dhe në të gjitha rastet e kundërvajtjeve siç janë përkufizuar në Ligjin e Kosovës për PPP/LFT-në. Shumat e sanksioneve financiare nuk janë në përputhje me Direktivën.
38. Të gjitha vendimet përfundimtare në lidhje me sanksionet administrative duhet që të publikohen nga të gjithë mbikëqyrësit. Shtrirja e informacionit të kërkuar që të publikohet është në përputhje me Direktivën dhe një mungesë e vogël vërehet në lidhje me shtyrjen e publikimit. Nuk ka procedura specifike të parapara me legjislacion që të sigurojnë mënyrën në të cilën të gjitha rrethanat përkatëse do të merreshin në konsideratë me rastin e përcaktimit të llojit dhe nivelit të sanksioneve apo masave administrative. Jo të gjithë personat që duhet të sanksionohen janë të mbuluar nga ligji i Kosovës siç e kërkon Direktiva.
39. Nuk ekzistojnë mekanizma për të nxitur raportimin, tek autoritetet kompetente, të shkeljeve potenciale apo aktuale të dispozitave vendore që e transpozojnë Direktivën.

TABELA E PAJTUESHMËRISË me Direktivën (BE) 2015/849
(E amenduar nga Direktiva (BE) 2018/843)

Dispozitat e Direktivës (BE) 2015/849	Përshkrimi dhe Analiza e masave në Kosovë	Niveli i pajtueshmërisë
<p>KAPITULLI I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME</p> <p>SEKSIONI 1 Objekti, fushëveprimi dhe përkufizimet</p> <p align="center">Neni 1</p> <p>1. Kjo Direktivë synon që të parandalojë shfrytëzimin e sistemit financiar të Unionit për qëllime të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.</p>	<p>Nuk aplikohet.</p>	<p>Nuk aplikohet</p>
<p>2. Shtetet Anëtare sigurojnë që pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit të jenë të ndaluara.</p>	<p>Ju lutemi referojuni Shtojcës së Përputhshmësisë Teknike (PT), kryesisht R. 3 dhe 5 si dhe elementeve të rëndësishme të R. 29 dhe Rezultatit të Menjëhershëm (RM) 6.</p> <p>Si PP-ja ashtu edhe FT-ja janë të kriminalizuara në Kosovë. Përderisa kriminalizimi i PP-së në masë të madhe është në pajtueshmëri me standardet ndërkombëtare ku mangësitë e mbetura kanë të bëjnë me dënimet dhe mungesën e kriminalizimit të manipulimit të tregut si vepër penale e ndërlidhur, shkeljet e FT-së janë të ndikuara nga mangësitë, kryesisht në kriminalizimin e veprave të ndryshme të traktateve mbi FT-në (për shkak të elementit të dashjes) dhe kufizimeve në lidhje me financimin e udhëtimeve. Vërehet se elementi i dashjes i veprës së "përgjithshme" të aktit terrorist, ndonëse nuk është në linjë me standardin e FATF-së, është në pajtueshmëri me kërkesat e legjislacionit të Unionit, në mënyrë specifike me nenin 3, paragrafi 2 të Direktivës (BE) 2017/541 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 15 mars 2017 për luftimin e terrorizmit dhe që zëvendëson Vendimin Kornizë 2002/475/JHA të Këshillit dhe ndryshon Vendimin 2005/671/JHA të Këshillit.</p>	<p>Pjesërisht</p>

Dispozitat e Direktivës (BE) 2015/849	Përshkrimi dhe Analiza e masave në Kosovë	Niveli i pajtueshmërisë
	Kosova e ka krijuar një NjIF e cila në pjesën më të madhe është në pajtueshmëri me kërkesat e legjislacionit të Unionit (shiko më poshtë dispozitat përkatëse të Direktivës (BE) 2015/849) dhe ka arritur një nivel të efikasitetit përkundër disa mangësive.	
<p>3. Për qëllimet e kësaj Direktive, veprimet në vijim, kur kryhen me dashje, konsiderohen si pastrim i parave:</p> <p>(a) shndërrimi apo transferimi i pasurisë, kur dihet se ajo rrjedh nga aktiviteti kriminal ose nga pjesëmarrja në këtë aktivitet, me qëllim të fshehjes apo maskimit të prejardhjes së paligjshme të pasurisë apo të dhënies së ndihmës personit i cili është i përfshirë në kryerjen e këtij aktiviteti për të shmangur pasojat juridike ndaj veprimeve të tij;</p> <p>(b) fshehja ose maskimi i natyrës, prejardhjes, vendndodhjes, disponimit, lëvizjes, të drejtave reale në lidhje me pasurinë, apo pronësinë e saj, kur dihet se një pasuri e tillë rrjedh nga aktiviteti kriminal apo nga pjesëmarrja në këtë aktivitet;</p> <p>(c) fitimi, posedimi apo shfrytëzimi i pasurisë, kur dihet, në kohën e pranimit, se ajo rrjedh nga aktiviteti kriminal apo nga pjesëmarrja në këtë aktivitet;</p> <p>(d) pjesëmarrja, bashkëpunimi për të kryer, tentativa për të kryer, ndihma apo shtytja, lehtësimi apo këshillimi për kryerjen e secilit prej veprimeve të cekura në shkronjat e mësipërme (a), (b) dhe (c).</p>	<p>Ju lutemi referojuni Shtojcës së PT-së, R. 3. Shtrirja e veprës së PP-së në Kosovë është kryesisht në përputhje me kërkesat e standardit ndërkombëtar dhe Direktivës (BE) 2015/849. Për më tepër, pasi që është kriminalizuar në nenin 56 të Ligjit për PPP/LFT-në, ajo është e zbatueshme në lidhje me sistemin parandalues sipas nevojës. Në lidhje me kërkesën për kryerjen me dashje të sjelljes, dispozita e nenit 56 të Ligjit për PPP/LFT-në shkon edhe më tej pasi që ajo e parasheh ndjekjen penale të llojeve të ndryshme të aktiviteteve të kryera nga një person që është në dijeni apo ka arsye për të ditur se një pasuri e caktuar është e ardhur nga krimi. Sidoqoftë, përkundër qasjes tërësore për të gjithë veprat penale, mangësitë në lidhje me veprat penale të ndërlihdura, siç është cekur më sipër, vlejné. Përkufizimi i pasurisë ka mundësi të jetë i ndikuar nga shkaputja në mes të dy termave të përdorur në Ligjin për PPP/LFT-në ("të ardhurat nga vepra penale" i cili i referohet vetëm pasurisë dhe "fonde ose pasuri të tjera"). Përkufizimi i të ardhurave nga vepra penale i referohet vetëm pasurisë pa përcaktuar më tej ndonjë lidhje me përkufizimin e aseteve dhe vetëm ky i fundit i përmban të gjitha elementet përkatëse të "pasurisë" siç është përkufizuar në Direktivë.</p>	Pjesërisht
<p>4. Përbën pastrim të parave edhe kur aktivitetet të cilat e kanë gjeneruar pasurinë që pastrohet kryhen në territorin e një Shteti tjetër Anëtar apo në atë të një vendi të tretë.</p>	<p>Ju lutemi referojuni Shtojcës së PT-së, R. 3. Legjislacioni i Kosovës (neni 56, paragrafi 3.3 i Ligjit për PPP/LFT-në) është në përputhje përpos për ndikimin e mundshëm të çështjes së kriminalitetit të dyfishtë.</p>	Pjesërisht
<p>5. Për qëllimet e kësaj Direktive, 'financimi i terrorizmit' nënkupton ofrimin ose grumbullimin e mjeteve financiare me çdo mjet, drejtpërdrejt apo tërthorazi, me synimin për t'i përdorur apo me dijeninë që do të përdoren, tërësisht ose pjesërisht,</p>	<p>Ju lutemi referojuni Shtojcës së PT-së, R. 5. Cekja e Vendimit Kornizë 2002/475/JHA të Këshillit në Direktivën (BE) 2015/849 duhet të kuptohet si cekje e</p>	Pjesërisht

Dispozitat e Direktivës (BE) 2015/849	Përshkrimi dhe Analiza e masave në Kosovë	Niveli i pajtueshmërisë
për të kryer një nga veprat e parapara nga nenet 1 deri në 4 të Vendimit Kornizë 2002/475/JHA të Këshillit ⁽⁸⁷⁾ .	Direktivës (BE) 2017/541 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 15 mars 2017 për luftimin e terrorizmit dhe zëvendësimin e Vendimit Kornizë 2002/475/JHA të Këshillit dhe ndryshimin e Vendimit 2005/671/JHA të Këshillit. Kur i krahasojmë shkeljet e cekura nën nenin 3 të Direktivës (BE) 2017/541, legjislacioni i Kosovës është kryesisht në përputhje, elementi i vetëm që mungon në raport me nenin 3, paragrafi 1 (i) (ndërrhyrja e paligjshme në sistem, siç është cekur në nenin 4 të Direktivës 2013/40/EU të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit në rastet kur neni 9(3) ose shkronja (b) ose (c) e nenit 9(4) e asaj Direktive janë të zbatueshme, dhe ndërrhyrja e paligjshme në të dhëna, siç është cekur në nenin 5 të asaj Direktive në rastet kur shkronja (c) e nenit 9(4) e asaj Direktive është e zbatueshme). Ju lutemi që po ashtu t'i referoheni edhe nenit 1, paragrafi 2 të Direktivës (BE) 2015/849.	
6. Dijenja, dashja apo qëllimi i kërkuar si element i aktiviteteve të cekura në paragrafët 3 dhe 5 mund të nxirren nga rrethanat objektive faktike.	Ju lutemi referojuni Shtojcës së PT-së, R. 3.8 dhe 5.5. Neni 22 i Kodit Penal do të zbatohet në lidhje me këtë ndonëse nuk ka dispozita të qarta korresponduese në Ligjin për PPP/LFT-në (të rëndësishme në lidhje me PP-në).	Në përputhje
<p style="text-align: center;">Neni 2</p> <p>1. Kjo direktivë është e zbatueshme për subjektet e detyruara në vijim:</p> <p>(1) institucionet kreditore;</p> <p>(2) institucionet financiare;</p> <p>(3) personat fizikë apo juridikë në vijim që veprojnë në ushtrimin e aktivitetit të tyre profesional:</p> <p>▼M1</p> <p>(a) auditorët, kontabilistët e jashtëm dhe këshilltarët tatimorë, dhe çdo person tjetër</p>	<p>Ju lutemi referojuni Shtojcës së PT-së, 26.1, si dhe R. 22 dhe 23.</p> <p>Shtyrja e institucioneve financiare të përfshira nën nenin 16 të Ligjit për PPP/LFT-në është kryesisht në pajtim me përkufizimin e nenit 3 (2) të Direktivës (BE) 2015/849. Përcaktimi i lojërave të fatit në Ligjin për PPP/LFT-në është më i ngushtë se sa kërkesa e Direktivës pasi që duket se shërbimet e lojërave të fatit online, përpos kazinove në internet, janë të përjashtuara.</p> <p>Nuk është e qartë nëse të gjitha "profesionet e tjera juridike të pavarura" janë të përfshira me legjislacionin për PPP/LFT-në. Nuk është e qartë nëse janë të përfshirë "personat e tjerë që marrin përsipër që të ofrojnë, drejtpërdrejt apo nëpërmjet personave të tjerë me të cilët</p>	Pjesërisht

⁸⁷ Vendimi Kornizë 2002/475/JHA i Këshillit i datës 13 qershor 2002 për luftën kundër terrorizmit (OJ L 164, 22.6.2002, f.3).

Dispozitat e Direktivës (BE) 2015/849	Përshkrimi dhe Analiza e masave në Kosovë	Niveli i pajtueshmërisë
<p>që merr përsipër të ofrojë, drejtpërdrejt apo nëpërmjet personave të tjerë me të cilët ai person tjetër ka lidhje, ndihmë materiale, asistencë apo këshilla për çështjet tatimore si aktivitet ekonomik apo profesional kryesor;</p> <p>▼B</p> <p>(b) noterët dhe profesionistët e tjerë juridikë të pavarur, kur marrin pjesë, duke vepruar në emër të dhe për llogari të klientit të tyre në ndonjë transaksion financiar apo të patundshmërisë, apo kur ndihmojnë klientin e tyre në planifikimin dhe ekzekutimin e transaksioneve në lidhje me:</p> <ul style="list-style-type: none"> (i) blerjen dhe shitjen e pasurisë së paluajtshme apo të subjekteve të biznesit; (ii) menaxhimin e parave, letrave me vlerë apo pasurive të tjera të klientit; (iii) hapjen apo menaxhimin e llogarive bankare, të kursimeve apo të letrave me vlerë; (iv) organizimin e kontributeve të nevojshme për krijimin, funksionimin apo menaxhimin e shoqërive tregtare; (v) krijimin, funksionimin apo menaxhimin e trusteve; shoqërive tregtare, fondacioneve ose strukturave të ngjashme; <p>(c) ofruesit e shërbimeve për truste apo kompani të cilët nuk janë mbuluar në shkronjën (a) ose (b);</p> <p>▼M1</p> <p>(d) agjentët e patundshmërive, përfshirë kur ata veprojnë si ndërmjetës në lëshimin me qira të patundshmërive, por vetëm në lidhje me transaksionet në të cilat shumat e qirasë mujore është 10.000 euro apo më shumë;</p> <p>▼B</p> <p>(e) personat e tjerë të cilët tregtojnë mallra kur pagesat bëhen ose pranohen me para të gatshme në shumën e 10.000 euro apo më shumë, nëse transaksioni kryhet në një veprim të vetëm apo në disa veprime të ndara të cilat duken se janë të ndërlidhura;</p>	<p>ata persona kanë lidhje, ndihmë materiale, asistencë apo këshilla për çështjet tatimore si biznes kryesor apo aktivitet profesional".</p> <p>Shtrirja e legjislacionit për PPP/LFT-në është e kufizuar në lidhje me tregtarët e metaleve të çmuara dhe gurëve të çmuar pasi që i cek vetëm "shitësit".</p> <p>Përkufizimi i ofruesve të shërbimeve për trustet dhe kompanitë sipas Ligjit për PPP/LFT-në është i kufizuar deri në atë shkallë pasi që nuk përfshin "një marrëveshje të ngjashme juridike" siç është cekur nën nenin 3, paragrafi 7 (d) të Direktivës (BE) 2015/849.</p> <p>Siç është diskutuar nën R. 22 dhe 23, Ligji për PPP/LFT-në i përcakton kontabilistët pa i specifikuar më tej llojet e aktiviteteve/transaksioneve. Për më tepër, duke qenë se përkufizimi i kontabilistëve i referohet certifikimit sipas Ligjit për Kontabilitetin me sa duket mungon një dallim i qartë në mes të auditorëve dhe kontabilistëve. Prandaj, nuk mund të arrihet në përfundimin se kontabilistët e jashtëm janë të mbuluar si duhet me ligj.</p> <p>Mungon qartësia juridike në raport me mbulimin e agjentëve të qiradhënies në kategorinë e agjentëve të patundshmërive sipas Ligjit për PPP/LFT-në. Përderisa, është i mundur përkufizimi më i gjerë i kategorisë së subjektit raportues, ka shumë gjasa që mungesa e qartësisë mund të rezultojë në pamundësinë e zbatimit.</p> <p>Përfshirja e personave të tjerë që tregtojnë mallra duket e kufizuar nga mungesa e kërkesës për zbatimin e masave nga personat që kryejnë transaksione mbi pragun prej 10.000 euro përmes disa operacioneve të cilat duket të jenë të ndërlidhura.</p> <p>Kategoritë e shkronjave (g) – (j) të nenit 2, paragrafi 1 nuk janë përfshirë (shërbimet këmbimore për valutat virtuale, ofruesit e kuletave kujdestare, tregtarët e veprave të artit).</p>	

Dispozitat e Direktivës (BE) 2015/849	Përshkrimi dhe Analiza e masave në Kosovë	Niveli i pajtueshmërisë
<p>(f) ofruesit e shërbimeve të lojrave të fatit;</p> <p>▼M1</p> <p>(g) ofruesit e shërbimeve të këmbimit në mes të valutave virtuale dhe valutave ligjore;</p> <p>(h) ofruesit e shërbimeve të kuletave kujdestare;</p> <p>(i) personat që tregtojnë apo që veprojnë si ndërmjetës në tregtinë e veprave të artit, përfshirë kur kjo kryhet nga galeritë e artit dhe shtëpitë e ankandeve, kur vlera e transaksionit apo një serie të transaksioneve të ndërlidhura është 10.000 euro apo më shumë;</p> <p>(j) personat që depozitojnë ose tregtojnë vepra të artit apo veprojnë si ndërmjetës në tregtinë e veprave të artit që kryhet në porte të lira, kur vlera e transaksionit apo një serie të transaksioneve të ndërlidhura e kapin është 10.000 euro apo më shumë.</p>		
<p>▼B</p> <p>2. Me përjashtim të kazinove, dhe pas një vlerësimi të përshtatshëm të rrezikut, Shtetet Anëtare mund të vendosin që të përjashtojnë, tërësisht apo pjesërisht, ofruesit e disa shërbimeve të lojrave të fatit nga dispozitat kombëtare që e transpozojnë këtë Direktivë, në bazë të rrezikut të ulët të evidentuar që paraqitet nga natyra dhe, sipas rastit, shtrirja e veprimeve në këto shërbime.</p> <p>Në mesin e faktorëve që merren në konsideratë në vlerësimet e tyre të rrezikut, Shtetet Anëtare vlerësojnë shkallën e cenueshmërisë së transaksioneve të zbatueshme, përfshirë metodat e përdorura të pagesës.</p> <p>Në vlerësimet e tyre të rrezikut, Shtetet Anëtare cekin se si ato e kanë marrë parasysh çdo gjetje të rëndësishme në raportet e nxjerra nga Komisioni sipas nenit 6.</p> <p>Çdo vendim i marrë nga një Shtet Anëtar në pajtim me nënparagrafin e parë i njoftohet Komisionit, së bashku me arsyetimin e bazuar në vlerësimin specifik të rrezikut. Komisioni ua komunikon këtë vendim Shteteve të tjera Anëtare.</p>	<p>Ju lutemi referojuni diskutimit të subjekteve të detyruara më sipër.</p> <p>Përjashtimi në lidhje me lojërat e fatit nuk duket të jetë i arsyetuar në pajtim me dispozitën përkatëse të Direktivës (BE) 2015/849.</p>	<p>Në mospërputhje (kërkesat për lajmërim nuk janë të zbatueshme)</p>
<p>3. Shtetet Anëtare mund të vendosin se personat që përfshihen në aktivitete financiare me raste apo në baza shumë të kufizuara, ku ka pak rrezik të pastrimit të</p>	<p>Ju lutemi referojuni Shtojcës së PT-së, R. 1.6.</p> <p>Në Kosovë nuk lejohet asnjë përjashtim i ngjashëm.</p>	<p>Nuk aplikohet</p>

Dispozitat e Direktivës (BE) 2015/849	Përshkrimi dhe Analiza e masave në Kosovë	Niveli i pajtueshmërisë
<p>parave apo të financimit të terrorizmit nuk bien në fushëveprimin e kësaj Direktive, me kusht që të plotësohen të gjitha kriteret në vijim:</p> <p>(a) aktiviteti financiar është i kufizuar në terma absolutë;</p> <p>(b) aktiviteti financiar është i kufizuar në bazë të transaksionit;</p> <p>(c) aktiviteti financiar nuk është aktiviteti kryesor i këtyre personave;</p> <p>(d) aktiviteti financiar është ndihmës dhe drejtpërdrejt i ndërlidhur me aktivitetin kryesor të këtyre personave;</p> <p>(e) aktiviteti kryesor i këtyre personave nuk është një aktivitet i cekur në shkronat (a) deri në (d) apo shkronjën (f) të paragrafit 1(3);</p> <p>(f) aktiviteti financiar ushtrohet vetëm për klientët e aktivitetit kryesor të këtyre personave dhe nuk ofrohet përgjithësisht për publikun e gjerë.</p> <p>Nënparagrafi i parë nuk është i zbatueshëm për personat e përfshirë në aktivitetin e dërgesave të parave siç është përkufizuar në nenin 4, paragrafi (13) të Direktivës 2007/64/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit ⁽⁸⁸⁾.</p>		
<p>4. Për qëllimet e paragrafit 3 shkronja (a), Shtetet Anëtare kërkojnë që qarkullimi i përgjithshëm i aktivitetit financiar të mos e kalojë pragun i cili duhet të jetë mjaftueshëm i ulët. Ky prag caktohet në nivel kombëtar, në varësi të llojit të aktivitetit financiar.</p> <p>5. Për qëllimet e paragrafit 3 shkronja (b), Shtetet Anëtare vendosin një prag maksimal për klient dhe për transaksion, qoftë nëse transaksioni kryhet në një veprim të vetëm qoftë në disa veprime të ndara të cilat duken se janë të ndërlidhur. Ky prag maksimal caktohet në nivel kombëtar, në varësi të llojit të aktivitetit financiar. Ai është mjaftueshëm i ulët për të siguruar që llojet e transaksioneve në fjalë të jenë metodë vështirësisht e përdorshme dhe pak efikase për pastrimin e parave apo financimin e terrorizmit, dhe nuk tejkalon vlerën prej 1.000 euro.</p> <p>6. Për qëllimet e paragrafit 3 shkronja (c), Shtetet Anëtare kërkojnë që qarkullimi i</p>	<p>Ju lutemi shihni më sipër.</p>	<p>Nuk aplikohet</p>

⁸⁸ Direktiva 2007/64/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 13 nëntor 2007 për shërbimet e pagesave në tregun e brendshëm, e cila ndryshon Direktivat 97/7/EC, 2002/65/EC, 2005/60/EC dhe 2006/48/EC dhe shfuqizon Direktivën 97/5/EC (OJ L 319, 5.12.2007, f. 1).

Dispozitat e Direktivës (BE) 2015/849	Përshkrimi dhe Analiza e masave në Kosovë	Niveli i pajtueshmërisë
përgjithshëm i aktivitetit financiar të mos e kalojë 5% të tërë qarkullimit të personit fizik apo juridik në fjalë.		
7. Gjatë vlerësimit të rrezikut të pastrimit të parave apo të financimit të terrorizmit për qëllimet e këtij neni, Shtetet Anëtare i kushtojnë vëmendje të veçantë çdo aktiviteti financiar i cili konsiderohet si veçanërisht i ndjeshëm, për nga natyra, që të përdoret apo keqpërdoret për qëllime të pastrimit të parave apo të financimit të terrorizmit.	Ju lutemi shihni më sipër. Pasi që nuk është aplikuar asnjë përjashtim nën fushëveprimin e këtij neni, dispozita konsiderohet si e pazbatueshme.	Nuk aplikohet
8. Vendimet e marra nga Shtetet Anëtare në zbatim të paragrafit 3 cekin arsyet mbi të cilat mbështeten. Shtetet Anëtare mund të vendosin që t'i tërheqin këto vendime në rastet kur ndryshojnë rrethanat. Ata ia njoftojnë vendimet Komisionit. Komisioni ua komunikon këto vendime Shteteve të tjera Anëtare. 9. Shtetet Anëtare vendosin aktivitete kontrolli të bazuara në rrezik apo ndërmarrin masa të tjera përkatëse për t'u siguruar se përjashtimi i dhënë nga vendimet e marra sipas këtij neni nuk keqpërdoret.	Ju lutemi shihni më sipër.	Nuk aplikohet
<p style="text-align: center;">Neni 3</p> <p>Për qëllimet e kësaj direktive zbatohen përkufizimet e mëposhtme:</p> <p>(1) 'institucion kreditor' do të thotë një institucion kreditor siç është përkufizuar në nenin 4(1) paragrafi (1) të Rregullores (BE) nr. 575/2013 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit ⁽⁸⁹⁾, përfshirë degët e tij, siç janë përkufizuar në nenin 4(1) paragrafi (17) të asaj Rregulloreje, i cili gjendet në territorin e Unionit, kur zyrat qendrore janë në Union apo në një vend të tretë;</p> <p>(2) 'institucion financiar' do të thotë:</p> <p>(a) një ndërmarrje që dallon nga institucioni kreditor, e cila kryen një apo disa prej aktiviteteve të cekura në paragrafët (2) deri në (12), (14) dhe (15) të Shtojcës I të Direktivës 2013/36/EU të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit ⁽⁹⁰⁾, përfshirë aktivitetet e zyrave të këmbimit;</p>	Ju lutemi shihni më sipër diskutimin në nenin 2, paragrafi 1.	

⁸⁹ Rregullorja (BE) nr. 575/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 26 qershor 2013 për kërkesat e kujdesshme për institucionet e kreditit dhe firmat investuese dhe që ndryshon Rregulloren (BE) nr. 648/2012 (OJ L 176, 27.6.2013, f. 1).

⁹⁰ Direktiva 2013/36/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 26 qershor 2013 për qasjen në veprimtarinë e institucioneve të kreditit dhe mbikëqyrjen e kujdesshme të institucioneve të kreditit dhe firmave investuese, e cila ndryshon Direktivën 2002/87/EC dhe shfuqizon Direktivat 2006/48/EC dhe 2006/49/EC (OJ L 176, 27.6.2013, f. 338).

Dispozitat e Direktivës (BE) 2015/849	Përshkrimi dhe Analiza e masave në Kosovë	Niveli i pajtueshmërisë
<p>(b) një shoqëri sigurimi siç është përkufizuar në nenin 13 paragrafi (1) të Direktivës 2009/138/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit ⁽⁹¹⁾, për aq sa kryen aktivitete të sigurimit të jetës të mbuluara nga kjo Direktivë;</p> <p>(c) një kompani investimi siç është përkufizuar në nenin 4(1) paragrafi (1) të Direktivës 2004/39/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit ⁽⁹²⁾;</p> <p>(d) një ndërmarrje kolektive investimi që tregton njësitë apo aksionet e veta;</p> <p>(e) një ndërmjetës në sigurime siç është përkufizuar në nenin 2 paragrafi (5) të Direktivës 2002/92/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit ⁽⁹³⁾ kur vepron në lidhje me sigurimin e jetës dhe shërbime të tjera të ndërlidhura me investime, me përjashtim të një ndërmjetësi të sigurimeve siç është përkufizuar në paragrafin (7) të atij neni;</p> <p>(f) degët e institucioneve financiare, të cilat gjenden në territorin e Unionit, siç janë cekur në shkronjat (a) deri në (e), kur zyra e tyre qendrore gjendet në territorin e një Shteti Anëtar apo në një vend të tretë.</p>		
<p>(3) 'pasuri' do të thotë pasuri të çdo lloji, të trupëzuar apo të patrupëzuar, të luajtshme ose të paluajtshme, të prekshme ose të paprekshme, dhe dokumente ose instrumente juridike në çdo formë, përfshirë ato elektronike ose digjitale, që evidentojnë titullin ose të drejtat në këto pasuri;</p>	<p>"Pasuria" dhe "fonde ose pasuri të tjera" përdoren në Ligjin për PPP/LFT-në në rrethana të ndryshme. Siç është cekur më sipër termi pasuri nuk është i përkufizuar sipas standardit dhe direktivës dhe mund të lërë hapësirë për ta sfiduar juridikisht. Kjo mund të rezultojë në mangësi në një sërë kërkesash të tjera të Direktivës dhe do të diskutoheshin në seksionet përkatëse kur është e përshtatshme.</p>	<p>Në mospërputhje</p>
<p>(4) 'aktivitet kriminal' do të thotë çdo lloj përfshirjeje kriminale në kryerjen e veprave të rënda në vijim:</p> <p>▼M1</p>	<p>Kosova përdor një qasje tërësore të veprave penale e cila është e kufizuar vetëm nga mangësitë e cekura më sipër në lidhje me kriminalizimin e shkeljeve të PP-së dhe FT-së. Neni 337 i KP të Kosovës do të ishte i zbatueshëm në</p>	<p>Pjesërisht</p>

⁹¹ Direktiva 2009/138/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 25 nëntor 2009 për qasjen në dhe ushtrimin e veprimtarisë së sigurimit dhe risigurimit (aftësia paguese II) (OJ L 335, 17.12.2009, f. 1).

⁹² Direktiva 2004/39/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 21 prill 2004 për tregjet e instrumenteve financiare, e cila ndryshon direktivat 85/611/EEC dhe 93/6/EEC të Këshillit dhe Direktivën 2000/12/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit dhe shfuqizon Direktivën 93/22/EEC të Këshillit (OJ L 145, 30.4.2004, f. 1).

⁹³ Direktiva 2002/92/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 9 dhjetor 2002 për ndërmjetësimin në sigurime (OJ L 9, 15.1.2003, f. 3).

Dispozitat e Direktivës (BE) 2015/849	Përshkrimi dhe Analiza e masave në Kosovë	Niveli i pajtueshmërisë
<p>(a) veprat terroriste, veprat që kanë të bëjnë me një grup terrorist dhe veprat që kanë të bëjnë me aktivitete terroriste siç janë cekur në Kapitujt II dhe III të Direktivës (BE) 2017/541 ⁽⁹⁴⁾;</p> <p>▼B</p> <p>(b) çdonjëra nga veprat e cekura në nenin 3(1)(a) të Konventës së Kombeve të Bashkuara të vitit 1988 kundër Trafikimit të Paligjshëm të Drogave Narkotike dhe Lëndëve Psikotrope;</p> <p>▼M1</p> <p>(c) aktivitetet e organizatave kriminale të përkufizuara në nenin 1(1) të Vendimit Kornizë 2008/841/JHA të Këshillit ⁽⁹⁵⁾;</p> <p>▼B</p> <p>(d) mashtrimi i cili prek interesat financiare të Unionit, të paktën mashtrimi i rëndë, siç përkufizohet në nenin 1(1) dhe nenin 2(1) të Konventës për mbrojtjen e interesave financiare të Komuniteteve Evropiane ⁽⁹⁶⁾;</p> <p>(e) korrupsioni;</p> <p>(f) të gjitha veprat, përfshirë veprat penale tatimore që kanë të bëjnë me tatimet e drejtpërdrejta dhe të tërthorta dhe sipas përkufizimit në legjislacionin kombëtar të Shteteve Anëtare, të cilat janë të dënueshme me heqje të lirisë apo një masë sigurie ndalimi mbi një vit maksimalisht apo, në lidhje me Shtetet Anëtare të cilat e kanë një prag minimal të shkeljeve në sistemet e tyre juridike, të gjitha veprat e dënueshme me heqje të lirisë apo masë sigurie ndalimi mbi gjashtë muaj së paku;</p>	<p>lidhje me mashtrimin që i cenon interesat financiare të Unionit.</p>	
<p>(5) 'organ vetërregullues' do të thotë një organ që përfaqëson anëtarët e një profesioni dhe që ka rolin e rregullimit të tyre, për të kryer disa funksione të llojit mbikëqyrës apo monitorues dhe për të siguruar zbatimin e rregullave që kanë të</p>	<p>Diskutim i mëtutjeshëm ku ka nevojë.</p>	

⁹⁴ Direktiva (BE) 2017/541 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 15 mars 2017 për luftën kundër terrorizmit që zëvendëson Vendimin Kornizë 2002/475/JHA të Këshillit dhe ndryshon Vendimin 2005/671/JHA të Këshillit (OJ L 88, 31.3.2017, f. 6).

⁹⁵ Vendimi Kornizë 2008/841/JHA i Këshillit i datës 24 tetor 2008 për luftën kundër krimit të organizuar (OJ L 300, 11.11.2008, f. 42).

⁹⁶ OJ C 316, 27.11.1995, f. 49.

Dispozitat e Direktivës (BE) 2015/849	Përshkrimi dhe Analiza e masave në Kosovë	Niveli i pajtueshmërisë
bëjnë me ta;		
<p>(6) 'pronar përfitues' do të thotë çdo person fizik i cili, në radhë të fundit, zotëron apo kontrollon klientin dhe/ose personat fizikë për të cilët kryhet transaksioni apo aktiviteti dhe që së paku përfshin:</p> <p>(a) në rastin e shoqërive tregtare:</p> <p>(i) personin(at) fizik(ë) të cilët, në radhë të fundit, zotërojnë apo kontrollojnë një subjekt juridik përmes pronësisë së drejtpërdrejtë apo të tërthortë në një përqindje të mjaftueshme të aksioneve apo të drejtave votuese ose pronësore në atë subjekt, përfshirë me aksione të bartësit, ose kontrollit përmes mjeteve të tjera, përpos shoqërive tregtare të regjistruara në një treg të rregulluar të cilat u nënshtrohen kërkesave për zbulim në pajtim me të drejtën e Unionit apo që iu nënshtrohen standardeve ndërkombëtare të barasvlershme të cilat sigurojnë transparencën e përshtatshme të informacionit të pronësisë.</p> <p>Pronësia e aksioneve prej 25% plus një aksion apo e drejta pronësore mbi 25% të kapitalit të klientit, të zotëruar nga personi fizik, është tregues i pronësisë së drejtpërdrejtë. Pronësia e aksioneve prej 25% plus një aksion apo e drejta pronësore mbi 25% të kapitalit të klientit, të zotëruar nga shoqëria tregtare, e cila është nën kontrollin e personit(ave) fizik(ë), apo nga disa shoqëri tregtare, të cilat janë nën kontrollin e personit(ave) fizik(ë) të njëjtë, është tregues i pronësisë së tërthortë. Kjo vlen pa paragjykim ndaj të drejtës së Shteteve Anëtare për të vendosur se një përqindje më e vogël mund të jetë tregues i pronësisë apo kontrollit. Kontrolli përmes mjeteve të tjera mund të përcaktohet, në mes të tjerash, në pajtim me kriteret në nenin 22(1) deri në (5) të Direktivës 2013/34/EU të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit ⁽⁹⁷⁾;</p> <p>(ii) nëse pas shterimit të të gjitha mjeteve të mundshme dhe me kusht se nuk ka baza të tjera të dyshimit, asnjë person në pikën (i) nuk identifikohet, apo nëse ka ndonjë dyshim se personi(at) e identifikuar janë pronarët përfitues, personi(at) fizikë në pozitën e zyrtarit të lartë menaxhues, subjektet e detyruara ruajnë të dhënat e të gjitha veprimeve të ndërmarra për të identifikuar pronësinë përfituese në pikën (i)</p>	<p>Ju lutemi referojuni Shtojcës së PT-së, R. 10.5, 10.10, 10.11, 24 dhe 25.</p> <p>Në lidhje me shkronjën (a): Neni 1.36 i Ligjit për PPP/LFT-në e përkufizon pronarin përfitues si person fizik i cili përfundimisht zotëron ose kontrollon klientin dhe/ose personin fizik në emër të të cilit është duke u kryer një transaksion apo aktivitet, ose personi i cili kryesisht ushtron kontroll efektiv mbi një person apo marrëveshje juridike. Prandaj, përkufizimi është në përputhje me kërkesat e standardit ndërkombëtar dhe përkufizimit të përgjithshëm në Direktivën (BE) 2015/849. Në rastin e personave juridikë, përkufizimi në Ligjin për PPP/LFT-në parasheh udhëzime për vendosjen e pronësisë direkte/indirekte dhe përfshin një referim të 25% të aksioneve apo interesit në pronësi si tregues i pronësisë së tillë. Megjithatë, përkufizimi në mënyrë eksplicite parasheh që njëzet e pesë për qind (25%) apo më shumë e aksioneve do të vlerësohen si të mjaftueshme për të përmbushur këtë kriter. Për më tepër, neni 19, paragrafi 1.2 i Ligjit për PPP/LFT-në e parasheh mundësinë e identifikimit qoftë të pronarit përfitues apo personit ose personave fizikë të cilët në mënyrë direkte apo indirekte e kontrollojnë njëzet e pesë për qind (25%) apo më shumë të një personi juridik. Këto dispozita do të komprometonin interpretimin e kërkuar të pragut të 25% thjesht si një tregues dhe do të rezultonin në kufizimin e kërkesës për të vendosur kontrollin e plotë.</p> <p>Përkufizimi i pronarit përfitues në Ligjin për PPP/LFT-në nuk e parasheh identifikimin e personit fizik që mban një pozitë të lartë drejtuese nëse asnjë person tjetër fizik nuk është identifikuar pas zbatimit të të gjitha mjeteve të</p>	Në mospërputhje

⁹⁷ Direktiva 2013/34/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 26 qershor 2013 për pasqyrat financiare vjetore, pasqyrat financiare të konsoliduara dhe raportet përkatëse të llojeve të caktuara të ndërmarrjeve, e cila ndryshon Direktivën 2006/43/EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit dhe shfuqizon direktivat 78/660/EEC dhe 83/349/EEC të Këshillit (OJ L 182, 29.6.2013, f. 19).

Dispozitat e Direktivës (BE) 2015/849	Përshkrimi dhe Analiza e masave në Kosovë	Niveli i pajtueshmërisë
<p>dhe në këtë pikë;</p> <p>▼M1</p> <p>(b) në rastin e trusteve, të gjithë personat në vijim:</p> <p>(i) themeluesin(t) e trustit;</p> <p>(i) administratorin(ët) e besuar të trustit;</p> <p>(iii) mbrojtësin(t) e trustit, nëse ka;</p> <p>(iv) përfituesit ose, kur individët që përfitojnë nga marrëveshja juridike apo subjekti duhet të përcaktohen, kategoria e personave në interesin kryesor të të cilëve marrëveshja juridike apo subjekti është krijuar apo operon;</p> <p>(v) çdo person tjetër fizik që ushtron kontrollin përfundimtar mbi një trust përmes pronësisë së drejtpërdrejtë apo të tërthortë apo përmes mjeteve të tjera;</p> <p>▼B</p> <p>(c) në rastin e subjekteve juridike si fondacionet, dhe marrëveshjet juridike të ngjashme me trustet, personin(at) fizik(ë) që kanë pozita të barasvlershme apo të ngjashme me ato që janë cekur në shkronjën (b);</p>	<p>mundshme dhe me kusht që nuk ka bazë për dyshim.</p> <p>Në lidhje me shkronjën (b): Ligji për PPP/LFT-në nuk e kërkon identifikimin e personave në pikat (i) deri në (iii) dhe (v) dhe është i mangët në zbatimin e pikës (iv) pasi që e parasheh pragun (25%) për identifikim.</p> <p>Në Ligjin për PPP/LFT-në nuk parashihen kërkesa në raport me identifikimin e pronësisë përfituese në rastin e subjekteve juridike siç janë fondacionet dhe marrëveshjet juridike të ngjashme me trustet (siç është paraparë në shkronjën (c) të Direktivës).</p> <p>Duhet cekur se një legjislacion tjetër në Kosovë parasheh kërkesa shtesë (Rregullorja e BQK-së) por, siç është cekur nën sektorët përkatës në Shtojcën e PT-së kjo do të mbulonte vetëm disa nga subjektet raportuese dhe mund t'i nënshtrohet sfidimit juridik.</p>	
<p>(7) 'ofruet i shërbimeve për truste dhe kompani' do të thotë çdo person i cili, përmes biznesit të tij, ofron ndonjë prej shërbimeve në vijim për palë të treta:</p> <p>(a) veprojnë si agjent në krijimin e shoqërive tregtare apo të personave të tjerë juridikë;</p> <p>(b) veprojnë, ose marrin masa që një person tjetër të veprojë, si drejtor ose sekretar i një shoqërie tregtare, ortak në një ortakëri apo në pozicione të ngjashme në lidhje me persona të tjerë juridikë ;</p> <p>(c) ofrojnë zyrat qendrore, një adresë tregtare, postare ose administrative dhe shërbime të tjera të ndërlidhura për një shoqëri tregtare, një ortakëri ose një person juridik apo marrëveshje juridike tjetër;</p> <p>(d) veprojnë, ose marrin masa që një person tjetër të veprojë, si administrator i</p>	<p>Ju lutemi referojuni analizës nën nenin 2 të Direktivës.</p>	

Dispozitat e Direktivës (BE) 2015/849	Përshkrimi dhe Analiza e masave në Kosovë	Niveli i pajtueshmërisë
<p>besuar i një trusti ekspres apo të një marrëveshje të ngjashme juridike;</p> <p>(e) vepronë, ose marrin masa që një person tjetër të veprojë, si aksionar i emëruar për një person tjetër të ndryshëm nga një shoqëri tregtare të regjistruar në një treg të rregulluar e cila u nënshtrohet kërkesave për zbulim në pajtim me të drejtën e Unionit apo që iu nënshtrohet standardeve ndërkombëtare të barasvlershme;</p>		
<p>8. 'Marrëdhënie korresponduese' do të thotë:</p> <p>(a) ofrimi i shërbimeve bankare nga një bankë si korrespondente për një bankë tjetër si kliente, përfshirë ofrimin e shërbimeve të llogarisë rrjedhëse apo të një llogarie tjetër dhe të shërbimeve të ndërlidhura, si menaxhimin e parave të gatshme, transferimin ndërkombëtar të fondeve, kompensimin e çeqeve, llogarive të përkohshme për pagesa dhe shërbimeve të këmbimit;</p> <p>(b) marrëdhëniet në mes të dhe ndërmjet institucioneve kreditore dhe institucioneve financiare, përfshirë rastet kur ofrohen shërbime të ngjashme nga një institucion korrespondent për një institucion klient, dhe duke përfshirë marrëdhëniet e krijuara për transaksionet e letrave me vlerë apo transferimin e fondeve;</p>	<p>Ju lutemi referojuni Shtojcës së PT-së, R. 13.</p> <p>Përkufizimi i marrëdhënies korrespondente në nenin 1.23 të Ligjit për PPP/LFT-në kryesisht është në pajtim me përkufizimin e Direktivës. Ligji për PPP/LFT-në e kufizon zbatimin e shkronjës (b) vetëm për marrëdhëniet në mes të institucioneve financiare (p.sh. me sa duket jo kur janë të përfshira një bankë dhe një institucion financiar).</p>	Pjesërisht
<p>9. 'Person i ekspozuar politikisht' do të thotë personi fizik i cili mban ose i janë besuar funksione të larta publike ku përfshihen:</p> <p>(a) krerët e Shteteve, krerët e qeverive, ministrat dhe zëvendësministrat apo ndihmësministrat;</p> <p>(b) anëtarët e parlamentit apo të organeve të ngjashme legjislative;</p> <p>(c) anëtarët e organeve drejtuese të partive politike;</p> <p>(d) anëtarët e gjykatave supreme, gjykatave kushtetuese apo të organeve të tjera të larta gjyqësore, vendimet e të cilave nuk iu nënshtrohen apeleve të mëtutjeshme përpos, në rrethana të jashtëzakonshme;</p> <p>(e) anëtarët e gjykatave të llogarive apo të bordeve të bankave qendrore;</p> <p>(f) ambasadorët, të ngarkuarit me punë dhe oficerët e lartë të forcave të armatosura;</p> <p>(g) anëtarët e organeve administrative, menaxhuese apo mbikëqyrëse të ndërmarrjeve në pronësi shtetërore;</p>	<p>Ju lutemi referojuni Shtojcës së PT-së, R. 12.</p> <p>Përkufizimi është në pajtim të plotë me përkufizimin e Direktivës (BE) 2015/849. Përkufizimi në Ligjin për PPP/LFT-në i numëron të gjitha kategoritë e PEP-ëve por, me sa duket nuk përfshin (ose të paktën jo shprehimisht) personat e ndërlidhur (anëtarët e familjes dhe bashkëpunëtorët e ngushtë) si persona të ekspozuar politikisht në vetvete, gjë që mund të rezultojë në mangësi gjatë zbatimit të KDSH-së të paraparë me nenin 22 të Ligjit për PPP/LFT-në (shih më poshtë nën nenet 20-23 të Direktivës).</p>	Në përputhje

Dispozitat e Direktivës (BE) 2015/849	Përshkrimi dhe Analiza e masave në Kosovë	Niveli i pajtueshmërisë
<p>(h) drejtorët, zëvendësdrejtorët dhe anëtarët e bordit apo funksionet e barasvlershme të një organizate ndërkombëtare.</p> <p>Asnjë funksion publik i përmendur në shkronjat (a) deri në (h) nuk konsiderohet se mbulon zyrtarët e rangut të mesëm apo të ulët;</p> <p>(10) 'anëtarë të familjes' janë:</p> <p>(a) bashkëshorti(ja), apo një person që vlerësohet si i barasvlershëm me bashkëshortin(en), e një personi të ekspozuar politikisht;</p> <p>(b) fëmijët dhe bashkëshortët(et) e tyre, apo personat që konsiderohen si të barasvlershëm me bashkëshortin(en), e një personi të ekspozuar politikisht;</p> <p>(c) prindërit e një personi të ekspozuar politikisht;</p> <p>(11) 'persona që njihen si bashkëpunëtorë të ngushtë' do të thotë:</p> <p>(a) personat fizikë të cilët dihet se kanë pronësi përfituese të përbashkët të subjekteve apo marrëveshjeve juridike, apo çfarëdo marrëdhënie të tjetër të ngushtë biznesi, me një person të ekspozuar politikisht;</p> <p>(b) personat fizikë të cilët janë pronarët përfitues të vetëm të një subjekti juridik apo marrëveshjeve juridike i cili dihet se është krijuar për përfitimin <i>de facto</i> të personit të ekspozuar politikisht.</p>		
<p>(12) 'drejtues i lartë' do të thotë një zyrtar apo punonjës me njohuri të mjaftueshme për rrezikun e ekspozimit ndaj pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit të një institucioni dhe nivel të mjaftueshëm për të marrë vendime të cilat ndikojnë në ekspozimin ndaj rrezikut, dhe nuk nevojitet, në të gjitha rastet, të jetë anëtar i bordit të drejtorëve;</p>	Tërësisht në përputhje (neni 1.49 i Ligjit për PPP/LFT-në).	Në përputhje
<p>(13) 'marrëdhënie biznesi' do të thotë një marrëdhënie biznesi, profesionale apo tregtare e cila është lidhet me aktivitetet profesionale të një subjekti të detyruar dhe e cila pritet që, në kohën e vendosjes së kontaktit, të ketë një element të kohëzgjatjes;</p>	Tërësisht në përputhje (neni 1.22 i Ligjit për PPP/LFT-në).	Në përputhje
<p>(14) 'shërbime të lojërave të fatit' do të thotë një shërbim i cili përfshin vënien e një basti me vlerë monetare në lojërat e fatit, përfshirë ato me një element të shkathtësisë si lotaritë, lojërat e kazinove, lojërat e pokerit dhe transaksionet e basteve të cilat ofrohen në një lokal fizik, ose përmes çfarëdo mjeti në distancë,</p>	Nuk ka përkufizim korrespondues në ligjin e Kosovës. Ju lutemi shikoni më poshtë në lidhje me detyrimet përkatëse materiale për kazinotë dhe lojërat e fatit.	Nuk aplikohet

Dispozitat e Direktivës (BE) 2015/849	Përshkrimi dhe Analiza e masave në Kosovë	Niveli i pajtueshmërisë
përmes mjeteve elektronike apo çfarëdo teknologjie që e lehtëson komunikimin, dhe me kërkesë individuale nga pranuesi i shërbimeve;		
(15) 'grup' do të thotë një grup i ndërmarrjeve të cilat përbëhen nga një ndërmarrje mëmë, filialet e saj, dhe subjektet në të cilat ndërmarrja mëmë apo filialet e saj zotërojnë një pjesëmarrje, si edhe ndërmarrjet e lidhura me njëra-tjetrën nga një marrëdhënie në përputhje me kuptimin e nenit 22 të Direktivës 2013/34/EU;	Legjislacioni i Kosovës nuk ofron asnjë përkufizim për grupet. Për të drejtën materiale, shikoni më poshtë në dispozitat përkatëse.	Nuk aplikohet
▼M1 (16) 'para elektronike' do të thotë paratë elektronike sipas përkufizimit në nenin 2 paragrafi (2) të Direktivës 2009/110/EC, me përjashtim të vlerave monetare të cekura në nenin 1(4) dhe (5) të asaj Direktive;	Përkufizimi në nenin 2 të Rregullores për Instrumentet e Pagesave Elektronike është i zbatueshëm dhe në përputhje me përkufizimin e Direktivës.	Në përputhje
▼B (17) 'bankë guaskë' do të thotë një institucion kreditor apo financiar, apo një institucion që kryen aktivitete të barasvlershme me ato që kryhen nga institucionet kreditore apo financiare, e krijuar në një juridiksion në të cilin nuk ka prani fizike për të ushtruar drejtim dhe menaxhim domethënës dhe që nuk është e lidhur me ndonjë grup financiar të rregulluar;	Banka guaskë është përkufizuar në Ligjin për PPP/LFT-në (neni 1.7) si bankë apo institucion i angazhuar në aktivitete ekuivalente, i themeluar në një shtet ku nuk ka prezencë fizike, e cila e bën të mundur menaxhimin dhe drejtimin pa u shoqëruar me ndonjë grup financiar të rregulluar. Kjo në vija të trasha është në pajtim me Direktivën (edhe pse jo tërësisht në pajtim me standardin e FATF-së).	Në përputhje
▼M1 (18) 'valutë virtuale' do të thotë një përfaqësim digjital i vlerës që nuk është lëshuar apo garantuar nga një bankë qendrore apo autoritet publik, që jo domosdoshmërisht është e lidhur me një valutë të krijuar ligjërisht dhe që nuk e ka statusin juridik të valutës apo parasë, por që pranohet nga personat fizikë apo juridikë si mjet shkëmbimi dhe e cila mund të transferohet, depozitohet dhe tregtohet në mënyrë elektronike; (19) 'ofrues i shërbimeve të kuletës kujdestare' do të thotë një subjekt që ofron shërbime për të ruajtur çelësat privatë kriptografikë në emër të klientëve të tij, për të mbajtur, depozituar dhe transferuar valutat virtuale.	Përkufizimet nuk zbatohen në legjislacionin e Kosovës.	Nuk aplikohet
▼B Neni 4 1. Shtetet Anëtare, në pajtim me qasjen e bazuar në rrezik, sigurojnë që fushëveprimi i kësaj Direktive të shtrihet në tërësi apo pjesërisht te profesionet dhe kategoritë e	Ju lutemi referojuni Shtojcës së PT-së, R. 1, R. 8 si dhe RM 9 dhe 10. Autoritetet e Kosovës e kanë zgjeruar shtrirjen e Direktivës tek OJQ-të, të cilat janë të përfshira në nenin 16 të Legjislacionit për PPP/LFT-në si subjekte të detyruara.	Pjesërisht

Dispozitat e Direktivës (BE) 2015/849	Përshkrimi dhe Analiza e masave në Kosovë	Niveli i pajtueshmërisë
<p>ndërmarrjeve, jashtë subjekteve të detyruara të cekura në nenin 2(1), të cilat përfshihen në aktivitete që kanë gjasa të posaçme që të përdoren për qëllime të pastrimit të parave apo financimit të terrorizmit.</p> <p>2. Kur një Shtet Anëtar e zgjeron shtrirjen e kësaj Direktive të profesione apo kategori të ndërmarrjeve jashtë atyre që janë cekur në nenin 2(1), ai informon Komisionin për këtë.</p>	<p>Sidoqoftë, autoritetet e Kosovës nuk e kanë demonstruar qartë në këtë rast që QBRr-ja e ka nënvizuar vendimin për të përfshirë këtë kategori të subjekteve raportuese. As VKR-ja dhe as vlerësimet sektoriale të kryera nga autoritetet e Kosovës nuk kanë rezultuar në identifikimin e çfarëdo profesioni dhe kategorie tjetër që të përfshihen në shtrirjen e Ligjit për PPP/LFT-në përkundër rrezikut domethënës të ndërlidhur p.sh. sektori i ndërtimit. Mangësitë e identifikuar nën R. 1 do të vlenin edhe në raport me zbatimin e këtij neni të Direktivës. Paragrafi 2 i nenit 4 të Direktivës nuk është i zbatueshëm.</p>	
<p style="text-align: center;">Neni 5</p> <p>Shtetet Anëtare mund të miratojnë apo të mbajnë në fuqi dispozita më të rrepta në fushën e mbuluar nga kjo Direktivë për të parandaluar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit, në kuadër të kufizimeve të legjislacionit të Unionit.</p>	<p>Zbatimi është vërejtur aty ku është i ndërlidhur sipas dispozitave materiale të legjislacionit të Kosovës. Një nga shembujt e dalluar janë rrethanat kufizuese në të cilat KDK-ja e thjeshtuar lejohet.</p>	Nuk aplikohet
<p><i>SEKSIONI 2</i> Vlerësimi i rrezikut</p> <p style="text-align: center;">Neni 6</p> <p>[...]</p>	<p>Kjo dispozitë nuk është e zbatueshme në Kosovë, ndonëse mund të jetë një burim i rëndësishëm për informimin e VKR-së së Kosovës dhe QBRr-së të autoriteteve dhe subjekteve raportuese. Nuk ka shenja se vlerësimi i rrezikut mbikombëtar është marrë në konsideratë nga autoritetet e Kosovës deri tani.</p>	Nuk aplikohet
<p style="text-align: center;">Neni 7</p> <p>1. Secili Shtet Anëtar ndërmerr masat e duhura për të identifikuar, vlerësuar, kuptuar dhe zbutur rrezikun e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit që e prek atë, si dhe çdo shqetësim për mbrojtjen e të dhënave në lidhje me këtë. Ai e mban të përditësuar këtë vlerësim të rrezikut.</p>	<p>Ju lutemi referojuni Shtojcës së PT-së, R. 1.1-1.9 si dhe RM 1.</p> <p>Autoritetet e Kosovës kanë ndërmarrë masa për të zbatuar këtë dispozitë të Direktivës përmes kërkesës së nenit 18, paragrafi 1 të Ligjit për PPP/LFT-në. Dispozita e përmendur parasheh identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve si dhe rekomandime për masat zbutëse. Rregullimi i mëtutjeshëm i çështjeve të lidhura me VKR-në duhet të zbatohet përmes akteve nënligjore të Ministrisë së Financave. Janë identifikuar mangësi metodologjike, vonesa në zbatimin e vlerësimit të rrezikut, përfshirë vlerësimin sektorial të rrezikut, si dhe mungesa e kërkesave të qarta në lidhje me miratimin e masave zbutëse, ndarjen e burimeve në bazë të rrezikut të identifikuar dhe shpërndarjen e rezultateve të vlerësimit të rrezikut. Për më tepër, nuk ka kërkesa për</p>	Pjesërisht

Dispozitat e Direktivës (BE) 2015/849	Përshkrimi dhe Analiza e masave në Kosovë	Niveli i pajtueshmërisë
	<p>subjektet e detyruara që të marrin parasysh VKR-në me rastin e përcaktimit të rreziqeve ndaj të cilave ato janë të ekspozuara përmes vlerësimit të tyre në pajtim me nenin 18 të Ligjit për PPP/LFT-në.</p> <p>Siç është diskutuar nën RM 1, autoritetet e Kosovës i kanë zhvilluar një sërë mjetesh dhe mekanizmash për të vlerësuar rreziqet nga këndvështrimi tërësor si dhe sektorial, por ato nuk i mbulojnë të gjitha aspektet dhe nuk përdoren në një mënyrë koherente dhe të integruar. Ndikimi i raportit të VKR-së së Kosovës i vitit 2013 është i kufizuar nga mangësi metodologjike si dhe praktike dhe nga mungesa e përditësimeve të mjaftueshme. Po ashtu, nuk janë theksuar mjaftueshëm çështjet që kanë të bëjnë me FT-në goftë në vlerësimet e VKR-së apo ato sektoriale. Çështjet e privatësisë së të dhënave nuk janë marrë në konsideratë në mënyrë specifike në ndonjërin prej vlerësimeve. Autoritetet e Kosovës kanë zbatuar mekanizma të gjerë për të bashkërenduar masat zbutëse, por ende mbesin disa çështje me zhvillimin dhe zbatimin e strategjive të mjaftueshme dhe planeve të veprimit.</p>	
<p>2. Secili Shtet Anëtar cakton një autoritet apo krijon një mekanizëm me të cilin bashkërendohet përgjigja kombëtare ndaj rreziqeve të cekura në paragrafin 1. Identiteti i atij autoriteti apo përshkrimi i mekanizmit i njoftohet Komisionit, AME-ve dhe Shteteve të tjera Anëtare.</p>	<p>Ju lutemi referojuni Shtojcës së PT-së, R. 1.1-1.9 si dhe RM 1.</p> <p>Neni 18 i Ligjit për PPP/LFT-në e parasheh rolin e NjIF-it por, pa i specifikuar më tej kërkesat për përgjigjen kombëtare ndaj rreziqeve (p.sh. ndërmarrjen e veprimeve zbutëse, shpërndarjen e informacionit, etj.).</p>	Pjesërisht
<p>3. Për kryerjen e vlerësimeve të rrezikut të cekura në paragrafin 1 të këtij neni, Shtetet Anëtare shfrytëzojnë gjetjet e raportit të cekur në nenin 6(1).</p>	<p>Ky nuk është i zbatueshëm në Kosovë, ndonëse mund të jetë një burim i rëndësishëm për informimin e VKR-së së Kosovës dhe QBRr-së së autoriteteve dhe subjekteve raportuese. Nuk ka shenja se vlerësimi i rrezikut mbikombëtar është marrë në konsideratë nga autoritetet e Kosovës deri tani.</p>	Në mospërputhje
<p>4. Në lidhje me vlerësimin e rrezikut të cekur në paragrafin 1, secili Shtet Anëtar:</p> <p>(a) përdor këtë vlerësim për të përmirësuar regjimin e vet për PPP/LFT-në, veçanërisht duke identifikuar fushat e mundshme në të cilat subjektet e detyruara duhet të zbatojnë masa të shtuara dhe, sipas rastit, të specifikojnë masat që duhet të</p>	<p>Ju lutemi referojuni Shtojcës së PT-së, R. 1.1-1.9 si dhe RM 1.</p> <p>Përkundër mungesës së kërkesave të qarta në ligjin e Kosovës dhe mekanizmave për zbatimin e këtyre dispozitave, autoritetet e Kosovës e kanë përdorur VKR-</p>	Pjesërisht

Dispozitat e Direktivës (BE) 2015/849	Përshkrimi dhe Analiza e masave në Kosovë	Niveli i pajtueshmërisë
<p>ndërmerren;</p> <p>(b) identifikon, sipas rastit, sektorët apo fushat me rrezik më të ulët apo më të lartë për pastrim të parave dhe financim të terrorizmit;</p> <p>(c) përdor këtë vlerësim si ndihmë në ndarjen dhe caktimin e prioriteteve të burimeve për të luftuar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit;</p> <p>(d) përdor këtë vlerësim për të siguruar hartimin e rregullave të duhura për secilin sektor apo fushë, në pajtim me rreziqet e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;</p> <p>(e) vendos menjëherë në dispozicion informacionin e përshtatshëm për subjektet e detyruara që të lehtësojë kryerjen e vlerësimeve të tyre për rrezikun e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;</p> <p>▼M1</p> <p>(f) raporton strukturën institucionale dhe procedurat e përgjithshme të regjimit të tij për PPP/LFT-në, duke përfshirë, në mes të tjerash, NjIF-in, autoritetet tatimore dhe prokurorët, si dhe burimet e ndara njerëzore dhe financiare deri në atë shkallë sa ky informacion është i disponueshëm;</p> <p>(g) raporton mbi përpjekjet dhe burimet kombëtare (fuqinë punëtore dhe buxhetin) të ndara për të luftuar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit.</p>	<p>në dhe vlerësimet e ndryshme sektoriale si bazë për zhvillimin e strategjisë, ndryshimin e politikës, identifikimin (e kufizuar) të disa sektorëve me rrezik më të lartë, përshtatjen e pjeseshme të burimeve. Gjithsesi, zbatimi i këtyre dispozitave kufizohet nga mungesa e dispozitave specifike që subjektet raportuese të marrin parasysh rezultatet e VKR-së si dhe nga mungesa e çfarëdo kërkesë korresponduese që autoritetet të marrin plotësisht parasysh vlerësimin e rrezikut për zbatimin e ndryshimeve të rëndësishme në zbatimin e masave nga subjektet raportuese.</p>	
<p>5. Shtetet Anëtare vënë në dispozicion të Komisionit, AME-ve dhe Shteteve të tjera Anëtare rezultatet e vlerësimeve të tyre të rrezikut, përfshirë edhe përditësimet e tyre. Shtetet e tjera Anëtare mund të ofrojnë informata shtesë përkatëse, sipas rastit, për Shtetin Anëtar që është duke e zhvilluar vlerësimin e rrezikut. Një përmbledhje e vlerësimit bëhet e qasshme për publikun. Kjo përmbledhje nuk përmban informacion të klasifikuar.</p>	<p>Ligji i Kosovës nuk ka kërkesa për ta bërë një përmbledhje të VKR-së të qasshme për publikun (ndonëse kjo bëhet në praktikë dhe në baza <i>ad hoc</i>).</p>	<p>Nuk aplikohet. dhe pjesërisht</p>
<p>▼B</p> <p style="text-align: center;">Neni 8</p> <p>1. Shtetet Anëtare sigurojnë që subjektet e detyruara të ndërmarrin masat e duhura për të identifikuar dhe vlerësuar rrezikun e pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit, duke marrë parasysh faktorët e rrezikut, përfshirë ata që kanë të bëjnë</p>	<p>Ju lutemi referojuni Shtojcës së PT-së, R. 1.10-1.12 si dhe RM 1.</p> <p>Dispozita e Direktivës zbatohet në Kosovë përmes nenit 18 të Ligjit për PPP/LFT-në. Paragrafi 2 i këtij neni ua kërkon subjekteve të detyruara që në mënyrë periodike të përcaktojnë rrezikun ndaj të cilit janë të ekspozuara duke i pasur parasysh shërbimet e tyre, produktet,</p>	<p>Pjesërisht</p>

Dispozitat e Direktivës (BE) 2015/849	Përshkrimi dhe Analiza e masave në Kosovë	Niveli i pajtueshmërisë
<p>me klientët e tyre, shtetet apo zonat gjeografike, produktet, shërbimet, transaksionet apo kanalet e dorëzimit. Këto masa janë në përpjesëtim me natyrën dhe madhësinë e subjekteve të detyruara.</p>	<p>vendndodhjen gjeografike dhe mekanizmat e kanalet e shpërndarjes. Mund të konsiderohet se dispozita vetëm pjesërisht e siguron ndërmarrjen e hapave të duhur pasi që nuk ka kërkesa përkatëse për vlerësimin e përgjithshëm të rrezikut të subjekteve të detyruara, nuk ka periudha të specifikuara për vlerësimin e rrezikut, posaçërisht duke e marrë parasysh rrezikun e përgjithshëm të përcaktuar, si dhe nuk ka asnjë mekanizëm për t'u siguruar se rezultatet e vlerësimit kombëtar dhe sektorial të rrezikut janë të pasqyruara si duhet në vlerësimin e kryer nga subjektet e detyruara. Nuk ka kërkesa që hapat e ndërmarra nga subjektet e detyruara të jenë në përpjesëtim me natyrën dhe madhësinë e subjekteve.</p>	
<p>2. Vlerësimet e rrezikut të cekura në paragrafin 1 dokumentohen, përditësohen dhe vihen në dispozicion të autoriteteve kompetente dhe organeve vetërregulluese përkatëse. Autoritetet kompetente mund të vendosin që vlerësime të caktuara të dokumentuara të rrezikut nuk janë të nevojshme kur rreziku specifik i natyrshëm në një sektor është i qartë dhe kuptohet.</p>	<p>Ju lutemi referojuni Shtojcës së PT-së, R. 1.10-1.12 si dhe RM 1. Nuk ka kërkesë të qartë për dokumentimin e vlerësimit të rrezikut të subjekteve të detyruara. Përditësimi i rregullt kërkohet nga neni 18 i Ligjit për PPP/LFT-në, por nuk ka kërkesa të tjera për përditësime, p.sh. në bazë të nivelit të përgjithshëm të rrezikut apo zhvillimeve domethënëse të tregut. Vlerësimet e rrezikut duhet të vihen vetëm në dispozicion të NjIF-it, dhe kur është e rëndësishme, edhe të BQK-së, por jo të mbikëqyrësve të tjerë apo organeve vetërregulluese (ndonëse, këta të fundit mund të jenë të parëndësishëm duke pasur parasysh mungesën e ndonjë roli të përcaktuar ligjërisht për këto organe në fushën e PPP/LFT-së, ju lutemi shikoni R. 23.1 të Shtojcës së PT-së). Në legjislacion nuk parashihen mundësi të qarta për përjashtime për vlerësimet e rrezikut në sektorë të caktuar.</p>	Pjesërisht
<p>3. Shtetet Anëtare sigurojnë që subjektet e detyruara të kenë politika, kontrolle dhe procedura për të zbutur dhe menaxhuar efektivisht rreziqet e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit të identifikuar në nivelin e Unionit, Shtetit Anëtar dhe subjektit të detyruar. Këto politika, kontrolle dhe procedura janë në përpjesëtim me natyrën dhe madhësinë e subjekteve të detyruara. 4. Politikat, kontrollet dhe procedurat e përmendura në paragrafin 3 përfshijnë:</p>	<p>Ju lutemi referojuni Shtojcës së PT-së, R. 1.10-1.12 si dhe RM 1. Politikat, kontrollet dhe procedurat e kërkuara nga neni 17 i Ligjit për PPP/LFT-në parashohin një numër të politikave të brendshme dhe të procedurave të parapara me paragrafin 4 të nenit 8 të Direktivës, por ato nuk e përfshijnë në mënyrë të qartë menaxhimin e rreziqeve</p>	Pjesërisht

Dispozitat e Direktivës (BE) 2015/849	Përshkrimi dhe Analiza e masave në Kosovë	Niveli i pajtueshmërisë
<p>(a) zhvillimin e politikave, kontrolleve dhe procedurave të brendshme, përfshirë praktikën e modeleve të menaxhimit të rrezikut, kujdesin e duhur ndaj klientit, raportimin, ruajtjen e të dhënave, kontrollin e brendshëm, menaxhimin e pajtueshmërisë, përfshirë kur është e përshtatshme në pajtim me madhësinë dhe natyrën e biznesit emërimin e një zyrtari për pajtueshmëri në nivelin menaxhues dhe kontrollin e përzgjedhjes së punonjësve;</p> <p>(b) kur është e përshtatshme në pajtim me madhësinë dhe natyrën e biznesit, një funksion të auditimit të pavarur për të testuar politikën, kontrollet dhe procedurat e brendshme të cekura në shkronjën (a).</p>	<p>dhe kontrollin e punonjësve. Rregullorja e BQK-së për PPP/LFT-në i parasheh kërkesat për përcaktimin e politikave të rrezikut në lidhje me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit, përfshirë pranimin dhe menaxhimin e rrezikut. Kërkesat për përshtatshmërinë dhe përputhjen e punonjësve po ashtu parashihen në Rregulloren e BQK-së për PPP/LFT-në. Të dyja këto kërkesa në Rregulloren e BQK-së vlejné për bankat dhe institucionet financiare, por jo për kategoritë e tjera të subjekteve raportuese.</p> <p>Neni 21 i parasheh kërkesat për funksionin e pajtueshmërisë, duke përfshirë zyrtarin e pajtueshmërisë në nivelin e drejtimit të lartë (për bankat). Nuk ka kërkesa specifike në ligj dhe mekanizma të qartë për ofrimin e VKR-së për subjektet e detyruara, ka mangësi në analizat e rrezikut të zhvilluara në nivelin kombëtar (ju lutemi shikoni RM 1), si dhe asnjë detyrim ligjor apo mekanizëm për të marrë në konsideratë vlerësimin mbikombëtar të rrezikut të BE-së.</p> <p>Nuk ka asnjë mekanizëm të përgjithshëm për t'u siguruar që politikën e brendshme, kontrollet dhe procedurat të jenë të përshtatura me natyrën dhe madhësinë, ndonëse kërkesat e nenit 17 dhe 21 të Ligjit për PPP/LFT-në i marrin parasysh në një masë të kufizuar karakteristikat e ndryshme të kategorive të subjekteve raportuese (posaçërisht bankave dhe institucioneve financiare në njërin anë dhe kategorive të tjera të subjekteve të detyruara, në anën tjetër, numrin e personelit, etj.). Rregullorja e BQK-së e merr parasysh natyrën dhe madhësinë e subjekteve të detyruara.</p>	
<p>5. Shtetet Anëtare u kërkojnë subjekteve të detyruara miratimin nga drejtuesi i lartë për politika, kontrolle dhe procedura që ato krijojnë dhe monitorimin dhe shtimin e masave të ndërmarra, kur kjo është e përshtatshme.</p>	<p>Ju lutemi referojuni Shtojcës së PT-së, R. 1.10-1.12 si dhe RM 1.</p> <p>Legjislacioni i Kosovës nuk ka kërkesa për miratim nga drejtuesi i lartë për politika, kontrolle dhe procedura.</p>	<p>Në mospërputhje</p>
<p>SEKSIONI 3 Politika për vendet e treta</p> <p style="text-align: center;">Neni 9</p>	<p>Nuk aplikohet</p>	<p>Nuk aplikohet</p>

Dispozitat e Direktivës (BE) 2015/849	Përshkrimi dhe Analiza e masave në Kosovë	Niveli i pajtueshmërisë
[...]		
<p>KAPITULLI II KUJDESI I DUHUR NDAJ KLIENTIT</p> <p><i>SEKSIONI 1</i> Dispozita të përgjithshme</p> <p style="text-align: center;">Neni 10</p> <p>▼M1</p> <p>1. Shtetet Anëtare u ndalojnë institucioneve të tyre kreditore dhe financiare të mbajnë llogari anonime, librezave anonime të kursimit apo kasaforta anonime. Në çdo rast, ata kërkojnë që pronarët dhe përfituesit e llogarive anonime, librezave anonime të kursimit apo kasafortave anonime ekzistuese t'u nënshtrohen masave të kujdesit të duhur ndaj klientit jo më vonë se më 10 janar 2019 dhe sidoqoftë, përpara se këta llogari, librezave të kursimeve dhe kasaforta të përdoren në çfarëdo mënyre.</p>	<p>Ju lutemi referojuni Shtojcës së PT-së, R. 10.1, 10.2, 10.4 dhe 10.16.</p> <p>Llogaritë anonime ndalohen nga neni 24, paragrafi 1 i Ligjit për PPP/LFT-në. Nuk ka kërkesa të qarta për kasafortat, ndonëse identifikimi dhe verifikimi i identitetit dhe datës së lindjes me rastin e dhënies së objekteve kasaforta kërkohen në pajtim me paragrafin 2 të nenit 19 dhe paragrafin 2 të nenit 24 të të njëjtit ligj. Mangësitë në raport me identifikimin dhe verifikimin e personave që pretendojnë se veprojnë në emër të klientit, po ashtu do të ishin dëmtuese ndaj identifikimit dhe verifikimit të përfituesve, përkundër kërkesës së përgjithshme të paragrafit 8 të nenit 19 të Ligjit për PPP/LFT-në (që gjithashtu nuk i referohet verifikimit) (Ju lutemi shihni R. 10.4 në Shtojcën e PT-së, nuk ka kërkesa të qarta për të identifikuar personat që pretendojnë se veprojnë në emër të klientit).</p>	Pjesërisht
<p>▼B</p> <p>2. Shtetet Anëtare ndërmarrin masa për të parandaluar keqpërdorimin e aksioneve të bartësit dhe garancive të aksioneve të bartësit.</p>	<p>Ju lutemi referojuni Shtojcës së PT-së, R. 24.11.</p> <p>Aksionet e bartësit duke se janë të ndaluara por, nuk ka asnjë masë kundër garancive të aksioneve të bartësit.</p>	Pjesërisht
<p style="text-align: center;">Neni 11</p> <p>Shtetet Anëtare sigurojnë që subjektet e detyruara të zbatojnë masat e kujdesit të duhur ndaj klientit në rrethanat në vijim:</p> <p>(a) kur krijojnë një marrëdhënie biznesi;</p> <p>(b) kur kryejnë një transaksion të rastit i cili:</p> <p>(i) është me vlerë prej 15.000 euro apo më shumë, nëse ai transaksion kryhet në një operacion të vetëm apo në disa operacione që duken se janë të ndërlidhura; apo</p>	<p>Ju lutemi referojuni Shtojcës së PT-së, R. 10.2, 16.1, 22.1. Ju lutemi shih gjithashtu RM 4 (Çështjen Thelbësore 4.2).</p> <p>Dispozita përkatëse e Ligjit për PPP/LFT-në për të gjitha institucionet është neni 19, paragrafi 2. Ligji për PPP/LFT-në nuk është në përputhje me Direktivën në raport me KDK-në që kërkohet për transaksionet e rastit pasi që nuk ka qartësi mbi përkufizimin e transaksioneve të ndërlidhura që e arrijnë pragun dhe me sa duket nuk ka kërkesë për KDK të plotë për të gjitha transaksionet e rastit sipër pragut (vetëm për transaksionet me para në</p>	Pjesërisht

Dispozitat e Direktivës (BE) 2015/849	Përshkrimi dhe Analiza e masave në Kosovë	Niveli i pajtueshmërisë
<p>(ii) përbën një transferim të fondeve, siç është përkufizuar në nenin 3 paragrafi (9) të Rregullores (BE) 2015/847 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit ⁽⁹⁸⁾, që e tejkalon vlerën prej 1.000 euro.</p> <p>(e) në rastin kur personat që tregtojnë mallra, kryejnë transaksione të rastit me para të gatshme në vlerën prej 10.000 euro apo më shumë, nëse transaksioni kryhet në një operacion të vetëm apo në disa operacione që duken se janë të ndërlidhura;</p> <p>(d) në rastin kur ofruesit e shërbimeve të lojërave të fatit, me rastin e mbledhjes së fitimeve, vendosjes së një basti, apo në të dyja rastet, kryejnë transaksione në vlerën prej 2.000 euro apo më shumë, nëse transaksioni kryhet në një operacion të vetëm apo në disa operacione që duken se janë të ndërlidhura;</p> <p>(e) kur ka dyshim për pastrim të parave apo financim të terrorizmit, pavarësisht nga ndonjë shmangie nga rregulli, përjashtim apo prag;</p> <p>(f) kur ekzistojnë dyshime për vërtetësinë ose saktësinë e të dhënave identifikuese të klientit të marra më herët.</p>	<p>dorë).</p> <p>Për transfertat elektronike, Ligji për PPP/LFT-në nuk kërkon që të kryhet KDK-ja e plotë. Në rastin e bankave dhe institucioneve financiare, masat e KDK-së (të kufizuar) për transfertat elektronike kërkojnë vetëm në raport me bankat (në krahasim me bankat dhe institucionet financiare).</p> <p>Për kazinotë, duke i përfshirë kazinotë në internet dhe objektet e licencuara të lojërave të fatit (të cilat janë më të ngushta se sa shtrirja e shërbimeve të lojërave të fatit të cilat kërkojnë nga Direktiva që të përfshihen si subjekte të detyruara, ju lutemi referojuni diskutimit nën nenin 2, paragrafin 2 të Direktivës), nuk kërkohet KDK-ja e plotë në raport me transaksionin sipër pragut (2.000 euro) (në krahasim me identifikimin dhe verifikimin).</p> <p>Nuk është e qartë nëse tregtarët e metaleve dhe gurëve të çmuar do të ishin subjekte të detyruara në të gjitha situatat (p.sh. Ligji për PPP/LFT-në u referohet vetëm shitësve të metaleve dhe gurëve të çmuar duke lënë hapësirë për interpretim dhe për t'i sfiduar juridikisht). Në raport me profesionistët ligjorë, kontabilistët dhe ofruesit e shërbimeve për truste dhe kompani, kufizimet e diskutuara nën përkufizimet e nenit 3 të Direktivës do të ishin të zbatueshme.</p> <p>Zbatimi i masave të KDK-së në praktikë ndikohet negativisht kryesisht nga mungesa e të kuptuarit të pronësisë përfituese dhe mungesa e zbatimit të masave të KDK-së në praktikë nga pothuajse të gjithë IFJB-të pa marrë parasysh rrezikun.</p>	
<p style="text-align: center;">Neni 12</p> <p>1. Pavarësisht nga neni 13(1) nënparagrafi i parë shkronjat (a), (b) dhe (c) dhe neni (14) dhe në bazë të një vlerësimi të përshtatshëm të rrezikut i cili demonstroi rrezik të ulët, një Shtet Anëtar mund t'i lejojë subjektet e detyruara që të mos i zbatojnë</p>	<p>Autoritetet e Kosovës nuk kanë paraparë asnjë rregullore dhe zbutje në raport me masat e PPP/LFT-së së zbatueshme për paratë elektronike. Prandaj, kërkesat e përgjithshme të Ligjit për PPP/LFT-në do të ishin të zbatueshme, duke përfshirë pragjet më të larta për</p>	<p>Në mospërputhje</p>

⁹⁸ Rregullorja (BE) 2015/847 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 20 maj 2015 për informacionin që shoqëron transfertat e fondeve, e cila shfuqizon Rregulloren (EC) nr. 1781/2006 (shih faqen 1 të kësaj Fletore Zyrtare).

Dispozitat e Direktivës (BE) 2015/849	Përshkrimi dhe Analiza e masave në Kosovë	Niveli i pajtueshmërisë
<p>disa masa të kujdesit të duhur ndaj klientit në lidhje me paratë elektronike, kur përmbushen të gjitha kushtet për zbutjen e rrezikut në vijim:</p> <p>▼M1</p> <p>(a) instrumenti i pagesës nuk është i lexueshëm, ose ka një kufi mujor maksimal prej 150 euro, i cili mund të shfrytëzohet vetëm në atë Shtet Anëtar;</p> <p>(b) shumat maksimale të depozituar elektronikisht nuk e tejkalojnë vlerën prej 150 euro;</p> <p>▼B</p> <p>(c) instrumenti i pagesës përdoret vetëm për të blerë mallra apo shërbime;</p> <p>(d) instrumenti i pagesës nuk mund të financohet me para elektronike anonime;</p> <p>(e) emetuesi kryen monitorim të mjaftueshëm të transaksioneve apo marrëdhënieve të biznesit për të mundësuar zbulimin e transaksioneve të pazakonshme apo të dyshimta.</p> <p>▼M1 —————</p> <p>2. Shtetet Anëtare sigurojnë që përjashtimi i paraparë në paragrafin 1 të këtij neni nuk është i zbatueshëm në rastin e rikthimit të parave të gatshme apo tërheqjes së parave të gatshme në vlerën e parave elektronike kur vlera e rikthyer e tejkalon shumën 50 euro, apo në rastin e transaksioneve të pagesave në distancë siç janë përkufizuar në nenin 4 paragrafi (6) të Direktivës (BE) 2015/2366 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit ⁽⁹⁹⁾ kur vlera e shumës së paguar i tejkalon 50 euro për transaksion.</p> <p>▼M1</p> <p>3. Shtetet Anëtare sigurojnë që institucionet kreditore dhe financiare që veprojnë si blerës të pranojnë vetëm pagesa të kryera me kartela të parapaguara anonime të lëshuara në vendet e treta kur këto kartela i plotësojnë kërkesat e barasvlershme me ato të përcaktuara në paragrafët 1 dhe 2.</p>	<p>transaksionet e rastit. Ngjashëm, mangësitë p.sh. në raport me mungesën e kërkesës për KDK-në në lidhje me transfertat elektronike, do të vlenin (duke përfshirë mangësitë në lidhje me transaksionet e rastit, mungesën e monitorimit, etj.). Nuk është paraparë asnjë kufizim në raport me përdorimin e kartelave anonime të parapaguara të lëshuara jashtë Kosovës (paragrafi 3 i nenit 12 të Direktivës). Të gjitha këto kontribuojnë në një rrezik domethënës. Po ashtu, vërehet se nuk është paraparë asnjë zbutje në Direktivë në lidhje me monitorimin dhe burimin e fondeve, përderisa pragjet e kërkesave të përgjithshme të KDK-së në Ligjin e Kosovës për PPP/LFT-në nuk do të kërkonin monitorim të tillë në praktikë.</p>	

⁹⁹ Direktiva (BE) 2015/2366 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 25 nëntor 2015 për shërbimet e pagesës në tregun e brendshëm, e cila ndryshon direktivat 2002/65/EC, 2009/110/EC dhe 2013/36/EC dhe Rregulloren (EU) nr. 1093/2010, dhe shfuqizon Direktivën 2007/64/EC (OJ L 337, 23.12.2015, f. 35).

Dispozitat e Direktivës (BE) 2015/849	Përshkrimi dhe Analiza e masave në Kosovë	Niveli i pajtueshmërisë
Shtetet Anëtare mund të vendosin që të mos i pranojnë në territorin e tyre pagesat e kryera me kartela të parapaguara anonime.		
<p>▼B</p> <p style="text-align: center;">Neni 13</p> <p>1. Masat e kujdesit të duhur përfshijnë:</p> <p>▼M1</p> <p>(a) identifikimin e klientit dhe verifikimin e identitetit të klientit në bazë të dokumenteve, të dhënave apo informatave të siguruar nga një burim i besueshëm dhe i pavarur, përfshirë, kur është e mundur, mjetet e identifikimit elektronik, shërbimet përkatëse të besimit të përcaktuara në Rregulloren (BE) nr. 910/2014 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit ⁽¹⁰⁰⁾ apo çdo proces tjetër të identifikimit të sigurt, në distancë apo elektronik të rregulluar, të njohur, të miratuar apo të pranuar nga autoritetet përkatëse kombëtare;</p>	<p>Ju lutemi referojuni Shtojcës së PT-së, R. 10.3 22.1. Ju lutemi shihni gjithashtu RM 4 (Çështjen Thelbësore 4.2). Kërkesat e legjislacionit të Kosovës për identifikimin dhe verifikimin e identitetit të klientit janë në pajtim me Direktivën përpos mundësisë për t'u mbështetur në mjetet e identifikimit elektronik që janë paraparë nën shkronjën (a). Neni 22, paragrafi 3.3 i Ligjit për PPP/LFT-në parasheh përdorimin e masave elektronike për të krijuar nënshkrime elektronike si masa zbutëse në lidhje me rreziqet më të larta gjatë krijimit të marrëdhënieve pa praninë fizike të klientit dhe për t'u siguruar që kërkesat për identifikim dhe KDK janë përmbushur. Kjo metodë e identifikimit nuk mund të konsiderohet se ofron nivelin e njëjtë të sigurisë sikurse mjetet e identifikimit elektronik të cekura në Direktivë pa asnjë specifikim të mëtutjeshëm mbi masat për të siguruar garancitë e duhura për rrezikun e lidhur me natyrën jo ballë për ballë të procesit të pranimit. Për më tepër, dispozita e Ligjit i referohet jo vetëm identifikimit dhe verifikimit por, edhe të gjitha kërkesave të tjera të KDK-së të cilat nuk janë cekur në dispozitën përkatëse të Direktivës. Zbatimi i masave të KDK-së në përgjithësi ndikohet negativisht kryesisht nga mungesa e të kuptuarit të pronësisë përfitueses dhe mungesa e zbatimit të masave të KDK-së në praktikë nga pothuajse të gjithë IFJB-të pa marrë parasysh rrezikun.</p>	Pjesërisht
<p>▼B</p> <p>(b) identifikimin e pronarit përfitues dhe marrjen e masave të arsyeshme për të verifikuar identitetin e atij personi në mënyrë që subjekti i detyruar të sigurohet për dijeninë se kush është pronari përfitues, përfshirë, në raport me personat juridikë, trustet, shoqëritë tregtare, fondacionet dhe marrëveshjet e ngjashme juridike,</p>	<p>Ju lutemi referojuni Shtojcës së PT-së, R. 10.5, 10.10, 10.11 dhe 22.1. Mangësitë e identifikuar në raport me përkufizimin e pronarit përfitues do të vlenin (ju lutemi shikoni më sipër nën nenin 3 të Direktivës). Për më tepër, verifikimi do të kërkohej (në pajtim me nenin 19, paragrafin 1.2 të Ligjit</p>	Pjesërisht

¹⁰⁰ Rregullorja (BE) nr. 910/2014 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 23 korrik 2014 për identifikimin elektronik dhe shërbimet e trustit për transaksionet elektronike në tregun e brendshëm, e cila shfuqizon Direktivën 1999/93/EC (OJ L 257, 28.8.2014, f. 73).

Dispozitat e Direktivës (BE) 2015/849	Përshkrimi dhe Analiza e masave në Kosovë	Niveli i pajtueshmërisë
<p>marrjen e masave të arsyeshme për të kuptuar strukturën e pronësisë dhe kontrollin e klientit. ►M1 Kur pronari përfitues i identifikuar është zyrtari i lartë drejtues siç është cekur në nenin 3(6)(a) (ii), subjektet e detyruara marrin masat e nevojshme të arsyeshme për të verifikuar identitetin e personit fizik i cili mban pozitën e zyrtarit të lartë drejtues dhe ruajnë informatat e veprimeve të ndërmarra si dhe të çdo vështirësie të hasur gjatë procesit të verifikimit; ◀</p>	<p>për PPP/LFT-në) vetëm në rast të situatave me rrezikshmëri të lartë dhe nuk ka kërkesa për përdorimin e burimeve të besueshme dhe të pavarura. Në lidhje me personat juridikë, kompanitë, fondacionet dhe marrëveshjet e ngjashme juridike, kërkesa për të marrë masa të arsyeshme për të kuptuar pronësinë dhe strukturën e kontrollit të klientit nuk plotësohet pasi që Ligji për PPP/LFT-në kërkon që këto masa të zbatohen sërish vetëm në situatat me rrezikshmëri të lartë. Nuk ka detyrim për të siguruar informata mbi zyrtarin e lartë menaxhues në rast se asnjë person fizik nuk identifikohet si pronar përfitues, prandaj nuk janë vendosur kërkesa shtesë në lidhje me këtë.</p>	
<p>(c) vlerësimin dhe, sipas nevojës, sigurimin e informatave mbi qëllimin dhe natyrën e synuar të marrëdhënies së biznesit;</p>	<p>Ju lutemi referojuni Shtojcës së PT-së, R. 10.6 dhe 22.1. Kërkesa e nenit 19, paragrafi 1.3 kërkon sigurimin e informacionit të nevojshëm në të gjitha rastet dhe konsiderohet në përputhje me Direktivën.</p>	Në përputhje
<p>(d) zhvillimin e monitorimit të vazhdueshëm të marrëdhënies së biznesit, përfshirë shqyrtimin e transaksioneve të ndërmarra gjatë tërë marrëdhënies për t'u siguruar që transaksionet e zhvilluara të jenë në përputhje me njohjen nga subjekti i detyruar të klientit, aktiviteteve të biznesit dhe profilit të tij të rrezikut, duke përfshirë kur kjo është e nevojshme prejardhjen e fondeve dhe duke u siguruar që dokumentet, të dhënat apo informacioni janë të përditësuar.</p>	<p>Ju lutemi referojuni Shtojcës së PT-së, R. 10.7 dhe 22.1. Mangësitë e vërejtura nën Rekomandimet e sipërpërmendura të FATF-së nuk do të vlenin (specifikisht "relevanca" e informacionit dhe "rishikimi i regjistrave ekzistues"). Formulimi i njëjtë i dokumenteve, të dhënave apo informacionit të përditësuar përdoret në nenin 19 të Ligjit për PPP/LFT-në.</p>	Në përputhje
<p>Kur zbatohen masat e cekura në shkronjat (a) dhe (b) të nënparagrafit të parë, subjektet e detyruara gjithashtu verifikojnë se çdo person që synon të kryejë një akt në emër të klientit është i autorizuar ta bëjë këtë dhe identifikojnë dhe verifikojnë identitetin e atij personi.</p>	<p>Ju lutemi referojuni Shtojcës së PT-së, R. 10.4 dhe 22.1. Ka mangësi në kërkesat për të identifikuar personat që synojnë të kryejnë një veprim në emër të klientit, të cilat lidhen kryesisht me dokumentet për identifikimin e subjekteve juridike të cilat nuk do të përfshinin marrëveshjet juridike dhe subjektet e tjera përpos organizatat e biznesit, OJQ-të dhe subjektet politike. Përtej kësaj, nuk ka kërkesë të qartë për të verifikuar identitetin e atyre personave.</p>	Pjesërisht
<p>2. Shtetet Anëtare sigurojnë që subjektet e detyruara të zbatojnë secilën kërkesë të kujdesit të duhur ndaj klientit të parashtruar në paragrafin 1. Sidoqoftë, subjektet e detyruara mund të përcaktojnë shtrirjen e këtyre masave në bazë të vlerësimit të ndjeshmërisë së rrezikut.</p>	<p>Fjalja e parë e paragrafit nuk është përmbushur pasi që ka një numër të mangësive të cilat do të ndikonin në zbatimin e atyre masave, p.sh. zbatimin e masave të verifikimit për pronësinë përfituese vetëm në situatat e</p>	Në mospërputhje

Dispozitat e Direktivës (BE) 2015/849	Përshkrimi dhe Analiza e masave në Kosovë	Niveli i pajtueshmërisë
	<p>rrezikut të lartë.</p> <p>Legjislacioni i Kosovës nuk e lejon në praktikë zbatimin e masave të KDK-së në një shkallë të ndryshueshme në bazë të përcaktimit të subjekteve të detyruara pas vlerësimit të tyre të rrezikut për shkak të arsyeve në vijim. Në njërin anë, ekzistojnë situata të përkufizuara saktësisht për KDK-në e shtuar (dhe masat përkatëse) dhe asnjë masë e mëtutjeshme e përkufizuar në mënyrë të përshtatshme që duhet marrë në konsideratë për këtë qëllim kur përcaktohen situatat me rrezikshmëri të lartë. Për më tepër, përcaktimi i rrezikut të lartë nuk lidhet me rrezikun e përgjithshëm por vetëm me klientët dhe personat e tjerë të cilëve iu ofrohen shërbime financiare dhe profesionale në pajtim me nenin 18, paragrafin 5 të Ligjit për PPP/LFT-në (në krahasim me shërbimet e ndërlidhura me rrezikun, produktet, vendndodhjen gjeografike dhe kanalet e mekanizmat e shpërndarjes). Në anën tjetër, KDK-ja e thjeshtuar u nënshtrohet situatave të miratuara nga NjIF-i dhe në ligj nuk ofrohen hollësi të tjera mbi masat që duhet të aplikohen (rrjedhimisht edhe shkalla e zbatimit të masave). Po ashtu, ka mangësi edhe në identifikimin e vlerësimit të rrezikut nga subjektet e detyruara (siç është diskutuar në raport me nenin 8, paragrafi 1 të Direktivës) të cilat do të vlenin edhe për këtë dispozitë të Direktivës. Ligji për PPP/LFT-në u lejon liri veprimi të kufizuar subjekteve të detyruara si rezultat i rrezikut të vlerësuar duke ofruar situata të përcaktuara që kërkojnë KDK të thjeshtë apo të shtuar (ndonëse ekziston një nivel i lirisë së veprimit vetëm si rezultat i udhëzimeve të parapara nga NjIF-i, shih nenin 23, paragrafi 5 të Ligjit për PPP/LFT-në).</p>	
<p>3. Shtetet Anëtare kërkojnë që subjektet e detyruara të marrin parasysh së paku variablat e përcaktuara në Shtojcën I gjatë vlerësimit të rrezikut të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.</p>	<p>Nuk zbatohet asnjë kërkesë e qartë për të marrë parasysh variablat e shënuara në Shtojcën I të Direktivës.</p>	<p>Në mospërputhje</p>
<p>4. Shtetet Anëtare sigurojnë që subjektet e detyruara të jenë në gjendje që t’iu demonstrojnë autoriteteve kompetente apo organeve vetërregulluese se masat e zbatuara janë të përshtatshme duke pasur parasysh rreziqet e identifikuar të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.</p>	<p>Ekzistojnë kërkesa për vlerësimin e rrezikut në raport me një numër të produkteve, shërbimeve, kanaleve të shpërndarjes, klientëve dhe zonave gjeografike, duke e ofruar këtë vlerësim të rrezikut për autoritetet</p>	<p>Pjesërisht</p>

Dispozitat e Direktivës (BE) 2015/849	Përshkrimi dhe Analiza e masave në Kosovë	Niveli i pajtueshmërisë
	<p>kompetente, si dhe për kërkesat për udhëzim të NjIF-it dhe mbikëqyrësve në mënyrë që të zbatohet p.sh. masat e thjeshtuara.</p> <p>Gjithsesi, ka shumë pak gjasa se kjo kërkesë e Direktivës mund të adresohet tërësisht duke marrë parasysh mungesën e kërkesave në Kosovë për të zbatuar sisteme dhe politika të brendshme për menaxhimin/zbutjen e rrezikut (me përjashtim të bankave dhe institucioneve financiare) dhe mangësitë që kanë të bëjnë me kërkesat e dokumentimit. Për më tepër, përgjegjësia e mbajtjes së masave në një nivel të përshtatshëm me sa duket është vënë mbi NjIF-in në bashkëpunim me mbikëqyrësit, p.sh. në paragrafin 5 të nenit 23 i cili kërkon që autoritetet të përcaktojnë situatat kur masat e thjeshtuara janë të përshtatshme.</p>	
<p>5. Për bizneset e sigurimit të jetës ose investime të tjera të lidhura me sigurimet, Shtetet Anëtare sigurojnë që, krahas masave të kujdesit të duhur që kërkohen për klientët dhe pronarët përfitues, institucionet kreditore dhe financiare të marrin masat vijuese të kujdesit të duhur ndaj klientit për përfituesit e sigurimit të jetës dhe investime të tjera të lidhura me policat e sigurimit, sapo përfituesit të identifikohen apo përcaktohen:</p> <p>(a) për përfituesit e identifikuar si persona apo marrëveshje juridike të emërtuar konkretisht, duke marrë emrin e personit;</p> <p>(b) për përfituesit që janë të përcaktuar nga karakteristikat, kategoria apo nga mjete të tjera, të sigurojnë informacion të mjaftueshëm në lidhje me këta përfitues deri sa institucionet kreditore apo institucionet financiare të kenë siguri se janë në gjendje të përcaktojnë identitetin e përfituesit në kohën e pagesës.</p> <p>Në raport me shkronjat (a) dhe (b) të nënparagrafit të parë, verifikimi i identitetit të përfituesve zhvillohet në të njëjtën kohë me pagesën. Në rast të caktimit, në tërësi apo pjesërisht, të sigurimit të jetës apo investimeve të tjera të ndërlidhura me sigurimet për një palë të tretë, institucionet kreditore dhe financiare identifikojnë pronarin përfitues në kohën e caktimit të personit fizik apo juridik apo të marrëveshjes juridike që e përfiton për dobinë e vet vlerën e policës së caktuar.</p>	<p>Ju lutemi referojuni Shtojcës së PT-së, R. 10.12.</p> <p>Mangësitë e identifikuar në raport me kohën e identifikimit të përfituesve dhe përfituesve që janë marrëveshje juridike ndikojnë në përputhshmërinë me këtë dispozitë të Direktivës. Situata e rrezikut e përshkruar nën paragrafin 5 të këtij neni të Direktivës nuk është përfshirë në legjislacionin e Kosovës.</p>	Pjesërisht
<p>6. Në rastin e përfituesve të trusteve apo marrëveshjeve të ngjashme juridike që përcaktohen nga karakteristika apo kategori të veçanta, subjekti i detyruar siguron</p>	<p>Ju lutemi referojuni Shtojcës së PT-së, R. 10.11.</p> <p>Kosova nuk është në përputhje me këtë dispozitë të</p>	Pjesërisht

Dispozitat e Direktivës (BE) 2015/849	Përshkrimi dhe Analiza e masave në Kosovë	Niveli i pajtueshmërisë
informacion të mjaftueshëm në lidhje me përfituesin deri sa subjekti i detyruar të ketë siguri se është në gjendje që të përcaktojë identitetin e përfituesit në kohën e pagesës ose në kohën e ushtrimit të të drejtave të fituara nga përfituesi.	Direktivës përpos bankave dhe institucioneve financiare në pajtim me nenin 10, paragrafi 7 të Rregullores së BQK-së për PPP/LFT-në.	
<p style="text-align: center;">Neni 14</p> <p>1. Shtetet Anëtare kërkojnë që verifikimi i identitetit të klientit dhe pronarit përfitues të zhvillohen përpara krijimit të marrëdhënieve të biznesit apo të kryerjes së transaksionit. ► M1 Sa herë që përfshihen në një marrëdhënie të re biznesi me një shoqëri tregtare apo subjekt tjetër juridik, një trust a marrëveshje juridike që ka një strukturë apo funksione të ngjashme me trustet (‘marrëveshje e ngjashme juridike’) të cilat i nënshtrohen regjistrimit të informacionit për pronarin përfitues në pajtim me nenin 30 ose 31, subjektet e detyruara mbledhin dëshmi të regjistrimit apo një ekstrakt të regjistrimit. ◀</p> <p>2. Pavarësisht nga paragrafi 1, Shtetet Anëtare mund të lejojnë që verifikimi i identitetit të klientit dhe pronarit përfitues të plotësohet gjatë vendosjes së një marrëdhënieje biznesi nëse është e nevojshme në mënyrë që të mos pengohet zhvillimi normal i biznesit dhe kur ka rrezik të vogël të pastrimit të parave apo financimit të terrorizmit. Në situata të tilla, këto procedura kryhen sa më parë pas kontaktit fillestar.</p>	<p>Ju lutemi referojuni Shtojcës së PT-së, R. 10.14 si dhe RM 4.</p> <p>Koha konsiderohet në përputhje me standardin (përpara apo gjatë), sidoqoftë në legjislacionin e Kosovës nuk është përfshirë asnjë garanci lidhur me verifikimin e kryer gjatë themelimit të marrëdhënieve apo kryerjes së transaksionit për t’u siguruar se kryhet vetëm në situata me rrezikshmëri të ulët. Sidoqoftë, mungesa kryesore këtu ka të bëjë me mungesën e kërkesës për verifikimin e pronarit përfitues përpos në situata me rrezikshmëri të lartë si dhe mungesa e të kuptuarit të përkufizimit të pronësisë përfituese posaçërisht në lidhje me skenarët e ndryshëm të kontrollit (ju lutemi referojuni edhe RM 4, Çështja Thelbësore 4.2).</p> <p>Në Kosovë nuk ekziston një regjistër në pajtim me nenet 30 dhe 31, prandaj fjalia e dytë në paragrafin 1 nuk përmbushet.</p>	Në mospërputhje
<p>3. Pavarësisht nga paragrafi 1, Shtetet Anëtare mund të lejojnë hapjen e një llogarie me një institucion kreditor apo financiar, përfshirë llogaritë të cilat lejojnë transaksione me letra me vlerë të transferueshme, me kusht që të ekzistojnë garanci të përshtatshme për të siguruar se transaksionet nuk kryhen nga klienti ose në emër të tij deri në sigurimin e pajtimit të plotë me kërkesat e kujdesit të duhur të parapara në nenin 13(1), paragrafi i parë, shkronjat (a) dhe (b).</p>	Ligji për PPP/LFT-në nuk e lejon një zbutje të tillë.	Nuk aplikohet
<p>4. Shtetet Anëtare kërkojnë që, kur një subjekt i detyruar nuk është në gjendje që të zbatojë kërkesat e kujdesit të duhur ndaj klientit të parapara në nenin 13(1) nënparagrafi i parë shkronjat (a), (b) dhe (c), nuk kryen një transaksion përmes një llogarie bankare, nuk krijojnë një marrëdhënie biznesi apo nuk kryen transaksionin, dhe përfundon marrëdhënien e biznesit dhe shqyrton përgatitjen e një raporti për transaksion të dyshimtë për NjIF-in në raport me klientin në pajtim me nenin 33.</p> <p>Shtetet Anëtare nuk e zbatojnë nënparagrafin e parë kundër noterëve, profesioneve juridike të pavarura, auditorëve, kontabilistëve të jashtëm dhe këshilltarëve tatimorë vetëm me kushtin e rreptë kur ata persona vlerësojnë pozitën juridike të klientit të tyre, apo kryejnë detyrën e mbrojtjes apo përfaqësimit të atij klienti në, ose në lidhje</p>	<p>Ju lutemi referojuni R. 10.19 të Shtojcës së PT-së.</p> <p>Ligji për PPP/LFT-në nuk është tërësisht në pajtim kryesisht pasi që nuk ka kërkesë në nenin 19, paragrafi 9 për të shqyrtuar (në mënyrë aktive) përgatitjen e një raporti për transaksion të dyshimtë (nuk ka pengesa për ta bërë këtë kur lind dyshimi).</p>	Pjesërisht

Dispozitat e Direktivës (BE) 2015/849	Përshkrimi dhe Analiza e masave në Kosovë	Niveli i pajtueshmërisë
me, procedurat juridike, përfshirë ofrimin e këshillave mbi nisjen apo shmangien e procedurave të tilla.		
<p>▼M1</p> <p>5. Shtetet Anëtare kërkojnë që subjektet e detyruara të zbatojnë masat e kujdesit të duhur ndaj klientit jo vetëm për të gjithë klientët e rinj por, në kohë të përshtatshme edhe për klientët ekzistues në bazë të ndjeshmërisë së rrezikut, apo kur rrethanat përkatëse të klientit ndryshojnë, apo kur subjekti i detyruar ka çfarëdo detyrimi ligjor gjatë viti kalendarik përkatës për të kontaktuar me klientin me qëllim të rishikimit të çdo informacioni të rëndësishëm në lidhje me pronarin(ët) përfitues, apo nëse subjekti detyruar e ka pasur këtë detyrim sipas Direktivës 2011/16/EU të Këshillit ⁽¹⁰¹⁾.</p>	<p>Ju lutemi referojuni R. 10.16 në Shtojcën e PT-së. Dispozita përkatëse në Ligjin për PPP/LFT-në është neni 68, paragrafi 1 i cili kërkon zbatimin e masave ndaj klientëve ekzistues në bazë të materialitetit dhe rrezikut. Kjo mund të konsiderohet se është në përputhje me opsionin e parë të lejuar nga Direktiva. Opsionet e tjera nuk janë të përfshira.</p>	<p>Në përputhje</p>
<p>▼B</p> <p>SEKSIONI 2 Kujdesi i duhur i thjeshtuar ndaj klientit</p> <p style="text-align: center;">Neni 15</p> <p>1. Aty ku një Shtet Anëtar apo një subjekt i detyruar identifikojnë fusha me rrezik më të ulët, ai Shtet Anëtar mund t'i lejojë subjektet e detyruara që të zbatojnë masat e thjeshtuara të kujdesit të duhur.</p> <p>2. Para zbatimit të masave të thjeshtuara të kujdesit të duhur ndaj klientit, subjektet e detyruara vërtetojnë se marrëdhënia e biznesit apo transaksioni paraqesin një shkallë më të ulët të rrezikut.</p> <p>3. Shtetet Anëtare sigurojnë që subjektet e detyruara të kryejnë monitorim të mjaftueshëm të transaksioneve dhe marrëdhënieve të biznesit për të mundësuar zbulimin e transaksioneve të pazakonshme apo të dyshimta.</p>	<p>Neni 23, paragrafët 1-3 të Ligjit për PPP/LFT-në sigurojnë përputhshmërinë e gjerë me kërkesat e Direktivës, sidoqoftë ekziston një liri veprimi e kufizuar e lejuar për subjektet raportuese për të miratuar KDK-në e thjeshtuar në bazë të vlerësimit të tyre të rrezikut. Kjo do të kufizonte zbatimin e KDK-së së thjeshtuar në praktikë siç është demonstruar gjatë vlerësimit në terren (praktikisht e pazbatuar nga asnjë institucion).</p>	<p>Pjesërisht (në lidhje me mungesën e aplikimit praktik të KDK-së së thjeshtuar)</p>
<p style="text-align: center;">Neni 16</p> <p>Gjatë vlerësimit të rreziqeve të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në</p>	<p>Dispozita nuk është plotësuar tërësisht pasi që autoritetet e Kosovës nuk i kanë përcaktuar dhe zbatuar faktorët përkatës dhe situatat e cekura në nenin 23, paragrafi 4.</p>	<p>Pjesërisht</p>

¹⁰¹ Direktiva 2011/16/EU e Këshillit e datës 15 shkurt 2011 për bashkëpunimin administrativ në fushën e tatimeve dhe shfuqizimin e Direktivës 77/799/EEC (OJ L 64, 11.3.2011, f. 1).

Dispozitat e Direktivës (BE) 2015/849	Përshkrimi dhe Analiza e masave në Kosovë	Niveli i pajtueshmërisë
lidhje me llojet e klientëve, zonat gjeografike, produktet, shërbimet, transaksionet apo kanalet e veçanta të shpërndarjes, Shtetet Anëtare dhe subjektet e detyruara marrin parasysh së paku faktorët e situatave të rrezikut potencial të ulët të parapara në Shtojcën II.	Prandaj, faktorët e përcaktuar në Direktivë (Shtojca II) nuk janë zbatuar.	
<p style="text-align: center;">Neni 17</p> <p>Deri më 26 qershor 2017, AME-të nxjerrin udhëzime që iu adresohen autoriteteve kompetente dhe institucioneve kreditore dhe financiare në pajtim me nenin 16 të Rregullores (BE) nr. 1093/2010, (BE) nr. 1094/2010 dhe (BE) nr. 1095/2010 mbi faktorët e rrezikut që duhet të merren në konsideratë dhe masat që duhet të ndërmerren në situatat kur masat e thjeshtuara të kujdesit të duhur ndaj klientit janë të përshtatshme. Konsideratë e posaçme tregohet ndaj natyrës dhe madhësisë së biznesit, dhe, kur kjo është e përshtatshme dhe proporcionale, parashtrohen edhe masat specifike.</p>	Me sa duket ato nuk janë marrë në konsideratë dhe nuk janë zbatuar në Kosovë.	Në mospërputhje
<p><i>SEKSIONI 3</i> Kujdesi i duhur i shtuar ndaj klientit</p> <p style="text-align: center;">Neni 18</p> <p>1. ► M1 Në rastet e cekura në nenet 18a dhe 24, si dhe në rastet e tjera të rrezikut më të lartë të cilat janë identifikuar nga Shtetet Anëtare apo subjektet e detyruara, Shtetet Anëtare iu kërkojnë subjekteve të detyruara që të zbatojnë masa të shtuara të kujdesit të duhur ndaj klientit për të menaxhuar dhe zbutur si duhet ato rreziqe. ◀</p> <p>Masat e shtuara të kujdesit të duhur ndaj klientit nuk vlejnë automatikisht në raport me degët apo filialet e kontrolluara të subjekteve të detyruara të themeluara në Union të cilat gjenden në vende të treta me rrezikshmëri më të lartë, kur ato degë apo filiale në të cilat subjekti zotëron shumicën e pronësisë së tyre përputhen në tërësi me politikat dhe procedurat në nivel të grupit në pajtim me nenin 45. Shtetet Anëtare sigurojnë që ato raste trajtohen nga subjektet e detyruara duke shfrytëzuar një qasje të bazuar në rrezik.</p>	<p>Ju lutemi referojuni R. 1 të Shtojcës së PT-së, Rekomandimeve përkatëse siç janë diskutuar më poshtë (nën situatat specifike) si dhe RM 1 dhe RM 4.</p> <p>Neni 22, paragrafi 1 i Ligjit për PPP/LFT-në kërkon KDSH-në në bazë të rreziqeve të identifikuara nga subjektet e detyruara. Sidoqoftë, nuk është vendosur asnjë kërkesë për t'u siguruar se VKR-ja është marrë tërësisht në konsideratë si faktor që e përcakton KDSH-në. Për zbatimin e neneve 18a dhe 24 të Direktivës ju lutemi shikoni në vijim.</p> <p>Legjislati i Kosovës nuk e ka përfshirë opsionin për degët dhe filialet siç është paraparë nga nënparagrafi i dytë i paragrafit 1 të nenit 18 të Direktivës.</p> <p>VKR-ja dhe analizat sektoriale të rrezikut nuk merren parasysh në mënyrë të qëndrueshme nga subjektet raportuese për të përcaktuar zbatimin e masave parandaluese. Në përgjithësi, ekziston një nivel i të kuptuarit dhe zbatimit të masave nga bankat dhe institucionet financiare siç është diskutuar më poshtë, por ka mungesë të vetëdijes në sektorin e BPCJF-ve.</p>	Pjesërisht
<p>▼ M1</p> <p>2. Shtetet Anëtare u kërkojnë subjekteve të detyruara që të analizojnë, aq sa është e</p>	Neni përkatës 25, paragrafët 1 dhe 3 parashohin detyrimin që të tregohet vëmendje dhe të analizohet konteksti dhe qëllimi i të gjitha transaksioneve të	Pjesërisht

Dispozitat e Direktivës (BE) 2015/849	Përshkrimi dhe Analiza e masave në Kosovë	Niveli i pajtueshmërisë
<p>arsyeshme, kontekstin dhe qëllimin e të gjitha transaksioneve të cilat e plotësojnë të paktën një prej kushteve në vijim:</p> <p>(i) ato janë transaksione komplekse;</p> <p>(ii) ato janë transaksione jashtëzakonisht të mëdha në vlerë;</p> <p>(iii) ato zhvillohen në një model të pazakonshëm;</p> <p>(iv) ato nuk e kanë një qëllim të dukshëm ekonomik ose ligjor.</p> <p>Në veçanti, subjektet e detyruara rrisin shkallën e natyrës së monitorimit të marrëdhënieve të biznesit në mënyrë që të përcaktojnë nëse ato transaksione apo aktivitete duken të dyshimta.</p>	<p>ndërlikuara e të pazakonshme dhe të gjitha modelet e pazakonshme të transaksioneve, të cilat nuk kanë asnjë qëllim të dukshëm ekonomik apo ligjor. Vërehet se Direktiva kërkon masa për të gjitha transaksionet që mund të plotësojnë cilindo prej këtyre kriterëve, përdërisa Ligji për PPP/LFT-në e parasheh zbatimin akumulues të këtyre kriterëve. Për më tepër, nuk ka kërkesë të qartë për të përcaktuar nëse ekziston ndonjë dyshim. Zbatimi i masave nga BPCJF-të duket të jetë në nivel të ulët. Në të njëjtën kohë, raportimi i transaksioneve të pazakonshme të NjIF-i duket se po sjell më shumë huti për të gjitha subjektet raportuese dhe nuk po përdoret në mënyrë efektive në bazë të monitorimit të ndërlidhur përkatës në pajtim me këtë dispozitë të Direktivës (ju lutemi shihni RM 6, çështjen thelbësore 6.2).</p>	
<p>▼B</p> <p>3. Gjatë vlerësimit të rrezikut të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, Shtetet Anëtare dhe subjektet e detyruara marrin parasysh së paku faktorët e situatave me rrezikshmëri potencialisht më të lartë të parashtruara në Shtojcën III.</p> <p>4. Deri më 26 qershor të vitit 2017, AME-të nxjerrin udhëzime që iu adresohen autoriteteve kompetente dhe institucioneve kreditore dhe financiare në pajtim me nenin 16 të Rregullores (BE) nr.1093/2010, (BE) nr.1094/2010 dhe (BE) nr. 1095/2010 mbi faktorët e rrezikut që duhet të merren në konsideratë dhe masat që duhet të ndërmerren në situatat kur masat e shtuara të kujdesit të duhur ndaj klientit janë të duhura. Konsideratë e posaçme tregohet ndaj natyrës dhe madhësisë së biznesit, dhe, kur kjo është e përshtatshme dhe proporcionale, parashtrihen edhe masat specifike.</p>	<p>Me sa duket, asnjë kërkesë në ligjin e Kosovës nuk i merr parasysh në mënyrë sistematike faktorët e përmendur të rrezikut, duke i lënë ato në lirinë e veprimit të subjekteve raportuese.</p>	Në mospërputhje
<p>▼M1</p> <p style="text-align: center;">Neni 18a</p> <p>1. Në lidhje me marrëdhëniet e biznesit apo transaksionet që përfshijnë vendet me rrezikshmëri më të lartë të identifikuar sipas nenit 9(2), Shtetet Anëtare u kërkojnë subjekteve të detyruara që të zbatojnë këto masa të shtuara të kujdesit të duhur ndaj klientit:</p>	<p>Ju lutemi referojuni Shtojcës së PT-së, R. 19</p> <p>Legjislacioni për PPP/LFT-në i parasheh masat e kujdesit të shtuar që duhet të zbatohen në raport me vendet e treta të cilat i nënshtrohen masave ndërkombëtare dhe që janë të përfshira në udhëzimet e NjIF-it (neni 18, paragrafi 6), si dhe me vendet që nuk i zbatojnë apo i zbatojnë në mënyrë të pamjaftueshme standardet ndërkombëtare përkatëse për PPP/LFT-në (neni 25, paragrafi 2). Sipas nenit 18, paragrafi 6 të Ligjit për</p>	Pjesërisht

Dispozitat e Direktivës (BE) 2015/849	Përshkrimi dhe Analiza e masave në Kosovë	Niveli i pajtueshmërisë
<p>(a) sigurimi i informacionit shtesë mbi klientin dhe pronarin(ët) përfitues;</p> <p>(b) sigurimi i informacionit shtesë mbi natyrën e synuar të marrëdhënies së biznesit;</p> <p>(c) sigurimi i informacionit mbi prejardhjen e fondeve dhe prejardhjen e pasurisë së klientit dhe të pronarit(ëve) përfitues;</p> <p>(d) sigurimi i informacionit mbi arsyet për transaksionet e synuara apo të kryera;</p> <p>(e) sigurimi i miratimit të drejtuesit të lartë për të krijuar apo vazhduar marrëdhënien e biznesit;</p> <p>(f) zhvillimi i monitorimit të shtuar të marrëdhënies së biznesit duke e shtuar numrin dhe kohën e kontrolleve të aplikuara, dhe zgjedhja e modeleve të transaksioneve të cilat duhet të hulumtohen më tej.</p> <p>Shtetet Anëtare mund t'u kërkojnë subjekteve të detyruara që të sigurojnë, kur kjo është e mundur, që pagesa e parë të kryhet përmes një llogarie në emrin e klientit me një institucion kreditor që u nënshtrohet standardeve të kujdesit të duhur ndaj klientit të cilat nuk janë më pak të forta se sa ato të parashtruara në këtë Direktivë.</p>	<p>PPP/LFT-në, në vitin 2018 NjIF-i nxori udhëzime në lidhje me zbatimin e masave në raport me vendet me rrezikshmëri më të lartë të identifikuar nga FATF-ja. Direktiva (në nenin 9 dhe këtu) parasheh masa edhe më të zgjeruara të cilat shkojnë përtej kërkesave të vendeve me rrezikshmëri më të lartë të identifikuar nga FATF-ja dhe parasheh masa specifike që duhet të zbatohen dhe të cilat mungojnë në Ligjin për PPP/LFT-në në Kosovë (por që në teori ato mund të zbatohen përmes udhëzimeve). Neni 18, paragrafi 6 mund të interpretohet se e lejon edhe përfshirjen e vendeve me rrezikshmëri më të lartë të identifikuar nga BE-ja, sidoqoftë, nuk ka detyrim sipas ligjit që të shqyrtohen listat e BE-së (sipas nenit 9 të Direktivës). Rrjedhimisht, kërkesat e Direktivës në këtë aspekt nuk janë të përmbushura në tërësi.</p> <p>Zbatimi në praktikë i kërkesave në raport me vendet me rrezikshmëri më të lartë të identifikuar nga FATF-ja është jo i njëtrajtshëm. Përderisa të kuptuarit dhe masat specifike ekzistojnë në përgjithësi në banka dhe institucione financiare, kjo nuk vlen në rastet e BPCJF-ve si dhe të zyrave këmbimore (ju lutemi referojuni masave të shtuara në çështjen thelbësore RM 4). Për më tepër, madje edhe bankat dhe institucionet financiare nuk kanë mekanizma specifike për monitorim të transaksioneve.</p>	
<p>2. Krahas masave të parapara në paragrafin 1 dhe në pajtim me detyrimet ndërkombëtare të Unionit, Shtetet Anëtare do u kërkojnë subjekteve të detyruara, kur kjo është nevojshme, një apo më shumë masa zbutëse shtesë për personat dhe subjektet juridike që kryejnë transaksione të cilat përfshijnë vende të treta me rrezikshmëri më të lartë të identifikuar në pajtim me nenin 9(2). Këto masa përbëhen nga një apo disa prej masave në vijim:</p> <p>(a) zbatimi i elementeve shtesë të kujdesit të duhur të shtuar;</p> <p>(b) futja e mekanizmave raportues përkatës shtesë apo raportimi sistematik i transaksioneve financiare;</p> <p>(c) kufizimi i marrëdhënieve të biznesit apo transaksioneve me personat fizikë apo subjektet juridike nga vendet e treta të identifikuar si vende me rrezikshmëri më të</p>	<p>Asnjë masë e tillë nuk është paraparë në Ligjin për PPP/LFT-në të Kosovës dhe nuk ka detyrime të tilla. Legjislacioni i Kosovës nuk parasheh masa të tilla shtesë të cilat mund të zbatohen si opsione në raport me rreziqet.</p>	Në mospërputhje

Dispozitat e Direktivës (BE) 2015/849	Përshkrimi dhe Analiza e masave në Kosovë	Niveli i pajtueshmërisë
Iartë sipas nenit 9(2).		
<p>3. Krahas masave të parapara në paragrafin 1, Shtetet Anëtare zbatojnë, kur kjo është e mundur, një apo disa nga masat në vijim në raport me vendet e treta me rrezikshmëri më të lartë të identifikuara sipas nenit 9(2) në pajtim me detyrimet ndërkombëtare të Unionit:</p> <p>(a) të refuzohet themelimi i filialeve apo degëve apo zyrave përfaqësuese të subjekteve të detyruara nga vendi në fjalë, ose përndryshe të merret parasysh fakti se subjekti i detyruar përkatës është nga një shtet i cili nuk ka regjim të duhur për PPP/LFT-në;</p> <p>(b) t'u ndalohet subjekteve të detyruara që të themelojnë degë apo zyra përfaqësuese në vendin në fjalë, ose përndryshe të merret parasysh fakti se dega apo zyra përfaqësuese përkatëse është në një vend që nuk ka regjim të duhur për PPP/LFT-në;</p> <p>(c) të kërkohet analizim mbikëqyrës i shtuar apo kërkesa të shtuara për auditim të jashtëm për degët dhe filialet e subjekteve të detyruara që gjenden në vendin në fjalë;</p> <p>(d) të kërkohet shtimi i kërkesave për auditim të jashtëm për grupet financiare në raport me cilëndo prej degëve dhe filialeve të tyre që gjenden në vendin në fjalë;</p> <p>(e) t'iu kërkohet institucioneve kreditore dhe financiare që të rishikojnë dhe ndryshojnë, apo nëse është e nevojshme, që të përfundojnë marrëdhëniet korresponduese me institucionet kliente në vendin në fjalë.</p>	Legjislacioni i Kosovës nuk parasheh masa të tilla shtesë të cilat mund të zbatohen si opsione në raport me rreziqet.	
<p>4. Kur miratojnë apo zbatojnë masat e parapara në paragrafët 2 dhe 3, Shtetet Anëtare marrin parasysh, si vlerësime të pranueshme të rëndësishme, vlerësimet apo raportet e hartuara nga organizatat ndërkombëtare dhe autoritetet që vendosin standardet në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe luftimit të terrorizmit, në raport me rreziqet e paraqitura nga vendet e treta individuale.</p> <p>5. Shtetet Anëtare njoftojnë Komisionin përpara se të zbatojnë apo aplikojnë masat e parapara në paragrafët 2 dhe 3.</p>	Kërkesat e tilla nuk janë përfshirë në legjislacionin e Kosovës. Kërkesa për njoftim nga paragrafi 5 nuk është e zbatueshme.	Në mospërputhje
<p>▼B</p> <p style="text-align: center;">Neni 19</p>	<p>Ju lutemi referojuni Shtojcës së PT-së, R. 13.1 dhe 13.2 si dhe RM 4.</p> <p>Kërkesat e Direktivës janë të plotësuara në përgjithësi nga neni 22, paragrafi 4 i Ligjit për PPP/LFT-në.</p>	Pjesërisht

Dispozitat e Direktivës (BE) 2015/849	Përshkrimi dhe Analiza e masave në Kosovë	Niveli i pajtueshmërisë
<p>▼M1</p> <p>Në raport me marrëdhëniet korresponduese ndërkufitare të cilat përfshijnë ekzekutimin e pagesave me një institucion klient të një vendi të tretë, Shtetet Anëtare, krahas masave të kujdesit të shtuar ndaj klientit të parapara në nenin 13, me rastin e krijimit të një marrëdhënie biznesi iu kërkojnë institucioneve të tyre kreditore dhe financiare që:</p> <p>▼B</p> <p>(a) të mbledhin informacion të mjaftueshëm rreth institucionit klient për të kuptuar në tërësi natyrën e biznesit të klientit dhe për të përcaktuar nga informacioni që është në dispozicion të publikut reputacionin e institucionit dhe cilësinë e mbikëqyrjes;</p> <p>(b) të vlerësojnë kontrollet për PPP/LFT-në të institucionit klient;</p> <p>(c) të sigurojnë miratimin e drejtuesit të lartë përpara krijimit të marrëdhënieve të reja korresponduese;</p> <p>(d) të dokumentojnë përgjegjësitë përkatëse për secilin institucion;</p> <p>(e) në raport me llogaritë e përkohshme për pagesa, të sigurohen se institucioni klient e ka verifikuar identitetin e, dhe e ka kryer kujdesin e duhur të vazhdueshëm për, klientët që kanë qasje të drejtpërdrejtë në llogaritë e institucionit korrespondues, dhe se është në gjendje që t'i ofrojë institucionit korrespondues të dhënat përkatëse për kujdesin e duhur ndaj klientit kur kjo kërkohet.</p>	<p>Sidoqoftë, ekziston një mungesë e qartësisë posaçërisht në lidhje me kërkesat që kanë të bëjnë me vlerësimin e mbikëqyrjes dhe kontrollit (politikat dhe procedurat e brendshme kundrejt kontrollit rregullator), kërkesat për llogaritë e përkohshme (për pagesa përmes llogarisë) dhe personat të cilëve do t'iu kërkohej që t'i aplikojnë këto masa. Rregullorja e BQK-së i qartëson çështjet, por vetëm në raport me bankat.</p> <p>Bankat, në përgjithësi, duket se janë të vetëdijshme për detyrimet e tyre në raport me marrëdhëniet korresponduese por, nuk është e qartë se deri në çfarë shkalle marrëdhëniet e tilla ekuivalente janë identifikuar dhe kërkesat janë zbatuar nga institucionet financiare.</p>	
<p style="text-align: center;">Neni 20</p> <p>Në raport me transaksionet apo marrëdhëniet e biznesit me personat e ekspozuar politikisht, Shtetet Anëtare, krahas masave të kujdesit të duhur ndaj klientit të parashtruara në nenin 13, u kërkojnë subjekteve të detyruara që:</p> <p>(a) të vendosin sistemet e duhura për menaxhim të rrezikut, përfshirë procedurat e bazuara në rrezik, për të përcaktuar nëse klienti ose pronari përfitues i klientit është person i ekspozuar politikisht;</p> <p>(b) të zbatojnë masat vijuese në rastet e marrëdhënieve të biznesit me personat e ekspozuar politikisht:</p>	<p>Ju lutemi referojuni Shtojcës së PT-së, R. 12 si dhe RM 4. Ngjashëm me Direktivën, Ligji i Kosovës për PPP/LFT parasheh KDSH-në e njëjtë në raport me PEP-ë të huaj dhe vendorë (neni 22, paragrafi 5). Siç është diskutuar në lidhje me përkufizimet e nenit 3 të Direktivës, fushëveprimi i PEP-ëve sipas Ligjit për PPP/LFT-në në përgjithësi është në pajtim me Direktivën, përpos në çështjen e mbulimit të personave të afërm (familjarëve apo bashkëpunëtorëve të ngushtë). Siç është cekur nën R. 12.1 të Shtojcës së PT-së, kërkesa për zbatimin e sistemeve për menaxhimin e rrezikut nuk është plotësuar. Në raport me masat e shtuara të KDK-së që duhet të</p>	Pjesërisht

Dispozitat e Direktivës (BE) 2015/849	Përshkrimi dhe Analiza e masave në Kosovë	Niveli i pajtueshmërisë
<p>(i) të sigurojnë miratimin e drejtuesit të lartë për krijimin apo vazhdimin e marrëdhënieve të biznesit me personat e tillë;</p> <p>(ii) të marrin masat e duhura për të përcaktuar burimin e pasurisë dhe burimin e fondeve që janë të përfshira në marrëdhëniet e biznesit apo në transaksionet me personat e tillë;</p> <p>(iii) të zhvillojnë monitorim të shtuar të vazhdueshëm të këtyre marrëdhënieve të biznesit.</p>	<p>aplikohen kur klienti apo pronari përfitues është një PEP, vërehet si në vijim: Kërkesa për të marrë miratimin e drejtuesit të lartë në Ligjin për PPP/LFT-në shkon përtej Direktivës pasi që ajo përfshin edhe transaksionet e rastit. Ka mangësi të qartësisë nëse kërkesa për të identifikuar burimin e pasurisë e mbulon edhe pronarin përfitues të klientit që është një PEP.</p> <p>Në raport me zbatimin e këtyre masave në praktikë, ekziston një mbështetje e tepruar në regjimin deklarues, mungesë të të kuptuarit në mesin e BPCJF-ve dhe mungesë të mekanizmave verifikues. Të kuptuarit e kërkesave të pronësisë përfituese të lidhura me pragun prej 25% është po ashtu pengues ndaj aplikimit të kërkesave për të marrë masa për të identifikuar PEP-ë. Po ashtu, mund të ketë vështirësi shtesë për subjektet raportuese që zbatojnë kërkesat për të identifikuar burimin e pasurisë në rastin e transaksioneve të rastit. Në praktikë, ekzistojnë vështirësi për të gjitha subjektet që të identifikojnë burimin e fondeve siç janë diskutuar në RM 4.</p>	
<p>▼M1</p> <p style="text-align: center;">Neni 20a</p> <p>1. Secili Shtet Anëtar nxjerr dhe përditëson një listë që tregon funksionet e sakta të cilat, sipas ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative kombëtare, cilësohen si funksione të rëndësishme publike për qëllimet e nenit 3 paragrafi (9). Shtetet Anëtare i kërkojnë çdo organizate ndërkombëtare të akredituar në territorin e tyre për të nxjerrë dhe përditësuar një listë të funksioneve të rëndësishme publike në atë organizatë ndërkombëtare për qëllimet e nenit 3 paragrafi (9). Këto lista do i dërgohen Komisionit dhe mund të publikohen.</p> <p>2. Komisioni harton dhe përditëson listën e funksioneve të sakta të cilat cilësohen si funksione të rëndësishme publike në nivelin e institucioneve dhe organeve të Unionit. Kjo listë, po ashtu përfshin çdo funksion që mund t'i besohet përfaqësuesve të vendeve të treta dhe organeve ndërkombëtare të akredituara në nivel të Unionit.</p> <p>3. Në bazë të listave të parapara në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, Komisioni krijon</p>	<p>Ju lutemi referojuni Shtojcës së PT-së, R. 12 si dhe RM 4. Ka lista që mbahen nga autoritetet e Kosovës (Agjencia kundër Korrupsionit) në lidhje me personat që mbajnë funksione të larta publike. Kjo në përgjithësi do ta sillte Kosovën në përputhje me këtë kërkesë të Direktivës. Përkundër efektit pozitiv të këtyre listave lidhur me aplikimin e kërkesave për PEP-ët, sidoqoftë, këto lista nuk do të sillnin ndonjë përfitim në raport me identifikimin e personave të lidhur me PEP-ët (si dhe PEP-ët e huaj). Gjithashtu, nuk është e qartë nëse dhe deri në çfarë mase janë të përfshirë në lista përfaqësuesit e organizatave ndërkombëtare.</p>	Pjesërisht

Dispozitat e Direktivës (BE) 2015/849	Përshkrimi dhe Analiza e masave në Kosovë	Niveli i pajtueshmërisë
<p>një listë të vetme të të gjitha funksioneve publike të rëndësishme për qëllimet e nenit 3, paragrafi (9). Kjo listë e vetme bëhet publike.</p> <p>4. Funksionet e përfshira në listën e cekur në paragrafin 3 të këtij neni trajtohen në pajtim me kushtet e parashtruara në nenin 41(2).</p>		
<p>▼B</p> <p style="text-align: center;">Neni 21</p> <p>Shtetet Anëtare u kërkojnë subjekteve të detyruara masa për të përcaktuar nëse përfituesit e një police të sigurimit të jetës apo të një investimi tjetër të lidhur me sigurimin dhe/ose, kur është e nevojshme, pronari përfitues i përfituesit janë persona të ekspozuar politikisht. Këto masa merren jo më vonë se në kohën e pagesës apo në kohën e caktimit, në tërësi apo pjesërisht, të policës. Kur identifikohen rreziqe më të mëdha, krahas aplikimit të masave të kujdesit të duhur ndaj klientit të parashtruara në nenin 13, Shtetet Anëtare iu kërkojnë subjekteve të detyruara që:</p> <p>(a) të informojnë drejtuesin e lartë përpara pagesës së të ardhurave nga polica;</p> <p>(b) të zhvillojnë inspektime të shtuara të tërë marrëdhënies së biznesit me mbajtësin e policës.</p>	<p>Ju lutemi referojuni edhe R.12.4 në Shtojcën e PT-së. Kërkesa për të marrë masa të arsyeshme për të përcaktuar nëse përfituesit dhe/ose pronarët e tyre përfitues janë PEP-ë është e përmbushur. Koha e kësaj kërkesë, sipas nenit 22, paragrafi 5 të Ligjit për PPP/LFT-në është përcaktuar se kryhet më së voni në kohën e pagesës, duke e lënë jashtë kërkesën për të marrë masa të arsyeshme në kohën e përcaktimit të policës e cila nuk është në linjë me Direktivën. Masat që ndërmerren në raport me një person të identifikuar si PEP janë në pajtim me Direktivën.</p>	Pjesërisht
<p style="text-align: center;">Neni 22</p> <p>Kur një personi të ekspozuar politikisht nuk i besohet më një funksion i rëndësishëm publik nga një Shtet Anëtar apo vend i tretë, apo një funksion i rëndësishëm publik nga një organizatë ndërkombëtare, subjekteve të detyruara iu kërkohet që, së paku për 12 muaj, të marrin parasysh rrezikun e vazhdueshëm që paraqet ai person dhe që të zbatojnë masat e përshtatshme dhe me ndjeshmëri ndaj rrezikut deri në atë kohë kur të vlerësohet se personi i tillë nuk paraqet rrezik të mëtutjeshëm specifik për personat e ekspozuar politikisht.</p>	<p>Asnjë kërkesë e ngjashme nuk ekziston në legjislacionin e Kosovës dhe asnjë kërkesë nuk zbatohet për të përcaktuar periudhën e aplikimit të masave të KDK-së së shtuar në këtë drejtim në bazë të vlerësimit të rrezikut.</p>	Në mospërputhje
<p style="text-align: center;">Neni 23</p> <p>Masat e cekura në nenet 20 dhe 21 vlejnë edhe për anëtarët e familjes ose personat që dihet se janë bashkëpunëtorë të ngushtë të personave të ekspozuar politikisht.</p>	<p>Ju lutemi shikoni pjesën përkatëse në Shtojcën e PT-së, R. 12.</p> <p>Ju lutemi shikoni më sipër diskutimin mbi përkufizimin e PEP-ëve. Vlefshmëria për anëtarët e familjes apo personave që dihet se janë bashkëpunëtorë të ngushtë nuk është e qartë. Lista e krijuar për qëllime kundër korrupsionit po ashtu, nuk është e dobishme në këtë drejtim.</p>	Në mospërputhje

Dispozitat e Direktivës (BE) 2015/849	Përshkrimi dhe Analiza e masave në Kosovë	Niveli i pajtueshmërisë
<p style="text-align: center;">Neni 24</p> <p>Shtetet Anëtare u ndalojnë institucioneve kreditore dhe financiare që të krijojnë, apo të vazhdojnë, një marrëdhënie korresponduese me një bankë guaskë. Ato kërkojnë që ato institucione të ndërmarrin masat e duhura për t'u siguruar se ato nuk angazhohen apo nuk vazhdojnë marrëdhënie korresponduese me një institucionet kreditor ose financiar që dihet se e lejon një bankë guaskë që të përdorë llogaritë e tij.</p>	<p>Ju lutemi shikoni Shtojcën e PT-së, R. 13.3. Zbatimi i kërkesave përkatëse ndikohet negativisht nga përkufizimi pjesërisht i përputhshëm i bankës guaskë.</p>	<p>Pjesërisht</p>
<p><i>SEKSIONI 4</i> Ekzekutimi nga palët e treta</p> <p style="text-align: center;">Neni 25</p> <p>Shtetet Anëtare mund t'i lejojnë subjektet e detyruara që të mbështeten te palë të treta për të përmbushur kërkesat e kujdesit të duhur ndaj klientit të parashtruara në nenin 13(1), nënparagrafi i parë, shkronjat (a), (b) dhe (c). Sidoqoftë, përgjegjësia përfundimtare për përmbushjen e këtyre kërkesave i takon subjektit të detyruar i cili mbështetet te pala e tretë.</p> <p style="text-align: center;">Neni 26</p> <p>1. Për qëllimet e kësaj pjese, 'palë e tretë' do të thotë subjektet e detyruara të cekura në nenin 2, organizatat anëtare apo federatat e atyre subjekteve të detyruara, apo institucionet ose personat e tjerë që gjenden në një Shtet Anëtar apo në një vend të tretë që:</p> <p>(a) i zbatojnë kërkesat e kujdesit të duhur ndaj klientit dhe kërkesat për ruajtjen e të dhënave të cilat janë në përputhje me ato të përcaktuara në këtë Direktivë; dhe</p> <p>(b) e mbikëqyrin pajtueshmërinë e tyre me kërkesat e kësaj Direktive në një mënyrë që është në pajtim me Pjesën 2 të Kapitullit VI.</p> <p>2. Shtetet Anëtare ua ndalojnë subjekteve të detyruara që të mbështeten te palë të treta të cilat janë të themeluara në vende me rrezikshmëri më të lartë. Shtetet Anëtare mund të përjashtojnë nga ky ndalim degët e filialet e kontrolluara të subjekteve të detyruara në Union kur ato degë dhe filiale, në të cilat subjekti zotëron shumicën e pronësisë së tyre, janë në pajtueshmëri të plotë me politikat dhe procedurat në nivel grupi në pajtim me nenin 45.</p>	<p>Ju lutemi referojuni Shtojcës së PT-së, R. 17 si dhe RM 4. Legjislacioni i Kosovës nuk parasheh kërkesa specifike për mbështetje në palët e treta, ndonëse nuk e ndalon në mënyrë të qartë një mbështetje të tillë. Prandaj, nuk mund të konsiderohet se (duke pasur parasysh mungesën e ndalimit) ka garanci të përshtatshme për zbatimin e kësaj mbështetjeje. Në praktikë, një mbështetje e tillë nuk ndodh, siç edhe është diskutuar në RM 4.</p>	<p>Në mospërputhje</p>

Dispozitat e Direktivës (BE) 2015/849	Përshkrimi dhe Analiza e masave në Kosovë	Niveli i pajtueshmërisë
<p style="text-align: center;">Neni 27</p> <p>1. Shtetet Anëtare sigurojnë që subjektet e detyruara të marrin nga pala e tretë tek e cila mbështeten informacione në lidhje me kërkesat e kujdesit të duhur ndaj klientit të parashtruara në nenin 13(1), nënparagrafi i parë, shkronjat (a), (b) dhe (c).</p> <p>▼M1</p> <p>2. Shtetet Anëtare sigurojnë që subjektet e detyruara, të cilat referohet klienti, ndërmarrin masat e përshtatshme për t'u siguruar se pala e tretë ofron menjëherë, sapo t'i kërkohet, kopje përkatëse të të dhënave identifikuese dhe verifikuese, duke përfshirë, kur është e mundur, të dhënat e siguruar përmes mjeteve elektronike të identifikimit, shërbimet përkatëse të trusteve siç është paraparë në Rregulloren (BE) nr.910/2014 apo çdo proces tjetër të sigurt, në distancë apo elektronik të identifikimit të rregulluar, njohur, pranuar apo miratuar nga autoritetet përkatëse kombëtare.</p>		
<p>▼B</p> <p style="text-align: center;">Neni 28</p> <p>Shtetet Anëtare sigurojnë që autoriteti kompetent i Shtetit Anëtar të origjinës (për politika dhe procedura grupore) dhe autoriteti kompetent i Shtetit Anëtar nikoqir (për degë dhe filiale) mund të vlerësojnë se një subjekt i detyruar respekton dispozitat e miratuara në pajtim me nenet 26 dhe 27 përmes programit të tij grupor, kur plotësohen të gjitha kushtet në vijim:</p> <p>(a) subjekti i detyruar mbështetet në informacionin e ofruar nga një palë e tretë që është pjesë e të njëjtit grup;</p> <p>(b) ai grup i zbaton kërkesat për kujdesin e duhur ndaj klientit, rregullat për ruajtjen e të dhënave dhe programet kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në pajtim me këtë Direktivë apo rregulla të barasvlershme;</p> <p>(c) zbatimi efektiv i kërkesave të cekura në shkronjën (b) mbikëqyret në nivel të grupit nga një autoritet kompetent i Shtetit Anëtar të origjinës apo të shtetit të tretë nikoqir.</p>	<p>Asnjë dispozitë nuk ekziston për t'u siguruar se mbështetja në kuadër të grupit (nuk është e ndaluar në mënyrë të qartë) ndodh në përputhje me garancitë përkatëse.</p>	<p>Në mospërputhje</p>

Dispozitat e Direktivës (BE) 2015/849	Përshkrimi dhe Analiza e masave në Kosovë	Niveli i pajtueshmërisë
<p align="center">Neni 29</p> <p>Ky seksion nuk vlen për kontraktimet e jashtme apo marrëdhëniet e agjencive kur, në bazë të marrëveshjeve kontraktore, ofruesi i shërbimit të kontraktimit të jashtëm apo agjenti shihet si pjesë e subjektit të detyruar.</p>	Nuk aplikohet.	Nuk aplikohet
<p>KAPITULLI III</p> <p>INFORMACIONI I PRONËSISË PËRFITUESE</p> <p align="center">Neni 30</p> <p>1. ▼M1 Shtetet Anëtare sigurojnë që shoqëritë tregtare dhe subjektet e tjera juridike të përfshira në territorin e tyre duhet të sigurojnë dhe mbajnë informacione të përshtatshme, të sakta dhe të përditësuara mbi pronësinë e tyre përfituese, përfshirë hollësitë e interesave përfituese që i kontrollojnë. Shtetet Anëtare sigurojnë që shkeljet e këtij neni t'i nënshtrohen masave apo sanksioneve efektive, proporcionale dhe zbindëse. ◀</p> <p>Shtetet Anëtare sigurojnë që këtyre subjekteve iu kërkohet që, krahas informacionit për pronarin e tyre të ligjshëm, të ofrojnë edhe informacione mbi pronarin përfitues për subjektet e detyruara kur këto ndërmarrin masat e kujdesit të duhur ndaj klientit në pajtim me Kapitullin II.</p> <p>►M1</p> <p>Shtetet Anëtare kërkojnë që pronarët përfitues të shoqërive tregtare apo subjekteve të tjera juridike, përfshirë përmes aksioneve, të drejtave votuese, interesave të pronësisë, aksioneve të bartësve apo kontrollit përmes mjeteve të tjera, t'u ofrojnë këtyre subjekteve tërë informacionin e nevojshëm me qëllim që shoqëritë tregtare apo subjektet e tjera juridike të jenë në pajtim me kërkesat e nënparagrafit të parë.</p>	<p>Ju lutemi referojuni Shtojcës së PT-së, R. 24 si dhe RM 5. Ligji i Kosovës nuk parasheh detyrime specifike që personat juridikë të sigurojnë dhe mbajnë informacione mbi pronësinë përfituese. Për më tepër, pronari, sipas kuptimit të qëllimeve të inkorporimit, nuk duket se i mbulon edhe pronarët përfitues.</p> <p>Nuk ka kërkesa ndaj subjekteve juridike që të ofrojnë informacione në kontekstin e masave të KDK-së të zbatuara nga subjektet raportuese.</p> <p>Nuk ekziston gjithashtu asnjë kërkesë që pronarët përfitues të paraqesin ndonjë informacion.</p>	Në mospërputhje
<p>▼B</p> <p>2. Shtetet Anëtare kërkojnë që informacioni i cekur në paragrafin 1 të mund të qaset në kohë nga autoritetet kompetente dhe NjIF-et.</p>	Mekanizmat e tillë nuk ekzistojnë.	Në mospërputhje
<p>3. Shtetet Anëtare sigurojnë që informacioni i cekur në paragrafin 1 të mbahet në një regjistër qendror në secilin Shtet Anëtar, për shembull regjistri i bizneseve, regjistri i</p>	Kërkesa të tilla nuk ekzistojnë në Kosovë.	Në mospërputhje

Dispozitat e Direktivës (BE) 2015/849	Përshkrimi dhe Analiza e masave në Kosovë	Niveli i pajtueshmërisë
<p>shoqërive siç është cekur në nenin 3 të Direktivës 2009/101/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit ⁽¹⁰²⁾, apo në një regjistër publik. Shtetet Anëtare njoftojnë Komisionin për karakteristikat e këtyre mekanizmave kombëtarë. Informacioni për pronësinë përfituese të përfshirë në atë bazë të të dhënave mund të mblidhet në pajtim me sistemet kombëtare.</p>		
<p>► M1</p> <p>4. Shtetet Anëtare kërkojnë që informacioni i mbajtur në regjistrin qendror siç është cekur në paragrafin 3 është i përshtatshëm, i saktë dhe i përditësuar si dhe krijojnë mekanizmat për këtë qëllim. Mekanizmat e tillë përfshijnë kërkesën për subjektet e detyruara dhe, nëse është e përshtatshme dhe për sa kohë që kjo kërkesë nuk ndërhyr panevojshëm në funksionet e tyre, autoritetet kompetente të raportojnë çdo mospërputhje që e gjejnë në mes të informacionit për pronësinë përfituese që gjendet në regjistrat qendrorë dhe informacionit për pronësinë përfituese që e kanë ato. Në rast të raportimit të mospërputhjeve, Shtetet Anëtare sigurojnë që të ndërmerren veprimet e duhura për të zgjidhur mospërputhjet në kohë, dhe, nëse është e përshtatshme, në ndërkohë të përfshihet përmendja specifike në regjistrin qendror.</p> <p>5. Shtetet Anëtare sigurojnë që informacioni për pronësinë përfituese të mund të qaset në të gjitha rastet nga:</p> <p>(a) autoritetet kompetente dhe NjIF-i pa kurrfarë kufizimi;</p> <p>(b) subjektet e detyruara, në kuadër të kornizës së kujdesit të duhur ndaj klientit në pajtim me Kapitullin II;</p> <p>(c) çdo anëtar i publikut të gjerë.</p> <p>Personat e cekur në shkronjën (c) lejohen që së paku të kenë qasje në emrin, muajin dhe vitin e lindjes, vendin e banimit dhe të shtetësisë së pronarit përfitues si dhe natyrën dhe shkallën e interesit përfitues të kontrolluar.</p> <p>Shtetet Anëtare mundën, sipas kushteve që përcaktohen me ligjin kombëtar, që të ofrojnë qasje në informata shtesë duke e mundur identifikimin e pronarit përfitues.</p>	<p>Kërkesa të tilla nuk ekzistojnë në Kosovë.</p>	<p>Në mospërputhje</p>

¹⁰² Direktiva 2009/101/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 16 shtator 2009 për bashkërendimin, me qëllim për t'i bërë të barasvlershme, të garancive që kërkohen, në Shtetet Anëtare, nga kompanitë në kuptim të nenit 48, paragrafi i dytë i Traktatit për mbrojtjen e interesave të ortakëve dhe të palëve të treta (OJ L 258, 1.10.2009, f. 11).

Dispozitat e Direktivës (BE) 2015/849	Përshkrimi dhe Analiza e masave në Kosovë	Niveli i pajtueshmërisë
<p>Ky informacion shtesë përfshin së paku datën e lindjes apo hollësitë për kontaktim në pajtim me rregullat për mbrojtjen e të dhënave.</p> <p>► M1</p> <p>5a. Shtetet Anëtare mund të zgjedhin që të ofrojnë qasje në informacionin e mbajtur në regjistrat e tyre kombëtarë të cekur në paragrafin 3 me kusht të regjistrimit në internet dhe pagesës së një tarife, e cila nuk tejkalon koston administrative për ofrimin e informacionit, përfshirë koston e mirëmbajtjes dhe zhvillimit të regjistrit.</p> <p>► M1</p> <p>6. Shtetet Anëtare sigurojnë që autoritetet kompetente dhe NjIF-i kanë qasje në kohë dhe të pakufizuar në tërë informacionin e ruajtur në regjistrin qendror të cekur në paragrafin 3 pa e alarmuar subjektin e prekur. Shtetet Anëtare gjithashtu lejojnë qasjen me kohë nga subjektet e detyruara kur merren masat e kujdesit të duhur ndaj klientit në pajtim me Kapitullin II.</p> <p>Autoritetet kompetente të cilat kanë qasje në regjistrin e cekur në paragrafin 3 janë ato autoritete publike me përgjegjësi të deleguar për të luftuar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit, si dhe autoritetet tatimore, mbikëqyrësit e subjekteve të detyruara dhe autoritetet që kanë funksionin e hetimit dhe ndjekjes penale të pastrimit të parave, veprave të ndërlidhura penale përkatëse dhe financimin e terrorizmit, gjurmimin dhe sekuestrimin apo ngrirjen dhe konfiskimin e pasurive kriminale.</p>		
<p>7. Shtetet Anëtare sigurojnë që autoritetet kompetente dhe NjIF-i janë në gjendje që t'ua ofrojnë informacionin e cekur në paragrafin 1 dhe 3 autoriteteve kompetente dhe NjIF-it të Shteteve të tjera Anëtare në kohë dhe falas.</p>	<p>Nuk ka kërkesa korresponduese meqenëse informacioni mbi pronësinë përfituese nuk është detyrimisht i mbajtur në mënyrë që të lejohet qasja efikase në pajtim me linjat e dispozitave përkatëse të Direktivës.</p>	<p>Në mospërputhje</p>
<p>▼ B</p> <p>8. Shtetet Anëtare kërkojnë që subjektet e detyruara të mos bazohen vetëm në regjistrin qendror të cekur në paragrafin 3 për të përmbushur kërkesat e tyre për kujdesin e duhur ndaj klientit në pajtim me Kapitullin II. Këto kërkesa plotësohen duke përdorur një qasje të bazuar në rrezik.</p>	<p>Nuk aplikohet</p>	<p>Nuk aplikohet</p>
<p>► M1</p> <p>9. Në rrethana të jashtëzakonshme të cilat duhet të parashtrohen në ligjin kombëtar, kur qasja e cekur sipas paragrafit 5 nënparagrafi i parë shkronjat (b) dhe (c) do të</p>	<p>Nuk aplikohet</p>	<p>Nuk aplikohet</p>

Dispozitat e Direktivës (BE) 2015/849	Përshkrimi dhe Analiza e masave në Kosovë	Niveli i pajtueshmërisë
<p>ekspozonte pronarin përfitues ndaj rrezikut joproportional, rrezikut të mashtrimit, rrëmbimit, shantazhit, zhvatjes, ngacmimit, dhunës apo shtrëngimit, apo kur pronari përfitues është i mitur apo ka ndonjë paaftësi tjetër ligjore, Shtetet Anëtare mund të parashohin një përjashtim nga qasja e tillë nga i tërë apo një pjesë e informacionit mbi pronësinë përfituese nga rasti në rast. Shtetet Anëtare sigurojnë që këto përjashtime të jepen në bazë të një vlerësimi të hollësishëm të natyrës së jashtëzakonshme të rrethanave. Të drejtat për një rishikim administrativ të vendimit për përjashtim dhe për një mjet juridik efektiv janë të garantuara. Një Shtet Anëtar që ka lejuar përjashtime publikon të dhëna statistikore vjetore mbi numrin e përjashtimeve të lejuara dhe arsyet e cekura si dhe ia raporton këto të dhëna Komisionit.</p> <p>Përjashtimet e lejuara në pajtim me nënparagrafin e parë të këtij paragrafi nuk vlejné për institucionet kreditore dhe institucionet financiare, apo për subjektet e detyruara të cekura në nenin 2(1) paragrafi (3)(b) që janë zyrtarë publikë.</p> <p>10. Shtetet Anëtare sigurojnë që regjistrat qendrorë të cekur në paragrafin 3 të këtij neni janë të ndërlidhur përmes Platformës Qendrore Evropiane të krijuar nga neni 22(1) i Direktivës (BE) 2017/1132 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit ⁽¹⁰³⁾. Lidhja e regjistrave qendrorë të Shteteve Anëtare me platformën rregullohet në pajtim me specifikat teknike dhe procedurat e krijuara duke i zbatuar aktet e miratuara nga Komisioni në pajtim me nenin 24 të Direktivës (BE) 2017/1132 dhe me nenin 31a të kësaj Direktive.</p> <p>Shtetet Anëtare sigurojnë që informacioni i cekur në paragrafin 1 të këtij neni të jetë në dispozicion përmes sistemit të ndërlidhjes së regjistrave të krijuar nga neni 22(1) i Direktivës (BE) 2017/1132, në pajtim me ligjet kombëtare të Shteteve Anëtare në zbatim të paragrafëve 5, 5a dhe 6 të këtij neni.</p> <p>Informacioni i cekur në paragrafin 1 është i qashtëm përmes regjistrave kombëtarë dhe përmes sistemit të ndërlidhjes së regjistrave për së paku pesë vjet dhe jo më shumë se 10 vjet pasi që shoqëria tregtare apo subjekti tjetër juridik është fshirë nga regjistri. Shtetet Anëtare bashkëpunojnë me njëri-tjetrin dhe me Komisionin për të zbatuar llojet e ndryshme të qasjes në pajtim me këtë nen.</p>		

¹⁰³ Direktiva (BE) 2017/1132 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 14 qershor 2017 për aspekte të caktuara të së drejtës së kompanive (OJ L 169, 30.6.2017, f. 46).

Dispozitat e Direktivës (BE) 2015/849	Përshkrimi dhe Analiza e masave në Kosovë	Niveli i pajtueshmërisë
<p>▼B</p> <p style="text-align: center;">Neni 31</p> <p>►M1</p> <p>1. Shtetet Anëtare sigurojnë që ky nen zbatohet për trustet dhe llojet e tjera të marrëveshjeve juridike, si, ndër të tjera, fiducie, lloje të caktuara të Treuhand or fideicomiso, kur marrëveshjet e tilla kanë një strukturë apo funksione të ngjashme me trustet. Shtetet Anëtare identifikojnë karakteristikat për të vendosur kur marrëveshjet juridike kanë një strukturë apo funksione të ngjashme me trustet në raport me marrëveshjet e tilla juridike që qeverisen nga ligjet e tyre.</p> <p>Secili Shtet Anëtar kërkon që administratorët e besuar të çdo trusti ekspres të rregulluar në atë Shtet Anëtar të sigurojnë dhe mbajnë informacion të përshtatshëm, të saktë dhe të përditësuar mbi pronësinë përfutuese në lidhje me trustin. Ky informacion përfshin identitetin e:</p> <ul style="list-style-type: none"> (a) themeluesit(ve) të trustit; (b) administratorit(ve) të besuar të trustit; (c) mbrojtësit(ve) të trustit (nëse ka); (d) përfituesit apo kategorisë së përfituesve; (e) çdo personi tjetër fizik që ushtron kontroll efektiv mbi trustin. <p>Shtetet Anëtare sigurojnë që shkeljet e këtij neni t'u nënshtrohen masave apo sanksioneve efektive, proporcionale dhe zhbindëse.</p> <p>2. Shtetet Anëtare sigurojnë që administratorët e besuar të trustit apo personat që kanë pozita të barasvlershme në marrëveshje të ngjashme juridike siç janë cekur në paragrafin 1 të këtij neni, ua zbulojnë me kohë statusin e tyre dhe informacionin e cekur në paragrafin 1 të këtij neni subjekteve të detyruara, ku si administratorë të besuar të trustit apo persona që kanë pozita të barasvlershme në marrëveshje të ngjashme juridike, ata krijojnë një marrëdhënie biznesi apo kryejnë një transaksion të rastit mbi prapun e paraparë në nenin 11, shkronjat (b), (c) dhe (d).</p>	<p>Dispozita të tilla nuk ekzistojnë në legjislacionin në Kosovë. Nuk ekzistojnë kërkesa për të siguruar zbulimin e informacionit për subjektet e detyruara. Nuk ka informacion se janë kryer analiza dhe përcaktimi i marrëveshjeve të ngjashme me trustet.</p>	<p>Në mospërputhje</p>

Dispozitat e Direktivës (BE) 2015/849	Përshkrimi dhe Analiza e masave në Kosovë	Niveli i pajtueshmërisë
<p>▼B</p> <p>3. Shtetet Anëtare kërkojnë që informacioni i cekur në paragrafin 1 mund të qaset në kohë nga autoritetet kompetente dhe NjIF-et.</p> <p>►M1</p> <p>3a. Shtetet Anëtare kërkojnë që informacioni për pronësinë përfituese të trusteve ekspres dhe marrëveshjeve të ngjashme siç janë cekur në paragrafin 1 mbahet në një regjistër qendror të pronësisë përfituese të krijuar nga Shtetet Anëtare ku administratori i besuar i trustit apo personi që e mban një pozitë të barasvlershme në një marrëveshje të ngjashme juridike është vendosur apo banon.</p> <p>Kur vendi i themelimit apo vendqëndrimit të administratorit të besuar të trustit apo personit që e mban një pozitë të barasvlershme në një marrëveshje të ngjashme juridike është jashtë Unionit, informacioni i cekur në paragrafin 1 mbahet në një regjistër qendror të krijuar nga Shteti Anëtar ku administratori i besuar i trustit apo personi që e mban një pozitë të barasvlershme në një marrëveshje të ngjashme juridike hyn në marrëdhënie biznesi apo blen patundshmëri në emër të trustit apo marrëveshjes së ngjashme juridike.</p> <p>Kur administratorët e besuar të një trusti apo personat që e mbajnë një pozitë të barasvlershme në një marrëveshje të ngjashme juridike janë të vendosur apo banojnë jashtë në Shtete Anëtare të ndryshme, apo kur administratori i besuar i trustit apo personi që e mban një pozitë të barasvlershme në një marrëveshje të ngjashme juridike hyn në marrëdhënie të shumëfishta biznesi në emër të trustit apo marrëveshjes së ngjashme juridike në Shtete Anëtare të ndryshme, një certifikatë e vërtetimit të regjistrimit apo një ekstrakt i informacionit të pronësisë përfituese që mbahet në një regjistër nga njëri prej Shteteve Anëtare mund të konsiderohet si i mjaftueshëm për të konsideruar si të përmbushur detyrimin e regjistrimit.</p>	<p>Trustet nuk mund të themelohen sipas legjislacionit të Kosovës. Gjithsesi, nuk ekziston asnjë dispozitë për të siguruar zbatimin e kërkesave për informacion në raport me administratorët e besuar të trustit që banojnë në Kosovë, të cilët hyjnë në marrëdhënie biznesi në Kosovë apo që blejnë pasuri për ta regjistruar në regjistrin qendror.</p>	<p>Në mospërputhje</p>
<p>►M1</p> <p>4. Shtetet Anëtare sigurojnë që informacioni për pronësinë përfituese për një trust apo marrëveshje të ngjashme juridike mund të qaset në të gjitha rastet nga:</p> <p>(a) autoritetet kompetente dhe NjIF-et pa kurrfarë kufizimi;</p> <p>(b) subjektet e detyruara, në kuadër të kornizës së kujdesit të duhur ndaj klientit në</p>	<p>Në legjislacionin e Kosovës nuk vlejnjë marrëveshje të ngjashme.</p>	<p>Në mospërputhje</p>

Dispozitat e Direktivës (BE) 2015/849	Përshkrimi dhe Analiza e masave në Kosovë	Niveli i pajtueshmërisë
<p>pajtim me Kapitullin II;</p> <p>(c) çdo person fizik apo juridik i cili mund të demonstrojë një interesim të ligjshëm;</p> <p>(d) çdo person fizik apo juridik i cili e parashtron një kërkesë me shkrim në lidhje me një trust apo marrëveshje të ngjashme juridike i cili mban ose zotëron një pjesëmarrje kontrolluese në çfarëdo shoqëri tregtare apo subjekt juridik tjetër nga ato që janë cekur në nenin 30(1), përmes pronësisë së drejtpërdrejtë apo të tërthortë, përfshirë përmes bartësve të aksioneve, ose përmes kontrollit nëpërmjet mjeteve të tjera.</p> <p>Informacioni që është i qasshëm për personat fizikë apo juridikë të cekur në shkronjat (c) dhe (d) të nënparagrafit të parë përbëhet nga emri, muaji dhe viti i lindjes dhe vendi banimit dhe i shtetësisë të pronarit përfitues, si dhe natyra dhe shkalla e interesit përfitues të kontrolluar.</p> <p>Shtetet Anëtare mundën, nën kushtet që përcaktohen nga ligji kombëtar, të ofrojnë qasjen në informacion shtesë që mundëson identifikimin e pronarit përfitues që informacioni shtesë të përfshijë së paku datën e lindjes apo hollësitë për kontaktim në pajtim me rregullat për mbrojtjen e të dhënave. Shtetet Anëtare mund të lejojnë qasje më të gjerë në informacionin e mbajtur në regjistër në pajtim me ligjin e tyre kombëtar.</p> <p>Autoritetet kompetente të cilat kanë qasje në regjistrin e cekur në paragrafin 3a janë autoritete publike me përgjegjësi të deleguara për të luftuar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit, si dhe autoritetet tatimore, mbikëqyrësit e subjekteve të detyruara dhe autoritetet që kanë funksionin e hetimit dhe ndjekjes penale të pastrimit të parave, veprave të ndërlidhura penale përkatëse dhe financimin e terrorizmit, gjurmimin, dhe sekuestrimin apo ngrirjen dhe konfiskimin e pasurive kriminale.</p> <p>► M1</p> <p>4a. Shtetet Anëtare mund të zgjedhin që të ofrojnë qasje në informacionin e mbajtur në regjistrat e tyre kombëtar të cekur në paragrafin 3a me kusht të regjistrimit në internet dhe pagesës së një tarife, e cila nuk tejkalon koston administrative për ofrimin e informacionit, përfshirë koston e mirëmbajtjes dhe zhvillimit të regjistrit.</p>		

Dispozitat e Direktivës (BE) 2015/849	Përshkrimi dhe Analiza e masave në Kosovë	Niveli i pajtueshmërisë
<p>► M1</p> <p>5. Shtetet anëtare kërkojnë që informacioni i mbajtur në regjistrin qendror siç është cekur në paragrafin 3a është i përshtatshëm, i saktë dhe i përditësuar si dhe krijojnë mekanizmat për këtë qëllim. Mekanizmat e tillë përfshijnë kërkesën për subjektet e detyruara dhe, nëse është e përshtatshme dhe për sa kohë që kjo kërkesë nuk ndërhyr panevojshëm në funksionet e tyre, autoritetet kompetente që të raportojnë çdo mospërputhje që e gjejnë në mes të informacionit për pronësinë përfituese që gjendet në regjistrat qendrorë dhe informacionit për pronësinë përfituese që e kanë ato. Në rast të raportimit të mospërputhjeve, Shtetet Anëtare sigurojnë që të ndërmerren veprimet e duhura për të zgjidhur mospërputhjet në kohë, dhe nëse është e përshtatshme, në ndërkohë të përfshihet përmendja specifike në regjistrin qendror.</p> <p>▼ B</p> <p>6. Shtetet Anëtare sigurojnë që subjektet e detyruara të mos bazohen vetëm në regjistrin qendror të cekur në paragrafin 4 për të përmbushur kërkesat e tyre për kujdesin e duhur ndaj klientit në pajtim me Kapitullin II. Këto kërkesa plotësohen duke përdorur një qasje të bazuar në rrezik.</p>		
<p>► M1</p> <p>7. Shtetet Anëtare sigurojnë që autoritetet kompetente dhe NjIF-i janë në gjendje që t'ua ofrojnë informacionin e cekur në paragrafin 1 dhe 3 autoriteteve kompetente dhe NjIF-eve të Shteteve të tjera Anëtare në kohë dhe falas.</p>	<p>Nuk ka në dispozicion informacione të tilla për të siguruar këmbimin efektiv. Çdo informacion do të mund të sigurohet në bazë të KDK-së së kryer vetëm nga subjektet e detyruara. Autoriteteve kompetente iu është dhënë kompetenca për të shkëmbyer çdo informacion në dispozicion, me pengesa të mundshme për mbikëqyrësit në sferën e kujdesit (për shembull, për shkak të kërkesave të rrepta lidhur me nxjerrjen e informacionit).</p>	<p>Në mospërputhje</p>
<p>► M1</p> <p>7a. Në rrethana të jashtëzakonshme të cilat duhet të parashtrihen në ligjin kombëtar, kur qasja e cekur në paragrafin 4 nënparagrafi i parë shkronjat (b), (c) dhe (d) do të ekspozonte pronarin përfitues ndaj rrezikut joproporcional, rrezikut të mashtrimit, rrëmbimit, shantazhit, zhvatjes, ngacimit, dhunës apo shtrëngimit, apo kur pronari përfitues është i mitur apo ka ndonjë paaftësi tjetër ligjore, Shtetet Anëtare mund të parashohin një përjashtim nga qasja e tillë nga i tërë apo një pjesë e informacionit mbi pronësinë përfituese nga rasti në rast. Shtetet Anëtare sigurojnë që këto përjashtime të jepen në bazë të një vlerësimi të hollësishëm të natyrës së</p>	<p>Nuk aplikohet.</p>	<p>Nuk aplikohet</p>

Dispozitat e Direktivës (BE) 2015/849	Përshkrimi dhe Analiza e masave në Kosovë	Niveli i pajtueshmërisë
<p>jashtëzakonshme të rrethanave. Të drejtat për një rishikim administrativ të vendimit për përjashtim dhe për një mjet juridik efektiv janë të garantuara. Një Shtet Anëtar që ka lejuar përjashtime publikon të dhëna statistikore vjetore mbi numrin e përjashtimeve të lejuara dhe arsyet e cekura si dhe do ia raporton këto të dhëna Komisionit.</p> <p>Përjashtimet e lejuara në pajtim me nënparagrafin e parë nuk vlejnë për institucionet kreditore dhe institucionet financiare, apo për subjektet e detyruara të cekura në nenin 2(1) paragrafi (3)(b) që janë zyrtarë publikë.</p> <p>Kur një Shtet Anëtar vendos që të krijojë një përjashtim në pajtim me nënparagrafin e parë, ai nuk kufizon qasjen në informacion nga autoritetet kompetente dhe NjIF-i.</p>		
<p>► M1</p> <p>9. Shtetet Anëtare sigurojnë që regjistrat qendrorë të cekur në paragrafin 3a të këtij neni janë të ndërlidhur përmes Platformës Qendrore Evropiane të krijuar nga neni 22(1) i Direktivës (BE) 2017/1132. Lidhja e regjistrave qendrorë të Shteteve Anëtare me platformën rregullohet në pajtim me specifikat teknike dhe procedurat e krijuara duke i zbatuar aktet e miratuara nga Komisioni në pajtim me nenin 24 të Direktivës (BE) 2017/1132 dhe me nenin 31a të kësaj Direktive.</p> <p>Shtetet Anëtare sigurojnë që informacioni i cekur në paragrafin 1 të këtij neni të jetë në dispozicion përmes sistemit të ndërlidhjes së regjistrave të krijuar nga neni 22(2) i Direktivës (BE) 2017/1132, në pajtim me ligjet kombëtare të Shteteve Anëtare në zbatim të paragrafëve 4 dhe 5 të këtij neni.</p> <p>Shtetet Anëtare ndërmarrin masa të përshtatshme për të siguruar se vetëm informacioni i cekur në paragrafin 1 që është i përditësuar dhe korrespondon me pronësinë përfituese aktuale të jetë i qasshëm përmes regjistrave kombëtare dhe përmes sistemit të ndërlidhjes së regjistrave, dhe qasja në këtë informacion të jetë në pajtim me rregullat për mbrojtjen e të dhënave.</p> <p>Informacioni i cekur në paragrafin 1 është i qasshëm përmes regjistrave kombëtarë dhe përmes sistemit të ndërlidhjes së regjistrave për së paku pesë vjet dhe jo më shumë se 10 vjet pasi që baza për të regjistruar informacionin për pronësinë përfituese siç është cekur në paragrafin 3a ka pushuar së ekzistuari. Shtetet Anëtare bashkëpunojnë me Komisionin për të zbatuar llojet e ndryshme të qasjes në pajtim me paragrafët 4 dhe 4a.</p>	<p>Nuk është e zbatueshme për shkak të mungesës së regjistrit qendror.</p>	<p>Nuk aplikohet</p>

Dispozitat e Direktivës (BE) 2015/849	Përshkrimi dhe Analiza e masave në Kosovë	Niveli i pajtueshmërisë
<p>► M1</p> <p>10. Deri më 10 korrik 2019, Shtetet Anëtare njoftojnë Komisionin për kategoritë, përshkrimin e karakteristikave, emrat dhe, kur është e aplikueshme, bazën juridike të trustit dhe marrëveshjeve juridike të ngjashme të cekura në paragrafin 1. Komisioni publikon listën e përbashkët të trusteve të tilla dhe marrëveshjeve juridike të ngjashme në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian deri më 10 shtator 2019.</p> <p>Deri më 26 qershor 2020 Komisioni parashtron një raport përpara Parlamentit Evropian dhe Këshillit ku vlerësohet nëse të gjitha trustet dhe marrëveshjet juridike të ngjashme siç janë cekur në paragrafin 1 të qeverisura sipas ligjit të Shteteve Anëtare janë identifikuar si duhet dhe u janë nënshtruar detyrimeve të parapara me këtë Direktivë. Kur është e nevojshme, Komisioni ndërmerr hapat e nevojshëm për të vepruar në bazë të gjetjeve të atij raporti.</p>		
<p style="text-align: center;">Neni 31a Mjetet detyruese</p> <p>Kur është e nevojshme, krahas mjeteve detyruese të miratuara nga Komisioni në pajtim me nenin 24 të Direktivës (BE) 2017/1132 dhe në pajtim me shtrirjen e nenit 30 dhe 31 të kësaj Direktive, përmes mjeteve detyruese Komisioni miraton specifikime teknike dhe procedura të nevojshme për të ofruar ndërlidhjen në mes të regjistrave qendrore të Shteteve Anëtare siç janë cekur në nenin 30(10) dhe nenin 31(9), në raport me:</p> <p>(a) specifikimin teknik që përcakton tërësinë e të dhënave teknike të nevojshme me qëllim që platforma të kryejë funksionet e saj si dhe metodave të ruajtjes, përdorimit dhe mbrojtjes së këtyre të dhënave;</p> <p>(b) kriteret e përbashkëta sipas të cilave informacioni i pronësisë përfituese është në dispozicion përmes sistemit të ndërlidhjes së regjistrave, varësisht nga niveli i qasjes së dhënë nga Shtetet Anëtare;</p> <p>(c) të dhënat teknike se si informacioni për pronarët përfitues vihet në dispozicion;</p> <p>(d) kushtet teknike të qasjes në shërbimet e ofruara nga sistemi i ndërlidhjes së regjistrave;</p>	Nuk përbën objekt të transpozimit.	Nuk aplikohet

Dispozitat e Direktivës (BE) 2015/849	Përshkrimi dhe Analiza e masave në Kosovë	Niveli i pajtueshmërisë
<p>(e) modalitetet teknike se si të zbatohen llojet e ndryshme të qasjes në informacion mbi pronësinë përfituese në bazë të nenit 30(5) dhe nenin 31(4);</p> <p>(f) modalitetet e pagesës kur qasja në informacionin e pronësisë përfituese i nënshtrohet pagesës së një tarife sipas nenit 30(5a) dhe nenit 31(4a) duke marrë parasysh metodat në dispozicion të pagesave sikur transaksionet e pagesave në distancë.</p> <p>Këto mjete detyruese miratohen në pajtim me procedurën analizuese të cekur në nenin 64a (2).</p> <p>Në mjetet e tij detyruese, Komisioni synon që të ripërdorë teknologjinë e provuar dhe praktikat ekzistuese. Komisioni siguron se sistemet që do të zhvillohen nuk do të pësojnë kosto mbi atë që është absolutisht e nevojshme në mënyrë që të zbatohet kjo Direktivë. Mjetet detyruese të Komisionit do të karakterizohen nga transparencja dhe shkëmbimi i përvojave dhe informacionit në mes të Komisionit dhe Shteteve Anëtare.</p>		
<p>▼B</p> <p>KAPITULLI IV DETYRIMET E RAPORTIMIT</p> <p><i>SEKSIONI 1</i> Dispozita të përgjithshme</p> <p style="text-align: center;">Neni 32</p> <p>1. Secili Shtet Anëtar themelon një NjIF në mënyrë që të parandalojnë, zbulojnë dhe luftojnë në mënyrë efektive pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit.</p> <p>2. Shtetet Anëtare njoftojnë Komisionin me shkrim për emrin dhe adresën e NjIF-it të tyre respektiv.</p> <p>3. Secila NjIF është operativisht e pavarur dhe autonome, gjë që do të thotë se NjIF-i ka autoritetin dhe kapacitetin për të kryer funksionet e veta lirshëm, duke përfshirë aftësinë për të marrë vendime autonome për të analizuar, kërkuar dhe shpërndarë informacione specifike. NjIF-i si njësi qendrore kombëtare është përgjegjëse për të pranuar dhe analizuar raporte të transaksioneve të dyshimta dhe informacione të tjera që kanë të bëjnë me pastrimin e parave, veprat e ndërlidhura penale përkatëse</p>	<p>Ju lutemi referojuni Shtojcës së PT-së, R. 29 si dhe RM 6. Kosova e ka themeluar një NjIF e cila i ka zbatuar politikën, procedurat, mekanizmat e bashkëpunimit dhe i ka në dispozicion burimet për të parandaluar, zbuluar dhe luftuar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit. Efektiviteti i vlerësuar nën RM 6 vlerësohet se është mesatar kryesisht për shkak të disa çështjeve që kanë të bëjnë me informacionin e përdorur për të zhvilluar inteligjencën financiare për hetimet dhe ndjekjen penale të PP-së, mospërputhjen e raporteve nga subjektet e detyruara me rreziqet kryesore.</p> <p>NjIF-i është themeluar në pajtim me Ligjin për PPP/LFT-në si një njësi operativisht e pavarur dhe autonome. Në pajtim me nenin 26 të Ligjit për PPP/LFT-në, NjIF-i pranon jo vetëm RTD-të por, edhe informacione të tjera përkatëse për PP-në, veprat e ndërlidhura penale dhe FT-në, përfshirë transaksionet me para të gatshme mbi pragun, informacionet shitesë nga subjektet raportuese (p.sh. për profesionet juridike të pavarura, OJQ-të, etj.) dhe autoritetet publike. NjIF-i është përgjegjëse për të analizuar raportet për paratë e gatshme që kalohen në kufi, informacionin nga autoritetet mbikëqyrëse dhe</p>	<p>Pjesërisht</p>

Dispozitat e Direktivës (BE) 2015/849	Përshkrimi dhe Analiza e masave në Kosovë	Niveli i pajtueshmërisë
<p>dhe financimin e terrorizmit. NjIF-i është përgjegjëse për t'ia shpërndarë autoriteteve kompetente rezultatet e analizave të saj dhe çdo informacion përkatës shtesë kur ka bazë për të dyshuar pastrimin e parave, veprat e ndërlidhura penale përkatëse dhe financimin e terrorizmit. Ajo është në gjendje që të sigurojë informacione shtesë nga subjektet e detyruara.</p> <p>Shtetet Anëtare ofrojnë për NjIF-in e tyre burime të përshtatshme financiare, njerëzore dhe teknike në mënyrë që ato të përmbushin detyrat e tyre.</p> <p>4. Shtetet Anëtare sigurojnë që NjIF-et e tyre të kenë qasje, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në kohë, në informacione financiare, administrative dhe të zbatimit të ligjit të cilat iu nevojiten atyre për të përmbushur si duhet detyrat e tyre. NjIF-et janë në gjendje që të përgjigjen ndaj kërkesave të autoriteteve kompetente në Shtetet e tyre Anëtare përkatëse kur kërkesat e tilla për informacion janë të motivuara nga shqetësimi që ka të bëjë me pastrimin e parave, veprat e ndërlidhura penale përkatëse dhe financimin e terrorizmit. Vendimi për të zhvilluar analizimin apo shpërndarjen e informacionit i takon NjIF-it.</p> <p>5. Kur ka arsye objektive për të hamendësuar se ofrimi i informacionit të tillë mund të ketë ndikim negativ në hetimet në vazhdim e sipër apo analizat, apo, në rrethana të jashtëzakonshme, kur zbulimi i informacionit do të ishte dukshëm në shpërpjesëtim me interesat e ligjshme të një personi fizik apo juridik ose të parëndësishme në raport me qëllimet për të cilat është kërkuar, NjIF-i nuk është e detyruar që t'iu bindet kërkesave për informacion.</p> <p>6. Shtetet Anëtare iu kërkojnë autoriteteve kompetente që të japin informata kthyesë për NjIF-in për përdorimin e informacionit të ofruar në pajtim me këtë nen dhe për rezultatet e hetimeve apo inspektimeve të kryera në bazë të këtij informacioni.</p> <p>7. Shtetet Anëtare sigurojnë që NjIF-i të ketë autorizim që të ndër marrë veprime urgjente, drejtpërdrejt apo tërthorazi, kur ka dyshime se një transaksion është i ndërlidhur me pastrimin e parave apo financimin e terrorizmit, për të pezulluar apo për të ndaluar miratimin për një transaksion që është duke u ekzekutuar, në mënyrë që të analizohet transaksioni, të konfirmohet dyshimi dhe që rezultatet e analizës t'iu shpërndahen autoriteteve kompetente. NjIF-i ka autorizim për të ndër marrë veprime të tilla, drejtpërdrejt apo tërthorazi, me kërkesë të NjIF-it nga një Shtet tjetër Anëtar për periudhat dhe nën kushtet e specifikuara sipas ligjit kombëtar të NjIF-it që e pranon kërkesën.</p>	<p>autoritetet e tjera kompetente publike. Funkcioni i shpërndarjes është paraparë në nenin 15 të Ligjit për PPP/LFT-në. NjIF-i është në gjendje që të sigurojë informacion shtesë nga subjektet raportuese në të gjitha rastet e hapura për analizë, të cilat sigurojnë përputhshmëri me këtë kërkesë të Direktivës.</p> <p>Funksioni analitik dhe i shpërndarjes së NjIF-it duket se është i konsoliduar mirë dhe, në parim, gjeneron informacion të dobishëm dhe cilësor për autoritetet kompetente me disa kufizime të ndërlidhura me përdorimin e pamjaftueshëm potencial të disa prej burimeve në dispozicion për shkak të kufizimeve të mundshme të burimeve dhe arsyeve të përshtatshmërisë në lidhje me prioritetet e caktuara të autoriteteve kompetente.</p> <p>NjIF-i ka qasje në një numër të gjerë të burimeve të informacioneve, por ka kufizime të cilësisë dhe shtrirjes së informacionit në dispozicion në disa raste si dhe me afatet kohore për të siguruar disa prej informacioneve dhe informatave kthyesë siç është cekur nën R. 29.3 dhe RM 6.</p> <p>NjIF-i e ka bazën e nevojshme ligjore dhe efektivisht i përgjigjet kërkesave për informim nga autoritetet kompetente siç kërkohet nga Direktiva. Ofrimi i informacionit kryhet në pajtim me nenin 15 të Ligjit për PPP/LFT-në dhe saktësisht në kuadër të kompetencës respektive të NjIF-it dhe marrësit kur është e rëndësishme për qëllime të hetimit. Sidoqoftë, nuk ka dispozita të qarta për zbatimin e arsyeve të refuzimit të parapara në paragrafin 5 të Direktivës. Në praktikë, këto arsye për refuzim do të konsideroheshin nga NjIF-i.</p> <p>Lidhur me paragrafin 6 të nenit 32 të Direktivës nuk ka dispozita në ligj apo në marrëveshjet e bashkëpunimit në mes të autoriteteve kompetente për të siguruar informata kthyesë. Në praktikë, cilësia dhe afatet kohore për informatat kthyesë që i jepen NjIF-it dallojnë, ato nga PK-ja zakonisht janë në një nivel më të ulët se informacioni</p>	

Dispozitat e Direktivës (BE) 2015/849	Përshkrimi dhe Analiza e masave në Kosovë	Niveli i pajtueshmërisë
<p>8. Funkzioni analizues i NjIF-it përbëhet nga sa vijon:</p> <p>(a) një analizë operative e cila përqendrohet në rastet individuale dhe shënjestrat specifike apo në informacionin e duhur të përzgjedhur, varësisht nga lloji i vëllimit të raporteve të pranuar dhe përdorimi i pritur nga informacioni pas shpërndarjes; dhe</p> <p>(b) një analizë strategjike që adreson tendencat dhe format e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.</p> <p>► M1</p> <p>9. Pa paragjykim ndaj nenit 34(2), në kontekstin e funksioneve të saj, secila NjIF është në gjendje që të kërkojë, sigurojë dhe përdorë informacion nga ndonjë subjekt i detyruar për qëllimin e paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, edhe nëse nuk është parashtruar ndonjë raport i mëparshëm në përputhje me nenin 33(1) (a) apo 34(1).</p>	<p>përkatës nga autoritetet tatimore.</p> <p>Në raport me paragrafin 7, NjIF-i është tërësisht i autorizuar që të pezullojë transaksionet në pajtim me nenet 27 dhe 28 të Ligjit për PPP/LFT-në në bazë të informacionit vendor që e pranon si dhe në bazë të një kërkesë me shkrim dhe të bazuar nga cilado palë homologe e huaj që kryen funksione të ngjashme. Neni 26 i Ligjit për PPP/LFT-në kërkon që subjekti raportues të njoftojë NjIF-in përpara se të ndërmarrë ndonjë veprim lidhur me ndonjë akt apo transaksion të dyshimtë, i cili mund të rezultojë në lirim apo transferim të pasurisë që i nënshtrohet transaksionit nga kontrolli i subjektit raportues. Pas pranimit të njoftimit, në pajtim me paragrafin 5 të këtij neni, NjIF-i, brenda afatit kohor prej dyzet e tetë (48) orëve, udhëzon subjektin raportues që të lejojë ekzekutimin e transaksionit apo të kryejë ngrirjen e përkohshme sipas nenit 27 të këtij ligji.</p> <p>Në bazë të nenit 14 dhe 15 të Ligjit për PPP/LFT-në, NjIF-i ka të drejtë që të kryejë analizë operative duke pranuar dhe analizuar raportet dhe informacionin që kanë të bëjnë me të ardhurat nga krimi dhe financimin e terrorizmit, të grumbullojë të gjitha informacionet përkatëse që kanë të bëjnë me ushtrimin e detyrave të veta dhe të shpërndajë informacionin për transaksione të veçanta të dyshimta dhe rezultatin e analizës për dyshimin për pastrim të parave, vepra të ndërlidhura penale dhe financim të terrorizmit. Në bazë të nenit 14 të Ligjit për PPP/LFT-në, NjIF-i është e autorizuar që të kryejë analiza strategjike të informatave që i grumbullon dhe pranon për të parandaluar dhe luftuar pastrimin e parave, veprat e ndërlidhura penale dhe financimin e terrorizmit. Në të njëjtën kohë, nuk është e qartë nëse i tërë informacioni përkatës që mund të sigurohet nga autoritetet kompetente përfshihet në analizën strategjike për shkak të kufizimeve të fshehtësisë profesionale.</p>	

Dispozitat e Direktivës (BE) 2015/849	Përshkrimi dhe Analiza e masave në Kosovë	Niveli i pajtueshmërisë
	NjIF-i është e autorizuar që të sigurojë dhe përdorë (kjo i nënshtrohet zbatueshmërisë së kufizimeve të privilegjit juridik) të gjitha të dhënat, dokumentet apo informatat e nevojshme për të ndërmarrë funksionet e saj sipas Ligjit për PPP/LFT-në në përputhje me nenin 14, paragrafi 1.4. Në praktikë, informacioni mund të kërkohet sa herë që hapet një rast, gjë që mund të bëhet në bazë të të gjitha informacioneve që janë në dispozicion të NjIF-it. Qasja në një raport të mëparshëm nuk është parakusht për të kërkuar, siguruar dhe përdorur informacionin e tillë.	
<p style="text-align: center;">Neni 32a</p> <p>1. Shtetet Anëtare krijojnë mekanizma të automatizuar qendrorë, siç janë regjistrat qendrorë apo sistemet elektronike qendrore për nxjerrje të të dhënave, të cilat mundësojnë identifikimin, në kohë, të çdo personi fizik apo juridik që mban ose kontrollon llogaritë e pagesave dhe llogaritë bankare të identifikuar nga IBAN siç është përkufizuar nga Rregullorja (BE) nr. 260/2012 e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit ¹⁰⁴, dhe kasafortave të një institucioni kreditor në kuadër të territorit të tyre. Shtetet anëtare njoftojnë Komisionin për karakteristikat e këtyre mekanizmave kombëtarë.</p> <p>2. Shtetet Anëtare sigurojnë që informacioni i mbajtur në mekanizmat qendrorë të cekur në paragrafin 1 të këtij neni mund të qaset drejtpërdrejt nga NjIF-e kombëtare në mënyrë të menjëhershme dhe të pafiltruar. Po ashtu, informacioni mund të qaset nga autoritetet kompetente kombëtare për të plotësuar detyrimet e tyre sipas kësaj Direktive. Shtetet Anëtare sigurojnë që çdo NjIF është në gjendje që të ofrojë informacionin e mbajtur në mekanizmat e centralizuar, të cekur në paragrafin 1 të këtij neni, për çdo NjIF tjetër në kohë dhe në pajtim me nenin 53.</p> <p>3. Informacioni në vijim është i qasshëm dhe i kërkueshëm përmes mekanizmave qendrorë të cekur në paragrafin 1:</p> <p>- për bartësin e llogarisë së klientit dhe çdo person që pretendon se vepron në emër të klientit: emri, i përcjellë nga të dhënat e tjera identifikuese që kërkohen me dispozitat kombëtare që transpozojnë nenin 13(1) shkronja (a), apo një numër unik i</p>	NjIF-i nuk ka në dispozicion asnjë sistem të automatizuar në lidhje me informacionin mbi pagesat apo llogaritë bankare, si dhe për kasafortat, apo mekanizmat që lejojnë identifikimin e bartësve të llogarive, pronarëve të tyre përfitues apo personave që pretendojnë se veprojnë në emrin e tyre. Janë krijuar mekanizma të centralizuar lidhur me informacionet për PEP-ët (në kuadër të masave kundër korrupsionit dhe me disa kufizime, ju lutemi shihni më sipër nën KDK-në e shtuar), pjesërisht për patundshmëritë, OJQ-të (me një numër kufizimesh dhe mangësish, ju lutem shihni R. 8 dhe RM 10), mjetet motorike.	Në mospërputhje (përveç pjesërisht me paragrafin 4)

¹⁰⁴ Rregullorja (BE) nr. 260/2012 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 14 mars 2012 për vendosjen e kërkesave teknike dhe tregtare për transfertat e kredive dhe debive direkte në euro dhe ndryshimin e rregullores (EC) nr. 924/2009 (OJ L 94, 30.3. 2012, f. 22).

Dispozitat e Direktivës (BE) 2015/849	Përshkrimi dhe Analiza e masave në Kosovë	Niveli i pajtueshmërisë
<p>identifikimit;</p> <p>- për pronarin përfitues të bartësit të llogarisë së klientit: emri, i përcjellë nga të dhënat e tjera identifikuese që kërkohen me dispozitat kombëtare që transpozojnë nenin 13(1) shkronja (a), apo një numër unik i identifikimit;</p> <p>- për bankën apo llogarinë e pagesës: numri IBAN dhe data e hapjes dhe mbylljes së llogarisë;</p> <p>- për kasafortën: emri i huazuesit i përcjellë nga të dhënat e tjera identifikuese që kërkohen me dispozitat kombëtare që transpozojnë nenin 13(1) shkronja (a), apo një numër unik i identifikimit dhe kohëzgjatjen e periudhës së huazimit.</p> <p>4. Shtetet Anëtare mund të marrin në konsideratë që të kërkojnë që informacionet e tjera që vlerësohen si thelbësore për NjIF-in dhe autoritetet kompetente për të përmbushur detyrimet e tyre sipas kësaj Direktive të mund të qasen dhe të kërkohen përmes mekanizmave të centralizuar.</p> <p>5. Deri më 26 qershor 2020 Komisioni parashtron një raport për Parlamentin Evropian dhe Këshillin për të vlerësuar kushtet dhe specifikat teknike dhe procedurat për të garantuar ndërlidhje të sigurt dhe efikase të mekanizmave të automatizuar qendrorë. Kur është e përshtatshme, ky raport do të përcillet me një propozim legjislativ.</p>		
<p style="text-align: center;">Neni 32b</p> <p>1. Shtetet Anëtare i ofrojnë NjIF-it dhe autoriteteve kompetente qasje në informacion që mundëson identifikimin në kohë të çdo personi fizik apo juridik që posedon patundshmëri, duke i përfshirë përmes regjistrave apo sistemeve elektronike për nxjerrje të të dhënave ku regjistrat apo sistemet e tilla janë në dispozicion.</p> <p>2. Deri më 31 dhjetor 2020 Komisioni dorëzon një raport para Parlamentit Evropian dhe Këshillit ku vlerëson nevojën dhe proporcionalitetin e harmonizimit të informacionit të përfshirë në regjistra si dhe nevojën për ndërlidhjen e këtyre regjistrave. Kur është e përshtatshme, ky raport përcillet me një propozim legjislativ.</p>	<p>Në Kosovë nuk është zbatuar në tërësi asnjë sistem i tillë për të lejuar qasjen në të gjitha informacionet përkatëse. Ju lutemi referojuni RM 6 dhe R. 29.</p>	<p>Pjesërisht</p>
<p>▼B</p> <p style="text-align: center;">Neni 33</p> <p>1. Shtetet Anëtare kërkojnë nga subjektet e detyruara, dhe sipas rastit, drejtorët dhe</p>	<p>Ju lutemi referojuni Shtojcës së PT-së, R. 20 si dhe RM 3, 4 dhe 6.</p> <p>Detyrimi për të raportuar transaksionet e dyshimta është i kufizuar në baza të arsyeshme për të ardhura të dyshimta nga aktiviteti kriminal, duke e lënë rrjedhimisht jashtë</p>	<p>Pjesërisht</p>

Dispozitat e Direktivës (BE) 2015/849	Përshkrimi dhe Analiza e masave në Kosovë	Niveli i pajtueshmërisë
<p>punonjësit e tyre që të bashkëpunojnë plotësisht dhe menjëherë duke:</p> <p>(a) informuar NjIF-in, përfshirë dorëzimin e një raporti, me nismën e tyre, ku subjekti i detyruar e di, dyshon apo ka bazë të arsyeshme që të dyshojë se fondet, pa marrë parasysh shumën në pyetje, janë të ardhura nga aktivitete kriminale ose janë të ndërlidhura me financimin e terrorizmit, dhe në rastet e tilla duke iu përgjigjur menjëherë kërkesave të NjIF-it për informata shtesë; dhe</p> <p>► M1</p> <p>(b) duke i ofruar drejtpërdrejt NjIF-it, sipas kërkesës së saj, të gjitha informacionet e nevojshme.</p> <p>▼ B</p> <p>Të gjitha transaksionet e dyshimta, përfshirë edhe transaksionet e tentuara, raportohen.</p> <p>2. Personi i emëruar në pajtim me nenin 8(4) shkronja (a) ia transmeton informacionin e cekur në paragrafin 1 të këtij neni NjIF-it të Shtetit Anëtar në territorin e të cilit është themeluar subjekti i detyruar që e transmeton informacionin.</p>	<p>dijeninë. Kërkesa për raportim nuk është e lidhur me ndonjë prag. Një qasje gjithëpërfshirëse e veprave penale zbatohet në lidhje me veprat e ndërlidhura penale me PP-në. Detyrimi për raportim do të ishte i kufizuar nga mangësitë në lidhje me kriminalizimin e PP-së dhe FT-së. Nuk ka ndonjë dispozitë të qartë për ndonjë raportim nga drejtorët dhe punonjësit.</p> <p>Në pajtim me nenin 14 të Ligjit për PPP/LFT-në, NjIF-i mund të kërkojë nga subjektet raportuese çdo të dhënë, dokument apo informacion që nevojitet për të ushtruar funksionet e saj sipas këtij Ligji. Të dhënat, dokumentet apo informacioni ofrohen në kuadër të afatit kohor të caktuar nga NjIF-i.</p> <p>Transaksionet e tentuara janë të përfshira në nenin 26, paragrafi 1.1 i Ligjit për PPP/LFT-në.</p> <p>Siç është cekur nën R. 29.2, raportimi i RTD-ve është (potencialisht) i kufizuar nga mospërputhja në po të njëjtin legjislacion (Ligji për PPP/LFT-në) në mes të përkufizimit të FT-së për qëllimet e sistemit parandalues dhe sistemit të legjislacionit penal që krijon bazën për interpretime të ndryshme; kërkesa të ndryshme për raportimin e RTD-ve nga profesionistët ligjorë në nenin 26 dhe kërkesat shtesë për profesionistët (për shkak të dallimeve në përkufizimin e shtrirjes së aktiviteteve të profesionistëve ligjorë që bien nën pjesë të ndryshme të ligjit); brenga në lidhje me disa përjashtime të zbrazëta për raportim; mungesa e parashikimit të kërkesave specifike në Ligjin për PPP/LFT-në apo në aktin nënligjor për sigurimin e informatave shtesë në lidhje me RTD-të tashmë të raportuara (neni 26, paragrafi 2). Subjektet/personat e përfshirë në tregtinë e metaleve dhe gurëve të çmuar janë të kufizuar të shitësit dhe tregtarët në përgjithësi nuk janë të përfshirë.</p> <p>Janë shprehur disa brenga nga vlerësuesit në lidhje me cilësinë e raporteve, duke pasur parasysh shpërndarjet nga NjIF-i, si dhe përputhjen me profilin e rrezikut të Kosovës (ju lutemi referojuni RM 4 dhe RM 6). Niveli i raportimit është tejte i pabarabartë, ku shumica e</p>	

Dispozitat e Direktivës (BE) 2015/849	Përshkrimi dhe Analiza e masave në Kosovë	Niveli i pajtueshmërisë
	subjekteve jashtë sektorit bankar rrallëherë i dorëzojnë raportet dhe mbikëqyrja për zbatimin e kësaj kërkesë është e pabarabartë dhe ndikohet nga çështje të bashkëpunimit dhe kompetencave ligjore të mbikëqyrësve (ju lutemi shikoni RM 3).	
<p style="text-align: center;">Neni 34</p> <p>1. Pavarësisht nga neni 33(1), Shtetet Anëtare mundën, në rastet e subjekteve të detyruara që janë cekur në nenin 2(1) paragrafi (3)(a), (b) dhe (d), që të përcaktojnë një organ të përshtatshëm vetërregullues të profesionit në fjalë si autoritetin për të pranuar informacionin e cekur në nenin 33(1).</p> <p>Pa paragjykim ndaj paragrafit 2, organi i përcaktuar vetërregullues, në rastet e cekura në nënparagrafin e parë të këtij paragrafi, ia përcjell NjIF-it informacionin menjëherë dhe pa e filtruar.</p> <p>2. Shtetet Anëtare nuk i aplikojnë detyrimet e parapara në nenin 33(1) ndaj noterëve, profesionistëve të tjerë juridikë të pavarur, auditorëve, kontabilistëve të jashtëm dhe këshilltarëve tatimorë deri në atë shkallë sa përjashtimet e tilla ndërlidhen me informacionin që e pranojnë përmes, apo e sigurojnë nga ndonjëri prej klientëve të tyre gjatë vlerësimit të pozitës juridike të klientit të tyre, apo kryerjes së detyrës së tyre për të mbrojtur apo përfaqësuar klientin në, apo në lidhje me, procedurat juridike, përfshirë dhënien e këshillave mbi nisjen apo shmangien e këtyre procedurave, pa marrë parasysh nëse ky informacion pranohet apo sigurohet përpara, gjatë apo pas procedurave të tilla.</p> <p>► M1</p> <p>3. Organet vetërregulluese të përcaktuara nga Shtetet Anëtare publikojnë një raport vjetor i cili përmban informata për:</p> <p>(a) masat e ndërmarra në pajtim me nenet 58, 59 dhe 60;</p> <p>(b) numrin e raportimeve të pranuar për shkelje siç është cekur në nenin 61, kur kjo është e aplikueshme;</p> <p>(c) numrin e raporteve të pranuar nga organi vetërregullues i cekur në paragrafin 1</p>	<p>Autoritetet e Kosovës nuk e kanë futur në përdorim opsionin për zbutje sipas nenit 34.</p> <p>Kërkesa e paragrafit 2 është zbatuar pjesërisht në nenin 31, paragrafi 7 i Ligjit për PPP/LFT-në. Zbutja për rastet që kanë të bëjnë me përcaktimin e pozitës juridike të klientit të profesionistëve ligjorë nuk është e përfshirë në nenin e cekur të ligjit. Noterët dhe kontabilistët janë përjashtuar për shkak të natyrës së aktiviteteve të tyre (nuk është e mundur që të përfaqësohet një klient në rrethanat e cekura). Sidoqoftë, neni i cekur paraqet një kërkesë për mosofrimin e informacionit për NjIF-in pa e pyetur më parë klientin apo pa një urdhër të gjykatës. Kushti i parë mund të ndikojë negativisht në kërkesën për raportim, p.sh. njoftimi i klientit për dërgimin e një RTD-je. Kjo mbështetet me leximin e paragrafit 6, gjegjësisht "Përveç rasteve të parapara në paragrafin 7 (theksimi nga unë) të këtij neni dhe në përputhje me dispozitat e nënparagrafit 1.1 të nenit 26 të këtij ligji, profesionistët në fjalë të angazhuar në aktivitete specifike i raportojnë NjIF-it për akte apo transaksione të dyshimta...".</p> <p>Paragrafi 3 i këtij neni të Direktivës nuk është i zbatueshëm pasi që nuk ekziston një rol i tillë i përkufizuar juridikisht për organet vetërregulluese në Kosovë.</p>	Pjesërisht (në raport me paragrafin 2)

Dispozitat e Direktivës (BE) 2015/849	Përshkrimi dhe Analiza e masave në Kosovë	Niveli i pajtueshmërisë
<p>dhe numrin e raporteve të përcjella nga organi vetërregullues të NjIF-i, kur është e aplikueshme;</p> <p>(d) kur është e aplikueshme, numrin dhe përshkrimin e masave të kryera sipas nenit 47 dhe 48 për të monitoruar përputhshmërinë nga subjektet e detyruara me detyrimet e tyre sipas:</p> <p>(i) neneve 10 deri në 24 (kujdesi i duhur ndaj klientit);</p> <p>(ii) nenet 33, 34 dhe 35 (raportimi i transaksioneve të dyshimta);</p> <p>(iii) neni 40 (ruajtja e të dhënave); dhe</p> <p>(iv) nenet 45 dhe 46 (kontrollat e brendshme).</p>		
<p>▼B</p> <p style="text-align: center;">Neni 35</p> <p>1. Shtetet Anëtare iu kërkojnë subjekteve të detyruara që të përmbahen nga kryerja e transaksioneve për të cilat ato e dinë apo dyshojnë se janë të ndërlidhura me të ardhurat nga aktivitetet kriminale apo me financimin e terrorizmit deri sa të mos i kenë përfunduar veprimet e nevojshme në pajtim me nenin 33(1) nënparagrafi i parë shkronja (a) dhe u janë bindur çdo udhëzimi të mëtutjeshëm specifik nga NjIF-i apo autoritetet kompetente në pajtim me ligjin e Shtetit Anëtar përkatës.</p> <p>2. Kur përmbajtja nga kryerja e transaksioneve të referuara në paragrafin 1 nuk është e mundur apo ka gjasa që t'i pengojë përpjekjet për të përcjellë përfituesit e një operacioni të dyshuar, subjektet e detyruara në fjalë njoftojnë NjIF-in menjëherë pas kësaj.</p>	<p>Neni 26 i Ligjit për PPP/LFT-në kërkon që subjekti raportues të njoftojë NjIF-in përpara se të ndërmarrë ndonjë veprim lidhur me aktin apo transaksionin e dyshimtë që mund të rezultojë në lirimin apo transferimin e pasurisë që i nënshtrohet transaksionit nga kontrolli i subjektit raportues. Pas pranimit të njoftimit, në pajtim me paragrafin 5 të këtij neni, NjIF-i, brenda afatit prej dyzet e tetë (48) orëve udhëzon subjektin raportues që të lejojë ekzekutimin e transaksionit apo të kryejë ngrirjen e përkohshme sipas nenit 27 të këtij ligji.</p> <p>Kërkesa e Ligjit për PPP/LFT-në, për dallim nga dispozita e Direktivës, në mënyrë formale e lë jashtë detyrimin për të informuar NjIF-in kur ka dijeni për të ardhura nga aktiviteti kriminal (p.sh. mund të ketë një detyrim të përgjithshëm për t'i njoftuar autoritetet e zbatimit të ligjit por jo NjIF-in). Kjo do të përjashtonte aplikimin e autorizimit të NjIF-it në këtë drejtim. Për më tepër, Direktiva i referohet çdo transaksioni përderisa Ligji për PPP/LFT-në e kufizon detyrimin për transaksionin i cili do të rezultonte në lirimin apo transferimin e pasurisë që i nënshtrohet transaksionit nga kontrolli i subjektit raportues. Kjo sërish mund të rezultojë në ndërmarrjen e veprimeve të parakohshme nga autoritetet (p.sh. në rast të gjenerimit të fitimit apo qarkullimit të sajuar në po të</p>	<p>Pjesërisht</p>

Dispozitat e Direktivës (BE) 2015/849	Përshkrimi dhe Analiza e masave në Kosovë	Niveli i pajtueshmërisë
	njëtin subjekt). Nuk ekziston ndonjë dispozitë e qartë për zbatimin e paragrafit 2 të nenit 35 të Direktivës.	
<p style="text-align: center;">Neni 36</p> <p>1. Shtetet Anëtare sigurojnë që nëse, gjatë kontrolleve të kryera mbi subjektet e detyruara nga autoritetet kompetente të cekura në nenin 48, apo në çfarëdo mënyre, ato autoritete zbulojnë fakte që mund të lidhen me pastrimin e parave apo financimin e terrorizmit, ato e njoftojnë menjëherë NjIF-in.</p> <p>2. Shtetet Anëtare sigurojnë që organet mbikëqyrëse të autorizuara nga ligji apo rregullorja për të mbikëqyrur bursën, tregjet e valutave dhe tregjet e derivateve financiare njoftojnë NjIF-in nëse zbulojnë fakte që mund të ndërlidhen me pastrimin e parave apo financimin e terrorizmit.</p>	<p>Neni 38, paragrafi 2 i Ligjit për PPP/LFT-në parasheh që BQK-ja dhe mbikëqyrësit e tjerë sektorialë, kur gjatë kryerjes së detyrave brenda kompetencave të tyre, dyshojnë apo identifikojnë aktivitete që janë ose mund të jenë të lidhura me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit, njoftojnë menjëherë me shkrim NjIF-in. Duhet cekur se fjala aktivitete nuk është tërësisht në pajtim me faktet siç kërkohet nga Direktiva. Për më tepër, ekzistojnë çështje, siç është cekur në RM 4, të cilat do të kufizonin aftësinë e mbikëqyrësve (përpos NjIF-it) që të kontrollojnë zbatimin e kërkesës për raportim nga subjektet e detyruara në përgjithësi dhe rrjedhimisht do të ndikonin në aftësinë për të zbuluar çdo transaksion të mëtutjeshëm të dyshuar. Ekzistojnë edhe brenga në lidhje me kompetencat dhe efektivitetin e mbikëqyrësve të BPCJF-ve (ju lutemi referojuni RM 4).</p>	Pjesërisht
<p style="text-align: center;">Neni 37</p> <p>Zbulimi në mirëbesim i informacionit nga një subjekt i detyruar apo nga një punonjës apo drejtor i një subjekti të tillë të detyruar në pajtim me nenet 33 dhe 34 nuk përbëjnë shkelje të ndonjë kufizimi për zbulimin e informacionit të imponuar nga kontrata apo ndonjë dispozitë legjislative, rregullative apo administrative, dhe nuk e përfshin subjektin e detyruar apo drejtorët apo punonjësit e tij në përgjegjësi të çfarëdo lloji as edhe në rrethanat kur ato nuk kanë qenë saktësisht në dijeni të aktivitetit kriminal dhe pa marrë parasysh nëse aktiviteti ilegal ka ndodhur me të vërtetë.</p>	<p>Ju lutemi referojuni Shtojcës së PT-së, R. 21.1. Legjislacioni i Kosovës në përgjithësi është në përputhje me kërkesën e Direktivës pasi që neni 61 i Ligjit për PPP/LFT-në parasheh mbrojtjen nga përgjegjësia civile dhe penale. Sidoqoftë, vërehet se nuk ka kërkesë korresponduese që veprimi nuk do të përbënte shkelje të detyrimeve kontraktore apo ndonjë dispozite legjislative, rregullative apo administrative (p.sh. që potencialisht ta nënshtrojë një punonjës ndaj dëmtimit të reputacionit).</p>	Pjesërisht
<p>► M1</p> <p style="text-align: center;">Neni 38</p> <p>1. Shtetet Anëtare sigurojnë që individët, përfshirë individët dhe përfaqësuesit e subjektit të detyruar të cilët raportojnë brenda subjektit apo pranë NjIF-it dyshimet për pastrimin e parave apo financimin e terrorizmit të jenë ligjërish të mbrojtur nga ekspozimi ndaj kërcënimeve, veprimeve hakmarrëse apo armiqësore, dhe posaçërisht</p>	Dispozita të tilla nuk ekzistojnë në Kosovë.	Në mospërputhje

Dispozitat e Direktivës (BE) 2015/849	Përshkrimi dhe Analiza e masave në Kosovë	Niveli i pajtueshmërisë
<p>ndaj veprimeve negative apo diskriminuese gjatë punësimit.</p> <p>2. Shtetet Anëtare sigurojnë që individët të cilët janë të ekspozuar ndaj kërcënimeve, veprimeve hakmarrëse apo armiqësore, apo veprimeve punësuese negative apo diskriminuese për raportimin e pastrimit të parave apo financimit të terrorizmit brenda subjektit apo pranë NjIF-it kanë të drejtë që të parashtronë ankesë në mënyrë të sigurt pranë autoriteteve kompetente përkatëse. Pa paragjykim ndaj konfidencialitetit të informacionit të mbledhur nga NjIF-i, Shtetet Anëtare gjithashtu, sigurojnë që individët e tillë gëzojnë të drejtën e një mjeti juridik efektiv për të mbrojtur të drejtat e tyre sipas këtij paragrafi.</p>		
<p>▼B</p> <p>SEKSIONI 2 Ndalimi i zbulimit</p> <p style="text-align: center;">Neni 39</p> <p>1. Subjektet e detyruara dhe drejtorët e tyre nuk ia zbulojnë klientit apo personave të tjerë të tretë faktin se informacioni është duke, do të apo është transmetuar në pajtim me nenin 33 apo 34 apo që analiza e pastrimit të parave apo financimit të terrorizmit është duke apo mund të zhvillohet.</p> <p>2. Ndalimi i paraparë në paragrafin 1 nuk përfshin zbulimin përpara autoriteteve kompetente, përfshirë organet vetërregulluese, apo zbulimin për qëllime të zbatimit të ligjit.</p> <p>►M1</p> <p>3. Ndalimi i paraparë në paragrafin 1 të këtij neni nuk pengon zbulimin në mes të institucioneve kreditore dhe financiare nga Shtetet Anëtare me kusht që ato t'i takojnë grupit të njëjtë, apo në mes të atyre subjekteve dhe degëve dhe filialeve të tyre të kontrolluara të krijuara në vende të treta, me kusht që ato degë dhe filiale, në të cilat grupi zotëron shumicën e pronësisë së tyre, përputhen në tërësi me politikat dhe procedurat në nivel të grupit, përfshirë procedurat për shkëmbimin e informacionit në kuadër të grupit, në pajtim me nenin 45 dhe se politikat dhe procedurat në nivel grupi janë në pajtim me kërkesat e parapara në këtë Direktivë.</p> <p>▼B</p>	<p>Ju lutemi referojuni Shtojcës së PT-së, R. 21.2.</p> <p>Kërkesa në paragrafin 1 është përgjithësisht e përmbushur. Sidoqoftë, nuk është e qartë nëse ndalimi i nenit 26, paragrafi 4 të Ligjit për PPP/LFT-në do të vrente për çdo punonjës të subjektit raportues që parashtron raport (jo vetëm për punonjësit që e përgatisin dhe e dërgojnë raportin).</p> <p>Në lidhje me paragrafin 2 nuk ka zbutje të tillë në legjislacionin e Kosovës e cila e lejon dërgimin e raporteve tek autoritetet kompetente (posaçërisht për mbikëqyrësit) përpos nga dërgimi i tyre te prokurori publik. Krahas kësaj, neni i përmendur i Ligjit për PPP/LFT-në e lejon njoftimin e gjykatës, gjë që nuk do të ishte në pajtim me paragrafin 2 (apo së paku jo në të gjitha rastet, nëse marrim në konsideratë p.sh. një rast civil, i cili do të shkonte përtej qëllimeve të zbatimit të ligjit siç është paraparë në këtë paragraf).</p> <p>Kërkesa e nenit 24 të Ligjit për PPP/LFT-në për zbatimin e programeve në kuadër të grupit apo ndonjë dispozitë tjetër e Ligjit nuk e parashohin zbutjen nga kërkesa për nxjerrjen e informacionit për qëllimet e krijimit të politikave dhe procedurave në nivel të grupit siç kërkohet nga paragrafi 3 i nenit 39 të Direktivës.</p> <p>Zbutjet e paragrafëve të tjerë të Direktivës gjithashtu nuk janë zbatuar në ligjin e Kosovës.</p>	<p>Pjesërisht</p>

Dispozitat e Direktivës (BE) 2015/849	Përshkrimi dhe Analiza e masave në Kosovë	Niveli i pajtueshmërisë
<p>4. Ndalimi i paraparë në paragrafin 1 nuk pengon zbulimin në mes të subjekteve të detyruara siç është cekur në nenin 2(1) paragrafi (3)(a) dhe (b), apo subjekteve nga vendet e treta të cilat imponojnë kërkesa të barasvlershme me ato të parapara me këtë Direktivë, të cilat kryejnë aktivitetet e tyre profesionale, qoftë si punonjës apo jo, në kuadër të personit të njëjtë juridik apo një strukture më të madhe të cilës i takon personi dhe i cili ka pronësi, menaxhim apo kontroll të pajtueshmërisë të përbashkët.</p> <p>5. Për subjektet e cekura në nenin 2(1) paragrafët (1), (2), (3) dhe (b) në rastet që kanë të bëjnë me klientin e njëjtë dhe transaksionin e njëjtë që i përfshin dy apo më shumë subjekte të detyruara, ndalimi i paraparë në paragrafin 1 të këtij neni nuk pengon zbulimin në mes të subjekteve të detyruara përkatëse me kusht që ato të jenë nga një Shtet Anëtar, apo subjektet në një vend të tretë i cili i zbaton kërkesat e barasvlershme me ato të parashtruara në këtë Direktivë, dhe se ato janë nga kategoria e njëjtë profesionale dhe u nënshtrohen detyrimeve në raport me fshehtësinë profesionale dhe mbrojtjen e të dhënave personale.</p> <p>6. Kur subjektet e detyruara të cekura në nenin 2(1) paragrafi (3)(a) dhe (b) kërkojnë që të bindin një klient që të heqë dorë nga angazhimi në aktivitet ilegal, kjo nuk përbën zbulim në kuadër të kuptimit të paragrafit 1 të këtij neni.</p>		
<p>KAPITULLI V</p> <p>MBROJTJA E TË DHËNAVE, RUAJTJA E DOKUMENTEVE E TË DHËNAVE DHE TË DHËNAT STATISTIKORE</p> <p style="text-align: center;">Neni 40</p> <p>1. Shtetet Anëtare iu kërkojnë subjekteve të detyruara që të ruajnë dokumentet dhe informacionet në vijim në pajtim me ligjin kombëtar me qëllim të parandalimit, zbulimit dhe hetimit nga NJIF-i apo nga autoritete të tjera kompetente të pastrimit të parave apo të financimit të terrorizmit të mundshëm:</p> <p>► M1</p> <p>(a) në rastin e kujdesit të duhur ndaj klientit, një kopje e dokumenteve dhe informacioneve që janë të nevojshme për të qenë në përputhje me kërkesat e kujdesit të duhur ndaj klientit të parapara në Kapitullin II, duke përfshirë, kur kjo</p>	<p>Ju lutemi referojuni Shtojcës së PT-së, R. 11.</p> <p>Në lidhje me kërkesat e paragrafit 1, ligji i Kosovës përkufizon në vija të trasha informacionin që duhet të ruhet ("të gjitha të dhënat për informatat", neni 20, paragrafi 1) dhe përfshin informacion "për të mundësuar rindërtimin e transaksioneve, që janë ekzekutuar ose është tentuar të ekzekutohen". Sidoqoftë, dispozita nuk mund të interpretohet në mënyrë të ngushtë si kërkesë për dëshmi të mjaftueshme mbështetëse, dokumente apo kopje të pranueshme në procedura gjyqësore sipas ligjit kombëtar të aplikueshëm, siç është paraparë në paragrafin 1 të nenit 40 të Direktivës. Rregullorja e BQK-së e zgjidh këtë çështje për bankat, por jo për subjektet e tjera. Për më tepër, nuk është e qartë nëse i tërë informacioni i siguruar përmes masave të KDK-së do t'u nënshtrohej kërkesave për ruajtjen e të dhënave (p.sh.</p>	<p>Pjesërisht</p>

Dispozitat e Direktivës (BE) 2015/849	Përshkrimi dhe Analiza e masave në Kosovë	Niveli i pajtueshmërisë
<p>është e mundur, informacionin e siguruar përmes mjeteve të identifikimit elektronik, shërbimeve përkatëse të trustit siç janë paraparë në Rregulloren (BE) nr. 910/2014 apo çdo proces tjetër të sigurt, në distancë apo elektronik të identifikimit të rregulluar, njohur, pranuar apo miratuar nga autoritetet përkatëse kombëtare, për një periudhë prej pesë vjet pas përfundimit të marrëdhënies së biznesit me klientin e tyre apo pas datës së një transaksioni të rastit;</p> <p>▼B</p> <p>(b) dëshmitë mbështetëse dhe regjistrat e transaksioneve, që përbëhen nga dokumentet origjinale apo kopjet e pranueshme në procedura gjyqësore sipas ligjit kombëtar të aplikueshëm, të cilat janë të nevojshme për të identifikuar transaksionet, për një periudhë prej pesë vjet pas përfundimit të marrëdhënies së biznesit me klientin e tyre apo pas datës së një transaksioni të rastit.</p> <p>Pas skadimit të periudhave të ruajtjes të cekura në nënparagrafin e parë, Shtetet Anëtare sigurojnë që subjektet e detyruara fshijnë të dhënat personale, përpos kur parashihet ndryshe nga ligji kombëtar, i cili përcakton nën cilat rrethana subjektet e detyruara mund apo i ruajnë të dhënat edhe më tej. Shtetet Anëtare mund të lejojnë apo kërkojnë ruajtjen e mëtejshme pasi të kenë kryer një vlerësim të plotë të nevojës dhe proporcionalitetit të ruajtjes së tillë të mëtejshme dhe ta kenë vlerësuar si të nevojshme për parandalimin, zbulimin apo hetimin e pastrimit të parave apo financimit të terrorizmit. Periudha e ruajtjes së mëtejshme nuk tejkalon edhe pesë vite shtesë.</p> <p>►M1</p> <p>Periudha e ruajtjes e cekur në këtë paragraf, duke e përfshirë periudhën e ruajtjes së mëtejshme e cila nuk tejkalon pesë vite shtesë, vlen edhe në raport me të dhënat që mund të qasen përmes mekanizmave të centralizuar të cekur në nenin 32a.</p> <p>▼B</p> <p>2. Nëse, më 25 qershor 2015, procedurat ligjore në lidhje me parandalimin, zbulimin, hetimin apo ndjekjen penale të dyshuar të pastrimit të parave apo financimit të terrorizmit janë në proces në një Shtet Anëtar, dhe një subjekt i detyruar mban informacione apo dokumente në lidhje me ato procedura në proces, subjekti i detyruar mund të mbajë këtë informacion apo ato dokumente në pajtim me ligjin</p>	<p>përjashtimi i rezultateve të analizave të zhvilluara përpos atyre të specifikuara në nenin 25 të ligjit, regjistrat e siguruar përmes masave të KDK-së dhe çdo analize të ndërmarrë në raport me transaksionet e rastit; ju lutemi referojuni R. 11).</p> <p>Nënparagrafët 2 dhe 3 të paragrafit 1 nuk janë përmbushur. Periudha nuk është caktuar në 5 vjet por është cekur si periudha minimale për t'u respektuar. Neni 20 i Ligjit për PPP/LFT-në i referohet nxjerrjes së akteve nënligjore për të qartësuar më tej kërkesat për ruajtjen e të dhënave por asnjë akt i tillë nuk është nxjerrë. Paragrafi 2 nuk është i aplikueshëm.</p>	

Dispozitat e Direktivës (BE) 2015/849	Përshkrimi dhe Analiza e masave në Kosovë	Niveli i pajtueshmërisë
<p>kombëtar, për një periudhë prej pesë vjetëve nga 25 qersori i vitit 2015. Shtetet Anëtare, pa paragjykim ndaj kodit penal kombëtar në bazë të dëshmive të zbatueshme në një hetim në zhvillim e sipër penal dhe të procedurave ligjore, mund të kërkojnë mbajtjen e informacioneve apo dokumenteve të tilla për një periudhë të mëtejshme prej pesë viteve kur nevoja dhe proporcionaliteti i mbajtjes së tillë të mëtejshme është vendosur për parandalimin, zbulimin, hetimin apo ndjekjen penale të rasteve të dyshuara të pastrimit të parave apo financimit të terrorizmit.</p>		
<p style="text-align: center;">Neni 41</p> <p>1. Përpunimi i të dhënave personale sipas kësaj Direktive i nënshtrohet Direktivës 95/46/EC, siç është transpozuar në ligjin kombëtar. Të dhënat personale që përpunohen sipas kësaj Direktive nga Komisioni apo nga AME-të i nënshtrohen Rregullores (EC) nr. 45/2001.</p> <p>2. Të dhënat personale përpunohen nga subjektet e detyruara në bazë të kësaj Direktive vetëm për qëllimet e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit siç është cekur në nenin 1 dhe nuk përpunohen më tej në ndonjë mënyrë që nuk është në përputhje me këto qëllime. Përpunimi i të dhënave personale në bazë të kësaj Direktive për çfarëdo qëllimi tjetër, si për shembull qëllime tregtare, është i ndaluar.</p> <p>3. Subjektet e detyruara ua ofrojnë klientëve të rinj informacionin e kërkuar në pajtim me nenin 10 të Direktivës 95/46/EC përpara se të krijojnë një marrëdhënie biznesi apo kryerjes së ndonjë transaksioni të rastit. Informacioni përfshin në veçanti një njoftim të përgjithshëm në lidhje me detyrimet ligjore të subjekteve të detyruara sipas kësaj Direktive për të përpunuar të dhënat personale për qëllimet e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit siç është cekur në nenin 1 të kësaj Direktive.</p> <p>4. Me aplikimin e ndalimit të zbulimit të paraparë në nenin 39(1), Shtetet Anëtare miratojnë masa legjislative që e kufizojnë, në tërësi apo pjesërisht, të drejtën e subjektit për qasje në të dhënat personale që kanë të bëjnë me të deri në atë shkallë që kufizimi i tillë i plotë apo i pjesshëm paraqet një masë të nevojshme dhe proporcionale në një shoqëri demokratike me respektin e duhur për interesat e ligjshme të personit në fjalë që:</p> <p>(a) t'i mundësojë subjektit të detyruar apo autoritetit kombëtar kompetent për të përmbushur detyrat e tij si duhet për qëllimet e kësaj Direktive; apo</p>	<p>Legjislacioni i Kosovës është në përputhje në një masë të gjerë me kërkesat e këtij neni të Direktivës. Përmes nenit 64 (si dhe kërkesave specifike për të dhënat e mbledhura në kuadër të KDK-së), Ligji për PPP/LFT-në përmbush në një masë të gjerë shumicën e kërkesave të nevojshme sipas Direktivës 95/46/EC (p.sh. neni 23 i Rregullores (BE) 2016/679 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 27 prill të vitit 2016 për mbrojtjen e personave fizikë në raport me përpunimin e të dhënave personale dhe për lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave, dhe shfuqizimin e Direktivës 95/46/EC) siç janë zbatuar në Kosovë nga Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Paragrafi 2 përmbushet nga dispozitat e nenit 64, paragrafët 2 dhe 3 të Ligjit për PPP/LFT. Paragrafi 3 nuk zbatohet në mënyrë të qartë në legjislacionin e Kosovës për PPP/LFT-në dhe rregulloret. Neni 4 përmbushet përmes dispozitave përkatëse të Ligjit për PPP/LFT-në lidhur me përpunimin dhe mbrojtjen e të dhënave ndonëse mënyra se si është specifikuar periudha e ruajtjes së të dhënave (kërkesat për mbajtjen e regjistrave) nuk i përmbush plotësisht kërkesat për mbrojtjen e të dhënave personale (ju lutemi shini më sipër, nën nenin 40 të Direktivës).</p>	<p>Pjesërisht</p>

Dispozitat e Direktivës (BE) 2015/849	Përshkrimi dhe Analiza e masave në Kosovë	Niveli i pajtueshmërisë
<p>(b) të shmangë pengimin e kërkesave, analizave, hetimeve apo procedurave zyrtare apo ligjore për qëllimet e kësaj Direktive dhe për t'u siguruar se parandalimi, hetimi dhe zbulimi i pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit nuk janë të rrezikuar.</p>		
<p style="text-align: center;">Neni 42</p> <p>Shtetet Anëtare kërkojnë që subjektet e tyre të detyruara të kenë sisteme që iu mundësojnë që të përgjigjen në tërësi dhe me shpejtësi ndaj hetimeve nga NjIF-et e tyre apo nga autoritetet e tjera, përmes kanaleve të sigurta dhe në një mënyrë që e siguron konfidencialitetin e plotë të hetimeve, në pajtim me ligjin e tyre kombëtar, rreth asaj nëse ato janë duke mbajtur apo kanë mbajtur, gjatë një periudhe pesë vjeçare përpara atij hetimi, një marrëdhënie biznesi me personat e specifikuar dhe mbi natyrën e asaj marrëdhënieje.</p>	<p>Ju lutemi referojuni Shtojcës së PT-së, R. 11.</p> <p>Neni 20, paragrafi 1 i Ligjit për PPP/LFT-në parasheh kërkesën që subjektet e detyruara të sigurojnë që dokumentacioni dhe informacionet përcjellëse të jenë të gatshme dhe në dispozicion të NjIF-it si dhe të autoriteteve të tjera kompetente, përfshirë edhe informacionin "për të mundësuar rindërtimin e transaksioneve, që janë ekzekutuar ose është tentuar të ekzekutohen". Përkufizimi i transaksioneve sipas Ligjit për PPP/LFT-në do të përfshinte marrëdhëniet e biznesit dhe transaksionet e tjera. Neni 14, paragrafi 1.4 i ligjit parasheh që informacioni të ofrohet nga subjektet raportuese në bazë të një kërkesë nga NjIF-i, brenda afatit kohor të përcaktuar nga NjIF-i. Neni 17 lidhur me politikën dhe procedurat e subjekteve raportuese kërkon që të zbatohen procedurat për raportimin të NjIF-it.</p> <p>Neni 16, paragrafi 6 i Rregullores së BQK-së për PPP/LFT-në kërkon sigurimin e informacionit për autoritetet kompetente, përfshirë NjIF-in dhe BQK-në, në formë dhe mënyrë të plotë, në kohë dhe të kuptueshëm. Krahas kësaj, institucionet financiare duhet të mbajnë kopje rezervë në formë elektronike dhe të qasshme në një formë të lexueshme për NjIF-in, BQK-në dhe autoritetet kompetente sipas legjislacionit në fuqi. Dispozitat e Rregullores së BQK-së vlejné vetëm për bankat dhe institucionet financiare.</p> <p>Nuk ka kërkesa të tjera ligjore në Kosovë për të plotësuar kërkesat e Direktivës në raport me përdorimin e kanaleve të sigurta dhe sigurimin e konfidencialitetit të kërkesave. Në praktikë, në shumicën e rasteve të shkëmbimit të informacionit ndërmjet NjIF-it dhe shumicës së subjekteve raportuese përdoret sistemi goAML, i cili ofron kështu një kanal të sigurt që mund të sigurojë konfidencialitetin e informacionit. Sidoqoftë, nuk ka</p>	<p>Pjesërisht</p>

Dispozitat e Direktivës (BE) 2015/849	Përshkrimi dhe Analiza e masave në Kosovë	Niveli i pajtueshmërisë
	kërkesa ligjore që të gjitha subjektet raportuese të përdorin këtë sistem dhe jo të gjitha ato e përdorin në praktikë.	
<p>►M1</p> <p style="text-align: center;">Neni 43</p> <p>Përpunimi i të dhënave personale në bazë të kësaj Direktive për qëllimet e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit siç është cekur në nenin 1 konsiderohet si një çështje e interesit publik sipas Rregullores (BE) 2016/679 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit ⁽¹⁰⁵⁾.</p>	Ju lutemi shikoni më sipër, në nenin 41.	
<p style="text-align: center;">Neni 44</p> <p>1. Për qëllimet e ndihmesës në përgatitjen e vlerësimit të rrezikut në pajtim me nenin 7, Shtetet Anëtare sigurojnë që ato të jenë në gjendje që të rishikojnë efektivitetin e sistemeve të tyre për të luftuar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit duke mbajtur statistika gjithëpërfshirëse lidhur me çështjet përkatëse për efektivitetin e sistemeve të tilla.</p> <p>2. Statistikat e cekura në paragrafin 1 përfshijnë:</p> <p>(a) të dhëna që e matin madhësinë dhe rëndësinë e sektorëve të ndryshëm të cilët bien në kuadër të fushëveprimit të kësaj Direktive, përfshirë numrin e personave fizikë dhe subjekteve dhe rëndësinë ekonomike të secilit sektor;</p> <p>(b) të dhëna që i matin fazat raportuese, hetuese dhe gjyqësore të regjimit kombëtar për PPP/LFT-në, duke përfshirë numrin e raporteve të transaksioneve të dyshimta që i janë dorëzuar NjIF-it, përcjelljen që i është bërë këtyre raporteve dhe në baza vjetore, numrin e rasteve të hetuara, numrin e personave të ndjekur penalisht, numrin e personave të dënuar për veprat e pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit, llojet e veprave të ndërlydhura penale;</p> <p>(c) nëse janë të disponueshme, të dhëna për identifikimin e numrit dhe përqindjeve të raporteve që rezultojnë në hetimin e mëtejshëm, së bashku me raportin vjetor të</p>	<p>Ju lutemi referojuni Shtojcës së PT-së, R. 33</p> <p>Neni 39 i Ligjit për PPP/LFT-në kërkon mbajtjen e statistikave nga të gjitha autoritetet kompetente me qëllim që t'i mundësohet NjIF-it që të rishikojë efektivitetin e sistemit për PPP/LFT-në.</p> <p>Sidoqoftë, ligji nuk parasheh udhëzime të tjera mbi llojin e statistikave që do të ishin të rëndësishme për të rishikuar sistemin. Udhëzimi Administrativ nr. 001/2013 Përgatitja e Statistikave, Raporteve dhe Rekomandimeve lidhur me Pastrimin e Parave dhe Financimin e Terrorizmit ofron hollësi mbi statistikatat që duhet të mbahen nga NjIF-i por, nuk ka detyrime ligjore për institucionet e tjera në lidhje me kategoritë e informacioneve që nevojiten dhe për konsolidimin e këtij informacioni për të siguruar një rishikim domethënës të sistemit. Rrjedhimisht, Kosova nuk është në gjendje që të përdorë për rishikimin e sistemit të vet shumicën e statistikave nën shkronjat (a), (b) dhe (c) të paragrafit 2. Nuk ka kërkesë për publikimin e rishikimit të konsoliduar të statistikave përkatëse për qëllimet e PPP-së dhe LFT-së dhe duke marrë parasysh kërkesat e Direktivës.</p>	Pjesërisht

¹⁰⁵ Rregullorja (BE) 2016/679 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 27 prill 2016 për mbrojtjen e personave fizikë në lidhje me përpunimin e të dhënave personale dhe lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave dhe shfuqizimin e Direktivës 95/46/EC (Rregullorja e përgjithshme për mbrojtjen e të dhënave) (OJ L 119, 4.5.2016, f. 1).

Dispozitat e Direktivës (BE) 2015/849	Përshkrimi dhe Analiza e masave në Kosovë	Niveli i pajtueshmërisë
<p>subjekteve të detyruara ku detajohet dobia e përcjelljes së raporteve që ato kanë prezantuar;</p> <p>(d) të dhëna në lidhje me numrin e kërkesave ndërkufitare për informacion që janë bërë, pranuar, refuzuar dhe përgjigjur pjesërisht apo tërësisht nga NjIF-i, kategorizuar nga vendi ekuivalent;</p> <p>(e) burimet njerëzore të ndara për autoritetet kompetente përgjegjëse për mbikëqyrjen e PPP/LFT-së si dhe burimet njerëzore të ndara për NjIF-in për të përmbushur detyrat e specifikuar në nenin 32;</p> <p>(f) numrin e veprimeve mbikëqyrëse në vendin e ngjarjes dhe jashtë tij, numrin e shkeljeve të identifikuar në bazë të veprimeve mbikëqyrëse dhe sanksionet/masat administrative të zbatuara nga autoritetet mbikëqyrëse.</p> <p>3. Shtetet Anëtare sigurojnë që një rishikim i konsoliduar i statistikave të tyre publikohet në baza vjetore.</p> <p>4. Çdo vit, Shtetet Anëtare ia transmetojnë Komisionit statistikave të referuara në paragrafin 2. Komisioni publikon një raport vjetor që i përmbledh dhe shpjegon statistikave të referuara në paragrafin 2, i cili është i qasshëm në faqen e tij të internetit.</p>		
<p>▼B</p> <p>KAPITULLI VI POLITIKAT, PROCEDURAT DHE MBIKËQYRJA</p> <p>SEKSIONI 1 Procedurat e brendshme, trajnimi dhe kthimi i informacionit</p> <p style="text-align: center;">Neni 45</p> <p>1. Shtetet Anëtare u kërkojnë subjekteve të detyruara që janë pjesë e një grupi që të zbatojnë politika dhe procedura në nivel grupi, përfshirë politika për mbrojtjen e të dhënave dhe politika e procedura për shkëmbimin e informacionit në kuadër të grupit për qëllime të PPP/LFT-së. Këto politika dhe procedura zbatohen në mënyrë efektive në nivelin e degëve dhe filialeve në të cilat grupi zotëron shumicën e pronësisë së tyre në Shtetet Anëtare dhe vendet e treta.</p>	<p>Ju lutemi referojuni Shtojcës së PT-së, R. 18.2 dhe 18.3. Neni 24, paragrafi 5 i Ligjit për PPP/LFT-në kërkon zbatimin e programeve në kuadër të grupit që mbulojnë degët dhe filiale në të cilat grupi zotëron shumicën e pronësisë. Nuk ka kërkesa që programet të zbatohen në mënyrë efektive në degë dhe filiale (kërkohet që ato vetëm të jenë të zbatueshme). Ka kërkesa për të përfshirë politikat dhe procedurat për mbrojtjen e të dhënave për shkëmbimin e të dhënave si pjesë e programeve të grupit. Gjithsesi, Ligji për PPP/LFT-në nuk parasheh zbutjen e kërkesave për nxjerrje të informacionit apo çfarëdo dispozite tjetër për shkëmbimin e të dhënave të cilat mund të zbatohen në kuadër të grupit dhe do të kufizonin zbatueshmërinë e procedurave për shkëmbimin e të dhënave në këtë kontekst. Paragrafi 2 nuk është i aplikueshëm.</p>	Pjesërisht

Dispozitat e Direktivës (BE) 2015/849	Përshkrimi dhe Analiza e masave në Kosovë	Niveli i pajtueshmërisë
<p>2. Shtetet Anëtare kërkojnë që subjektet e detyruara që operojnë në institucione në një Shtet tjetër Anëtar të sigurojnë që ato institucione i respektojnë dispozitat kombëtare të atij Shteti Anëtar tjetër që e transpozon këtë Direktivë.</p> <p>3. Shtetet Anëtare sigurojnë që atje ku subjektet e detyruara kanë degë apo filiale të kontrolluara të vendosura në vende të treta ku kërkesat minimale për PPP/LFT-në janë më pak të rrepta se sa ato të Shteteve Anëtare, degët e tyre dhe filialet, në të cilat subjekti zotëron shumicën e pronësisë së tyre, të vendosura në vendin e tretë zbatojnë kërkesat e Shtetit Anëtar, përfshirë mbrojtjen e të dhënave, deri në atë shkallë që është e lejueshme nga ligji i vendit të tretë.</p>	<p>Paragrafi 3 nuk është përmbushur pasi që nuk ka asnjë kërkesë për të zbatuar kërkesat deri në shkallën e lejuar nga legjislacioni i një vendi tjetër.</p>	
<p>► M1</p> <p>4. Shtetet Anëtare dhe AME-të njoftojnë njëri-tjetrin për rastet në të cilat ligji i shtetit të tretë nuk e lejon zbatimin e politikave dhe procedurave të parapara në paragrafin 1. Në raste të tilla, mund të ndërmerren veprime të bashkërenduara për të gjetur një zgjidhje. Gjatë vlerësimit se cilat vende të treta nuk e lejojnë zbatimin e politikave dhe procedurave të parapara në paragrafin 1, Shtetet Anëtare dhe AME-të marrin në konsideratë çdo kufizim ligjor që mund të pengojë zbatimin korrekt të atyre politikave dhe procedurave, përfshirë fshehtësinë, mbrojtjen e të dhënave dhe kufizimet e tjera që e ngushtojnë shkëmbimin e informacionit që mund të jetë i rëndësishëm për këtë qëllim.</p>	<p>Nuk aplikohet</p>	<p>Nuk aplikohet</p>
<p>▼ B</p> <p>5. Shtetet Anëtare kërkojnë që, aty ku ligjet e një vendi të tretë nuk e lejojnë zbatimin e politikave dhe procedurave të parapara me paragrafin 1, subjektet e detyruara sigurojnë që degët dhe filialet e kontrolluara në atë vend të zbatojnë masa shtesë për të trajtuar në mënyrë efektive rrezikun nga pastrimi i parave apo financimi i terrorizmit, dhe për të informuar autoritetet kompetente të Shtetit të tyre Anëtar. Nëse masat shtesë nuk janë të mjaftueshme, autoritetet kompetente të Shtetit Anëtar mëmë ushtrojnë veprime mbikëqyrëse shtesë, përfshirë kërkesën që grupi të mos krijojë apo që të përfundojë marrëdhëniet e biznesit, dhe nuk ndërmerr ndonjë transaksion dhe, kur është e nevojshme, t'i kërkojë grupit që të mbyllë operacionet e veta në vendin e tretë.</p> <p>6. AME-të hartojnë projekt standardet teknike rregulluese që e specifikojnë llojin e masave shtesë të referuara në paragrafin 5 dhe veprimet minimale që duhet të ndërmerren nga institucionet kreditore dhe financiare kur ligji i një vendi të tretë nuk</p>	<p>Ju lutemi referojuni Shtojcës së PT-së, R. 18.3. Ligji i Kosovës nuk parasheh asnjë kërkesë për të zbatuar masa të tilla shtesë dhe për të informuar mbikëqyrësin.</p>	<p>Në mospërputhje</p>

Dispozitat e Direktivës (BE) 2015/849	Përshkrimi dhe Analiza e masave në Kosovë	Niveli i pajtueshmërisë
<p>e lejon zbatimin e masave të parapara me paragrafët 1 dhe 3.</p> <p>AME-të ia dorëzojnë Komisionit projekt standardet teknike rregulluese të cekura në nënparagrafin e parë deri më 26 dhjetor 2016.</p> <p>7. Komisionit i është deleguar autorizimi për të miratuar projekt standardet teknike rregulluese të cekura në paragrafin 6 të këtij neni në pajtim me nenet 10 deri në 14 të Rregullores (BE) nr. 1093/2010, (BE) nr. 1094/2010 dhe (BE) nr. 1095/2010.</p>		
<p>8. Shtetet Anëtare sigurojnë që të lejohet shkëmbimi i informacionit në kuadër të grupit. Informacioni që i raportohet NjIF-it për dyshimet se fondet janë të ardhura nga aktiviteti kriminal apo që janë të lidhura me financimin e terrorizmit ndahet në kuadër të grupit, përpos nëse NjIF-i ka udhëzuar ndryshe.</p>	<p>Kriteri nuk është përmbushur. Ju lutemi shihni diskutimin në paragrafët 1-3.</p>	<p>Në mospërputhje</p>
<p>9. Shtetet Anëtare mund t'u kërkojnë emetuesve të parave elektronike siç janë cekur në nenin 2 paragrafi (3) të Direktivës 2009/110/EC dhe ofruesve të shërbimeve të pagesave siç janë cekur në nenin 4 paragrafi (9) të Direktivës 2007/64/EC të themeluar në territorin e tyre jo në formën e degës, dhe zyra kryesore e të cilëve gjendet në një Shtet Anëtar tjetër, që të emërojnë pikë kontakti qendrore në territorin e tyre për të siguruar, në emër të institucionit emërues, përputhshmërinë me rregullat për PPP/LFT-në dhe për të lehtësuar mbikëqyrjen nga autoritetet kompetente, përfshirë ofrimin e dokumenteve dhe informatave për autoritetet kompetente sipas kërkesës.</p> <p>10. AME-të hartojnë projekt standardet teknike rregulluese mbi kriteret për përcaktimin e rrethanave në të cilat emërimi i një pike qendrore të kontaktit në pajtim me nenin 9 është i përshtatshëm, dhe se cilat do të jenë funksionet e pikës qendrore të kontaktit.</p> <p>AME-të ia dorëzojnë Komisionit projekt standardet teknike rregulluese të cekura në nënparagrafin e parë deri më 26 dhjetor 2017.</p> <p>11. Komisionit i është deleguar pushteti për të miratuar projekt standardet teknike rregulluese të cekura në paragrafin 10 të këtij neni në pajtim me nenet 10 deri në 14 të Rregullores (BE) nr. 1093/2010, (BE) nr. 1094/2010 dhe (BE) nr. 1095/2010.</p>	<p>Nuk aplikohet</p>	<p>Nuk aplikohet</p>
<p style="text-align: center;">Neni 46</p> <p>1. Shtetet Anëtare kërkojnë që subjektet e detyruara të marrin masa në përpjesëtim me rreziqet, natyrën dhe madhësinë e tyre në mënyrë që punonjësit e tyre të jenë të vetëdijshëm për dispozitat e miratuara në pajtim me këtë Direktivë, përfshirë</p>	<p>Ju lutemi referojuni Shtojcës së PT-së, R. 18.1, 34 si dhe RM 3 dhe 4.</p> <p>Nuk ka kërkesë në nenin përkatës 17 të Ligjit për PPP/LFT-në mbi politikën, procedurat dhe kontrollet për të qenë në përpjesëtim me rreziqet, natyrën dhe madhësinë</p>	<p>Pjesërisht</p>

Dispozitat e Direktivës (BE) 2015/849	Përshkrimi dhe Analiza e masave në Kosovë	Niveli i pajtueshmërisë
<p>kërkesat përkatëse për mbrojtjen e të dhënave.</p> <p>Këto masa përfshijnë pjesëmarrjen e punonjësve të tyre në programet speciale të trajnimeve të vazhdueshme për t'i ndihmuar ata që t'i njohin operacionet të cilat mund të jenë të lidhura me pastrimin e parave apo financimin e terrorizmit dhe që t'i udhëzojnë ata se si të veprojnë në raste të tilla.</p> <p>Kur një person që bie në kuadër të cilësdo prej kategorive të cekura në nenin 2(1) paragrafi (3) i kryen aktivitetet profesionale si një punonjës i një personi juridik, detyrimet në këtë Pjesë zbatohen për atë person juridik se sa për personin fizik.</p> <p>2. Shtetet Anëtare sigurojnë që subjektet e detyruara kanë qasje në informacionin e përditësuar mbi praktikën e pastruesve të parave dhe financuesve të terrorizmit dhe për treguesit që çojnë në njohjen e transaksioneve të dyshimta.</p> <p>3. Shtetet Anëtare sigurojnë që, kur kjo është e mundur, subjekteve të detyruara iu ofrohen informatat kthyesë me kohë mbi efektivitetin dhe përcjelljen e raportimeve për dyshime për pastrim të parave dhe financim të terrorizmit.</p> <p>4. Shtetet Anëtare kërkojnë që, kur kjo është e mundur, subjektet e detyruara të identifikojnë anëtarin e bordit menaxhues që është përgjegjës për zbatimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative të nevojshme për të qenë në përputhje me këtë Direktivë.</p>	<p>e subjektit raportues, përfshirë procedurat për trajnimin e punonjësve. Trajnimi duhet që të zhvillohet në pajtim me nenin 17, paragrafi 2.5 dhe nenin 21 të Ligjit për PPP/LFT-në si dhe me Rregulloren e BQK-së për PPP/LFT-në. Kërkesat për trajnime në pajtim me Ligjin për PPP/LFT-në duhet të mbulojnë të gjitha përgjegjësitë sipas Ligjit për PPP/LFT-në, dhe për rrjedhojë përfshijnë dallimin dhe raportimin e operacioneve të ndërlidhura me PP/FT-në.</p> <p>Ligji në Kosovë nuk parasheh kërkesa që korrespondojnë me kërkesën e Direktivës për personat e cekur në paragrafin (3) të nenit 2(1).</p> <p>Në lidhje me paragrafin 2, NjIF-i është e autorizuar që, në bazë të nenit 14, paragrafi 1.11.2, të miratojë akte nënligjore, të lëshojë urdhra dhe udhëzues mbi çështjet që kanë të bëjnë me sigurimin ose promovimin e pajtueshmërisë me këtë ligj lidhur me aktet ose transaksionet e dyshimta, përfshirë natyrën e akteve ose transaksioneve të dyshimta për qëllime të këtij ligji, si dhe hartimin e listave të indikatorëve të këtyre akteve dhe transaksioneve. Kjo dispozitë konsiderohet se është në pajtim me paragrafin 2.</p> <p>Në raport me paragrafin 3, kërkesa është kryesisht e mbuluar nga dispozita e nenit 39, paragrafi 5 të Ligjit për PPP/LFT-në ndonëse nuk ka ndonjë detyrim ligjor për të siguruar me kohë informatën kthyesë.</p> <p>Janë vërejtur një numër mangësish në lidhje me efektivitetin, përfshirë mungesën e informatave kthyesë të mjaftueshme nga NjIF-i në lidhje me dyshimet e raportuara, nevojën për të përmirësuar strukturën dhe gjithë përfshirjen e treguesve për raportim, trajtimin sipërfaqësor të alarmeve nga subjektet raportuese, si dhe rregullimet e papërshtatshme institucionale për kontrollimin e pajtueshmërisë me kërkesat e RTD-së, mungesën e vetëdijes së BPCJF-ve. Trajnimi është në përgjithësi i mirë për bankat dhe institucionet financiare por i pamjaftueshëm duke pasur parasysh vetëdijen e BPCJF-ve.</p>	

Dispozitat e Direktivës (BE) 2015/849	Përshkrimi dhe Analiza e masave në Kosovë	Niveli i pajtueshmërisë
<p><i>SEKSIONI 2</i> Mbikëqyrja</p> <p style="text-align: center;">Neni 47</p> <p>► M1</p> <p>1. Shtetet Anëtare sigurojnë që ofruesit e shërbimeve këmbimore në mes të valutave virtuale dhe valutave zyrtare, dhe ofruesit e kuletave kujdestare, janë të regjistruar, se zyrat për këmbimin e valutave dhe zyrat për këmbimin e çeqeve, dhe ofruesit e shërbimeve për truste dhe kompani janë të licencuar apo regjistruar, dhe se ofruesit e shërbimeve të lojërave të fatit janë të rregulluar.</p> <p>▼ B</p> <p>2. Shtetet Anëtare iu kërkojnë autoriteteve kompetente që të sigurojnë që personat të cilët mbajnë funksione menaxhimi në subjektet e cekura në paragrafin 1, apo që janë pronarë përfitues të subjekteve të tilla, janë persona të përshtatshëm dhe të duhur.</p> <p>3. Në lidhje me subjektet e detyruara të cekura në nenin 2(1) paragrafi (3)(a), (b) dhe (d), Shtetet Anëtare sigurojnë që autoritetet kompetente ndërmarrin masat e nevojshme për të parandaluar kriminelët e dënuar në fushat përkatëse apo bashkëpunëtorët e tyre që të mbajnë poste drejtuese apo që të jenë pronarë përfitues të atyre subjekteve të detyruara.</p>	<p>Ju lutemi referojuni Shtojcës së PT-së, R. 26.2 dhe 26.3, 28.1, 28.4(b) si dhe RM 3.</p> <p>Ligji në Kosovë nuk parasheh kërkesë për regjistrim për shërbimet e këmbimit të valutave virtuale dhe ofruesve të kuletave kujdestare si dhe kërkesa për regjistrimin e ofruesve të shërbimeve për truste dhe kompani dhe rrjedhimisht për përshtatshmërinë dhe përputhjen e personave që mbajnë pozita drejtuese apo kontrolluese në ato subjekte. Prandaj, mbikëqyrja efektive nuk është e mundur.</p> <p>BQK-ja është përgjegjëse për licencimin e bankave dhe regjistrimin e zyrave për këmbimin e valutave.</p> <p>Analiza sipas R. 26.3 tregon mangësi në kriteret e përshtatshme dhe të duhura që janë të lidhura me mungesën e gjuhës së qartë për të parandaluar personat me histori kriminale të zotërojnë (apo të jenë pronarë përfitues me) pjesëmarrje të konsiderueshme ose kontrolluese, apo të mbajnë funksione drejtuese, në një zyrë për këmbimin e valutave. Për më tepër, nuk është konfirmuar efektiviteti i mbikëqyrjes kur kihet parasysh numri i madh i personave që kryejnë aktivitete të këmbimit të valutave pa licencë apo regjistrim. Efektiviteti po ashtu komprometohet nga mungesa e masave për të trajtuar çështjet e bashkëpunëtorëve të kriminelëve të cilët mbajnë funksione drejtuese apo i kontrollojnë subjektet (ndonëse nuk kërkohen në mënyrë të qartë nga Direktiva).</p> <p>Nuk ekzistojnë kërkesa për hyrje në treg për agjentët e patundshmërive gjë që rezulton në efektivitetin e dyshimtë të mbikëqyrjes duke pasur parasysh numrin dhe madhësinë e këtij sektori. Nuk ka informacion në dispozicion për të siguruar zbatimin e kriterëve gjithëpërfshirëse sipas "i përshtatshëm" dhe "i duhur" lidhur me kontabilistët, auditorët, noterët dhe profesionistët e tjerë ligjorë.</p>	<p>Pjesërisht</p>

Dispozitat e Direktivës (BE) 2015/849	Përshkrimi dhe Analiza e masave në Kosovë	Niveli i pajtueshmërisë
<p style="text-align: center;">Neni 48</p> <p>1. Shtetet Anëtare iu kërkojnë autoriteteve kompetente që të monitorojnë në mënyrë efektive dhe të ndërmarrin masat e nevojshme për të siguruar përputhshmërinë me këtë Direktivë.</p> <p>► M1</p> <p>1a. Në mënyrë që të lehtësohet dhe nxitet bashkëpunimi efektiv, dhe në veçanti shkëmbimi i informacionit, Shtetet Anëtare ia komunikojnë Komisionit listën e autoriteteve kompetente të subjekteve të detyruara të cekura në nenin 2(1), duke përfshirë edhe hollësitë për kontaktimin e tyre. Shtetet Anëtare sigurojnë që informacioni që i ofrohet Komisionit përditësohet.</p> <p>Komisioni publikon në faqen e tij të internetit, një regjistër të këtyre autoriteteve dhe hollësitë e tyre për kontaktim. Autoritetet në këtë regjistër, në kuadër të shtrirjes së autorizimit të tyre, shërbejnë si pika të kontaktit për autoritetet kompetente të barasvlershme të Shteteve të tjera Anëtare. Autoritetet mbikëqyrëse financiare të Shteteve Anëtare, shërbejnë edhe si pika të kontaktit për AME-të.</p> <p>Në mënyrë që të sigurohet zbatimi i përshtatshëm i kësaj Direktive, Shtetet Anëtare kërkojnë që të gjitha subjektet e detyruara i nënshtrohen mbikëqyrjes së përshtatshme, përfshirë autorizimin për të zhvilluar mbikëqyrje në vendin e ngjarjes dhe jashtë tij, dhe për të ndërmarrë masat e duhura dhe proporcionale administrative për të përmirësuar situatën në rast të shkeljeve.</p> <p>► M1</p> <p>2. Shtetet Anëtare sigurojnë që autoritetet kompetente kanë autorizim të duhur, përfshirë autorizimin për të detyruar prodhimin e çdo informacioni që është i rëndësishëm për monitorimin e përputhshmërisë dhe për të kryer kontrole dhe për t'i pasur burimet e përshtatshme financiare, njerëzore dhe teknike për t'i kryer funksionet e tyre. Shtetet Anëtare sigurojnë që personeli i atyre autoriteteve ka integritet të lartë dhe zotëron shkathtësitë e duhura, dhe që të mbajnë standarde të larta profesionale, përfshirë standardet e konfidencialitetit, mbrojtjes së të dhënave dhe standardet që adresojnë konfliktet e interesit.</p> <p>▼ B</p>	<p>Ju lutemi referojuni RM 3 si dhe Shtojcës së PT-së, R. 26 - 28.</p> <p>Në raport me paragrafin 1 dhe 1a, një sërë çështjesh vërehen si negative ndaj efektivitetit të mbikëqyrjes, përfshirë përgjegjësinë e ndarë në mes të disa mbikëqyrësve për vetëm një lloj të subjektit pa një ndarje të qartë në mes të përgjegjësave, mangësitë në lidhje me hyrjen në treg dhe operacionet pa licencën apo regjistrimin e nevojshëm, masat për të parandaluar pjesëmarrjen e bashkëpunëtorëve të kriminelëve, zbatimin e sanksioneve dhe qasjen e bashkërenduar kundrejt BPCJF-ve. Kompetencat e mbikëqyrësve për të ushtruar mbikëqyrje në terren dhe në distancë ekzistojnë, ndonëse mbesin çështjet që kanë të bëjnë me qartësimin e funksionit të BQK-së dhe NjIF-it në raport me bankat dhe institucionet financiare. Përshtatshmëria e mbikëqyrjes së NjIF-it mund të komprometohet nga kompetencat e paqarta për të siguruar të gjitha dokumentet përkatëse pasi që neni 35 e parasheh mundësinë e subjekteve raportuese që të refuzojnë në bazë të vlerësimit të tyre të relevancës së dokumenteve. Krahas kësaj, ekziston një çështje e efektivitetit që po ashtu lidhet me kompetencat e BQK-së që të mbikëqyrë si duhet në raport me kërkesat e raportimit të Ligjit për PPP/LFT-në (ju lutemi shikoni R. 26 dhe 27 si dhe RM 3).</p> <p>Në raport me paragrafin 2, krahas komenteve të sipërpërmendura mbi kompetencat e mbikëqyrësve, mekanizmat për ndarjen e burimeve duken të jenë si duhet për BQK-në dhe të papërshtatshme për NjIF-in ku potencialisht kërkohet vlerësim i mëtejshëm i procedurave dhe strukturës institucionale. Vëmendje e mëtejshme duhet t'u kushtohet faktorëve të rrezikut dhe nevojitet shpërndarje dhe alokim i mëvonshëm i burimeve. NjIF-i dhe BQK-ja u nënshtrohen kërkesave të konfidencialitetit dhe kërkesave specifike për personemin e tyre. Ekzistojnë standarde në lidhje me konfliktin e interesit për të dy mbikëqyrësit.</p> <p>Janë vendosur edhe kompetenca të shtuara mbikëqyrëse</p>	<p>Pjesërisht, kur është e zbatueshme</p>

Dispozitat e Direktivës (BE) 2015/849	Përshkrimi dhe Analiza e masave në Kosovë	Niveli i pajtueshmërisë
<p>3. Në rastin e institucioneve kreditore dhe financiare, dhe ofruesve të shërbimeve të lojërave të fatit, autoritetet kompetente kanë kompetenca të shtuara mbikëqyrëse.</p> <p>► M1</p> <p>4. Shtetet Anëtare sigurojnë që autoritetet kompetente të Shtetit Anëtar, në të cilin subjekti i detyruar operon institucione, e mbikëqyrin respektimin nga ato institucione të dispozitave kombëtare të atij Shteti Anëtar të cilat e transpozojnë këtë Direktivë.</p> <p>Në rastin e institucioneve kreditore dhe financiare të cilat janë pjesë e një grupi, Shtetet Anëtare sigurojnë që, për qëllimet e parashtruara në nënparagrafin e parë, autoritetet kompetente të Shtetit Anëtar, ku një ndërmarrje mëmë është themeluar, bashkëpunojnë me autoritetet kompetente të Shteteve Anëtare ku janë themeluar institucionet që janë pjesë e një grupi.</p> <p>Në rastin e institucioneve të cekura në nenin 45(9), mbikëqyrja siç është parashtruar në nënparagrafin e parë të këtij paragrafi mund të përfshijë marrjen e masave përkatëse dhe proporcionale për të adresuar mangësitë serioze që kërkojnë mjete juridike të menjëhershme. Këto masa do të jenë të përkohshme dhe do të përfundohen pasi që të jenë adresuar dështimet e identifikuara, përfshirë ndihmën apo bashkëpunimin me autoritetet kompetente të Shtetit Anëtar të origjinës të subjektit të detyruar në pajtim me nenin 45(2).</p> <p>▼ B</p> <p>5. Shtetet Anëtare sigurojnë që autoritetet kompetente të Shtetit Anëtar në të cilin subjekti i detyruar operon institucione bashkëpunojnë me autoritetet kompetente të Shtetit Anëtar në të cilin subjekti i detyruar ka zyrat qendrore, për të siguruar mbikëqyrjen efektive të kërkesave të kësaj Direktive.</p> <p>► M1</p> <p>Në rastin e institucioneve kreditore apo financiare që janë pjesë e një grupi, Shtetet Anëtare sigurojnë që autoritetet kompetente të Shtetit Anëtar, ku është themeluar një ndërmarrje mëmë, e mbikëqyrin zbatimin efektiv të politikave dhe procedurave në nivel grupi të cekura në nenin 45(1). Për këtë qëllim, Shtetet Anëtare sigurojnë që autoritetet kompetente të Shtetit Anëtar ku janë themeluar institucionet kreditore dhe</p>	<p>në lidhje me kërkesën e paragrafit 3 të Direktivës, të cilat iu nënshtrohen kufizimeve të diskutuara më sipër.</p> <p>Paragrafët 4 dhe 5 nuk janë të zbatueshëm.</p> <p>Në lidhje me paragrafin 6 dhe 7, ju lutemi referojuni Shtojcës së PT-së, R. 26.5, 26.6 dhe 26.7, 28.5 dhe RM 3. Neni 34, paragrafi 6 i Ligjit për PPP/LFT-në parasheh që mbikëqyrësit të marrin parasysh rreziqet për mbikëqyrjen e sektorëve përkatës por, nuk ka kërkesa të qarta për të marrë në konsideratë rrezikun në nivel kombëtar, si dhe profilin e rrezikut të institucionit dhe grupit, ndonëse qasja në informacionin përkatës është përgjithësisht e siguruar nga dispozitat ligjore. Përjashtim bën situata e paqartë në lidhje me bankat dhe institucionet financiare si vazhdim i ndarjes së përgjegjësive në mes të BQK-së dhe NjIF-it në lidhje me raportimin e transaksioneve të dyshimta. Ligji për PPP/LFT-në nuk parasheh kërkesa të qarta për NjIF-in që të zbatohet qasjen e bazuar në rrezik ndaj mbikëqyrjes ndonëse PSO për mbikëqyrjen nga NjIF-i janë miratuar në vitin 2017. BQK-ja si dhe NjIF-i kanë demonstruar se i kuptojnë mirë rreziqet dhe procedurat për udhëheqjen e mbikëqyrjes në bazë të vlerësimit të rrezikut. Gjithsesi, duket se profilizimi i rrezikut të subjekteve individuale të mbikëqyrura (apo në bazë të grumbullimit adekuat) ka mangësi. Mungojnë përpjekje të përshtatshme në këtë drejtim nga mbikëqyrësit e tjerë.</p> <p>Nuk mund të përfundohet se paragrafi 7 dhe 8 janë përmbushur pasi që mungon informacioni përkatës mbi këto rishikime dhe konsideratat e duhura, siç është diskutuar më sipër, për rreziqet në nivelin e subjekteve individuale.</p> <p>Opsioni i paraparë në paragrafin 9 nuk përdoret nga autoritetet e Kosovës.</p> <p>Nuk ka tregues se autoritetet i kanë marrë në konsideratë udhëzimet e AME-ve në lidhje me QBRr-në.</p>	

Dispozitat e Direktivës (BE) 2015/849	Përshkrimi dhe Analiza e masave në Kosovë	Niveli i pajtueshmërisë
<p>financiare, që janë pjesë e një grupi, bashkëpunojnë me autoritetet kompetente të Shtetit Anëtar ku është themeluar ndërmarrja mëmë.</p> <p>▼B</p> <p>6. Shtetet Anëtare sigurojnë që gjatë zbatimit të qasjes së bazuar në rrezik ndaj mbikëqyrjes, autoritetet kompetente:</p> <p>(a) i kuptojnë qartë rreziqet nga pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit që janë të pranishme në Shtetin e tyre Anëtar;</p> <p>(b) kanë qasje në vend të ngjarjes dhe jashtë tij në të gjithë informacionin mbi rreziqe specifike vendore dhe ndërkombëtare të ndërlidhura me klientët, prodhimet dhe shërbimet e subjekteve të detyruara; dhe</p> <p>(c) e bazojnë shpeshtësinë dhe intensitetin e mbikëqyrjes në vendin e ngjarjes dhe jashtë tij për profilin e rrezikut të subjekteve të detyruara, dhe për rrezikun e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në atë Shtet Anëtar.</p> <p>7. Vlerësimi i profilin të rrezikut të subjekteve të detyruara për pastrimin e parave dhe financimit të terrorizmit, përfshirë rreziqet e mospërputhshmërisë, rishikohet periodikisht dhe kur ka ngjarje apo zhvillime madhore në operacionet e tyre menaxhuese.</p> <p>8. Shtetet Anëtare sigurojnë që autoritetet kompetente marrin në konsideratë shkallën e vlerësimit të lejuar për subjektin e detyruar, dhe rishikojnë si duhet vlerësimet e rrezikut që e mbështesin këtë liri vlerësimi, dhe përshtatshmërinë e zbatimit të politikave, kontrolleve dhe procedurave të tyre të brendshme.</p> <p>9. Në rastin e subjekteve të detyruara të cekura në nenin 2(1) paragrafi (3)(a), (b) dhe (d), Shtetet Anëtare mund të lejojnë që funksionet e cekura në paragrafin 1 të këtij neni kryhen nga organet vetërregulluese, me kusht që këto janë në pajtim me paragrafin 2 të këtij neni.</p> <p>10. Deri më 26 qershor 2017, AME-të nxjerrin udhëzimet për autoritetet kompetente në pajtim me nenin 16 të Rregulloreve (BE) nr. 1093/2010, (BE) nr. 1094/2010 dhe (BE) nr. 1095/2010 për karakteristikat e qasjes së bazuar në rrezik ndaj mbikëqyrjes dhe hapave që duhet të ndërmerren gjatë zhvillimit të mbikëqyrjes së bazuar në</p>		

Dispozitat e Direktivës (BE) 2015/849	Përshkrimi dhe Analiza e masave në Kosovë	Niveli i pajtueshmërisë
<p>rrezik. Konsideratë e posaçme tregohet ndaj natyrës dhe madhësisë së biznesit, dhe, kur kjo është e përshtatshme dhe proporcionale, parashtrohen edhe masat specifike.</p>		
<p>SEKSIONI 3 Bashkëpunimi</p> <p><i>Nëseksioni I</i> Bashkëpunimi kombëtar</p> <p>▼M1</p> <p style="text-align: center;">Neni 49</p> <p>Shtetet Anëtare sigurojnë që politikëbërësit, NjIF-et, mbikëqyrësit dhe autoritetet e tjera kompetente të përfshira në PPP/LFT-në, si dhe autoritetet tatimore dhe autoritetet për zbatimin e ligjit kur veprojnë në kuadër të fushëveprimit të kësaj Direktive, kanë mekanizma efektivë për t'ua mundësuar atyre që të bashkëpunojnë dhe bashkërendojnë brenda vendit në lidhje me zhvillimin dhe zbatimin e politikave dhe aktiviteteve për luftimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, përfshirë synimin për të përmbushur detyrimin e tyre sipas nenit 7.</p>	<p>Ju lutemi referojuni RM 1 (Çështjet Thelbësore 1.4 dhe 1.5), RM 3 (Çështjet Thelbësore 3.2 dhe 3.3), RM 6 (Çështjet Thelbësore 6.4).</p> <p>Kosova ka zhvilluar një sistem relativisht gjithëpërfshirës të bashkërendimit në nivelin e politikave në raport me çështjet për PPP/LFT-në, kryesisht të përqendruara rreth Grupit Punues Qeveritar, të udhëhequr nga Ministria e Financave. Puna e këtij grupi plotësohet nga një numër i nismave bashkërenduese të nivelit të lartë të përqendruara mbi aspektet e ndryshme të sistemit, përfshirë menaxhimin e kufirit, luftën kundër terrorizmit dhe krimit ekonomik. Nismat e fundit kërkojnë që të adresohen edhe më tej çështjet e PP-së dhe FT-së në vetvete përkundër përfshirjes së tyre në kundërveprimet e një numri të çështjeve dhe rreziqeve të ndërlidhura. Në këtë nivel, të gjitha autoritetet kompetente janë përfshirë në bashkëpunim.</p> <p>Në nivelin operativ, Kosova i ka elaboruar dhe vendosur një numër të marrëveshjeve të bashkëpunimit në mes të të gjitha institucioneve përkatëse në këtë kontekst si bazë për bashkëpunimin e tyre përtej dispozitave tashmë të gjera të legjislationit për PPP/LFT-në. Mekanizmat përkatës të Ligjit për PPP/LFT-në përfshijnë Bordin e NjIF-it (neni 6), bashkëpunimin e NjIF-it (neni 14), bashkëpunimin në mes të NjIF-it dhe mbikëqyrësve për të përcaktuar faktorët e rrezikut, bashkëpunimin për grumbullimin e statistikave për rishikimin e sistemit (neni 39). Disa mangësi ende ndikojnë në bashkërendim, p.sh. mungesa e dispozitave të qarta dhe të detajuara për bashkërendimin e vlerësimit kombëtar të rrezikut (i cili duhet t'i nënshtrohet bashkërendimit nga NjIF-i dhe përcaktimit të kushteve nga Ministria e Financave), dhe ca mangësi të vogla në zbatimin dhe detajimin e disa prej marrëveshjeve për bashkëpunim, informatat kthyesë për NjIF-in, etj.</p>	<p>Pjesërisht</p>

Dispozitat e Direktivës (BE) 2015/849	Përshkrimi dhe Analiza e masave në Kosovë	Niveli i pajtueshmërisë
<p>▼B</p> <p><i>Nëseksioni II</i> Bashkëpunimi me AME-të</p> <p style="text-align: center;">Neni 50</p> <p>Autoritetet kompetente u ofrojnë AME-ve të gjithë informacionin e nevojshëm që ua mundëson atyre që të kryejnë detyrat sipas kësaj Direktive.</p>	Nuk aplikohet	Nuk aplikohet
<p>▼M1</p> <p><i>Nëseksioni IIa</i> Bashkëpunimi në mes të autoriteteve kompetente dhe Shteteve Anëtare</p> <p style="text-align: center;">Neni 50a</p> <p>Shtetet Anëtare nuk ndalojnë apo nuk vendosin kushte të paarsyeshme apo tepër kufizuese mbi shkëmbimin e informacionit apo ndihmës në mes të autoriteteve kompetente për qëllimet e kësaj Direktive. Shtetet Anëtare në veçanti sigurojnë që autoritetet kompetente nuk refuzojnë një kërkesë për ndihmë për shkak se:</p> <p>(a) konsiderohet se kërkesa përfshin edhe çështjet tatimore;</p> <p>(b) ligji kombëtar i detyron subjektet që të ruajnë fshehtësinë apo konfidencialitetin, përpos në rastet kur informacioni përkatës që kërkohet është i mbrojtur me privilegje juridike apo kur zbatohet fshehtësia profesionale juridike, siç është përkrahur në nenin 34(2);</p> <p>(c) një kërkesë, hetim apo procedurë është duke u zhvilluar në Shtetin Anëtar të pyetur, përpos nëse ndihma pengon atë kërkesë, hetim apo procedurë;</p> <p>(d) natyra apo statusi i autoritetit kompetent homolog që kërkon ndihmë dallon nga ai i autoritetit kompetent nga i cili kërkohet ndihma.</p>	<p>Ju lutemi referojuni Shtojcës së PT-së, R. 29, 40.5 si dhe RM 2.</p> <p>Shkëmbimi ndërkombëtar i informacionit (në kontekstin e Direktivës) nuk pengohet nga kushte të paarsyeshme apo tepër kufizuese, përfshirë lidhjet me çështjet tatimore, fshehtësinë apo konfidencialitetin, hapjen e një hetimi apo procedure, natyrën dhe statusin e autoritetit kompetent homolog. Lidhur me NjIF-in, dispozita përkatëse është neni 15. Nuk duket të ketë ndonjë pengesë për mbikëqyrësit në kuptimin e këtij neni të Direktivës.</p>	Në përputhje
<p>▼B</p> <p><i>Nëseksioni III</i> Bashkëpunimi në mes të NjIF-it dhe Komisionit</p>	Nuk aplikohet	Nuk aplikohet

Dispozitat e Direktivës (BE) 2015/849	Përshkrimi dhe Analiza e masave në Kosovë	Niveli i pajtueshmërisë
<p align="center">Neni 51</p> <p>Komisioni mund të ofrojë të gjithë ndihmën e nevojshme që të lehtësohet bashkërendimi, përfshirë shkëmbimin e informacionit në mes të NjIF-eve në kuadër të Unionit. Ai mund të thërrasë mbledhje të rregullta të Platformës së NjIF-eve të BE-së e cila përbëhet nga përfaqësuesit e NjIF-eve të Shteteve Anëtare, në mënyrë që të lehtësojë bashkëpunimin në mes të NjIF-eve, shkëmbejë këndvështrimet dhe të ofrojë këshilla mbi çështjet e zbatueshmërisë që kanë të bëjnë me NjIF-et dhe subjektet raportuese si dhe për çështjet që kanë të bëjnë me bashkëpunimin si bashkëpunimi efektiv në mes të NjIF-eve, identifikimin e transaksioneve të dyshimta me përmasa ndërkufitare, standardizimin e formateve raportuese përmes FIU.net apo pasuesin e tij, analizën e përbashkët të rasteve ndërkufitare, dhe trendët e identifikimit dhe faktorët përkatës për vlerësimin e rrezikut të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.</p>		
<p align="center">Neni 52</p> <p>Shtetet Anëtare sigurojnë që NjIF-et të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën në shkallën më të lartë të mundshme, pa marrë parasysh statusin e tyre organizativ.</p>	<p>NjIF-i ka kompetencë që të ofrojë ndihmë të plotë ndaj homologëve të vet. Disa mangësi në lidhje me qasjen me kohë në informacion apo gjithëpërfshirjen e bazave të të dhënave, informatat kthyesë të pranuar, etj. mund të pengojnë këtë shkëmbim të informacionit.</p>	<p>Pjesërisht</p>
<p align="center">Neni 53</p> <p>▼M1</p> <p>1. Shtetet Anëtare sigurojnë që NjIF-et shkëmbejnë, në mënyrë spontane apo me kërkesë, çdo informacion që mund të jetë i rëndësishëm për përpunimin apo analizimin e informacionit nga NjIF-i në lidhje me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit dhe personin fizik apo juridik të përfshirë, pa marrë parasysh llojin e veprave të ndërlidhura penale përkatëse e madje edhe nëse lloji i veprave të ndërlidhura penale përkatëse nuk është identifikuar në kohën e shkëmbimit.</p> <p>▼B</p> <p>Një kërkesë duhet të përmbajë faktet e spikatura, informacion për rrethanat, arsyet e kërkesës dhe se si do të përdoret informacioni i kërkuar. Mekanizmat e ndryshme të shkëmbimit po ashtu, mund të vlejné nëse kështu pajtohen NjIF-et në mes tyre, posaçërisht në lidhje me shkëmbimet përmes FIU.net apo pasuesin e tij.</p> <p>Kur një NjIF e pranon një raport në pajtim me nenin 33(1) nënparagrafi i parë</p>	<p>Ju lutemi referojuni Shtojcës së PT-së, R. 40 si dhe RM 2. Paragrafi 2 përmbushet në tërësi pasi që NjIF-i është e autorizuar sipas nenit 15 të Ligjit për PPP/LFT-në që të shkëmbejë informacion pa marrë parasysh identifikimin e veprës së ndërlidhur penale në kohën e shkëmbimit. Ligji për PPP/LFT-në nuk i parasheh kushtet e nënparagrafit 2, por PSO-ja e detajuar në pajtim me linjat e parimeve të Grupit Egmont përmban kërkesa të ngjashme. Në lidhje me nënparagrafin e tretë nuk ekziston ndonjë detyrim i tillë ligjor për NjIF-in, por nuk ka pengesa që raportet të ofrohen si informacion spontan (gjë që përsëri nuk do të ishte në baza të rregullta duke pasur parasysh burimet e kërkuara për zbatimin e një sistemi të ngjashëm pa ndihmën e një rrjeti për shkëmbim si FIU.net).</p> <p>Nënparagrafi 1 i paragrafit 2 është plotësuar në tërësi dhe statistikat e ofruara nga NjIF-i tregojnë se përgjigjet janë</p>	<p>Pjesërisht</p>

Dispozitat e Direktivës (BE) 2015/849	Përshkrimi dhe Analiza e masave në Kosovë	Niveli i pajtueshmërisë
<p>shkronja (a) i cili ka të bëjë me një Shtet Anëtar tjetër, ai ia përcjell menjëherë NjIF-it të atij Shteti Anëtar.</p> <p>2. Shtetet Anëtare sigurojnë që NjIF-i të cilit i është bërë një kërkesë përdor tërë gamën e autorizimeve në dispozicion të saj, të cilat do t'i përdorte brenda vendit për të pranuar dhe analizuar informata, kur t'i përgjigjet kërkesës nga një NjIF tjetër për informacion siç është cekur në paragrafin 1. NjIF-i, të cilit i është bërë kërkesa, përgjigjet me kohë.</p> <p>Kur një NjIF kërkon informacion shtesë nga një subjekt i detyruar i themeluar në një Shtet Anëtar tjetër i cili vepron në territorin e tij, kërkesa i adresohet NjIF-it të Shtetit Anëtar në territorin e të cilit është themeluar subjekti i detyruar. ►M1 NjIF-i siguron informacionin në pajtim me nenin 33(1) dhe i transferon përgjigjet menjëherë. ◀</p> <p>3. Një NjIF mund të refuzojë shkëmbimin e informacionit vetëm në rrethana të jashtëzakonshme kur shkëmbimi do të ishte në kundërshtim me parimet themelore të ligjit të saj kombëtar. Këto përjashtime specifikohen në mënyrë që të parandalojnë keqpërdorimin e, dhe kufizimet e pavend ndaj, shkëmbimit të lirë të informacionit për qëllime analitike.</p>	<p>dhënë në kohë të përshtatshme përkundër aftësisë për të vënë në përdorim të gjitha kompetencat vendore në dispozicion të NjIF-it. Nënparagrafi i dytë nuk do të ishte i zbatueshëm pa marrëveshje të tjera ndërkombëtare.</p>	
<p style="text-align: center;">Neni 54</p> <p>Informacioni dhe dokumentet e pranuar në pajtim me nenet 52 dhe 53 përdoren për të përmbushur detyrat e NjIF-it të parapara me këtë Direktivë. Me rastin e shkëmbimit të informacionit dhe dokumenteve në pajtim me nenet 52 dhe 53, NjIF transmetuese mund të imponojë kufizime për përdorimin e atij informacioni. NjIF pranuese u bindet këtyre kufizimeve dhe kushteve.</p> <p>►M1</p> <p>Shtetet Anëtare sigurojnë që NjIF-et caktojnë së paku një person apo pikë kontakti që të jetë përgjegjës për pranimin e kërkesave për informacion nga NjIF-et e Shteteve të tjera Anëtare.</p>	<p>Ky parim respektohet në tërësi nga NjIF-i. Nënparagrafi i dytë nuk është i aplikueshëm (pikat e kontaktit janë të caktuara në bazë të kërkesave të parimeve të Grupit Egmont të cilave iu përmbahet NjIF-i).</p>	Në përputhje
<p style="text-align: center;">Neni 55</p> <p>1. Shtetet Anëtare sigurojnë që informacioni i shkëmbyer në pajtim me nenet 52 dhe 53 përdoret vetëm për qëllimet për të cilat është kërkuar apo ofruar dhe se çdo shpërndarje e tij nga NjIF-et pranuese të cilido autoritet, agjenci apo departament tjetër, apo çdo përdorim i këtij informacioni për qëllime jashtë atyre të miratuara</p>	<p>Dispozita e aplikueshme është neni 15, paragrafi 4 i Ligjit për PPP/LFT-në. Legjislacioni i Kosovës është plotësisht në pajtim me këtë kërkesë. Kushtet e Ligjit për PPP/LFT-në për refuzim (paragrafi 2) janë më pak kufizuese se sa kërkesa e Direktivës.</p>	Në përputhje

Dispozitat e Direktivës (BE) 2015/849	Përshkrimi dhe Analiza e masave në Kosovë	Niveli i pajtueshmërisë
<p>fillimisht, i nënshtrohet miratimit paraprak nga NjIF-i e cila e ka dhënë informacionin.</p> <p>► M1</p> <p>2. Shtetet Anëtare sigurojnë që pajtimi paraprak i NjIF-it të cilit i është bërë kërkesa për shpërndarjen e informacionit tek autoritetet kompetente jepet shpejt dhe në shkallën më të lartë të mundshme, pa marrë parasysh llojin e veprave të ndërlidhura penale përkatëse. NjIF-i të cilës i është bërë kërkesa nuk e refuzon pajtimin e saj për shpërndarjen e tillë përpos nëse kjo do të binte përtej shtrirjes së zbatimit të dispozitave të saj për PPP/LFT-në apo do të mund të çonte në pengimin e një hetimi, apo përndryshe nuk do të ishte në pajtim me parimet themelore të ligjit kombëtar të atij Shteti Anëtar. Çdo refuzim i tillë për të dhënë pajtimin shpjegohet si duhet. Këto përjashtime specifikohen në mënyrë që të parandalojnë keqpërdorimin e, dhe kufizimet e pavend ndaj, shkëmbimit të lirë të informacionit për autoritetet kompetente.</p>		
<p>▼ B</p> <p style="text-align: center;">Neni 56</p> <p>1. Shtetet Anëtare iu kërkojnë NjIF-eve të tyre që të përdorin kanale të mbrojtura të komunikimit në mes tyre dhe të nxisin përdorimin e FIU.net apo pasuesin e tij.</p> <p>2. Shtetet Anëtare sigurojnë që, në mënyrë që të përmbushin detyrat e tyre siç janë paraparë me këtë Direktivë, NjIF-et e tyre bashkëpunojnë në zbatimin e teknologjive më të reja në pajtim me ligjin e tyre kombëtar. Këto teknologji ua mundësojnë NjIF-eve që t'i përputhin të dhënat e tyre me ato të NjIF-eve të tjera në mënyrë anonime duke siguruar mbrojtjen e plotë të të dhënave personale me qëllim të zbulimit, në Shtetet Anëtare të tjera, të subjekteve/persona për të cilat NjIF-i ka interes dhe për të identifikuar të ardhurat dhe fondet e tyre.</p>	<p>Përdorimi i kanalit të mbrojtur është zbatuar (Egmont Group secure web). NjIF-i nuk ka zbatuar asnjë mekanizëm tjetër siç është paraparë në paragrafin 2 për shkak të pazbatueshmërisë dhe mungesës së qasjes në kanale të tilla. Përndryshe, NjIF-i zbaton mekanizma të ngjashëm dhe përdor teknologji të tilla brenda vendit (p.sh. ajo e ka infrastrukturën përkatëse, ju lutemi shikoni RM 6).</p>	<p>Në përputhje</p>
<p style="text-align: center;">Neni 57</p> <p>Dallimet në mes të përkufizimeve të ligjit kombëtar për veprat e ndërlidhura penale në paragrafin 4 të nenit 3 nuk pengojnë aftësinë e NjIF-eve që të ofrojnë ndihmë për një NjIF tjetër dhe nuk do ta kufizojnë shkëmbimin, shpërndarjen dhe përdorimin e informacionit në pajtim me nenet 53, 54 dhe 55.</p>	<p>Shkëmbimi bëhet pa marrë parasysh veprat e ndërlidhura penale, madje edhe nëse ato nuk janë identifikuar. Në teori, mangësitë në kriminalizimin e disa prej veprave të ndërlidhura penale dhe FT/krimeve të lidhura me terrorizmin mund të jenë negative për shkëmbimin ndërkombëtar të informacionit në raste shumë të kufizuara.</p>	<p>Pjesërisht</p>

Dispozitat e Direktivës (BE) 2015/849	Përshkrimi dhe Analiza e masave në Kosovë	Niveli i pajtueshmërisë
<p>► M1</p> <p><i>Nëseksioni IIIa</i> Bashkëpunimi në mes autoriteteve që i mbikëqyrin institucionet kreditore dhe financiare dhe autoriteteve të tjera të detyruara nga fshehtësia profesionale</p> <p style="text-align: center;">Neni 57a</p> <p>1. Shtetet Anëtare u kërkojnë të gjithë personave që punojnë apo që kanë punuar për autoritetet kompetente që i kanë mbikëqyrur institucionet kreditore dhe financiare që të respektojnë këtë Direktivë dhe auditorëve apo ekspertëve të cilët veprojnë në emër të autoriteteve të tilla kompetente që t'i përmbahen detyrimit të fshehtësisë profesionale.</p> <p>Pa paragjykim ndaj rasteve të mbuluara nga kodi penal, informacioni konfidencial të cilin personat e cekur në nënparagrafin e parë e marrin në kuadër të detyrës së tyre sipas kësaj Direktive mund të zbulohet vetëm në formë të përmbledhur, në mënyrë që institucionet kreditore dhe financiare individuale të mos mund të identifikohen.</p> <p>2. Paragrafi 1 nuk pengon shkëmbimin e informacionit në mes të:</p> <p>(a) autoriteteve kompetente që i mbikëqyrin institucionet kreditore dhe financiare brenda një Shteti Anëtar në pajtim me këtë Direktivë apo aktet e tjera legjislative që kanë të bëjnë me mbikëqyrjen e institucioneve kreditore dhe financiare;</p> <p>(b) autoriteteve kompetente që i mbikëqyrin institucionet kreditore dhe financiare në Shtetet e ndryshme Anëtare në pajtim me këtë Direktivë apo aktet e tjera legjislative që janë të lidhura me mbikëqyrjen e institucioneve kreditore dhe financiare, përfshirë Bankën Qendrore Evropiane (BQE) që vepron në pajtim me Rregulloren (BE) nr. 1024/2013 të Këshillit ⁽¹⁰⁶⁾. Ky shkëmbim i informacionit u nënshtrohet kushteve të fshehtësisë profesionale të cekura në paragrafin 1.</p> <p>Deri më 10 janar të vitit 2019, autoritetet kompetente që i mbikëqyrin institucionet kreditore dhe financiare në pajtim me këtë Direktivë dhe BQE-ja që vepron në pajtim</p>	<p>Për NjIF-in, ju lutemi që t'i referoheni R. 29.6 dhe 40.15 të Shtojcës së PT-së si dhe RM 6 dhe RM 2.</p> <p>Në lidhje me paragrafin 1, kërkesat e konfidencialitetit në raport me të gjithë informacionin e pranuar nga personeli i NjIF-it parashihen në nenin 14, paragrafi 2 të Ligjit për PPP/LFT-në. Kjo do t'i përfshinte edhe personat që kanë punuar në NjIF (duke e mbuluar kështu rolin mbikëqyrës të NjIF-it). (Ish) personeli i BQK-së u nënshtrohet kufizimeve për zbulimin e informacionit jopublik në pajtim me nenin 74 të Ligjit për BQK-në, ndonëse nuk ka ndonjë përkufizim të termit dhe rrjedhimisht nuk është e qartë se çka përfshihet në informacionin jopublik dhe nëse do të përfshihej informacioni i pranuar në pajtim me ligjet e tjera (p.sh. informacioni në lidhje me mbikëqyrjen në pajtim me Ligjin për PPP/LFT-në). Duket se zbatimi do t'i mbetej Bordit Ekzekutiv, i cili duhet të vendosë mbi qasshmërinë dhe klasifikimin e informacionit. Rregullat e konfidencialitetit duket se nuk vlejnjë për ekspertët e jashtëm (p.sh. auditorët e jashtëm të BQK-së).</p> <p>Në lidhje me paragrafin 2, nuk ka pengesa për bashkëpunimin vendor në mes të autoriteteve kompetente pasi që Ligji për PPP/LFT-në parasheh kërkesa të detajuara. Gjithsesi, nuk është e qartë nëse kufizimet e fshehtësisë profesionale do të mund të thirrshin për të penguar bashkëpunimin pasi përjashtimi sipas nenit 63 të Ligjit për PPP/LFT-në i referohet në përgjithësi informacionit të zbuluar në pajtim me Ligjin për PPP/LFT-në i cili me sa duket nuk e mbulon informacionin për qëllime të analizave strategjike. Në të njëjtën kohë, neni 80 i Ligjit për Bankat e parasheh zbulimin e informacionit të pranuar nga BQK-ja në kushtet e fshehtësisë vetëm në pajtim me Ligjin për BQK-në.</p> <p>Me sa duket nuk ka pengesa për bashkëpunimin ndërkombëtar të BQK-së, përfshirë detyrimin për të</p>	<p>Pjesërisht</p>

¹⁰⁶ Rregullorja e Këshillit (BE) nr. 1024/2013 e datës 15 tetor 2013, që përcakton detyra specifike për Bankën Qendrore Evropiane në lidhje me politikën që kanë të bëjnë me mbikëqyrjen e kujdesshme të institucioneve të kreditit (OJ L 287, 29.10.2013, f. 63).

Dispozitat e Direktivës (BE) 2015/849	Përshkrimi dhe Analiza e masave në Kosovë	Niveli i pajtueshmërisë
<p>me nenin 27(2) të Rregullores (BE) nr. 1024/2013 dhe nenin 56 nënparagrafi i parë shkronja (g) të Direktivës 2013/36/EU të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit ⁽¹⁰⁷⁾, të arrijnë, me mbështetjen e Autoriteteve Mbikëqyrëse Evropiane, një marrëveshje mbi modalitetet praktike për shkëmbimin e informacionit.</p> <p>3. Autoritetet kompetente që i mbikëqyrin institucionet kreditore dhe financiare të cilat marrin informacion konfidencial siç është cekur në paragrafin 1, e përdorin këtë informacion vetëm:</p> <p>(a) për ushtrimin e detyrave të tyre sipas kësaj Direktive apo sipas akteve të tjera legjislative në fushën e rregullimit të veprave të ndërlidhura të PPP/LFT-së dhe të mbikëqyrjes së institucioneve kreditore dhe financiare, përfshirë sanksionimin;</p> <p>(b) për të apeluar kundër një vendimi të autoritetit kompetent që i mbikëqyr institucionet kreditore dhe financiare, përfshirë procedurat gjyqësore;</p> <p>(c) gjatë procedurave gjyqësore sipas dispozitave të posaçme të parapara me ligjin e Unionit të miratuar në fushën e kësaj Direktive apo në fushën e rregullimit të veprave të ndërlidhura dhe mbikëqyrjes së institucioneve kreditore dhe financiare.</p> <p>4. Shtetet Anëtare sigurojnë që autoritetet që i mbikëqyrin institucionet kreditore dhe financiare bashkëpunojnë me njëra-tjetrën për qëllimet e kësaj Direktive në shkallën më të madhe të mundshme, pa marrë parasysh natyrën apo statusin e tyre përkatës. Bashkëpunimi i tillë përfshin edhe aftësinë për të bërë, në kuadër autorizimeve të autoritetit kompetent kërkuar, kërkesa në emër të një autoriteti kompetent kërkuar, dhe shkëmbimin pasues të informacionit të marrë përmes kërkesave të tilla.</p> <p>5. Shtetet Anëtare mund të autorizojnë autoritetet e tyre kompetente kombëtare të cilat i mbikëqyrin institucionet kreditore dhe financiare që të arrijnë marrëveshje të bashkëpunimit që e parashohin bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit konfidencial me autoritetet kompetente të vendeve të treta të cilat përbëjnë palë homologe të atyre autoriteteve kompetente kombëtare. Marrëveshjet e tilla të bashkëpunimit arrihen në bazë të reciprocitetit dhe vetëm nëse informacioni i zbuluar u nënshtrohet garancive të kërkesave të fshehtësisë profesionale së paku të</p>	<p>mbajtur fshehtësinë profesionale. Kërkesa e nenit 15, paragrafi 4 i Ligjit për PPP/LFT-në për shkëmbim me palët homologe do të lejonte bashkëpunimin e tërthortë të NjIF-it me autoritetet mbikëqyrëse të huaja. Interpretimi i NjIF-it duket të jetë në linjë me parimet e Grupit Egmont për bashkëpunim ndërkombëtar përfshirë bashkëpunimin diagonal, i cili në përgjithësi do të thoshte ofrimin e informacionit për qëllim mbikëqyrëse përmes NjIF-it të juridiksionit tjetër dhe jo drejtpërdrejt me autoritetin mbikëqyrës kërkuar.</p> <p>Në lidhje me paragrafin 3, NjIF-it dhe BQK-së u lejohet që të shkëmbejnë informacion në bazë të kërkesave që janë në pajtim me Direktivën përpos për shkronjën (c) (nuk është e aplikueshme).</p> <p>Legjislacioni i Kosovës me sa duket nuk është në pajtim me kërkesat për BQK-në që të bëjë kërkesa në emër të palëve homologe të huaja. NjIF-i duket se nuk është e kufizuar që të bëjë kërkesa në emër të palëve homologe të huaja duke përdorur kompetencat e veta dhe shkëmbyer informacionin.</p> <p>Në lidhje me paragrafin 5, NjIF-i është e autorizuar që të nënshkruajë Marrëveshje të Mirëkuptimit me palë homologe të huaja të cilat do të pajtoheshin me parimet e Grupit Egmont dhe rrjedhimisht të lejonin shkëmbimin e tërthortë të informacionit për qëllime të mbikëqyrjes, përfshirë respektimin e parimeve të konfidencialitetit në pajtim me kërkesat e Grupit Egmont.</p> <p>Në lidhje me efektivitetin e bashkëpunimit, si NjIF-i ashtu edhe BQK-ja duket se janë duke bashkëpunuar ngushtë dhe duke shkëmbyer informacione përkatëse në nivel vendor, ndonëse nuk është e qartë nëse është shfrytëzuar potenciali i plotë i kërkesave të bashkëpunimit duke marrë parasysh mangësitë e vërejtura në lidhje me mbikëqyrjen e bankave dhe institucioneve financiare për</p>	

¹⁰⁷ Direktiva 2013/36/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 26 qershor 2013 për qasjen në veprimtarinë e institucioneve të kreditit dhe mbikëqyrjen e kujdesshme të institucioneve të kreditit dhe të firmave investuese, e cila ndryshon Direktivën 2002/87/EC dhe shfuqizon direktivat 2006/48/EC dhe 2006/49/EC (OJ L 176, 27.6.2013, f. 338).

Dispozitat e Direktivës (BE) 2015/849	Përshkrimi dhe Analiza e masave në Kosovë	Niveli i pajtueshmërisë
<p>barasvlershme me ato të cekura në paragrafin 1. Informacioni konfidencial i shkëmbyer në pajtim me këto marrëveshje të bashkëpunimit përdoret me qëllim të detyrës së mbikëqyrjes së atyre autoriteteve.</p> <p>Kur informacioni i shkëmbyer buron nga një Shtet Anëtar tjetër, ai zbulohet vetëm me pajtimin e qartë të autoritetit kompetent që e ka dhënë atë dhe, kur është e përshtatshme, vetëm për qëllimet për të cilat ai autoritetet e ka dhënë pajtimin e vet.</p>	<p>kërkesat e raportimit sipas Ligjit për PPP/LFT-në. Bashkëpunimi ndërkombëtar i NjIF-it është aktiv ndonëse nuk është e qartë se deri në ç'skallë shkëmbehet informacioni. BQK-ja nuk e ka dëshmuar qartë se shkëmbimi ndërkombëtar i informacionit është duke u zhvilluar efektivisht për qëllimet e PPP/LFT-së.</p>	
<p style="text-align: center;">Neni 57b</p> <p>1. Pavarësisht nenit 57(a) dhe pa paragjykim ndaj nenit 34(2), Shtetet Anëtare mund të autorizojnë shkëmbimin e informacionit në mes të autoriteteve kompetente në Shtetin Anëtar të njëjtë apo në Shtetet Anëtare të ndryshme, në mes të autoriteteve kompetente dhe autoriteteve të cilave iu është besuar mbikëqyrja e subjekteve të sektorit financiar dhe personave fizikë apo juridikë që veprojnë në ushtrimin aktivitetëve të tyre profesionale siç janë cekur në paragrafin (3) të nenit 2(1) dhe të autoriteteve përgjegjëse me ligj për mbikëqyrjen e tregjeve financiare gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre përkatëse mbikëqyrëse.</p> <p>Informacioni i pranuar në çdo rast u nënshtrohet kërkesave të fshehtësisë profesionale ose të paktën të atyre të barasvlershme që janë cekur në nenin 57a (1).</p> <p>2. Pavarësisht nenit 57a (1) dhe (3), Shtetet Anëtare munden, në bazë të dispozitave të parashtruara në ligjin kombëtar, që të autorizojnë zbulimin e disa informacioneve për autoritetet e tjera kombëtare që janë përgjegjëse me ligj që të mbikëqyrin tregjet financiare, apo me përgjegjësi të përcaktuara në fushën e luftimit apo hetimit të pastrimit të parave, veprave të ndërlidhura penale përkatëse apo financimit të terrorizmit.</p> <p>Sidoqoftë, informacioni konfidencial i shkëmbyer në pajtim me këtë paragraf përdoret vetëm me qëllim të kryerjes së detyrës ligjore të atyre autoriteteve. Personat që kanë qasje në këtë informacion u nënshtrohen kërkesave të fshehtësisë profesionale ose të paktën të atyre të barasvlershme që janë cekur në nenin 57a (1).</p> <p>3. Shtetet Anëtare mund të autorizojnë zbulimin e disa informacioneve që kanë të bëjnë me mbikëqyrjen e institucioneve kreditore dhe financiare në pajtim me këtë Direktivë për Komitetet Hetimore Parlamentare, gjykatat e llogarive dhe subjektet e tjera në krye të hetimeve, në Shtetin e tyre Anëtar, sipas kushteve në vijim:</p>	<p>Marrëveshjet e bashkëpunimit në mes të autoriteteve janë paraparë në nenin 38 të Ligjit për PPP/LFT-në (shih edhe diskutimin në nenin 57a të Direktivës) në raport me bashkëpunimin për qëllime të mbikëqyrjes. Në lidhje me bashkëpunimin me mbikëqyrësit e tjerë, do të vlenin rregullimet sipas nenit 38 të Ligjit për PPP/LFT-në. Organizatat profesionale të profesionistëve ligjorë, auditorëve dhe kontabilistëve nuk kanë ndonjë rol të përkufizuar juridik në lidhje me mbikëqyrjen për qëllimet e PPP/LFT-së.</p> <p>Në lidhje me paragrafin 2, Ligji për BQK-në e lejon zbulimin në pajtim me Kodin Penal, përfshirë ndihmën për zbatimin e ligjit penal ose me urdhër të gjykatës që ka të bëjë me raste penale. Nuk është e qartë nëse informacioni mbikëqyrës në këtë rast do t'i nënshtrohej njëjtë mbrojtjes së fshehtësisë profesionale (posaçërisht kur nuk shkëmbehet si informacion i fshehtë).</p> <p>Në Kosovë nuk ka garanci mbrojtëse siç është paraparë nga paragrafi 3.</p>	Pjesërisht

Dispozitat e Direktivës (BE) 2015/849	Përshkrimi dhe Analiza e masave në Kosovë	Niveli i pajtueshmërisë
<p>(a) subjektet kanë një funksion të përpiktë sipas ligjit kombëtar për të hetuar apo shqyrtuar veprimet e autoriteteve përgjegjëse për mbikëqyrjen e atyre institucioneve kreditore ose për ligjet e lidhura me këtë mbikëqyrje;</p> <p>(b) informacioni është i nevojshëm vetëm për përmbushjen e funksionit të cekur në shkronjën (a);</p> <p>(c) personat që kanë qasje në këtë informacion u nënshtrohen kërkesave të fshehtësisë profesionale sipas ligjit kombëtar ose të paktën të atyre të barasvlershme që janë cekur në nenin 57a (1);</p> <p>(d) kur informacioni buron nga një Shtet Anëtar tjetër, ai zbulohet vetëm me pajtimin e qartë të autoritetit kompetent që e ka dhënë atë dhe, vetëm për qëllimet për të cilat ai autoritet e ka dhënë pajtimin e vet.</p>		
<p>▼B</p> <p>SEKSIONI 4 Sanksionet</p> <p style="text-align: center;">Neni 58</p> <p>1. Shtetet Anëtare sigurojnë që subjektet e detyruara mund të mbahen përgjegjëse për shkeljet e dispozitave kombëtare që e transpozojnë këtë Direktivë në pajtim me këtë nen dhe nenet 59 deri në 61. Çdo sanksion apo masë që rrjedh prej tyre është efektiv, proporcional dhe zbindës.</p> <p>2. Pa paragjykim ndaj të drejtës së Shteteve Anëtare që të parashohin dhe shqiptojnë sanksione penale, Shtetet Anëtare parashirojnë rregulla për sanksione dhe masa administrative dhe sigurojnë se autoritetet e tyre kompetente mund të shqiptojnë sanksione dhe masa në lidhje me shkeljet e dispozitave kombëtare që e transpozojnë këtë Direktivë, dhe sigurojnë zbatimin e tyre.</p> <p>Shtetet Anëtare mund të vendosin që të mos i parashirojnë rregullat për sanksionet apo masat administrative për shkeljet të cilat iu nënshtrohen sanksioneve penale në ligjin e tyre kombëtar. Në atë rast, Shtetet Anëtare ia bëjnë të ditur Komisionit dispozitat përkatëse të kodit penal.</p> <p>►M1</p>	<p>Ju lutemi referojuni Shtojcës së PT-së, R. 35 si dhe RM 3. Shtojca e PT-së përfshin një numër të mangësive në lidhje me gjuhën e disa prej shkeljeve të parapara me Ligjin për PPP/LFT-në, i cili do të rezultonte në pasiguri juridike në lidhje me aplikimin e tyre (p.sh. në lidhje me shtyrjen e operacioneve, disa prej kërkesave raportuese, etj.). Ekziston edhe një mungesë e qartësisë dhe vërtetimit në lidhje me përcaktimin e peshës së shkeljeve (duke mos marrë parasysh, në parim, natyrën, peshën, formën dhe pasojat e shkeljeve). Disa mospërputhje në mes të autorizimeve për sanksionim të mbikëqyrësve të ndryshëm, zbatueshmërinë e sanksioneve kundër drejtorëve dhe drejtuesve të lartë në mënyrë koherente, mungesën e të vërtetuarit në bazë të kriterëve objektive të sanksioneve që mund të shqiptohen, si dhe mungesat në lidhje me sanksionimin e OJQ-ve ndikojnë në proporcionalitetin dhe efektin zbindës.</p> <p>Efektiviteti i regjimit është dobësuar nga dyfishimi i përpjekjeve në punën e kryer nga NjIF-i dhe BQK-ja dhe mungesa e zbatimit të sanksioneve proporcionale dhe zbindëse të parapara me Ligjin për PPP/LFT-në.</p> <p>Rregullat për sanksionet administrative të parapara me ligjin në Kosovë do të mbulonin shumicën e kërkesave por nuk janë tërësisht në pajtim me Direktivën, ku mangësitë</p>	Pjesërisht

Dispozitat e Direktivës (BE) 2015/849	Përshkrimi dhe Analiza e masave në Kosovë	Niveli i pajtueshmërisë
<p>Shtetet Anëtare sigurojnë më tej që ku autoritetet kompetente të identifikojnë shkeljet të cilat iu nënshtrohen sanksioneve penale, ato informojnë në kohë autoritetet për zbatimin e ligjit.</p> <p>▼B</p> <p>3. Shtetet Anëtare sigurojnë që kur detyrimet janë të aplikueshme për personat juridikë, në rast të shkeljes së dispozitave kombëtare që e transpozojnë këtë Direktivë, sanksionet dhe masat mund të zbatohen ndaj anëtarëve të organit menaxhues dhe kundrejt personave të tjerë fizikë të cilët sipas ligjit kombëtar janë përgjegjës për shkeljen.</p> <p>4. Shtetet Anëtare sigurojnë që autoritetet kompetente t'i kenë të gjitha autorizimet mbikëqyrëse dhe hetuese të cilat nevojiten për ushtrimin e funksioneve të tyre.</p> <p>5. Autoritetet kompetente ushtrojnë autorizimet e tyre për të shqiptuar sanksione dhe masa administrative në pajtim me këtë Direktivë, dhe me ligjin kombëtar, në cilëndo prej mënyrave në vijim:</p> <p>(a) drejtpërdrejt;</p> <p>(b) në bashkëpunim me autoritete të tjera;</p> <p>(c) nën përgjegjësinë e tyre përmes delegimit për autoritetet e tilla të tjera;</p> <p>(d) përmes aplikimit pranë autoriteteve kompetente gjyqësore.</p> <p>Gjatë ushtrimit të autorizimit të tyre për të shqiptuar sanksione dhe masa administrative, autoritetet kompetente bashkëpunojnë ngushtë për t'u siguruar që ato sanksione dhe masa administrative të japin rezultatet e dëshiruara dhe për të bashkërenduar veprimin e tyre kur trajtohen rastet ndërkufitare.</p>	<p>vërehen në lidhje me zbatimin e kërkesave të Direktivës (p.sh. pronësinë përfituese, mungesën e transparencës së mjaftueshme të pronësisë përfituese, mungesën e disa bazave të të dhënave, etj.). Duket se ka mbulim të dyfishtë në mes të shkeljes administrative në Ligjin për PPP/LFT-në dhe veprave penale siç janë cekur në nenin 59 të të njëjtit ligj. Ky nen do të përfshinte një numër të shkeljeve që iu nënshtrohen sanksioneve penale, përfshirë kërkesat për raportim, ruajtjen e të dhënave, kërkesat për fshehtësi për NjIF-in, etj. Mbulimi i dyfishtë mund të jetë negativ për aplikimin efektiv të sanksioneve (p.sh. vendimi mbi natyrën e shkeljes dhe sanksioneve të aplikueshme pa ndonjë kriter tjetër). Nuk duket se ka kërkesa për të siguruar raportimin e shpejtë të veprave penale siç kërkohet në këtë nen të Direktivës (paragrafi 2).</p> <p>Autorizimet e përshtatshme të mbikëqyrësve ekzistojnë në përgjithësi ndonëse ndarja e përgjegjësisë në mes të BQK-së dhe NjIF-it siç është diskutuar më sipër (posaçërisht përputhja e mbikëqyrjes me detyrimet raportuese) ka efekt negativ në sistem.</p> <p>Autorizimet e autoriteteve kompetente ushtrohen kryesisht drejtpërdrejt në disa rrethana të kufizuara në bashkëpunim me autoritetet e tjera (p.sh. kërkesat raportuese të subjekteve të detyruara siç është cekur më sipër).</p> <p>Rastet ndërkufitare do të ndikoheshin nga efektiviteti i paqartë i bashkëpunimit ndërkombëtar të zhvilluar nga BQK-ja (ju lutemi shikoni RM 2).</p>	
<p align="center">Neni 59</p> <p>1. Shtetet Anëtare sigurojnë që ky nen të zbatohet së paku për shkeljet e kërkesave nga ana e subjekteve të detyruara që janë të rënda, të përsëritura, sistematike, apo një kombinim i tyre, siç janë parashtruar në:</p>	<p>Ligji për PPP/LFT-në i parasheh sanksionet e njëjta në lidhje me shkeljet e dispozitave për KDK-në, raportimin, ruajtjen e të dhënave dhe politikave, procedurave dhe kontrolleve të brendshme. Sidoqoftë, ekziston një numër i mangësive të cilat janë vërejtur në raport me zbatimin e kërkesave të të gjitha dispozitave të përmendura – nenet</p>	<p>Pjesërisht</p>

Dispozitat e Direktivës (BE) 2015/849	Përshkrimi dhe Analiza e masave në Kosovë	Niveli i pajtueshmërisë
<p>(a) nenet 10 deri në 24 (kujdesi i duhur ndaj klientit);</p> <p>(b) nenet 33, 34 dhe 35 (raportimi i transaksioneve të dyshimta);</p> <p>(c) nenin 40 (ruajtja e të dhënave); dhe</p> <p>(d) nenet 45 dhe 46 (kontrollet e brendshme).</p> <p>2. Shtetet Anëtare sigurojnë që në rastet e cekura në paragrafin 1, sanksionet dhe masat administrative që mund të aplikohen të përfshijnë së paku:</p> <p>(a) një deklaratë publike e cila e identifikon personin fizik apo juridik dhe natyrën e shkeljes;</p> <p>(b) një urdhër që i kërkon personit fizik apo juridik të ndërpresë sjelljen dhe që të reshtë së përsërituri atë sjellje;</p> <p>(c) kur një subjekt i detyruar i nënshtrohet një autorizimi, tërheqjen apo pezullimin e atij autorizimi;</p> <p>(d) një ndalim të përkohshëm ndaj çdo personi që ushtron përgjegjësi menaxhuese në një subjekt të detyruar, apo çdo personi tjetër fizik, që mbahet përgjegjës për shkeljen, për të ushtruar funksione menaxhuese në subjektin e detyruar;</p> <p>(e) sanksione administrative financiare maksimale në së paku dyfishin e shumës së përfitimit nga shkelja kur ai përfitim mund të përcaktohet, ose së paku 1.000.000 euro.</p> <p>3. Shtetet Anëtare sigurojnë që, pavarësisht nga paragrafi 2(e), kur subjekti i detyruar në fjalë është një institucion kreditor apo financiar, mund të zbatohen edhe këto sanksione:</p> <p>(a) në rast të një personi juridik, sanksione administrative financiare maksimale prej së paku 5.000.000 euro apo 10% e qarkullimit të përgjithshëm vjetor sipas pasqyrave më të fundit në dispozicion që janë të miratuara nga organi menaxhues; kur subjekti i detyruar është një ndërmarrje mëmë apo filial i një ndërmarrjeje mëmë e cila duhet të përgatisë pasqyrat e konsoliduara financiare në pajtim me nenin 22 të Direktivës 2013/34/EU, qarkullimi i përgjithshëm vjetor përkatës është qarkullimi i përgjithshëm vjetor i llojit korrespondues të të hyrave në pajtim me direktivat përkatëse të</p>	<p>10 deri në 24, 33 deri në 35, 40, 45 dhe 46 të Direktivës. Prandaj, sanksionet nuk mund të shqiptohen në lidhje me elementet të cilët janë identifikuar se mungojnë sipas këtyre dispozitave.</p> <p>Në lidhje me paragrafin 2 vërehet si në vijim:</p> <p>Nuk ka detyrim që të identifikohet natyra e shkeljes si pjesë e vërejtjes publike me shkrim që mund të shqiptohet. Vërejtja publike po ashtu nuk ekziston për kundërvajtjet të cilat do të përfshinin elementet e neneve 33 deri në 35 dhe 40 të Direktivës (shtyrja e operacioneve në bazë të kërkesës së huaj, identifikimi dhe verifikimi i klientit për lojërat e fatit, raportimi i profesionistëve juridikë dhe kërkesat për ruajtjen e të dhënave, etj.).</p> <p>Ligji për PPP/LFT-në parasheh (neni 49) që pas pranimit të vendimit për shqiptimin e sanksionit administrativ, subjekti raportues duhet të ndërmarrë masa për të siguruar pajtueshmërinë me këtë Ligj, gjë që duhet të bëhet brenda afatit të caktuar në vendim. Pajtueshmëria e subjektit raportues me dispozitat e këtij Ligji do të verifikohet dhe nëse subjekti raportues, kundërshtues të cilit është shqiptuar një sanksion administrativ, nuk ka ndërmarrë veprime për pajtueshmëri, kundër tij mund të shqiptohet një gjobë monetare ditore. Kjo mund të konsiderohet si e mjaftueshme për të përmbushur kërkesat e shkronjës (b) të paragrafit 2 të nenit 59 të Direktivës përpos atyre shkeljeve në paragrafin 1 të përkufizuara në ligjin e Kosovës si kundërvajtje (shih më sipër).</p> <p>Shkronja (c) është plotësuar për të gjitha kërkesat përpos për shkeljet në paragrafin 1, të përkufizuara në ligjin e Kosovës si kundërvajtje (shih më sipër).</p> <p>Shkronja (d) është plotësuar përpos për shkeljet në paragrafin 1, të përkufizuara në ligjin e Kosovës si kundërvajtje (shih më sipër).</p> <p>Shumat e sanksioneve financiare nuk janë në pajtim me Direktivën.</p>	

Dispozitat e Direktivës (BE) 2015/849	Përshkrimi dhe Analiza e masave në Kosovë	Niveli i pajtueshmërisë
<p>kontabilitetit sipas pasqyrave të fundit të konsoliduara që janë në dispozicion e të cilat janë të miratuara nga organi menaxhues i ndërmarrjes finale mëmë;</p> <p>(b) në rast të një personi fizik, sanksione administrative financiare maksimale prej së paku 5.000.000 euro, apo në Shtetet Anëtare valuta e të cilave nuk është euro, vlerën korresponduese në valutën kombëtare më 25 qershor 2015.</p> <p>4. Shtetet Anëtare mund të autorizojnë autoritetet kompetente që të shqiptojnë lloje shtesë të sanksioneve administrative krahas atyre që janë cekur në shkronjat (a) deri në (d) të paragrafit 2 apo për të shqiptuar sanksione administrative financiare që i tejkalojnë shumat e cekura në shkronjën (e) të paragrafit 2 dhe në paragrafin 3.</p>		
<p style="text-align: center;">Neni 60</p> <p>1. Shtetet Anëtare sigurojnë që një vendim që shqipton një sanksion apo masë administrative për shkeljen e dispozitave kombëtare që e transpozojnë këtë Direktivë, kundër të cilave nuk ka ankesa publikohen nga autoritetet kompetente në faqen e tyre zyrtare të internetit menjëherë pasi që personi i sanksionuar të jetë informuar për atë vendim. Publikimi përfshin së paku informacion për llojin dhe natyrën e shkeljes dhe identitetin e personave përgjegjës. Shtetet Anëtare nuk janë të detyruara që të zbatojnë këtë nënparagraf ndaj vendimeve që shqiptojnë masa që janë të natyrës hetimore.</p> <p>Kur publikimi i identitetit të personave përgjegjës që janë cekur në nënparagrafin e parë, apo të të dhënave personale të personave të tillë konsiderohet nga autoriteti kompetent se është në shpërpjesëtim pas një vlerësimi rasti pas rasti i cili bëhet për proporcionalitetin e publikimit të të dhënave të tilla, apo kur publikimi rrezikon stabilitetin e tregjeve financiare apo një hetim në vazhdim e sipër, autoritetet kompetente:</p> <p>(a) shtyjnë publikimin e vendimit për të shqiptuar një sanksion apo masë administrative deri në atë moment kur arsyet për mospublikimin e tij pushojnë së ekzistuari;</p> <p>(b) publikojnë vendimin për të shqiptuar një sanksion apo masë administrative në baza anonime në pajtim me ligjin kombëtar, nëse publikimi i tillë anonim e siguron mbrojtjen efektive të të dhënave personale në fjalë; në rastin e vendimit për të publikuar një sanksion apo masë administrative në baza anonime, publikimi i të dhënave mund të shtyhet për një kohë të arsyeshme nëse parashihet se gjatë asaj</p>	<p>Neni 55 i Ligjit për PPP/LFT-në parasheh publikimin e të gjitha vendimeve përfundimtare që kanë të bëjnë me sanksionet administrative nga të gjithë mbikëqyrësit. Fushëveprimi i informacionit të kërkuar që të publikohet është në pajtim me Direktivën. Sidoqoftë, nuk parashihet mundësia për vonesa me kushtin e skadimit të arsyeve për të mos kryer publikimin (sanksioni i shqiptuar apo të dhënat e personit).</p> <p>Paragrafi 2 nuk është i aplikueshëm në Kosovë.</p> <p>Paragrafi 3 është plotësuar.</p> <p>Në raport me paragrafin 4 të këtij neni të Direktivës, neni 49, paragrafi 2 i Ligjit për PPP/LFT-në i referohet shumicës së kushteve të parapara për të përcaktuar sanksionin. Sidoqoftë, Ligji për PPP/LFT-në nuk i parasheh "përfitimet" e shkelësit siç parashihet në paragrafin 4 shkronja (d). Ajo që është më e rëndësishme, në legjislacion nuk janë paraparë procedura për të siguruar mënyrën se si këto kritere do të futeshin në vendimet për sanksionim. Vëllimi ekonomik i transaksionit do të mund të vlerësohej në përcaktimin e shumës së sanksionit material për shkelje të rënda dhe shumë të rënda, por ai nuk mund të merret në konsideratë sikurse përfitimi nga shkelja.</p> <p>Legjislacioni i Kosovës nuk është në pajtim me paragrafin 5 pasi që personat që veprojnë (p.sh. individualisht) nën autorizimin për të përfaqësuar personin juridik janë përjashtuar nga neni 47 i Ligjit për PPP/LFT-në.</p>	Pjesërisht

Dispozitat e Direktivës (BE) 2015/849	Përshkrimi dhe Analiza e masave në Kosovë	Niveli i pajtueshmërisë
<p>kohe arsyet për publikimin anonim pushojnë së ekzistuari;</p> <p>(c) nuk e publikojnë vendimin për të shqiptuar një sanksion apo masë administrative fare në rast se alternativat e parashtruara në shkronjat (a) dhe (b) konsiderohen si të pamjaftueshme:</p> <p>(i) për të shmangur që stabiliteti i tregjeve financiare të vihet në rrezik; ose</p> <p>(ii) për të siguruar përpjesëtimin e publikimit të vendimit në raport me masat të cilat vlerësohen se janë të një natyre më të vogël.</p> <p>2. Kur Shtetet Anëtare e lejojnë publikimin e vendimeve kundër të cilave është parashtruar ankesë, autoritetet kompetente publikojnë, menjëherë, në faqen e tyre zyrtare në internet këtë informacion dhe çdo informacion të mëvonshëm mbi rezultatin e asaj ankese. Për më tepër, çdo vendim që e hedh poshtë vendimin e mëparshëm për të shqiptuar sanksione apo masa administrative publikohet, po ashtu.</p> <p>3. Autoritetet kompetente sigurojnë që publikimi në pajtim me këtë nen mbetet në faqen e tyre zyrtare në internet për një periudhë prej pesë vjetësh pas publikimit të saj. Sidoqoftë, të dhënat personale të përmendura në atë publikim mbahen në faqen zyrtare të internetit të autoritetit kompetent për periudhën që është e nevojshme në pajtim me rregullat në fuqi për mbrojtjen e të dhënave.</p> <p>4. Shtetet Anëtare sigurojnë që kur të vendoset lloji dhe niveli i sanksioneve dhe masave administrative, autoritetet kompetente marrin parasysh të gjitha rrethanat përkatëse, përfshirë kur janë të aplikueshme:</p> <p>(a) peshën dhe kohëzgjatjen e shkeljes;</p> <p>(b) shkallën e përgjegjësisë së personit përgjegjës fizik apo juridik;</p> <p>(c) gjendjen financiare të personit përgjegjës fizik apo juridik, siç është cekur për shembull nga qarkullimi vjetor i personit juridik përgjegjës apo të hyrat vjetore të personit fizik përgjegjës;</p> <p>(d) përfitimin nga shkelja të personit përgjegjës fizik apo juridik, për aq sa mund të përcaktohet;</p> <p>(e) humbjet e palëve të treta nga shkelja, për aq sa ato mund të përcaktohen;</p>	<p>Ligji i Kosovës nuk parasheh sanksionimin e personave juridikë në bazë të mungesës së mbikëqyrjes apo kontrollit nga një person siç është cekur në paragrafin 5, gjë që ka çuar në shkeljen e kërkesave nga një person nën autoritetin e tyre.</p>	

Dispozitat e Direktivës (BE) 2015/849	Përshkrimi dhe Analiza e masave në Kosovë	Niveli i pajtueshmërisë
<p>(f) nivelin e bashkëpunimit me autoritetin kompetent të personit përgjegjës fizik apo juridik;</p> <p>(g) shkeljet e mëparshme nga personi përgjegjës fizik apo juridik.</p> <p>5. Shtetet Anëtare sigurojnë që personat juridikë mund të mbahen përgjegjës për shkeljet e cekura në nenin 59(1) të kryera për dobinë e tyre nga çdo person, që ka vepruar si individ apo si pjesë e një organi të atij personi juridik, dhe që ka pozitë udhëheqëse në kuadër të personit juridik në bazë të sa vijon:</p> <p>(a) autorizimit për të përfaqësuar personin juridik;</p> <p>(b) autoritetit për të marrë vendime në emër të personit juridik; apo</p> <p>(c) autoritetit për të ushtruar kontroll në kuadër të personit juridik.</p> <p>6. Shtetet Anëtare, po ashtu, sigurojnë që personat juridikë mund të mbahen përgjegjës kur mungesa e mbikëqyrjes apo kontrollit nga një person i cekur në paragrafin 5 të këtij neni e ka mundësuar kryerjen e ndonjëris prej shkeljeve të cekura në nenin 59(1) në dobi të atij personi juridik nga një person në autoritetin e tij.</p>		
<p style="text-align: center;">Neni 61</p> <p>►M1</p> <p>1. Shtetet Anëtare sigurojnë që autoritetet kompetente, si dhe, kur është e aplikueshme, organet vetërregulluese, krijojnë mekanizma efektivë dhe të besueshëm për të nxitur raportimin përpara autoriteteve kompetente, si dhe, sipas rastit, edhe të organeve vetërregulluese, shkeljet e mundshme apo faktike të dispozitave kombëtare që e transpozojnë këtë Direktivë.</p> <p>Për këtë qëllim, ato ofrojnë një apo më shumë kanale të sigurta të komunikimit për personat për raportimin e cekur në nënparagrafin e parë. Kanalet e tilla mundësojnë që identiteti i personave që e ofrojnë informacionin të jetë i njohur vetëm për autoritetet kompetente, si dhe kur është e aplikueshme, për organet vetërregulluese.</p> <p>▼B</p>	<p>Ligji i Kosovës nuk parasheh ndonjë detyrim për plotësimin e kërkesave të paragrafit 1 dhe 2 si dhe të nënparagrafit të parë të paragrafit 3. Nuk ekzistojnë dispozita për të siguruar mbrojtjen e individëve të cilët janë të ekspozuar ndaj kërcënimeve, veprimeve hakmarrëse apo armiqësore, apo veprimeve punësuese negative apo diskriminuese për raportimin e pastrimit të parave apo financimit të terrorizmit.</p>	<p>Në mospërputhje</p>

Dispozitat e Direktivës (BE) 2015/849	Përshkrimi dhe Analiza e masave në Kosovë	Niveli i pajtueshmërisë
<p>2. Mekanizmat e cekur në paragrafin 1 përfshijnë:</p> <p>(a) procedurat specifike për pranimin e raporteve për shkeljet dhe përcjelljen e tyre;</p> <p>(b) mbrojtjen e duhur për punonjësit, apo personat në pozitë të ngjashme, të subjekteve të detyruara të cilët i raportojnë shkeljet në kuadër të subjektit të detyruar;</p> <p>(c) mbrojtjen e duhur për personin e akuzuar;</p> <p>(d) mbrojtjen e të dhënave personale si të personit që i raporton shkeljet po ashtu edhe të personit fizik i cili pretendohet se është përgjegjës për një shkelje, në pajtim me parimet e parashtruara në Direktivën 95/46/EC;</p> <p>(e) rregulla të qarta që sigurojnë se konfidencialiteti është i garantuar në të gjitha rastet në raport me personin që i raporton shkeljet e kryera në kuadër të subjektit të detyruar, përveç nëse zbulimi nuk kërkohet me ligjin kombëtar në kontekstin e hetimeve të mëtutjeshme apo procedurat gjyqësore pasuese.</p> <p>3. Shtetet Anëtare iu kërkojnë subjekteve të detyruara që të kenë procedurat e duhura për punonjësit e tyre, apo personat në pozita të ngjashme, për të raportuar shkeljet brenda subjektit përmes një kanali specifik, të pavarur dhe anonim, në përpjesëtim me natyrën dhe madhësinë e subjektit të detyruar në fjalë.</p> <p>► M1</p> <p>Shtetet Anëtare sigurojnë që individët, përfshirë individët dhe përfaqësuesit e subjektit të detyruar të cilët i raportojnë brenda subjektit apo pranë NjIF-it dyshimet për pastrimin e parave apo financimin e terrorizmit janë ligjërisht të mbrojtur nga ekspozimi ndaj kërcënimeve, veprimeve hakmarrëse apo armiqësore, dhe posaçërisht ndaj veprimeve punësuese negative apo diskriminuese.</p> <p>Shtetet Anëtare sigurojnë që individët të cilët janë të ekspozuar ndaj kërcënimeve, veprimeve hakmarrëse apo armiqësore, apo veprimeve punësuese negative apo diskriminuese për raportimin e pastrimit të parave apo financimit të terrorizmit brenda subjektit apo pranë NjIF-it kanë të drejtë që të parashtrorjnë ankesë në mënyrë të sigurt pranë autoriteteve kompetente përkatëse. Pa paragjykim ndaj</p>		

Dispozitat e Direktivës (BE) 2015/849	Përshkrimi dhe Analiza e masave në Kosovë	Niveli i pajtueshmërisë
<p>konfidencialitetit të informacionit të mbledhur nga NjIF-i, Shtetet Anëtare gjithashtu, sigurojnë se individët e tillë e gëzojnë të drejtën e mjetit juridik efektiv për të mbrojtur të drejtat e tyre sipas këtij paragrafi.</p>		
<p>▼B</p> <p style="text-align: center;">Neni 62</p> <p>1. Shtetet Anëtare sigurojnë që autoritetet e tyre kompetente informojnë AME-të për të gjitha sanksionet dhe masat administrative të shqiptuara në pajtim me nenet 58 dhe 59 për institucionet kreditore dhe financiare, përfshirë çdo ankesë në lidhje me to dhe rezultatin e tyre.</p> <p>2. Shtetet Anëtare sigurojnë që autoritetet e tyre kompetente, në pajtim me ligjin e tyre kombëtar, kontrollojnë ekzistencën e dënimeve përkatëse në regjistrin penal të personit në fjalë. Çdo shkëmbim i informacionit për këto qëllime kryhet në pajtim me Vendimin 2009/316/JHA dhe Vendimin Kornizë 2009/315/JHA siç është zbatuar në ligjin kombëtar.</p> <p>3. AME-të mbajnë një faqe interneti me vegza për secilin publikim të sanksioneve dhe masave administrative të autoriteteve kompetente të shqiptuara në pajtim me nenin 60 mbi institucionet kreditore dhe financiare, dhe tregojnë periudhën kohore për të cilën secili Shtet Anëtar i publikon sanksionet dhe masat administrative.</p>	Nuk aplikohet	Nuk aplikohet
Nenet 63 deri në 69	Nuk aplikohet	Nuk aplikohet